REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Vëllimi I

janar - qershor 2017

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Z. Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Prof. Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Kontribuesit:

Anita Çavdarbasha
Bardh Bokshi
Burim Hoxha
Jeton Bytyqi
Veton Dula

© 2017 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqëson formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

janar – qershor 2017

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e Përmbajtjes:

1. Parathënie:..... 11
2. KI96/15, Parashtrues: Mirsad Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 59/2015, të 20 majit 2015 12
3. KI84/15, Parashtrues: Selman Mustafa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës se Kosovës, Rev. 3/2015, të 28 prillit 2015 18
4. KI 80/15, KI81/15 and KI82/15 (të bashkuara), Parashtrues: Rrahim Hoxha Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 188/2014, 189/2014, të 19 janarit 2015, dhe të Aktvendimit Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015 26
5. KI 66/15, Parashtrues: Bekim Baliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2015, të 23 shkurtit 2015 . 32
6. KI91/16, Parashtrues: Belkis Abazi, Fahrije Nuhiu, Bedrije Vërtopi, Ilaz Bullatovci, Atije Zeqiri, Artan Shabani, Dardane Xërxa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit, AC-I-13-0264, të 21 janarit 2016 39
7. KI137/16, Parashtrues: Agdi Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016, të 23 qershorit 2016 48
8. KI87/16, Parashtrues: Nafije Bakalli, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0189, të 18 shkurtit 2016 55
9. KI08/16, Parashtrues: Premtim Provolija, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 220/2015, të 17 nëntorit 2015 65
10. KI67/16, Parashtruese: Lumturije Voca, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-041/14, të 2 dhjetorit 2015..... 74
11. KI88/16, Parashtrues: Kompania N.T.SH. "ELING", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN nr. 3/2016, të 14 prillit 2016, i cili i është dorëzuar asaj më 25 maj 2016. 93
12. KO120/16, Parashtrues: Slavko Simic dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës 100
13. KI113/15, Parashtrues: Ramë Ramaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 80/2014, të 14 prillit 2014....124
14. KI62/16, Parashtrues: Bekë Lajçi, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1961/2015, të 16 nëntorit 2015 130
15. KI145/16, Parashtrues: Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani, Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016 141
16. KI34/16, Parashtrues: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit (nr. prot. 55) të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina“, të 14 janarit 2016 148

17. KI01/16, Parashtrues: Agim Arifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSP-KPA-A-ll0-13, të 20 korrikut 2015 154
18. KO12/17, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje..... 159
19. KI 84/16, Parashtrues: Hilmi Krasniqi Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR 13/2014, të 27 marsit 2015, i cili i është dorëzuar atij më 11 prill 2015 167
20. KI102/16, Parashtrues: Shefqet Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016 172
21. KI96/16, Parashtrues: Shaha Salihu-Fetahu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-0293, të 6 prillit 2016 181
22. KI82/16, Parashtrues: Đeljalj Kazagić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2016, të 10 shkurtit 2016 187
23. KI103/15, Parashtrues: Skender Vitia, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 88/2015, të 29 prillit 2015 ...199
24. KI106/16, Parashtrues: Shaban Hasani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0148-A0001, të 31 marsit 2016 205
25. KI73/15 dhe KI 85/15, Parashtrues: Hysni Gashi dhe Ali Rashani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme Rev. nr. 346/2014, i 24 marsit 2015, i cili u është dorëzuar atyre më 5 maj 2015 211
26. KI50/16, Parashtrues: Veli Berisha dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.276/2015, të tetorit 2015 221
27. KI124/16, Parashtrues: Senad Rama, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. I. Nr. 1802/2016, të 13 tetorit 2016 228
28. KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017 235
29. KI31/17, Parashtrues: Shefqet Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM. Nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016.....241
30. KI110/16, Parashtrues: Nebojša Đokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimi të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 155/2016, të 14 qershorit 2016 250
31. KO01/17, Parashtrues: Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës se Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës..... 257
32. KO12/17, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje..... 282
33. KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr. 50/2017, të 6 marsit 2017 286

34. KI105/16, Parashtrues: Fetih Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009 290
35. KI103/16, Parashtrues: Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. nr. 174/16, të 11 korrikut 2016 295
36. KI44/16, Parashtruese: Biljana Topko nga Beogradi, Republika e Serbisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A225/13, të 4 shtatorit 2015 302
37. KI02/17, Parashtrues i kërkesës: Fadil Aziri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-015/2014, të 20 prillit 2016 311
38. KI119/16, Parashtrues: Xhemail Lani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 7 qershorit 2016 319
39. KI23/16, Parashtrues: Qazim Bytyqi dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit 325
40. KI114/16, Parashtrues: Feriz Gashi dhe Hysni Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Api-Kzi-6/2011, të 25 shtatori 2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz.nr.283/2009, të 19 prillit 2011 337
41. KO12/17, Parashtruesi: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje 342
42. KO126/16, Parashtrues: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën 359
43. KI137/16, Parashtrues: Agdi Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016, të 23 qershorit 2016 372
44. KI101/16, Parashtrues: Ukë Balaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 94/16, të 11 majit 2016 379
45. KI26/16 Parashtrues: Januz Fazliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [AC-I-14-0311-A0001-A0023] 387
46. KI41/16, Parashtrues: Bedrije Rama, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.5/2015, të 17 dhjetorit 2015 395
47. KI132/16, Parashtrues: Musa Torbani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 97/2016, të 14 qershorit 2016 405
48. KI111/16, Parashtrues: Asllan Zenuni, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. S/16, të 2 shkurtit 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4370/15, të 18 dhjetorit 2015 411
49. KI 75/16, Parashtrues: Teatri Kombëtar i Kosovës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 56/2016, te 17 marsit 2016 416
50. KI68/16, Parashtrues: Fadil Rashiti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 249/2015, të 3 dhjetorit 2015 422

51. KI58/16, Parashtrues Kadri Emini, Skender Emini, Flamur Emini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.8/2016, të 26 janarit 2016 432
52. KI141/15, Parashtrues: Hajdar Podrimja, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP nr. 29/2015, të 29 tetorit 2015 438
53. KI 22/16, Parashtrues: Naser Husaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015 444
54. KI109/16, Parashtrues: Lumni Limaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi ose akti të pacaktuar të një autoriteti publik. 454
55. KI148/16, Parashtrues: Mitat Qovanaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014 459
56. KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr. 50/2017, të 6 marsit 2017 465
57. KI147/16, Parashtrues: Asllan Fazliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 250/2016, të 13 tetorit 2016 494
58. KI145/16, Parashtrues: Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani, Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016 501
59. KI138/16, Parashtrues: Gani Gërbeshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Kzz. 136/16, të 14 korrikut 2016 510
60. KI133/16, Parashtrues: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "3CIS JSC", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 232/2015, të 9 marsit 2016 517
61. KI117/16, Parashtrues: Rexhep Lushtaku, Tahir Meha, Shefqet Bytyqi, Bedri Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.nr.18/16, të 23 prillit 2016 525
62. KI112/16, Parashtrues: N.T.SH. "LOKI", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 110/16, të 7 qershorit 2016 537
63. KI30/16, Parashtrues: KONZORCIUMI"ALFA.i" Sh.p.k. & "INFRATEK", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. rev. nr. 44/2015, të 18 nëntorit 2015 546
64. KI144/16, Parashtrues: Salih Gerqina, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta 2009 555
65. KI141/16, Parashtrues: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Agrounion", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016 dhe Njoftimit të Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016 560
66. KI31/17, Parashtrues: Shefqet Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM. Nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016 568
67. KI127/15, Parashtrues: Mile Vasović, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në zhvillim në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07) 584
68. KI07/17, Parashtrues: Pashk Mirashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, të 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR nr. 231/2015, të 6 gushtit 2015 593
69. INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE 604

70. INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS 616
71. SHKELJE TË NENIT 24, 31, 32, 46, 54 TË KUSHTETUTËS.....617

Parathënie:

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, të shkruaj këtë parathënie për Buletinin e 7-të të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Buletini është bërë pikë referimi, i dobishëm dhe i cituar shpesh nga ata që punojnë në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të të drejtave e lirive themelore të njeriut. Edhe këtë herë jemi përkushtuar të tregojmë disa nga rezultatet kryesore të punës sonë gjatë gjysmës së parë të vitit 2017.

Ky edicion i Buletinit përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe më të rëndësishme, duke përfshirë një kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në të ashtuquajturin 'kontroll incidental' për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, dhe një kërkesë tjetër, të dorëzuar nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të ashtuquajturin 'kontroll abstrakt', për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjatë gjysmës së parë të këtij viti, Gjykata po ashtu ka nxjerrë edhe vendime të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me kërkesat individuale në të cilat janë trajtuar çështje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të mbrojtjes së pronës, të konceptit të shterimit të mjeteve juridike dhe të procesit të rregullt zgjedhor të kryetarëve të gjykatave të zakonshme.

Është e rëndësishme të theksohet që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, të konsultojnë me vëmendje këtë Buletin, si dhe buletinët e mëparshëm, dhe të vlerësojnë nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi, duke iu referuar vendimeve të ngjashme të Gjykatës. Duhet kuptuar qartë që, parimisht, e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por që do të ishte e dobishme që ata paraprakisht të njoftohen me jurisprudencën e Gjykatës dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e kërkesës së tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletin është t'i tregohet opinionit të gjerë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI96/15 Parashtrues i kërkesës: Mirsad Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 59/2015, të 20 majit 2015

KI96/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 tetorit 2016, i publikuar më 11 janar 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës në vitin 2014 ka qenë njëri nga akterët e aksidentit të trafikut me fatalitet. Më 7 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prizren [me Aktgjykimin P. nr. 901/2014] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shkaktimin e aksidentit të trafikut dhe e dënoi me dënim me burg. Ky Aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit.

Parashtruesi i kërkesës ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Gjykata Supreme mori Aktvendimin [Pzd. nr. 59/2015] me të cilin është refuzuar, si e pabazuar, kërkesa e parashtruesit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata vërtetoi se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme sepse në procedurën e zbatuar nuk ka asgjë që tregon se procedurat para gjykatave të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI96/15

Parashtrues

Mirsad Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 59/2015, të 20 majit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Mirsad Gashi nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Natal Bullakaj, avokat nga Suhareka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 59/2015, të 20 majit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin, siç pretendohet, është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 23 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 19 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 3 gusht 2016, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës në vitin 2014 ka qenë njëri nga akterët e aksidentit të trafikut me fatalitet.

12. Më 7 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prizren [me Aktgjykimin P. nr. 901/2014] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shkaktimin e aksidentit të trafikut dhe e dënoi me dënim me burg.

13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren [P. nr. 901/2014].

14. Më 9 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit [me Aktgjykimin PA1. nr. 1350/2014] refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren.

15. Parashtruesi i kërkesës, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

16. Më 20 maj 2015, Gjykata Supreme [me Aktvendimin Pzd. nr. 59/2015] refuzoi kërkesën e parashtruesit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren. Gjykata Supreme në arsyetimin, *inter alia,* thekson se:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikonin në një dënim më të butë.*
> *[...]*
> *nga certifikata mjekësore e bashkangjitur kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, nuk mund të kuptohet diagnoza e sëmundjes së të dënuarit përveç që theksohet se ekzistojnë ca sëmundje mendore aq edhe fizike të cilat kërkojnë një trajtim ndërsa sqarime dhe trajtime të tjera janë planifikuar tek mjekët specialist konstatim ky i cili për gjykatën është i pakuptueshëm. Megjithatë, kjo Gjykatë konsideron se kjo rrethanë edhe pse konsiderohen si e re, nuk është e asaj natyre e cila në kuptim me dispozitën e lartcekur ligjore e justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale të të dënuarit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe pasojat e shkaktuara ku kanë gjetur vdekjen tre persona ...".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet të Gjykatës Themelore, të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të:

> "*... vlerësojë kushtetutshmërinë e aktgjykimeve dhe aktvendimeve që Gjykata e shkallës së parë - Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin P. nr. 901/14 të dt. 07.08.2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1 nr. 1350/14, Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme kanë bërë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së RKS-së - e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nuk janë marrë për bazë pretendimet e dhëna dhe propozojmë që: Gjykata Kushtetuese ta obligon Gjykatën e Apelit TA NDRYSHOJ Aktgjykimin e shkallës së parë apo të kthej çështjen në rigjykim, apo që Gjykatën Supreme të Kosovës që ta miratoj kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit*".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të zgjidhë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Neni 49 i Ligjit, gjithashtu, përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

22. Në këtë rast Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (c), (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

> *"(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi.*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

23. Në rastin konkret, duke i shqyrtuar shkresat e lëndës Gjykata gjeti se parashtruesi i kërkesës kishte dy procedura në gjykatat e rregullta në të cilat vendimet ishin marrë për çështje të ndryshme.

24. Procedura e parë kundër parashtruesit të kërkesës është iniciuar nga Prokuroria Themelore më 3 qershor 2014. Kjo procedurë kishte përfunduar më 9 dhjetor 2014 me Aktgjykimin [PA1. nr. 1350/14] të Gjykatës së Apelit dhe kështu Aktgjykimi [P. nr. 901/2014] i Gjykatës Themelore, me të cilin parashtruesi është shpallur fajtor, mori formën e prerë.

25. Gjykata vëren se në procedurën e lartpërmendur u vendos në bazë të meritave të pretendimeve të Prokurorisë se parashtruesi e kishte kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378, paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, për të cilën ai u dënua me vendim të formës së prerë.

26. Vërtetimi i ekzistimit të veprës penale të parashtruesit u mbyll me vendim të formës së prerë më 9 dhjetor 2014, ndërsa kërkesa e parashtruesit është dorëzuar më 13 korrik 2015, që është më shumë se katër muaj pas vendimit të formës së prerë.

27. Prandaj, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, kërkesa në lidhje me grupin e parë të procedurave duhet të refuzohet si e paafatshme.

28. Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të promovuar sigurinë juridike, duke siguruar që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

29. Sa i përket procedurës së dytë, Gjykata vëren se e njëjta ka të bëjë me një kërkesë të parashtruar nga parashtruesi për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Parashtruesi e ka iniciuar këtë procedurë më 26 mars 2015.

30. Kjo procedurë përfundoi më 20 maj 2015, kur Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Pzd. nr. 59/2015], me të cilin është refuzuar, si e pabazuar, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në pajtim me nenin 429 të KPPK-së, i cili përcakton standardet që duhet të përmbushen si bazë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të shqiptuar në formë të prerë.

31. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në këtë procedurë, Gjykata Supreme vendosi vetëm për përmbushjen e kushteve procedurale për zbutjen e dënimit të shqiptuar, dhe jo për meritat e rastit, i cili përfundoi me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit, të 9 dhjetorit 2014.

32. Në fakt, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim të qartë dhe përfundime të sakta duke u mbështetur në gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën gjyqësore. Nga ana tjetër, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse i janë shkelur të drejtat me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, e cila konstatoi se kërkesa e tij është e pabazuar.

33. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2129/2013, të 5

dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

34. Për më tepër, Gjykata konsideron se në procedurën e zbatuar nuk ka asgjë që tregon se procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se referimi në shkeljen e Kushtetutës është i pabazuar.

35. Për arsyet e cekura në paragrafët 26 dhe 31, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c), (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (c), (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI84/15, Parashtrues: Selman Mustafa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës se Kosovës, Rev. 3/2015, të 28 prillit 2015

KI84/15: Aktvendim për papranueshmëri i 14 shtatorit 2016, i publikuar më 11 Janar 2017.

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta e punës, KEDNJ, aktvendim për papranueshmëri, e pabazuar në baza kushtetuese.*

Më 1 tetor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. 3/2015, të datës 23 Mars 2015, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, duke arsyetuar se parashtruesi nuk kishte të drejtë për kompensimin e dëmit të zakonshëm dhe fitimin e humbur në pajtim me nenin 189 (1) te Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, për shkak të pensionimit të tij me 28 tetor 2008.

Me 19 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta apo autoritetet tjera publike, pasi që roli i tyre është, kur është e zbatueshme, të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se si ishte shkelur Kushtetuta, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 te Ligjit. Prandaj, Gjykata përfundoi se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI84/15

Parashtrues

Selman Mustafa

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 3 /2015, të 28 prillit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Selman Mustafa nga Vushtrria (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Nexhat Beqiri, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. 3/2015, të 23 marsit 2015, me të cilin ishte refuzuar revizioni i tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 4895/2012, të 1 tetorit 2014.

3. Vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 maj 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. 3/2015, i cili sipas parashtruesit të kërkesës "*është në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe në Protokollet e saj, me të cilën rregullohet e drejta e punës së qytetarit*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI84/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI84/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 23 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 14 mars 2016, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj një numri të madh të pyetjeve të gjyqtarit raportues.

10. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

11. Në fillim të vitit shkollor 2008/2009, parashtruesi i kërkesës nënshkroi kontratën për të dhënë mësim në Gjimnazin "Eqrem Çabej" në Vushtrri, nga 1 shtatori 2008 deri më 31 gusht 2009.

12. Me Vendimin 10 nr. 467, të 21 tetorit 2008, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë të Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: Drejtori), në pajtim me nenin 35.1 (a) të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, e njoftoi parashtruesin se kontrata e tij e punës do të ndërpritet, për arsye se ky i fundit do të përfundojë punësimin e tij në shërbimin civil në ditën e arritjes së moshës 65 vjeçare, që është, 28 tetori 2008.

13. Për këtë qëllim, Drejtori e ka hequr datën e skadimit të kontratës (31 gusht 2009) dhe me laps e kishte ndryshuar atë në 28 tetor 2008.

14. Më 13 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës shkoi në Stacionin Policor në Vushtrri për të raportuar një rast të "falsifikimit të dokumenteve".

15. Kundër Vendimit të Drejtorit, parashtruesi u ankua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejmë: KPM), duke pretenduar se, në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 18/2005 të 12 majit 2005 për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 345/2-1 të 2 marsit 2004 për pensionimin e mësimdhënësve (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi Administrativ nr. 18/2005) të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Drejtori u ka mundësuar të gjithë mësimdhënësve të tjerë që ta përfundojnë vitin shkollor, edhe pse ata kishin arritur moshën 65 vjeçare, por atij ia kishte mohuar këtë të drejtë.

16. Me Vendimin nr. 333 të 18 shkurtit 2009, KPM-ja e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.

17. Më 23 mars 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi administrative në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që ajo ta anulojë Vendimin nr. 333 të KPM-së, për arsye se KPM-ja nuk kishte dhënë asnjë arsye për refuzimin e kërkesës së parashtruesit dhe nuk

kishte shpjeguar nëse Udhëzimi Administrativ nr. 18/2005, i 12 majit 2005 ishte ende në fuqi.

18. Me Aktvendimin A. nr. 244/2009 të 24 korrikut 2009, Gjykata Supreme vendosi që, pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me një kontest pune, jo Gjykata Supreme, por gjykatat komunale kishin juridiksion të nxjerrin vendimin. Si pasojë, Gjykata Supreme ia përcolli shkresat e lëndës Gjykatës Komunale në Vushtrri.

19. Më 17 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 247/2009, e aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi dhe e anuloi Vendimin nr. 333 të KPM-së, të 18 shkurtit 2009.

20. Gjykata Komunale arsyetoi se "*[...] pasi e paditura* [Komuna e Vushtrrisë] *brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk u përgjigj në padi, Gjykata Komunale e ka aprovuar padinë"*.

21. Më 10 janar 2010, Komuna e Vushtrrisë parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, ndërsa parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi përgjigje në ankesë brenda afatit ligjor.

22. Me Aktgjykimin Ac. nr. 7/11, të 27 qershorit 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe e ktheu rastin në Gjykatën Komunale për rigjykim.

23. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut arsyetoi se Gjykata Komunale në Vushtrri "[...] *është dashur të caktoi shqyrtimin kryesor dhe të ju mundësoi palëve procedurale që çështja e tyre të shqyrtohet në mënyrë të drejtë për drejtë publikisht dhe duke zbatuar parimin e kundërshtimit, me marrjen e provave"*.

24. Më 21 dhjetor 2011, Stacioni i Policisë në Vushtrri i dërgoi letër Kryetarit të Komunës në Vushtrri, duke theksuar që, më 13 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës *[...] ka ardhur në Stacionin Policor në Vushtrri dhe ka dashur të raportoj rastin Falsifikim i Dokumentit*." Në letër, më tej, thuhej se "*pas konsultimit me Prokurorin Publik Komunal Policia është udhëzuar se nuk ka rast për t'u hetuar dhe se nuk ka vepër penale"*.

25. Më 31 janar 2012, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 148/2011, aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit dhe urdhëroi Komunën e Vushtrrisë që t'i paguajë parashtruesit dy paga si çmim jubilar si dhe dy paga mesatare për pensionimin e parashtruesit të kërkesës. Sipas mendimit të Gjykatës Komunale, këto paga duhet t'i jepen parashtruesit të kërkesës, *inter alia*, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, e cila ishte në fuqi që nga 1 janari 2005.

26. Gjykata Komunale e hodhi poshtë pjesën e mbetur të padisë me të cilën parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që Komuna duhet t'i paguajë atij të ardhurat personale, duke filluar nga 1 nëntori 2008 deri më 31 gusht 2012.

27. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Udhëzimi Administrativ nr. 18/2005 i 12 majit 2005, nuk ishte aplikuar në rastin e tij, Gjykata Komunale konstatoi se Udhëzimi Administrativ është një akt më i ulët se ligji i cili ka paraparë që koha e daljes në pension ishte mosha 65 vjeçare për nëpunësit civilë dhe që, në kohën e daljes në pension të parashtruesit të kërkesës, ishte i aplikueshëm ligji sipas të cilit mësimdhënësit e kishin statusin e nëpunësit civil.

28. Edhe parashtruesi i kërkesës edhe Komuna e Vushtrrisë parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila me Aktgjykimin AC. nr. 4895/2012, të 1 tetorit 2014, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e aprovoi ankesën e Komunës së Vushtrrisë.

29. Gjykata e Apelit konstatoi se parashtruesi i kërkesës kishte fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë më 28 tetor 2008, në kohën kur Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/35 ishte e aplikueshme për pensionet në Kosovë, ndërsa pagesa e rrogave për dalje në pension nuk ishte paraparë me asnjë nen.

30. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit vlerësoi se Kontrata e Përgjithshme Kolektive, e cila është aplikuar në Kosovë që nga 1 nëntori 2005, nuk ishte aplikuar asnjëherë për nëpunësit civilë, siç është parashtruesi i kërkesës, i cili ishte mësimdhënës.

31. Më 1 tetor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar, *inter alia*, se nëse Gjykata e Apelit do të kishte zbatuar të drejtën materiale drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk do të kishte nxjerrë një aktgjykim të tillë.

32. Parashtruesi i kërkesës, më tej, konstatoi se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 18/2005 i cili kishte qenë në fuqi në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës, duhej që të arrihej përfundimi se është shkelur Udhëzimi Administrativ.

33. Prandaj, ai kërkoi, që "*Gjykata Supreme ta shqyrtojë Aktgjykimin sipas detyrës zyrtare, edhe në disa pjesë ku nuk ishte kontestuar nga ky revizion.*"

34. Më 23 mars 2015, me Aktgjykimin Rev. 3/2015, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, duke arsyetuar, *inter alia*, se Marrëveshja Kolektive kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2005 dhe ishte e aplikueshme deri më 1 janar 2008, ndërsa parashtruesi i kërkesës ishte pensionuar më 28 tetor 2008. Për këtë arsye, në kohën e daljes në pension të parashtruesit të kërkesës, Marrëveshja Kolektive nuk ishte më e zbatueshme.

35. Gjykata Supreme, me tej, konstatoi se gjykata e shkallës së dytë duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, kishte zbatuar drejtë të drejtën materiale.

36. Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi nuk kishte të drejtë për kompensimin e dëmit të zakonshëm dhe fitimin e humbur në pajtim me nenin 189 (1) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, sepse pas përfundimit të marrëdhënies së tij të punës, për shkak të pensionimit të tij më 28 tetor 2008, ai më nuk kishte punuar dhe, për këtë arsye, nuk kishte të drejtë në kompensim për dëmin apo fitimin e humbur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në fillim të vitit shkollor 2008/2009, ai kishte nënshkruar kontratë si mësimdhënës me datën e fillimit të saj më 1 shtator 2008 dhe datën e skadimit më 31 gusht 2009.

38. Sipas parashtruesit të kërkesës, më 30 tetor 2008, pas fillimit të vitit shkollor iu dorëzua një vendim për dalje në pension dhe kontrata e tij e punës ishte ndërprerë, ku Drejtori i Arsimit kishte fshirë datën fillestare të skadimit [31 gusht 2009] dhe e kishte zëvendësuar me një datë tjetër [28 tetor 2008].

39. Si rezultat i kësaj, parashtruesi e denoncoi rastin në polici dhe filloi një procedurë administrative e pasuar me një procedurë në gjykatat e rregullta.

40. Sa i përket pretendimeve të tij në gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës pretendon se, në momentin e shkëputjes së kontratës së tij të punës [më 28 tetor 2008], ishte në fuqi Udhëzimi Administrativ 18/2005 i Ministrisë së Arsimit, të 12 majit 2005, në të cilin në nenin 1, para. 1.1 parashihet: "*Mosha mandatore e pensionimit është gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet*" dhe në para. 2 1.2: "*Për mësimdhënësit të cilët plotësojnë kushtet për pension, pas fillimit të vitit akademik përkatësisht shkollor, nuk zbatohen dispozitat ligjore të nenit 1. "1 në momentin e mbushjes gjashtëdhjetë e pesë vjet (65) por u vazhdohet kontrata e punës deri në fund të vitit akademik përkatësisht shkollor."*

41. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës "*[...] gjykatat kanë shkelur Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2005 [...] i cili parasheh mënyrën e pensionimit të punëdhënësve".*

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon më tej se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme *"është në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut ku në protokollet e saj rregullon të drejtën e punës së qytetarit e që është një nga të drejtat fundamentale të njeriut; për më tepër kjo Konventës është drejtpërdrejt e zbatueshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ".*

43. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se "*Gjykata Supreme e zbatoi të drejtën materiale në mënyrë të gabuar, sepse nuk ishte kërkesë e jona kompensimi i dëmit dhe fitimi i humbur".*

Pranueshmëria e kërkesës

44. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

46. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht* se cilat të drejta *dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

47. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të "*Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut ku e drejta në punë garantohet sipas kësaj konvente e që kjo konventë është drejtpërdrejt e paraparë në*

Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në rastin konkret kemi shkelje të Kushtetutës së Kosovës dhe Konventës së lartcekur".

49. Përveç kësaj, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi Rev. 3/2015 i Gjykatës Supreme, të 23 marsit 2015, në lidhje me Aktvendimin P. nr. 42/2013 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i 26 gushtit 2014, dhe Aktvendimin PAKR. nr. 463/2014 të Gjykatës së Apelit të 6 nëntorit 2014, gjithashtu kanë shkelur të drejtën e tij të punës.

50. Megjithatë, lidhur me këto pretendime, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta apo autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

51. Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta apo autoritetet tjera publike, pasi që roli i tyre është, kur është e zbatueshme, të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

52. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, të 10 korrikut 1991).

53. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në të gjitha procedurat, parashtruesi ishte ndihmuar nga një avokat dhe se gjykatat kishin shikuar me kujdes argumentet dhe kishin arsyetuar tërësisht vendimet e tyre.

54. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konsideron se procedurat në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme kanë qenë të drejta dhe të kryera mirë (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009) dhe se parashtruesi nuk ka specifikuar se si janë shkelur *"dispozitat ligjore të brendshme dhe ndërkombëtare"* të përmendura prej tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

55. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe as nuk ka dorëzuar asnjë provë se Gjykata Supreme e ka shkelur të drejtën e tij të punës.

56. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se si ishte shkelur Kushtetuta, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

57. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi

KI 80/15, KI81/15 and KI82/15 (të bashkuara), Parashtrues i kërkesës Rrahim Hoxha Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 188/2014, 189/2014, të 19 janarit 2015, dhe të Aktvendimit Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015

KI 80/15, KI81/15 dhe KI82/15 (të bashkuara), Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit, i publikuar më 11 janar 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, përsëritje e procedurës përmbarimore, kontratat e ndërtimit, kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim*

Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të lejojë përsëritjen e tri procedurave përmbarimore dhe të anulojë vendimet e marra më parë lidhur me rastet në lidhje me propozimet e parashtruesit për ekzekutimin e tri kredive për punët e kryera në pajtim me kontratën e lidhur midis parashtruesit të kërkesës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Gjykata e Apelit (Aktvendimet Ae nr. 188/2014, 189/2014 dhe 190/2014) i refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimet e ankimuara të Gjykatës Themelore duke konstatuar se nuk lejohet revizioni dhe përsëritja e procedurës përmbarimore.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi në Gjykatën Kushtetuese, *inter alia,* se Aktvendimet e Gjykatës së Apelit kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Gjykata vlerësoi se ankesat e parashtruesit të kërkesës për refuzimin e gjykatave të rregullta për përsëritjen e procedurës përmbarimore nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, Gjykata e deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme për shkak të papranueshmërisë *ratione materiae* siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) (d) dhe 56 të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15 (të bashkuara)

Parashtrues

Rrahim Hoxha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 188/2014, 189/2014, të 19 janarit 2015, dhe Aktvendimin Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15 ishin dorëzuar nga Rrahim Hoxha, pronar i kompanisë "ISARS" (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Z. Hoxha përfaqësohet nga z. Bajram Tmava, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimet Ae. nr. 188/2014 (kërkesa KI80/15) dhe 189/2014 (kërkesa KI81/15), të 19 janarit 2015 dhe Aktvendimin Ae. nr. 190/2014 (kërkesa KI82/15), të 20 janarit 2015, të gjitha të Gjykatës së Apelit, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për përsëritje të procedurës përmbarimore.

3. Të tre aktvendimet i janë dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 mars 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara Ae. nr. 188/2014 dhe 189/2014, të 19 janarit 2015 dhe Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me të cilat pretendohet të jetë shkelur neni 31, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 qershor 2015, parashtruesi i dorëzoi kërkesat nr. KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës vendosi t'i bashkojë kërkesat KI81/2015 dhe KI82/2015 me kërkesën KI80/2015, dhe emëroi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 6 tetor 2015, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë autorizim ose dokument që vërteton se parashtruesi ishte përfaqësues ose pronar i kompanisë "ISARS".

9. Gjykata, gjithashtu, njoftoi parashtruesin e kërkesës se më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës kishte vendosur t'i bashkojë kërkesat KI81/15 dhe KI82/15 me kërkesën KI80/15.

10. Më 9 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi certifikatën e regjistrimit të kompanisë të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila tregon se parashtruesi i kërkesës ishte pronari i saj.

11. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.
12. Më 6 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura përmbarimore

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë tri propozime për përmbarimin e tri kredive për punët e kryera në pajtim me kontratën e lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: TMK-ja).

14. Më 19 janar 2011 dhe 20 janar 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut (Aktvendimet E. nr. 57/2008, E. nr. 58/2008 dhe E. nr. 59/2008) refuzoi "propozimet për përmbarimin" e tri faturave të papaguara për punët e kryera të TMK-së.

15. Gjykata Ekonomike e Qarkut arsyetoi se, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/46, TMK-ja ishte duke vepruar nën kontrollin dhe autoritetin e UNMIK-ut dhe nuk mund të merrte pjesë në procedurë, për shkak se "*UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor*".

16. Kundër aktvendimeve E. nr. 57/2008 dhe 59/2008 parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme. Shkresat e lëndës nuk përmbajnë ndonjë informatë që parashtruesi

ishte ankuar edhe kundër Aktvendimit E. nr. 58/2008, të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

17. Më 29 dhe 30 nëntor 2012, Gjykata Supreme (Aktvendimet Ae. nr. 19/12, dhe 17/2011) refuzoi ankesat e parashtruesit, duke arsyetuar se me asnjë dispozitë ligjore ose rregullore të UNMIK-ut, TMK-së nuk i është njohur cilësia e personit juridik. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se TMK-ja nuk i kishte plotësuar kushtet për të fituar cilësinë e palës, duke pasur parasysh se nuk kishte fonde të veta dhe nuk posedonte mjete financiare ose pronë në të cilat përmbarimi do të mund të kryhej.

Përsëritja e procedurës përmbarimore

18. Më 30 maj 2014, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të lejojë përsëritjen e tri procedurave përmbarimore dhe të anulojë vendimet e marra më parë në lidhje me rastet.

19. Më 8 tetor 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimet E. nr. 57/2008, E. nr. 58/2008 dhe E. nr. 59/2008) i refuzoi kërkesat për përsëritje si të pabazuara, pasi që "*me nenin 68 të Ligjit për procedurën përmbarimore është përcaktuar se nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore*".

20. Pas kësaj, parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtyre aktvendimeve në Gjykatën e Apelit "*për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*".

21. Më 19 janar 2015, (Aktvendimet Ae. nr. 188/2014 dhe 189/2014) dhe më 20 janar 2015 (Aktvendimi Ac. nr. 190/2014) Gjykata e Apelit (Aktvendimet Ae. nr. 188/2014, 189/2014 dhe 190/2014) i refuzoi ankesat e parashtruesit si të pabazuara dhe vërtetoi aktvendimet e ankimuara të Gjykatës Themelore, duke konstatuar se nuk lejohet revizioni dhe përsëritja e procedurës përmbarimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi pretendon se me aktvendimet e Gjykatës së Apelit janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të parapara me paragrafin 1, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktvendimet e Gjykatës së Apelit (Ae. nr. 188/2014, 189/2014, 190/2014), dhe aktvendimet e Gjykatës Themelore (E. nr. 57/08, 58/2008 dhe 59/2008), të gjitha në lidhje me përsëritjen e procedurës përmbarimore, dhe ta kthejë çështjen e kontestuar në Gjykatën Ekonomike Themelore për rigjykim dhe rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë në lidhje me kërkesat e bashkuara, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Gjykata rikujton se parashtruesi inicioi dy procedura që kanë të bëjnë me kërkesat KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15: procedurën përmbarimore dhe përsëritjen e procedurës përmbarimore. Gjykata do të kufizohet në përsëritjen e procedurës përmbarimore, pasi që ajo është objekt i çështjes së kërkesave dhe ajo është gjithashtu hapi i fundit procedural i tërë procesit të mbajtur në gjykatat e rregullta.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
>
> *7.* Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave *dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".*

28. Gjykata, më tej, i referohet paragrafit (3) (e) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *[...]*
> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
> *[...]*
> *(e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën.*
> *[...]*

29. Gjykata, gjithashtu, rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të paragrafit 1, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse me vendimet e kontestuara ishte refuzuar përsëritja e procedurës përmbarimore.

30. Gjykata përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në mënyrë të vazhdueshme ka konstatuar që paragrafi 1, i nenit 6 [E drejta për gjykim të drejtë] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) nuk garanton të drejtën për të rihapur apo përsëritur procedurat, dhe, prandaj neni 6 nuk zbatohet tek kërkesat për rishikim apo përsëritjen e procedurës (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Zawadzki kundër Polonisë* (dec), nr. 34158/96, 6 korrik 1999; *Sablon kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 36445/97, § 86, 10 prill dhe *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010; *Nistler kundër Austrisë*, nr. 24912/08, Vendim i 19 nëntorit 2013, *Dichev kundër Bullgarisë*, nr. 1355/04, Aktgjykim i 27 janarit 2011).

32. Prandaj, Gjykata konsideron se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, nuk zbatohet në kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës përmbarimore.

33. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim

ratione materiae me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për rishikim dhe përsëritje të procedurës.

34. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit në lidhje me refuzimin e përsëritjes së procedurës përmbarimore nga ana e gjykatave të rregullta si të tilla nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës.
35. Për këtë arsye, Gjykata më tej konsideron se kërkesat e parashtruesit nuk i kanë plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, siç përcaktohet me Kushtetutë, dhe siç parashihet më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

36. Prandaj, Gjykata konstaton se ankesat e parashtruesit në kërkesat KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, janë të papranueshme *ratione materiae*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (d) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Arta Rama-Hajrizi

KI 66/15, Parashtrues i kërkesës Bekim Baliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2015, të 23 shkurtit 2015

KI 66/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 shtatorit 2016, i publikuar më 11 janar 2017.

Fjalët kyçe*: kërkesë individuale, vepra penale, e drejta për gjykim të drejtë, barazia para ligjit, gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, e drejta për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave*

Parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktgjykimi P. nr. 42/13) për kryerjen e veprës penale të "Marrjes se ryshfetit" sipas nenit 343 (1) të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi i AKP-së, nr. 463/14) e aprovoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 23 shkurt 2015, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo kërkesë është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesi pohon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në lidhje me nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë], paragrafi 3 (d), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Gjykata konstaton se procedurat në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, ishin te drejta dhe te kryera mirë (Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009). Prandaj, Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI66/15

Parashtrues

Bekim Baliu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2015, të 23 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bekim Baliu nga Skënderaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Flutra Hoxha, avokate në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 13/2015, të 23 shkurtit 2015, me të cilin është refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P. nr. 42/2013, të 26 gushtit 2014 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë PAKR. nr. 463/2014, të 6 nëntorit 2014. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 13/2015 i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të 23 shkurtit 2015, me të cilin, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], paragrafi 3 (d), i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 12 gusht 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 26 gusht 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin P. nr. 42/13, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të "*Marrjes së ryshfetit*" sipas nenit 343 (1) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe e dënoi atë me 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili dënim më vonë u zëvendësua me gjobë.

10. Gjykata Themelore konstatoi se në vend që të vendosë një gjobë për kundërvajtje kundër kryerësit të kundërvajtjes në trafik, parashtruesi i kërkesës, polic në kohën e ngjarjeve, kishte kërkuar dhe kishte marrë një shumë të caktuar parash.

11. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, duke u ankuar për shkak të *"shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit penal dhe të procedurës penale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Gjykata Themelore"*.

12. Më 6 nëntor 2014, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAKR. nr. 463/14, ka vendosur ta refuzojë ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata e Apelit arsyetoi, *inter alia*, se "*aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë dhe as që ka shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë i vëren detyrimisht e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij"*.

13. Gjykata e Apelit, më tej, gjeti se "*veprimet përbëjnë qenien e veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe i njëjti është në harmoni me përmbajtjen e provave nga shkresat e kësaj çështje. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit*".

14. Më 8 maj 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar *inter alia,* se për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, "*aktgjykimet e kontestuara duhet të anulohen dhe se rasti duhet t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, ose aktgjykimet të ndryshohen, ashtu që aktakuza kundër tij të refuzohet*".

15. Me parashtresën KMLP. II. nr. 10/2015, të 19 shkurtit 2015, Prokurori i Shtetit propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

16. Më 23 shkurt 2015, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, duke arsyetuar, *inter alia*, se pretendimi i parashtruesit se "*të dy aktgjykimet, në kundërshtim me nenin 123 (3) të KPPK, ishin të bazuara në prova të papranueshme, përkatësisht, deklaratat e dëshmitarëve [...] të cilët nuk ishin marrë në pyetje nga Prokurori, [...]",* ishte i pabazuar.

17. Gjykata Supreme konsideroi se gjykata e shkallës së parë "*[...] vendimin e saj e mbështet, veç tjerash, në deponimet e dëshmitarëve të cilët në shqyrtimin gjyqësor, me deklarimet që ishin konsekuente gjatë gjithë fazave të procedurës, në detaje kanë përshkruar veprimet inkriminuese të të dënuarit ndërsa identitetin e tij ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë dëshmitari P. M., në bazë të numrit identifikues të personit zyrtar [Policisë] të cilin e mbante i dënuari [parashtruesi i kërkesës] [...]. kurse fakti se i dënuari [parashtruesi i kërkesës] me dëshmitarin S. S. [polic] në ditën kritike ishin në pikën e kontrollit në fshatin Polac, ku është ndalur i dëmtuari për shkak të kundërvajtjes në trafik, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar nga raporti i Stacionit Policor në Skenderaj datë 2.3. 2009".*

18. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme *"[...] në bazë të të gjitha provave të administruara, rezultoi se [...] konkluzionet e gjykatave ishin të drejta dhe të ligjshme [...] dhe se [...] nuk ka asnjë dyshim se deklaratat e dëshmitarëve janë prova të pranueshme, pasi mbrojtjes i është dhënë mundësia t'i kundërshtojë ato, [...]"* dhe se "*[...] këto pretendime ndërlidhen dhe gërshetohen me gjendjen faktike [...], për shkak të të cilave nuk mund të parashtrohet asnjë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë [...]".*

19. Në fund, Gjykata Supreme konstatoi se, sa i përket pretendimeve në kërkesën e parashtruesit se ligji penal ishte shkelur në dëm të të dënuarit [parashtruesit të kërkesës], "*shkeljet për të cilat ata* [parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij] *flasin nuk përmenden në kërkesën* [për mbrojtje të ligjshmërisë]".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon, *inter alia,* se "*[...] Gjykata Themelore në Mitrovicë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës me mosveprimin apo shqyrtimin jo të drejtë të çështjes juridike konform ligjeve pozitive dhe duke mos vepruar në përputhje me obligimet e saja kushtetuese dhe ligjore për të trajtuar dispozitat ligjore, e njëjta në Aktgjykimin e saj ka cenuar të drejtat [e tij] individuale [...] të garantuara me nenet 24, 31 , 32, 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 paragrafi 3 (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe protokolleve të saj".*

21. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se Prokurori Publik nuk ka kryer ndonjë hetim në lidhje me këtë çështje, por është bazuar në raportet policore të dëshmitarit dhe të personit të dëmtuar [personi i cili i kishte dhënë të hollat]. Për më tepër, sipas parashtruesit të kërkesës, ai nuk ishte marrë në pyetje nga Prokurori, si dhe ai dhe avokati i tij mbrojtës nuk ishin informuar se ekzistonin deklaratat e mundshme hetimore të dëshmitarëve.

22. Sa i përket dënimit të tij nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, të 26 gushtit 2014, parashtruesi i kërkesës pretendon se ishte gjykuar për vepër penale e cila nuk përmban elementet e veprës penale, pasi nuk ishte përmbushur kushti thelbësor për të kërkuar dhe pranuar ryshfet në bazë të një marrëveshjeje.

23. Parashtruesi pretendon më tej se, më 6 nëntor 2014, Gjykata e Apelit nuk është dashur ta refuzojë ankesën e tij si të pabazuar dhe nuk është dashur ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konkluduar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta

për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës. Ai, gjithashtu, pretendon se Gjykata e Apelit nuk kishte shqyrtuar pretendimin e tij se ai nuk ishte personi që kishte marrë të hollat, pasi që të dy dëshmitarët nuk ishin në gjendje ta identifikojnë atë në shqyrtimin kryesor.

24. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të 23 shkurtit 2015, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë si e pabazuar, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme ka vlerësuar gabimisht se procedura e provave ishte kryer në mënyrë të drejtë dhe se identiteti i të akuzuarit [parashtruesit të kërkesës] ishte konfirmuar nga dëshmitari, në bazë të numrit të identifikimit të parashtruesit si zyrtar policor.

25. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij individuale duke shqyrtuar në mënyrë të padrejtë çështjen ligjore dhe parashtresat në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe duke mos vepruar në përputhje me detyrimet e saj kushtetuese dhe ligjore.

26. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme është dashur të vendosë nëse deklaratat e dëshmitarit dhe të personit të dëmtuar [personi i cili i kishte dhënë të hollat] janë pranuar në mënyrë të drejtë dhe është dashur të vërtetojë nëse e tërë procedura, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën ishin administruar provat, ka qenë e drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta *dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

30. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Sa i përket kërkesës së tanishme, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*[...] sipas jurisprudencës kushtetuese, tashmë të konsoliduar, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga Kushtetuta dhe nga neni 6 i KEDNJ".*

32. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Strasburgut, parashtruesi i kërkesës gjithashtu deklaroi se "*[...] ai është i vetëdijshëm se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese*".

33. Gjykata vëren se sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të 23 shkurtit 2015, është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenet 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 (3) të KEDNJ-së.

34. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta apo autoritetet e tjera publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

35. Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta apo autoriteteve publike, sepse është roli i tyre, kur është e aplikueshme, që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28; Shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

36. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).

37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte ndihmuar nga avokati i tij mbrojtës në procedurë, dhe se gjykatat e rregullta kishin shikuar me kujdes të gjitha provat dhe kishin arsyetuar plotësisht vendimet e tyre.

38. Përveç kësaj, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj, jo vetëm që shqyrtoi se është i pabazuar pretendimi i parashtruesit, se aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta ishin të bazuara në prova të papranueshme, por gjithashtu konstatoi se nuk kishte asnjë dyshim se deklaratat e dëshmitarëve ishin të pranueshme, pasi mbrojtjes i është dhënë mundësia për t'i kundërshtuar këto deklarata.

39. Gjykata Supreme më tej vendosi se kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të refuzohej si e pabazuar, aq më tepër që "*[...] këto pretendime ndërlidhen dhe gërshetohen me gjendjen faktike [...], për shkak të të cilave nuk mund të parashtrohet asnjë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë [...]",* në pajtim me nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

40. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se procedurat në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, ishin të drejta dhe të kryera mirë (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009) dhe se parashtruesi dhe mbrojtësi i tij kishin pasur mundësi të shumta për t'i kundërshtuar dëshmitë e dëshmitarit dhe të të dëmtuarit.

41. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka specifikuar se si ishin shkelur nenet e Kushtetutës në të cilat ai referohet, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

42. Prandaj, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së janë të pambështetura dhe të padëshmuara dhe, prandaj, janë qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI91/16, Parashtrues Belkis Abazi, Fahrije Nuhiu, Bedrije Vërtopi, Ilaz Bullatovci, Atije Zeqiri, Artan Shabani, Dardane Xërxa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit, AC-I-13-0264, të 21 janarit 2016

KI91/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 shtatorit 2016, publikuar më 13 janar 2017

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, masë e përkohshme, qartazi e pabazuar.*

Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit ka nxjerrë Aktgjykimin, AC-I-13-0264, të 21 janarit 2016, me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, duke anuluar pjesërisht Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit SCEL-11-0063, të 4 dhjetorit 2013.

Parashtruesit ndër të tjera pretenduan, se Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,të drejtën për mjete juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave. Parashtruesit kërkuan që të ndalohet ekzekutimi i pagesës për disa presona, si rezultat i ndarjes së 20 % të mjeteve të realizuara nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore "Drithnaja"

Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Në

rastin nr. KI91/16

Parashtrues

Belkis Abazi
Fahrije Nuhiu
Bedrije Vërtopi
Ilaz Bullatovci
Atije Zeqiri
Artan Shabani
Dardane Xërxa

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0264, të 21 janarit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Belkis Abazi, Fahrije Nuhiu, Bedrije Vërtopi, Ilaz Bullatovci, Atije Zeqiri, Artan Shabani dhe Dardane Xërxa (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga z. Florin Vërtopi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), AC-I-13-0264, të 21 janarit 2016, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 26 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe nenin 13 [E Drejta për

Zgjidhje Efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të ndalohet ekzekutimi i pagesës së shumës, të cilën duhet ta pranojë N. I. si rezultat i 20 % të mjeteve të realizuara nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore "Drithnaja" (në tekstin e mëtejmë: Drithnaja).

5. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore lidhur me rastin e tyre.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 15 qershor 2016, parashtruesit dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë.

8. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 28 korrik 2016, Gjykata i informoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Kolegjit të Apelit.

10. Më 29 korrik 2016, Gjykata i dërgoi një kopje të saj Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

11. Më 13 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 27 gusht 2007, NSH "Drithnaja/Zhitopromet" ishte privatizuar.

13. Më 27, 28, 29 dhe 30 tetor 2011, AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve, të cilët kanë të drejtë në 20% e të ardhurave të krijuara nga privatizimi i "Drithnaja /Zhitopromet".

14. Më 11 dhe 21 nëntor 2011, N. I. dhe L. K., parashtruan ankesë ndaj listës përfundimtare në Kolegjin e specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i specializuar), duke kërkuar që të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë në 20% të mjeteve të realizuara nga privatizimi i "Drithnaja /Zhitopromet".

15. Më 12 dhjetor 2011, AKP-ja paraqiti kundërshtimin e saj ndaj ankesës, duke konsideruar se ankuesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike pasi që nuk janë ankuar ndaj listës së përkohshme të AKP-së, duke mos e kontestuar pretendimin se ankuesi N. I. nuk ka punuar në "Drithnajë/Zhitopromet" nga data "*12. 10. 1994 deri në muajin*

qershor 1999" ndërsa ankuesja L. K. ka punuar nga data "*28. 12. 1987 deri në qershor 1999"*.

16. Më 4 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar (Aktgjykimi SCEL-11-0063) aprovoi ankesat si të bazuara, duke arsyetuar se "*[...] konsiderohet me të drejta legjitime për listën e punëtorëve ai i cili ka punuar në NSH gjatë të ashtuquajturës "Periudhë e Masave të Dhunshme Serbe" dhe është ndaluar të vazhdojë punën në të pas luftës [...] në pajtim me rrethanat faktike të përmendura më sipër nën pikën A. II. 2.B ankuesi ka treguar që ka qenë i diskriminuar*".

17. Më 26 dhjetor 2013, AKP-ja paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke kontestuar përfshirjen e N. I. dhe L. K. në listën përfundimtare, dhe duke pretenduar se "*gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, rrjedhimisht gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale dhe kërkon që ankuesit e cekur të hiqen nga lista përfundimtare*".

18. Më 21 janar 2014, Kolegji i Apelit ua dorëzoi ankuesve N. I. dhe L. K ankesën e ushtruar, duke iu dhënë mundësinë e përgjigjes në ankesë.

19. Më 24 shkurt 2014, ankuesja L. K. u përgjigj në lidhje me ankesën, duke kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

20. Më 26 nëntor 2014, parashtruesit kërkuan nga Kolegji i Apelit "*që atyre tu lejohet statusi procedural si bashkëndërgjygjës unik në lëndën SCEL_11-0063 [...]*". Parashtruesit e kërkesës, po ashtu, kërkuan që ankuesve N. I. dhe L. K. t'u refuzohet kërkesa për përfshirje në listën përfundimtare.

21. Më 24 dhjetor 2014, AKP-ja dorëzoi në Kolegj të Apelit plotësim në ankesë ku theksohet se ankuesja L. K. kishte punuar në ndërmarrjen shoqërore "Mulliri" dhe se ajo kishte marrë mjetet e 20% nga privatizimi i asaj ndërmarrjeje.

22. Më 29 dhjetor 2014, parashtruesit dorëzuan sërish një parashtresë në Kolegj të Apelit, duke e precizuar deklaratën e 26 nëntorit 2014, me po të njëjtat pretendime.

23. Më 22 janar 2015, AKP-ja dorëzoi në Kolegj të Apelit "*Informatë plotësuese*", duke bashkëngjitur një aktgjykim të Kolegjit të Specializuar të Gjykatës Supreme, i cili e dëshmon se ankuesja L. K. ka përfituar shumën e 20% nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore "Mulliri".

24. Më 29 tetor 2015, parashtruesit dorëzojnë edhe një parashtresë në Kolegj të Apelit me të njëjtat pretendime.

25. Më 9 nëntor 2015, Kolegji i Apelit ua komunikoi parashtresat e parashtruesve të kërkesës ankuesit N. I. dhe ia dërgoi ankueses L. K. parashtresat e parashtruesve të kërkesës.

26. Më 21 janar 2016, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-I-13-0264) e aprovoi pjesërisht ankesën e AKP-së, duke anuluar pjesërisht dispozitivin e Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të 4 dhjetorit 2013. Më tutje, Kolegji i Ankesave theksoi se "*anulohet pjesërisht pika 1 e dispozitivit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, SCEL-11-0063 të 4 dhjetorit 2013, [...] dhe kjo ankuese hiqet nga lista përfundimtare për NSH-në "Drithnaja", ndërsa vërtetohet pjesërisht pika 1 e dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, SCEL-11-0063 të 4 dhjetorit 2013, lidhur me ankuesin C1 Nenad Ivković, i cili mbetet në listën përfundimtare*".

27. Kolegji i Apelit theksoi se "*ankesa e AKP-së lidhur me ankuesin [...] është e pa bazuar, ngase mos kontestimi i listës së përkohshme nuk është me ndikim që ai të hiqet nga lista përfundimtare. Ky ankues do të mbetet në listën përfundimtare për NSH "Drithnaja", ngase librezën e punës e ka të hapur dhe përfundimet e Kolegjit të Specializuar se ky ankues i ka plotësuar kushtet për tu përfshirë në listën përfundimtare në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 23/13, janë të sakta [...] ankesa e AKP-së lidhur me ankuesin [...] duhet të aprovohet si e bazuar pasi që tashmë kjo ankuese duke përfituar të drejtën e 20 % për NSH "Mulliri" dhe NSH "Kosovarja"/ Zhito Promet në bazë të aktgjykimeve të cekura të cilat janë të formës së prerë, nuk mund të pretendon më tuje të përfshihet edhe në listën përfundimtare për N. SH. "Drithnaja".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të KEDNJ-së.

29. Parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se *"A. mos analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave materiale", B." Mos arsyetim i aktgjykimit", e që ndërlidhen me të drejtën e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si dhe C" për shkak të shkeljes së të drejtës për mjet efektiv juridik [...]".*

30. Parashtruesit e kërkesës, më tej, pretendojnë se *"Gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosë për Deklaratën për ndërhyrje në çështjen SCEL-11-0063 të dt.26.11.2014 dhe në Precizimin/Rregullimin e deklaratës për ndërhyrje, në çështjen SCEL-11-0063 të dt.29.12.2014 me qëllim që të na lejohet neve ndërhyrësve statusi procedural i palëve si bashkëndërgjygjës unik në këtë lëndë [...].* Përveç kësaj, ata po ashtu ankohen se *"Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj, vetëm tërthorazi e përmend ndërhyrjen e ndërhyrësve në faqen e fundit të këtij aktgjykimi".*

31. Parashtruesit e kërkesës, konsiderojnë se *"është e domosdoshme të vendoset masa e përkohshme e moslejimit të pagesës vetëm për shumën prej 66.354,03 euro, të cilën do të duhej ta pranonte [...], e sipas Rekapitullimit 20%, nga të ardhurat e privatizimit sipas listës".*

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij ta qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

35. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (b) dhe (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

36. Gjykata rikujton se parashtruesit pohojnë se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat e tyre kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjete juridike, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, për shkak të *"mos analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave materiale"* dhe *"Mos arsyetim i aktgjykimit".*

37. Në të vërtetë, Gjykata vëren se AKP-ja parashtroi ankesë në Kolegj të Apelit për shkak se *"gabimisht është vërtetuar gjendja faktike rrjedhimisht gabimisht është aplikuar e drejta materiale".*

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, i cili konkludoi se "*Ankesa e AKP-së është pjesërisht e bazuar, ndërsa pika 1 e dispozitivit të ankimuar [...] duhet të anulohet lidhur me ankuesen [...], ndërsa ankesa e AKP-së lidhur me ankuesin [...], refuzohet si e pabazuar dhe pika 1 e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar lidhur me këtë ankues duhet të vërtetohet*".

39. Kolegji i Apelit gjeti se "*ankesa e AKP-së lidhur me ankuesin [...] është e pa bazuar, ngase mos kontestimi i listës së përkohshme nuk është me ndikim që ai të hiqet nga lista përfundimtare. Ky ankues do të mbetet në listën përfundimtare për NSH 'Drithnaja', ngase librezën e punës e ka të hapur dhe përfundimet e Kolegjit të Specializuar se ky ankues i ka plotësuar kushtet për t'u përfshirë në listën përfundimtare në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 23/13, janë të sakta".*

40. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës pretenduan se Kolegji i Apelit "*nuk ka vendosë për Deklaratën për ndërhyrje (...) vetëm tërthorazi e përmend ndërhyrjen e ndërhyrësve në faqen e fundit të këtij aktgjykimi".*

41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit ka theksuar se *"kërkesa e ish punëtorëve të NSH Drithnaja/Zhito Promet, të cilët me parashtresën e tyre të 26 nëntorit 2014, kërkojnë marrin cilësinë e ndërhyrësit në procedurë në përmbajtje është e njëjtë, dhe me qenë se se me këtë Aktgjykim është dhënë zgjidhje në merita për ankesën e AKP-së, Kolegji i Apelit konstaton se nuk është e nevojshme të vendoset lidhur me kërkesën e ndërhyrësve".*

42. Gjykata e rithekson se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vërtetojë nëse disa lloje të provave janë të lejuara, cilat prova duhet të merren dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të konstatojë nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 35394/97, paragrafi 34-35 i KEDNJ-së, Aktgjykimi i 12 majit 2000).

43. Gjykata, gjithashtu, përsërit se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike dhe ligji i zbatueshëm është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65, shih po ashtu *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

44. Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij adresoi çështjet thelbësore që lidhen me pretendimin ankimor të parashtruesve të kërkesës.

45. Edhe pse gjykata e rregullt ka liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve dhe pranimin e provave, neni 6. 1 i KEDNJ-së nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës (Shih, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801, GEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, para. 36, *Van de Hurk kundër Holandës*, Nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës* (dhjetor); *Perez kundër Francës* [DHM] Nr. 47287/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 prillit 2004, para 81; *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Nr. 18390/91, GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Nr. 18064/91. GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 27).

46. Prandaj, Gjykata nuk mund të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta lidhur me interpretimin dhe zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96 Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999; shih gjithashtu, rastin KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

47. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe nuk ka dëshmuar shkeljen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjet efektiv juridik dhe për mbrojtje gjyqësore. Për më tepër, ai nuk ka arritur të dëshmojë se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë Kolegjin e Apelit, ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur.

48. Nga sa u tha më lart, Gjykata konstaton se është respektuar e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm gjatë procedurës dhe, në mënyrë më specifike, ai kishte qasje të lirë në gjykata, i ishin dhënë aktgjykime të arsyetuara në shkallë të ndryshme të procedurave. Gjykata, më tej, konstaton se për pasojë, të drejtat e tij në mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësore gjithashtu janë garantuar.

49. Si përmbledhje, Gjykata rikujton se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe, rrjedhimisht, as për shkeljen e të drejtës për mjete efektive juridike dhe për mbrojtje gjyqësore. Kësisoj, kërkesa është e papranueshme si e pabazuar në baza kushtetuese.

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore

50. Sa i përket kërkesës së parashtruesve për të mbajtur seancë dëgjimore, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, Gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".

51. Gjykata konsideron që, sipas nenit 20 të Ligjit, shkresat e lëndës janë të mjaftueshme për të vendosur rastin.

52. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve për mbajtje të seancës dëgjimore hedhet poshtë si e pa bazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

53. Parashtruesit e kërkesës i kanë kërkuar Gjykatës të caktojë masën e përkohshme të " *mos lejimit të pagesës vetëm për shumën, të cilën do të duhej ta pranonte [...], e sipas Rekapitullimit të 20 % nga të ardhurat e privatizimit sipas listës".*

54. Parashtruesit nuk kanë ofruar asnjë argument apo shkak lidhur me atë se pse duhet Gjykata të caktojë masën e përkohshme. Parashtruesit thjesht e kanë kërkuar atë në parashtresën e tyre.

55. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, nevojitet që:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar (...), nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

[...]

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

56. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 13 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Arta Rama-Hajrizi

KI137/16, Parashtruesi i kërkesës Agdi Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016, të 23 qershorit 2016

KI 137/16, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2017, i publikuar më 1 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa individuale, akuza penale, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor nga Gjykata Themelore në Gjilan (PKR 171/2014) për veprën penale të vrasjes siç parashihet me nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua nga Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 580/15). Përveç kësaj, kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë u refuzua nga Gjykata Supreme (Vendimi PPr. Kr. nr. 174/2016) si e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, në Gjykatën Kushtetuese, *inter alia,* se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk e kishte mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij. Prandaj, kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç përcaktohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI137/15

Parashtrues

Shefki Qerimi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 114/2015, të 22 qershorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shefki Qerimi nga fshati Dumnicë, Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga znj. Flutra Hoxha, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin (Pml. Nr. 114/2015, të 22 qershorit 2015) te Gjykatës Supreme, me të cilin është refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si e pabazuar.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 tetor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); të drejtat e tij të garantuara me nenin 5 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë, KEDNJ); si dhe e drejta e tij e garantuar me nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 31 maj 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Me 20 tetor 2016 kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 korrik 2012, kishte ndodhur një aksident komunikacioni, ku tre persona kishin pësuar lëndime të rënda trupore.

11. Më 26 prill 2013, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës në bazë të dyshimit se ai ka kryer veprën penale *"Rrezikim i trafikut publik"* dhe *"Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi të komunikacionit"*.

12. Më 11 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi, P. nr. 1781/13) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerje të veprave penale të lartcekura dhe e dënoi atë me burgim prej nëntë (9) muajsh. Përveç kësaj, parashtruesit të kërkesës iu ndalua drejtimi i automjeteve të kategorisë B për një periudhë prej një (1) viti.

13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së të drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të vendimit për dënim. Ai ka kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta lirojë atë për shkak të mungesës së provave, ose ta kthejë çështjen për rigjykim.

14. Prokuroria Themelore në Prishtinë gjithashtu parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të vendimit për dënim, duke kërkuar që dënimi të zëvendësohet me një dënim më të ashpër.

15. Më 18 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, PA1. nr. 98/2014) i refuzoi, edhe ankesën e parashtruesit edhe ankesën e Prokurorisë Themelore si të pabazuara. Ajo arsyetoi si në vijim:

> *"[...] Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit, nga se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë dhe konkret dhe se përmban veprën penale për të cilën i akuzuari është*

shpallur fajtor, faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit penal [...].”

16. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe të drejtës penale.

17. Më 22 qershor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Pml. nr. 114/2015) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi si në vijim:

“[...] kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal duke i aprovuar në tërësi qëndrimin juridik të shprehur në aktgjykimet e kundërshtuara përkitazi me përgjegjësinë penale të të dënuarit, si dhe për faktin se me provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprave penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 29, 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës; të drejtat e tij të garantuara me nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së; dhe, të drejtën e garantuar me nenin 7 të DUDNJ-së. Ai pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tilla *“me mosveprimin apo shqyrtimin jo të drejtë të çështjes juridike konform ligjeve pozitive”*.

19. Parashtruesi i kërkesës thekson se ai *“nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe për të cilat është dënuar”*. Në këtë drejtim, ai pretendon se vendimi për dënim është *“jo ligjor, i gabuar, i ashpër dhe i pa arsyetuar, për një vepër për të cilën nuk ka prova te mjaftueshme se është kryer nga i akuzuari”*.

20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur “*parimin e lirisë dhe sigurisë, parimin e prezumimit të pafajësisë që nga fillimi ndjekjes penale, parimin e barazisë së armëve [...] të parimit in dubio pro reo, të drejtës së mbrojtjes”*.

21. Parashtruesi i kërkesës konkludon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim:

“Kërkesën e paraqitësit të kërkesës ta konstatojë të pranueshme;
Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të paraqitësit të kërkesës [...] në procedurat gjyqësore te Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe marrjes së Aktgjykimit e gjithashtu të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe të
Përcaktojë çfarëdo të drejte ose përgjegjësie për palët në kërkesë që kjo Gjykatë e nderuar i vlerëson si të bazuara juridikisht dhe të arsyeshme”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta *dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

25. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Lidhur me si më sipër Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një kërkesë individuale ai ka cilësinë e palës së autorizuar ,kërkesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike. Andaj Gjykata konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet formale të pranueshmërisë në mënyrë që kërkesa të shqyrtohet nga Gjykata.

27. Siç u cek më sipër, parashtruesi i kërkesës në thelb ankohet se Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar atë për një vepër që ai nuk e ka kryer. Përveç kësaj, ai pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme pretendohet të kenë vërtetuar vendim *"jo ligjor, të gabuar, të ashpër dhe të pa arsyetuar"* të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe kështu kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 29, 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës; të drejtat e tij të garantuara me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ-së; dhe të drejtën e tij të garantuar me nenin 7 të DUDNJ-së.

28. Gjykata gjithashtu rikujton ankesën e parashtruesit se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të lartpërmendura, duke mos shqyrtuar në mënyrë të drejtë çështjen ligjore dhe duke marrë një vendim për dënimin e tij pa dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur këtë përfundim. Ai më tej iu referua shkeljeve të parimeve të ndryshme, siç janë parimi i lirisë dhe sigurisë, prezumimi i pafajësisë dhe *in dubio pro reo*, pa ofruar ndonjë arsyetim të mëtejshëm se si dhe pse janë shkelur parimet e tilla nga gjykatat e rregullta.

29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për kryerjen e dy veprave penale dhe në këtë mënyrë ishte shpallur fajtor dhe dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nëntë (9) muaj burgim dhe një masë shtesë të ndalimit të drejtimit të automjeteve për një (1) vit.

30. Për më tepër, Gjykata vëren se pas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i kanë refuzuar pretendimet e tij për shkelje të ligjit penal dhe të ligjit të procedurës penale duke mbështetur plotësisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Të dyja instancat u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve për shkelje të ligjit penal dhe të ligjit të procedurës penale të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se pretendimet që janë ngritur nga parashtruesi i kërkesës në këtë Gjykatë janë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë.

32. Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion që të vendosë nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka juridiksion as për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë ose për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e parashtruesit të kërkesës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e shkallës më të ulët, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

34. Gjykata Kushtetuese thekson më tej se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës.

35. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).

36. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe të ligjit të procedurës penale që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata e Apelit, kur e refuzoi ankesën e tij si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Parashtruesi kishte pretenduar në Gjykatën Supreme që *"aktgjykimet bazohen në prova të papranueshme"; "dispozitivet e aktgjykimeve janë të paqarta"; "Prokurori i shtetit [...] fare nuk ka paraqitur fjalën e tij përfundimtare"; "ka tejkaluar padinë" dhe* se vendimet janë korrigjuar dy herë në mënyrë të paligjshme për gabime teknike.

37. Në përgjigje ndaj pretendimeve të tilla, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

> *"[...] Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e sipër theksuara nuk qëndrojnë nga këto arsyera:*
> *[...] procesverbalin e datës 7.11.2013 nga i cili procesverbal qartë shihet se Prokurorja [...] jep fjalën përfundimtare. [...]fakti se gjykata e shkallës së parë i bie dy aktvendime mbi përmirësimin e aktgjykimit [...] bëhet fjalë për gabime të padëmshme [...] të cilat nuk ndryshojnë substancën e veprës penale.*

[...] aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal [...]. [...] si dhe me provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprave penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor."

38. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme që i referohet pretendimeve të parashtruesit për shkelje të ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

39. Prandaj, në rastin konkret, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret ai dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) dhe 56 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) dhe 56 të Rregullores së punës , në seancën e mbajtur më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Arta Rama-Hajrizi

KI87/16, Parashtruesja e kërkesës: Nafije Bakalli, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0189, të 18 shkurtit 2016

KI87/16, Aktvendim për papranueshmi i 7 dhjetorit 2016, i publikuar më 16 janar 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, pronë*

Më 2 tetor 2000, parashtruesja e kërkesës lidhi kontratë për shitblerjen e lokalit nr. 138 me Shoqërinë Aksionare „Agimi“ nga Gjakova. Kjo kontratë mbi shitblerjen e lokalit u nuk u vërtetua asnjëherë nga Gjykata dhe bartja e pronësisë në bazë të kësaj kontrate nuk u regjistrua asnjëherë në librat kadastralë.

Parashtruesja e kërkesës me padi kërkoi njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe regjistrimin e pronës në emrin e saj (paditëses). Parashtruesja e kërkesës në padi pretendoi se ky ishte rasti i tretë i shitjes së lokalit nga SH. A. „Agimi“ dhe se blerësve të tjerë u është njohur e drejta në lëndët e Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06).

Më 29 qershor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë (me Aktgjykimin C. nr. 354/07) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës për njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe për regjistrimin e pronës në emrin e saj.

Gjykata Komunale gjeti se kontrata e lidhur ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe SH. A. “Agimi” ishte e paligjshme mbi disa baza juridike dhe që: e paditura nuk e kishte të drejtën për ta shitur lokalin në bazë të ligjit në fuqi; se kontrata nuk kishte vlerë ligjore sepse nuk ishte e vërtetuar nga organet shtetërore; se në momentin e shitblerjes, objekti i shitblerjes (lokali) nuk ekzistonte; dhe kështet e pagesës nuk ishin paguar sipas afateve të përcaktuara me kontratë.

Kolegji i Apelit (me Aktvendimin AC-II-12-0189) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 354/07 e Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta i kanë shkelur nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Gjykata konstatoi se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk është bërë bartëse e të drejtës pronësore; përkundrazi, ajo është përpjekur ta fitojë pronën, do të thotë se parashtruesja e kërkesës kishte vetëm *“shpresë për njohjen e të drejtave pronësore, e cila është e pamundur të arrihet efektivisht”,* prandaj kjo gjendje juridike *“nuk mund të konsiderohet si “pronë” në kuptim të nenin 1 të Protokollit nr. 1”.*

Gjykata konstatoi se parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në fazat e ndryshme të kësaj procedure të paraqes argumentet dhe provat që i konsideroi të rëndësishme për rastin e saj. Njëkohësisht, asaj i është dhënë mundësia për të kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtrueses, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara me lart, procedurat pranë gjykatave të

rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/16

Parashtrues

Nafije Bakalli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0189, të 18 shkurtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nafije Bakalli nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin (AC-II-12-0189) e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të 18 shkurtit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe neni 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 korrik 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që t'i dorëzojë vendimet e kontestuara dhe dokumente tjera relevante.

8. Më 4 gusht 2016, parashtruesja e kërkesës i dorëzoi vendimet e kontestuara në Gjykatë.

9. Më 23 gusht 2016, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

10. Më 7 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 2 tetor 2000, parashtruesja e kërkesës lidhi kontratë për shitblerjen e lokalit nr. 138 me Shoqërinë Aksionare "Agimi" nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: SH. A. "Agimi"). Kjo kontratë mbi shitblerjen e lokalit nuk u vërtetua asnjëherë nga Gjykata dhe bartja e pronësisë në bazë të kësaj kontrate nuk u regjistrua asnjëherë në librat kadastralë.

12. Më 11 prill 2006, parashtruesja e kërkesës parashtroi padinë kundër të padituresh SH. A. "Agimi" për vërtetimin e pronësisë mbi lokalin, në Kolegjin e Specializuar të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar).

13. Më 24 prill 2007, Kolegji i Specializuar (me Aktvendimin SCC-06-0155) e barti kompetencën dhe e referoi padinë në fjalë për shqyrtim në Gjykatën Komunale në Gjakovë.

14. Parashtruesja e kërkesës me padi kërkoi njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe regjistrimin e pronës në emrin e saj (paditëses). Parashtruesja e kërkesës në padi pretendoi se ky ishte rasti i tretë i shitjes së lokalit nga SH. A. "Agimi" dhe se blerësve tjerë u është njohur e drejta në lëndët e Gjykatës Komunale në Gjakovë (C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06).

15. Në Gjykatën Komunale e paditura SH. A. "Agimi", nëpërmjet të të autorizuarit të saj, deklaroi "*se lokali në fjalë i është shitur blerëses sipas procedurave të parapara me Statutin e të padituresh dhe me ligjet në fuqi, andaj nuk e konteston të drejtën e blerëses të lokalit lëndor nga ana e paditëses sepse të gjitha obligimet të cilat i ka pasur i ka kryer ndaj palës paditëse*".

16. Në këtë procedurë para Gjykatës Komunale, në cilësinë e ndërhyrësit, është paraqitur e para Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), e cila u pasua nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

17. AKP-ja e kontestoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtrueses, duke pretenduar se kontrata ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe SH. A. "Agimi" është e kundërligjshme që nga lidhja e saj mbi disa baza juridike.

18. Më 29 qershor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë (me Aktgjykimin C. nr. 354/07) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës për njohjen e të drejtës pronësore mbi pronën dhe për regjistrimin e pronës në emrin e saj.

19. Gjykata Komunale gjeti se kontrata e lidhur ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe SH. A. "Agimi" ishte e paligjshme mbi disa baza juridike dhe që: e paditura nuk e kishte të drejtën për ta shitur lokalin në bazë të ligjit në fuqi; se kontrata nuk kishte vlerë ligjore sepse nuk ishte e vërtetuar nga organet shtetërore; se në momentin e shitblerjes, objekti i shitblerjes (lokali) nuk ekzistonte; dhe këstet e pagesës nuk ishin paguar sipas afateve të përcaktuara me kontratë.

20. Më 10 mars 2010, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër (Aktgjykimit C. nr. 354/07) të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Parashtruesja në ankesën e saj kërkoi që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale dhe të kthehet lënda për rigjykim, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore.

21. Më 30 nëntor 2012, AKP-ja parashtroi përgjigje në ankesë, duke pretenduar se SH. A. "Agimi" *"në atë kohë nuk mund të shiste apo blente pa pëlqimin e UNMIK-ut"*.

22. Më 18 shkurt 2016, Kolegji i Apelit (me Aktvendimin AC-II-12-0189) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 354/07 e Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Në esencë, të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës mund të përmblidhen në:

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera të Kushtetutës dhe me konventat ndërkombëtare

24. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se është e diskriminuar, sepse në *"praktikën gjyqësore në Kosovë [...] në çështjet juridike C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 në situata krejtësisht identike u ka aprovuar kërkesat palëve"*.

25. Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"... ka edhe lokale tjera që janë shitur nga e paditura pas lufte dhe prona u është bartur"*.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

26. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës citon edhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës, duke theksuar se *"... Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me dt. 21 maj 2008, ..."*, ndërsa *"Raporti juridik në mes të palëve është krijuar dukshëm më herët, para se të themelohet AKM dhe pastaj AKP"*.

27. Në bazë të asaj që u tha më lart, parashtruesja e kërkesës konkludon se *"dispozitat në të cilat bazohen aktgjykimet e atakuara nuk mund të aplikohen retroaktivisht, në dëm të parashtrueses së kërkesës"*.

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe me nenet e tjera

28. Parashtruesja konsideron se AKP-ja kishte ndërhyrë në procedurë në kundërshtim me funksionin e ndërhyrësit, të përcaktuar me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas pretendimeve të parashtrueses statusi i tillë juridik i AKP-së *"e bënë aktgjykimin e atakuar të pa qëndrueshëm për shkak të konfliktualitetit të ndërhyrësit gjatë procedurës me palën të cilës i është bashkuar, çka me ligj nuk është e lejuar"*.

29. Më tej, parashtruesja e kërkesës "*konsideron se ky gjykim është përfshirë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 31 - E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, përkatësisht nenit 6 - E drejta për një proces të rregullt të Konventës për mbrojtjen e së drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ...*".

30. Në kuadër të këtyre pretendimeve, parashtruesja e kërkesës citon nenin 22 të Kushtetutës dhe pohon më tej se *"Interesi i rendit kushtetues, i respektimit të normave minimale, standardeve minimale të përcaktuara me dispozita të konventave ndërkombëtare të cilat e obligojnë edhe Republikën e Kosovës duhet të imponojnë ndalimin e menjëhershëm të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të transformuara në aspektin pronësor"*.

31. Parashtruesja e kërkesës i propozon Gjykatës:

> *"... të anulojë dhe të shpallë kundërkushtetuese Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të GJSK për çështje që lidhen me AKP AC-II-12-0189 dt. 18.02.2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 354/07 të dt. 29.06.2009, për shkak se aktgjykimet nuk kanë qenë fer..."*.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

34. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

35. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

36. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesja i ka përmbushur kërkesat procedurale të nenit 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesja i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera të Kushtetutës dhe konventat ndërkombëtare

37. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata së pari i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thekson se "*diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme"* (Shih, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar,* paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002, dhe *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë,* paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006).

38. Gjykata më tej rikujton së në mënyrë që pretendimet e parashtrueses, në lidhje me shkeljen e të drejtës për diskriminim të mund të jenë të suksesshme, ata *inter alia,* duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet ngjashëm me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (Shih, *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 18 shkurtit 1991).

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se është diskriminuar, sepse *"në praktikën gjyqësore në Kosovë [...] në çështjet juridike C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 në situata krejtësisht identike u ka aprovuar kërkesat palëve".*

40. Mirëpo, parashtruesja e kërkesës nuk e dorëzon dokumentacionin nga *"lënda C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06",* por më tej thekson "*... se ka edhe lokale tjera që janë shitur nga e paditura pas lufte dhe prona u është bartur".*

41. Gjykata vëren se, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 354/07) e trajtoi këtë çështje të ngritur nga parashtruesja e kërkesës, ku *"... në cilësinë e provës i administroi edhe shkresat e lëndës C. nr. 122/06 dhe C. nr. 733/06 të formës së prerë, mirëpo meqë të njëjtat ishin irelevante për vendosjen ndryshe të kësaj çështje nuk bëri ndonjë analizë të veçantë ndonëse në sistemin tonë juridik nuk aplikohet e ashtuquajtura "e drejta e precedentit".*

42. Prandaj, Gjykata konstaton se Gjykata Komunale në Gjakovë në lidhje me këto pretendime të parashtrueses dha një përgjigje të arsyeshme, dhe se ajo nuk arriti të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

43. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GJEDNJ në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të cilat janë të aplikueshme edhe me nenin 46 të Kushtetutës dhe e arsyetojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës në pronë (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë,*

paragrafi 35 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 2004; *MALTZAN (FREIHERR VON) dhe të tjerët kundër Gjermanisë,* paragrafi 74, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri, i 2 marsit 2005).

44. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk është bërë bartëse e të drejtës pronësore; përkundrazi, ajo është përpjekur ta fitojë pronën, do të thotë se parashtruesja e kërkesës kishte vetëm "*shpresë për njohjen e të drejtave pronësore, e cila është e pamundur të arrihet efektivisht",* prandaj kjo gjendje juridike "*nuk mund të konsiderohet si "pronë" në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1".*

45. Të gjitha "pritjet legjitime" të saj se ajo do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës ishin të bazuara në kontratën e cila nuk është vërtetuar nga asnjë autoritet publik, për të cilën Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Kolegji i Apelit konstatuan se *"ishte lidhur ultra vires dhe nuk ia barti të drejtën e pronës palës kontraktuese".*

46. Edhe pse parashtruesja e kërkesës thirret në "*zbatimin retroaktiv të së drejtës*", Gjykata vëren se ajo këtë nuk e arsyeton në asnjë mënyrë.

47. Gjykata vëren se çështja kryesore që u ngrit në gjykatat e rregullta ishte çështja e "*bazës ligjore për fitimin e të drejtës pronësore",* për të cilën Gjykata Komunale në Gjakovë arsyetoi se, në rastin konkret:

> *"E paditura nuk e kishte të drejtën për ta shitur shitoren në bazë të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1, [...]e cila thotë se UNMIK-u administron pasurinë e tundshme dhe të patundshme, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe format e tjera të pronës të regjistruara në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, të cilat gjendet në territorin e Kosovës".*

48. Më tej, Gjykata Komunale arsyetoi se "*kontrata nuk kishte vlerë ligjore dhe ishte e paligjshme për faktin se nuk ishte e legalizuar dhe nuk ishte e mundur të legalizohej nga ndonjë organ kompetent gjyqësor".*

49. Përveç kësaj, Gjykata Komunale gjeti se *"nga referati i padisë shihet se (në momentin e shitblerjes) dyqani - lokali si pasojë e luftës së fundit në Kosovë, ka qenë tërësisht i shkatërruar. Andaj, në raport me përmbajtjen: kontrata është nule, jo vetëm "kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejuar, i pa caktuar ose i pa caktueshëm" neni 47 i LMD".*

50. Në fund, Gjykata Komunale konkludoi që "*paditësja poqëse i shpreson suksesit në kontest mund të ushtroj padi kundër të padituërs për kthimin e shumës së paguar të çmimit të kontraktuar të shitblerjes të lokalit lëndor sipas kontratës".*

51. Një përfundim i tillë i Gjykatës Komunale është mbështetur edhe nga Kolegji i Apelit, i cili më tej konstatoi se *"Menaxhmenti i SH. A. "Agimi" nuk kishte kompetenca për të shitur ndonjë aset pa autorizimin e UNMIK-ut sipas nenit 6. 1. b të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/54, që ishte e zbatueshme në kohën e përpjekjes së blerjes. Kontrata në fjalë ishte lidhur ultra vires dhe nuk ia barti të drejtën e pronësisë palës kontraktuese. Përveç kësaj, kontrata nuk është vërtetuar asnjëherë në gjykatën me kompetencë territoriale".*

52. Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludon se parashtruesja nuk arriti t'i paraqes dhe t'i mbështes pretendimet për "*zbatimin retroaktiv të së drejtës*" janë të pabazuara. Gjykata konsideron se Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Kolegji i Apelit kanë dhënë

përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës, përkitazi me arsyet e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe të asaj materiale.

53. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës ka lidhur marrëdhënie kontraktuale që është *void ab initio;* kjo punë juridike ka qenë e pavlefshme që nga fillimi, dhe rrjedhimisht një punë e tillë juridike nuk mund të konvalidohet më vonë.

54. Nga ajo që u tha më lart, Gjykata rikujton se "pritshmëria legjitime" nuk mund të ndodhë *"në qoftë se ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit të brendshëm";* prandaj, në bazë të të gjithave që u prezantuan, Gjykata konkludon se me vendimet e gjykatave të rregullta nuk është shkelur neni 46 i Kushtetutës as neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe që këto nene nuk garantojnë të drejtën e fitimit të pronës (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 të Aktgjykimit të GjEDNj-së, të 28 shtatorit 2004).

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës dhe nenet e tjera

55. Parashtruesja e kërkesës pretendon se AKP-ja kishte ndërhyrë në procedurë në kundërshtim me funksionin e ndërhyrësit, të përcaktuar me nenin 271 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas pretendimeve të parashtrueses statusi i tillë juridik i AKP-së *"e bënë aktgjykimin e atakuar të pa qëndrueshëm për shkak të konfliktualitetit të ndërhyrësit gjatë procedurës me palën të cilës i është bashkuar, çka me ligj nuk është e lejuar".*

56. Parashtruesja e kërkesës, më tej, konsideron se është shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës, dhe pretendon më tej se *"interesi i rendit kushtetues, i respektimit të normave minimale, standardeve minimale të përcaktuara me dispozita të konventave ndërkombëtare të cilat e obligojnë edhe Republikën e Kosovës ... ".*

57. Gjykata përsëritë që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara të aplikimit të ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* paragrafi 28 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999).

58. Sidoqoftë, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i zgjidhin çështjet e interpretimit të ligjit. Kjo veçanërisht vlen për aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e të drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e rregullta (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, veçanërisht ato të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

59. Parashtruesja e kërkesës konteston aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e tyre nga ana e gjykatave të rregullta. Këtë interpretim e kanë arsyetuar gjykatat e rregullta në dy shkallë. Ky përfundim u arrit nga gjykatat e rregullta pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës.

60. Parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në fazat e ndryshme të kësaj procedure të paraqesë argumentet dhe provat që i konsideroi të rëndësishme për rastin e saj. Njëkohësisht, asaj i është dhënë mundësia për të kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe ta kontestojë

interpretimin e ligjit në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe Kolegjin e Apelit në procedurë të rregullt gjyqësore.

61. Gjykata konsideron se vendimet e Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Kolegjit të Apelit janë të drejta dhe të arsyeshme. Në fakt, ato shpjegojnë në detaje përse kontrata e shitblerjes është juridikisht e pavlefshme, dhe se ajo është lidhur *ultra vires* dhe për këtë arsye ai nuk kishte bartur të drejtën e pronësisë palës kontraktuese.

62. Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë përmbushur. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës.

63. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI08/16, Parashtrues i kërkesës: Premtim Provolija, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 220/2015, të 17 nëntorit 2015

KI08/16, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2016, i publikuar më 16 janar 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, madhor i ri, vepër penale, ekspert, juridiksion*

Më 7 korrik 2014, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzë (Aktakuza PP. nr. I. 115/14) kundër parashtruesit të kërkesës për dy vepra penale: veprën penale grabitje në bashkëkryerje dhe veprën penale mbajtja e paautorizuar në pronësi, në kontroll ose në posedim të armëve. Më 23 shtator 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj, me Aktgjykimin PKR. nr. 116/14, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor, pas marrjes parasysh të faktit të pranimit të fajësisë, për të dy veprat penale dhe i shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe 2 (dy) muaj.

Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i refuzuan si të pabazuara ankesat e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 220/2015, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me arsyetim të detajuar.

Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se gjykatat e rregullta, në rastet kur vepra penale është kryer nga "madhori i ri", duhet të zbatojnë KDM-në, dhe se, në rastin e tij, duke refuzuar të marrin "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri", atij i cenuan parimin e: i) barazisë së palëve në procedurë penale, dhe ii) të drejtës së qasjes në Gjykatë.

Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin e saj, ndër të tjera, adresoi edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth detyrimit ose jo të zbatimit të KDM-së në rastet kur kryesi i veprës penale është "madhor i ri" dhe rreth detyrimit të Gjykatës Themelore të marrë ose jo "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri", duke arsyetuar se *"...sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kjo dispozitë nuk mund të aplikohet ndaj personit të moshës madhor i ri në çdo rast, por në rastet e parapara me nenin 11, par. 1 të KDM i cili më lart u citua e sipas të cilit kjo është mundësi e jo imperativ ligjor."*

Gjykata Kushtetuese konsideron se gjykatat e rregullta kishin trajtuar dhe kishin arsyetuar në mënyrë përmbajtjesore të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth domosdoshmërisë së zbatimit të KDM-së në rastet kur veprat penale kryhen nga "madhori i ri" dhe diskrecionin e gjykatave për marrjen e *„mendimit të ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri"*.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar dhe janë trajtuar në gjykatat e rregullta dhe se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin administruar hollësisht dhe se procedura pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishte e drejtë. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI08/16

Parashtrues

Premtim Provolija

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 220/2015, të 17 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Premtim Provolija, nga fshati Sopanicë, komuna e Kaçanikut (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 220/2015, të 17 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 janar 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 2 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 korrik 2014, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzë (Aktakuza PP. nr. I. 115/14) kundër parashtruesit të kërkesës për dy vepra penale: grabitje në bashkëkryerje dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të armëve.

10. Më 23 shtator 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj, me Aktgjykimin PKR. nr. 116/14, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor, pas marrjes parasysh të faktit të pranimit të fajësisë, për të dy veprat penale dhe i shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe 2 (dy) muaj.

11. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesë në Gjykatën e Apelit paraqitën edhe parashtruesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore në Ferizaj. Gjithashtu, Prokuroria e Apelit (Parashtresa PPA. I/nr. 178/15) i propozoi Gjykatës së Apelit që ankesa e Prokurorisë Themelore të aprovohet dhe, që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarve t'u shqiptohet një dënim më i ashpër me burgim.

12. Çështja thelbësore e shtruar para Gjykatës së Apelit ishte nëse ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke marrë parasysh që: i) në kohën e kryerjes së veprës penale, parashtruesi i kërkesës ishte "madhor i ri" dhe, sipas tij, do të duhej të aplikoheshin dispozitat e Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur (në tekstin e mëtejmë: KDM), siç përcaktohet në nenin 4, par. 2, të këtij Kodi, dhe ii) Gjykata Themelore kishte refuzuar të merrte "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri", të paraparë me nenin 11 të KDM-së, përkundër propozimit të mbrojtjes.

13. Më 29 qershor 2015, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAKR. nr. 179/15, e vërtetoi Aktgjykimin nr. 116/14 të Gjykatës Themelore dhe refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorisë Themelore.

14. Më 21 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit PKR. nr. 116/14 të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe kundër Aktgjykimit PAKR. nr. 179/15 të Gjykatës së Apelit, duke u thirrur në shkelje esenciale të procedurës penale. Nga ana tjetër, më 12 tetor 2015, Prokurori i Shtetit (me parashtresën KMLP. II. nr. 164/15) propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

15. Më 17 nëntor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 220/2015, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me arsyetim të detajuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur neni 31, paragrafët 4 dhe 7, i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon cenim të: i) barazisë së palëve në procedurë penale dhe ii) të drejtës së qasjes në gjykatë.

17. Sa i përket parimit të barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës pretendon që me refuzimin e kërkesës për mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të "madhorit të ri", Gjykata Themelore i pamundësoi parashtruesit të kërkesës mundësinë e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet dhe, si rezultat, e vendosi në pozitë më pak të favorshme kundrejt pretendimeve të Prokurorisë.

18. Sa i përket pretendimeve për cenim të së drejtës për qasje në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon që me refuzimin e kërkesës për mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të "madhorit të ri", Gjykata Themelore i pamundësoi parashtruesit të kërkesës të drejtën për t'u dëgjuar, duke e vendosur parashtruesin e kërkesës në pozitë të pabarabartë dhe, si rezultat, duke e dëmtuar zbatimin efektiv të një procesi të rregullt ligjor.

19. Për më tepër, në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në rastin KI78/12, parashtrues i kërkesës *Bajrush Xhemajli*, aktgjykim i nxjerrë nga kjo Gjykatë më 24 janar 2013 (në tekstin mëtejmë: rasti Xhemajli), ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

20. Rrjedhimisht, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të deklarojë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke e kthyer atë në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, paragrafëve 1 dhe 7, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
>
> *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
> *[...]"*

23. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Por, për të konstatuar pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara me procedurat e veçanta të përcaktuara me nenet 46 deri në 49 të Ligjit dhe me kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 36 të Rregullores së punës.

24. Gjykata vlerëson që parashtruesi i kërkesës i plotëson kushtet e parapara me nenin 46 [Lejueshmëria]; paraqet kërkesë individuale në bazë të cilës parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga një autoritet publik dhe atë pasi që janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj, siç është përcaktuar me nenin 47 [Kërkesa Individuale]; dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, siç është paraparë me nenin 49 [Afatet].

25. Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij, siç kërkohet me nenin 48 [Saktësimi i Kërkesës] të Ligjit, që parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

26. Gjykata vlerëson që parashtruesi i kërkesës ka qartësuar që pretendon t'i jetë cenuar e drejta e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe saktëson aktin e autoritetit publik të cilin e konteston, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 220/2015, të 17 nëntorit 2015.

27. Më tej, për të konstatuar pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata gjithashtu duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

28. Rregulli 36 (1) i Rregullores së punës saktëson kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke e përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Sipas rregullit 36 (2), një kërkesë është qartazi e pabazuar nëse Gjykata bindet se:

> *(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*
> *[...]"*

29. Duke marrë parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk arriti të arsyetojë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese, për arsyet si në vijim:

30. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se gjykatat e rregullta, në rastet kur vepra penale është kryer nga "madhori i ri", duhet të zbatojë KDM-në, dhe se, në rastin e tij, duke refuzuar të marrin "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri", atij i cenuan parimin e: i) barazisë së palëve në procedurë penale, dhe ii) të drejtës së qasjes në Gjykatë.

31. Gjykata para së gjithash thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat

e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

32. Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse ligjore, dhe se nuk është detyrë e Gjykatës, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta (Shih rastin *Perlala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, paragrafi 25, GJEDNJ, aktgjykimi i 22 shkurtit 2007).

33. Gjykata rikujton gjithashtu se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vërtetojë nëse disa lloje të provave janë të lejuara, se cilat prova duhet të merren dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Pyetjes së cilës duhet t'i përgjigjet Gjykata Kushtetuese është nëse procedura në tërësi ishte e drejtë, duke përfshirë mënyrën e marrjes së dëshmive (Shih rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 35394/97, paragrafi 34-35 i KEDNJ, aktgjykimi i 12 majit 2000).

34. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar dhe janë trajtuar në gjykatat e rregullta dhe se pretendimet e parashtruesit të kërkesës ishin administruar hollësisht dhe se procedura pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishte e drejtë. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës i paraqiti këto pretendime edhe në procedurën sipas ankesës në Gjykatën e Apelit edhe nëpërmjet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar në këto pretendime të parashtruesit.

35. Së pari, Gjykata e Apelit e Kosovës (me Aktgjykimin PARK. nr. 179/15), detajisht e arsyetoi mënyrën në të cilën Gjykata e zbatoi ligjin procedural dhe material:

> *"... Janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit së [...] KDM-së zbatohen ndaj çdo personi të dyshuar për vepër penale të kryer si madhor i ri (*personat *nga 18 deri në 21 vjet), por zbatimi i kësaj dispozite vjen në shprehje vetëm në rastin kur madhorit të ri mund t'i shqiptohet masa por me kusht që duke pas parasysh personalitetin dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, mund të pritet që edhe me masën edukuese të arrihet qëllimi i cili kishte me arrit me shqiptimin e dënimit. Zbatimi i dispozitës së nenit 4 par. 2 të KDM-së vjen në shprehje vetëm në rastin kur kryesi ka ngecje në zhvillimin mendor, ndërsa hulumtimi bëhet nëse paraqiten rrethana, të cilat shkaktojnë dyshim se shkalla e zhvillimit mendor nuk i përgjigjet moshës madhore. Në rastin konkret nuk janë paraqitur rrethana se i akuzuari ka ngecje në zhvillimin mendor, gjykata nuk ka dyshuar në zhvillimin mendor të të akuzuarit në raport me moshën që ka, prandaj drejt ka vepruar kur këtë çështje e ka gjykuar sipas dispozitave të KPPK-së, e jo sipas dispozitave të KDM-së".*

36. Për më tepër, në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, adresoi edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth detyrimit ose jo të zbatimit të KDM-së në rastet kur kryesi i veprës penale është "madhor i ri" dhe rreth detyrimit të Gjykatës Themelore të marrë ose jo "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri".

37. Sa i përket domosdoshmërisë së zbatimit të KDM-së, në rastet kur vepra penale është kryer nga "madhori i ri", Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj arsyeton:

"... sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kjo dispozitë nuk mund të aplikohet ndaj personit *të moshës madhor i ri në çdo rast, por në rastet e parapara me nenin 11, par.1. të KDM i cili më lart u citua e sipas të cilit kjo është mundësi e jo imperativ ligjor. Nga vet formulimi i nenit 11. par.1. të KDM del se ndaj kësaj kategorie të kryesve të veprës penale, gjykata mund të shqiptojë masë ose dënimet në pajtim me nenin 7 të KPDM, por se ndaj tyre si rregull, shqiptohen dënimet të parapara për kryes të veprave penale të moshës madhore.*

Andaj, nga kjo del se dispozitat e KDM nuk aplikohen gjithherë ndaj kryesve të veprës penale të moshës madhor i ri, siç në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë gabimisht është interpretuar me dispozitat e nenit 4. par.2 të KDM".

38. Ndërsa, sa i përket detyrimit të Gjykatës që të marrë "mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri", Gjykata Supreme arsyeton:

"Gjykata Supreme nga shkresat e lëndës konkludoi se në rastin konkret propozimi për caktimin e ekspertit nuk është bërë në shqyrtim gjyqësor por në shqyrtim fillestar. Nga *procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës. Paraprakisht, gjykata është bindur se janë plotësuar kriteret nga neni 248. par.1 të KPPK dhe ka marr aktvendim me te cilin ka pranuar pranimin e fajësisë. Të gjitha këto nuk kontestohen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Nga procesverbali i shqyrtimit fillestar po ashtu del se pasi i dënuari ka pranuar fajësinë, mbrojtësi i tij (si dhe prokurori) janë pyetur të deklarohen lidhur me pranimin e fajësisë dhe me këtë rast, mbrojtësi i të dënuarit ka deklaruar se edhe ai akcepton pranimin e fajësisë sepse ky pranim i fajësisë është bërë pas konsultimeve me të – me mbrojtësin, i cili e ka informuar të dënuarin për llojet e dënimeve të parapara për këto vepra penale, për pasojat dhe privilegjet e të njëjtës dhe se pranimi i fajësisë është bërë me vullnet të plotë pa kurrfarë lajthitje ose premtimi nga ana e mbrojtësit...

Sipas dispozitës së nenit 11.par.1 të KDM "Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit të ri i cili nuk ka arritur moshën njëzetenjë (21) vjet për vepër penale të kryer si madhor i ri, gjykata mund të shqiptojë masë ose dënim në pajtim me nenin 7 të këtij *Kodi, nëse çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej edhe me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë.*

Nga kjo dispozitë del se aplikimi i kësaj dispozite ndaj madhorit të ri është në diskrecionin e gjykatës e jo domosdoshmëri *sepse ndaj madhorit të ri, për veprat penale të kryera si madhor i ri, parimisht aplikohen dispozitat e KPK dhe KPPK. Për të aplikuar këtë nen duhet të ekzistojë një pikënisje, shkas për të besuar se, në mes tjerash, edhe në bazë të zhvillimit psikologjik të madhorit të ri, duke marr parasysh mendimin e ekspertit (dhe faktet e tjera të cekura më lartë), ka vend për shqiptimin e sanksionit i cili shqiptohet ndaj ekzekutorit të mitur. Në rastin konkret, gjatë procedurës e cila ka paraprirë shqyrtimin fillestar dhe në vet këtë shqyrtim, nuk është paraqitur asnjë rrethanë e atillë që këtë rast do të bënte të veçantë në kuptimin e lartcekur".*

39. Për më tepër, arsyetimi i gjykatave të rregullta ishte në përputhje me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 14 shkurtit 2014, të cilin Gjykata Supreme e nxori në bazë të autorizimeve të saj ligjore për të përcaktuar qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat

në territorin e Kosovës, duke marrë parasysh paqartësitë që mund të dalin nga neni 4, par. 2 i KDM-së. Gjykata Supreme në mendimin juridik të saj konkludoi:

> *"Ndaj madhorit të ri, i cili ka kryer vepër penale si madhor i ri, mund të aplikohet procedura sipas KDM, nëse gjykata çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri, dhe interesin e tij më të mirë, në të kundërtën ndaj tij aplikohen dispozitat e KPPK në të gjitha aspektet".*

40. Si rezultat, Gjykata Kushtetuese konsideron që gjykatat e rregullta kishin trajtuar dhe kishin arsyetuar në mënyrë përmbajtjesore të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth domosdoshmërisë së zbatimit të KDM-së në rastet kur veprat penale kryhen nga "madhori i ri" dhe diskrecionin e gjykatave për marrjen e "mendimit të ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri".

41. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur neni 31, paragrafët 4 dhe 7 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht sa i përket pretendimeve për cenim të: i) barazisë së palëve në procedurë penale dhe ii) të drejtës së qasjes në Gjykatë:

42. Gjykata rikujton që parimi i "barazisë së armëve" në mes të palëve në një rast është kusht thelbësor i shqyrtimit të drejtë. Barazia e armëve, e cila duhet të respektohet gjatë tërë procesit të gjykimit, do të thotë që palët duhet të trajtohen në atë mënyrë duke u siguruar që ato të kenë pozitë procedurale të barabartë gjatë zhvillimit të gjykimit dhe të jenë në pozitë të barabartë për të paraqitur rastin e tyre. (Shih aktgjykimet e GJEDNJ-së në rastet *Ofrer dhe Hopfinger*, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696). Kjo do të thotë që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis* a *vis* palës kundërshtare (Shih gjithashtu aktgjykimin në rastin nr. 10/14, parashtrues *Shoqëria Aksionare Raiffeisen Bank Kosovë Sh. A.*).

43. Megjithatë, në rastin në fjalë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor në bazë të pranimit të fajësisë në shqyrtimin fillestar, të bërë në bazë të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, përderisa domosdoshmëria e marrjes së mendimit të lidhur me zhvillimin psikologjik të "madhorit të ri" dhe vetë aplikimi i dispozitave të këtij Kodi ishte adresuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme dhe ishte arsyetuar detajisht në aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, siç është elaboruar më lart.

44. Sa i përket pretendimeve për cenim të së drejtës për qasje në gjykatë, Gjykata sërish i referohet arsyetimeve të gjykatave të rregullta mbi specifikat dhe kushtet përkatëse për aplikimin e dispozitave të KDM-së në rastin e "madhorëve të rinj".

45. Për më tepër, në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin Xhemajli, ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

46. Gjykata vëren se ka disa aspekte kyçe, në të cilat kërkesa e tanishme dallon me rastin Xhemajli. Gjykata vëren se: i) në rastin Xhemajli, parashtruesi ka kërkuar ekspertizë shtesë prej të cilit varej në mënyrë të drejtë "*fajësia ose pafajësia e tij*", përderisa në rastin e tanishëm fajësia e parashtruesit ishte vërtetuar në bazë të pranimit të fajësisë, në përputhje me dispozitat e Kodit për Procedurë Penale; dhe ii) domosdoshmëria dhe kushtet nën të cilat aplikohen dispozitat e KDM-së në rastin e "madhorëve të rinj" ishin

elaboruar detajisht, fillimisht në mendimin juridik të Gjykatës Supreme dhe, më pas, në arsyetimin e aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme.

47. Për shkak të kësaj që u tha më lart, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që, në faza të ndryshme të procedurës, t'i paraqesë argumentet dhe dëshmitë që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestonte në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe ta kontestonte interpretimin e ligjit në Gjykatën Themelore, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës në procedurën e rregullt gjyqësore.

48. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë.

49. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk arriti të paraqesë dhe të mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

50. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç specifikohet me kriteret e pranueshmërisë, rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI67/16, Parashtruesja e kërkesës: Lumturije Voca, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-041/14, të 2 dhjetorit 2015

KI67/16, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetori, i publikuar më 23 janar 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, pronë, juridiksion*

Parashtruesja e kërkesës e bleu një banesë në Prishtinë dhe e vërtetoi kontratën në gjykatën kompetente.

Të drejtën mbi këtë banesë e pretendoi edhe një familje e cila e inicioi procedurën e vërtetimit të pronësisë në KÇPB, i cili (me Vendimin HPCC/D/06/2003/B&C) gjeti se *„Egjlane Gashi e ka fituar pronësinë e banesës objekt kërkese"*.

Krahas me këtë procedurë, parashtruesja paraqiti kërkesën për vërtetimin e pronësisë para gjykatave të rregullta. Gjykata Supreme (me Aktgjykimin Rev. nr. 142/2003) ia ka njohur të drejtën e posedimit parashtrues së kërkesës.

Në këtë mënyrë, në procedurë janë paraqitur dy vendime të cilat kanë qenë të formës së prerë me statusin *res judicata*, por në njërin vendim bartëse e të drejtës ka qenë parashtruesja, e në tjetrin personat e tretë.

Parashtruesja pretendoi se për të njëjtën çështje ligjore janë zhvilluar dy procedura të ndryshme: një para gjykatave të rregullta dhe një para KÇPB-së dhe Kolegjit të Apelit. Ajo situatë çoi në atë se *"në rastin para jush keni dy vendime të ndryshme të formës së prerë dhe të detyrueshme për të njëjtin objekt çështje ndaj personave të tretë dhe institucioneve"*.

Gjykata vërtetoi se në procedurat në gjykatat e rregullta parashtruesja Lumturije Voca kishte për qëllim që të ushtrojë „të drejtën e posedimit" mbi banesën kontestuese. Parashtruesja ka kërkuar që banesa kontestuese të lirohet nga njerëzit dhe gjërat, dhe si e tillë t'i dorëzohet asaj për përdorim të mëtejshëm.

Parashtruesja e kërkesës nuk ka kërkuar në procedurën në gjykatat e rregullta vërtetimin e *„të drejtave të pronësisë",* edhe pse parashtruesja e kërkesës ishte në dijeni për procedurat në KÇPB në lidhje me vërtetimin e *„të drejtave të pronësisë"* ndërmjet *"trashëgimtarëve ligjorë të Egjlane Gashit"* konkretisht motrës së saj Saide Kelmendi dhe Vesela Radović.

Fushëveprimi material i kontestit në KÇPB ishte e drejta për pronësi mbi banesën e kontestuar, e jo e drejta për posedim të banesës kontestuese. Në këtë drejtim, KÇPB-ja konkludoi që të gjitha përpjekjet e mëtejshme për ta shitur banesën duhet të konsiderohen të pavlefshme, për shkak se ajo ka deklaruar si të vlefshme *"transaksionin e bërë midis Egjlane Gashit dhe bartësit të së drejtës së ndarjes, dt. 18 nëntor 1994"* (shih: Vendimin HPCC/D/06/2003/B&C, të 12 dhjetorit 2003).

Gjykata konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 142/2003, nëse ka prodhuar efekt *res judicata* vetëm në fushëveprimin material të *"së drejtës së posedimit"* dhe se ai Aktgjykim do ta kishte humbur efektin *res judicata* me Vendimin (nr. HPCC/REC/61/2006) të KÇPB-së, nëse kishte prodhuar efekt *res judicata* sa i përket *"të drejtave pronësore"*.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtrueses, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ajo e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara me lart, procedurat pranë gjykatave të

rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI67/16

Parashtrues

Lumturije Voca

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-041/14, të 2 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Lumturije Voca nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), që përfaqësohet nga avokati Qazim Qerimi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), GSK-KPA-A-041/14, të 2 dhjetorit 2015.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 28 janar 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur nenet 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në

rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 prill 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 11 maj 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 2 qershor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë Vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/215/2013, të 21 shtatorit 2013. Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

9. Më 23 qershor 2016, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Rifat Çekut dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë të Egjlane Gashit, përkatësisht: Saide Kelmendi, Bashkim Mulliqi, Safinaz Rudi dhe Tabe Ivesi, si palë të paditura, dhe u dha afat prej 7 (shtatë) ditësh për të paraqitur komentet e tyre, nëse kanë.

10. Më 1 korrik 2016, Rifat Çeku i dorëzoi komentet në Gjykatë dhe autorizimin për të përfaqësuar trashëgimtarët e tjerë ligjorë të Egjlane Gashit.

11. Më 6 korrik 2016, Gjykata i dërgoi parashtrueses së kërkesës një kopje të komenteve të paraqitura nga palët e paditura, duke lënë një periudhë prej 7 (shtatë) ditësh t'i paraqet komentet e saj, nëse ka.

12. Më 21 shtator 2016, Gjykata, duke qenë në dijeni që çështja C. nr. 1268/10 është në procedurë e sipër në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kërkoi që gjykata në fjalë t'i informojë lidhur me atë se cilat janë palët ndërgjyqëse në procedurë; cili është objekti i çështjes në këtë rast; dhe në cilën fazë është procedura.

13. Më 20 tetor 2016, Gjykata Themelore informoi se rasti në procedurë e sipër "*ka filluar me padinë C. nr. 1268/10 e paditëses Lumnije Voca nga Prishtina, më 3 qershor 2010, të parashtruar kundër të padituri Rifat* Çeku *nga Prishtina, rr. Tirana, ndërtesa 52-1/1, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë*". Përveç kësaj, Gjykata Themelore ka bashkëngjitur "*padinë e paditëses të 3 qershorit 2010 dhe përgjigjen ndaj padisë të 27 marsit 2015*".

14. Më 6 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të përgjithshme

15. Më 23 tetor 1986, Egjlane Gashit i është ndarë banesa në ish rrugën e Beogradit dhe tani në rrugën e Tiranës, në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: banesa).

16. Më 30 shtator 1987, Egjlane Gashi lidhi kontratë mbi shfrytëzimin e banesës me Ndërmarrjen Publike Banesore (në tekstin e mëtejmë: NPB-ja).

17. Më 8 nëntor 1994, Egjlane Gashi lidhi kontratë për blerjen e banesës dhe pagoi çmimin e kontraktuar.

18. Ministria e Financave e Republikës së Serbisë nuk e aprovoi bartjen e të drejtës së pronësisë siç kërkohet me Ligjin për qarkullimin e pronës së paluajtshme. Kontrata mbi blerjen e banesës nuk u vërtetua nga Gjykata Komunale, për shkak të mungesës së këtij aprovimi.

19. Më 2 shkurt 1995, Egjlane Gashi ka vdekur dhe në banesë vazhduan të jetojnë trashëgimtarët e saj ligjorë, gjegjësisht motra e saj Saide Kelmendi, e cila gjatë vitit 1997 është dëbuar nga banesa.

20. Më 12 shkurt 1998, NPB-ja ia ndau banesën në shfrytëzim Vesela Radović dhe më 31 mars 1998, NPB-ja lidhi kontratën mbi shfrytëzimin e banesës me Vesela Radović.

21. Më 13 maj 1998, Vesela Radović lidhi kontratë për blerjen e banesës me NPB. Vesela Radović ka jetuar në banesë deri më 24 qershor 1999, kur u shpërngul nga Kosova.

22. Pas kësaj dite, në banesë u vendos Rifat Çeku, trashëgimtari i të ndjerës Egjlane Gashi.

23. Më 14 dhjetor 2001, parashtruesja e kërkesës Lumturije Voca lidhi kontratë për shitblerjen e banesës me Vesela Radović. Ajo kontratë ishte vërtetuar (VR. nr. 6692/2001) nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

Përmbledhja e fakteve në procedurën e zhvilluar në gjykatat e rregullta

24. Parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale, duke pretenduar se Rifat Çeku qëndron në banesë dhe kërkoi që ai të obligohet që "*ta liroj nga njerëzit dhe sendet dhe të lirë t'ia dorëzojë paditëses në shfrytëzim të mëtejmë*".

25. I padituri Rifat Çeku i propozoi Gjykatës Komunale ta refuzojë padinë si të pabazuar *"nga arsyeja se banesa e cila është objekt i kërkesëpadisë është pronë e Egjlane Gashit"*.

26. Më 30 maj 2002, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 290/2002) aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses dhe obligoi Rifat Çekun ta lirojë banesën.

27. Rifat Çeku, si njëri nga trashëgimtarët ligjorë të së ndjerës Egjlane Gashi, parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar se procedura lidhur me të drejtat pronësore për të njëjtën banesë ishin në pritje para Komisionit për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejmë: KÇPB), ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë të Egjlane Gashit dhe Vesela Radović. Trashëgimtarët e tjerë ligjorë të Egjlane Gashit, përkatësisht Saide Kelmendi, Bashkim Mulliqi, Safinaz Rudi dhe Taibe Ivesi, gjithashtu parashtruan ankesë, duke pretenduar se banesa ishte pronë e tyre dhe se procedurat në lidhje me banesën ishin iniciuar në KÇPB-së.

28. Më 2 korrik 2003, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 521/2002) refuzoi si të pabazuara ato ankesa të Rifat Çekut dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

29. Rifat Çeku parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se gjykatat e rregullta ishin jokompetente për të vendosur në këtë çështje juridike, pasi KÇPB-ja kishte kompetencë ekskluzive dhe se banesa është pronësi e Egjlane Gashit dhe të trashëgimtarëve ligjorë. Për më tepër, Rifat Çeku pretendoi se trashëgimtarëve ligjorë të Egjlane Gashit nuk u është lejuar që të ndërhyjnë në procedurë.

30. Më 21 janar 2004, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 142/2003) refuzoi, si të pabazuar, revizionin e Rifat Çekut dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut.

31. Gjykata Supreme shqyrtoi pretendimin për jokomeptencë të gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, Gjykata Supreme gjeti se ai pretendim është i pabazuar, sepse "fakti se *parashtruesja ka blerë banesën nga Vesela Radović më 14 dhjetor 2001, transaksion juridik që ka ndodhur pas datës 13.10.1999 dhe sipas nenit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 të datës 15 nëntor 1999 këto çështje janë në kompetencë të gjykatave dhe jo të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore".*

32. Gjykata Supreme, gjithashtu, konstatoi se Vesela Radović ka mundur ta posedojë banesën dhe t'ia shesë atë paditësit "*për faktin se Vesela Radović, sipas kontratës së shitblerjes të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka qenë pronare e banesës në fjalë dhe gjatë tërë procedurës, deri në marrjen e aktgjykimit të goditur* [të Gjykatës së Qarkut]*, nuk është provuar, që përveç paditëses së cilës ia ka shitur, ta ketë tjetërsuar atë".*

33. Parashtruesja e kërkesës parashtroi në Gjykatën Komunale propozim për përmbarim.

34. Më 7 gusht 2003, Gjykata Komunale përcaktoi (Aktvendimi E. nr. 469/03) përmbarimin.

35. Më 21 gusht 2003, KÇPB-ja informoi Gjykatën Komunale se është regjistruar një rast për të njëjtën çështje juridike (DS008675) dhe është në pritje në KÇPB, duke kërkuar ndërprerjen e të gjitha procedurave në lidhje me përmbarimin, pasi që KÇPB-ja ka juridiksion ekskluziv për këto raste.

36. Më 2 shtator 2003, Gjykata Komunale (Konkluzioni E. nr. 469/03) urdhëroi debitorin që të bëjë *"shpërnguljen nga njerëzit dhe sendet nga banesa (...) dhe dorëzimin në shfrytëzim dhe disponim të lirë kreditorit".*

37. Më 14 nëntor 2003, Gjykata Komunale (E. nr. 469/03) kërkoi nga KÇPB-ja që të përshpejtojë procedurën e zgjidhjes së rastit të regjistruar dhe i cili është në pritje.

38. Më 11 mars 2004, Gjykata Komunale njoftoi KÇPB-në se Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 142/2003, i 21 janarit 2004) refuzoi si të pabazuar, revizionin e të paditurit Rifat Çeku. Gjykata Komunale, gjithashtu, kërkoi nga KÇPB-ja që ta informojë "*gjer ku ka arritur procedura në zgjidhjen e këtij rasti si dhe çfarë është qëndrimi i juaj tani pas këtij rasti - Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë çështje juridike, veçmas përkitazi me juridiksionin e veprimit".*

39. Më 1 korrik 2016, Rifat Çeku e informoi Gjykatën se në vitin 2010, *"parashtruesja e kërkesës (...) parashtroi padi kundër* [atij] *në Gjykatën Komunale në Prishtinë (...) për të konfirmuar pronësinë*" mbi banesën e kontestuar dhe se padia "*është në pritje në gjykatat e rregullta, përkatësisht procedura është ende në zhvillim e sipër".* Më 6 korrik 2016, Gjykata i dërgoi parashtrueses së kërkesës komentet e dorëzuara nga Rifat Çeku. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar nga parashtruesja brenda afatit të caktuar.

Përmbledhja e fakteve në procedurën e zhvilluar në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit

40. Në një datë të pacaktuar, Saide Kelmendi, njëra nga trashëgimtarët ligjorë të Egjlane Gashit parashtroi në KÇPB një kërkesë të kategorisë A (DS008675), duke kërkuar "*vërtetimin e pronësisë"* mbi banesën e kontestuar. Në atë padi, Saide Kelmendi ishte paditëse. Vesela Radović ishte e paditur, ndërsa Lumturije Voca (parashtruesja e kërkesës) ishte palë e interesuar.

41. Në një datë të pacaktuar, Vesela Radović, parashtroi në KÇPB dy kërkesa të kategorisë C (DS003476 dhe DS606736), duke kërkuar *"posedimin e sërishëm"* të banesës së kontestuar. Në kërkesë, Vesela Radović ishte paditëse, Rifat Çeku ishte i paditur dhe Lumturije Voca (parashtruese e kërkesës), ishte palë e interesuar.

42. Në procedurë, si palë e interesuar ka ndërhyrë edhe parashtruesja e kërkesës Lumturije Voca, duke pretenduar se banesën e ka blerë nga Vesela Radović.

43. Më 12 dhjetor 2003, KÇPB-ja (Vendimi HPCC/D/06/2003/B&C) gjeti se *"Egjlane Gashi e ka fituar pronësinë e banesës objekt kërkese. Mirëpo, me qenë se paraqitësja e parë e kërkesës* [Saide Kelmendi] *pranon se procedura gjyqësore nuk ka përfunduar, është e pa qartë nëse paraqitësja e parë e kërkesës është e vetmja trashëgimtare e ligjshme e Egjlane Gashit. Menjëherë sapo të përfundojë procedura e pa zgjedhur mbi trashëgiminë, trashëgimtari ligjor i trashëgimtarëve, i përcaktuar në bazë të këtyre procedurave, duhet të regjistrohet në regjistrat përkatës publik si pronar i banesës objekt kërkese"*.

44. Rrjedhimisht, KÇPB-ja urdhëroi më tej:

> *"1. Transaksioni i pronës ndërmjet Egjlane Gashit dhe Bartësit të së Drejtës së Ndarjes i datës 8 nëntor 1994 është valid;*
> *2. Pronësia mbi pronën objekt kërkese të regjistrohet në regjistrat përkatës publikë në favor të personave të cilët shpallen trashëgimtarë të ligjshëm të Egjlane Gashit në procedurën e pa përfunduar mbi trashëgiminë; dhe*
> *3. Kërkesa e Vesela Radović (DS003476 dhe DS606736) të refuzohet"*.

45. KÇPB-ja, gjithashtu, konstatoi se "*paraqitësja e dytë e kërkesës* [Vesela Radović] *nuk kishte të drejtë pronësore mbi banesën objekt kërkese",* dhe për këtë arsye nuk ka mundur ta bartë të drejtën e pronësisë te parashtruesja e kërkesës Lumturije Voca.

46. Në lidhje me palën e interesuar Lumturije Voca (parashtruesen e kërkesës), KÇPB-ja gjeti se "*transaksioni i vitit 1994 ishte valid"*. Prandaj, ai konsideroi se "*është e pa mundur që Komisioni ta pranojë si valide ndonjë përpjekje nga BDN që ta shesë (apo t'i akordojë ndonjë të drejtë) mbi banesën ndonjë pale"*. Prandaj, KÇPB-ja gjithashtu konstatoi se *"Komisioni e ndalon njohjen e validitetit të kësaj shitje"*.

47. Më 10 maj 2005, Lumturije Voca (parashtruesja e kërkesës), parashtroi në KÇPB kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të saj të 12 dhjetorit 2003. Në atë kërkesë, palë e paditur ishte Saide Kelmendi.

48. Më 31 mars 2006, KÇPB-ja (Vendimi nr. HPCC/REC/61/2006) refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim dhe vërtetoi vendimin e saj duke rikujtuar se *"vendimet përfundimtare të komisionit janë të detyrueshme dhe të imponueshme, dhe nuk mund të rishqyrtohen nga asnjë trup tjetër juridik apo administrativ në Kosovë"*.

49. Më 27 janar 2010, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga KÇPB-ja që ta anulojë vendimin e saj për rishqyrtim dhe të gjitha vendimet e mëparshme të marra nga ajo dhe ta vërtetojë Aktgjykimin (C. nr. 290/2002) të Gjykatës Komunale, sepse ai Aktgjykim është bërë *res judicata* më 2 korrik 2003.

50. Më 21 gusht 2013, KÇPB-ja (Vendimi nr. KPCC/D/R/215/2013) hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses si çështje e gjykuar (*res judicata),* duke konsideruar "*se e njëjta kërkesë e saj dhe për të njëjtën banesë, e regjistruar në HPCC nr. DS003476 i DS606736, është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë të KÇPB, HPCC/REC/61/2006, të 31 marsit 2006*".

51. Më 16 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër atij vendimi të KÇPB-së. Në ankesë Lumturije Voca ishte ankuese, dhe palë të paditura ishin Saide Kelmendi, Bashkim Mulliqi, Tabe Ivesi, Safinaz Rudi dhe Rifat Çeku, të cilët përfaqësonin palët tjera të paditura.

52. Më 2 dhjetor 2015, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi GSK–KPA-A–041/14) refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, sepse *"ajo nuk është ushtruar brenda afatit prej 30 ditëve"*. Kolegji i Apelit, gjithashtu, ndryshoi sipas detyrës zyrtare Aktvendimin e 21 gushtit 2013, si në vijim: *"përveç Rifat Çekut palë përgjegjëse në kërkesë në shkallën e parë janë edhe Saide Kelmendi, Bashkim Mulliqi, Safinaz Rudi dhe Tabe Ivesi"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

53. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. Ajo konsideron se "*do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale"*.

54. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. nr. 290/2002, i 30 majit 2002 është *res judicata* dhe se për 13 (trembëdhjetë) vjet nuk është përmbaruar Aktgjykimi.

55. Parashtruesja e kërkesës më tej arsyeton se për të njëjtën çështje juridike janë zhvilluar dy procedura të ndryshme: një para gjykatave të rregullta dhe një para KÇPB-së dhe Kolegjit të Apelit. Kjo situatë rezultoi *"në rastin para jush keni dy vendime të ndryshme të formës së prerë dhe të detyrueshme për të njëjtin objekt çështje"*.

56. Më tej, parashtruesja e kërkesës konsideron se KÇPB-ja "*nuk është arsyetuar fare rreth vendimit res judicata të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe si qëndron ai vendim. Këtë nuk e ka bërë as Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme"*.

57. Parashtruesja deklaron se "*Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj të 21 janarit 2004 (Rev. nr. 142/2003) qartë e ka arsyetuar çështjen e juridiksionit dhe ka konstatuar se gjykatat e rregullta kanë kompetencë të vendosin rastin sepse parashtruesja e ka blerë banesën nga Vesela Radović më 14 dhjetor 2001"*.

58. Parashtruesja e kërkesës konsideron se Kolegji i Apelit ka pasur për obligim të *"tregojë se cili aktgjykim i formës së prerë, i zbatueshëm dhe i detyrueshëm, duhet të lihet në fuqi, ai i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore më 12 dhjetor 2003 dhe 31 mars 2006 si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës i datës 21 gusht 2013 dhe të Kolegjit të Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës të Gjykatës Supreme i datës 2 dhjetor 2015 apo vendimi i Gjykatës Supreme (Rev. nr. 142/2003, të 21 janarit 2004) dhe ai i Gjykatës Komunale në Prishtinë (C. nr. 290/2002, të 30 majit 2002)"*.

59. Parashtruesja e kërkesës konsideron se është krijuar pasiguria juridike sa i përket *"parashtrueses, personave të tretë dhe institucionet kompetente. Ata "nuk dinë si të veprojnë"* sepse KÇPB-ja dhe Kolegji i Apelit "*kishte vendosur në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Supreme dhe vendimin e Gjykatës Komunale"*.

60. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se është shkelur e drejta e saj e gëzimit paqësor të kësaj pasurie, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

61. Parashtruesja e kërkesës në fund konsideron se janë shkelur parimet e sundimit të ligjit dhe nenet 7 dhe 102 të Kushtetutës, për shkak se "*Gjykata Supreme, si dhe Kolegji i Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës të Gjykatës Supreme, si pjesë e Gjykatës Supreme, kanë obligim kushtetues që të mënjanojnë këtë pasiguri juridike të shkaktuar*".

62. Parashtruesja kërkon nga Gjykata: *"që të konstatohet se vendimet e gjykatave të rregullta (...), të cilësohen si vendime të vlefshme që reflektojnë institutin res judicata në rastin konkret"*.

Komentet e palës përgjegjëse

63. Pala përgjegjëse theksoi se "*parashtruesja fare nuk e njofton Gjykatën Kushtetuese se në vitin 2010 ka ushtruar padi kundër Rifat Çekut në Gjykatën Komunale në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm me numër C. 1268/2010 për vërtetimin e pronësisë, me vlerë prej 60.000 euro, për të njëjtën banesë*".

64. Më 11 mars 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 1268/2010) caktoi afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, në të cilin "*i padituri Rifat Çeku, duke vepruar sipas aktvendimit, të afatit ligjor ka dhënë përgjigje në padi, i cili sot e kësaj dite është në pritje të vendimit të gjykatës që ta hedhë si të palejuar dhe të pa bazë ligjore padinë e parashtrueses*".

65. Më tej, pala përgjegjëse pyet "*si mundet të ushtroj një kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë kur ka padi ende të pa zgjidhur në gjykatë të rregullt respektivisht ka procedurë në zhvillim e sipër*".

66. Si dëshmi të pretendimeve të lartpërmendura, pala përgjegjëse ka dorëzuar në Gjykatë Aktvendimin (C. nr. 1268/2010, të 11 marsit 2015) të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

67. Pala përgjegjëse gjithashtu dorëzoi në Gjykatë vendimin e KÇPB-së, të 21 gushtit 2003, me të cilën KÇPB-ja e informoi Gjykatën Themelore në këtë që vijon:

> *"Ne me respekt kërkojmë vëmendjen tuaj për paragrafin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut/1999/23 dhe paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut/2000/60, të cilët Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore i japin juridiksion ekskluziv mbi problemet e veçanta të pronësisë, sidomos mbi pronat që janë objekt të një padie të ngritur sipas rregullave në Drejtori. Pronësia në këtë fazë është subjekt i dy padive nën numrat DS003476 dhe DS008675 të cilat janë në pritje në Drejtorinë për çështje banesore dhe pronësore.*
> *Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore ka autoritet ekskluziv mbi këto raste, prandaj ju si dhe Gjykata juaj nuk keni juridiksion mbi këto çështje. Prandaj, ne prapë do të ju përkujtojmë se nëse e kryeni dëbimin, ju do të shkelni ligjin dhe rregulloret e UNMIK-ut. Prandaj ju sugjerojmë që t'i ndërpreni të gjitha procedurat e mëtutjeshme gjyqësore dhe administrative deri në zgjidhjen e këtyre kërkesave nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore.*
> *Për më tepër, duket se urdhri juaj është i bazuar në një rast gjyqësor, i cili është i përfshirë në tentim të shitblerjes së pronës që është përcaktuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë më 13.12.2001. Dua të jua tërheq vëmendjen tuaj në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, paragrafi 5.2, i cili thekson se një shitblerje e tillë është e pavlefshme dhe nuk ka fuqi ligjore, dhe të ju rikujtoj cila gjykatë u përpoq për të konfirmuar një kontratë të tillë, e cila është përfshirë në mosrespektimin e ligjit"*.

Pranueshmëria e kërkesës

68. Gjykata në fillim dhe sipas një vlerësimi paraprak, rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se janë kryer dy procedura të ndryshme për të njëjtën çështje juridike: një para gjykatave të rregullta dhe një tjetër para KÇPB-së dhe Kolegjit të Apelit dhe se nga kjo situatë dolën *"dy vendime të ndryshme përfundimtare dhe të detyrueshme për të njëjtin objekt të çështjes"*.

69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut për Themelimin e KÇPB-së nr. 1999/23, i cili përcakton:

> *"Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Komisioni ka kompetencë ekskluzive për të zgjidhur kategoritë e kërkesave të theksuara në paragrafin 1.2. të kësaj Rregulloreje. Megjithatë, Komisioni mund t'u drejtojë pjesë të veçanta të këtyre kërkesave gjykatave lokale apo ndonjë organi tjetër administrativ, nëse vlerësimi i pjesëve të veçanta të këtyre ankesave nuk kanë të bëjnë me çështjet e parapara në nenin 1.2. Gjatë hetimit ose zgjidhjes së një kërkese, Komisioni mund të marrë masa të përkohshme mbrojtëse"*.

70. Gjykata rikujton se neni 1.2 i Rregullores përfshin: "*Kërkesat e personave fizikë, pronësia,* posedimi *ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore (...)"; Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore (...); dhe Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore (...)"*.

71. Gjykata më tej rikujton se kjo Rregullore hyri në fuqi më 15 nëntor 1999.

72. Për më tepër, Gjykata vëren se rasti i parashtrueses së kërkesës, në të vërtetë, ngre çështje lidhur me përcaktimin juridiksioni i kujt (gjykata të rregullta, ose KÇPB-ja dhe Kolegji i Apelit) është materialisht kompetent, cili prej dy vendimeve të ndryshme është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe çfarë është vlefshmëria dhe plotfuqishmëria e një aktgjykimi të nxjerrë nga një gjykatë pa kompetencë ekskluzive.

73. Megjithatë, Gjykata konsideron se këto çështje janë çështje të ligjshmërisë, që bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta dhe jo nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

74. Në të vërtetë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me vërtetimin e fakteve, ose interpretimin apo aplikimin e ligjit, siç gjykohet apo vendoset nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

75. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" përkitazi me çështjet e lartcekura (shih *rastin Akdivar kundër. Turqisë,* nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65, dhe, po ashtu shih rastin *mutatis mutandis*, rasti KI86/11, të parashtruesit *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).

76. Prandaj, Gjykata kufizohet në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës për shkeljet e pretenduara kushtetuese, siç referohen nga parashtruesja e kërkesës.

77. Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

78. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

79. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

80. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh paragrafët (1) d) dhe (2) d) të rregullit 36 të Rregullores së punës [Kriteri i Pranueshmërisë], i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

81. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses së kërkesës mund të përmblidhen si në vijim:

(i) Shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe neneve të tjera të Kushtetutës;
(ii) Shkeljet e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet tjera; dhe
(iii) Shkeljet e nenit 7 dhe nenit 102. të Kushtetutës në lidhje me nenet tjera.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

82. Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

83. Gjykata i referohet nenit 6.1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht [...] nga një gjykatë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet".*

84. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 13 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

> *"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".*

A. Parimet e përgjithshme të parimit *res judicata*

85. Gjykata përsërit se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës e interpretuar në dritën e parimit të sigurisë juridike, përfshin kërkesën që në rastet kur gjykatat kanë zgjidhur mosmarrëveshjen me një efekt përfundimtar vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim *(*Shih rastet e GJEDNJ: *Brumarescu kundër Rumanisë,* [DHM], nr. 28342/95, 1999-VII, § 61 dhe *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 47797/99 dhe 68698/01, Aktgjykimi i 12 janarit 2006, paragrafi 61).

86. Parimi *res judicata* kërkon që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikim të një vendimi të formës së prerë dhe detyrues vetëm për qëllim të fitimit të një rigjykimi dhe nxjerrjes së një vendimi të ri për çështjen. Çdo shqyrtim nuk duhet të trajtohet si një ankesë e mbuluar, dhe vetëm mundësia e ekzistencës së dy pikëpamjeve mbi këtë çështje nuk është bazë për rishqyrtim (shih rastin e GJEDNJ-së *Esertas kundër Lituanisë,* nr. 50208/06, Aktgjykim i 31 majit 2012 paragrafi 21).

87. Në këtë drejtim, parimi *res judicata* është një element themelor i së drejtës për gjykim të drejtë, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës në çështjet civile (shih rastin GJEDNJ-së *Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, ib idem*, paragrafi 63*)*.

88. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se efektet *res judicata* të vendimeve kanë kufizime *ad personam* (për një person të caktuar) dhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar) (Shih rastin e GJEDNJ-së *Esertas kundër Lituanisë*, *ib idem*, paragrafi 22 më sipër dhe rastin *Kehaya dhe të tjerët*, *ib idem*, paragrafi 66).

B. Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

89. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës i ka filluar procedurat në Gjykatën Komunale duke kërkuar që Rifat Çeku të detyrohet ta lirojë banesën e kontestuar. Rifat Çeku iu përgjigj se banesa ishte në pronësi të Egjlane Gashit dhe të trashëgimtarëve të tjerë ligjorë.

90. Gjykata, gjithashtu, rikujton se parashtruesja arsyeton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. nr. 290/2002, i 30 majit 2002 është *res judicata* dhe se për 13 (trembëdhjetë) vjet nuk është ekzekutuar.

91. Në të vërtetë, parashtruesja e kërkesës pretendon se për të njëjtën çështje ligjore janë mbajtur dy grupe të procedurës; një para gjykatave të rregullta dhe një para KÇPB-së dhe Kolegjit të Apelit. Ajo situatë çoi në atë se *"në rastin para jush keni dy vendime të ndryshme të formës së prerë dhe të detyrueshme për njëjtin objekt çështje ndaj personave të tretë dhe institucioneve".*

92. Prandaj, parashtruesja e kërkesës konsideron se është krijuar pasiguria juridike sepse *"parashtruesja, personat e tretë dhe institucionet kompetente nuk e dinë si të*

veprojnë", dhe në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit "*ishte vendosur në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Supreme dhe vendimin e Gjykatës Komunale".*

93. Prandaj, parashtruesja konkludon se të drejtat e saja të garantuara me nenin 31 të Kushtetuës dhe nenin 6, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së ishin shkelur, siç konsideron ajo se: "*do të ishte iluzore nëse sistemi juridik i Kosovës lejon një vendim final dhe detyrues të gjykatës të mbetet joefektiv*".

94. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se procedurat që janë kryer në gjykatat e rregullta dhe KÇPB-së dhe Kolegjit të Apelit dallohen *ad personam* (ndaj një personi të caktuar) në fushëveprimin material (ndaj një çështjeje të caktuar).

***Ad personam* (ndaj një personi të caktuar)**

95. Në të vërtetë, procedurat e kryera në gjykatat e rregullta, ishin zhvilluar ndërmjet parashtrueses dhe Rifat Çekut si i paditur. Këto procedura kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Supreme.

96. Procedurat e kryera në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit, janë zhvilluar ndërmjet paditëses Saide Kelmendi, motrës dhe një prej *"pasardhësve legjitimë të Egjlane Gashit"* dhe të paditurës Vesela Radović. Parashtruesja Lumturije Voca mori pjesë në këto procedura për shkak të shitjes së banesës së kontestuar nga Vesela Radović. Këto procedura kishin përfunduar me vendimin final të Kolegjit të Apelit.

97. Të gjitha procedurat e mëvonshme që janë kryer në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit janë iniciuar nga parashtruesja e kërkesës Lumturije Voca, me qëllim të rihapjes së çështjes. Të gjitha kërkesat e mëvonshme ishin refuzuar për shkak se ose ishin shqyrtuar nga KÇPB-ja si *res judicata* ose ishin të paafatshme (Shih vendimin nr. KKPK/REC/61/2006, të 31 marsit 2006; Vendimi nr. KPCC/D/R/215/2013, të 21 gushtit 2013; dhe Aktgjykimi GSK-KPA-A-041/14, të 2 dhjetorit 2015).

98. Gjykata konkludon nga sa u tha më lart se procedurat në gjykatat e rregullta, dhe procedurat në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit dallohen *ad personam* (ndaj një personi të caktuar) dhe pastaj efektet *res judicata* të këtyre aktgjykimeve kanë kufizime *ad personam* (ndaj një personi të caktuar).

99. Ai dallim *ad personam* ishte vërejtur edhe nga Kolegji i Apelit (Aktgjykimi GSK – KPA-A – 041/14), me të cilin u ndryshua sipas detyrës zyrtare vendimi në lidhje me palët në procedurë dhe ka përfshirë si palë më tej Rifat Çekun edhe të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjorë të Egjlane Gashit *"përkatësisht: Saide Kelmendi, Bashkim Mulliqi, Safinaz Rudi dhe Tabe Ives".* Si duket Kolegji i Apelit veproi në këtë mënyrë për të parandaluar hapjen procedurave të reja me palë të ndryshme.

Fushëveprimi material (çështja e caktuar)

100. Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesja e kërkesës pretendoi se janë mbajtur dy procedura të ndryshme për të njëjtën çështje ligjore dhe se nga kjo situatë dolën "*dy vendime të ndryshme përfundimtare dhe të detyrueshme për të njëjtin objekt të çështjes".*

101. Gjykata vëren se procedurat në gjykatat e rregullta dhe procedurat në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit ndryshojnë edhe sipas fushëveprimit material (çështja e caktuar).

102. Gjykata rikujton se parashtruesja ka filluar procedurat në Gjykatën e Komunale, duke kërkuar që Rifat Çeku të detyrohet të lirojë banesën e kontestuar. Rifat Çeku u përgjigj se banesa ishte në pronësi të Egjlane Gashit dhe të trashëgimtarëve të tjerë ligjorë.

103. Në të vërtetë, në procedurat në gjykatat e rregullta parashtruesja Lumturije Voca kishte për qëllim që të ushtrojë "*të drejtën e posedimit*" mbi banesën e kontestuar. Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar që banesa kontestuese të lirohet nga njerëzit dhe gjërat, dhe si e tillë t'i dorëzohet parashtrueses së kërkesës për përdorim të mëtejshëm.

104. Parashtruesja e kërkesës nuk ka kërkuar në procedurën në gjykatat e rregullta vërtetimin e *"të drejtave të pronësisë",* edhe pse parashtruesja e kërkesës ishte në dijeni për procedurat në KÇPB në lidhje me vërtetimin e *"të drejtave të pronësisë"* ndërmjet "*trashëgimtarëve ligjorë të Egjlane Gashit"* konkretisht motrës së saj Saide Kelmendi dhe Vesela Radović.

105. Fushëveprimi material i kontestit në KÇPB ishte e drejta për pronësi mbi banesën e kontestuar, e jo e drejta për posedim të banesës kontestuese. Në këtë drejtim, KÇPB-ja konkludoi që të gjitha përpjekjet e mëtejshme për ta shitur banesën duhet të konsiderohen të pavlefshme, për shkak se ajo ka deklaruar si të vlefshme *"transaksionin e bërë midis Egjlane Gashit dhe bartësit të së drejtës së ndarjes, dt. 8 nëntor 1994". (*Shih *v*endimi i HPCC/D/06/2003/B&C, i 12 dhjetorit 2003).

106. Ndryshimet në fushëveprimin material të kontestit janë vërejtur edhe nga Gjykata Komunale e cila pezulloi procedurën e përmbarimit, për shkak se ishte informuar nga ana e KÇPB-së se kishte një rast tjetër lidhur me të drejtën e pronësisë dhe se KÇPB-ja ka juridiksion ekskluziv në këtë çështje ligjore.

107. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi Gjykatës Supreme Rev. nr. 142/2003, nëse ka prodhuar efekt *res judicata* vetëm në fushëveprimin material të *"së drejtës së posedimit"* dhe se ai Aktgjykim do të kishte humbur efektin *res judicata* me Vendimin (nr. HPCC/REC/61/2006) të KÇPB-së, nëse kishte prodhuar efekt *res judicata* sa i përket "*të drejtave pronësore*".

108. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se neni 1.2 i Rregullores UNMIK/REG/1999/23 për Themelimin e KÇPB-së përfshin kategoritë e kërkesave si në vijim: "*Kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore (...)";Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore (...); dhe Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore (...)".*

109. Gjykata gjithashtu vëren se Rregullorja UNMIK/REG/1999/23 i referohet në mënyrë të posaçme *"pronësisë, posedimit ose të drejtës së banimit"* dhe *"pronarët, poseduesit, ose ata që kanë të drejtën e banimit".* Gjykata vëren që në fillim, se *"këto kategori të kërkesave"* i referoheshin KÇPB-së" si *"juridiksionit ekskluziv"* dhe *"si një përjashtim nga juridiksioni i gjykatave të vendit".*

110. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron, në pajtim me këtë veçim të bërë nga Rregullorja, se e drejta e pronësisë absorbon dhe përfshin të drejtën e posedimit. Pronësia dhe posedimi janë komponentë të ndryshëm të së drejtës pronësore. Një banesë në pronësi të dikujt është pronë e dikujt; banesa në posedim të dikujt nuk do të thotë domosdoshmërisht se banesa është pronë e dikujt.

111. Megjithatë, Gjykata konkludon se nuk janë të sakta pretendimet e parashtrueses së kërkesës kur arsyeton që *"në rastin para jush keni dy vendime të ndryshme të formës së prerë dhe të detyrueshme për të njëjtin objekt çështjeje ndaj personave të tretë dhe*

institucioneve". Procedurat në gjykatat e rregullta dhe procedurat në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit dallojnë *ad personam* (ndaj një personi të caktuar), dhe gjithashtu për fushëveprimin material.

112. Prandaj, Gjykata konsideron se ka dallime *ad personam* (ndaj një personi të veçantë) edhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar) ndërmjet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 142/2003 dhe vendimit (Vendimi nr. HPCC/REC/61/2006) të KÇPB-së, si dhe dallime në aspektin e efekteve *res judicata* të këtyre vendimeve.

113. Andaj, Gjykata gjen se këto vendime nuk janë kontradiktore dhe se nuk janë shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së

114. Gjykata i referohet nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës], i cili përcakton:

"1. E drejta e pronës është e garantuar".
[...]

115. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij". [...]

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën e mbrojtjes së pronës

116. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara nga KEDNJ në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, të cilat janë të aplikueshme edhe për nenin 46 të Kushtetutës dhe konfigurojnë fushën e mbrojtjes të së drejtës pronësore (shiko rastin e GJEDNJ-së *Kopecký kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 35, *Maltizan dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Vendimi për pranueshmërinë e 2 marsit 2005, paragrafi 74)

117. Parimet e përgjithshme janë si në vijim:

a) Privimi nga pronësia apo të një të drejte tjetër *in rem* në parim është një akt i menjëhershëm dhe nuk prodhon një gjendje të përhershme të *"privimit të së drejtës"* (Shih rastin e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimi i 12 korrikut 2001).

b) Neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës (Shih rastin e GJEDNJ-së *Van der Mussele kundër Belgjikës,* Aktgjykimi i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; *Slivenko dhe të tjerët kundër Lituanisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 9 tetorit 2003, paragrafi 121) .

c) Parashtruesja e kërkesës mund të pretendoj shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "*pronën*" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite "*pronë*" mund të jetë "*pasuri ekzistuese*", duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të cilave parashtruesi mund të pretendojë "*pritshmëri legjitime*" që do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës së njëjtë. Në të kundërtën, shpresa në njohje të të drejtave të pronësisë që ishte e pamundur të realizohej në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet si "*pronë*" brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së as një kërkesë

kushtimore që pushon të jetë e vlefshme si rezultat i mospërmbushjes së kritereve (Shih rastin e GJEDNJ-së *Prince Hans-Adam II i Linhgeshtajnit kundër Gjermanisë,* , Aktgjykimi i 12 korrikut 2001, paragrafët 82 – 83; dhe *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, Vendim për pranueshmëri, të 10 korrikut 2002, paragrafi 69,.

d) Nuk mund të thuhet se lind ndonjë "*pritje legjitime*", atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtresat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (Shih rastin e GJEDNJ-së *Kopecký kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50,).

B. Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

118. Gjykata rikujton se parashtruesja pretendon se Aktgjykimi (C. nr. 290/2002 i 30 majit 2002) i Gjykatës Komunale "*i formës së prerë, i detyrueshëm dhe i zbatueshëm" pasi që "përbën pritje legjitime për parashtruesen, me të cilin është konstatuar se e njëjta është pronare legjitime e pronës në fjale".*

119. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk është bërë bartëse e së drejtës pronësore, përkundrazi, ajo nuk e ka fituar as të drejtën e posedimit mbi pronën në fjalë, përkundrazi ajo është përpjekur të realizojë të drejtën e posedimit dhe të fitojë pronësinë, që do të thotë se parashtruesja e kërkesës kishte vetëm "*shpresë për njohjen e të drejtave pronësore, e cila ishte e pamundur të arrihet efektivisht*". Prandaj kjo gjendje e tillë reale *"nuk mund të konsiderohet si "pronë"* në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

120. Gjykata është e vetëdijshme se parashtruesja e kërkesës kishte deri diku pritshmëri për të fituar gëzimin efektiv të së drejtës pronësore bazuar në kontratën të cilën ajo e ka lidhur me Vesela Radović, e cila "*nuk ishte pronari i pronës*". Në të vërtetë, Vesela Radović është përpjekur të dëshmojë se ajo ishte pronare e pronës, në mënyrë që ajo të mund ta transferojë të njëjtën më tutje. Megjithatë, si rregull një marrëdhënie kontraktuale që ishte e pavlefshme që nga fillimi (*void ab inicio***)** nuk mundet assesi të jetë rrjedhimisht e vlefshme dhe të prodhojë *"pritshmëri legjitime".*

121. Gjykata ripërsërit se "*pritshmëria legjitime*" nuk mund të ndodhë "*në qoftë se ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit të brendshëm*". Për më tepër, neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk garantojnë të drejtën për të fituar pronën

122. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së *"nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës".* Parashtruesja e kërkesës ka mundur ta dijë në momentin e nënshkrimit të kontratës për blerjen e banesës që Vesela Radović nuk mundet ta dorëzojë atë në gëzim paqësor. Pasi që Vesela Radović nuk e ka dorëzuar pronësinë e banesës, pretendimi i parashtrueses se i është shkelur *"e drejta për gëzimin paqësor të pronës"* është i pabazuar.

123. Prandaj, Gjykata gjen se vendimet e gjykatave të rregullta dhe vendimet e KPÇB-së dhe Kolegjit të Apelit nuk kanë shkelur nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së .

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 7 dhe të nenit 102 të Kushtetutës

124. Gjykata i referohet nenit 7 të Kushtetutës [Vlerat], i cili përcakton:

"1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut".

125. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 102 të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], i cili përcakton:

"1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit".

126. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se situata e saj është nën pasigurinë juridike dhe konsideron se *"Gjykata Supreme, si dhe Kolegji i Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës të Gjykatës Supreme, si pjesë e Gjykatës Supreme, kanë obligim kushtetues që të mënjanojnë këtë pasiguri juridike të shkaktuar".*

127. Gjykata vëren se neni 7 dhe 102 të Kushtetutës nuk janë të lidhur drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë e Kapitujve II dhe III të Kushtetutës, ku parashihen në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

128. Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat e njeriut nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për *"gëzimin e të drejtave dhe lirive",* që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me *"gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut"* (Shih rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *E.B. kundër Francës [GC],* Aktgjykim i 22 janarit 2008, paragrafi 47; dhe *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë,* Aktgjykim i 7 shtatorit 2013, paragrafi 72,).

129. Prandaj, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtojë këto pretendime për shkak se parashtruesja e kërkesës nuk e ka dëshmuar shkeljen e neneve të Kushtetutës nga kapitujt II dhe III, dhe pa këto shkelje këto dispozita kushtetuese nuk kanë efekt të pavarur.

Kërkesa ende në pritje e dorëzuar në Gjykatën Komunale, më 3 qershor 2010

130. Gjykata vëren se, më 3 qershor 2010, *"parashtruesja e kërkesës (...) kishte parashtruar padi kundër Rifat Çekut (...) që ta konfirmojë pronësinë"* mbi banesën kontestuese.

131. Më 24 mars 2015, Rifat Çeku u përgjigj ndaj padisë, duke propozuar "*që të hidhet poshtë si e pabazuar dhe e papranueshme sepse ky rast është gjykuar një herë, prandaj, në pajtim me nenin 391, paragrafi 1, pika d, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duhet të hidhet poshtë si e papranueshme*".

132. Në pajtim me informatat e dhëna nga Gjykata Themelore *"procedurat janë ende në vazhdim e sipër*" dhe "*rasti në fjalë nuk është në procedurë shqyrtimi*".

133. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se, më 10 maj 2005, Lumturije Voca (parashtruesja e kërkesës) parashtroi në KÇPB kërkesë për rishqyrtimin e vendimeve të veta të 12 dhjetorit 2003. Ajo kërkesë ishte refuzuar më 31 mars 2006 sepse "*vendimet*

përfundimtare të komisionit janë të detyrueshme dhe (...) nuk mund të rishqyrtohen nga asnjë trup tjetër juridik apo administrativ në Kosovë".

134. Gjykata rikujton më tej se, më 27 janar 2010, parashtruesja kërkoi nga KÇPB -ja që ta anulojë vendimin e saj për rishqyrtim dhe të gjitha vendimet e mëparshme. Ajo kërkesë ishte refuzuar më 21 gusht 2013, sepse kërkesa e saj kishte të bënte me një çështje të gjykuar (*res judicata),* duke marrë parasysh që "*se e njëjta kërkesë e saj dhe për të njëjtën banesë, (...) është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë".*

135. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, më 16 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Vendimit të KÇPB, të 21 gushtit 2013. Ajo ankesë ishte refuzuar më 2 dhjetor 2015, sepse "*nuk ishte ushtruar brenda afatit prej 30 ditëve".*

136. Gjykata vëren më tej se të gjitha procedurat e mbajtura në KÇPB dhe në Kolegjin e Apelit pas 12 dhjetorit 2003 (vendimi *res judicata)* ishin iniciuar nga parashtruesja e kërkesës me qëllim të rihapjes së rastit. Të gjitha kërkesat pasuese ishin refuzuar, sepse ose vendimet ishin konsideruar *res judicata* ose ishin të paafatshme.

137. Gjykata vlerëson se kërkesa në pritje në Gjykatën Themelore, që nga 3 qershori 2010, është vetëm edhe një tjetër iniciativë paralele e parashtrueses së kërkesës, për të kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë dhe detyrues thjesht për qëllim të fitimit të një rigjykimi dhe një rivendosje të rastit.

138. Megjithatë, Gjykata më tej konsideron se shqyrtimi, revokimi, rishqyrtimi apo shfuqizimi i vendimit të formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*) do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke bërë rendin juridik plotësisht joefektiv.

139. Prandaj, Gjykata konkludon se iniciativa e procedurës në vazhdim e sipër nuk do të jetë ligjërisht efektive dhe prandaj nuk do ta vlerësojë atë nga aspekti i shterimit të mjeteve juridike.

Konkluzion

140. Si përmbledhje, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare.

141. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka mbështetur dhe dëshmuar se me vendimet e kontestuara i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe me nenin 7 dhe nenin 102 të Kushtetutës.

142. Prandaj, Gjykata më tej konsideron se kërkesa e parashtrueses nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

143. Për këto arsye, kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 1) (d) dhe (2) (d), dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI88/16 Parashtrues i kërkesës Kompania N.T.SH. "ELING" Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN nr. 3/2016, të 14 prillit 2016, i cili i është dorëzuar asaj më 25 maj 2016.

KI88/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016 i publikuar më 26 janar 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa është dorëzuar nga personi juridik, qartazi e pabazuar*

Objekti i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [CN nr. 3/2016] të Gjykatës Supreme të 14 prillit 2016.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata përsëriti se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi si person juridik kishte të drejtë të parashtronte ankesë kushtetuese si individ.

Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura parashtruesi i kërkesës nuk i vërtetoi pretendimet e tyre dhe nuk dëshmoi shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI88/16

Parashtrues

N. T. SH. „ELING“

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN nr. 3/2016, të 14 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga ndërmarrja N. T. SH. „ELING“ (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Prishtina, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Muhamet Shala.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [CN nr. 3/2016] e Gjykatës Supreme, të 14 prillit 2016, i cili i është dorëzuar atij më 25 maj 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin, siç pretendohet, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 28 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 15 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie afariste me një person tjetër juridik (furnizuesin), nga i cili kishte blerë mallra të caktuara.

10. Furnizuesi, për shkak të llogarive të arkëtueshme të papaguara, ngriti kërkesëpadinë kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

11. Më 4 dhjetor 2012, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin [C. nr. 18/2012], me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e paditësit (furnizuesit) dhe obligoi të padituri (parashtruesin e kërkesës) të paguajë borxhin nga kontrata, duke përfshirë edhe interesin vjetor të saktësuar në të njejtin aktgjykim.

12. Në afatin ligjor, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën kundër këtij aktgjykimi, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 2 shtator 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 16/2013], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, thuhet:

> *„Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese në bazë të kontratës për shitblerjen e mallrave dhe se sipas konstatimit dhe vlerësimit edhe të ekspertit të lamisë financiare është vërtetuar se nga kjo bazë e paditura paditësit i ka mbetur borxh shumën prej 13.746,25 €. Me ekspertizë, eksperti në mënyrë tabelore ka gjetur dhe ka vërtetuar numrin e faturave në bazë të së cilës është krijuar borxhi, shumën e tyre, datën e pagesës dhe shumën e tërësishme të borxhit të paguar sipas këtyre faturave dhe pjesa e cila ka mbetur e papaguar. Andaj, edhe sipas mendimit të kësaj gjykate qëndron obligimi i të paditurës që në vështrim të nenit 17 dhe nenit 262 të LMD ta përmbushë detyrimin e saj në tërësi".*

14. Më 16 janar 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke u thirrur në shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

15. Më 27 janar 2016, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Rev. E. nr. 5/2016], me të cilin e hodhi poshtë si të paafatshëm revizionin e parashtruesit të kërkesës.

16. Më 13 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme në Gjykatën Supreme, me pretendimin që vendimi i Gjykatës Supreme për hedhjen poshtë të revizionit ishte i padrejtë sepse, sipas parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e kishte pranuar më 18 dhjetor 2014, dhe jo më 15 dhjetor 2014, siç e kishte marrë për bazë Gjykata Supreme dhe se, rrjedhimisht, kërkesa për revizion në Gjykatën Supreme, e dorëzuar më 16 janar 2015, ishte në kuadër të afatit ligjor 30-ditor. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës konteston autenticitetin e nënshkrimit në fletëkthesën që vërteton datën e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke e kontestuar kështu edhe datën prej të cilës Gjykata Supreme e kishte llogaritur rrjedhjen e afatit ligjor për afatshmërinë e kërkesës për revizion.

17. Më 14 prill 2016, Gjykata Supreme, pasi kishte marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin [CN. nr. 3/2016] me të cilin e refuzoi kërkesën e tij për kthim në gjendjen e mëparshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata anulimin e aktvendimeve të Gjykatës Supreme .... *"sepse konsideroj se me të shkelen të drejtat e njeriut të parapara me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj dhe atë të nenit 6 (1) – E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse ai si i tillë është në kundërshtim edhe me qëndrimet juridike të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së."*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

21. Gjykata thekson se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili përcakton që *"të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara me Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme",* parashtruesi i kërkesës, si person juridik, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke kërkuar të drejtat themelore të cilat vlejnë për individë dhe për persona juridikë (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimi i 27 janarit 2010, kërkesa KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*).

22. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe i cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

23. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(3) "Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesës nëse:*
>
> *[...]*
> *(d) nëse kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(4) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

24. Së pari, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar që të njëjtat i shkelin atij të drejtat e përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

25. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet ankimore për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës ndërlidhen specifikisht vetëm me mënyrën në të cilën Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën e tij për revizion si të paafatshme, e më vonë edhe kërkesën e tij për kthim në gjendjen e mëparshme. Gjykata thekson që këto pretendime të parashtruesit të kërkesës ishin trajtuar detajisht nga Gjykata Supreme.

26. Në Aktvendimin [Rev. E. nr. 5/2016] e 27 janarit 2016, me të cilin e hodhi poshtë si të paafatshëm revizionin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, ndër të tjera, kishte arsyetuar:

> *„Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri ka pranuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë me dt. 15.12.2014, ndërsa, revizionin e ka paraqitur (dorëzuar rekomande nëpërmjet postës - nr. 2151228 – shih shkresat e lëndës), me dt. 16.01.2015, ditë e premte, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh të paraparë me dispozitën e nenit 211.1 të LPK-së, ndërsa, dita e fundit për paraqitjen e revizionit ka qenë data 14.01.2015, ditë e mërkurë.*
>
> *Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se revizioni është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, ndaj, konform dispozitës së nenit 211.1 të LPK, e ka hedhur si të pasafatshëm".*

27. Ndërsa, përkitazi me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme të parashtruesit të kërkesës, në Aktvendimin [CN. nr. 3/2016] e datës 14 prill 2016, Gjykata Supreme kishte dhënë përgjigje të qartë dhe arsyetim të detajuar, si në vijim:

> *„Duke vendosur sipas propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme, Gjykata Supreme e Kosovës, nga shkresat e lëndës, ka vërtetuar se përfaqësuesi i të padituri e ka pranuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë me dt. 15.12.2014, kurse revizionin e ka paraqitur (dorëzuar rekomande nëpërmjet postës - nr. 2151228 – shih shkresat e lëndës, fletkthesën, vulën), me dt. 16.01.2015, ditë e premte, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh të paraparë me dispozitën e nenit 211.1 të LPK-së, ndërsa, dita e fundit për paraqitjen e revizionit ka qenë data 14.01.2015, ditë e mërkurë. D.m.th. me nënshkrimin e tij, në fletkthesë, ka konfirmuar se me dt. 15.12.2014 (që është shënuar edhe me fjalë, me shkrim) e ka pranuar aktgjykimin e shkallës së dytë".*

„Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se në rastin konkret, nuk ka kushte për lejimin e këtij instituti procedural, nuk ekzistojnë arsyet a shkaqet e justifikueshme për lejimin e kthimin në gjendjen e mëparshme, sepse pala përkatëse, përfaqësuesi i saj, nuk ka provuar faktin se ka qenë i penguar nga ndonjë ngjarje e paparaparë dhe e paevitueshme që me kohë t'a ndërmerr veprimin përkatës procedural-paraqitjen e mjetit juridik, revizionit".

28. Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të lëndës konkrete të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme ka dhënë arsyetime të detajuara dhe të qarta për vendosjen e vet, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e hodhi poshtë kërkesat e parashtruesit, si në akvendimin e parë [Rev. E. nr. 5/2016, të 27 janarit 2016], ashtu edhe në të dytin [CN. nr. 3/2016, të 14 prillit 2016].

29. Në vijim, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

30. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesit nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

31. Për më tepër, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

32. Gjykata posaçërisht rikujton faktin se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret, përveç se ai është i pakënaqur me rezultatin e procedurës në të cilën, së pari, është refuzuar kërkesa e tij për revizion dhe, më pas, kërkesa e tij për kthim në gjendjen e mëparshme (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).

33. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta në proces te rregullt) të KEDNJ-së (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

34. Duke pasur parasysh atë që u tha, si dhe praktikën konsistente të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese dhe qëndrimet e cekura në këtë vendim, Gjykata konsideron se

nuk ka asgjë që tregon se pretendimet e parashtruesit në kërkesën në fjalë ngrenë çështjet kushtetuese në të cilat është thirrur.

35. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij këto të drejta.

36. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113(7) të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe më tej siç specifikohet me kriteret e pranueshmërisë, rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 nëntor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KO120/16 Parashtrues Slavko Simic dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

KO120/16 Aktvendim për papranueshmëri i 20 janarit 2017 i publikuar më 1 shkurt 2017

Fjalët kyçe: Rishikimi i legjislacionit, kontrolli abstrakt, qartazi i pabazuar

Objekti i çështjes ishte shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Investimet Strategjike), miratuar nga Kuvendi më 11 tetor 2016. Kërkesa u parashtrua nga 11 deputetë të Kuvendit. Gjykata vuri në dukje se në rastin konkret parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në baza përmbajtjesore dhe procedurale.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Ligji i kontestuar ishte në kundërshtim me nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenin 46 (Mbrojtja e Pronës), nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit), nenin 58 (Përgjegjësitë e Shtetit), nenin 60 (Këshilli Konsultativ për Komunitete), nenin 78 (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve), 81.1 (Legjislacioni me Interes Vital), nenin 123 (Parimet e Përgjithshme) dhe nenin 124 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

Thelbi i ankesës së parashtruesve të kërkesës ishte se ligji i kontestuar ishte i natyrës së ligjeve të interesit vital për komunitetin serb në Kosovë dhe për këtë arsye ishte e nevojshme që të ndiqej procedura e paraparë me nenin 81.1 të Kushtetutës, përkatësisht do të duhej të miratohej nga shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë që mbajnë vende të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk ishin shumicë në Kosovë.

Parashtruesit gjithashtu kërkuan nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe që Ligji për Investimet Strategjike të *"PEZULLOHET" në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese deri sa te nxirret vendimi përfundimtar për kushtetutshmërinë e Ligjit te kontestuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nxjerrjes së tij".*

Gjykata konstatoi se parashtruesit nuk e mbështetën kërkesën e tyre në baza kushtetuese dhe nuk ofruan prova që tregojnë se si dhe pse Ligji i kontestuar për Investimet Strategjike ka shkelur Kushtetutën, qoftë në procedurë qoftë në përmbajtje.

Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesve nuk përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO120/16

Parashtrues

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Slavko Simić, Jelena Bontić, Saša Milosavljević, Milka Vuletić, Jasmina Živković, Slobodan Petrović, Bojan Mitić, Milena Miličević, Srđan Popović, Nenad Rašić dhe Adem Hodža (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar z. Slavko Simić që t'i përfaqësojë në procedurë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Investimet Strategjike), të miratuar nga Kuvendi më 11 tetor 2016.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar për Investimet Strategjike në baza përmbajtjesore dhe procedurale.

5. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar për Investime Strategjike është në kundërshtim me nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenin 46 (Mbrojtja e Pronës), nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) nenin 58 (Përgjegjësitë e Shtetit), nenin 60 (Këshilli Konsultativ për Komunitete), nenin 78 (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve) dhe 81.1 (Legjislacioni me Interes Vital), nenin 123 (Parimet e Përgjithshme) dhe nenin 124 (Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale) të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

6. Thelbi i kërkesës së parashtruesve është se Ligji i kontestuar për Investimet Strategjike është me interes vital për komunitetin serb në Kosovë, dhe për këtë arsye, ishte e nevojshme që të ndiqet procedura e paraparë me nenin 81.1 të Kushtetutës. Si një ligj me interes vital, sipas parashtruesve, Ligji për Investime Strategjike duhej të miratohej nga shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe nga shumica e deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë që mbajnë vende të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

7. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe që Ligji për Investime Strategjike të *"PEZULLOHET në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese deri sa të nxirret vendimi përfundimtar për kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nxjerrjes së tij."*

Baza juridike

8. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, dhe nenet 27, 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

9. Më 18 tetor 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën dhe kopjet e letërnjoftimeve të tyre në Gjykatë.

10. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani (gjyqtare).

11. Më 19 tetor 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.

12. Më 19 tetor 2016, kërkesa iu dërgua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit të Kosovës dhe Kryetarit të Kuvendit me udhëzim që t'u jepet mundësia të gjithë deputetëve të Kuvendit që të paraqesin komente. Kërkesa gjithashtu i është dërguar edhe Sekretariatit të Kuvendit, të cilit i është kërkuar të dorëzojë një kopje të versionit përfundimtar të miratuar të Ligjit për Investimet Strategjike, një kopje të procesverbalit të seancës plenare të Kuvendit, si dhe duke përfshirë dokumentet tjera të vlefshme në lidhje me këtë rast. Të gjitha institucioneve të lartpërmendura u ishte kërkuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 2 nëntor 2016.

13. Më 21 tetor 2016, Zyra e Kryetarit të Kuvendit dorëzoi dokumente shtesë lidhur me kërkesën, duke përfshirë: Vendimin e Qeverisë së 1 dhjetorit 2015, me të cilin u miratua Projektligji për Investime Strategjike; Certifikatën e përputhshmërisë procedurale të Projektligjit për Investime Strategjike të 1 dhjetorit 2015; Letrën e 4 dhjetorit 2015, të Kryetarit të Kuvendit me të cilën ua dërgoi Projektligjin për Investimet Strategjike komisioneve parlamentare përkatëse për shqyrtim; Raportin me rekomandimet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 22 dhjetorit 2015; Vendimin për mbajtjen e seancës plenare të Kuvendit dërguar deputetëve të Kuvendit me rendin e ditës së rekomanduar për 16 shkurt 2016; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur nga 19 shkurti deri më 24 shkurt 2016; Vendimin e Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit për Investime Strategjike, të 19 shkurtit 2016; Raportin me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik

në Projektligjin për Investime Strategjike të 21 prillit 2016; Raportin me rekomandime nga Ministria e Financave të 10 majit 2016; Raportin me rekomandime të Komisionit për Integrimin Evropian të 10 majit 2016; Raportin me rekomandimet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 31 majit 2016; Njoftimin e Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare dhe për rendi i ditës i rekomanduar së 3 qershorit 2016; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 9 qershor 2016; Kërkesën Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për rishikimin e ligjit pas rekomandimeve të 9 qershorit 2016; Raportin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i 21 qershorit 2016; Njoftimin e 4 korrikut 2016 të Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare duke përfshirë rendin e ditës; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur nga 7 korriku deri më 11 korrik 2016; Kërkesën e 13 shtatorit 2016 të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Kryetarit të Kuvendit për përfshirjen e Projektligjit për Investime Strategjike në rend të ditës; Njoftimin e 10 tetorit 2016 të Kryetarit të Kuvendit dërguar deputetëve për mbajtjen e seancës plenare me rendin e ditës së rekomanduar; Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 11 tetor 2016; Vendimin e 11 tetorit 2016 të Kryetarit të Kuvendit për miratimin e Ligjit për Investimet Strategjike; Kopjet e Ligjit për Investimet Strategjike, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

14. Në letrën e 21 tetorit 2016, Kryetari i Kuvendit tregoi që në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 19 shkurt 2016, Kuvendi miratoi Ligjin për Investimet Strategjike në leximin e parë, dhe caktoi komisionet përkatëse për shqyrtimin e Projektligjit dhe t'i dorëzojnë komentet e tyre brenda afatit të paraparë në Rregulloren e punës së Kuvendit.

15. Komisionet e caktuara ishin: (1) Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; dhe komisionet e përhershme: (2) Komisioni për Buxhet dhe Financa; (3) Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim; (4) Komisioni për Mandate, Imunitete, Rregulloren e punës dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe (5) Komisioni për Integrime Evropiane.

16. Më 25 tetor 2016, Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën.

17. Më 2 nëntor 2016, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve dorëzoi argumente plotësuese në mbështetje të kërkesës.

18. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit dhe përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesve një kërkesë për sqarim shtesë të procedurës së Kuvendit në lidhje me miratimin e ligjit.

19. Më 13 dhjetor 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dorëzoi përgjigje.

20. Më 15 dhjetor 2016, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të kërkesës dorëzoi përgjigje.

21. Më 20 janar 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 1 dhjetor 2015, me Vendimin Nr. 01/61, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Investime Strategjike, dhe e përcolli atë në Kuvend për procedurë të mëtutjeshme.

23. Më 4 dhjetor 2015, Kryetari i Kuvendit u dërgoi letër 05/L-079 me Projektligjin për Investime Strategjike deputetëve të Kuvendit dhe Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për të shqyrtuar projektligjin dhe t'ia dorëzojë Kuvendit një raport me rekomandime.

24. Më 21 dhjetor 2015, Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, u dërgoi deputetëve të Kuvendit, rekomandimin për miratimin në parim të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike. Në rekomandimin e Komisionit thuhet:

> *"Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës vlerësoi se ai i plotëson kërkesat e nenit 56 të Rregullores së punës të Kuvendit dhe në të njëjtën kohë ka miratuar këtë të fundit në parim."*

25. Më 16 shkurt 2016, Kryetari i Kuvendit u dërgoi një njoftim deputetëve të Kuvendit për caktimin e seancës plenare të Kuvendit për 19 shkurt 2016, me fillim në orën 10:00. Njoftimi përmban rendin e ditës të rekomanduar; ku pika 13 e rendit të ditës të seancës plenare renditej *"leximi i parë i Ligjit për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës."*

26. Më 19 shkurt 2016, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Investimet Strategjike. Sipas komenteve të dorëzuar më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

> *"Kuvendi i Republikes se Kosoves, ne seancen plenare te mbajtur me 19 shkurt 2016, ka miratuar ne shqyrtim te pare Projektligjin nr. 05/L-079 per Investimet Strategjike ne Republiken e Kosoves dhe ka ngarkuar Komisionin funksional per Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe Industri dhe komisionet e perhershme: Komisionin per Buxhet dhe Financa; Komisionin per te Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe per Kthim; Komisionin per Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikeqyrjen e Agjencise kunder Korrupsionit dhe Komisionin per Integrime Evropiane, qe ne afatin e parapare me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojne Projektligjin per Investimet Strategjike ne Republiken e Kosoves dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime per shqyrtim te dyte ne seance plenare."*

27. Më 21 prill 2016, Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ua dërgoi rekomandimin e tij, me amendamentet e Ligjit për Investimet Strategjike komisioneve të përhershme të Kuvendit. Sipas komenteve të dorëzuar më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

> *"Komisioni funksional per Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe Industri, ne disa mbledhje te mbajtura ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin per Investimet Strategjike ne Republiken e Kosoves, kurse ne mbledhjen e mbajtur me 21 prill 2016, ka proceduar Raportin me amendamente per shqyrtim ne komisionet e perhershme: Komisionin per Buxhet dhe Financa; Komisionin per te Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe per Kthim; Komisionin per Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikeqyrjen e Agjencise kunder Korrupsionit dhe Komisionin per Integrime Evropiane."*

28. Më 10 maj 2016, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ia dërgoi rekomandimet e tij lidhur me projektligjin me amendamente Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

29. Më 10 maj 2016, Komisioni për Integrime Evropiane i dërgoi Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Raportin nr. 49/05 ku theksohet që Projektligji për Investimet Strategjike nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

30. Më 21 maj 2016, Komisioni për Buxhet dhe Financa i dërgoi Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Raportin nr. 05/2029/L-079 dhe konstatoi që projektligji është brenda kostos buxhetore të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

31. Sipas komenteve të dorëzuara më 21 tetor 2016 nga Kryetari i Kuvendit,

"Komisioni per te Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe per Kthim, nuk e ka shqyrtuar Projektligjin per Investimet Strategjike ne Republiken e Kosoves se bashku me amendamentet e Komisionit funksional per Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti dhe lndustri, ne afatin e parapare me nenin 57, paragrafi 8 te Rregullores se Kuvendit."

32. Më 3 qershor 2016, Kryetari i Kuvendit dërgoi një njoftim deputetëve të Kuvendit për caktimin e seancës plenare të Kuvendit më 9 qershor 2016, me fillim në orën 10:00. Njoftimi përmbante rendin e ditës të rekomanduar, ku si pika 9 e rendit të ditës të seancës plenare ishte renditur *"Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës."*

33. Më 9 qershor 2016, Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për Investimet Strategjike, për shkak të dy (2) amendamenteve në nenin 32 të Ligjit, të propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Projektligji i është kthyer Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për një shqyrtim tjetër.

34. Më 13 shtator 2016, Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, i dërgoi Kryesisë së Kuvendit, një propozim që Projektligji Nr. 05/L-79 për Investimet Strategjike të përfshihet në rendin e ditës së sesionit vjeshtor të Kuvendit me një korrigjim teknik të nenit 32 të Ligjit.

35. Më 10 tetor 2016, Kryetari i Kuvendit ua dërgoi njoftimin SP-077 LV me rendin e ditës së propozuar të gjithë deputetëve të Kuvendit që seanca e ardhshme plenare e Kuvendit do të mbahej më 11 tetor 2016 në orën 10:00.

36. Në rendin e ditës së seancës plenare të caktuar për 11 tetor 2016, si pika e 9 (nëntë) është renditur, *"leximi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-79 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës."*

37. Më 11 tetor 2016, me Vendimin nr. 05-V-362, pas leximit të dytë të projektligjit në seancë plenare, Kuvendi miratoi Ligjin për Investime Strategjike në Republika e Kosovës Nr. 05/L-79. Gjatë seancës plenare, kur u miratua Ligji për Investime Strategjike ishin të pranishëm tetëdhjetë e dy (82) deputetë nga të cilët pesëdhjetë e shtatë (57) deputetë votuan për projektligjin, katërmbëdhjetë (14) deputetë votuan kundër, ndërsa njëmbëdhjetë (11) deputetë abstenuan.

38. Qëllimi i Ligjit për Investime Strategjike theksohet në nenin 1 të Ligjit i cili përcakton:

1. *Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve plr realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe*

mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike.

2. Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, parimit të mosdiskriminimit, të transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok.

3. Ky ligj mbështet parimet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për ndihmë shtetërore, dhe ato që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

39. Fushëveprimi i zbatimit të Ligjit për Investime Strategjike theksohet në nenin 2 të Ligjit i cili përcakton që:

"1. Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët si:

1.1. energji me infrastrukturë dhe miniera;
1.2. transport dhe telekomunikacion;
1.3. turizëm;
1.4. industri përpunuese;
1.5. bujqësi dhe industri ushqimore;
1.6. shëndetësi;
1.7. parqe industriale dhe teknologjike;
1.8. administrimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave"

2. Vëllimi minimal i investimit për të fituar statusin e investimit strategjik është si vijon: për nën-paragrafët: 1.1, 1.2 dhe 1.6 së paku tridhjetë (30) milion euro; për nën-paragrafët 1.3 dhe 1.4: së paku njëzet (20) milion euro, për nën-paragrafët: 1.5, 1.7 dhe 1.8 së paku dhjetë (10) milion euro.

3. Prioritetet në përzgjedhjen e projekteve për të fituar statusin e investimit strategjik do t'u jepet projekteve me vëllim më të madh investimesh dhe të cilat gjenerojnë në shumë vende pune.

4. Sipas këtij Ligji statusin e investimit strategjik mund të marrin edhe projektet që realizohen në kuadër të marrëveshjeve ndërshtetërore, projektet që realizohen në bashkëpunim me BE-në dhe ato me institucionet financiare ndërkombëtare.

5. Investimet e propozuara për t'u konsideruar strategjike në kuptim të këtij ligji, duhet t'i përmbushin edhe kriteret si më poshtë:

5.1. Subjekti investues në momentin e aplikimit për marrjen e statusit investime strategjike duhet të paraqesë dëshmi për aftësinë e tij të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve;

5.2. investimet e propozuara duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian;

5.3. investimet e propozuara nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me obligimet e Republikës së Kosovës të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

40. Ligji për Investimet Strategjike ka të bëjë me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore në nenet 18, 22 dhe 23. Këto nene parashohin:

"Neni 18. Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike

1. Disponimi me pasurinë e paluajtshme të Republikës së Kosovës për të realizuar projektet lidhur me investimet strategjike rregullohet me ligjet që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe përdorimin e pronës shtetërore e publike, të drejtat pronësore, ligjin mbi obligacionet dhe ligjet që rregullojnë shfrytëzimin dhe disponimin e pronës së Republikës së Kosovës, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

2. Prona e Republikës së Kosovës duke përfshirë pyjet, tokën pyjore, tokën bujqësore, rrugët publike do të jetë në diskonim të Qeverisë së Kosovës nëpajtim me rregullimin hapësinor dhe urbanistik. Kjo pronë mund të përdoret nga Qeveria për të realizuar projektet me negociata direkte, sipas dispozitave të nenit 4 paragrafëve 1 deri 6 të këtij Ligji.

3. Qeveria parasheh procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës nga paragrafi 2 i këtij nenin dhe mund të angazhojë një ekspert gjyqësor për të caktuar vlerën e pronës së paluajtshme që jepet në shfrytëzim.

4. Në rast se bartja e pronës e përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, bëhet me qëllim të realizimit të projekteve strategjike të cilat kanë element të kontratave të parapara me Ligjin përkatës për Partneritet Publiko Privat, rregullat e prokurimit publik duhet të respektohen.

Neni 22. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të merr vendim me shumicë të thjeshtë votash.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme komunale për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Komunës përkatëse.

Neni 23. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjes publike tek subjekti investues

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve publike, tek subjekti investues për qëllim të zbatimit të ndonjë projekti për investime strategjike.

2. Mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të ndërmarrjeve publike për zhvillimin dhe realizimin e projekteve Investuese Strategjike do të rregullohet me akte nënligjore të cilat do të nxjerrën në përputhje me dispozitat e këtij ligj dhe dispozitat e Ligjit përkatës për Ndërmarrjet Publike."

41. Ligji për Investimet Strategjike i referohet kufizimeve për kohëzgjatjen e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore në nenin 24. Ky nen parasheh:

"Neni 24. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës së Republikës së Kosovës nga ana e subjektit investues

1. Kohëzgjatja e së drejtës për shfrytëzimin e pronës në të cilën janë bërë investimet strategjike përcaktohet me marrëveshjen për investime duke marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar me këtë ligj, por kjo e drejtë nuk zgjatë më shumë se deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

2. Autoriteti publik përgjegjës, ka për detyrë të japë pëlqimin për vazhdimin e së drejtës për shfrytëzimin e pronës dhe për periudhën tjetër me afat kohor të arsyeshëm, nëse në pronën në të cilën janë bërë investimet e kapitalit të huaj apo vendor janë të ndërtuara objekte apo ndërtesa që janë duke u shfrytëzuar në mënyrë aktive për qëllime afariste.

3. Kur revokohet vendimi për dhënien e statusit të investimit strategjik apo kur shkëputet marrëveshja, sipas kritereve të këtij ligji, Komisioni duhet t'ia ndërpresë subjektit investues të drejtën e shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës e cila është dhënë në shfrytëzim për realizimin e investimit strategjik."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), neni 46 (Mbrojtja e Pronës), neni 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) Neni 58 (Përgjegjësitë e Shtetit), neni 60 (Këshilli Konsultativ për Komunitete), neni 78 (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve) dhe 81.1 (Legjislacioni me Interes Vital) neni 123 (Parimet e Përgjithshme) dhe neni 124 (Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale) të Kushtetutës, si dhe të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.

43. Në lidhje me shkeljen e nenit 81.1 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që "*Kur është miratuar Ligji për Investime Strategjike, nuk është respektuar procedura e paraparë me nenin 81, paragrafi 1, të Kushtetutës së Kosovës e cila shprehimisht përcakton se ligjet me interes vital për komunitete duhet të miratohen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë. Ligji për Investimet Strategjike paraqet një ligj i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të parapara me nenin 81, paragrafi 1, pika 2, të Kushtetutës."*

44. Sa i përket shkeljes së nenit 78 të Kushtetutës, parashtruesit pretendojnë se *"kur është miratuar Ligji për Investime Strategjike ka pasur shkelje të procedurës së rregullt për*

miratimin e ligjit, sepse nuk është respektuar procedura e shqyrtimit të domosdoshëm nga ana e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të paraparë me nenin 78 të Kushtetutës, përkatësisht ligji nuk është shqyrtuar nga Këshilli Konsultativ për Komunitete nga neni 60 i Kushtetutës, me të çka janë shkelur të drejtat e komunitetit serb prandaj përfshin përgjegjësinë e Kosovës të paraparë me nenin 58 të Kushtetutës".

45. Sa i përket shkeljes së nenin 60 të Kushtetutës, parashtruesit pretendojnë se *"Në pajtim me nenin 60 të Kushtetutës, Këshilli Konsultativ për Komunitete siguron një mekanizëm për shkëmbimin e rregullt të mendimeve ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë, për këtë arsye, ai u siguron Komuniteteve mundësinë për të komentuar lidhur me nismat legjislative dhe politike të cilat përgatiten nga Qeveria. Duke pasur parasysh se Këshilli Konsultativ për Komunitete është privuar nga mundësia për të komentuar për Projektligjin për Investime Strategjike kur u miratua Ligji për Investime Strategjike, kjo paraqet shkelje të nenit 60 të Kushtetutës".*

46. Përkitazi me shkeljen e nenit 58 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që *"Me nenin 58, paragrafi 1 të Kushtetutës, parashihet që Kosova të sigurojë kushte të përshtatshme që u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Me nenin 58, paragrafi 7, është paraparë që Kosova siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me Kushtetutë. Të gjithë shembujt e sipërpërmendur tregojnë se përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë ishin të privuar nga e drejta e tyre në procesin e vendim marrjes në investimet strategjike, si interes i tyre vital, në këtë mënyrë është shkelur neni 58 i Kushtetutës i cili përshkruan përgjegjësitë e Kosovës".*

47. Sa i përkt shkeljes së nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"neni 46, paragrafi 1, i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës. E drejta e pronës paraqet një të drejtë themelore të njeriut të mbrojtur me nenin 1, Protokolli 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Neni 22 i Kushtetutës parasheh zbatim të drejtpërdrejtë në territorin e Kosovës të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të cilat përfshijnë edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj".*

48. *"Nenet 18, 22, 23 dhe 24 të Ligjit për Investime Strategjike janë në kundërshtim me parimet e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të pronës të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Në fakt, investitorit strategjik i jepet mundësia që të marrë pa ndonjë kompensim pronën e ndërmarrjeve shoqërore që janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Kjo është plotësisht në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në të cilën thuhet se ligji është bërë me qëllim që të sigurojë që çdo person i cili pretendon se ka të drejtën e pronësisë ose të kreditorit apo interes, ndaj një ndërmarrjeje ose prone e cila është objekt i privatizimit ose është nën administrimin e Agjencisë, që në bazë të procedurave përkatëse të dëgjohen në lidhje me pretendimet e tyre dhe nëse ata i dëshmojnë pretendimet e tyre, që tu' mundësohet atyre kompensim adekuat të holla për dëmin e shkaktuar me shkeljen e të drejtave apo të interesave".*

49. Sa i përket shkeljes së nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"neni 22 i Ligjit për Investimet Strategjike parasheh që Qeveria e Republikës së Kosovës mund të aprovojë të drejtën e shfrytëzimit të ndërmarrjes në pronësi shoqërore ose ndonjë prej pasurive së saj, nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, vetëm pasi Kuvendi i Kosovës merr vendim me shumicë të*

thjeshtë të votave për heqjen e ndonjë ndërmarrje në pronësi shoqërore ose pasurinë e saj nga autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me qëllim të zbatimit të një Projekti të Investimeve Strategjike për periudhën prej 40 vjetësh në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Investimet Strategjike.

Me nenet e lartpërmendura çështja e personalitetit juridik të ndërmarrjes shoqërore prona e së cilës është transferuar tek investitori ka mbetur tërësisht e pazgjidhur, përkatësisht çështja e fatit të të punësuarve në ato ndërmarrje në aspekt të vazhdimit ose ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe pretendimet ndaj ndërmarrjes shoqërore e cila është transferuar te një investitor. Me dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit është përcaktuar që të punësuarit në një ndërmarrje shoqërore, prona e së cilës është shitur përmes procesit të privatizimit apo likuidimit, kanë të drejtë në një kompensim prej 20% të çmimit të shitjes të pronës së ndërmarrjeve shoqërore. Duke pasur parasysh se me Ligjin për Investimet Strategjike, nuk do të ketë shitje të pasurisë së një ndërmarrjeje shoqërore; në vend të kësaj ajo është transferuar falas për shfrytëzim tek investitori strategjik, me të cilën pretendimet e të punësuarve mbeten të parregulluara njëjtë si statusi i tyre i punësimit".

50. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se bartjet e propozuara të së drejtës për shfrytëzimin e pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore që gjenden në territorin e komunave shkelin dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit) për kompetencat komunale, siç elaborohet në Kapitullin X [Qeverisjes Lokale dhe Organizimi Territorial] i Kushtetutës.

51. Parashtruesit theksojnë se *"Plani i Ahtisaarit në nenin 3 të Shtojcës III, ofron një sërë të kompetencave të komunave. Përveç kësaj, neni 4 i Shtojcës III përcakton një listë të kompetencave të zgjeruara vetanake të komunave. Këto lista janë përfshirë në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale).*

Në Kapitullin 10. Qeverisja Lokale [të Kushtetutës], në nenin 123, para. 3, thuhet:

> *3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.*
>
> *Me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale janë përcaktuar [kompetencat vetanake dhe të zgjeruara të komunave]".*

52. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit, dhe që të pezullojë shpalljen e Ligjit për Investimet Strategjike, sepse *"... zbatimi i këtij ligji në këtë formë mund të shkaktojë dëme të paripareshme për komunitetin serb në Kosovë".*

Pranueshmëria e kërkesës

53. Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, qëllimi i Gjykatës është që të shqyrtojë nëse procedurat e ndjekura për miratimin e ligjit të kontestuar në Kuvend dhe nëse përmbajtja e ligjit të kontestuar janë në shkelje të Kushtetutës, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.

54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që, kur një ligj apo një akt është në shqyrtim sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, procedura e shqyrtimit do të jetë e natyrës pezulluese, ashtu që ligji do të ndalohet për t'u shpallur deri sa Gjykata të ketë marrë vendimin final për rastin.

55. Në fakt, në pajtim me nenin 43 (2) të Ligjit, në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, "*ligji [...] i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar*", që do të thotë se Ligji i miratuar nuk duhet t'i kthehet Kuvendit por duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet të cilat Gjykata i ka shpallur në Aktgjykimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën. (Shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin nr. KO118/13, *Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-16s për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, paragrafët 36 dhe 37).

56. Në mënyrë që ta gjykojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

57. Fillimisht, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

58. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa ishte parashtruar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5, të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e cfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur"*.

59. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga 11 deputetë të Kuvendit, në pajtim me kriteret e nenit 113.5 të Kushtetutës. Kësisoj, parashtruesit e kanë përmbushur kriterin për t'u njohur si palë e autorizuar.

60. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 42 të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili parasheh që,

> *"Neni 42 Saktësimi i kërkesës*
>
> *1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme::*
>
> *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës;*
>
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
>
> *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti"*.

61. Gjykata konsideron se kriteret e nenit 42, paragrafi 1, nën pikat 1 dhe 2, të Ligjit janë përmbushur sa i përket emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve, specifikimit të ligjit të kontestuar dhe dispozitave relevante të Kushtetutës që kanë të bëjnë me procedurën e ndjekur gjatë votimit dhe miratimit të ligjit në Kuvend.

62. Sa i përket afatit, Gjykata vëren se Ligji për Investimet Strategjike është miratuar më 11 tetor 2016, ndërsa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 18 tetor 2016. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh të përcaktuar me nenin 113.5 të Kushtetutës.

63. Megjithatë, Gjykata duhet të ketë parasysh kriterin që parashihet me nenin 42, paragrafi 1, pikën 3, të Ligjit, përkatësisht deri në çfarë mase parashtruesit kanë paraqitur dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tyre.

64. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, që përcaktojnë se,

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
> *(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

Përkitazi me procedurën e ndjekur

Shkelja e pretenduar e nenit 81.1 të Kushtetutës

65. Pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës është që procedura e miratimit të Ligjit për Investimet Strategjike është dashur të ndjekë procedurën e specifikuar në nenin 81 të Kushtetutës lidhur me Legjislacionin me Interes Vital. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Investime Strategjike hyn në fushëveprimin e nenit 81, paragrafi 1, pika 2, të Kushtetutës.

66. Neni 81, paragrafi 1, pika 2, i Kushtetutës përcakton që,

> *"Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:*
>
> *[...]*
>
> *(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;"*

67. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Investimet Strategjike autorizon bartjen e shfrytëzimit të pronës shtetërore dhe të pronës shoqërore, dhe pjesë e

rëndësishme të pronës së paluajtshme në komunat me shumicë serbe mbahen nga ndërmarrjet shtetërore dhe shoqërore. Bartja e shfrytëzimit të pronave të tilla në komunat me shumicë serbe mund të prekë një numër të madh të banorëve. Kësisoj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës preken në mënyrë disproporcionale nga ndryshimet e parapara me Ligjin për Investimet Strategjike dhe se, rrjedhimisht, ky Ligj është me interes vital për mbijetesën e komunitetit serb në Kosovë.

68. Gjykata vëren se neni 81, paragrafi 1, përcakton një sërë kriteresh specifike për të përcaktuar cilat ligje konsiderohen se hyjnë në kuptimin e termit 'ligje me interes vital'. Për më tepër, Gjykata vëren se pika (2) e këtij neni në mënyrë specifike u referohet ligjeve që zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të përmendur në Kushtetutë. Këto ligje theksohen në Kapitullin III të Kushtetutës [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] (Shih Rastin Nr. KO118/16, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, Aktvendim për papranueshmëri i 19 tetorit 2016 paragrafi 54).

69. Gjykata më tej vëren se fushëveprimi i Ligjit për Investime Strategjike, neni 2 (1), ka të bëjë me përcaktimin e *"Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me Ligj për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës […]."*

70. Përveç kësaj, Gjykata rikujton qëllimin e Ligjit për Investime Strategjike siç theksohet në nenin e parë, përkatësisht që, *"Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike*".

71. Përveç kësaj, Ligji për Investime Strategjike, në nenin 1 (2), përcakton se *"Institucionet dhe autoritetet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij ligji do të respektojnë parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, parimit të mosdiskriminimit, të transparencës, proporcionalitetit dhe respektit reciprok".*

72. Prandaj, Gjykata vëren se objektivi i Ligjit për Investime Strategjike është përmirësimi i zhvillimit ekonomik, punësimi dhe zbatimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së aftësive konkurruese të Kosovës për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme dhe kushteve të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

73. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se përfitimet e propozuara të Ligjit për Investime Strategjike nuk janë të kufizuara në një ose një tjetër komunitet, por janë me interes të përgjithshëm publik dhe synojnë mirëqenien e tërë shoqërisë.

74. Gjykata konsideron që, përveç se përmendin që shumë nga bizneset e prekura në sektorët ekonomikë në shënjestër gjenden në komunat me shumicë serbe dhe punësojnë shumë serbë të Kosovës, parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të demonstrojnë se si dhe përse konkretisht do të dëmtohej komuniteti serb i Kosovës me Ligjit për Investimet Strategjike.

75. Gjykata përsërit se, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, është përgjegjësi e parashtruesve që të dëshmojnë pretendimet e tyre, duke përfshirë nëse një ligj i kontestuar është dashur të konsiderohej si ligj me interes vital brenda kuptimit të nenit 81.1 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, rasti Nr. KO94/16, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 48).*

76. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të dispozitave procedurale që përmban neni 81, paragrafi 1, pika 2, i Kushtetutës.

77. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar, në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e nenit 78 të Kushtetutës

78. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë shkelje të dispozitave procedurale qe përmban neni 78 i Kushtetutës, pasi që mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim nuk është mbajtur në mes të leximit të parë dhe të dytë të Projektligjit për Investimet Strategjike.

79. Neni 78 i Kushtetutës parasheh:

> *"**Neni 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve**]*
>
> *1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.*
>
> *2. Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.*
>
> *3. Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, Komisioni mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit.*
>
> *4. Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësive të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime individuale.*
>
> *5. Një çështje mund t'i referohet komisionit për mendim këshillimor nga Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grupi të përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit".*

80. Gjykata vëren nga komentet e marra nga Kryetari i Kuvendit të 21 tetorit 2016, që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është eemëruar më 19 shkurt 2016 për shqyrtimin e Projektligjit për Investimet Strategjike dhe të japin komentet e tyre brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e punës së Kuvendit.

81. Përveç kësaj, Kryetari i Kuvendit tregoi në komentet e tij se më 25 prill 2016 raporti me amendamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, është proceduar për shqyrtim në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

82. Kryetari i Kuvendit deklaroi më tej se *"Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nuk e ka shqyrtuar Projektligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë , Tregti dhe Industri, brenda afatit të përcaktuar në nenin 57 paragrafi 8 të Rregullores së punës së Kuvendit. (Rregullorja e punës, neni 57, paragrafi 8, "Komisionet e përhershme raportet e veta duhet t'ia paraqesin komisionit funksional, në afat prej dhjetë (10) ditë pune, nga dita e pranimit të amendamenteve nga komisioni funksional - raportues."*

83. Gjykata vëren së më 2 nëntor 2016, Parashtruesit informoi Gjykatën se nuk është mbajtur ndonjë takim i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në mes të leximit të parë dhe leximit të dytë të Ligjit të kontestuar.

84. Më 7 dhjetor, Gjykata kërkoi nga Parashtruesit që të mbështesin më tutje këtë kërkesë. Në të njëjtën ditë, Gjykata ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të paraqes qartësime të mëtutjeshme sa i përket pretendimeve të Parashtrueseve që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk është takuar për të diskutuar Ligjin e kontestuar.

85. Më 12 dhjetor 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka konfirmuar Gjykatës se të gjitha informatat sa i përket mbajtjes së takimit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim janë përfshirë në komentet që janë shpërndarë nga Kryetari i Kuvendit më 21 tetor 2016.

86. Më 14 dhjetor 2016, Parashtruesit i kanë konfirmuar Gjykatës së nuk është mbajtur ndonjë takim i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, dhe kanë potencuar së dështimi për tu takuar mund të konfirmohet nga njëri nga Parashtruesit si Kryesues, dhe disa nga Parashtruesit si anëtarë të Komisionit. Për më tepër, Parashtruesit potencuan që dështimi për të mbajtur takimin mund gjithashtu të konfirmohet nga informatat që janë paraqitur në webfaqen e Kuvendit.

87. Për më tepër, Gjykata vëren nga komentet e 25 tetorit 2016 të dorëzuara nga Kryetari i Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, se që nga data e dorëzimit të Projektligjit për Investimet Strategjike te Komisioni Funksional më 21 dhjetor 2015, një prej parashtruesve ka marrë pjesë në të gjitha seancat e këtij Komisioni.

88. Përveç kësaj, Gjykata vëren nga këto komente që njëri prej parashtruesve të kërkesës kishte propozuar amendamentet e Projektligjit për Investimet Strategjike, dhe se të gjitha këto amendamente të propozuara janë votuar, dhe ose janë miratuar ose refuzuar nga Komisioni në përbërje të plotë.

89. Gjykata vëren se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka pasur kohë të njëjtë në dispozicion për të shqyrtuar Projektligjin për Investimet Strategjike dhe për të përgatitur opinionin e tij për projektligjin si dhe të gjitha komisionet e përhershme.

90. Për më tepër, Gjykata vëren se as Parashtruesit e as Kuvendi nuk kanë potencuar arsyet pse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk është takuar për të vlerësuar Ligjin e kontestuar.

91. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të dispozitave procedurale që përmban neni 78 i Kushtetutës.

92. Prandaj, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e rregullave 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Kuvendit

93. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me zbatimin e rregullave 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Kuvendit në lidhje me shqyrtimin e Projektligjit për Investime Strategjike nga komisione të ndryshme, Gjykata vëren se fushëveprimi i juridiksionit të Gjykatës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës është që të shqyrtojë pajtueshmërinë me rregullat procedurale të përfshira në Kushtetutë, të procedurës së ndjekur në Kuvend, që nuk përfshin shqyrtimin e zbatimit të Rregullores së punës së vetë Kuvendit.

94. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk kanë dëshmuar se si ky pretendim, që ka të bëjë me Rregulloren e punës së Kuvendit, paraqet shkelje kushtetuese, të cilat Gjykata do të kishte kompetencë që t'i shqyrtonte (Shih, *mutatis mutandis*, *rasti Nr. KO94/16, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 53*).

Shkelja e pretenduar e nenit 60 të Kushtetutës

95. Sa i përket pretendimit procedural të parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenin 60 të Kushtetutës, që Projektligji për Investime Strategjike është dashur të dorëzohet në Këshillin Konsultativ për Komunitete për shqyrtim, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 60, paragrafi 3, i Kushtetutës, mandati i Komuniteteve Konsultative është përcaktuar si në vijim:

> *"3. Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:*
> *(1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;*
> *(2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla*
> *dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;*
> *(3) çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin."*

96. Gjykata vëren se mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete ka të bëjë, *inter alia*, me *"mundësinë për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria"*.

97. Sa i përket fazës në të cilën mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete vjen në shprehje, ajo i paraprin procedurës legjislative. Kjo ka të bëjë me fazën e *"nismave legjislative dhe politike"* dhe nuk është pjesë e procedurës për miratimin e një ligji nga Kuvendi, brenda kuptimit të nenit 113.5 të Kushtetutës.

98. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës që Këshilli Konsultativ për Komunitete është dashur të konsultohet nuk hyn në kuadër të nenit

113.5 të Kushtetutës. Një konsultim i tillë nuk është pjesë e procedurës legjislative kushtetuese që çon në miratimin e një ligji nga Kuvendi. Prandaj, Gjykata gjen se ky pretendim duhet të refuzohet si jorelevant.

99. Përkitazi me atë se parashtruesit e kërkesës janë thirrur në përgjegjësitë e Shtetit ndaj komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre sipas nenit 58 të Kushtetutës, në lidhje me miratimin e Ligjit për Investime Strategjike, Gjykata gjen se këto pretendime nuk kanë të bëjnë me miratimin e këtij ligji, as në lidhje me procedurë, dhe as me përmbajtje.

Përkitazi me përmbajtjen

Shkelja e pretenduar e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], në lidhje me nenin 1, Protokollin 1, të KEDNJ-së

100. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërore, sipas autorizimit nga nenet 18, 22 dhe 23 të Ligjit për Investime Strategjike, përbën shpronësim të pronës në shkelje të nenit 46, paragrafi 3, i Kushtetutës. Ky nen parasheh që,

> *"3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet."*

101. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se kjo bartje e shfrytëzimit të ndërmarrjeve është gjithashtu në kundërshtim me nenin 1, Protokolli 1, [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së. Ky nen përcakton që

> *"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
> *Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."*

102. Parashtruesit pretendojnë që Ligji për Investimet Strategjike, duke autorizuar bartjen e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, në mënyrë efektive shpronëson pronat e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore, publike dhe shoqërore, pa kompensim, në shkelje të obligimeve sipas nenit 46 të Kushtetutës.

103. Gjykata rikujton se neni 46 [Mbrojtja e Pronës], paragrafi 3, i Kushtetutës parasheh:

> *"3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet."*

104. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së ku thuhet:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

105. Edhe pse këto dispozita të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së përmbajnë disa elemente, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës kanë të bëjnë vetëm me çështjen e kompensimit për shpronësimin e pretenduar të pronës.

106. Gjykata vëren se nenet e kontestuara 18, 22 dhe 23 të Ligjit për Investimet Strategjike tregojnë se çdo bartje e shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të, ndërmarrjeve shtetërore, publike ose shoqërore do t'i nënshtrohet, ligjeve për shfrytëzim të pronës shtetërore dhe pronës publike, rregullimit hapësinor dhe urban, Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, si dhe rregullimit të mëtejshëm në ligjet plotësuese dhe aktet nënligjore.

107. Gjykata vëren se Ligji për Investimet Strategjike i referohet vetëm "bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme", dhe nuk nënkupton bartjen e pronësisë së plotë. Kjo bartje e së drejtës së shfrytëzimit do t'i nënshtrohet kushteve të tjera të përcaktuara në ligje dhe rregullore të tjera, duke përfshirë në disa raste Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

108. Përveç kësaj, neni 24 i Ligjit për Investimet Strategjike kufizon kohëzgjatjen e çdo bartjeje të së drejtës së shfrytëzimit dhe thekson se bartja e së drejtës së shfrytëzimit mund të ndërpritet në rastet kur statusi i investimeve strategjike revokohet ose kur ndërpritet marrëveshja me investitorin.

109. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se nuk është e mundur që të përcaktohet saktësisht se si do të ndodhin bartjet e propozuara të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore. Për më tepër, nuk është e qartë nga Ligji për Investime Strategjike se nuk do të paguhet asnjë kompensim për të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të ndërmarrjeve shtetërore, publike dhe shoqërore.

110. Kësisoj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të së drejtës së pronës që mbrohet me nenin 46 të Kushtetutës.

111. Prandaj, Gjykata konkludon që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se me Ligjin për Investime Strategjike shkelen dispozitat e nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1, Protokollin 1, të KEDNJ-së, duhet të deklarohet qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

112. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se, për shkak se bartja e shfrytëzimit për një periudhë prej 40 vitesh të pronës të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore përbën një shpronësim të pronës pa kompensim, siç u diskutua më sipër, kjo në mënyrë efektive ndërhyn në të drejtat e punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore për të përfituar nga 20% i vlerës së ndërmarrjes pas privatizimit. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë

se kjo shkel të drejtën e punës së të gjithë punonjësve të ndërmarrjeve të prekura shoqërore, në kundërshtim me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

113. Neni 49 i Kushtetutës përcakton:

> ***"Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]***
>
> *1. E drejta e punës garantohet.*
> *2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".*

114. Gjykata rikujton nenet 14 dhe 15 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (i ndryshuar), të cilët përcaktojnë rregullat themelore në lidhje me kompensimin për shpronësim. Këto nene parashohin që,

> **KREU IV - BARTJA E PRONËS SË PALUAJTSHME PËRFITUESIT**
> **Neni 14. Bartja e Pronës së Paluajtshme Përfituesit; Bartja e kostos**
>
> *"1. Nëse Qeveria ka për qëllim të bëjë shpronësimin e të drejtave sipërfaqësore për t'i lejuar bartësit të një licence ose leje të lëshuar nga KPMM ushtrimin e të drejtat e tij në bazë të licencës ose lejes, Qeveria së pari do të kërkojë nga ky bartës që të nënshkruajë një zotim me shkrim për pagimin e kompensimit për personin(at) e shpronësuar. Qeveria e përmbyll Procesin e Shpronësimit vetëm pas pagimit të kompensimit nga bartësi i licencës ose lejes. Qeveria më pas ia bartë të drejtën për shfrytëzimin e pronës në fjalë bartësit të licencës ose lejes. Fushëveprimi dhe kohëzgjatja e kësaj të drejte të shfrytëzimit duhet të jetë e arsyeshme për t'i lejuar bartësit të licencës ose lejes ushtrimin e të drejtave të tij në bazë të licencës ose lejes së tij."*
>
> **KREU V – KOMPENSIMI**
> **Neni 15. Rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit**
>
> *"1. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni".*

115. Gjykata vëren se edhe Ligji për Investimet Strategjike edhe Ligji për Shpronësimin parashohin kompensim për shpronësimin e pronës së paluajtshme me qëllim të bartjes së të drejtës së shfrytëzimit.

116. Përveç kësaj, Gjykata kujton nenin 3, paragrafi 4, të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Ky nen parasheh që,

> **Neni 3. Dispozitat e përgjithshme**
>
> *"[...]*
> *4. Gjithashtu përcaktohet se Qeveria, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 4 të këtij ligji mund të shpronësojë të drejtat pronësore ose të drejtat tjera të një Komune ose Autoriteti Publik Komunal në pronën e paluajtshme. Në këto raste, shprehimisht përcaktohet se Komuna përkatëse ose Autoriteti Publik Komunal ka të drejtat e njëjta si ato të cilat u janë dhënë Personave privat sipas këtij ligji, duke përfshirë të drejtën për kundërshtimin e ligjshmërisë së shpronësimit dhe/ose shkallës së kompensimit [...]".*

117. Gjykata rikujton se ajo ishte thirrur më parë që të shqyrtojë pajtueshmërinë e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me Kushtetutë, dhe se ajo konstatoi që ky ligj është në përputhje me Kushtetutën (shih Aktgjykimin në rastin Nr. KO04/11 , Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Shpronësim, Nr. 03/L-139).

118. Gjykata vëren se ka konstatuar se mënyra në të cilën Ligji për Investimet Strategjike autorizon bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme nuk do të thotë domosdoshmërish se nuk do të ketë kompensim të nevojshëm për këtë bartje, dhe as se komunat do të privohen nga të drejtat e tyre. Për më tepër, nuk është e mundur që Gjykata të përcaktojë se bartjet e tilla të së drejtës së shfrytëzimit do të ndërhynin në procesin e privatizimit, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës.

119. Lidhur me deklaratën e parashtruesve të kërkesës se e drejta e shfrytëzimit të pronës së ndërmarrjeve shoqërore mund të bartet për një periudhë prej 40 vitesh, Gjykata vëren se neni 24 i Ligjit për Investimet Strategjike autorizon bartjen e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme për një periudhë deri në 99 vjet. Rëndësia e kësaj deklarate në lidhje me periudhën 40 vjeçare nuk është e qartë për Gjykatën, përkundër dy kërkesave dërguar parashtruesve të kërkesës që t'i sqarojnë pretendimet e tyre.

120. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Ligji për Investimet Strategjike nuk parandalon apo nuk ia mohon askujt të drejtën për punë ose ushtrim të profesionit, në kuptim të nenit 49 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendim për papranueshmëri Nr. RK734 / 14 në rastin KI09 / 14 të 24 nëntorit 2014, paragrafi 29).

121. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtës për punë, siç mbrohet me nenin 49 të Kushtetutës.

122. Prandaj, Gjykata konkludon që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se me Ligjin për Investimet Strategjike shkelen dispozitat e nenit 49 të Kushtetutës duhet të deklarohet qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

Shkelja e pretenduar e neneve 123 dhe 124

123. Në fund, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, bartja e autorizuar e së drejtës së shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore që gjenden në territorin e komunave shkel kompetencat ekskluzive të komunave të garantuara me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit), Shtojca III [Decentralizimi], siç zhvillohet në Kapitullin X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial] të Kushtetutës, dhe siç parashihet më tej në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

124. Gjykata rikujton Kapitullin X të Kushtetutës, i cili parasheh:

> ***"Kapitulli X. Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial***
>
> ***Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]***
>
> 1. *E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.*
> 2. *Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.*
> 3. *Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.*

4. *Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.*

Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

125. Gjykata vëren se neni 124 (3) i Kushtetutës parasheh që komunat do të kenë "*kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin*".

126. Megjithatë, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk e rregullon çfarë janë këto kompetenca, ose se si ato duhet të zbatohen apo të sigurohen nga komunat. Kjo është çështje e ligjit.

127. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit nuk kanë dëshmuar pretendimet e tyre për shkelje të kompetencave të komunave, siç garantohen me nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës.

128. Si i tillë, ky pretendim duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar në pajtim me Kushtetutën.

129. Për më tepër. Gjykata rikujton se neni 113.4 i Kushtetutës, parasheh: "*Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt*".

Kërkesa për vendosje të masës së përkohshme

130. Gjykata rikujton se parashtruesit kanë kërkuar që Ligji për Investime Strategjike "*të PEZULLOHET në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese deri sa të nxirret vendimi përfundimtar për kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar*."

131. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 43, paragrafi 2, të Ligjit, i cili parasheh që,

"2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i

tillë mund ti dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar."

132. Gjykata konsideron se që qëllimi i synuar me kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme tashmë është arritur me anë të Ligjit.

133. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme dhe si të tillë, të papranueshme.

Përfundim

134. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë paraqitur prova që tregojnë se si dhe përse me Ligjin e kontestuar për Investime Strategjike është shkelur Kushtetuta, qoftë për shkak të procedurës, qoftë për shkak të përmbajtjes.

135. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve, sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 22, 46, 49, 58, 60, 78, 81.1, 123 dhe 124 të Kushtetutës, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 42 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

136. Rrjedhimisht, Gjykata deklaron se Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës është në pajtueshmëri me Kushtetutën, që do të thotë se ai është kushtetues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenin 27 dhe nenin 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 20 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË SHPALLË që Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës është kushtetues për nga përmbajtja dhe për nga procedura e ndjekur për miratimin e tij nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

III. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme në bazë të nenit 43.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

IV. TË SHPALLË që Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, siç është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VII. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI113/15, Applicant: Ramë Ramaj, Constitutional review of Judgment Rev. no. 80/2014, of the Supreme Court of the Republic of Kosovo, of 14 April 2014

KI113/15, Resolution on Inadmissibility of 6 February 2017, published on 8 February 2017

Keywords*: Individual referral, administrative matter, civil matter, general principles, equality before the law, manifestly ill-founded referral, inadmissible referral*

In this case, the Applicant alleged a violation of his rights guaranteed by Chapter II of the Constitution, in particular the rights guaranteed by Articles 21, 22 and 24 of the Constitution, and Article 224 of the Law on Associated Labor, because the regular courts have erroneously interpreted the provisions of this law referred to.

In the present case, the Court considers that the facts presented by the Applicant do not indicate in any way that the regular courts denied him the rights guaranteed by the Constitution, namely the rights guaranteed by Articles 21, 22 and 24 of the Constitution. As regards the allegations of erroneous application of the substantive law, the Court reiterated its view that such allegations fall outside its jurisdiction. Therefore, the Applicant's Referral, in accordance with Rule 36 (1) (d) and 36 (2) (b) of the Rules of Procedure, was declared as manifestly ill-founded and inadmissible.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI113/15

Parashtrues

Ramë Ramaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 80/2014, të 14 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramë Ramaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev.nr. 80/2014, të 14 prillit 2014 (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar) lidhur me padinë e iniciuar nga ai për konflikt administrativ.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 gusht 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet shkelja e nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 1 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 tetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 13 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme. Ndërsa, po të njëjtën ditë, nga Gjykata Themelore në Ferizaj kërkoi fletekthesën për pranimin e vendimit përfundimtar nga ana e parashtruesit të kërkesës.

9. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Faktet lidhur me procedurën administrative

10. Më 3 janar 2006, parashtruesi nënshkroi kontratë pune me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi), si punëtor i sigurimit pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj.

11. Më 15 nëntor 2006, punëdhënësi e njoftoi parashtruesin për mosvazhdimin e kontratës së punës.

12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi paraqiti ankesë në Komisionin për Ankesa të Kuvendit të Komunës së Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: KAKK Ferizaj).

13. Më 12 janar 2007, KAKK në Ferizaj me Vendimin nr. 07/8638-08 refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

14. Ndaj këtij Vendimi parashtruesi u ankua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHC).

15. Më 30 mars 2007, KPMSHC refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe la në fuqi vendimin e KAKK të Ferizajt.

Faktet lidhur me procedurën gjyqësore

16. Parashtruesi, ndaj Vendimit të KPMSHC, parashtroi padi për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme.

17. Më 18 korrik 2007, Gjykata Supreme hodhi poshtë padinë e parashtruesit dhe lëndën ia dërgoi Gjykatës Komunale të Ferizajt, për të vendosur si gjykatë kompetente.

18. Më 18 shtator 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendimi C. nr. 548/07), hodhi poshtë padinë e parashtruesit për shkak të ushtrimit të saj jashtë afatit ligjor.

19. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktvendimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

20. Më 30 dhjetor 2012, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 4753/12, e shpalli ankesën e parashtruesit si pjesërisht të pranueshme, duke e ndryshuar vendimin e gjykatës së instancës së parë sa i përket aplikimit të ligjit material. Si përfundim, Gjykata e Apelit vendosi që padinë e parashtruesit në tërësi ta hedhë poshtë si të paafatshme.

Faktet lidhur me mjetin juridik të jashtëzakonshëm

21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

22. Më 14 prill 2014, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 80/2014, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion dhe la në fuqi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.

23. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

> *"Në rastin konkret paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur pas afatit të parashikuar me ligjet e lartpërmendura për arsye se padia në gjykatë është paraqitur me datën 22.5.2007, ndërsa aktvendimin përfundimtar e ka pranuar me datë 11.4.2007.*
> *Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 83 të LPTHMPJ, për arsye se ky afat është prekluziv dhe pas skadimit të këtij afati punëtori e humb të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hedhet poshtë si e paafatshme, andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II, respektivisht me nenin 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës.

25. Parashtruesi, mes tjerash, pretendon se gjykata e instancës së parë dhe ajo e instancës së dytë morën vendim në kundërshtim me dispozitat e nenit 224 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, për arsye se të njëjtat gabimisht interpretuan dispozitat e këtij ligji.

26. Parashtruesi kërkon që Gjykata ta deklarojë kërkesën e tij të bazuar dhe t'i anulojë vendimet e të gjitha gjykatave lidhur me rastin e tij, duke përfshirë edhe vendimet administrative.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Së pari, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

29. Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

30. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës. Ai konsideron se këto shkelje kushtetuese burojnë nga refuzimi i shqyrtimit të padisë për konflikt administrativ nga gjykatat e rregullta.

32. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se të gjitha instanca të ndryshme gjyqësore, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, që u morën me rastin e parashtruesit, e hodhën poshtë si të pabazuar padinë e tij për konflikte administrative për shkaqe procedurale, respektivisht për shkak të parashtrimit të padisë në fjalë, pas afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh.

33. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend dispozitat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, pa argumentuar se si janë shkelur ato dispozita konkrete të Kushtetutës në rastin e tij, ashtu siç kërkon neni 48 i Ligjit.

34. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta interpretuan në mënyrë të gabuar dispozitat e ligjit material, respektivisht nenin 224 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar.

35. Përkitazi me këtë, Gjykata thekson se një pretendim i tillë është i natyrës së ligjshmërisë dhe çështjet e ligjshmërisë janë në domenin e gjykatave të rregullta.

36. Gjykata Kushtetuese vëren se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

37. Në juridiksionin e Gjykatës është të vërtetojë nëse, në përgjithësi, procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë korrekte dhe të drejta në tërësi (Shih, ndër të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

38. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë që ai mund të ngre një kërkesë të pranueshme dhe të justifikueshme, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij/saj, të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.

39. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtat e garantuara me nenin 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës.

40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 6 shkurt 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI62/16, Parashtrues: Bekë Lajçi, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1961/2015, të 16 nëntorit 2015

KI62/16, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 29 shtator 2016 dhe publikuar më 10 shkurt 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, kërkesë e parakohshme, mos-shterje e mjeteve juridike*

Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit ishte refuzuar ankesa e parashtruesit si e pabazuar dhe ishte kthyer lënda në rivendosje tek përmbaruesi privat.

Parashtruesi pretendonte se refuzimi i ankesës së tij përbënte shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojta e Pronës] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Përveç anulimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë masë të përkohshme lidhur me rastin e tij si dhe të caktojë seancë dëgjimore.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të papranueshme meqë në këtë rast konkret nuk kishte asnjë vendim përfundimtar të ndonjë organi kompetent i cili do të mund të ishte, në këtë fazë, objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Si rrjedhojë, Gjykata e shpalli kërkesën e parashtruesit si të parakohshme meqë ai nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI62/16

Parashtrues

Bekë Lajçi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1961/2015, të 16 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bekë Lajçi, avokat nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1961/2015, të 16 nëntorit 2015.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit më 30 dhjetor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojta e Pronës], me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt], paragrafi 1, dhe me nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht "*të urdhëron Noterin në Istog dhe cilindo Noter tjetër në R. e Kosovës që të mos përpilojë kurrfarë kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë, mbi qiranë, për ndërrimin apo çfarëdo qoftë veprimi, apo pune tjetër juridike, e që ka të bëj lidhur me patundshmërinë që evidentohet në emër të zonjës SH. J. nga Istogu [...]*".

6. Parashtruesi kërkon po ashtu nga Gjykata që të caktojë dëgjim publik *"për të sqaruar provat dhe faktet e pretenduara [...]"*.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 8 prill 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 14 dhe 15 prill 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informata dhe dokumente shtesë në Gjykatë.

10. Më 15 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

11. Më 25 prill 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi nga një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit si dhe I. J., si palë e interesuar në kërkesën në fjalë.

12. Më 20 maj 2016, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë disa sqarime lidhur me kërkesën e tij, si dhe disa dokumente shtesë.

13. Më 2 qershor 2016, Gjykata e informoi Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Istog, për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi që t'i dorëzohet dosja e plotë lidhur me rastin në fjalë.

14. Me 10 qershor 2016, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Istog, dorëzoi dosjen e kërkuar nga Gjykata.

15. Më 14 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.

16. Më 29 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si anëtar të Kolegjit shqyrtues me gjyqtaren Snezhana Botusharova, e cila, sipas moshës, u caktua kryesuese e Kolegjit shqyrtues.

17. Më 29 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Nga viti 2002 e deri në vitin 2007, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e avokatit, kishte përfaqësuar I. J. në disa procedura para gjykatave të rregullta. Këta të dy kishin lidhur një marrëveshje nëpërmjet së cilës ishin pajtuar për shumën e kompensimit që parashtruesi i kërkesës do të pranonte si kompensim për kryerjen e shërbimeve të avokatisë.

19. Duke qenë që I. J. nuk kishte përmbushur obligimet e tij ndaj parashtruesit të kërkesës, ky i fundit kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Istog, me ç'rast kishte kërkuar që I. J. të detyrohet t'i paguajë parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar të të hollave.

20. Më 2 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Istog (Aktgjykimi C. nr. 51/09) e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi I. J. që t'i paguajë atij një shumë të caktuar të të hollave në emër të kompensimit për shërbimet e avokatisë që i kishte kryer I. J-së.

21. Në një datë të paspecifikuar, I. J. kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.

22. Ndërkohë, I. J. kishte parashtruar edhe një propozim në Gjykatën Komunale në Istog, ku kishte kërkuar që të bëhet ndarja e pasurisë që ai deri në atë kohë e kishte në bashkëpronësi me nënën e tij, SH. J., dhe me vëllain e tij, Z. J.

23. Më 5 prill 2011, duke vepruar sipas propozimit të I. J. për ndarje të pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi, Gjykata Komunale në Istog (Aktvendimi N. nr. 23/010) vendosi që pasuria të ndahet ndërmjet SH. J. dhe Z. J., ashtu që I. J. të mos marrë asnjë pjesë nga ajo bashkëpronësi. SH. J. [nëna e I. J.] ishte shpallur pronare e një lokali afarist [që më vonë do të bëhej objekt i procedurës përmbarimore], ndërsa Z. J., [vëllai i I. J.] kishte fituar disa ngastra të tjera toke. Gjykata kishte vendosur kështu meqë I. J., SH. J. dhe Z. J. ishin pajtuar që me marrëveshje jashtëgjyqësore të bënin ndarjen e pasurisë që kishin në bashkëpronësi. Me vendimin e saj, Gjykata Komunale në Istog vetëm sa kishte konfirmuar marrëveshjen e tyre.

24. Më 5 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi Ac. nr. 146/2011) refuzoi ankesën e I. J. [shih paragrafin 21], si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 51/09, të 2 shkurtit 2011) e Gjykatës Komunale në Istog.

25. Duke qenë se aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Komunale në Istog u bë i plotfuqishëm si dhe pasi që I. J. nuk e përmbushi obligimin e tij në mënyrë vullnetare, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të kreditorit, kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Komunale në Istog për inicimin e procedurës përmbarimore kundër I. J., në cilësi të debitorit.

26. Më 18 maj 2012, Gjykata Komunale në Istog (Aktvendimi E. nr. 150/012) kishte caktuar përmbarimin në favor të parashtruesit të kërkesës.

27. I. J. kishte parashtruar prapësim kundër aktvendimit të lartpërmendur dhe kishte kërkuar që i njëjti të anulohet dhe propozimi i parashtruesit të kërkesës për përmbarim të refuzohet.

28. Më 16 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Istog (Aktvendimi E. nr. 150/012) kishte refuzuar prapësimin e I. J. dhe kishte konfirmuar përmbarimin, si të ligjshëm dhe të lejueshëm.

29. Më 2 tetor 2013, tashmë Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Istog (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktvendimit E. nr. 150/12 konstatoi se *"procedura e përmbarimit ka arritur në fazën e përgatitjes së ankandit publik"* dhe se *"gjykata është e obliguar të përcaktojë vlerën shitëse të tregut të paluajtshmërisë"*. Nëpërmjet këtij aktvendimi dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të caktuar për qëllim të konstatimit të çmimit të tregut, Gjykata Themelore në Istog caktoi një çmim

të caktuar për lokalin afarist të përmendur më sipër, i cili u vlerësua si objekt i përmbarimit në këtë lëndë.

30. Kundër këtij aktvendimi, I. J. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. I. J. kontestoi, me këtë rast, propozimin për përmbarim të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se Gjykata Themelore në Istog ka lejuar përmbarimin *"në pronën e cila nuk është e tij"*.

31. Më 4 prill 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 3432/2013) pranoi ankesën e I. J. si të bazuar, prishi Aktvendimin e Gjykatës Themelore (E. nr. 150/12, të 2 tetorit 2013) dhe vendosi që kësaj të fundit t'ia kthejë lëndën në rishqyrtim. Gjykata e Apelit konstatoi: a) Çmimi i tregut të objektit të përmbarimit është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore; b) Gjykata Themelore kishte vendosur me Aktvendim ndërsa do të duhej të kishte vendosur me konkluzion; dhe, c) Gjykata Themelore nuk ka marrë fare parasysh vërejtjet e I. J. Vlen të theksohet se Gjykata e Apelit nuk u deklarua lidhur me atë se a është lejuar përmbarimi mbi pronën e I. J. apo mbi pronën që nuk ishte në emër të tij.

32. Paralelisht me këto procedura që ishin duke u zhvilluar para gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës kishte bartur lëndën e tij të përmbarimit kundër I. J. te një përmbarues privat i emëruar për territorin e Gjakovës.

33. Më 18 gusht 2014, SH.J. kishte parashtruar prapësim pranë Gjykatës Themelore, duke pretenduar se është pronare e lokalit afarist që ishte caktuar si objekt përmbarimi. Në prapësimin e saj, SH. J. theksoi që *"ky lokal nuk mund të jetë objekt përmbarimi"* meqë është pronë e saj dhe jo e birit të saj, I. J.

34. Më 9 shtator 2014, Gjykata Themelore (Konkluzioni P. nr. 1/2014) udhëzoi në kontest të rregullt civil personin e tretë, SH. J. me arsyen se kjo e fundit dhe parashtruesi i kërkesës kanë pretendime të ndryshme lidhur me pronësinë e lokalit afarist dhe si e tillë, çështja duhet të rregullohet nëpërmjet një kontesti të ri civil. Sipas shkresave të lëndës, kontesti civil i udhëzuar nga Gjykata Themelore akoma nuk ka përfunduar.

35. Më 16 shtator 2014, përmbaruesi privat, pavarësisht konkluzionit të sipërpërmendur, organizoi një ankand publik për shitjen e paluajtshmërisë [lokalit afarist] që ai e cilësonte si pronë të I. J. Pas përfundimit të ankandit publik, fitues u shpall parashtruesi i kërkesës, i cili krahas një personi tjetër ishte paraqitur si ofertues. Nëpërmjet procedurave të zhvilluara nga përmbaruesi privat, parashtruesi i kërkesës u shpall blerës i lokalit afarist në fjalë. Me këtë rast, parashtruesi i kërkesës u urdhërua që të deponojë diferencën e mjeteve te I. J., pasi që kishte marrë pjesën që I. J. i kishte borxh për shërbimet e avokatisë.

36. Më 26 shtator 2014, përmbaruesi privat (Urdhri P. nr. 33/14) caktoi zbatimin e përmbarimit kundër debitorit I. J. Si objekt i përmbarimit ishte përcaktuar lokali afarist i cili ishte bartur në pronësi të SH. J. në vitin 2011.

37. I. J. parashtroi prapësim kundër Urdhrit të lartpërmendur para Gjykatës Themelore.

38. Më 6 nëntor 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi P. nr. 3/014) pranoi prapësimin e I. J. dhe anuloi Urdhrin e lartcekur të përmbaruesit privat me arsyetimin:

"[...] Gjykata e ka vlerësuar urdhrin e atakuar në kuptim të thënieve në ankesë-prapësim dhe gjënë që ankesa-prapësimi është i bazuar, i cili si i tillë pranohet. Këtë mbështetur në faktin se, fillimisht, siç konstatohet nga gjendja në shkresat e lëndës në kuptim të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, si Gjykatë e Shkallës së Dytë, AC. nr. 3432/013 ka qenë prish Aktvendimi i Gjykatës Themelore – Dega në Istog E.nr.150/012 i dt. 02.10.2013 dhe lënda është kthyer në rishqyrtim, me vërejtje e sygjerime të caktuara si në atë Aktvendim.
Në kuptim të kësaj, siç vërtetohet nga shkresat e lëndës, nuk është përmbush sugjerimi sipas atij Aktvendimi në procedurën e mëtejme përmbarimore ashtu që ka mbete pa u përmbush kushti paraprak i caktimit të çmimit te objektit [...]. Ndërkaq sa i takon çështjes se atakimit të Urdhrit, në kuptimin që lokali, që është objekt përmbarimi, nuk është pronë e debitorit, por e Shahe Jahaj, në këtë kuptim, nga ana e Gjykatës, me Konkluzionin E. nr. 1/2014 të dt. 09.09.2014, Personi i Tretë, ka qenë udhëzuar në kontest të rregullt civil, për realizimin e të të drejtës së pretenduar".

39. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që të lihen në fuqi vendimet e marra nga përmbaruesi privat, nëpërmjet të cilave ai ishte shpallur fitues i ankandit publik për shitjen e lokalit afarist.

40. Më 16 nëntor 2015, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 1961/2015) [vendimi i kontestuar] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar si dhe vendosi që lëndën t'ia kthejë në rivendosje përmbaruesit privat. Më këtë rast, Gjykata e Apelit arsyetoi:

"Në rastin konkret përmbaruesi privat, fillimisht nuk e ka vlerësuar faktin se me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim, cila ishte pronësia e debitorit dhe atë me ndonjë ekstrakt pronësie.

Përmbaruesi privat është fakt se ka vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, por nuk e ka vërtetuar faktin i cili është bazik, për këtë çështje përmbarimore, e ai është se, në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbarim lokali – paluajtshmëria e cila tani është objekt i përmbarimit, në pronësi të kujt ishte nga se në shkresat e lëndës nuk shihet se është vepruar në këtë drejtim. Nga Gjykata e Apelit kërkohet një gjë e tillë, edhe bazuar në përgjigjen në ankesë, të cilën e ka paraqitur vet debitori. Nga se nuk mund të këtë përmbarim, nëse objekti i përmbarimit nuk i takon debitorit, nga se siç shihet objekti i përmbarimit për të qenë i mundshëm për përmbarim, duhet të jetë në ekskluzivisht në pronësi të debitorit. Sipas Gjykatës, sikur ky fakt të ishte vërtetuar fillimisht, situata nuk do të ishte siç është tani dhe të ndodhte gjithë ky prolongim i kësaj procedure [...]. Do të kishte qenë në rregull, sikur prona-lokali që i është shitur kreditorit gjatë procedurës përmbarimore të Përmbaruesi privat, të ishte argumentuar me ekstrakt pronësie se është vërtetë në pronësi të debitorit. Mirëpo, nga shkresat e kësaj lënde, ende nuk është e qartë pronësia e këtij lokali, kështu që nga kjo arsye dhe aktvendimi i atakuar u desh të vërtetohet, sepse edhe ashtu kjo lëndë gjithsesi është dashur t' i kthehet në ri procedim Përmbaruesit privat, i cili paraprakisht duhet të vërtetoi pasurinë e debitorit e pastaj të lejoj shitjen e saj nëse plotësohen kushtet e parapara ligjore. [...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur e drejta për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mbrojtje

të pronës si dhe parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

42. Për sa i takon të drejtës për barazi para ligjit, parashtruesi pretendon se *"cenimi i barazisë në rastin konkret bëhet evident për faktin që Gjykata e Apelit e favorizon dhe e shpërblen debitorin, në kurriz të kreditorit – këtu parashtruesit, duke u injorua ekzistimi i pronës së pakontestueshme të debitorit, dhe duke u shkelur e shpërfillur të drejtat procedurale të arashtruesit [...]"*.

43. Për sa i takon të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ia ka cenuar këtë të drejtë përmes *"arbitraritetit në vendimmarrje, respektivisht paarsyeshmërisë së vendimit"*. Sipas tij, Gjykata e Apelit *"ka vendosur në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, dhe nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë, të pavarur dhe të paanshme"*.

44. Më tutje, lidhur me këtë pretendim, parashtruesi thekson se Gjykata e Apelit me arsyetimin e përdorur në vendimin e saj *"haptazi kërkon nga PP* [Përmbaruesi privat] *që në rastin e rivendosjes [...] ta hedh poshtë propozimin e kreditorit-këtu propozuesit, me arsyetimin se objekti përmbarimor – lokali afarist [...] nuk është pronë e debitorit I. J. porse është pronë e personit të tretë SH.J. (nënës së debitorit)"*. Në këtë mënyrë, ai konsideron se Gjykata e Apelit e ka parashikuar zgjidhjen e rastit, duke mos i lënë opsione për përmbarim përmbaruesit privat.

45. Më tutje, parashtruesi thekson se edhe pse përmbarimi duhet trajtuar me urgjencë, gjykatat e rregullta e kanë prolonguar çështjen dhe e kanë pamundësuar përmbarimin *"duke e kthyer lëndën – pa pikë arsye – në riprocedurë – herë të njëri e herë të tjetri, herë në gjykatën e shkallës së parë, e herë në atë të dytën, për së paku tri herë me radhë deri më tani, e sërish duke e rikthyer te Përmbaruesi privat [...]."* Ai po ashtu thekson se kanë kaluar *"6 vite – pas vendimit res judicata – dhe 5 vite pas vendimit për ekzekutim"* ndërsa *"aktgjykimi ende nuk është zbatuar"*.

46. Për sa i takon të drejtës për mbrojtje të pronës, parashtruesi pretendon se Gjykata e Apelit i ka cenuar këtë të drejtë duke ia pamundësuar atij që të kompensohet për shumën e të hollave që I. J. i ka borxh dhe se ky pamundësim ka rrjedhë si pasojë e *"një vendimi të gabuar se kinse lokali afarist në fjalë nuk është pronë e debitorit"*.

47. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

"I. TA DEKLAROJE Kërkesën [...] e parashtruesit [...] të pranueshme;
II. TË KONSTATOJ se ka pasur shkelje Neni 31 të Kushtetutës [...] lidhur me n.6.1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;
III. TË KONSTATOJ se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [...];
IV. TË KONSTATOJ se ka pasur shkelje të nenit 24 të Kushtetutës [...];
V. TI SHPALLË TË PAVLEFSHME:
1. Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 1961/15, të dt. 16.11.2015 dhe
2. Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë – dega Istog – PPP. nr. 3/014, të dt. 17.04.2015.
VI. Ta lej në FUQI URDHËRIN e Përmbaruesit Privat [...] P. nr. 33/14, të dt. 24.09.2014 [...]
VII. Të URDHEROJ bartjen e të drejtës së pronësisë në librat kadastrale [...] në bazë të URDHERIT të Përmbaruesit Privat [...] në afatin menjëherë pas marrjes së këti aktgjykimi.
VIII. TA URDHEROJE Gjykatën Themelore në Pejë - dega Istog dhe Përmbaruesin Privat që [...] t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata për masat e ndërmarra për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

P. S. Lidhur me kërkesën e parashtruesit për lëshimin e masës së përkohshme [...] të merr këtë VENDIM
I. Gjykata Kushtetuese LEJON Masën e Përkohshme [...] ashtu që:
II. Gjykata URDHERON Noterin në Istog dhe cilindo qoftë Noter tjetër në R. e Kosovës që të mos përpiloj kurrfarë kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë, mbi qiranë, për ndërrimin apo çfarëdo qoftë veprimi [...]".

Pranueshmëria e kërkesës

48. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

50. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 [Kërkesat Individuale] të Ligjit, i cili parasheh:

"[...] 2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

51. Më tutje, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...] (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, [...]".

52. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Aktvendimin (Ac. nr. 1961/2015, të 16 nëntorit 2015) e Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte vërtetuar Aktvendimi (P. nr. 3/014, i 24 shtatorit 2014) i Gjykatës Themelore. Me atë rast, Gjykata e Apelit kishte konfirmuar se Urdhri (P. nr. 33/14, i 24 shatorit 2014) i përmbaruesit privat duhet të rikthehet në rivendosje, duke qenë se akoma nuk është qartësuar çështja e objektit të përmbarimit.

53. Gjykata po ashtu rikujton pretendimet e parashtruesit se vendimi i Gjykatës së Apelit shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 31, 46 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

54. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtruesit janë të drejtuara te vendimi i Gjykatës së Apelit, vendim ky që në vetvete nuk është përfundimtar për sa i përket çështjes së përmbarimit. Ky vendim nuk ia mohon parashtruesit të drejtën për të marrë kompensimin për shërbimet e avokatisë që ia ka kryer I. J., e drejtë kjo e konfirmuar edhe nëpërmjet vendimeve gjyqësore te instancës së parë dhe të dytë [shih paragrafët 21 dhe 25]. Me fjalë të tjera, Gjykata vëren dhe nuk e konteston faktin që parashtruesi veçse e ka fituar të drejtën e tij për kompensim dhe se vendimet lidhur me të drejtën e tij për kompensim janë bërë përfundimtare. Rrjedhimisht, parashtruesi duhet të marrë kompensimin e akorduar.

55. Gjykata vëren se, me vendimin e kontestuar, Gjykata e Apelit vetëm sa ka konfirmuar thëniet e Gjykatës Themelore se çështja e objektit përmbarimor, që do të mund të përdoret për realizimin e kërkesës monetare të parashtruesit, është një çështje ende e kontestueshme dhe rrjedhimisht përmbaruesi privat duhet ta ketë këtë fakt parasysh me rastin e riprocedimit të kësaj çështjeje.

56. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit me rastin e refuzimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Ajo theksoi:

> *"[...] Përmbaruesi privat [...] nuk e ka vlerësuar faktin se me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim, cila ishte pronësia e debitorit dhe atë me ndonjë ekstrakt pronësie. [...] nuk mund të këtë përmbarim, nëse objekti i përmbarimit nuk i takon debitorit [...].*
> *Është fakt se dispozitat e nenit 205 par.1 dhe 2 të LPP e përcaktojnë situatën te Ndryshimi i pronarit të paluajtshmërisë, gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore... Mirëpo, në rastin konkret, procedura përmbarimore ka fillua me dt.18.05.2012, ndërsa SH. J. me Aktvendimin Gjykatës së shkallës së parë në Istog, N. Nr. 23/010 të dt.05.04.2011, i cili është i formës së prerë me dt. 03.05.2011 dhe sipas tij pronar nuk është debitori por personi tjetër, përkatësisht SH.J. dhe se kjo ka ndodhur para se të fillohet procedura përmbarimore, e jo gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore. Kjo situatë duhet të qartësohet nga Përmbaruesi Privat dhe palët e kësaj procedure, në procedimin e sërishëm tek Përmbaruesi Privat."*

57. Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës së Apelit tregon qartazi që procedura për përcaktimin e objektit përmbarimor është çështje kontestuese, e cila akoma nuk është zgjidhur meqë palët në procedurë kanë pretendime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Përmbaruesi privat është udhëzuar se si duhet të veprojë në rishqyrtim të këtij rasti të përmbarimit.

58. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata thekson se nuk është në rolin e saj të ndërhyjë në çështjen e konstatimit të fakteve nga gjykatat e rregullta, meqë ato kanë juridiksion për të vendosur lidhur me konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjeve lidhur me një rast konkret.

59. Gjykata thekson se kjo lloj qasje e saj është në përputhje të plotë me parimin e subsidiaritetit, i cili kërkon nga parashtruesit që para se të drejtohen në Gjykatën Kushtetuese, ata duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në gjykatat e rregullta për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, ose për të korrigjuar ndonjë shkelje eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

60. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri: *Universiteti AABRIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës,* nr. 25803/94, Vendimi i 29 korrikut 1999).

61. Si përmbledhje, Gjykatakonsideron se në këtë rast nuk ka asnjë vendim përfundimtar të organit kompetent që nkëtë fazë mund të jetë subjekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, sepse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për seancë dëgjimore

62. Parashtruesi gjithashtu ka kërkuar që Gjykata të caktojë dëgjim publik *"për të sqaruar provat dhe faktet e pretenduara [...]"*.

63. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 24 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, nuk është e detyruar të mbajë seancë dëgjimore. Ajo mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se e konsideron si të nevojshme për të qartësuar provat. Duke qenë se rasti konkret është i parakohshëm, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme mbajtën e seancës dëgjimore dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit refuzohet.

Kërkesa për masë të përkohshme

64. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme, përkatësisht "*të urdhëron Noterin në Istog dhe cilindo Noter tjetër në R. e Kosovës që të mos përpilojë kurrfarë kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë, mbi qiranë, për ndërrimin apo çfarëdo qoftë veprimi, apo pune tjetër juridike, e që ka të bej lidhur me patundshmërinë që evidentohet në emër të zonjës SH.J. nga Istogu [...]*".

65. Në mënyrë që Gjykata të lejojë masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, ajo duhet të përcaktojë se:

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie (...), nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*
>
> *[...]*
>
> *Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

66. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit si dhe rregullat 36 (1) (b), 55 (4), 56 (2) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, 6 shkurt 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI145/16, Parashtrues të kërkesës Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani, Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016

KI 145/16, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2017, i publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa individuale, trashëgimia, të drejtat pronësore, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesit parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore në lidhje me disa prona të mbetura nga i ndjeri E. B. Gjykata Themelore ne Prishtine (Aktgjykimi C. nr. 1477/2008) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit si e pabazuar. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 263/2016) e refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Kushtetuese, se Gjykata Supreme duke e refuzuar si të pabazuar revizionin e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat para gjykatave të rregullta ishin në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtjen e pronës dhe për barazi para ligjit. Prandaj, Gjykata e deklaroi të papranueshme kërkesën e parashtruesve si qartazi të pabazuar siç parashihet me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI45/16

Parashtrues

Muhamet Nikqi dhe Arbnor Nikqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 222/2015, të 17 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Nikqi dhe Arbnor Nikqi nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (PML. nr. 222/2015, të 17 nëntorit 2015), me të cilin është refuzuar kërkesa e tyre e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë si e pabazuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 3 maj 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 14 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 shkurt 2012, Gjykata Themelore në Pejë (Aktgjykimi P. nr. 833/09) shpalli parashtruesit e kërkesës fajtorë për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje, dhe i dënoi me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

10. Parashtruesit e kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, shkeljes të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesit kanë kërkuar që Gjykata e Qarkut t'i lirojë nga akuza ose ta kthejë rastin për rigjykim.

11. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, përveç parashtruesve të kërkesës, ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë ka paraqitur edhe pala e dëmtuar për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarve t'ua shqiptojë dënimin sipas ligjit.

12. Më 20 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktvendimi AP. br. 63/12) aprovoi ankesën e parashtruesve, e prishi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ktheu për rigjykim. Sa i përket ankesës së palës së dëmtuar, ajo nuk është shqyrtuar, pasi që palës së dëmtuar i është dhënë mundësia që të paraqesë pretendimet e veta në procedurën e rigjykimit.

13. Në arsyetimin, Gjykata e Qarkut në Pejë, *inter alia,* theksoi:

> *"[...] gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur kompetencë për gjykimin e kësaj çështje penale, por kompetencë ka pasur Gjykata e Qarkut, kështu që rezulton se aktgjykimi i sulmuar është i përfshirë me shkeljen e rëndë të cekur më lart të dispozitave të procedurës penale. [...] Meqenëse aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve tjera ankimore të parashtruara me ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve si dhe në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, nga se të njëjtit këto pretendime mund t'i parashtrojnë në rishqyrtimin e çështjes. [...]".*

14. Më 19 dhjetor 2014, Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Pejë [Aktgjykimi P. nr. 206/13] shpalli parashtruesit e kërkesës fajtorë për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje dhe i dënoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

15. Në arsyetimin, Gjykata Themelore në Pejë, *inter alia,* theksoi:

"[...] Me rastin e vendosjes mbi dënimin duke vlerësuar në kuptim të parimit "refarmatio in peius" nga neni 395 të KPPK-së. Gjykata konkludon se parimi nuk është shkelur nga se në rastin konkret kishte ankesë edhe në dëmin e të akuzuarve nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar si dhe për faktin se çështja në fjalë ishte vendosur nga gjykata in kompetente. [...]".

16. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë.

17. Më 16 korrik 2015, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi PARK. nr. 107/2015] refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë.

18. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe aktgjykimit të shkallës së dytë.

19. Më 17 nëntor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 222/2015) refuzoi kërkesën e parashtruesve për mbrojtje të ligjshmërisë. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme, *inter alia*, theksoi:

"[...] Fakti se të dënuarit konsiderojnë se ankesa e paraqitur nga pala e dëmtuar është dashur të hudhet, meqenëse nga përmbajtja shihet se ankesa është paraqitur edhe për bazën sa i përket shkeljeve të ligjit penal, është çështje e cila fare nuk u shqyrtua dhe gjykata e shkallës së dytë ka vendosur sipas detyrës zyrtare të anulojë aktgjykimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Me këtë rast nuk janë shqyrtuar ankesat as të dënuarve dhe as të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, andaj edhe nuk mund të themi se ka pasur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, përkundrazi kemi pasë edhe ankesë në dëm të të akuzuarve.
Kusht themelor i zbatimit të ndalimit të reformatio in peius, është ekzistimi i ankesës ose i një mjeti tjetër juridik vetëm në favor të të akuzuarit, dhe kur përveç ankesës në favor të tij ekziston edhe ankesa në dëm të tij, aktgjykimi mund të ndryshohet në dëm të të akuzuarit, ashtu si edhe është vendosur në rastin konkret. [...]".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të së drejtës për mjet juridik dhe për mbrojtje gjyqësore, të garantuara me Kushtetutë.

21. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me parimin "*refarmatio in peius*".

22. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata:

"Që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë P. nr. 833/09 të merret në konsideratë ashtu që për Muhamet dhe Arbnor Nikqi çështja penale të kthehet në rigjykim, në mënyrë që të akuzuarit të marrin një dënim të favorshëm."

Dispozitat ligjore relevante

KODI Nr. 04/L-123
I PROCEDURËS PENALE

Neni 395
Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi përsa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

25. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

26. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar."*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

27. Siç u përmend më lart, parashtruesit e kërkesës në thelb ankohen se gjykatat e rregullta pretendohet t'ua kenë shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjet juridik dhe të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, të garantuara me Kushtetutë.

28. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar asnjë arsyetim procedural ose material në mbështetje të pretendimeve të tyre. Ata vetëm përmendin nene të Kushtetutës në lidhje me të drejtat e përmendura, pa dhënë shpjegime të mëtejshme rreth asaj se si dhe pse erdhi deri te shkeljet e pretenduara kushtetuese.

29. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se në ankesën e tyre gjykatat e rregullta e ndryshuan vendimin për dënimin në dëm të tyre, përkatësisht, ata thirren në shkelje të parimit *refarmatio in peius*.

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se aktgjykimi i shkallës së parë është prishur nga Gjykata e Qarkut ngase është nxjerrë nga ana e një gjykate jo kompetente. Sa u përket ankesave tjera të të dyja palëve, ato nuk janë shqyrtuar, pasi që të dyja palëve u është dhënë mundësia që të paraqesin pretendimet e tyre në procedurën e rigjykimit.

31. Për më tepër, Gjykata vëren se pas ankesës së parashtruesve të kërkesës dhe kërkesës së tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme refuzuan pretendimet e tyre për shkelje të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale, duke mbështetur në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë përgjigjur në të gjitha pretendimet e parashtruesve në lidhje me shkelje të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale, dhe kanë dhënë arsyetime të qarta dhe konkluzione të sakta në bazë të gjendjes faktike që është vërtetuar në procedurën gjyqësore.

32. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se pretendimet që janë ngritur nga parashtruesit e kërkesës para kësaj Gjykate janë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë.

33. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër të shkallës më të ulët, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

34. Gjykata Kushtetuese më tej përsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65, gjithashtu, *mutatis mutandis,* shih rastin KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012). Fakti i thjeshtë se parashtruesit nuk janë të kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tyre, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesit e kërkesës të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 35394/97, paragrafët 34-35, GJEDNJ, Aktgjykimi i 12 majit 2000).

36. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet arsyetimit të Gjykatës Supreme në përgjigje të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkeljet e Kodit penal dhe Kodit të procedurës penale që thuhet se janë kryer nga Gjykata e Apelit, kur e refuzoi ankesën e tyre si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë. Parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Supreme se *"Duke qenë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar dhe nuk ka pasur ankesë të Prokurorit, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar ka qenë e palejuar, atëherë Gjykata Themelore në Pejë, duke vendosur si gjykatë e shkallës së parë në rigjykim të kësaj çështjeje ka qenë e detyruar të zbatojë parimin reformatio in peius të përcaktuar me nenin 395 të KPPK, sipas të cilit i akuzuari është i mbrojtur, nga çfarëdo veprimi që është më i pafavorshëm në drejtim të cilësimit më të rëndë të veprës penale apo vendimit për dënimin, në rastet kur është ushtruar ankesë vetëm në favor të tij."*

37. Në përgjigje të pretendimeve të tilla, Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

> *"[...] Duke vlerësuar pretendimin se të dënuarit a janë dënuar në kundërshtim me parimin reformatio in peius nga Gjykata themelore në Pejë, kjo Gjykatë gjen se në rastin konkret nuk ka pasur ankesë vetëm në dobi të të dënuarve, por kemi ankesë edhe në dëm të të dënuarëve, meqenëse ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar ka qenë e ushtruar për shkak të vendimit për dënimin, çka edhe lejohet në rastet kur kemi të bëjmë me veprat penale kundër jetës dhe trupit, Fakti se të dënuarit konsiderojnë se ankesa e paraqitur nga pala e dëmtuar është dashur të hudhet, meqenëse nga përmbajtja shihet se ankesa është paraqitur edhe për bazën sa i përket shkeljeve të ligjit penal, është çështje e cila fare nuk u shqyrtua dhe gjykata e shkallës së dytë ka vendosur sipas detyrës zyrtare të anulojë aktgjykimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Me këtë rast nuk janë shqyrtuar ankesat as të dënuarve dhe as të përfaqësuesit të palës së dëmtuar, andaj edhe nuk mund të themi se ka pasur ankese vetëm në dobi të akuzuarit, përkundrazi kemi pasë edhe ankesë në dëm të të akuzuarve."*

38. Prandaj, në këtë rast, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të cilave ata u referohen, dhe ata nuk dëshmojnë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre.

39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI34/16, Parashtrues i kërkesës: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit (nr. prot. 55) të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina“, të 14 janarit 2016

KI34/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 dhjetorit 2016, i publikuar më 20 shkurt 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, palë e paautorizuar*

Në muajin dhjetor 2015, Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“ miratoi Rregulloren për Zgjedhjet në UP. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina“ (në tekstin e mëtejmë: Këshilli Drejtues i UP) kundër miratimit të Rregullores për Zgjedhjet në UP. Në muajin janar 2016, Këshilli Drejtues (me Vendimin nr. prot. 55) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës kërkon *„interpretimin ligjor të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat e Zgjedhjeve të Përgjithshme në UP (nr. 4/541, dt. 24.12.2015), përkatësisht nenit 3 nën nr. rendor 4 Asistent, se a janë konform dhe në bazë të Statutit të UP-së, saktësisht me nenin 171, 178 dhe 241 të Statutit të UP-së në fuqi.“*

Gjykata vërtetoi se, sipas Statutit të UP-së, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit është njësi akademike dhe organizative e Universitetit dhe se Fakulteti nuk është person juridik. Prandaj, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar, pasi që nuk është individ në kuptim të neneve 21 (4) dhe 113 (7) të Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI34/16

Parashtrues

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit (nr. prot. 55) të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të 14 janarit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), që përfaqësohet nga sekretari i fakultetit Gani Ibrahimi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin (nr. prot. 55) e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të 14 janarit 2016, si dhe Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", nr. 4/541, të 24 dhjetorit 2015 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja për Zgjedhjet në UP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend konkretisht, se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 25 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 11 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović kryesues të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili ka dhënë dorëheqje më 9 shtator 2016.

9. Më 12 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 dhjetor 2015, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" miratoi Rregulloren për Zgjedhjet në UP.

11. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Rregullores për Zgjedhjet në UP-së në Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejmë: Këshilli Drejtues).

12. Më 14 janar 2016, Këshilli Drejtues (me Vendimin nr. prot. 55) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Kërkesa e parashtruesit

13. Parashtruesi kërkon *"interpretimin ligjor të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat e Zgjedhjeve të Përgjithshme në UP (nr. 4/541, dt. 24/12/2015), përkatësisht nenit 3 nën nr. rendor 4 Asistent, se a janë konform dhe në bazë të Statutit të UP-së, saktësisht me nenin 171, 178 dhe 241 të Statutit të UP-së në fuqi"*.

14. Parashtruesi më tej kërkon *"që të anulohet zgjedhja e "asistentëve të ri" për anëtar të Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit; dhe të anulohet e drejta e ushtrimit të votës së asistentëve të ri për të zgjedhë Dekan në FEFS."*

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI nr. 04/L-037
PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 17
Statuti i bartësve të arsimit të lartë

1. Funksionimi dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet në statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi. Ky statut mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat e tij dhe me pëlqimin e Ministrisë dhe miratimin nga ana e Kuvendit.

2. Statutet e të gjithë bartësve të tjerë dhe çdo ndryshim në to miratohen vetëm nga Ministria.
3. Statuti i çdo universiteti përmban dispozita që i japin Senatit apo një strukture të barasvlershme përgjegjësi kryesore për këshillim dhe vendimmarrje lidhur me çështje akademike, ku ndër anëtarët e këtij organi janë edhe përfaqësues të zgjedhur të stafit akademik dhe studentë.
4. Statuti i çdo bartësi publik të arsimit të lartë, garanton zhvillimin e konsultimeve për çështje akademike me personelin mësimor dhe me studentët.
5. Statuti i çdo bartësi të arsimit të lartë që merr fonde publike siguron zbatimin e parimeve të mëposhtme nga bartësi:

5.1. mundësi të barabarta për punësim dhe qasje të barabartë në studim e kërkim shkencor pa diskriminim.

5.2. të gjithë personat dhe organet veprojnë në përputhje me standardet më të larta të modestisë, integritetit, të sinqeritetit, të objektivitetit, të llogaridhënies, të transparencës, të ndershmërisë dhe të udhëheqjes. Në kryerjen e detyrave zyrtare, askush nuk mund të veprojë si përfaqësues i asnjë lloj grupi të çfarëdo përshkrimi dhe nuk kërkon apo pranon asnjë lloj mandati. Gjatë tërë kohës të gjithë duhet të veprojnë vetëm në interes të bartësit si i tërë.

*6. Statuti që i paraqitet Ministrisë në bazë të dispozitave të këtij ligji, miratohet nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Refuzimi i Ministrisë për të dhënë pëlqimin në statut apo për të konfirmuar modifikime në të mund të kundërshtohet pranë Gjykatës kompetente***.**

STATUTI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
"Hasan Prishtina"

Neni 14

Njësitë akademike dhe njësitë organizative të Universitetit nuk janë persona juridik. Njësitë akademike dhe organizative të Universitetit kanë ato autorizime që parashihen me këtë Statut. Njësitë akademike dhe njësitë organizative të Universitetit janë programe të veçanta në kuadër të UP-së, gjegjësisht UP-ja është organizatë buxhetore në kuadër të Ligjit për buxhetin e përbërë nga programet-njësitë akademike.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 21 (4) dhe 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 21

"[...]
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

Neni 113

"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

„(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

17. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, që parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar."

18. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk përmend ndonjë shkelje të të drejtave kushtetuese nga autoritetet publike. Ai vetëm kërkon *interpretimin ligjor të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat e Zgjedhjeve të Përgjithshme në UP (nr. 4/541, dt. 24/12/2015), përkatësisht nenit 3*".

19. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë informacion lidhur me inicimin e procedurave pranë gjykatave të rregullta për zgjidhjen e ankesave të tij, apo në lidhje me interpretimin ligjor të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat e Zgjedhjeve të Përgjithshme në UP.

20. Gjykata rikujton se, në pajtim me nenet 21 (4) dhe 113 (7) të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë.

21. Megjithatë, Gjykata vëren se, sipas statutit të UP-së, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit është njësi akademike dhe organizative e Universitetit dhe se Fakulteti nuk është person juridik.

22. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar, pasi që nuk është individ në kuptim të neneve 21 (4) dhe 113 (7) të Kushtetutës.

23. Si përmbledhje, Gjykata konkludon që, në pajtim me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, kërkesa refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenet 113.7, 21.4 të Kushtetutës, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Arta Rama-Hajrizi

KI01/16: Parashtrues: Agim Arifi, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSP-KPA-A-ll0-13, të 20 korrikut 2015

KI01/16, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2016, i publikuar më 20 shkurt 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, mbrojtja e pronës, aktvendim për papranueshmëri, e paafatshme*

Me 26 shkurt 2007, M. D. ka paraqitur kërkese ne AKP - Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), për riposedimin e një prone të paluajtshme - banesë private të përshkruar në detaje si në kërkesë, për të cilën ka pohuar se i ishte uzurpuar nga parashtruesi i kërkesës. Me 5 shtator 2012, KKPK me Vendimin, KPCC/D/R/167/2012, ka refuzuar kërkesën e parashtruar. Me 20 korrik 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin, GSP-KPA-A-110-13, me të cilin ndryshoi Vendimin e KKPK-së, në atë mënyrë që ankesën e M. D. e deklaroi si të bazuar dhe ankuesin e shpalli pronar të banesës kontestuese.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se më Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit ai është privuar nga prona e paluajtshme (banesa), të cilën e kishte fituar në mënyrë të ligjshme në bazë të kontratës valide të lidhur me M. D., në të cilën parashihej se në rast të mos pagesës në afatin e paraparë me kontratë të mallit të blerë nga M. D., në ndërmarrjen e parashtruesit, këtij të fundit do t'i bartej në pronësi banesa e cila më parë ishte pronë e M. D. dhe rrjedhimisht për pasojë parashtruesit i është cenuar e drejta e pronës, e paraparë me nenin 46 te Kushtetutës.

Në rastin konkret, Gjykata thekson se është detyrë e parashtruesve të kërkesave apo përfaqësuesve të tyre, që të veprojnë me 'kujdes të nevojshëm' (due diligence) për tu siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej, me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës (Shih rastin *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [DHM], aplikacionet nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267). Rrjedhimisht, kërkesa deklarohet e papranueshme për shqyrtim për shkak se është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI01/16

Parashtrues

Agim Arifi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSP-KPA-A-110-13, të 20 korrikut 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agim Arifi nga Vitia, të cilin e përfaqëson Sahit Musa, avokat nga Vitia.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), GSP-KPA-A-110-13, të 20 korrikut 2015, i cili parashtruesit i është dorëzuar më 18 dhjetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me pretendimin se është cenuar neni 46, paragrafi 1 dhe 2 [Mbrojtja e pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 dhjetor 2015, parashtruesi nëpërmjet postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues, Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 30 mars 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që Gjykatës t'i dorëzojë dokumentacion shtesë duke përfshirë edhe autorizimin për përfaqësuesin e tij ligjor. Të njëjtën ditë, u njoftua edhe Gjykata Supreme për kërkesën.

8. Më 12 prill 2016, Gjykata pranoi si dokument shtesë autorizimin e kërkuar.

9. Më 3 maj 2016, Gjykata përsëri nga parashtruesi kërkoi dokumentacionin shtesë dhe veçanërisht formularin e plotësuar me të gjitha të dhënat si dhe kopjet e të gjitha vendimeve që lidhen me rastin, duke i caktuar edhe afatin brenda të cilit ky dokumentacion duhet të dorëzohet në Gjykatë. Gjykata nuk mori përgjigjeje nga parashtruesi lidhur me këtë kërkesë.

10. Më 27 maj 2016, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme fletëkthesën lidhur me datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi.

11. Më 20 korrik 2015, Gjykata pranoi fletëkthesën e kërkuar.

12. Më 13 shtator 2016, Kryetarja, me vendim, caktoi gjyqtar raportues për këtë rast gjyqtarin Ivan Čukalović në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.

13. Më 17 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 26 shkurt 2007, M. D. ka paraqitur kërkesë në AKP - Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), për riposedimin e një prone të paluajtshme – banesë private të përshkruar në detaje si në kërkesë, për të cilën ka pohuar se i ishte uzurpuar parashtruesi i kërkesës.

15. Më 5 shtator 2012, KKPK me Vendimin, KPCC/D/R/167/2012, ka refuzuar kërkesën e parashtruar.

16. Më 20 korrik 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin, GSP-KPA-A-110-13, me të cilin ndryshoi Vendimin e KKPK-së, në atë mënyrë që ankesën e M. D. e deklaroi si të bazuar dhe ankuesin e shpalli pronar të banesës kontestuese.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit ai është privuar nga prona e paluajtshme (banesa), të cilën e kishte fituar në mënyrë të ligjshme në bazë të kontratës valide të lidhur me M. D., në të cilën parashihej se në rast të mospagesës në afatin e paraparë me kontratë të mallit të blerë nga M. D., në ndërmarrjen e

parashtruesit, këtij të fundit do t'i bartej në pronësi banesa e cila më parë ishte pronë e M. D. dhe rrjedhimisht për pasojë parashtruesit i është cenuar e drejta e pronës, e paraparë me nenin 46 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".*

21. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullat 27 (3) (4) dhe 36 (1) (c) të Rregullores së punës, që specifikojnë:

> *"27. Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:*
>
> *(…)*
>
> *(3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;*
>
> *(4) Kur periudha shprehet në muaj dhe në ditë, së pari llogariten muajt e plotë e pastaj ditët".*
>
> *"36. 1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> (…)
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

22. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesve më 18 korrik 2015 derisa kërkesa është dorëzuar në postë me 31 dhjetor 2015, e që llogaritet si datë e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, mirëpo gjithsesi është e qartë se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor 4 (katër) mujor.

23. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih, *mutatis mutandis,* rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendim i 25 gushtit

2005 dhe, po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi,* Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

24. Gjykata thekson se është detyrë e parashtruesve të kërkesave apo përfaqësuesve të tyre, që të veprojnë me 'kujdes të nevojshëm' *(due diligence)* për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej, me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës (Shih rastin *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë,* [DHM], aplikacionet nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267).

25. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shqyrtim për shkak se është e paaftshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KO12/17, Parashtruesi i kërkesës: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

KO12/17, Aktgjykim i 9 majit 2017, i publikuar më 30 maj 2017

Fjalët kyçe*: kërkesë institucionale, Avokati i Popullit, kundërvajtjet, e drejta për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur, kërkesë e pranueshme.*

Në këtë rast, Avokati i Popullit në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63 , 64, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje nuk janë në pajtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Dispozitat e mësipërme të Ligjit për Kundërvajtje delegojnë kompetenca të caktuara gjyqësore lidhur me kundërvajtjet tek organet administrative sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Kundërvajtje.

Pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parashikuara më tej me Ligj dhe të parapara me rregullat e procedurës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës, Gjykata arriti në përfundim se kundërvajtjet bien në kuadër të fushës së veprës penale "akuza penale" brenda kuptimit të Kushtetutës. Megjithatë, mundësia e ankesës në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë përmbush kërkesën për qasje në një seancë të drejtë dhe të paanshme për një akuzë penale. Prandaj, Gjykata ka gjetur se dispozitat e kontestuara të ligjit të kontestuar janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO12/17

parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (ligji i kontestuar), i cili hyri në fuqi në janar 2017, gjegjësisht, nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të referuara më lart të ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, duke suspenduar zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të ligjit të kontestuar, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji); si dhe në rregullat 54, 55, 56, 62 dhe 64 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi kërkesën Gjykatës.

7. Më 10 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

8. Më 14 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

9. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me udhëzimin që t'u shpërndajë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Sekretariatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkua që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për rastin, Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, dhe dokumentet relevante lidhur me kërkesën.

10. Nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nga deputetët e Kuvendit, nga Kryeministri, nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe nga Ministria e Drejtësisë u kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 3 mars 2017.

11. Më 15 shkurt 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 30 prill 2017.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 5 gusht 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e kontestuar, me 71 (shtatëdhjetenjë) vota për, 0 (zero) vota kundër dhe 0 (zero) abstenime.

13. Më 23 gusht 2016, ligji i kontestuar u shpall nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

14. Më 8 shtator 2016, ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

15. Siç përcaktohet me nenin 171 të ligjit të kontestuar, "*ky ligji hyn në fuqi në janar 2017*".

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës konteston dispozitat e Ligjit të ri për Kundërvajtje, të cilat "delegojnë kompetenca gjykuese në degën ekzekutive", përkatësisht nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63 , 64, 65, 66, 67 dhe 68, duke pretenduar se të njejtat nuk janë në përputhje me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për Gjykim të Drejtë) të KEDNJ-së.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*personat e akuzuar për kundërvajtje kanë të drejtë për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut",* dhe që në rastet e gjykuara nga ana e *"organeve të kundërvajtjes", "Ligji për Kundërvajtje nuk u jep personave të akuzuar qasje në një tribunal të pavarur",* duke theksuar gjithashtu se *"Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës nuk ka juridiksion të plotë në kontrollimin e vendimeve të "organeve të kundërvajtjes".* Parashtruesi i kërkesës përmbledh pretendimet e veta kundër dispozitave të kontestuara të Ligjit të ri për Kundërvajtje, duke ia ngritur Gjykatës pyetjen si në vijim: "*Ky delegim i kompetencave gjykuese te organet administrative dhe ekzekutive, a paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?*".

18. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike pretendon shkelje kushtetuese, duke argumentuar se: a) "*personat e akuzuar për kundërvajtje kanë të drejtë për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur*"; b) *"Organet e kundërvajtjes nuk përmbushin kriteret e një tribunali të pavarur*", dhe c) "*Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës nuk ka juridiksion të plotë në kontrollimin e vendimeve të "organeve të kundërvajtjes"".*

Në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë para një tribunali të pavarur për personat e akuzuar për kundërvajtje

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje delegon te organet administrative dhe ekzekutive kompetencën për të gjykuar dhe për të vendosur sanksione, në një varg të gjerë të rasteve kundërvajtëse. Vendimet e këtyre organeve i nënshtrohen vetëm një forme të kufizuar të kontrollit gjyqësor".*

20. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se *"ky delegim i kompetencave gjykuese [tek organet e kundërvajtjes] shkel të drejtën për gjykim të drejtë para një tribunali të pavarur, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

21. Më tutje, parashtruesi i kërkesës argumenton se *"një linjë e gjatë e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së tregon se edhe kur kundërvajtjet nuk klasifikohen si "vepra penale" brenda sistemit ligjor kombëtar, ato mund të quhen "vepra penale" në kontekstin e Konventës, nëse penalizimi i kundërvajtjeve u shërben qëllimeve parandaluese dhe ndëshkuese. Ky parim u dëshmua qartë në rastin Öztürk kundër Gjermanisë, Aplikimi Nr. 8544179, GJEDNJ (1984)".*

22. Parashtruesi i kërkesës më tej specifikon se *"duke marrë parasysh këto qëllime shprehimisht parandaluese dhe ndëshkuese në Republikën e Kosovës, vepra të tilla duhet të konsiderohen 'penale' brenda kuptimit të nenit 6, në përputhje me arsyetimin e GJEDNJ-së në Oztürk. Prandaj, personat e akuzuar për kundërvajtje në Republikën e Kosovës, duhet të gëzojnë mbrojtjet e nenit 6, duke përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur".*

23. Parashtruesi i kërkesës në fund argumenton se "*në mënyrë që të quhet 'tribunal i pavarur', një organ duhet të përmbushë disa kritere. Dy kriteret më relevante për vlerësimin e Ligjit për Kundërvajtje janë: (a) që organi të jetë i pavarur prej Ekzekutivit dhe (b) që ai të ketë juridiksionin e plotë. [...] Vetëm një institucion që ka juridiksion të plotë dhe që përmbush një varg kërkesash, si p.sh. pavarësia nga Ekzekutivi..., meriton etiketimin 'tribunal' brenda kuptimit të nenit 6, par. 1".*

Në lidhje me organet e kundërvajtjes

24. Në lidhje me organet e kundërvajtjes, parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se "*Ligji për Kundërvajtje nuk e siguron pavarësinë e organeve të kundërvajtjes në asnjë prej kritereve të identifikuara nga GJEDNJ […] vetë Ligji thekson se organet kundërvajtëse janë organe administrative dhe ekzekutive, të ngarkuara me zbatimin e ligjeve. Organi i kundërvajtjes përkufizohet si 'organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike… të mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje' […] Prandaj, sipas përkufizimit të vetë Ligjit, organet e kundërvajtjes jo vetëm që nuk janë të pavarura nga Ekzekutivi, por janë vetë pjesë e Ekzekutivit*".

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se përbërja e organit për kundërvajtje, siç përcaktohet me ligjin e kontestuar, nuk ofron garancitë e nevojshme për pavarësinë dhe paanshmërinë e anëtarëve të tij.

26. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pohon se organet për kundërvajtje "*nuk mund të konsiderohen të 'pavarura' prej Ekzekutivit brenda kuptimit të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës*".

Përkitazi me shqyrtimin gjyqësor nga Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë

27. Parashtruesi i kërkesës argumenton se "*sipas precedentëve të GJEDNJ-së, mungesa e pavarësisë së një organi administrativ mund të tolerohet, nëse vendimet e atij organi 'i nënshtrohen kontrollit të mëtejshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë'*".

28. Parashtruesi i kërkesës shton se "*koncepti i 'juridiksionit të plotë', siç përdoret nga GJEDNJ-ja, është i rreptë dhe përfshin, në veçanti, 'kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështje ligjore dhe faktike, vendimin e [organit administrativ]' dhe 'është e nevojshme që 'tribunali' në fjalë të ketë juridiksionin për të shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin përpara tij'*".

29. Parashtruesi i kërkesës më tej specifikon që "*Kompetenca e Departamentit për Çështje Administrative për të kontrolluar vendimet e organeve kundërvajtëse është e kufizuar, sidomos në lidhje me çështje faktike. Ligji për Konfliktet Administrative përcakton shprehimisht se, në kontrollimin e vendimit të një organi administrativ, Departamenti 'vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative' - me fjalë të tjera, në bazë të fakteve të vërtetuara nga vetë organi i kundërvajtjes*".

30. Parashtruesi i kërkesës në fund argumenton se "*Ligji për Konfliktet Administrative i jep Departamentit mundësinë për të anuluar vendimet e organeve administrative mbi dy baza faktike të kufizuara: nëse (a) 'nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike' ose (b) faktet 'në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht' (po aty, neni 43, par. 2). Në këtë mënyrë, Departamenti për Çështje Administrative mund t'i hedhë poshtë konkluzionet që organi kundërvajtës i nxori prej këtyre fakteve të vërtetuara, apo të konstatojë që këto fakte nuk janë vërtetuar plotësisht. Mirëpo, ajo që Departamenti nuk mund të bëjë është të shqyrtojë të tjera pretendime faktike apo prova që nuk ishin shqyrtuar më parë gjatë procedurave administrative të vetë organit kundërvajtës. Mbi këtë pikë, shih Ligjin për Kundërvajtje, neni 66, par. 1, nënpar. 3 (në ankesat kundër vendimeve të organeve kundërvajtëse 'nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja'). Prandaj, Departamenti për Çështje Administrative nuk ka mundësinë 'për të*

shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin përpara saj".

Kërkesa për masë të përkohshme

31. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, duke pezulluar zbatimin e dispozitave të kontestuara të ligjit të kontestuar "*deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate*".

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin baza më shumë se prima facie për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara*".

33. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se "*në mungesën e masës së përkohshme, ka një rrezik substancial që, derisa kjo Gjykatë të arrijë vendimin e saj përfundimtar, funksionimi i 'organeve të kundërvajtjes' të imponojë sanksione mbi persona të akuzuar, pa u dhënë këtyre personave qasje në një tribunal të pavarur"*.

34. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*është me interes publik që masa e përkohshme të miratohet. Siç u vërejt në Pjesën I të Argumentit, Ligji për Kundërvajtje është një ligj që zbatohet në mënyrë plotësisht të përgjithshme, duke mbuluar 'sjelljen me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Ligji për Kundërvajtje, neni 2, paragrafi 1)'. Meqenëse Ligji mbulon një rang kaq të gjerë të sjelljeve, të kryera qoftë nga persona fizikë, qoftë nga persona juridikë (shih, po aty, neni 7, par. 4), është me interes publik që kjo Gjykatë të sigurojë, të paktën gjatë periudhës në të cilën vendimi i tij është në pritje, që personat e akuzuar të mos u nënshtrohen procedurave të 'organeve të kundërvajtjes', të cilat janë kushtetutshmërisht të dyshimta"*.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

35. Për të bërë vlerësimin e kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata ekzaminon nëse janë plotësuar kushtet përkatëse të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës që përcakton:

> "(...)
>
> *"2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme."*
>
> (...)"

37. Gjithashtu, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit që përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale."

38. Në fund, Gjykata rikujton rregullin 55, paragrafët 4 dhe 5, të Rregullores së punës, që specifikojnë:

Rregulli 55 (4) i Rregullores së punës

[...]

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmerinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik".

[...]

Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës (fragment)

"[...] Nuk mund të merret vendim për masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. [...]"

39. Gjykata konsideron se pretendimet dhe faktet e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës, ngrehin një sërë pyetje të nivelit kushtetues që përmbajnë kompleksitete të rëndësishme dhe pasoja të mundshme në administrimin e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (a), të Rregullores së punës.

40. Më tej, duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore në një shoqëri demokratike, Gjykata konkludon që zbatimi i Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, i 8 tetorit 2016, që ka hyrë në fuqi në janar 2017, më saktësisht zbatimi i neneve të kontestuara 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68, potencialisht mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për qytetarët e prekur të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar rrezikun për dëme të pariparueshme në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (b), të Rregullores së punës.

41. Përfundimisht, Gjykata konsideron se çështjet e ngritura në kërkesë janë të një rëndësie të tillë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe për administrimin e duhur të sistemit të drejtësisë, sa që adresimi i tyre para zbatimit të dispozitave të kontestuara të ligjit të kontestuar është në interesin publik. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik në kuptim të rregullit 55, paragrafi 4, pika (c), të Rregullores së punës, që justifikojnë miratimin e masës së përkohshme.

42. Prandaj, Gjykata, pa paragjykim ndaj vendimeve të tjera që do të nxirren nga Gjykata lidhur me pranueshmërinë ose meritat e kësaj kërkese në të ardhmen, konkludon se kërkesa për masë të përkohshme duhet të miratohet, në mënyrë që të parandalohen dëme të pariparueshme si dhe të mbrohet interesi publik.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116 (2) të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullave 54 dhe 55 të Rregullores së punës, më 15 shkurt 2017, njëzëri

VENDOS

I. TË MIRATOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 30 prill 2017, nga data e nxjerrjes së këtij vendimi;

II. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje, në kohëzgjatje të njëjtë;

III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve;

IV. Ky vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese — **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani — Arta Rama-Hajrizi

KI 84/16 Parashtrues i kërkesës Hilmi Krasniqi Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR 13/2014, te 27 marsit 2015, i cili i është dorëzuar atij më 11 prill 2015

KI84/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 shtatorit 2016 i publikuar më 27 shkurt 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesa është dorëzuar nga individi, qartazi i pabazuar*

Objekti i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit REV. 3/2015, i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, *"është në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si në Protokollet e saj, ku rregullohet e drejta e punës së qytetarit"*.

Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit nuk përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI84/16

Parashtrues

Hilmi Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR 13/2014, të 27 marsit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Hilmi Krasniqi nga Vushtria (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [PARK 13/2014] e Gjykatës së Apelit, të 27 marsit 2015, i cili i është dorëzuar më 11 prill 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës "*i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës*" (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 maj 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 27 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën kohë kërkoi nga ajo që të paraqesë dëshmi se kur Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

8. Më 23 gusht 2016, Gjykata pranoi vërtetimin lidhur me atë kur Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit.

9. Më 13 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje në pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa, sipas moshës, Kryesuesi i Kolegjit shqyrtues u caktua gjyqtari Altay Suroy.

10. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shkurt 2009, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, Policia e Kosovës e ka arrestuar parashtruesin e kërkesës.

12. Më 8 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), pas nëntë seancave të mbajtura nxori Aktgjykimin [P. nr. 322/09] me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me dënimin me burgim prej 22 (njëzet e dy) vjet.

13. Në afatin ligjor, parashtruesi i kërkesës e paraqiti ankesën në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 8 tetorit 2013, duke theksuar "*shkelje esenciale të procedurës, shkelje të ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*".

14. Gjithashtu, në afatin ligjor dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

15. Më 27 mars 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR 13/2014], me të cilin e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 8 tetorit 2013, në lidhje me dënimin dhe parashtruesin e kërkesës e dënoi me burgim prej 25 (njëzet e pesë) vjet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*se është bërë shkelje e madhe ligjore, përkatësisht, nuk kisha hapësirë për të paraqitur mbrojtjen time, dhe në këtë mënyrë më janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës*".

17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të shqyrtojë me kujdes të gjitha dëshmitë dhe vendimet e gjykatave, sepse dëshiron të ketë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe pretendon se është duke u mbajtur në burg qe 8 (tetë) vjet padrejtësisht.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".*

21. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *(…)*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

22. Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata ka konstatuar se ai e konteston Aktgjykimin [PAKR 13/2014] e Gjykatës së Apelit, të 27 marsit 2015, i cili i është dorëzuar më 11 prill 2015.

23. Gjithashtu, Gjykata vëren se parashtruesi paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë më 26 maj 2016.

24. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajve.

25. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, shih, edhe: rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmërinë, të 17 marsit 2014, paragrafi 24).

26. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shqyrtim, sepse është dorëzuar jashtë afatit, siç është përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashikuar në nenin 49 të Ligjit dhe më tej të specifikuar në rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI102/16, Applicant: Shefqet Berisha, Constitutional review of Judgment Rev. no. 50/2016, of the Supreme Court of Kosovo, of 4 April 2016

KI102/16, Resolution on Inadmissibility of 14 December 2016, published on 7 March 2017.

Keywords*: Individual referral, contested procedure, right to fair and impartial trial, request for interim measure, exhaustion of legal remedies, inadmissible referral*

In this case, the Applicant had lost a civil dispute in all judicial instances but the State Prosecutor had filed a request for protection of legality on behalf of the Applicant with the Supreme Court. The Applicant alleged violation of the right to fair and impartial trial and requested the imposition of the interim measure.

The Court noted that the Referral raises important issues dealing with the procedural legitimacy of the parties and hearing of witnesses. However, based on the principle of subsidiarity, the Court is obliged to provide the opportunity and give advantage to regular courts to address these issues. In this regard, the Court declared the Referral inadmissible due to non-exhaustion of legal remedies. The Court also rejected the request for imposition of interim measure.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI102/16

Parashtrues

Shefqet Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shefqet Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 401/2014, të 26 tetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 162/09, të 29 tetorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 22.2 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

5. Parashtruesi i kërkesës kërkon vënien e masës së përkohshme dhe ndalimin e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 27, 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullat 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 4 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović (gjyqtarë).

9. Më 10 nëntor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

10. Më 14 dhjetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C. nr. 162/09, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit KSH dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që paditësit t'ia paguaj huan e papaguar.

12. Gjykata Themelore në Prishtinë përcaktoi si në vijim:

> *"I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Komjet Shala nga Peja, dhe DETYROHET i padituri Shefqet Berisha nga Prishtina që në emër të borxhit nga marrëveshja mbi huan e pa paguar t'i paguaj paditësit shumën prej 17.500 euro, me kamatë në lartësi prej 3.5% të cilën e paguajnë bankat në mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar duke filluar nga data e ushtrimit të padisë, datë 02.02.2009, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.*
>
> *II. Detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në shumë prej 568 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë".*

13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

14. Më 26 tetor 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin CA. nr. 401/2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vërtetoi se, bazuar në deklaratat e dëshmitarëve parashtruesi i kërkesës i kishte borxh paditësit shumën prej 17,500 euro, se kërkesëpadia e paditësit nuk ishte parashkruar, sepse bazuar në deklaratat e dëshmitarëve parashtruesi i kërkesës kishte pranuar vazhdimin e afatit të borxhit; kurse pretendimet tjera nuk i arsyetoi posaçërisht, sepse konsideroi se ato pretendime nuk vënë në dyshim rregullsinë e vendimit të Gjykatës Themelore.

15. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi e paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi i kërkesës kryesisht u ankua: (i) se Gjykata Themelore nuk kishte pranuar propozimin e tij për dëgjimin e një dëshmitari të rëndësishëm, (ii) legjitimiteti dhe identiteti i palës paditëse nuk ishte përcaktuar me saktësi dhe se nuk dihet identiteti i tij, (iii) kërkesëpadia e palës paditëse ishte parashkruar dhe se (iv) vendimet e gjykatave të instancës së ulët nuk janë të arsyetuara sepse nuk përmbajnë arsye të qarta për faktet vendimtare.

16. Më 4 prill 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 50/2016, refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesit duke vërtetuar detyrimin e tij ndaj paditësit dhe ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët vetëm për sa i përket kamatës.

17. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

> *"Në procedurë të zhvilluar nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së, në të cilën i padituri thirret në revizion, pasi që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsyet e qarta dhe të plota për faktet vendimtare, dispozitivi i aktgjykimeve është i qartë dhe i plotë për faktet vendimtare dhe se nuk është në kundërshtim me arsyet e dhëna dhe me provat e administruara dhe se me aktgjykimin e goditur janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditurit të cilat janë me rëndësi për vendosjen në këtë çështje juridike.*
>
> *Thëniet e revizionit mbi zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nuk janë të bazuara. Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është konstatuar se i padituri i ka borxh paditësit shumën prej 35.000 DM, e cila është konvertuar në 17.500 €. Borxhi rrjedh nga raporti juridik i kontratës mbi huan, ku paditësi në emër të huas ia ka dhënë të paditurit shumën prej 35.000 DM. Në bazë të marrëveshjes mbi huan në vitin 1999, i padituri ka qenë i detyruar që shumën e huas t'ia kthejë paditësit gjer më 31.12.2002, e që ky afat është zgjatur gjer më 31.12.2008, dhe se pas këtij afati i padituri nuk ia ka kthyer borxhin paditësit. Ekzistimi i raportit juridik të kontratës mbi huan në mes të ndërgjyqësve është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve te dëgjuar Islam Jahjaga, Abaz Berisha dhe Selman Berisha.*
>
> *Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në vendosje në këtë çështje juridike në mënyrë të drejtë është aplikuar e drejta materiale, ku është konstatuar se ndërgjyqësit kanë qenë në marrëdhënie detyrimi nga kontrata mbi huan, në bazë të nenit 557 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta zyrtare e RSFJ nr.29/1978) e cila ka qenë e aplikueshme kur është krijuar raporti juridik. I padituri si huamarrës në bazë të nenit 562 të LMD-së, ka qenë i obliguar që në afatin e kontraktuar ta kthejë huan, dhe se afati për kthimin e huas, sipas marrëveshjes në mes të ndërgjyqësve, në fillim ka qenë gjer më 31.12.2002 e që më vonë është shtyrë për 31.12.2008, dhe se pas këtij afati i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin nga kjo kontratë. Paditësi si kreditor ka të drejtë të kërkojë që i padituri si debitor të përmbushë detyrimin nga kontrata mbi huan në kuptim të nenit 262.1 të LMD-së.*
>
> *Thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar ta dëgjojë dëshmitarin Ismet Ali Sopi, imamin e xhamisë "Sofalia" në Prishtinë, janë të pabazuara, nga arsyeja se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozimi për dëgjimin e dëshmitarit në fjalë është irelevante për vendosje në këtë çështje juridike. Thëniet e revizionit se dëshmitarët e dëgjuar nuk janë deklaruar për*

faktet relevante për vendosje në këtë çështje juridike, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar dëshmitarët në rrethana që kanë të bëjnë se a ka ekzistuar raporti juridik nga kontrata mbi huan në mes të palëve ndërgjyqëse, i cili fakti ka qenë relevant për vendosje të drejtë në këtë çështje juridike, nga arsyeja se palët ndërgjyqës kanë lidhur kontratë verbale mbi huan.

I padituri në revizion konteston faktin e legjitimitetit dhe identitetit të palës së paditur, duke theksuar se paditësi përveç identitetit Komjet Shala, ka identitet si Andreas Carsten Robert Shëarz, si shtetas gjerman. Mirëpo, në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë me 19.4.2013, gjykata ka bërë identifikimin e paditësit në bazë të pasaportës nr. K000432720 dhe se në këtë shqyrtim ka qenë prezent personalisht i padituri dhe i autorizuari i tij Hasan Rexha, të cilët nuk kanë pasur vërejtje në identitetin e paditësit si dhe në shqyrtimet e mëvonshme, prandaj, nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se nuk është bërë identifikimi i palës paditëse.

Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se nuk ka parashkrim të kërkesës së paditësit, në kuptim të nenit 361 .1 të LMD-së, për shkak se kemi ndërprerje të parashkrimit të kërkesës në bazë të nenit 387 dhe nenit 392 të LMD-së dhe se me ndërprerje të parashkrimit afati llogaritet që nga fillimi, prandaj në këtë drejtim thëniet e revizionit janë të pabazuara.

Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike në bazë të nenit 214.2 të LPK, prandaj në këtë drejtim thëniet e revizionit nuk janë vlerësuar".

18. Më 15 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin C. nr. 2929/2015, aprovoi si të bazuar propozimin e paditësit K.SH. që të caktohet masa e sigurimit dhe të urdhërohet parashtruesi i kërkesës që të mos ndërtojë asgjë, të mos e shes, dhe të mos kontraktojë dhe vërtetojë kontratën për shitblerje të patundshmërisë tek noteri kompetent në Prishtinë dhe më gjerë për njësinë kadastrale të caktuar në Prishtinë deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër të kësaj gjykate.

19. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

20. Më 24 prill 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 1347/16, refuzoi të pathemeltë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore.

21. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit duke pretenduar, ndër të tjera, se pala paditëse KSH gjatë gjithë kohës ishte paraqitur me identitet të rrejshëm dhe se kjo gjë nuk ishte vërtetuar nga gjykatat e rregullta, edhe përkundër ankesave të shumta të parashtruesit të kërkesës.

22. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, pretendon si në vijim:

"Gjatë seancave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë kemi ngritur çështjen e identitetit të paditësit i cili në të vërtetë është z. Andreas Carsten Robert Schwarz, shtetas Gjerman me nr. Ausweis 5683830991 nga Iserlohn/Hagen - me vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Republikën Federale të Gjermanisë, por në Kosovë paraqitet me identitet të rrejshëm/falsifikuar si Komjet Shala (identiteti që është përdorur në padi dhe në proces gjyqësor). Rrjedhimisht duke marrë parasysh çështjen e ngritur Gjykata sipas detyrës zyrtare do të duhej

të vepronte në përputhje me nenin 278.2 te LPK-së, sepse me këtë rast janë paraqitur të paktën vepra penale (nga paditësi-pala kundërshtare) falsifikim i dokumentit, mashtrim dhe lajthim. Gjykata do të duhej të përfillte informacionin e dorëzuar - provat e prezantuara që në seancën e parë".

23. Më 31 maj 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka pranuar iniciativën e tij dhe se ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në të gjitha instancat nuk kanë marrë parasysh provat e propozuara nga ai dhe as nuk kanë arsyetuar përse i kanë refuzuar ato prova, me ç'rast, ndër të tjera, kanë refuzuar ta vërtetojnë me saktësi identitetin e palës paditëse K.SH. dhe dëgjimin e dëshmitarit I.S. që – sipas parashtruesit të kërkesës – është dëshmitar i rëndësishëm për zgjidhjen e drejtë të rastit të tij. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij – për shkak të refuzimit dhe mosarsyetimit të refuzimit të provave dhe dëshmitarit të propozuar nga ai - janë shkelur parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për vendim të arsyetuar si komponentë të së drejtës së përgjithshme për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur nenin 6 të Konventës pasi që nuk e ka trajtuar fare kërkesën për pjesëmarrje në seancën e revizionit e paraqitur nën arsyetimin e shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut - nenit 6 të Konventës. Përmes kësaj kërkese i kam kërkuar gjykatës që të thërras seancë në të cilën do të dëgjonte pretendimet e mia për shkelje të lirive dhe të drejtave themelore - neni 6 të Konventës. Argumentet për shkeljet të lirive dhe të drejtave themelore nga ana e gjykatave paraprake (shkelje të cilat kanë pamundësuar një proces të drejtë dhe të paanshëm) janë bashkëngjitur kësaj shkrese dhe janë arsyetuar duke ju referuar edhe praktikave të GJEDNJ-së".*

27. Parashtruesi i kërkesës deklaron: "*Prokuroria e Shtetit ka kërkuar anulimin e vendimeve gjyqësore të cilat janë nxjerrë në procedurë të vendosjes së masës siguruese – duke konsideruar se ekzistojnë elemente të veprës penale (identiteti i falsifikuar i paditësit), sepse ai nuk është Komjet Shala (shtetas i Kosovës), por është Andreas Carsten Roben Schwartz, shtetas gjerman me vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Republikën Federale të Gjermanisë. Duke marrë parasysh se RFGJ e ndalon dyshtetësinë, nuk ka asnjë mundësi të shmanget ekzistimi i këtyre veprave penale. Edhe sikur të lejohej dyshtetësia, në asnjë mënyrë nuk lejohet që të përdoren identitete të ndryshme në shtete të ndryshme, sepse identiteti përcaktohet nga emri personal dhe në këtë kuptim përcaktohet edhe personaliteti dhe legjitimiteti i një pale. Nuk mund të bëhet fjalë për të njëjtin person – por për personalitete të ndryshme. Si mund të konsiderohet një procedurë e rregullt, për derisa nuk është i sigurt as identiteti i palëve në procedurë?".*

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë nxjerrë vendime të paarsyetuara: "*Gjykata e Apelit përpos që nuk i ka arsyetuar vendimet/konkluzionet e saj, madje as nuk i ka përsëritur arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë - dhe nuk e arsyeton se pse pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë ... Gjykata Supreme e Kosovës ka përsëritur heshtazi të gjitha shkeljet e instancave paraprake, duke i kthyer ato në shkelje të vazhdueshme të lirive dhe të*

drejtave themelore nga pushteti gjyqësor i shtetit. Gjykata ndër të tjera nuk i arsyeton fare vendimet e saj se nuk ka pasur shkelje të drejtës formale dhe se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale".

29. Parashtruesi i kërkesës kërkon caktimin e masës së përkohshme bazuar në nenin 27 të Ligjit dhe Rregullin 54 të Rregullores së punës. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shprehet: "*... i parashtroj Gjykatës Kushtetuese të Republikës se Kosovës këtë kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktgjykimit Rev.nr.50/2016 të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktgjykimit CI. nr. 41 0/2014 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të formës së prerë C. nr. 162/ 2009 të Gjykatës Themelore Prishtinë".*

30. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të caktojë masën e përkohshme sepse vendimet e gjykatave të rregullta janë kundërkushtetuese, dhe se zbatimi i këtyre vendimeve atij do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm.

31. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme, (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 22.2 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016 dhe (iv) që rastin ta kthejë për rigjykim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Gjykata i referohet nenit 47 të Ligjit, që parasheh:

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

35. Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 27 të Ligjit, që parasheh:

Neni 27
Masat e përkohshme

> *"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

36. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 36
Kriteret e pranueshmërisë

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
...

b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka pranuar iniciativën e tij dhe se ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

38. Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga individët nuk kërkohet që t'i shterojnë mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme siç janë rishikimi i vendimit ose rihapja e procedurës (shih *Çinar kundër Turqisë* dhe *Prystavka kundër Ukrainës)*. Po ashtu, individët nuk janë të obliguar që t'i shterojnë mjetet juridike që nuk janë drejtpërdrejtë në dispozicion të tyre dhe që varen nga ushtrimi i diskrecionit nga ndërmjetësi (shih, për shembull, *Tanase kundër Moldovës,* [DHM] paragrafi 122).

39. Mirëpo, Gjykata po ashtu rikujton se tashmë ka përcaktuar në jurisprudencën e saj se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta atëherë kërkesa e parashtruesve konsiderohet e parakohshme (shih, për shembull, aktvendimet për papranueshmëri në rastet individuale nr. KI23/10, KI32/11, KI113/12, KI114/12, KI07/13 dhe KI58/13).

40. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për mbrojtje nga shkelja e të drejtave kushtetuese. (Shih*, mutatis mutandis,* GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës,* Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

41. Gjykata vëren se kërkesa ngre çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me legjitimitetin procedural të palëve ndërgjyqëse dhe dëgjimin e dëshmitarëve. Megjithatë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e obliguar që t'i ofrojë mundësinë dhe përparësinë gjykatave të rregullta që t'i trajtojnë këto çështje. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh faktin se Prokurori i Shtetit ka miratuar kërkesën e parashtruesit për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë (Për shpjegim më të hollësishëm të parimit të subsidiaritetit shih rastin nr. KI08/11, Aktvendimi për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 10 majit 2012, paragrafët 46 dhe 47, si dhe referencat e tjera të cituara në atë vendim).

42. Gjykata konsideron se – pavarësisht nga procedurat që janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta dhe pa paragjykim ndaj atyre procedurave - asgjë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesën që në të ardhmen sërish të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor katër mujor nga dita që ka pranuar vendimin e formës së prerë në rastin e tij nga gjykatat e rregullta.

43. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

44. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vënien e masës së përkohshme për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë, ndër të tjera, në kundërshtim të parimit të barazisë së armëve, janë kundërkushtetuese dhe se ai do të pësojë dëm të pariparueshëm.

45. Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores, që specifikon:

> *"[...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*
>
> > *(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

46. Siç u përmend më lart, kërkesa është e parakohshme dhe se nuk ka rast *prima facie*. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (b) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 14 dhjetor 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI96/16, Applicant: Shaha Salihu-Fetahu, Constitutional review of Decision AC-I-0293 of the Appellate Panel of the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo, of 6 April 2016

KI96 / 16, Resolution on Inadmissibility, of 15 November 2016, published on 7 March 2017.

Keywords*: Individual referral, civil case, right to fair trial, manifestly ill-founded, inadmissible referral*

In this case, the Applicant alleged a violation of her constitutional rights caused by public authorities and the courts as a result of denial of her right to benefit from 20% of the privatization of the socially-owned enterprise "Ramiz Sadiku".

The Court notes that the Applicant's allegations were related to the interpretation and the application of the provisions of the procedural law, regarding the legal deadlines that provide for the right to file an appeal under Regulation 2003/13 and the Law on Contested Procedure. The Court considered that the Applicant's allegations, as such, in fact raise issues of legality and fall within the scope of the regular courts. Therefore, the Referral was declared manifestly ill-founded and inadmissible,

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI96/16

Parashtrues

Shaha Salihu-Fetahu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-0293, të 6 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shaha Salihu-Fetahu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim në fshatin Kaqybeg, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin [AC-I-0293] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), të 6 prillit 2016.

3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 5 maj 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-0293] të Kolegjit të Apelit, të 6 prillit 2016, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës për të përfituar nga 20%-shi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku". Parashtruesja e kërkesës nuk ka specifikuar të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë, të cilat pretendon që mund t'i jenë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores

së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 qershor 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 21 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

9. Më 7 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Altay Suroy kryesues të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.

10. Më 15 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës, prej vitit 1981 deri në vitin 1990 ishte punëtore e ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku". Në vitin 1990, ajo ishte larguar nga puna.

12. Më 27 qershor 2006, ndërmarrja shoqërore "Ramiz Sadiku" u privatizua.

13. Sipas njoftimit të shpallur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), të gjitha ankesat lidhur me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku", duhet të dorëzoheshin deri më 31 gusht 2007.

14. Më 6 dhjetor 2007, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në AKM, të cilës ia kishte bashkëngjitur të gjitha dëshmitë për të vërtetuar se ishte punëtore e ndërmarrjes "Ramiz Sadiku". Sipas parashtrueses së kërkesës, ajo nuk mori asnjëherë përgjigje lidhur me ankesën e saj.

15. Më 7 mars 2009, AKM-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për 20%-shin nga privatizimi i ndërmarrjes "Ramiz Sadiku". Në bazë të Rregullores 2003/13, lista përfundimtare e AKM-së mund të kontestohet në afat prej 20 (njëzetë) ditësh nga publikimi i saj dhe rrjedhimisht, ky afat ishte përcaktuar të përfundonte më 27 mars 2009.

16. Më 19 qershor 2013, parashtruesja e kërkesës e kontestoi listën përfundimtare të AKP-së në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, me pretendimin se kishte të drejtë pjesëmarrjeje në 20%-shin e privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.

17. Më 10 dhjetor 2015, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përmes Aktvendimit [SCEL-09-0001-C1237-C1274], hodhi poshtë, si të paafatshme ankesën e parashtrueses së kërkesës.

18. Më 25 janar 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë pranë Kolegjit të Apelit, përmes së cilës kërkon rishqyrtimin e ankesës së refuzuar nga Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

19. Më 6 prill 2016, Kolegji i Apelit [Aktvendimi AC-I-0293], la në fuqi Aktvendimin [SCEL-09-0001-C1237-C1274] të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

20. Në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit [Aktvendimi AC-I-0293], përkitazi me ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndër të tjera, arsyetohet si në vijim:

> *"Ankuesja C1268 Shaha Fetahu Salihu me datë 25 janar 2016 e dorëzon një ankesë ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar dhe kërkon të përfshihet në listën përfundimtare për të drejtën legjitime për 20%. Për më tepër në ankesë pohon se ka dëshmi të mjaftueshme se ka punuar në NSH "Ramiz Sadiku" nga viti 1981 e deri në 1990, dhe se nuk është e drejtë të i mohohet e drejta për 20%. Në ankesë nuk ka dhënë asnjë sqarim për lëshimin e afatit ligjor për kontestimin e listës përfundimtare.*
>
> *(...)*
> *Në rastin e këtyre ankuesve, të asnjë ankesë e paafatshme nuk ka mundur të aplikohet neni 130.3 i LPK, për të lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme, nëse ankesat e ankuesve mund të trajtoheshin për kthim në gjendjen e mëparshme pasi që në bazë të kësaj dispozite ligjore vetëm në afatet prej 60 ditësh mund të kërkohet kthim në gjendjen e mëparshme, e në rastin e këtyre ankesave kanë kaluar disa vite pas mbylljes së afatit për kontestimin e listës përfundimtare."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin [AC-I-0293] të Kolegjit të Apelit, të 6 prillit 2016, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, për shkak të mohimit të së drejtës së saj për të përfituar të ardhura nga 20%-shi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku". Përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtave të saj, parashtruesja e kërkesës nuk ka specifikuar ndonjë nen të Kushtetutës.

22. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata *"të përfshihet në listën përfundimtare të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes Ramiz Sadiku".*

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1 dhe 7, të Kushtetutës [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

26. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *(...)*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *(...)*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*
> *(...)*

27. Së pari, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit [AC-I-0293], të 6 prillit 2016, për çështjet që lidhen me AKP-në, duke pretenduar që i njëjti ia shkel të drejtën e saj për të përfituar të ardhura nga 20%-shi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku".

28. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në mënyrë specifike nuk ka përmendur ndonjë nen të Kushtetutës dhe as të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtave të saj. Por, Gjykata vëren se në substancë pretendimet e parashtrueses së kërkesës kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë.

29. Gjykata vëren se, pretendimet e parashtrueses së kërkesës ndërlidhen specifikisht vetëm me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të ligjit procedural, në lidhje me afatet ligjore që parashohin të drejtën e ushtrimit të ankesës, sipas Rregullores 2003/13 dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Pretendimet e parashtrueses së kërkesës, si të tilla, në të vërtetë ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe hynë në fushëveprimin e gjykatave të rregullta.

30. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

31. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesja e kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

32. Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses nuk arrin të dëshmojë që kolegjet përkatëse të Dhomës e Posaçme të Gjykatës Supreme kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Për më tepër, Gjykata konsideron se në bazë të fakteve të lëndës konkrete të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit të Dhomës së Posaçme i Gjykatës Supreme kanë dhënë arsyetime të detajuara dhe të qarta për vendosjen e çështjes, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e hodhën poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme.

33. Gjykata posaçërisht rikujton faktin se parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e saj se në ndonjë mënyrë mund të ketë pasur shkelje të të drejtave kushtetuese.

34. Fakti që parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

35. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, sepse faktet e paraqitura nga ajo në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar asaj këto të drejta.

36. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 shkurt 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI82/16, Parashtruesi: Đeljalj Kazagić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2016, të 10 shkurtit 2016

KI82/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 marsit 2017, publikuar më 7 mars 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, çështje penale, e drejta për gjykim të drejtë, barazia para ligjit, të drejtat e të akuzuarit, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24, 27, 29, 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës, të shkaktuara nga gjykatat e rregullta si rezultat i njëanshmërisë së trupit gjykues, trajtimit të pabarabartë (diskriminimit gjinor), mbajtjes se jashtëligjshme në paraburgim, pamundësisë së kundërshtimit të deklaratave të dëshmitareve, dhe dënimit përtej parashikimeve ligjore.

Gjykata, në këtë rast, konstatoi se parashtruesi i kërkesës, thjesht nuk ishte pajtuar me rezultatin e rastit dhe i sugjeroi atij që të shihte rastin KI125/11, *Shaban Gojnovci,* Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28. Si përfundim, duke i marrë për bazë të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregonin që gjykatat e rregullta ia kishin mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese ishte qartazi e pabazuar dhe duhej të deklarohej e papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI82/16

Parashtrues

Đeljalj Kazagić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 13/2016, të 10 shkurtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Đeljalj Kazagić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), banues në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 13/2016, të 10 shkurtit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i kontestuar).

3. Vendimin e kontestuar parashtruesi e ka pranuar më 1 mars 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues në rastet Penale], 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 maj 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues) Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 8 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës me urdhër të autoriteteve përkatëse u arrestua dhe u ndalua në afat prej 48 orësh.

10. Më 5 qershor 2013, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, parashtruesit të kërkesës ia caktoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas dyshimit të bazuar se i njëjti kishte kryer disa vepra penale.

11. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara me mision në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: OKB). Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, personeli i OKB-së, përfshirë edhe personelin vendor, gëzon imunitet nga arrestimet dhe ndalesat. Për këtë arsye, më 23 qershor 2013, Kryeprokurori i Shtetit, bazuar në Ligjin nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, i kërkoi Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me mision në Kosovë, që parashtruesit të kërkesës t'i hiqet imuniteti, në mënyrë që gjykata të vazhdonte me gjykimin e rastit të tij PP. nr. 58/13.

12. Më 3 korrik 2013, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i OKB-së me mision në Kosovë, njofton Kryeprokurorin e Shtetit, se Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, ka marrë vendim për heqjen e imunitetit të parashtruesit të kërkesës, për shkak të rastit PP. nr. 58/13 të ngritur kundër tij në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

13. Më 31 mars 2014, Prokurori i çështjes, në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ndaj parashtruesit të kërkesës paraqiti 9 (nëntë) aktakuza mbi dyshimin e bazuar të kryerjes së veprave penale në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nënparagrafin (3); me nenin 201, paragrafin (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe nenin 20; me nenin 195, paragrafin (4) në lidhje me paragrafin (1); me nenin 198, paragrafin (1) në lidhje me paragrafin (5), nënparagrafin (3) dhe (4); nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nënparagrafin (2); me nenin 193, paragrafin (3) nënparagrafin (4); me nenin 195, paragrafin (2) nënparagrafin (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20; me nenin 193, paragrafi (2) nënparagrafin (3); dhe me nenin 241, paragrafin (3) të KPK-së.

14. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë, nxori Aktgjykimin P. nr. 42/14) me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpall të pafajshëm për akuzën 3, 4, 5, 6 dhe 9, ndërsa e gjen fajtor atë për akuzën 1, 2, 7 dhe 8, duke e dënuar me burgim unik në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) vjetësh.

15. Më 7 prill 2015, parashtruesi e apeloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi masën e dënimit.

16. Më 7 shtator 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Vendimi PAKR. nr. 220/15), e aprovoi si pjesërisht të pranueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me vendimin për dënimin, duke e ndryshuar masën e dënimit unik me burgim nga 14 (katërmbëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burg. Në pjesët tjera vendimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës mbeti i pandryshuar.

17. Në një datë të paspecifikuar, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës penale dhe të ligjit penal.

18. Më 22 dhjetor 2015, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë parashtroi edhe parashtruesi i kërkesës.

19. Më 6 janar 2015, Gjykata Supreme (Vendimi Pml. nr. 268/2016), refuzoi si të pabazuar kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke arsyetuar se vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të ligjit procedural dhe material. Për më tepër, kjo gjykatë erdhi në përfundim se:

(...)
Konkludimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me zhvillimin e ngjarjeve dhe cilësimin juridik të veprave penale pra, se në veprimet e të dënuarit përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, të cilat i ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë për çfarë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike, por edhe lidhur me pretendimet nga ankesa e mbrojtësve të të dënuarit, si të drejta dhe të ligjshme i akcepton edhe kjo Gjykatë, meqë drejtë është aplikuar ligji penal, në përjashtim të veprës penale nga pika 2 e dispozitivit të aktgjykimit, për çfarë janë dhënë arsye më lart në këtë aktgjykim.
(...)

20. Më 10 shkurt 2016, Gjykata Supreme, nxori Vendimin Pml. nr. 13/2016, me të cilin kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar. Për më tepër, Gjykata Supreme erdhi në këtë përfundim:

(...)
Në fakt i dënuari me këtë mjet juridik vetëm ka bërë përsëritjen e pretendimeve të paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë, ai në këtë kërkesë me tepër i referohet fakteve, mënyrës se si janë vërtetuar ato dhe vlerësimit të provave, në pjesën dërmuese të kërkesës merret me interpretimin dhe komentimin e dispozitave ligjore si dhe citimin e pjesëve të caktuara të procesverbalit mbi shqyrtimin gjyqësor, ndërsa fare pak jep shpjegime se cilat janë ato shkelje konkrete të cilat pretendohen me kërkesën për mbrojtën e ligjshmërisë.
(...)

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi pretendon se është viktimë e shkeljeve të të drejtave themelore të njeriut të shkaktuara nga autoritetet publike dhe gjykatat.

22. Për më tepër, parashtruesi pretendon në shkeljet e të drejtave kushtetuese, si në vijim:

i. Shkelje të nenit 24, paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, me pretendimin se u diskriminua në bazë të gjinisë, sepse trupi gjykues mori si të besueshme deklaratën e të dëmtuarës S. N. dhe të dëshmitares N. T., për arsye se ato i takonin gjinisë femërore;

ii. Shkelje të nenit 27 të Kushtetutës, me pretendimin se arrestimi nga autoritetet e policisë, faza hetuese dhe gjykimi kundër tij ndikuan në *"forcën e tij psikike të paqëndrueshme fizikisht"*. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se presioni i shkaktuar nga shkeljet e shumta të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe KPK-së, mori formën e *"Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues"*;

iii. Shkelje të nenit 29.4 të Kushtetutës, me pretendimin se u mbajt kundërligjshëm në paraburgim prej momentit të arrestimit nga autoritetet e policisë deri në paraqitjen e tij para gjyqtarit të procedurës paraprake. Për më tepër, parashtruesi pretendon se mbajtja e tij për një muaj në paraburgim, përderisa gëzonte imunitetet si punëtor vendor i OKB-së me mision në Kosovë ishte e kundërligjshme gjithashtu;

iv. Shkelje të nenit 30.3 të Kushtetutës, me pretendimin se kryetarja e trupit gjykues ia mohoi të drejtën për t'u mbrojtur ndaj aktakuzave të ngritura nga prokurori i çështjes, si dhe të drejtën për t'i komentuar dhe kundërshtuar deklaratat dhe provat e dëshmitarëve;

v. Shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, me pretendimet se janë shkelur dispozitat e nenit 19, paragrafit 1, pikave 1.8, 1.9, dhe 1.12, të KPPK-së, për shkak se përpilimi i aktakuzës nga prokurori i çështjes ishte bërë në kundërshtim me ligjin; dhe se gjykata iu shmang provave shfajësuese që ishin në favorin e tij;

vi. Shkelje të nenit 33, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, me pretendimin se ashpërsia e dënimit lidhur me akuzën nr. 8 (tetë) tejkalonte masën e parashikuar me ligjin penal dhe ishte në disproporcion me veprën penale, për shkak se gjykata aplikoi gabimisht nenin 193.1 të KPK-se, sipas të cilit parashihet dënim me burg nga 2 (dy) deri në 10 (dhjetë) vjet, në vend që gjykata të aplikonte nenin 194 të KPK-së, që parashikonte dënim nga 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vlerëson se: parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar sipas kuptimit të nenit 113 të Kushtetutës; i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës; ka përmbushur kërkesën e afatit 4 (katër) mujor, të kërkuar me nenin 49 të Ligjit; ka specifikuar saktë shkeljet e pretenduara kushtetuese dhe vendimet e kontestuara të autoriteteve publike me të cilat pretendohen shkeljet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë.

25. Më tej, Gjykata merr parasysh kriterin e kërkuar me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës, që përcakton se:

> *1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *(...)*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

26. Bazuar ne rregullin e sipërpërmendur, Gjykata vlerëson më tej nëse pretendimet e parashtresat të kërkesës për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara

me Kushtetutë dhe Konventë evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë KEDNJ), janë qartazi të bazuara.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit në pikën (i)

27. Përkitazi me këtë, Gjykata merr parasysh nenin 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së:

Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës

"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".
(...)

Neni 14 [Ndalimi i Diskriminimit] i KEDNJ-së

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër".

28. Gjykata para së gjithash dëshiron të rikujtojë se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton barazinë e individëve që ndodhen në kushte të barabarta dhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj pa asnjë diskriminim. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori peronash që janë në kushte objektivisht të ndryshme të ketë trajtim dhe zgjidhje të njëllojta.

29. Gjykata në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, vë në pah se barazia para ligjit duhet të kuptohet si një e drejtë e palës në procedurë, të ndodhur para një procesi gjyqësor në shqyrtim, që pret një trajtim korrekt, të paanshëm me mundësi të barabarta të shfrytëzimit të mjeteve ligjore, pavarësisht statusit personal ose juridik që e ka ai ose ajo si palë ndërgjyqëse.

30. Për më tepër, praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sqaron se, sipas kuptimit të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), një trajtim diskriminues konsiderohet vetëm atëherë kur *"ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm",* që do të thotë se, ai nuk ndjek një *"qëllim legjitim",* apo kur ai trajtim nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti *"midis mjeteve të përdoruara dhe qëllimit që arrihet"* (shih, për shembull gjykimin e 28 majit 1985 në çështjen *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, nr. 94, para 78).

31. Në këtë kontekst, Gjykata, duke i marrë parasysh shtjellimet e mësipërme përkitazi me të drejtat që burojnë nga neni 24 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, konsideron se asnjë nga testet e kërkuara me këto dispozita konkrete nuk e justifikojnë pretendimin e parashtruesit për shkeljen e kësaj të drejte themelore. Sepse, parashtruesi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë me prova pretendimet e tij dhe të argumentojë më tej se, si dhe pse trupi gjykues synonte arritjen e një qëllimi jolegjitim për ta trajtuar atë në mënyrë të pabarabartë, në raport me palët tjera ndërgjyqëse, përkatësisht me të dëmtuarën S.N. dhe dëshmitaren N.Z., vetëm pse ato i përkisnin gjinisë femërore, së cilës i përkiste edhe kryetarja e trupit gjykues.

32. Rrjedhimisht, Gjykata në baza kushtetuese pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit e konsideron, si qartazi të pabazuar.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit në pikën (ii)

33. Gjykata merr parasysh nenin 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së:

> Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues] i Kushtetutës: *"1. Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues".*
>
> Neni 3 [Ndalimi i Torturës] i KEDNJ-së: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese".*

34. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson, nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës bien brenda kërkesave dhe qëllimit të nenit 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së.

35. Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së, për qëllime të nenit 3, ka përkufizuar se Konventa edhe në rrethanat më të vështira, si lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, në mënyrë absolute e ndalon torturën, trajtimin çnjerëzor ose degradues pavarësisht sjelljes së viktimës. Sipas GJEDNJ-së, trajtimi çnjerëzor është pranuar si degradues vetëm atëherë kur viktimës a viktimave u është shkaktuar qëllimshëm ndjenja e frikës, ankthit dhe inferioritetit, poshtërimit dhe përuljes, thyerjes së qëndrueshmërisë fizike ose morale, ose kur ashpërsia e keqtrajtimit e nxitë viktimën të veprojë kundër vullnetit ose vetëdijes së tij/saj (shih, ndër të tjera, rastin *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, § 120, EHCR 2001-III, dhe *Ramirez Sanchez kundër Francës* [CG], nr. 59450/00, § 118, ECHR 2006-IX).

36. Më tutje, GJEDNJ thekson, në mënyrë që keqtrajtimi të bie brenda objektit të nenit 3 të Konventës, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij niveli do të varet nga të gjitha rrethanat e rastit si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore, në disa raste merret në konsideratë edhe gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit 1978, § 162, seria A nr. 25).

37. Për më tepër, GJEDNJ theksoi se pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten me prova dhe se vlerësimi i tyre duhet të karakterizohet përtej dyshimit të arsyeshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Gök dhe Güler kundër Turqisë,* aplikacioni nr. 74307/01, i 28 korrikut 2009).

38. Andaj, në dritën e shpjegimeve të mësipërme, Gjykata konsideron se asnjë nga elementet që kërkohen me nenin 3 të Konventës nuk është përmbushur në rastin e parashtruesit të kërkesës për t'u konstatuar si kushtetutshmërisht i bazuar pretendimi i tij për shkeljen e kësaj të drejte themelore. Sepse, ai me asnjë dëshmi nuk ka provuar se autoritetet e policisë a të hetuesisë, apo kushdo nën autorizimet zyrtare, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 27 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit në pikën (iii)

39. Gjykata merr parasysh nenin 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së:

> Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës:

(...)
"4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit".
(...)

Neni 5 [E drejta për liri dhe siguri] i KEDNJ-së:

"Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:
(...)
c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
(...)

40. Në këtë drejtim, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës bien brenda kuptimit të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNj-së.

41. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, qëllimi i përgjithshëm i nenit 5 të KEDNJ-së është që të sigurojë se askush nuk duhet të privohet nga liria në mënyrë arbitrare (shih, *Assanidze kundër Gjeorgjisë,* Kërkesa nr. 71503/01, Aktgjykimi i 8 prillit 2004). Më tej, neni 5 i KEDNJ-së, kërkon që çdo heqje lirie të jetë *"në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji".*

42. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është informuar fillimisht nga autoritetet përkatëse, për shkakun e arrestimit dhe të ndalesës, më pas, me vendim të Gjykatës, brenda afatit të paraparë me ligj dhe Kushtetutë, i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh. Andaj, në këtë kontekst, nuk mund të thuhet se veprimet e autoriteteve përkatëse, përkitazi me arrestimin dhe mbajtjen në paraburgim të parashtruesit të kërkesës janë në kundërshtim me qëllimin dhe kërkesat e nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

43. Ndërsa, sa i përket imunitetit, Gjykata vëren se kërkesa për heqjen e imunitetit të parashtruesit të kërkesës është bërë në pajtim me nenin 7 të Ligjit, nr. 03/L-033, që thotë: "*Imunitetet në nenet 5 dhe 6 të këtij Ligji mund të hiqen vetëm nga Udhëheqësi i misionit ... me marrëveshje të shpejtë me shkrim ...".* Sipas nenit 5 të këtij ligji kategoria e individëve që bëjnë pjesë në personelin vendor në misionet diplomatike apo konsullore "*... gëzojnë imunitet nga procedurat penale dhe civile për veprimet e kryera nga ata, dhe për fjalët e shkruara apo të shqiptuara, në cilësinë e tyre zyrtare".*

44. Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës u arrestua dhe u ndalua nga autoritetet përkatëse me urdhër të prokurorit të çështjes për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e disa veprave penale, ku nga disa prej tyre u shpall fajtor dhe u dënua. Gjykata vëren se natyra e veprave penale, për çfarë ai akuzohej, bien jashtë fushëveprimit dhe përgjegjësive të tij zyrtare, si punëtor i OKB-së, prandaj nuk mund të thuhet se mbajtja në paraburgim ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të Konventës, përderisa autoritetet vepruan në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

45. Për më tepër, Gjykata thekson se imuniteti nuk mund t'u shërbej individëve si e drejtë për t'i ikur ndjekjes dhe përgjegjësisë penale, për veprat penale të cilat janë të dënueshme me ligj.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit në pikën (iv)

46. Gjykata i referohet nenit 30.3 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së:

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së:

"Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:
(...)
(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
(...)

Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.
(...)
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
d) të pyes ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
e) të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq".

47. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se të njëjtat pretendime parashtruesi i kërkesës i kishte ngritur edhe në Gjykatën Supreme, e cila në vendimin e saj Pml. nr. 13/2016, të 10 shkurtit 2016 arsyetoi: "*Ky intervenim i kryetarit të trupit gjykues kjo Gjykatë e vlerëson se ka qenë me qëllim që të orientojë mbrojtjen e të dënuarit në faktet e rëndësishme të çështjes prandaj këtu assesi nuk mund të bëhet fjalë për mohimin e të drejtës për të paraqitur mbrojtjen, aq më tepër kur dihet i dënuari për dy ditë ka paraqitur mbrojtjen e tij pa asnjë pengesë*".

48. Për më tepër, në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij u përballën me dëshmitarët e akuzës dhe patën mundësinë që atyre t'u bënin pyetje dhe t'i kundërshtonin deklaratat e tyre (shih, ndër të tjera *Saïdi kundër Francës*, Vendim i 20 shtatorit 1993, seritë A nr. 261-C, fq. 56 § 43, dhe A.M. kundër Italisë, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999 –IX).

49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia e duhur për të ushtruar të drejtat e tij për t'u mbrojtur, brenda kuptimit të nenit 30 (3) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës, prandaj edhe këtë pretendim, Gjykata e konsideron, si qartazi të pabazuar.

Sa i përket pretendimit të parashtresat në pikën (v)

50. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së:

> Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së:
>
> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
> *3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
> *4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
> *5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
> *6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
> *7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit".*

51. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, pretendimet për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm i ndërlidh me ligjshmërinë e përpilimit të aktakuzës nga ana e prokurorit të çështjes, duke aluduar në shkelje të dispozitave të nenit 19, paragrafit 1, pikave 1.8, 1.9, dhe 1.12 të KPPK-së; dhe se gjykatat nuk i morën parasysh provat shfajësuese që ishin në favorin e tij.

52. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me ligjshmërinë e përpilimit të aktakuzës nga ana e prokurorit të çështjes ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe, si të tilla bien në fushëveprimin dhe kompetencën e gjykatave të rregullta. Si rregull, interpretimi i ligjit është ekskluzivisht çështje për gjykatat e rregullta. Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë atë (Shih, *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë* [DHM], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, paragrafi 89).

53. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykatat nuk i morën parasysh provat shfajësuese, Gjykata rikujton, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

54. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu rikujton praktikën e GJEDNJ-së që thotë se pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislacionit të brendshëm dhe se, si rregull, janë gjykatat kombëtare ato që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e

institucioneve të Konventës është të sigurojë që procesi në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën sesi janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt. Këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësia e nevojshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, qoftë në momentin kur ai bën deklaratat, ose dhe në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih, *Saïdi kundër Francës*, vendim i 20 shtatorit 1993, seritë A nr. 261 – C, fq. 56 § 43, dhe A.M. kundër Italisë, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999 –IX).

55. Prandaj, duke i pasur parasysh shtjellimet e mësipërme nuk mund të thuhet se gjykatat e rregullta nuk vepruan në përputhje me detyrën e tyre sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit në pikën (vi)

56. Gjykata merr parasysh nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale], të Kushtetutës:

> *(...)*
> *2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.*
> *3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.*
> *(...)*

57. Gjykata verën se shkeljen e nenit 33, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e argumenton me faktin se ashpërsia e dënimit lidhur me akuzën nr. 8 (tetë), tejkalon dënimin e përcaktuar me ligjin penal dhe është në disproporcion me veprën penale, sepse gjykata aplikoi gabimisht nenin 193.1 të KPK-se, sipas të cilit parashihet dënim me burg nga 2 (dy) deri në 10 (dhjetë) vjet, në vend që gjykata të aplikonte nenin 194 të KPK-së, që parashikonte dënim nga 6 (gjashtë) muaj, deri në 5 (pesë) vjet dënim me burg.

58. Gjykata, në fakt, konsideron se ky pretendim ka të bëjë me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të ligjit penal. Andaj, Gjykata ripërsëritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato gjykata mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë korrekte dhe të drejta në tërësi, përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

59. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

60. Në këtë drejtim, Gjykata, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës i konsideron po ashtu, si qartazi të pabazuara.

61. Nga sa u tha më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk është pajtuar me rezultatin e rastit; megjithatë, mospajtimi nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë që të parashtroi kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 24, 27, 29, 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës (Shih rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci,* Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).

62. Si përfundim, duke i marrë për bazë të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i mbështeti me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

63. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI103/15 Parashtrues Skender Vitia, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 88/2015, të 29 prillit 2015

KI103/15 Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2017 i publikuar më 14 mars 2017

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, kërkesa qartazi e pabazuar

Objekti i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 88/2015 të Gjykatës Supreme të 29 prillit 2015 dhe pretendimi i parashtruesit se është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura se parashtruesi i kërkesës nuk i mbështeti pretendimet e tij dhe nuk dëshmoi shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI103/15

Parashtrues

Skender Vitia

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 88/2015, të 29 prillit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Skender Vitia nga Hajvalia (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. nr. 88/2015, të 29 prillit 2015, me të cilin ishte refuzuar si e papranueshme kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar kundër Aktgjykimit PKR. nr. 1045/2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 10 dhjetorit 2014 dhe Aktgjykimit PAKR. nr. 33/2015, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 26 shkurtit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 88/2015, të 29 prillit 2015 dhe pretendimi i parashtruesit të kërkesës se është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

7. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 17 janar 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin PKR. nr. 1045/13, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale "Marrja e ryshfetit" në pajtim me nenin 343 (3) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK) dhe e dënoi atë me gjobë në shumën prej 500, 00 euro.

10. Gjykata Themelore konstatoi se të gjitha provat konfirmuan se parashtruesi i kërkesës, në mënyrë që të përfitojë financiarisht, kishte kërkuar dhe kishte marrë ryshfet shumën prej 10 (dhjetë) euro.

11. Kundër këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, duke propozuar që "*për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të KPPK-së, shkeljes së Ligjit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin",* Gjykata e Apelit duhet ta *"ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ta lirojë të akuzuarin nga akuza apo ta prishë aktgjykimin dhe ta kthejë rastin në rigjykim dhe rishqyrtim*."

12. Më 26 shkurt 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR. nr. 33/15, vendosi që ta miratojë pjesërisht ankesën e parashtruesit, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke zëvendësuar dënimin me gjobë me dënim me burgim (kështu që nëse dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim, një ditë burgim llogaritet 20 € të gjobës).

13. Gjykata e Apelit arsyetoi, *inter alia*, se "*gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit, ka dhënë arsye për secilën pikë të aktgjykimit duke e paraqitur plotësisht dhe qartë këtë me fakte dhe se pse i konsideron ato të konfirmuara."*

14. Gjykata e Apelit më tej konstatoi se "*pretendimet e të akuzuarit se gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike janë pretendime të pa bazuara, sepse sipas gjendjes së kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike*."

15. Në një datë të pacaktuar, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës e parashtroi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

16. Me parashtresën KMLP. II. nr. 67/2015, të 24 marsit 2015, Prokurori i Shtetit propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

17. Më 29 prill 2015, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të papranueshme, duke arsyetuar se "*Në rastin konkret, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka ushtruar avokati O.H. nga Prishtina, ndërsa autorizimi me shkrim apo me gojë nga i dënuari nuk ekziston në shkresat e çështjes.*"

18. Gjykata Supreme konkludoi se "*Për arsyet e cekura më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hedh si e papranueshme [...].*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon, *inter alia*, se "*është marr vendimi mbi dënimin mbi bazën vetëm të deklaratës së të dëmtuarit, E. L., ndërsa nuk është argumentuar me asnjë provë materiale se i kam marr 10 (dhjetë) Euro nga ai.*"

20. Ai më tej pretendon se "*është shkelur dispozita e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës sepse gjykata nuk ka kërkuar të caktohet me provë materiale [krimin] se vërtetë i kam marr 10 (dhjetë) Euro nga E.L.*"

21. Parashtruesi kërkon nga Gjykata "*të anulohen të gjitha vendimet e mëparshme dhe çështja të rigjykohet duke eliminue shkeljet e duke respektuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31.*"

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se: "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

25. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) (d) [Kriteret e pranueshmërisë] dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *(...)*
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *(...)*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*"

26. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi kërkoi që t'i mbrojë të drejtat e tij në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si dhe në Gjykatën e Apelit dhe parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

27. Në Aktgjykimin e 29 prillit 2015, Gjykata Supreme theksoi që "*[...] Në rastin konkret, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka ushtruar avokati O. H. nga Prishtina, ndërsa autorizimi me shkrim apo me gojë nga i dënuari* [parashtruesi i kërkesës] *nuk ekziston në shkresat e çështjes. Për arsyet e cekura më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hedh si e papranueshme [...].*"

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta, në veçanti aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit, për shkak se ai ankohet për vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve nga ana e këtyre gjykatave.

29. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të përmendura në kërkesë ngrenë çështje të ligjshmërisë, të cilat bien në domenin dhe në prerogativën e gjykatave të rregullta.

30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

31. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* GJEDNJ, kërkesa nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu, *mutatis mutandis,* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

32. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai kishte mundësi që të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij dhe të kontestojë argumentet dhe dëshmitë e paraqitura kundër tij; se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar drejt nga gjykatat; dhe se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht. Rrjedhimisht, rezulton se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

33. Për më tepër, Gjykata vëren se nuk ka asgjë në kërkesën e tanishme që do të sugjeronte se provat janë marrë në mënyrë të paligjshme ose në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese.

34. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, siç pretendohet nga ai.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (d) dhe 36 (2) (b) si dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI106 / 16, Applicant: Shaban Hasani, Constitutional review of Judgment AC-I-13-0148-A0001 of the Appellate Panel of the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters of 31 March 2016

KI106/16, Resolution on Inadmissibility of 18 January 2017, published on 20 March 2017

Key words: *Individual referral, equality before the law, the right to fair and impartial trial, manifestly ill-founded*

The Appellate Panel of the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters rendered judgment AC-I-13-0148-A0001 of 31 March 2016, rejecting as ungrounded the Applicant's appeal against Judgment SCEL-09-0022 of the Specialized Panel of the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters of 28 June 2012.

The Applicant, *inter alia*, claimed that the Appellate Panel of the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters violated his rights guaranteed by the Constitution, that is, equality before the law and the right to fair and impartial trial, since the regular courts rejected the Applicant's request to be included in the list of employees in order to receive 20% of the proceeds generated from the sale of SOE "Plantacioni".

The Court found that the Applicant did not sufficiently substantiate and proved his allegation on constitutional basis of violation of human rights and fundamental freedoms guaranteed by the Constitution. The Referral was declared inadmissible, as manifestly ill-founded.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI106/16

Parashtrues

Shaban Hasani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0148-A0001, të 31 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shaban Hasani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Kemajl Ademaj, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0148-A0001, të 31 marsit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 13 prill 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 7 nëntor 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i dërgoi një kopje të saj Kolegjit të Apelit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

8. Më 18 janar 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 maj 2005, NSH "Plantacioni" nga Ferizaj ishte privatizuar.

10. Më 18 gusht 2007, AKP-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve, të cilët kanë të drejtë në 20% e të ardhurave, të krijuara nga privatizimi i NSH "Plantacioni" nga Ferizaj.

11. Më 30 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj listës përfundimtare në Kolegjin e specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i specializuar), duke kërkuar që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legjitime, për të marrë pjesë në 20% të mjeteve të realizuara nga privatizimi i NSH "Plantacioni" në Ferizaj.

12. Në një datë të paspecifikuar, AKP-ja paraqiti kundërshtimin e saj duke kërkuar refuzimin e ankesës dhe duke theksuar se "*ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë materiale që të ketë qenë punëtor i NSH apo të ketë qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit*".

13. Më 28 qershor 2012, Kolegji i Specializuar (Aktgjykimi SCEL-09-0022) refuzon kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Më tutje, në Aktgjykim, shtohet: "*Shaban Hasani (C.12.2) nuk ishte punëtor në kohën e privatizimit të NSH-së. [...] ai nuk mundi të paraqesë dëshmi se është lajmëruar në punë ose se është kthyer në punë në çka mbështetet ai, e as që ka qenë fare punëtor i NSH. [...] Ai nuk i përmbushë kërkesat për të qenë me të drejta legjitime*".

14. Më 14 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke pretenduar se Kolegji i Specializuar në mënyrë të padrejtë ka vendosur për refuzimin e ankesës.

15. Më 31 mars 2016, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-I-13-0148-A0001) refuzon ankesën si të pabazuar, duke arsyetuar se "*Pretendimet ankimore të këtij ankuesi nuk janë të bazuara. Ai, pos deklarimit për diskriminimin, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të ketë qenë punëtor i kësaj NSH-je, nuk dihet kur është punësuar në këtë NSH, nuk ka të dhëna tjera se kur është larguar nga puna. Për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e këtij ankuesi si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë ankues*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"punëtori përpos që u diskriminua nga menaxhmenti i NSH-së dhe nga AKP, ai u diskriminua edhe me vendimet e sipërtheksuara të Dhomës së posaçme [...] nuk u pranua në listën për 20% edhe pse pozita e tij si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik, ishte plotësisht e njëjtë me kolegët e tij të punës"*.

18. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata të vlerësojë:

> *"A është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës dhe dispozitat e KEDNJ-së, nëse një autoritet publik në këtë rast menaxhmenti i NSH "Plantacioni" AKP-ja dhe Dhoma e Posaçme, një person nuk e trajton në mënyrë të barabart me personat e tjerë nëse rrethanat faktike dhe juridike mes palëve janë tërësisht të ngjashme ose identike?*
>
> *A i është siguruar Shaban Hasanit në rastin konkret, një gjykim i drejtë dhe i paanshëm në Dhomën e Posçme e cila të drejtën e ankuesit Shaban Hasani e refuzoi derisa këtë të drejtë kolegëve të tij të punës e pranoi edhe pse ata ishin në situata plotësisht të njëjta [...]?"*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij ta qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*.

22. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi* e *pabazuar*.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

23. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i ka përmbushur kërkesat procedurale të nenit 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta e refuzuan kërkesën e parashtruesit për t'u futur në listë të punëtorëve për të marrë pjesë në 20% e të ardhurave të realizuara nga shitja e NSH "Plantacioni".

25. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*nuk u pranua në listën për 20% edhe pse pozita e tij si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik, ishte plotësisht e njëjtë me kolegët e tij [...]*".

26. Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit në mënyrë specifike ka adresuar dhe elaboruar pretendimet kryesore të parashtruesit lidhur me konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-13-0148-A0001, të 31 marsit 2016, i cili thekson "*Si rregull e përgjithshme, është që i punësuari të jetë në listën e pagave të ndërmarrjes në datën e privatizimit të saj me minimum tre vjet përvojë. Kështu një punonjës i cili nuk ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes, nga data e privatizimit nuk mund të vendoset në listën e punonjësve me të drejta legjitime [...]*".

28. Më tutje, në Aktgjykim, shtohet se "*pos deklarimit për diskriminimin, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të ketë qenë punëtor i kësaj NSH-je, nuk dihet kur është punësuar në këtë NSH, nuk ka të dhëna tjera se kur është larguar nga puna. Për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e këtij ankuesi si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë ankues".*

29. Gjykata thekson, se pakënaqësia e parashtruesit me vendimin nuk është e mjaftueshme për të ngritur një kërkesë të besueshme për shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë. Kur pretendohen shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (shih Aktvendimin për papranueshmëri, KI198/13, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2014).

30. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, ku pretendon se është diskriminuar në raport me kolegët e tij në pozitë të njëjtë.

31. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, as ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit: *Tafil Qorri i Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr.

2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

32. Prandaj, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, më 18 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI73/15 dhe KI 85/15 Parashtrues Hysni Gashi dhe Ali Rashani Vlerësim i kushtetutshmërisë se dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme Rev. nr. 346/2014, i 24 marsit 2015, i cili u është dorëzuar atyre më 5 maj 2015

KI73/15 dhe KI 85/15 Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2017 i publikuar më 20 mars 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa individuale, e drejta për punë, kërkesë qartazi e pabazuar*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës: Aktgjykimi Rev. nr. 346/2014 i 24 marsit 2015, dhe Aktgjykimi Rev. nr. 349/2014 i 3 shkurtit 2015

Objekti i çështjes së kërkesave KI73/15 dhe KI85/15 ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesve të kërkesave të garantuara me nenin 21 (Parimet e Përgjithshme), Neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Ndërkombëtare), nenin 24 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 32 (E Drejta për Mjetet Juridike) nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) dhe nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura se parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre dhe nuk kanë dëshmuar shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve nuk i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregullore të punës dhe e kanë deklaruar atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI73/15 dhe KI85/15

Parashtrues

Hysni Gashi dhe Ali Rashani

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe atë: Aktgjykimit Rev. nr. 346/2014, të 24 marsit 2015, dhe Aktgjykimit Rev. nr. 349/2014, të 3 shkurtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI73/15 është dorëzuar nga Hysni Gashi nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i parë). Ai është i përfaqësuar nga Ndue Kurti, avokat nga Prishtina.

2. Kërkesa KI85/15 është dorëzuar nga Ali Rashani nga fshati Lutogllavë, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i dytë). Ai është i përfaqësuar nga Ndue Kurti, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i parë e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 346/2014, të 24 marsit 2015, i cili i është dorëzuar më 5 maj 2015.

4. Parashtruesi i dytë e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 349/2014, të 3 shkurtit 2015, i cili i është dorëzuar më 23 mars 2015.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes së kërkesave KI73/15 dhe KI85/15 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, me të cilat, siç pretendohet, parashtruesve u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 21 (Parimet e Përgjithshme), nenin 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenin 24 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 32 (E Drejta për Mjete Juridike), nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) dhe nenin 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesat janë paraqitur në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 29 dhe 37.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10 qershor 2015, parashtruesi i parë e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 25 qershor 2015, parashtruesi i dytë e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 3 gusht 2015, në rastin KI73/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

10. Më 25 nëntor 2015, Kryetarja, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, nxori vendimin me të cilin kërkesën KI85/15 e bashkoi me kërkesën KI73/15.

11. Më 29 prill 2016, Gjykata i njoftoi të dy parashtruesit se kërkesat e tyre janë regjistruar në regjistrin gjyqësor dhe se në pajtim me Vendimin e 25 nëntorit 2015 ato janë bashkuar për shqyrtim. Gjithashtu, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme nga një kopje të kërkesave të dy parashtruesve ,.

12. Më 2 dhjetor 2016, Kryetarja nxori Vendimin për të zëvendësuar gjyqtarin Robert Carolan në Kolegjin shqyrtues, i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij në Gjykatë më 9 shtator 2016, . Gjyqtari Almiro Rodrigues u emërua kryesues i Kolegjit shqyrtues dhe gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u emërua anëtare e Kolegjit shqyrtues.

13. Më 17 janar 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në rastin KI73/15

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka pasur marrëdhënie të themeluar të punës me Hekurudhat e UNMIK-ut.

15. Më 7 shkurt 2001, Administrata e Hekurudhave të UNMIK-ut i dërgoi parashtruesit njoftimin se atij i kishte përfunduar marrëdhënia e punës.

16. Më 30 maj 2001, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Hekurudhave të UNMIK-ut për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

17. Më 26 qershor 2002, Gjykata Komunale në Prizren e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe me Aktgjykimin, C. nr. 311/2001, i urdhëroi Hekurudhat e UNMIK-ut që parashtruesin ta kthejnë në vendin e punës.

18. Në afatin ligjor e paditura (Hekurudha e UNMIK-ut) ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut ne Prizren ndaj Aktgjykimit, C. nr. 311/2001, të Gjykatës Komunale.

19. Më 9 shtator 2003, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin Ac. nr. 18/2003 ,me të cilin e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

20. Kundër këtij Aktgjykimi, Hekurudhat e UNMIK-ut paraqitën kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme.

21. Më 13 nëntor 2003, Gjykata Supreme pranoi kërkesën për revizion dhe, me Aktgjykimin, Rev. nr. 131/2003 e ktheu procedurën në Gjykatën Komunale për rivendosje. Në arsyetimin e Aktvendimit thuhet:

> *"Në shkresat e lëndës nuk ka, ashtu siç nuk përmban as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të dhëna se në çfarë baze juridike iu ka ndërprerë puna paditësit, si dhe të metat e tjera, prandaj, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në riprocedurë, me prova të nevojshme, t'i vërtetojë faktet e përmendura më sipër, dhe pas vlerësimit të drejtë të provave, të marrë një vendim të ligjshëm."*

22. Më 28 shtator 2010, Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin C. nr. 787/03 e hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit kundër Hekurudhës së UNMIK-ut si të paafatshme. Në Aktvendim thuhet: "*Nga këto prova materiale që ndodhen në shkresat e lëndës dhe faktet jokontestuese, Gjykata konstaton se kjo padi e paditësit është e paafatshme, andaj Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, njëherit duke pasur parasysh edhe dispozitat ligjore të parapara me nenin 181 të Ligjit për Punën e Bashkuar, si dhe dispozitat e nenit 83 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, - si ligj më i favorshëm për punëtorët, dhe se nga këto arsye është dashur të vendoset si në dispozitiv të këtij aktvendimi."*

23. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut ndaj Aktvendimit C. nr. 787/03, të Gjykatës Komunale.

24. Më 3 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren e aprovoi ankesën e parashtruesit dhe e prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 787/2003, të 28 shtatorit 2010. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, ndër të tjera, konstatohet si në vijim:

> *"Në dispozitiv të Gjykatës Themelore hudhet padia si e paaftshme, mirëpo nga arsyetimi dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet se në bazë të çkafit gjykata e shkallës së parë vjen në përfundim se padia e paditësit është e paafatshme.*
>
> *Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në riprocedurë të mënjanojë të metën e cekur si më lart, të vlerësojë faktin se paditësi a është vënë në lajthim e nëse po atëherë atij nuk mund të mohohet e drejta që të gëzoj mbrojtje gjyqësore si dhe të administrojë provat e nevojshme dhe pas vlerësimit të tyre të merr një vendim të ligjshëm."*

25. Më 6 prill 2012, Gjykata Komunale në Prizren nxori Aktgjykimin C. nr. 436/11, me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, gjykata tha:

> *"[...] nga faktet të cilat gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se Hekurudhat janë në regjistrin, me çka vërtetohet fakti se me Hekurudhat e Kosovës ka administruar UNMIK-u, kështu që Hekurudhat e Kosovës nuk kanë ekzistuar si subjekt afarist i pavarur.*
>
> *Nga të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike si palë e paditur nuk mund të jenë Hekurudhat e Kosovës (INFRAKOS), kurse as Hekurudhat e UNMIK-ut nuk mund të jenë palë e paditur, për shkak se me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 datë 18.08.2000, sipas të cilës*

dispozitë juridike UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuria e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor."

26. Më 18 maj 2012, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 6 prillit 2012.

27. Më 22 shtator 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin CA. nr. 3424/2012, me të cilin e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 436/11, të 6 prillit 2012 godine. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

„Me nenin 181 të Ligjit të Punës së Bashkuar („Gazeta Zyrtare e RSFJ", nr. 11/88), e që përfaqësonte ligj të zbatueshëm në Kosovë, sipas UNMIK Rregullores 1999/24 është përcaktuar: "Nëse nuk është i kënaqur me vendimin, apo organi kompetent i punëdhënësit nuk bie vendim në afat prej 15 ditësh, nga dita e ushtrimit të kërkesës, punëtori ka të drejtë që në afatin e mëtejmë prej 15 ditësh, të kërkon mbrojtjen e të drejtave para gjykatës.

Paditësi kishte të drejtë që të kërkonte mbrojtje gjyqësore brenda 15 ditësh, nga data 25.03.2001 e që do të thotë deri më datën 10.04.2001, kurse ai padinë e kishte paraqitur në gjykatë më datën 30.05.2001, e që do të thotë pas skadimit të afatit ligjor."

28. Parashtruesi në afatin ligjor paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 3424/2012.

29. Më 24 mars 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 346/2014, me të cilin e pranoi pjesërisht si të bazuar kërkesën për revizion të paditësit, ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ca. nr. 3424/2012, të 22 shtatorit 2014, me të cilin është refuzuar padia si e paafatshme, ku Gjykata Supreme vendosi se padia ishte e afatshme, ndërsa la në fuqi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, C. nr. 436/2011, të 6 prillit 2012 ku eshte vendosur qe te padituri i mungon legjitimiteti pasiv. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se të padituri i mungon legjitimiteti pasiv, nga se menjëherë pas luftës së vitit 1999, me Hekurudhat e Kosovës ka menaxhuar UNMIK-u.

Si të tilla, Hekurudhat e UNMIK-ut për shkak të statusit, privilegjeve dhe imunitetit të paraparë me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, të datës 18 gusht 2000, sipas së cilës dispozitë UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij, janë të liruara nga çfarëdo procesi gjyqësor dhe nuk mund të jenë palë në procedurë."

Përmbledhja e fakteve në rastin KI85/15

30. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka pasur marrëdhënie të themeluar të punës me Hekurudhat e UNMIK-ut.

31. Më 7 shkurt 2001, Administrata e Hekurudhave të UNMIK-ut i dërgoi parashtruesit njoftimin se atij i kishte përfunduar marrëdhënia e punës.

32. Gjatë vitit 2001, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Hekurudhave të UNMIK-ut për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

33. Më 28 maj 2002, Gjykata Komunale në Prizren aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe me Aktgjykimin C. nr. 317/2001 i urdhëroi Hekurudhat e UNMIK-ut që parashtruesin ta kthejnë në vendin e punës.

34. Në afatin ligjor e paditura paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut ndaj Aktgjykimit C. nr. 317/2001, të Gjykatës Komunale.

35. Më 31 tetor 2002, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin Ac. nr. 229/2002, me të cilin e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren.

36. Kundër këtij Aktgjykimi, Hekurudhat e UNMIK-ut paraqitën kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme.

37. Më 1 prill 2003, Gjykata Supreme e aprovoi kërkesën për revizion të të padituërës dhe me Aktgjykimin Rev. nr. 22/2003 e ktheu procedurën në Gjykatën Komunale për rivendosje. Në arsyetimin e Aktvendimit konstatohet:

> *"Në shkresat e lëndës nuk ka, sikurse as në aktgjykimin e shkallës së parë, të dhëna përkitazi me statusin e paditësit si punëtor - a ka qenë paditësi i punësuar në kohë të pacaktuar, a ishte sistemuar përkohësisht me vendimin e organit kompetent të ndërmarrjes Hekurudhat e Kosovës apo punonte me kontratë.*
>
> *Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në riprocedurë t'i vërtetojë me provat e nevojshme faktet e përmendura më sipër dhe pas vlerësimit të drejtë të provave, të marrë një vendim të ligjshëm."*

38. Më 28 shtator 2010, Gjykata Komunale nxori Aktvendimin C. nr. 656/02, me të cilin e hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të pavlefshme, me arsyetimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit kohor.

39. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren ndaj Aktgjykimit C. nr. 656/02, të Gjykatës Komunale.

40. Më 3 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktgjykimin Ac. nr. 672/2010, me të cilin e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 656/2002, të 28 shtatorit 2010 dhe e ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje. Gjykata e Qarkut, bazoi Aktgjykimin e saj në arsyetimin se: "*[...] në dispozitiv hidhet padia si e paafatshme, mirëpo nga arsyetimi dhe provat që gjinden në shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet se në bazë të çkafit gjykata e shkallës së parë vjen në përfundim se padia e paditësit është e paafatshme."*

41. Më 6 prill 2012, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin C. nr. 437/11, me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar, bazuar në arsyetimin se *"Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes në padi, shkresave të tjera të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, konform nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, për shkak të mungesës së legjitimacionit real pasiv të të padituërës. [...] Hekurudhat e UNMIK-ut nuk mund të jenë palë e paditur, për shkak se me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 datë 18.08.2000, sipas të cilës dispozitë juridike UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuria e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor."*

42. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit C. nr. 437/11, të Gjykatës Komunale.

43. Më 22 tetor 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin CA. nr. 3425/2012, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 437/11, të Gjykatës Komunale, me këtë arsyetim:

> *"Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka konstatuar gjendjen faktike kur ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e [Parashtruesit] është e pabazuar, por fakt vendimtar ishte se ai me të padituren kishte lidhur kontratë tjetër të punës me ç'rast në kuptim të nenit 11 të Ligjit të lartë cituar me marrëveshjen me shkrim e ka përfunduar marrëdhënien e punës për vendin e punës të kërkuar në kërkesëpadinë e tij të paraqitur më 04.06.2001, e të cilën nuk e kishte ndryshuar deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor."*

44. Në afatin ligjor parashtruesi paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit CA. nr. 3425/2012, të Gjykatës së Apelit.

45. Më 3 shkurt 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 349/2014, me të cilin kërkesa për revizion e paditësit refuzohet si e pabazuar. Në konkluzionin e Aktgjykimit thuhet: "*Duke u nisur nga këto që u thanë më lart, mund të përfundohet se në këtë çështje juridike palë e paditur nuk mund të jenë Hekurudhat e Kosovës, kurse as Hekurudhat e UNMIK-ut, për shkak të statusit, privilegjeve dhe imunitetit të paraparë me nenin 3.1. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 datë 18 gusht 2000 sipas të cilës dispozitë juridike, UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij, janë të liruara nga çfarëdo procesi gjyqësor.*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

46. Pretendimet e parashtruesit të parë dhe të dytë janë identike, prandaj Gjykata i prezanton ato së bashku, si pretendime të njëjta.

47. Të dy parashtruesit pretendojnë se hekurudha, prona e saj dhe punëtorët e saj nuk janë pronë e UNMIK-ut, por që ato kanë ekzistuar edhe para themelimit të UNMIK-ut dhe se UNMIK-u i ka 'gjetur' Hekurudhat në Kosovë pas arritjes së tij. Për shkak të këtyre fakteve, Gjykata Supreme ka konstatuar gabimisht që Hekurudhat e Kosovës nuk mund të jenë palë e paditur, konform nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të Personelit të tyre (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut), Me këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme ka bërë shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

48. Gjithashtu, të dy parashtruesit pretendojnë se me këtë interpretim të Rregullores së UNMIK-ut u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 21 (Parimet e Përgjithshme), nenin 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenin 24 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 32 (E Drejta për Mjete Juridike), nenin 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) dhe nenin 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

49. Të dy parashtruesit i kërkojnë Gjykatës të:

> *"a) deklarojë që kërkesat e të dy parashtruesve të shpallen të pranueshme,*
>
> *b) të konstatohet se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese siç janë theksuar më lart,*

c) të shpallen të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, si në rastin e parashtruesit të parë Aktgjykimi Rev. nr. 346/2014, edhe në rastin e parashtruesit të dytë Aktgjykimi Rev. nr. 349/2014."

Ligji relevant

50. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/47 për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të Personelit të tyre në Kosovë.

Neni 3. Statusi i UNMIK-ut dhe i personelit të tij

"UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor."

Pranueshmëria e kërkesës

51. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesat e të dy parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

52. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7të nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

53. Gjithashtu, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

54. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."

55. Në kërkesat konkrete, Gjykata vëren se procedurat e të dy parashtruesve kanë filluar qysh në vitin 2001 me paraqitjen e kërkesëpadisë kundër Hekurudhave të UNMIK-ut, si palë e paditur, për kthimin në vendin e punës ku kanë punuar, dhe se këto procedura kanë përfunduar në vitin 2015, me aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të cilat kontestohen nga parashtruesit.

56. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në të dyja rastet ka vendosur mbi bazat e njëjta, duke u mbështetur në interpretimin e saj se sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, Hekurudhat e UNMIK-ut nuk mund të jenë palë të paditura në çështje të marrëdhënies së punës, sepse kanë imunitet nga paditë gjyqësore.

57. Në bazë të kësaj, Gjykata gjen se pretendimet e të dy parashtruesve për aplikimin e gabuar dhe interpretimin jokonsistent nga gjykatat e rregullta të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, kanë të bëjnë me çështjen e interpretimit dhe kualifikimit të dispozitave ligjore, që bie në fushëveprimin e juridiksionit të gjykatave të rregullta (ligjshmëria) dhe nuk bien në domenin e Gjykatës Kushtetuese (kushtetutshmëria).

58. Lidhur me këtë, Gjykata referohet në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), ku është qartësuar se *"është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale" (Shih, mutatis mutandis,* Aktgjykimin e Gjykatë Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *García Ruiz v. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28.*

59. Gjykata Kushtetuese ndërhyn vetëm atëherë kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e rregullta cenojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, apo ri—interpretim të ligjeve, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të rregullt.

60. Rrjedhimisht, roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë e proceseve gjyqësore me standardet dhe të drejtat që garantohen me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ të 16 shtatorit 1996 *Akdivar v. Turkey,* nr. 21893/93, paragrafi 65. Shih, po ashtu, *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

61. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* në mbështetje të kërkesës së tyre dhe nuk i kanë arsyetuar pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

62. Gjykata konsideron se kërkesat e parashtruesve nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, me neni 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (d) dhe (2) (b) si dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI50/16: Parashtrues: Veli Berisha dhe të tjerët, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.276/2015, të tetorit 2015

KI50/16, Aktvendim për papranueshmëri i 14 korrikut 2016, i publikuar më 20 mars 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, aktvendim për papranueshmëri, kërkesë e pabazuar*

Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës, kanë parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Suharekë me kërkesë që Gjykata të vërtetojë pronësinë mbi ngastrat kadastrale të theksuara si në padi, duke kërkuar që ata të shpallen bashkëpronarë me 1/3 e paluajtshmërisë. Me 30 tetor 2012, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktgjykimin C.nr.302/12, ka refuzuar kërkesëpadinë. Me 27 nëntor 2012, parashtruesit paraqiten ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren për shkak të shkeljes esenciale të procedurës civile, të verifikimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me 1 qershor 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin Ac. nr./4973/2012, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C.nr.302/2012, të 30 tetorit 2012. Më 14 tetor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev.nr.276/2015, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtrueseve, konstatoi se nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih, rasti *Fc Metrebi kundër Gjeorgjisë*, par. 31, Aktgjykimi i GJENDJ-se, i 31 korrikut 2007), e që gjykuar sipas rrethanave të rastit qëllimi primar i parashtruesve duket të ketë qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese e Kosovës po ashtu vlerësoi se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe te paanshëm dhe të drejtës së pronës, andaj në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (b) dhe (d), gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI50/16

Parashtrues

Veli Berisha dhe të tjerët

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 276/2015, të 14 tetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Veli Berisha, Muhamet Berisha dhe Adem Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit) nga Suhareka, të përfaqësuar nga avokati z. Zef Delhysa.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 276/2015, i 14 tetorit 2015, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 14 nëntor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), me nenin 46 (Mbrojtja e Pronës), me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

4. Parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar të mos u zbulohet identiteti pa shpjeguar arsyet për këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 mars 2016, nëpërmjet postës, parashtruesit e dërguan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan, Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 3 maj 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe Gjykatës Supreme i dërgoi një kopje të kërkesës.

9. Më 11 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, zëvendësoi panelin gjyqësor me ç 'rast gjyqtarja Snezhana Botusharova u emërua kryesuese e panelit gjyqësor duke zëvendësuar gjyqtarin Robert Carolan.

10. Më 14 korrik 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 maj 1953, babai i parashtruesve, Rr. N., me vendim të Rrethit Popullor të Suharekës, i është ekspropriuar një sipërfaqe toke për nevojat e ndërtimit të një çerdheje publike për fëmijë.

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës, në cilësi të pasardhësve të Rr. N., kanë parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Suharekë, me kërkesën që Gjykata të vërtetojë pronësinë mbi ngastrat kadastrale të theksuara si në padi, duke kërkuar që ata të shpallen bashkëpronarë me 1/3 e paluajtshmërisë.

13. Më 30 tetor 2012, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktgjykimin C. nr. 302/12, ka refuzuar kërkesëpadinë.

14. Gjykata Komunale në aktgjykimin e vet, ndër të tjera, ka theksuar: "*Nga ekspertiza gjeodete është provuar fakti se ngastra e ekproprijuar nga Rrustem Berisha e përshkruar në aktvendimin për ekproprijim, me formimin e operatorit të ri kadastral të vitit 1959, e që ka hyrë në fuqi në vitin 1965, është evidentuar sipas fletës poseduese nr. 409 dhe 410 si ngastra katastrale 1992, 1992, 1993, 1994, 1995, 1996 dhe 1998 si pasuri shoqërore Komuna e Suharekës përkatësisht Shtëpia e Shëndetit ZK Suharekë...*" dhe, më pastaj, *"pasi që ekziston vendimi për shpronësim (ekproprijim) dhe vendimi për kompensim të paluajtshmërisë së pronësuar gjykata vlerësoi se e paditura është pronare me vendim të organit shtetëror në bazë të nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit themelor të marrëdhënieve juridiko pronësore, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit"*.

15. Më 27 nëntor 2012, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren për shkak të lëndimit esencial të procedurës civile, të verifikimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 1 qershor 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin Ac. nr./4973/2012, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 302/2012, të 30 tetorit 2012.

17. Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e vet, arsyetoi: *"Kjo gjykatë, duke vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i*

drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozitat ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë". Ndërsa, lidhur me pretendimet e parashtruesve, gjykata vlerësoi: *"Pretendimet ankimore të paditësve, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata* e *shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare".*

18. Më 14 tetor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 276/2015, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke theksuar, ndër të tjera: *"Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, se aktgjykimi i goditur dhe ai gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, se gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës kanë pretenduar se procedura e eksproprijimit të palujatshmërisë së paraardhësit të tyre ka qenë në kundërshti të plotë me ligjin dhe me plot parregullsi, se ndaj paraardhësit të ndjerë të parashtruesit është ushtruar dhunë policore dhe se ai nuk ka marrë kurrë kurrfarë kompensimi për pronën e eksproprijuar, ndërsa gjykatat e rregullta, me refuzimin e padisë, pasardhësve të tij (parashtruesve), i kanë mohuar të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe i kanë privuar nga e drejta e pronës të cilën, po të kishin një gjykim të drejtë, do ta gëzonin në bazë të trashëgimisë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Më tej, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

23. Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"1. Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi* e *pabazuar.*
>
> dhe

2. Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

24. Gjykata konstaton se parashtruesit kanë pretenduar se me vendimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat kanë përmbajtjen si në vijim:

Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[.....]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

[.....]

25. Duke vlerësuar pretendimet e parashtruesve për shkelje kushtetuese, Gjykata konstaton se ato janë mbështetur në "*konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gjegjësisht vlerësimin e gabuar të provave të prezantuara nga parashtruesit nga ana e gjykatave të rregullta*".

26. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se nuk është kompetencë e saj që me vlerësimin vetjak të fakteve të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga ana e gjykatave të rregullta, sepse sipas rregullave të përgjithshme është detyrë e atyre gjykatave të vlerësojnë faktet të cilat gjenden para tyre (Shih rastin KI47-48/15, Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-14-0057, të 12 marsit 2015, parashtrues *Beqir Kosokoviku e Mustafë Lutolli*), ndërsa detyrë e kësaj gjykate është të vlerësojë nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm ashtu siç kërkohet me nenin 6 (Shih, ndër të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar,* 16 dhjetor 1992., f. 34, seria A, nr. 247 dhe B . *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A, nr. 235).

27. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (Shih, rasti *Fc Metrebi v Georgia,* par. 31, Aktgjykimi i GJENDJ-së, i 31

korrikut 2007), e që gjykuar sipas rrethanave të rastit qëllimi primar i parashtruesve duket të ketë qenë pikërisht kontestimi i rezultatit të procesit gjyqësor.

28. Asgjë në rastin e prezantuar nga ana e parashtruesve nuk provon se procesi gjyqësor si tërësi, në rastin konkret, ka qenë i padrejtë apo arbitrar në mënyrë që Gjykatën ta bindë se është cenuar esenca e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

29. Bazuar në sa u tha më lart, i ka takuar gjykatave të rregullta të vlerësojnë nëse eksproprijimi i paluajtshmërisë kontestuese ishte bërë në përputhje me ligjin apo jo dhe kjo çështje ishte trajtuar në tri instanca gjyqësore duke marrë një epilog përfundimtar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

30. Gjykata më tej konstaton se Gjykata Supreme gjithashtu kishte arsyetuar plotësisht aktvendimin e saj lidhur me revizionin, duke sqaruar në mënyrë të detajuar se pse kërkesa për revizion është e pabazuar, duke argumentuar qartazi aplikimin e ligjit në fuqi dhe konstatimin e gjendjes faktike dhe atë duke vlerësuar njëkohësisht edhe vendimet gjyqësore të instancave më të ulëta gjyqësore në kuadrin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesit.

31. Sa i përket pretendimit tjetër të parashtruesve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës], Gjykata konstaton se në paragrafin 1, të nenit 46, në mënyrë të përgjithshme Kushtetuta e garanton atë, në paragrafin 2 Kushtetuta përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës duke specifikuar qartë se kjo parashihet në bazë të ligjit dhe, në paragrafin 3, ka përcaktuar mënyrën e deprivimit nga prona.

32. Nga sa u tha më lart, është tërësisht e qartë se Kushtetuta i referohet një prone ekzistuese dhe nuk parasheh në nenin 46 (që kontestohet nga parashtruesit) të drejtën e fitimit të pronës.

33. Gjykata me këtë rast vë në dukje se, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriu*", andaj, duke qenë se "*Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës"* (neni 112 i Kushtetutës), edhe Gjykata kur vendos për kërkesat që kanë objekt shqyrtimi shkeljen eventuale të drejtave të njeriut domosdo i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në rastin *Marckx kundër Belgjikës* lidhur me të drejtën e pronës (GJEDNJ në aktgjykimin e saj), ndër të tjera, kishte theksuar se Gjykata pranoi që neni 1 i Protokollit 1 që mishëron të drejtën e secilit për respektimin e pasurisë së tij "*nuk e garanton të drejtën për të marrë pasuri me anë të trashëgimisë apo shprehjes së një vullneti me pasoja juridike pasurore"* (Shih *Marckx kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 6833/74, e 13 qershorit 1979), pra është tërësisht e qartë se as Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut (KEDNJ), në nenin 1 të Protokollit 1 të saj, kur i referohet të drejtës së pronës nuk e garanton të drejtën në fitimin e pronës (pasurisë), sepse çështja e fitimit të pronësisë rregullohet me ligj dhe kontestet eventuale zgjidhen në gjykatat e rregullta.

35. Në këto rrethana të rastit, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, gjegjësisht nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së [E drejta e pronës], sepse parashtruesit nuk kishin një pronë ekzistuese, nuk e shfrytëzonin atë dhe nuk ishin deprivuar në mënyrë të kundërligjshme nga prona, gjë që gjykatat e rregullta në tri instanca gjykimi edhe e kishin konstatuar qartë.

36. Gjykata gjithashtu refuzon kërkesën për moszbulim të identitetit, sepse parashtruesit nuk kishin paraqitur asnjë arsye të vetme apo fakt që do ta mbështeste këtë kërkesë.

37. Bazuar në atë që u përmend më lart, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës së pronës, andaj në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (b) dhe (d), gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 14 korrik 2016, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI124/16, Parashtrues i kërkesës Senad Rama, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. I. Nr. 1802/2016, të 13 tetorit 2016

KI 124/16, 2017 Aktvendim për papranueshmëri i 18 janarit 2017, i publikuar më 20 mars 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesë individuale, arrest shtëpiak, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore PPr.Kr. Nr. 174/2016 për të vazhduar arrestimin shtëpiak për parashtruesin e kërkesës për një (1) muaj. Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN I. nr. 1802/2016 i 13 tetorit 2016), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, në Gjykatën Kushtetuese, në mes tjerash se Gjykata e Apelit, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e tij kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore për vazhdimin e arrestimit të tij shtëpiak, kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri], dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata vlerësoi se parashtruesi nuk e ka mbështetur mjaftueshëm kërkesën e tij se përse u shkelën dispozitat e mësipërme të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata e deklaroi kërkesën e parashtruesit si të papranueshme si qartazi të pabazuar siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç përcaktohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI124/16

Parashtrues

Senad Rama

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. I. Nr. 1802/2016, të 13 tetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Senad Rama, nga Gjilani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN. I. Nr. 1802/2016 të 13 tetorit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj parashtruesit të kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 31 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

7. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 1 dhjetor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

9. Më 19 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

10. Më 18 janar 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 5 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës ishte arrestuar dhe ishte vendosur në paraburgim për 48 orë, nën dyshimin se ka kryer veprat penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe të falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

12. Më 6 shtator 2016, Prokurori kërkoi nga Gjykata Themelore (PP. I. Nr. 66/2016) që të vendosë masën e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës.

13. Më 7 shtator 2016, Gjykata Themelore (Aktvendimi PPr. Kr. Nr. 174/2016) e refuzoi kërkesën e prokurorit për vendosje të paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe urdhëroi në vend të tij arrestin shtëpiak në kohëzgjatje prej një (1) muaji dhe konfiskimin e pasaportës së tij.

14. Më 29 shtator 2016, Prokurori kërkoi (PP. I. Nr. 66/2016) nga Gjykata Themelore që të vazhdojë arrestin shtëpiak e parashtruesit të kërkesës.

15. Më 4 tetor 2016, Gjykata Themelore (Aktvendimi PPr. Kr. Nr. 174/2016) e aprovoi kërkesën e prokurorit për vazhdimin e arrestit shtëpiak deri më 4 nëntor 2016.

16. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj këtij Aktvendimi, *"për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-së [Kodi i Procedurës Penale i Kosovës]"*.

17. Më 13 tetor 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN. I. Nr. 1802/2016) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

19. Parashtruesi i kërkesës thekson se prokurori nuk ka ofruar dëshmi se *"për dyshimin e bazuar që [parashtruesi i kërkesës] të ketë kryer vepër penale sipas nenit 422 dhe 434 [...]. Mirëpo, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është i nevojshëm arsyetimi i bazuar për kufizimin e të drejtës time në liri."*

20. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"Procedura e hetimeve nga ana e prokurorit po zvarritet dhe në këtë mënyrë arresti shtëpiak panevojshëm zgjatet, çka bie ndesh me nenin 5 [Gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm], parag. 3 të KPPK [Kodi i Procedurës Penale i Kosovës]."*

21. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta ndërprenë arrestin shtëpiak dhe të caktojë ndonjë mase më të butë, si dhe të konstatojë nëse janë shkelur të drejtat për liri dhe trajtim të barabartë.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës të cilët përcaktojnë:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

24. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

25. Përveç kësaj, Gjykata rikujton paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës të cilët parashohin:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me vendimin e kontestuar ishin shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë, kryesisht me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë].

27. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës e konteston interpretimin juridik të Gjykatës së Apelit lidhur me vendosjen e arrestit të tij shtëpiak dhe mënyrën në të cilën ata aplikuan dispozitat procedurale dhe të drejtën materiale.

28. Gjykata vëren se dy instancat e gjykatave të rregullta kishin vlerësuar faktet dhe kishin interpretuar dhe zbatuar dispozitat e së drejtës procedurale dhe materiale në lidhje me dyshimin e bazuar se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprat penale për të cilat është

akuzuar. Përfundimi i tyre është arritur pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga prokurori dhe parashtruesi i kërkesës.

29. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit para Gjykatës të njëjtat argumente që i kishte paraqitur në procedurën para gjykatave të rregullta, në veçanti, në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta.

30. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

31. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

32. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih po ashtu, Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

33. Me fjalë të tjera, vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i drejtë i ligjit është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë).

34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore [Aktvendimi PPr. Lr. nr. 174/2016 i 4 tetorit 2014] arsyetoi vendimin e saj për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak si në vijim:

> *"[...] duke e marrë për bazë natyrën dhe peshën e veprave penale për të cilat dyshohet [parashtruesi i kërkesës], si dhe faktin se prokurori i shtetit nuk ka arritur që ta marr në pyetje edhe [parashtruesin e kërkesës], dhe për shkak të hetimeve të ndërlikuara ende janë në grumbullimin e provave materiale, gjë që dyshohet se edhe personat tjerë kanë kryer vepra penale me [parashtruesin e kërkesës], që do të thotë se hetimet në këtë qështje penale janë në zhvillim e sipër, atëherë duke marrë për bazë, të gjitha këto me të vërtetë ekziston rreziku real që poqese i njëjti do te gjendet ne liri të plotë ai do të mund të asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale, si dhe do të mund të pengoj rrjedhën e procedurës penale."*

35. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit e arsyetoi vendimin e saj si në vijim:

> *"[...] ekziston dyshimi i bazuar se [parashtruesi i kërkesës] e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet, në bazë të aktvendimit për fillimin e hetimeve, me çka vërtetohet nga raporti i policisë si dhe nga deklaratat e dhëna. Gjykata e shkallës parë ka dhëne arsye të mjaftueshme dhe ka vepruar drejt kur i ka vazhduar masën e arrestit shtëpiak [parashtruesit të kërkesës] në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj, sipas nenit 183 par. 1 nënpar. 1.1 e 1.2 të KPPK-së, duke pas parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ekziston rreziku se me gjetjen e mundshme të të pandehurit në liri, i njëjti mund të përsëris veprën penale të njëjtë të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale apo të arratiset pasi është shtetas i Austris dhe mund të pengon rrjedhën normale të procedurës.*

[...]
Duke pasur parasysh rrethanat e lartpërmendura, kjo [Gjykata e Apelit] konsideron se masat tjera të parapara me nenin 173 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së [parashtruesit të kërkesës] dhe për parandalimin e përsëritjes së veprave penale me qëllim të zbatimit me sukses të procedurës penale, prandaj ankesa e mbrojtësit të [parashtruesit të kërkesës] u refuzua si e pabazuar."

36. Gjykata më tej vëren se gjykatat e rregullta kanë vlerësuar *"aktvendimin për fillimin e hetimeve, raportin e policisë dhe deklaratat e dhëna"* kur kanë konkluduar se ekziston "*dyshimi i bazuar se [parashtruesi i kërkesës] e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet."*

37. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetimin për të justifikuar ekzistencën e fakteve apo informatave që do të bindnin një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale (Shih, *mutatis mutandis,* rasti i GJEDNJ-së *Fox, Campbell dhe Hartley* kundër Mbretërisë së Bashkuar nr. 12244/86; 12245/86, 12383/86, Aktgjykim i i 30 gushtit 1990).

38. Gjykata thekson se detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (çështje e kushtetutshmërisë) (shih: *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009, paragrafi 16; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 34; *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68).

39. Gjykata konsideron se vendimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit ishin të arsyetuara dhe të drejta kur ishte vendosur për vazhdimin e arrestit shtëpiak dhe, prandaj, nuk mund të thuhet se nuk kanë qenë të arsyetuara në pajtim me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri] të Kushtetutës (shih: *mutatis mutandis,* rasti i GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë,* nr. 72508/13, Aktgjykim i 14 qershorit 2016, para 87).

40. Gjykata në fund vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij për barazi para ligjit, për liri dhe siguri dhe për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

41. Prandaj Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

42. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (d), si dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Arta Rama-Hajrizi

KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017

KI34/17, Vendim për masë të përkohshme i 27 marsit 2017, publikuar më 28 mars 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, e drejta për zgjedhje, pozitë e Kryetarit të Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

Në këtë rast parashtruesja e kërkesës u ankua se e drejta e saj për zgjedhje ishte cenuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ngase nuk ishte emëruar në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kërkoi caktimin e masës së përkohshme.

Duke marrë parasysh rëndësinë e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe interesin e administrimit të duhur të sistemit të drejtësisë, Gjykata konsideroi se ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik në kuptim të nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 55 paragrafi (4) pika (c) të Rregullores së punës, që justifikojnë miratimin e masës se përkohshme.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KI34/17

Parashtrues

Valdete Daka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJK nr. 50/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 6 marsit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Valdete Daka, të cilën e përfaqëson avokati Artan Qerkini nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK, nr. 50/2017, të 6 marsit 2017 (në tekstin e mëtejmë: KGJK).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartcekur të KGJK-së, me të cilin, sipas parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesja kërkon nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme dhe pezullimin e dekretimit të z. Enver Peci për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme deri në vendimin e Gjykatës lidhur me këtë kërkesë.

5. Parashtruesja gjithashtu kërkon nga Gjykata të urdhërojë mbajtjen e një seance dëgjimore në përputhje me rregullin 39 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 16 mars 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 17 mars 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

10. Gjykata ftoi KGJK-në të paraqesë komentet e saj, nëse ka, deri më 23 mars 2017.

11. Më 23 mars 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj në Gjykatë.

12. Më 23 mars 2017, komentet e KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe u ftua që të paraqesë komente shtesë deri më 5 prill 2017.

13. Më 27 mars 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandojë Kolegjit shqyrtues miratimin e masës së përkohshme.

14. Në të njëjtën datë, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme.

15. Në të njëjtën datë, Kolegji shqyrtues vendosi njëzëri ta miratojë masën e përkohshme deri më 16 maj 2017.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 8 dhjetor 2016, KGJK-ja mori Vendimin KGJK nr. 152/2016 për shpalljen e pozitës së lirë për Kryetar të Gjykatës Supreme.

17. Më 23 dhjetor 2016, u shpall konkursi për këtë pozitë. Parashtruesja e kërkesës aplikoi në këtë konkurs dhe u regjistrua në rrethin e vlerësimit të kandidatëve.

18. Më 13 janar 2017, KGJK-ja caktoi Komisionin për Vlerësim dhe Intervistim të kandidatëve.

19. Më 13 shkurt 2017, u mbajtën intervistat dhe Komisioni vlerësoi kandidatët si në vijim:

1.	Valdete Daka	90 pikë
2.	Nesrin Lushta	87.3 pikë
3.	Enver Peci	85 pikë
4.	Erdogan Haxhibeqiri	83 pikë

20. Më 6 mars 2017, KGJK-ja me Vendimin KGJK Nr. 50/2017, pas tri raundesh votimi, zgjodhi që Enver Peci të emërohet Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe e dërgoi propozimin te Presidenti i Republikës së Kosovës për dekretim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: *"Në procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ka pasur parregullsi të cilat reflektojnë në cenimin e të drejtave të propozueses të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe atë, inter alia, të drejtën e përcaktuar në nenin 45, sipas të cilit secili qytetarë i Republikës së Kosovës ka të drejtën aktive (të drejtën të zgjedhë) dhe të drejtën pasive të votës (të drejtën për t'u zgjedhur)."*

22. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të shqyrtojë se *"A i është cenuar e drejta kushtetuese e garantuar me Nenin 45, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si rezultat i zbatimit të gabuar të Rregullores së KGJK-së për përzgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës."*.

23. Parashtruesja e kërkesës deklaron se *"[...] nuk kërkon nga Gjykata Kushtetuese të deklarohet në lidhje me mënyrën e interpretimit të Nenit 4 të Rregullores në fjalë [...]"*, por, *"[...] kërkon të konstatojë se zbatimi i gabuar i saj, ka cenuar të drejtat kushtetuese të parashtrueses së kërkesës [...]"*.

24. Sipas parashtrueses së kërkesës, bazuar në Rregulloren e përmendur më lart, KGJK-ja së pari votoi për kandidatin i cili kishte marrë më së shumti pikë në vlerësim; në rastin konkret për të. Në atë votim, pesë (5) anëtarë votuan "PËR", katër (4) anëtarë "ABSTENUAN", ndërsa një (1) anëtar votoi "KUNDËR".

25. Gjithashtu, ajo thekson se "*Sipas vlerësimit të KGJK-së kandidatja e parë nuk ka marrë shumicën e thjeshtë të votave, prandaj është vazhduar me procedurën e votimit për dy kandidatët e mbetur. Kandidati i renditur si i treti, z. Enver Peci, pas votimit të anëtarëve të KGJK-së ka marrë "PËR" gjashtë (6) vota dhe "KUNDËR" katër (4) vota"*.

26. Parashtruesja e kërkesës vëren se "*Përfundimisht sipas vlerësimit të KGJK-së z. Enver Peci është propozuar për përzgjedhje në postin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas mënyrës së përshkruar më lartë. Vlen të potencohet se lista për përzgjedhjen e kandidateve ka karakter shterues, çka do të thotë se në rastin kur kandidati i parë merr shumicën e thjeshtë të votave, votimi përfundon dhe për kandidatët e tjerë nuk votohet fare"*.

27. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"procedura e përzgjedhjes është përfshirë në shkelje të paragrafit 2 të nenit 8 të Rregullores Nr. 9/2016, të riformuluar me nenin 4 të Rregullores Nr. 14/2016 të KGJK-së"*.

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"*në *asnjë rast abstenimi nuk mund të konsiderohet si votë negative apo kundër sepse atë efekt e ka vota KUNDËR dhe nuk mund të barazohet vota Abstenim dhe Kundër. Abstenimi nënkupton vullnetin e anëtarëve për ta krijuar kuorumin dhe mundësimin e zhvillimit te procedurës, për mos-pjesëmarrje në votim dhe pajtim me vendimin e anëtarëve tjerë*."

29. Ajo më tutje thekson se "*fokusi duhet përqendruar te interpretimi juridik dhe logjik i shprehjes së vullnetit të KGJK-së si organ kolegjial i vendimmarrjes. Në rastin konkret, gjatë votimit 5 anëtarë kanë shprehur vullnetin PRO përzgjedhjes së kandidates ndërsa vetëm 1 votë ka qenë KUNDËR, andaj duhet të shtrohet pyetja se mbi çfarë logjike është ardhur deri te konstatimi se KGJK ka shprehur vullnetin kundër kandidaturës së kandidates Valdete Daka"*.

30. Parashtruesja e kërkesës përfundimisht konsideron se *"për shkak të shkeljeve të lartcekura, në këtë procedurë të përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme,*

kandidates i janë shkelur edhe të drejtat e garantuara me nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës".

Kërkesa për masë të përkohshme

31. Parashtruesja kërkon nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 54 të Rregullores së punës.

32. Parashtruesja e kërkesës konsideron se *"zbatimi i vendimit të KGJK-së, që përmban në vete një mori shkeljesh të të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë, do të ishte në vetvete edhe një cenim i mëtutjeshëm i të drejtave të garantuara. Vet zbatimi i këtij vendimi antikushtetues do të privonte ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e funksionimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të gjitha vendimet e marra nën drejtimin e z. Enver Peci do të mund të shpalleshin si të kundërligjshme, fakt ky i cili cenon parimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës. Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte zgjedhjen time për Kryetare të Gjykatës Supreme të Kosovës vendimet unifikuese të Gjykatës Supreme të marra nën drejtimin e z. Peci, e të cilat merren me qëllim të zbatimit unik të ligjeve, do të konsideroheshin si të pavlefshme".*

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

33. Në vlerësimin e kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës që përcakton:

> "*[...] 2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme. [...]"*

35. Gjithashtu, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit që parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*
>
> *2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale."*

36. Në fund, Gjykata rikujton rregullin 55, paragrafët 4 dhe 5, të Rregullores së punës që specifikojnë se:

Rregulli 55 (4) i Rregullores së punës

> *"4. [...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të paripareushme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik".

[...] Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës (fragment)

5. [...] Nuk mund të merret vendim për masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. [...]"

37. Duke marrë parasysh rëndësinë e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe interesin e administrimit të duhur të sistemit të drejtësisë, Gjykata konsideron se ka arsye substanciale të natyrës së interesit publik në kuptim të nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 55, paragrafi 4, pika (c) të Rregullores së punës, që justifikojnë miratimin e masës së përkohshme.

38. Prandaj, pa paragjykim ndaj vendimeve të tjera që do të nxirren nga Gjykata lidhur me pranueshmërinë ose meritat e kërkesës, në të ardhmen, Gjykata konkludon se kërkesa për masë të përkohshme duhet të miratohet në mënyrë që të mbrohet interesi publik.

39. Gjykata vendosë që, në përputhje me nenin 27 (2) të Ligjit dhe rregullin 55 (5) të Rregullores së punës, kohëzgjatja e masës së përkohshme të jetë deri më 16 maj 2017.

40. Masa e përkohshme do të skadojë menjëherë nëse Gjykata vendosë se kërkesa është e papranueshme, në përputhje me rregullin 55 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit dhe rregullave 54 dhe 55 të Rregullores së punës, më 27 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TË VENDOSË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 16 maj 2017 nga data e miratimit të këtij vendimi;

II. TË PEZULLOJË MENJËHERË procedurën e emërimit të kandidatit për Kryetar të Gjykatës Supreme nga Presidenti i Republikës së Kosovës përgjatë kësaj kohëzgjatjeje;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe Presidentit të Republikës së Kosovës;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Arta Rama-Hajrizi

KI31/17, Parashtrues: Shefqet Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM. Nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016

KI31/17, Vendim për masë të përkohshme i 27 marsit 2017, publikuar më 28 mars 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë për masë të përkohshme*

Në këtë rast parashtruesi i kërkesës kontestoi dy vendime të gjykatave të rregullta që kishin refuzuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në njërën anë, dhe caktimin e masës së sigurisë ndaj pronës së tij në anën tjetër. Parashtruesi u ankua për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe cenim të pasurisë së tij për shkak të masës së sigurisë që ishte caktuar ndaj asaj pasurie.

Gjykata verën se mund të ketë dëm potencial të pariparueshëm për të drejtën e parashtruesit në pronë si pasojë e shkeljes së vazhdueshme të pretenduar të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesit për caktimin e masës së përkohshme deri në marrjen e vendimit përfundimtar të këtij rasti.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KI31/17

Parashtrues

Shefqet Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shefqet Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme CML nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016.

3. Vendimi i lartpërmendur kontestohet në lidhje me Aktvendimin PPP.Nr.1216/15, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 21 nëntorit 2016; Aktvendimin Ac. nr. 1347, të Gjykatës së Apelit, të 24 prillit 2016; Aktgjykimin Rev. Nr. 50/2016, të Gjykatës Supreme, të 4 prillit 2016; Aktvendimin C. Nr. 2929/2015, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 15 shkurtit 2016; Aktgjykimin Ac. Nr. 401/204, të Gjykatës së Apelit, të 26 tetorit 2015 dhe Aktgjykimin C. Nr. 162/09, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 tetor 2013.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura të cilat pretendohet se ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

5. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme ndaj Aktgjykimit C.nr. 162/09 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 tetorit 2013, dhe të stopohet çdo procedurë gjyqësore, procedurë përmbarimore, veprim apo vendim i autoriteteve publike që buron nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Objekt i aktgjykimit të lartcekur dhe i procedurave përmbarimore që pasuan është konfiskimi i pronës private të parashtruesit të kërkesës dhe i pensionit invalidor që është i nevojshëm për trajtimin e tij mjekësor.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 10 mars 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 22 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI31/17, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI31/17, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).

10. Më 22 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 27 mars 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Gjykatës miratimin e Masës së përkohshme. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi me shumicë votash ta miratojë Masën e përkohshme deri më 20 qershor 2017.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

12. Më 2 shkurt 2009, paditësi K.Sh. parashtroi padi në ish Gjykatën Komunale në Prishtinë duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të detyrohet t'ia paguajë shumën prej € 20. 337,40 duke përfshirë normën e interesit nga dita kur është dorëzuar padia.

13. Më 23 qershor 2016 K.Sh. dorëzoi një padi tjetër në Gjykatën Themelore, duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të detyrohet që t'i paguajë atij shumën prej € 17.500 duke përfshirë kamatën.

14. Më 1 janar 2013, hyri në fuqi Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199. Në pajtim me nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të këtij Ligji: "*Gjykata Themelore - gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike të themeluara me këtë ligj*".

15. Më 6 shkurt 2013, Gjykata Themelore nxori vendim me të cilin e detyroi parashtruesin e kërkesës të përgjigjet në padinë e K.Sh. brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

16. Më 15 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës në përgjigjen e tij i kontestoi pretendimet e K.Sh. dhe kërkoi nga Gjykata Themelore që të refuzojë kërkesëpadinë e K.Sh. në tërësi si të pabazuar ose ta hedhë poshtë si të papranueshme.

17. Më 19 prill 2013 dhe 7 qershor 2013 u mbajtën dy seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar dëshmitarët. Parashtruesi i kërkesës kundërshtoi mënyrën se si janë marrë dhe vlerësuar provat, sepse në njërën anë, provat dhe dëshmitarët e propozuar nga parashtruesi i kërkesës janë refuzuar; ndërsa në anën tjetër, provat dhe dëshmitarët e propozuar nga KSH u pranuan nga gjykata.

18. Më 29 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C. nr. 162/09 aprovoi kërkesëpadinë e paditësit KSH dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që t'ia paguajë paditësit 'huan e papaguar'. Të njëjtën ditë, parashtruesi paraqiti prova të reja, duke pretenduar: (i) ligjshmëria dhe identiteti i K.Sh. nuk ishte përcaktuar saktë dhe se identiteti i tij nuk është i njohur; dhe, (ii) propozoi që të dëgjohet një dëshmitar. Pretendohet se provat dhe dëshmitari i propozuar ishin refuzuar nga gjykata.

19. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim.

20. Më 26 tetor 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin CA. nr. 401/2014 e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

21. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi sërish ritheksoi se ai kishte ngritur në instancat më të ulëta argumentin për shkelje të pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të mospranimit që të dëgjohet dëshmitari i tij dhe mospranimit për të marrë parasysh provat e tij.

22. Më 30 nëntor 2015, Zyra e Përmbaruesit Privat, me kërkesë të parashtruesit K.Sh., lëshoi urdhër (P. nr. 784/15) për përmbarim. Parashtruesi i kërkesës e kishte prapësuar këtë urdhër (shih paragrafët 33-36 më poshtë).

23. Më 4 prill 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 50/2016 refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, vërtetoi detyrimin e tij ndaj paditësit dhe i ndryshoi vendimet e gjykatës instancës më të ulët vetëm në aspektin e normës së interesit. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) vendimet e gjykatave të rregullta ishin mjaft të qarta dhe të arsyetuara; (ii) ekzistenca e marrëdhënieve ligjore midis palëve ndërgjyqëse ishte konfirmuar nga dëshmia e dëshmitarëve; (iii) dëshmitari i propozuar nga parashtruesi i kërkesës për t'u dëgjuar ishte jorelevant për rastin në fjalë; dhe, (iv) pretendimi me të cilin vihej në dyshim identiteti dhe legjitimiteti i K.Sh. ishte i pabazuar dhe se parashtruesi nuk e kishte ngritur këtë pretendim para gjykatave të instancës më të ulët, *inter alia*, që është në kundërshtim me faktet dhe procesverbalet që gjenden në dosjet e gjykatave.

24. Në ndërkohë, paditësi K.Sh. parashtroi propozim për vendosjen e masës së sigurisë ndaj pronës së patundshme të parashtruesit të kërkesës.

25. Më 15 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Vendimin C. nr. 2929/2015 aprovoi si të bazuar propozimin e paditësit K.Sh.. për vendosje të masës së sigurisë. Parashtruesi i kërkesës ishte urdhëruar që të mos ndërtojë asgjë, që të mos shesë, dhe të mos lidhë kontratë dhe të vërtetojë kontratë mbi shitblerjen e parashtruesit të kërkesës me noterin kompetent në Prishtinë, në njësinë kadastrale të caktuar në Prishtinë deri sa të nxirret një vendim tjetër i kësaj gjykate.

26. Parashtruesi në kohën e duhur ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

27. Më 24 prill 2016, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 1347/16 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

28. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke pretenduar, *inter alia*, se paditësi K.Sh., gjatë gjithë kohës u paraqit me një identitet të rremë dhe se kjo nuk është verifikuar nga gjykata, pavarësisht ankesave të shumta të parashtruesit të kërkesës.

29. Përkitazi me çështjen e identitetit dhe legjitimitetit të K.Sh., parashtruesi ka bashkangjitur si provë një njoftim nga autoritetet gjermane të prokurorisë ku në pjesën përkatëse thuhet: "*...autoritet kosovare janë njoftuar përmes interpolit ... se i akuzuari Sch. (i cili dikur quhej K.Sh., në vitin 1995 përmes natyralizimit ka fituar shtetësinë giermane dhe ka ndërruar emrin e tij në A. C. R. Sch.)...se deri në çfarë mase paraqet përdorimi i të dhënave personale të mëhershme vepër penale...mbetet përgjegjësi e autoriteteve kosovare".*

30. Më 31 maj 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se e ka pranuar nismën e tij dhe ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Prokurori i Shtetit theksoi në Gjykatën Supreme se vendimet e gjykatave duhej të shfuqizoheshin për shkak të shkeljeve esenciale të së drejtës procedurale.

31. Më 4 gusht 2016, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë. Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme për shkak se ishte e parakohshme pasi që procedura ishte duke u zhvilluar pranë Gjykatës Supreme. Gjykata gjithashtu vërejti se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese sa i përket legjitimitetit procedural të palëve dhe dëgjimit të dëshmitarëve (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI102/16, parashtrues i kërkesës *Shefqet Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 marsit 2017, paragrafi 41).

32. Më 24 gusht 2016, Gjykata Supreme me Aktvendimin CLM. nr. 10/2016 e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të parashtruar kundër vendimeve të gjykatave të faktit dhe të apelit. Gjykata Supreme arsyetoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm për shkelje që kanë të bëjnë me kompetencë territoriale, detyrimin për të mbajtur dëgjim publik ose në një situatë kur publiku mbahet jashtë një seance publike. Gjykata Supreme konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkelje të legjitimitetit procedural të palëve.

33. Më 21 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.1216/15 e refuzoi prapësimin e parashtruesit ndaj urdhrit përmbarimor (P.nr.784/15 të 30 nëntorit 2015) të nxjerrë nga Zyra e Përmbaruesit Privat. Gjykata Themelore konstatoi se urdhri përmbarimor ishte bazuar në Aktgjykimin C.nr. 162/09 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 29 tetorit 2013.

34. Objekt i procedurave përmbarimore të lartpërmendura ishte konfiskimi i pronës private të parashtruesit të kërkesës dhe bllokimi i pensionit invalidor të tij që ishte i nevojshëm për trajtimin e tij mjekësor.

35. Parashtruesi i kërkesës kontestoi vendimin (PPP.nr.1216/115) e lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

36. Gjykata vëren se, edhe pse procedurat përmbarimore të kontestuara janë duke u zhvilluar në Gjykatën e Apelit, por ato nuk mund të parandalojnë zbatimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore për konfiskimin e pronës së parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në të gjitha instancat nuk kanë marrë parasysh provat e propozuara nga ai, dhe nuk kanë arsyetuar pse i kanë hedhur poshtë ato prova. Kjo përfshinte, *inter alia,* refuzimin që të përcaktojnë me saktësi identitetin e K.Sh. dhe ta dëgjojnë dëshmitarin e propozuar nga parashtruesi i kërkesës. Ky dëshmitar, sipas parashtruesit të kërkesës, ishte dëshmitar i rëndësishëm për vendosjen e drejtë të rastit të tij, pra nëse i kishte borxh paditësit apo jo, nëse paditësi me të vërtetë i kishte dhënë atij "hua" apo jo.

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij - për shkak të refuzimit që të paraqiste prova dhe që të dëgjohej dëshmitari i tij, si dhe për shkak të mungesës së arsyetimit të këtij refuzimi, janë shkelur parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për një vendim të arsyetuar, si pjesë esenciale e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se ai kurrë nuk kishte pranuar se kishte marrë para apo i kishte borxh paditësit ndryshe nga ajo çfarë theksoi Gjykata Themelore.

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur nenin 6 të Konventës, për shkak se nuk është marrë fare me kërkesën për pjesëmarrje në seancën e revizionit të parashtruar për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut -neni 6 i Konventës. Përmes kësaj kërkesë i kërkoj gjykatës që të mbajë seancën në të cilën ajo do të dëgjonte pretendimet e mia për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut -neni 6 i Konventës. Argumentet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe lirive nga ana e gjykatave të mëparshme (shkeljet që kanë penguar gjykim të drejtë dhe të paanshëm) janë të bashkangjitur në këtë letër dhe justifikohen duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ.*"

41. Parashtruesi i kërkesës deklaron: "*Prokuroria e Shtetit ka kërkuar anulimin e vendimeve gjyqësore të cilat janë nxjerrë në procedurë të vendosjes së masës siguruese - duke e konsideruar se ekzistojnë elementet të veprës penale (identiteti i falsifikuar i paditësit), sepse ai nuk është K.Sh. (shtetas i Kosovës), por është A. C. R. Sch., shtetas gjerman me vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Republikën Federale të Gjermanisë. Duke marrë parasysh se RFGJ e ndalon dyshtetësinë, nuk ka asnjë mundësi që të shmanget ekzistimi i këtyre veprave penale. Edhe sikur të lejohej dyshtetësia, në asnjë mënyrë nuk lejohet që të përdoren identitete të ndryshme në shtete të ndryshme, sepse identiteti përcaktohet nga emri personal dhe në këtë kuptim përcaktohet edhe personaliteti dhe legjitimiteti i një pale. Nuk mund të bëhet fjalë për të njëjtin person - por për personalitete të ndryshme .. Si mund të konsiderohet një procedurë e rregullt, përderisa nuk është i sigurt as identiteti i palëve në procedurë?*"

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë nxjerrë vendime të paarsyetuara: "*Gjykata e Apelit përpos që nuk i ka arsyetuar vendimet/konkluzionet e saj, madje as nuk i ka përsëritur arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë - dhe nuk e arsyeton se pse pajtohet me arsyetimin e gjykatës së*

shkallës së parë... Gjykata Supreme e Kosovës ka përsëritur heshtazi të gjitha shkeljet e instancave paraprake, duke i kthyer ato në shkelje të vazhdueshme të lirive dhe të drejtave themelore nga pushteti gjyqësor i shtetit. Gjykata ndër të tjera nuk i arsyeton fare vendimet e saj se nuk ka pasur shkelje të së drejtës formale dhe se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale".

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme (vendimi CLM nr. 10/2016 i 24 gushtit 2016) edhe një herë dështoi që të adresojë çështjet kyçe të ngritura nga ai dhe nga Prokurori i Shtetit: (i) çështjen e identitetit dhe legjitimitetit procedural të K.Sh; (ii) mënyra se si janë marrë provat; dhe, (iii) pse i vetmi dëshmitar i propozuar prej tij ishte refuzuar nga gjykatat. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij është shkelur parimi i barazisë së armëve në të gjitha instancat gjyqësore.

44. Parashtruesi kërkon vendosjen e masës së përkohshme, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregulli 54 të Rregullores së punës. "Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson: "*...parashtroj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës kërkesën për masë të përkohshme kundër të gjitha aktgjykimeve dhe vendimeve të nxjerra nga gjykatat sepse ato janë nxjerrë në shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe gëzim paqësor të pronës."*

45. Gjithashtu, parashtruesi specifikon arsyet e mëposhtme: (i) prona e patundshme e cila ishte objekt i masave të sigurisë ishte gjithashtu objekt i hipotekës në favor të personit të tretë; (ii) vendosja e masave të sigurisë në pronën e cila ishte objekt i hipotekës përbën vepër penale; (iii) llogaria e parashtruesit (pensioni invalidor) përmes të cilit ai siguron trajtimin e tij mjekësor është e bllokuar, dhe (iv) parashtruesi që nga viti 1992 ka qenë i diagnostikuar me 100% shkallë të invaliditetit, dhe se për këtë arsye, bllokimi i pensionit të tij invalidor do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm.

46. Parashtruesi i kërkesës pohon se për shkak të qëndrimit të njëanshëm të gjykatave në rastin e tij është krijuar një situatë e "shkeljes së vazhdueshme". Vendosja e masës së sigurisë kundër pasurisë së tij dhe bllokimi i pensionit të tij invalidor për më tepër shkel të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

47. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës thekson: *"Konsideroj se përmbarimi i një vendimi mbi një pension invalidor, i cili është i dedikuar si ndihmë për sigurim të trajtimit shëndetësor dhe mosrrezikimit të mëtejmë të jetës, është duke pasur si rezultat edhe shkeljen e nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

48. Së fundi, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që ta shpallë kërkesën të pranueshme, (ii) që të konstatojë se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, (iii) t'i deklarojë të pavlefshme procedurat gjyqësore në tërësi dhe t'i anulojë vendimet e kontestuara; (iv) që të vendosë masë të përkohshme; dhe (v) ta kthejë rastin në Gjykatën Themelore për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

49. Në mënyrë që Gjykata të lejojë masë të përkohshme në pajtim me nenin 116 (2) [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 55 (4), (5) të Rregullores së punës, duhet të vërtetohet se:

Neni 116 (2) i Kushtetutës

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

Neni 27 i Ligjit

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

Rregulli 55 (4) i Rregullores së punës

[...]

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.

Rregulli 55 (5) i Rregullores së punës (ekstrakt):

[...] Nuk mund të merret vendim për masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. [...]

50. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi ka paraqitur argumente të shumta në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut.

51. Gjykata gjithashtu vëren se rasti ka një ndërlikueshmëri të madhe, dhe ndërlidhet me një numër të madh procedurash në bazë të po të njëjtit Aktvendim të Gjykatës Themelore që është bazë fillestare dhe përfundimtare për procedurat përmbarimore lidhur me pronën.

52. Si i tillë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur rastin *prima facie* për meritat e kërkesës brenda kuptimit të rregullit 55, paragrafi 4, nën (a), të Rregullores së punës.

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se duhet të mbështetet në pensionin e tij invalidor për trajtimin e tij mjekësor dhe për shkak të vendimeve të gjykatave, ai nuk mundet . Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se vendosja e masës së sigurisë ndaj pronës së tij private do t'ua shkelë edhe të drejtat e personave të tretë dhe si e tillë është e paligjshme dhe paraqet vepër penale.

54. Duke pasur parasysh këto rrethana, Gjykata konsideron se ka arsye të mjaftueshme të pranojë se parashtruesi i kërkesës do të pësonte dëme të pariparueshme brenda kuptimit të rregullit 55, paragrafi 4, nën b, të Rregullores së punës.

55. Përveç kësaj, Gjykata vëren se kërkesa ngre dyshime serioze në lidhje me kushtetutshmërinë e procedurave gjyqësore, përkitazi me: (i) arbitraritetin e pretenduar në vlerësimin e fakteve; (ii) çështjen nëse identiteti dhe legjitimiteti procedural i K.Sh.; (iii) pretendimi për shkeljen e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dëshmitari i tij dhe për t'u pranuar provat e tij; (iv) pasojat e mundshme negative për parashtruesin e kërkesës dhe për palët e treta në rast të zbatimit të masave të sigurisë kundër pasurisë së tij, si dhe bllokimi i pensionit të tij invalidor.

56. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka ngritur shqetësime të gjykimit të drejtë në të gjitha instancat gjyqësore, respektivisht për mospranimin e provave lidhur me legjitimitetin e K.Sh. dhe që të dëgjohej dëshmitari i tij, por gjykatat nuk morën qëndrim për ato shqetësime, dhe për pasojë, pretendohet se kanë shkelur "balancimin e drejtë" që është parakusht i barazisë së armëve ndërmjet palëve ndërgjyqëse në procedurat civile.

57. Që nga Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI102/16 me të cilin kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte deklaruar e papranueshme për shkak se ishte e parakohshme, Gjykata vëren se gjendja e parashtruesit nuk ishte rregulluar, por në fakt duket se ajo është rënduar akoma më shumë dhe ende vazhdon.

58. Për më tepër, Gjykata vëren se mund të ketë dëm potencial të pariparueshëm për të drejtën e parashtruesit në pronë dhe në pronësi si pasojë e shkeljes së vazhdueshme të pretenduar të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

59. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxjerrë përkitazi me pranueshmërinë ose meritat e kërkesës, e miraton kërkesën për masë të përkohshme si të bazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 55 (4), (5) të Rregullores së punës, më 27 mars 2017, me shumicë votash

VENDOSI

I. TË VENDOSË masën e përkohshme, konkretisht ndaj Aktgjykimit C.nr. 162/09 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 tetorit 2013, dhe të stopojë çdo procedurë gjyqësore, procedurë përmbarimore, veprim apo vendim të autoriteteve publike që buron nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

II. TË MIRATOJË masë të përkohshme deri më 20 qershor 2017;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI110/16, Parashtrues i kërkesës: Nebojša Đokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimi të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 155/2016, të 14 qershorit 2016

KI110/16, Aktvendim për papranueshmëri i 18 janarit 2017, i publikuar më 3 prill 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, pronë, prima facie*

Parashtruesi i kërkesës dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PTK) lidhën kontratë për pagesën e borxhit të mbetur në këste, në lidhje me impulset telefonike të shpenzuara nga parashtruesi i kërkesës në vlerë prej 1,134.79€.

Më 7 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Gjilan (me Aktgjykimin P. nr. 256/2009) e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e PTK-së dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës t'ia paguajë PTK-së borxhin në vlerë prej 1,134.79€ brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Aktgjykimi (P. nr. 256/2009) i Gjykatës Themelore në Gjilan është vërtetuar me Aktgjykimin (Gž. nr. 1935/2013) të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës (me Aktvendimin Rev. nr. 155/2016) e refuzoi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, për shkak se vlera e kontestit në pjesën e kontestuar të aktgjykimit nuk e tejkalon shumën prej 3,000 euro.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur mangësi në vërtetimin e provave nga gjykatat e rregullta; se gjykatat e rregullta nuk kanë kërkuar nga PTK-ja për të paraqitur listimet dhe faturat; se në procesin gjyqësor nuk është konstatuar që PTK-ja ka ofruar shërbime telefonike; se kontratën nuk e ka kuptuar sepse ishte në gjuhën shqipe dhe se aktgjykimet janë marrë me një seri të shkeljeve të Ligjit për procedurën kontestimore dhe Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve".

Gjykata konstatoi se parashtruesi i përsërit të njëjtat pretendime që i kishte theksuar në procedurën pranë gjykatave të rregullta, me ç'rast Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin Gž. nr. 1935/2013) u dha përgjigje të detajuar në të gjitha këto pretendime të parashtruesit, duke arsyetuar mes tjerash: *„...i padituri në seancën në gjykatën e shkallës së parë të 7.02.2013, nuk e ka kontestuar faktin se me paditësin e ka lidh kontratën për pagesën e borxhit në këste, [...]. Lidhur me pretendimet ankimore se kontratën nuk e ka kuptuar sepse ishte në gjuhën shqipe, [...] I padituri këtë fakt nuk e ka theksuar para gjykatës së shkallës së parë, por në deklaratën e tij ishte e qartë se kontratën e kishte kuptuar dhe dha arsyet se pse nuk ka paguar pjesën e mbetur të borxhit"*.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara me lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI110/16

Parashtrues

Nebojša Đokić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 155/2016, të 14 qershorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nebojša Đokić nga fshati Koretishtë, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 155/2016, të 14 qershorit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kushtetutshmëria e Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet që është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 gusht 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 22 shtator 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi ta specifikojë kërkesën, plotësojë formularin e kërkesës dhe t'i dorëzojë vendimet e kontestuara.

8. Më 20 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë vendimet e kontestuara dhe formularin e plotësuar të kërkesës.

9. Më 4 nëntor 2016, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 18 janar 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të përgjithshme

11. Më 22 prill 2008, parashtruesi i kërkesës dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PTK) lidhën kontratë për pagesën e borxhit të mbetur në këste në lidhje me impulset telefonike të shpenzuara nga parashtruesi i kërkesës në vlerë prej 1.134.79 €.

12. Me këtë kontratë, parashtruesi i kërkesës është detyruar që borxhin e mbetur ndaj PTK-së për impulset e shpenzuara telefonike t'ia paguajë me këste mujore në vlerë prej 67.40 €.

13. Parashtruesi i kërkesës pasi që e nënshkroi kontratën pagoi një këst të borxhit, dhe u ndal me pagesat e mëtejshme sipas kontratës.

14. Në një datë të pacaktuar, PTK-ja paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Gjilan.

15. Më 7 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Gjilan (me Aktgjykimin P. nr. 256/2009) aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e PTK-së dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës t'ia paguajë PTK-së borxhin në vlerë prej 1.134.79 € brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke pretenduar që gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, që kontrata është lidhur për aktivizimin e numrit të telefonit, dhe jo për pagesën e borxhit. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në ankesë theksoi se kontrata të cilën e nënshkroi ishte në gjuhën shqipe, që është arsye pse nuk e ka kuptuar përmbajtjen e saj, dhe prandaj kontrata është joligjore.

17. Më 16 nëntor 2015, Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin Gž. nr. 1935/2013) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar detajisht secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës.

18. Më 21 dhjetor 2015, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

19. Më 14 qershor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (me Aktvendimin Rev. nr. 155/2016) refuzoi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, për shkak se vlera e kontestit në pjesën e kontestuar të aktgjykimit nuk e tejkalon shumën prej 3,000 euro.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: " *... asnjëra nga instancat e mëparshme nuk i ka marrë parasysh pretendimet tona se borxhi i mësipërm prej 1.134.79 euro nuk ekziston, sepse nuk kanë dorëzuar faturat dhe as listimet për shërbimet, prandaj konsiderojmë se fatura është i vetmi kriter i ekzistencës së borxhit gjë që në këtë rast nuk është. Borxhi edhe para vitit 1999 për të cilin ngarkohemi është paguar në Telekom dhe me atë PTK-ja nuk ka të bëjë asgjë, as që është e bazuar kërkesëpadia e tyre".*

21. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta *"... nuk e kanë shqyrtuar asnjë fakt të vetëm në pajtim me Ligjin për procedurën kontestimore, neni 188,1 dhe 188.2 ku theksohet se gjykata është e obliguar t'i mbledh të gjitha provat për nxjerrjen e aktgjykimit (faturat dhe provat e tjera, nëse ka)."*

22. Bazuar në të gjitha më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta "*... po ia shkelin të drejtat në liri dhe gjykim objektiv [...], për shkak se nuk është mbajtur procedura e provave, e as nuk janë paraqitur dokumentet e nevojshme që provojnë borxhin."*

23. Parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës si në vijim:

> *"Vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të përmendur, me të cilin u janë shkel të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 32 (E Drejta për Mjete Juridike) dhe nenin 33 (Parimi i legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale) të Kushtetutës [...] Si dhe me nenet 6 dhe 13 [...] të KEDNJ-së."*

24. Më tej, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës:

> *"... t'i prishë të gjitha aktgjykimet e lartpërmendura, përkatësisht të urdhëroj përsëritjen e procedurës së provave në Gjykatën Themelore për paraqitjen e dokumentacionit që provon se ka përfunduar veprimi, përkatësisht ofrimi i shërbimeve nga PTK-ja e Kosovës dhe mbledhja e borxhit para vitit 1999, gjë që është e papranueshme dhe nuk është vërtetuar se ekziston ...".*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata shqyrton nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*

7. "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

28. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie".

29. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i ka përmbushur kërkesat procedurale të nenit 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

30. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se ka pasur mangësi në vërtetimin e provave nga gjykatat e rregullta; se gjykatat e rregullta nuk kanë kërkuar nga PTK-ja për të paraqitur listimet dhe faturat; se në procesin gjyqësor nuk është konstatuar që PTK-ja ka ofruar shërbime telefonike; se kontratën nuk e ka kuptuar sepse ishte në gjuhën shqipe dhe se aktgjykimet janë marrë me një seri të shkeljeve të Ligjit për procedurën kontestimore dhe Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

31. Në fakt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në një numër të madh të dispozitave të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Megjithatë, ai nuk shpjegon se pse konsideron se me aktvendimin e gjykatave të rregullta janë shkelur të gjitha dispozitat e përmendura të cilat ia garantojnë të drejtat dhe liritë.

32. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës provoi ta ndërtojë rastin e tij mbi baza ligjore, përkatësisht në interpretimin e gabuar të ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave të rregullta (më saktësisht, të Ligjit për procedurën kontestimore dhe Ligjit për marrëdhëniet detyrimore), si dhe vlerësimin e gabuar të provave.

33. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i përsërit të njëjtat pretendime që i kishte theksuar në procedurën pranë gjykatave të rregullta, me ç'rast Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin Gž. nr. 1935/2013) u dha përgjigje të detajuar në të gjitha këto pretendime të parashtruesit, duke arsyetuar mes tjerash:

":...i padituri në seancën në gjykatën e shkallës së parë të 7.02.2013, nuk e ka kontestuar faktin se me paditësin e ka lidh kontratën për pagesën e borxhit në këste, [...]. Lidhur me pretendimet ankimore se kontratën nuk e ka kuptuar sepse ishte në gjuhën shqipe, [...] I padituri këtë fakt nuk e ka theksuar para gjykatës së shkallës së parë, por në deklaratën e tij ishte i qartë se kontratën e kishte kuptuar dhe dha arsyet se pse nuk ka paguar pjesën e mbetur të borxhit".

34. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet faktike ose ligjore, që pretendohet të janë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.

35. Gjykata së pari rikujton se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vërtetojë nëse disa lloje të provave janë të lejuara, cilat prova duhet të merren dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën e marrjes së dëshmive (shih, rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35394/97, paragrafët 34-35, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 12 majit 2000).

36. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu përsërit se roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmërinë, të 16 dhjetorit 2011).

37. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësinë t'i paraqesë në gjykatat e rregullta arsyet materiale dhe juridike për zgjidhjen e kontestit; argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatave të rregullta; procedurat, shikuar në tërësi, ishin të drejta dhe vendimet e marra ishin të arsyetuara në detaje.

38. Gjykata, më tej, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin *Mezotur-Tiszazug Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur pretendim preciz dhe konkret për shkeljen e të drejtave të tij dhe nuk e ka shpjeguar se si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme mund t'i ketë shkelur të drejtat e tij kushtetuese; ai vetëm theksoi se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie,* e cila do të theksonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, KEDNJ, Vendimi nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

40. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*: *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

41. Prandaj, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës, nuk janë plotësuar.

42. Prandaj, Gjykata vërteton se kërkesa e tij është e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (a) si dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KO01/17, Parashtrues të kërkesës: Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës se Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

KO01/17, Aktgjykim i 28 marsit 2017, i publikuar më 4 prill 2017

Fjalët kyçe*: Shqyrtimi abstrakt, kërkesë e pranueshme, e drejta për pension të veteranëve, barazia para ligjit, ndalimi i diskriminimit, e drejta e pronës.*

Më 30 dhjetor 2016, Kuvendi miratoi Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Ligji i kontestuar). Më pas, më 10 janar 2017, përpara shpalljes dhe hyrjes në fuqi të ligjit të kontestuar, njëzet e katër (24) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (parashtruesit e kërkesës) parashtruan një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e neneve 3 (2), 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar, vetëm sa i përket përmbajtjes së tij. Parashtruesit e kërkesës në esencë pretenduan se dispozitat e kontestuara nuk ishin në pajtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe neni 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të Konventës, si dhe nenet 7 dhe 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata, njëzëri, vendosi ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe ta vlerësojë thelbin e kërkesës.

Lidhur me nenin 3 (2) të Ligjit të kontestuar, Gjykata Kushtetuese konsideroi se mohimi i së drejtës për pension për veteranët e luftës që jetojnë jashtë, por jo në vendet fqinje apo në Kosovë, përbën shkelje të së drejtës së tyre për barazi para ligjit në lidhje me të drejtat e pronës.

Lidhur me nenin 4 të Ligjit të kontestuar, Gjykata Kushtetuese konkludoi se të gjithë Veteranët e Luftës që i nënshtrohen Ligjit janë në një situatë relativisht të ngjashme, duke marrë parasysh kontributin e tyre si Veteran i Luftës. Megjithatë, trajtimi i ndryshëm, që është kategorizimi i bazuar në kohën e mobilizimit dhe shërbimit, është i justifikuar në baza objektive dhe të arsyeshme dhe është në përputhje me të drejtën e barazisë, e marrë në lidhje me të drejtën e pronës.

Lidhur me nenin 5 të Ligjit të kontestuar, Gjykata konstatoi se rënia e shumës së pensionit nën pagën minimale në Kosovë përbën një ndërhyrje në të drejtën e pronës, megjithatë, ekziston një ndërhyrje e justifikuar me gëzimin e lirë të së drejtës së pronës në bazë të shërbimit të interesit publik dhe duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO01/17

Parashtrues

Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Glauk Konjufca, Albin Kurti, Aida Dërguti, Albulena Haxhiu, Besa Baftija, Rexhep Selimi, Ismail Kurteshi, Mytaher Haskuka, Puhie Demaku, Faton Topalli, Fisnik Ismaili, Visar Ymeri, Driton Çaushi, Shqipe Pantina, Donika Kadaj-Bujupi, Salih Salihu, Pal Lekaj, Time Kadrijaj, Teuta Haxhiu, Lahi Ibrahimaj, Daut Haradinaj, Rrustem Berisha, Ali Berisha, Bali Muharremaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputeten e Kuvendit, Aida Dërguti, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Ligji i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji i kontestuar), miratuar nga Kuvendi më 30 dhjetor 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 3, 4 dhe 5 të ligjit të kontestuar, të cilët pretendohet se nuk janë në pajtueshmëri me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe

51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), me nenet 6 [E drejta në gjykim të drejtë], 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe me nenet 7 dhe 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, dhe në nenet 42 [Saktësimi i Kërkesës] dhe 43 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 janar 2017, parashtruesit i paraqitën Gjykatës kërkesën me dokumentet e bashkëlidhura.

7. Më 10 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 11 dhe 12 janar 2017, Gjykata njoftoi Sekretariatin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Sekretariati) dhe Presidentin e Republikës së Kosovës duke ua përkujtuar atyre se, në pajtueshmëri me paragrafin 2, të nenit 43 [Afatet] të Ligjit, ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte ligjore përderisa Gjykata përfundimisht të vendosë lidhur me çështjen e ngritur para saj.

9. Më 12 janar 2017, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 12 janar 2017, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit) me udhëzimin që t'ua shpërndajë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit; Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri); Sekretariatit nga i cili u kërkua të dorëzojë versionin final të miratuar të ligjit të kontestuar si dhe dokumentet relevante për rastin; Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Avokati i Popullit) dhe Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

11. Nga deputetët e Kuvendit, nga Kryeministri, nga Avokati i Popullit dhe nga Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u kërkua të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë ndonjë, deri më 23 janar 2017.

12. Më 13 janar 2017, parashtruesit e kërkesës plotësuan kërkesën e tyre me pretendime shtesë, duke kërkuar edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 të ligjit të kontestuar.

13. Më 13 janar 2017, kërkesa e plotësuar iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Avokatit të Popullit dhe Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

14. Deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Avokati i Popullit dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u njoftuan që mund të dorëzojnë komentet e

tyre, nëse kanë ndonjë, deri më 23 janar 2017. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë koment nga ta.

15. Më 18 janar 2017, Sekretariati dorëzoi versionin final të ligjit të kontestuar, i cili është miratuar nga Kuvendi, si dhe dokumentet relevante të rastit.

16. Gjykata vërejti se neni 4 i versionit final të ligjit të kontestuar, i cili u miratua nga Kuvendi, ndryshon nga teksti të cilit i referohen parashtruesit e kërkesës dhe i bashkëlidhën kërkesës së tyre fillestare.

17. Si rezultat, më 24 janar 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që të informojnë Gjykatën, jo më vonë se më 27 janar 2017, nëse qëndrojnë me të njëjtat pretendime siç i specifikuan në lidhje me tekstin të cilit ata iu referuan fillimisht, apo dëshirojnë të ndryshojnë ose të tërhiqen nga ato pretendime. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga parashtruesit.

18. Më 30 janar 2017, Gjykata informoi, duke ua bashkëlidhur nga një kopje, Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Avokatin e Popullit dhe Organizatën e Veteranëve të Luftës se versioni i Ligjit të miratuar përfundimisht nga Kuvendi ndryshon nga teksti të cilit parashtruesit i referohen në kërkesën e tyre fillestare.

19. Deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Avokati i Popullit dhe Organizata e Veteranëve të Luftës u informuan se mund të dorëzojnë komentet shtesë, nëse kanë ndonjë, deri më 6 shkurt 2017. Gjykata nuk pranoi ndonjë koment.

20. Më 28 mars 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të vlerësojë përmbajtjen e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 3 prill 2014, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji bazik). Ai u shpall më 18 prill 2014, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 23 prill 2014 dhe hyri në fuqi më 9 maj 2014.

22. Më 28 dhjetor 2016, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, i dorëzoi Qeverisë Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Projektligji) bashkë me Memorandumin shpjegues të ligjit të kontestuar (në tekstin e mëtejmë: Memorandumi shpjegues); Certifikatën e përputhshmërisë me "*EU-Acquis",* e lëshuar nga Ministria e Integrimeve Evropiane; Certifikatën për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave; dhe Certifikatën e Qeverisë për përputhshmërinë procedurale.

23. Më 29 dhjetor 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës (Vendimi nr. 02/124) miratoi Projektligjin. Po të njëjtën ditë, Kryeministri i Republikës së Kosovës i dorëzoi Kuvendit Projektligjin dhe kërkoi seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin dhe për miratimin e Projektligjit. Seanca e jashtëzakonshme u miratua dhe u caktua të mbahet më 29 dhjetor 2016.

24. Po të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit ua shpërndau deputetëve tekstin e Projektligjit, bashkë me dokumentet shoqëruese, dhe kërkoi nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të raportojë për Projektligjin.

25. Po të njëjtën ditë, Komisioni parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e rekomandoi miratimin në parim të tekstit të Projektligjit siç ishte dorëzuar nga Qeveria.

26. Po të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit i ftoi të gjithë deputetët për seancë të jashtëzakonshme, të caktuar për 29 dhjetor 2016, me fillim në orën 15:15. Megjithatë, në mungesë të kuorumit, ajo seancë e jashtëzakonshme u shty për 30 dhjetor 2016, për të filluar në orën 10:00.

27. Më 30 dhjetor 2016, gjatë seancës së jashtëzakonshme, Kryesuesi i Grupit parlamentar të PDK-së i propozoi Kuvendit që të ndiqej një procedurë e përshpejtuar e shqyrtimit dhe e miratimit të Projektligjit po të njëjtën ditë.

28. Po të njëjtën ditë, Kuvendi vendosi (Vendimi nr. 05-V-407) të shqyrtojë Projektligjin në dy leximet, me procedurë të përshpejtuar sipas Rregullores. Në votim morën pjesë 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetë: 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë votuan për dhe 9 (nëntë) deputetë kundër.

29. Rrjedhimisht, gjatë procedurës së leximit të parë të Projektligjit, Kryesuesi i Kuvendit urdhëroi një orë pauzë për shkak të mungesës së kuorumit të mjaftueshëm për miratimin e Projektligjit në leximin e parë.

30. Pas pauzës, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me leximin e parë. Në seancën e jashtëzakonshme ishin të pranishëm 63 (gjashtëdhjetetre) deputetë. Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin.

31. Pastaj, Kryetari i Kuvendit urdhëroi komisionet parlamentare që urgjentisht të shqyrtojnë Projektligjin dhe të paraqesin ndryshimet eventuale para vazhdimit me leximin e dytë. Këto komisione ishin: Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale; Komisioni për buxhet dhe financa; Komisioni për legjislacion, mandate, imunitete, rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Komisioni për integrime evropiane dhe Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim. Leximi i dytë ishte caktuar të fillonte në orën 18:15 të njëjtën ditë.

32. Po të njëjtën ditë, Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale shqyrtoi Projektligjin dhe raportet e dorëzuara nga Komisioni për buxhet dhe financa; Komisioni për legjislacion, mandate, imunitete, rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisioni për integrime evropiane. Pastaj, Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale i paraqiti Kuvendit raportin me rekomandimin e 8 (tetë) amendamenteve të Projektligjit. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim nuk paraqiti raport.

33. Po të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me leximin e dytë. Të pranishëm ishin 63 (gjashtëdhjetë e tre) deputetë. Kuvendi miratoi Projektligjin me 4 (katër) amendamente [nga 8 (tetë) sa kishte propozuar Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale]. 44 (Dyzetekatër) deputetë votuan për, 8 (tetë) deputetë votuan kundër dhe 11 (njëmbëdhjetë) deputetë abstenuan.

34. Kështu që, më 30 dhjetor 2016, Kuvendi miratoi (Vendimi nr. 05-V-410) Projektligjin si Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Ligji i kontestuar).

Pretendimet e parashtruesit

35. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se nenet 3, 4 dhe 5 të ligjit të kontestuar nuk janë në pajtueshmëri me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës; me nenet 6 [E drejta në proces të drejtë], 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1 të KEDNJ-së (në tekstin e mëtejmë: neni 1 i Protokollit 1); si dhe me nenet 7 dhe 22 të DUDNJ-së.

1. Sa i përket nenit 3 të ligjit të kontestuar

36. Neni 3 (2) i ligjit të kontestuar ia shton paragrafët 5 dhe 6 nenit 16 të ligjit bazik.

37. Parashtruesit pohojnë se neni 3 i ligjit të kontestuar *"përbën shkelje të Nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Barazia para Ligjit], Nenit 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Nenit 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Ndalimi i Diskriminimit"*.

38. Parashtruesit pretendojnë se *"[...] personat pjesëmarrës në luftën çlirimtare të cilët gëzojnë statusin e veteranit luftëtar të UÇK-së, e që jetojnë në ndonjë shtet tjetër, privohen nga e drejta e realizimit të beneficioneve që janë të parapara me ligjin bazik dhe [Ligjit të kontestuar]. [...] Mohimi i realizimit të të drejtave në beneficionet që i ka paraparë legjislacioni në fuqi vetëm në bazë të vendqëndrimit të tyre është diskriminues"*.

2. Sa i përket nenit 4 të ligjit të kontestuar

39. Neni 4 i ligjit të kontestuar ia shton nenin e ri 16A ligjit bazik.

40. Së pari, parashtruesit pohojnë se neni 4 i ligjit të kontestuar *"përbën shkelje të Nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Barazia para Ligjit], Nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - [Ndalimi i Diskriminimit]"*.

41. Parashtruesit pretendojnë se *"Kategorizimi i përkufizuar me dispozitën e Nenit 4 të [Ligjit të kontestuar], me të cilin formulohet neni 16a, paraqet rregullim diskriminues në raport me përkufizimin ligjor të sanksionuar me Nenin 3 të ligjit bazik [nënparagrafi 1.3]"*.

42. Së dyti, parashtruesit e kërkesës po ashtu pohojnë se ligji i kontestuar, duke paraparë kategorizimin e ri të veteranëve të luftës, është në kundërshtim me dispozitat e ligjit bazik, pasi që këto dispozita nuk janë amendamentuar në mënyrë eksplicite me ligjin e kontestuar. Parashtruesit pretendojnë se, duke mos ndryshuar, duke mos plotësuar apo duke mos shfuqizuar dispozitat e caktuara të ligjit bazik, ligji i kontestuar është në kundërshtim me *"Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e hartimit të akteve normative, i cili në nenin 10, paragrafi 2, thekson se (citim): 'Ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi i një neni ose nënndarjeve të tij duhet të bëhet nëpërmjet një paragrafi të veçantë për çdo nen'"*.

43. Së treti, parashtruesit e kërkesës po ashtu kontestojnë kushtetutshmërinë e nenit 4 të tekstit të bashkëngjitur fillimisht të ligjit të kontestuar, i cili supozohet të ketë shtuar paragrafët e rinj, 4 dhe 6, të nenit 16A të ligjit bazik. Megjithatë, neni 4 i tekstit final të ligjit të kontestuar dallon në substancë nga neni 4 i tekstit të bashkëngjitur fillimisht.

3. Sa i përket nenit 5 të ligjit të kontestuar

44. Neni 5 i ligjit të kontestuar e fshin nenin 18 të ligjit bazik.

45. Parashtruesit pretendojnë se fshirja e nenit 18 të ligjit bazik *"është në kundërshtim me nenin 46 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

46. Në fakt, ata pretendojnë se *"shkelja e tillë rezulton në faktin se me nenin 18 të ligjit bazik [...] veteranëve luftëtarë të UÇK-së, si kategori e veçantë shoqërore, pa përjashtim, u është garantuar e drejta në pension, jo më pak se paga minimale në nivel të Republikës se Kosovës që, në kuptim të nenit 57 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, paraqet të ardhurën minimale që ka për qëllim mbrojtjen e të ardhurave jetike në kuptim të mirëmbajtjes së mirëqenies sociale si kategori shoqërore"*.

47. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se *"pensioni i garantuar me nenin 18 të ligjit bazik [...] sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, paraqet pritje legjitime (legitimate expectation) dhe shkelje të së drejtës së pronës, për faktin se kjo e drejtë legjitime po i mohohet kategorisë shoqërore që kishin pritje të tilla legjitime bazuar në dispozita ligjore dhe se, me ndryshimet e kontestuara, krijohet pasoja juridike direkte, e cila i cenon pritjet e tilla"*.

48. Lidhur me këtë, parashtruesit rikujtojnë praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) gjegjësisht *Pressos Campania Naviera SA et al kundër Belgjikës*, GJEDNJ, aktgjykimi i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Greqisë*, nr. 39794/98, Vendimi i 10 korrikut 2002, paragrafi 73, si dhe aktgjykimet [e Gjykatës] në rastet e KEK-ut [...].

Zgjidhja e kërkuar

49. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të anulojë nenet vijuese të ligjit të kontestuar: nenin 3 (i cili ia shton paragrafët 5 dhe 6 nenit 16 të ligjit bazik), nenin 4 (i cili ia shton paragrafin 1 dhe nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 nenit 16A të ligjit bazik) dhe nenin 5 (i cili fshin nenin 18 të ligjit bazik).

Pranueshmëria e kërkesës

50. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

51. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

52. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet nenit 113 (5) të Kushtetutës, i cili parasheh: *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur"*.

53. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar vetëm sa i përket përmbajtjes por jo edhe procedurën e ndjekur për

miratimin e tij. Prandaj, detyrë e Gjykatës është që vetëm të shqyrtojë nëse përmbajtja e ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, siç edhe pretendojnë parashtruesit.

54. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa ishte paraqitur nga 24 (njëzetekatër) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me nenin 113 (5) të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

55. Më tej, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i Kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
> *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti".*

56. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës shënuan emrat e deputetëve me nënshkrime, specifikuan Ligjin që kontestojnë, iu referuan dispozitave relevante kushtetuese për të cilat ata pretendojnë se Ligji i kontestuar nuk është në pajtueshmëri dhe paraqitën dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e nenit 42 të Ligjit janë plotësuar.

57. Gjykata më tej vëren se ligji i kontestuar ishte miratuar më 30 dhjetor 2016, përderisa kërkesa i është parashtruar Gjykatës më 10 janar 2017. Kështu që, afati prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit: *"tetë (8) ditë nga data e miratimit"*, ka mbaruar më 7 janar 2017.

58. Megjithatë, Gjykata i referohet rregullit 27 [Llogaritja e periudhës kohore] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:*
>
> *[...]*
> *(6) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj".*

59. Gjykata vëren se 7, 8 dhe 9 janari 2017 ishin, në fakt, e shtunë, e diel dhe festë zyrtare. Andaj, afati për parashtrim të kërkesës u vazhdua deri në fund të ditës tjetër të punës, e që ishte 10 janari 2017. Kështu që, kërkesa është parashtruar me kohë.

60. Si konkludim, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, se kanë identifikuar ligjin e kontestuar, specifikuan pretendimet e tyre kushtetuese, paraqitën dëshmi mbështetëse dhe parashtruan kërkesën brenda afatit të paraparë. Andaj, Gjykata konkludon se parashtruesit kanë respektuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

Substanca e kërkesës

61. Gjykata rithekson se parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e nenit 3 (2), 4 dhe 5 të ligjit të kontestuar vetëm përkitazi me përmbajtjen e tij.

1. Kushtetutshmëria e nenit 3 (2) të ligjit të kontestuar

62. Gjykata vëren se neni 3 (2) i ligjit të kontestuar shton paragrafët 5 dhe 6 të nenit 16 të ligjit bazik, ku thuhet:

> *"Nenit 16 të ligjit bazik, pas paragrafit 4, i janë shtuar paragrafët 5 dhe 6 si në vijim:*
>
> *5. Veterani luftëtar i UÇK-së, që jeton në shtet tjetër, gëzon të drejtën në beneficione të tjera sipas këtij ligji por nuk gëzon të drejtën në pension.*
>
> *6. Përjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, veterani luftëtar i UÇK-së, që jeton në vendet fqinje, i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj".*

63. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se *"[...] personat pjesëmarrës në luftën çlirimtare të cilët gëzojnë statusin e luftëtarit veteran të UÇK-së, e që jetojnë në ndonjë shtet tjetër privohen nga e drejta e realizimit të beneficioneve që janë të parapara me ligjin bazik [...]".*

64. Parashtruesit pretendojnë se *"mohimi i realizimit të të drejtave [...], duke u bazuar vetëm në vendqëndrimin e tyre, është diskriminues".*

65. Gjykata rikujton se parashtruesit konkludojnë që *"rregullimi i tillë përjashtues i cili veçon subjektet e së drejtës mbi bazën e rrethanave subjektive, përbën shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Barazia para Ligjit], nenit 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenit 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Ndalimi i Diskriminimit".*

66. Gjykata i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
> *2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
> *3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".*

67. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.*
> *2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj".*

68. Gjykata më tej i referohet nenit 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër".

69. Në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera".

70. Në këtë drejtim, Gjykata më tej i referohet nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
[...]"

71. Gjykata gjithashtu merr parasysh nenet 7 dhe 22 të DUDNJ-së, si në vijim:

Neni 7

"Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Neni 22

Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe të drejta të domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti".

72. Që në fillim, Gjykata rithekson se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, "*të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

1.1 Parimet e përgjithshme në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 24 dhe 46 të Kushtetutës

73. GJEDNJ-ja përsërit që neni 24 i Kushtetutës përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore.

74. Gjykata rikujton se vetëm dallimet në trajtim të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose *"status",* mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata relevante të ngjashme. Shih, *mutatis mutandis Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976 § 56; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, 16 mars 2010, § 61.

75. Gjykata konsideron se, për qëllimet e interpretimit të nenit 24, një trajtim ndryshe është i pabarabartë dhe arbitrar nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim ose kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Shih, *mutatis mutandis Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesat nr. 9214/80; 9473/81 dhe 9474/81, 24 prill 1985 § 72.

76. Për më tepër, Gjykata thekson se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë kur vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase diferencat në situata të tjera të ngjashme justifikojnë një ndryshim në trajtim. Fushëveprimi i kësaj margjine ndryshon sipas rrethanave, sipas objektit të çështjes dhe sipas historisë së rastit. Një margjinë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme. Shih, *mutatis mutandis, Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13378/05, 29 prill 2008, *§* 60; *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë*, cituar më lart, § 64

77. Në mënyrë analoge, Gjykata i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së të përcaktuar në raport me pagesën e beneficionit të mirëqenies, e cila përcakton se, nëse legjislacioni parasheh pagesën e përfitimit të beneficionit të mirëqenies si e drejtë, pa marrë parasysh a është kushtëzuar ose jo me pagesën paraprake të kontributeve, ai legjislacion duhet të konsiderohet se gjeneron një interes pronësor që bie brenda kufirit të së drejtës pronësore të nenit 46 të Kushtetutës për ata përfitues që i përmbushin këto kritere. Shih, *mutatis mutandis, Pickur v. Ukraine*, kërkesa nr. 10441/06, 7 nëntor 2013, § 41.

78. Gjykata më tej konsideron se edhe pse e drejta në pronë nuk përfshin të drejtën për të marrë pagesën e sigurisë sociale të çfarëdo lloji, nëse ligjvënësi vendos të krijojë një skemë të përfitimeve, duhet ta bëjë këtë në një mënyrë që të jetë e barabartë për të gjithë ata që janë në situata analoge ose situata relevante të ngjashme. Shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Pichkur kundër Ukrainës*, cituar më lart, § 42.

1.2 Aplikimi i këtyre parimeve në rastin e tanishëm (konkret)

79. Gjykata vlerëson nëse neni 3 (2), duke shtuar paragrafin 5 dhe 6 në nenin 16 të ligjit bazik, është në përputhje me të drejtat për barazi para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës, dhe me të drejtën e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

a. Trajtimi i pabarabartë

80. Gjykata së pari përcakton nëse ekziston një dallim në trajtimin e veteranëve të UÇK-së në situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme.

81. Gjykata vëren se, sipas paragrafit 5 të nenit 16 të ligjit bazik (i shtuar me nenin 3 (2) të Ligjit të kontestuar), veteranët e UÇK-së "*që jetojnë në shtet tjetër, gëzojnë të drejtën në beneficione të tjera sipas këtij ligji*". Megjithatë, veteranët e UÇK-së, që jetojnë jashtë shtetit "*nuk gëzojnë të drejtën në pension*". Gjykata gjithashtu vëren se, në bazë të paragrafit 6 të nenit 16 të ligjit bazik (i shtuar me nenin 3 (2) të Ligjit të kontestuar), veteranët e UÇK-së "*të cilët jetojnë në vendet fqinje i gëzojnë të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj*".

82. Gjykata vëren se nga paragrafët 5 dhe 6, të nenit 16 të ligjit bazik (shtuar me nenin 3 (2) të Ligjit të kontestuar), rrjedh se veteranët e UÇK-së që jetojnë jashtë shtetit, por jo edhe në vendet fqinje, nuk kanë të drejtë për pension, ndërsa veteranët e UÇK-së që jetojnë në vendet fqinje kanë të drejtë për pension. Kështu, dallimi i të drejtës për pension ndërmjet veteranëve të UÇK-së është bërë në lidhje me vendin e banimit: ata që jetojnë jashtë vendit, në vendet fqinje, kanë të drejtë; ata që jetojnë jashtë vendit, por jo në vendet fqinje, nuk kanë të drejtë.

83. Gjykata konsideron se të dyja palët edhe veteranët e UÇK-së që jetojnë në vendet fqinje dhe veteranët e UÇK-së që jetojnë jashtë vendit, por jo në vendet fqinje, janë në situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme: ata nuk jetojnë në Kosovë. Megjithatë, për shkak të vendit të banimit, ata janë në një gjendje të ndryshme thelbësore dhe materiale në lidhje me të drejtën që u takon për pension, edhe pse ata janë në situatë analoge ose situatë relevante të ngjashme.

84. Gjykata më tej vëren se vendi i banimit është kriter për trajtim ndryshe për gëzimin e së drejtës për pension të veteranëve të UÇK-së. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vendi i banimit përbën një aspekt të statusit personal për qëllimet e nenit 24 të Kushtetutës.

85. Prandaj, Gjykata konsideron se dallimi në të drejtën për pension është bërë në varësi nga vendi i banimit të veteranëve të UÇK-së, duke rezultuar në një situatë në të cilën veteranët e UÇK-së me banim jashtë vendit, por jo edhe në vendet fqinje, do të privohen nga pensioni për arsyen e vetme të vendit të banimit. Megjithatë, të gjithë veteranët e UÇK-së, të cilët nuk banojnë në Kosovë apo në vendet fqinje, janë në një situatë relativisht të ngjashme me ata që banojnë në Kosovë ose në vendet fqinje.

86. Prandaj, Gjykata konkludon se ekziston një dallim në trajtimin e veteranëve të UÇK-së që janë në një situatë analoge ose në situatë relevante të ngjashme, e cila përbën një kufizim në të drejtën e tyre për pension.

b. Legjitime dhe proporcionale

87. Gjykata rikujton se trajtimi i pabarabartë nuk është në pajtim me nenin 24 të Kushtetutës nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

88. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. "Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar".

89. Në lidhje me këtë, Gjykata do të analizojë, nëse:

(1) Kufizimi është paraparë me ligj;
(2) Ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me kufizim; dhe
(3) Ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet

90. Përkitazi me kriterin (1), Gjykata vëren se kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Prandaj, Gjykata konsideron se kufizimi i tillë është në përputhje me kërkesat e përfshira në nenin 55 (1) të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata konkludon se kufizimi i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me ligj.

91. Përkitazi me kriterin (2), Gjykata vëren se neni 1 i ligjit të kontestuar thotë se qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të veteranëve të UÇK-së, të cilët me *"sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës".*

92. Gjykata gjithashtu vëren që Memorandumi shpjegues thotë se "*çështja kryesore e trajtuar në këtë draft është kategorizimi i veteranit luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe i benefiteve të tjera, e cila do të përcaktohet në përputhje me kohën e mobilizimit dhe të shërbimit në UÇK*".

93. Gjykata më tej vëren se Memorandumi shpjegues gjithashtu thotë se "*Qëllimi kryesor i miratimit të* [Ligjit të kontestuar] *është orientuar që të krijohet stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare për Buxhetin e Kosovës si dhe përmbushja e realizimit të të drejtave dhe përfitimet e këtyre kategorive të dala nga lufta*".

94. Megjithatë, Gjykata vëren se as Qeveria dhe as Kuvendi nuk kanë dhënë ndonjë justifikim se përse veteranët e UÇK-së që banojnë në Kosovë dhe në vendet fqinje kanë të drejtë për pension dhe pse veteranët e UÇK-së që banojnë jashtë vendit, por jo edhe në vendet fqinje, nuk kanë të drejtë për pension të tillë.

95. Për më tepër, Gjykata vëren se asnjë dëshmi nuk është paraqitur, duke përfshirë ligjin e kontestuar dhe Memorandumin shpjegues, që tregon arsyet objektive për këtë kufizim të veteranëve të UÇK-së me banim në Kosovë ose në vendet fqinje nga ata që banojnë

jashtë vendit, por jo në vendet fqinje, as nuk mund të nxirret ndonjë qëllim i veçantë që do të arrihej me një kufizim.

96. Në të kundërtën, Gjykata vëren se veteranët e UÇK-së gëzojnë të drejtën për pension për shkak të "*sakrificës së tyre të çmuar, angazhimin dhe kontributin në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës*". Për më tepër, kohëzgjatja dhe periudha e shërbimit të kontributit të tyre është një kriter i përbashkët për të gjithë veteranët e UÇK-së, edhe pse ata janë të kategorizuar bazuar në kohëzgjatjen e periudhës së shërbimit dhe të kontributit të tyre, siç është paraparë në nenin 4 të ligjit të kontestuar.

97. Prandaj, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtës për pension të veteranëve të UÇK-së, të cilët jetojnë jashtë vendit por jo në vendet fqinje, nuk është as i justifikuar e as nuk është i bazuar në arsye objektive.

98. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ekziston ndonjë qëllim legjitim që synohet të arrihet me trajtimin ndryshe të veteranëve të UÇK-së dhe me kufizimin konsekuent për të drejtën e tyre për pension.

99. Përkitazi me kriterin (3), Gjykata vetëm ka arritur në përfundim se nuk ekziston ndonjë qëllim legjitim që synohet të arrihet me trajtimin ndryshe të së drejtës për pension të veteranëve të UÇK-së. Prandaj, Gjykata konsideron se mosekzistimi i qëllimit legjitim e bën të panevojshme analizën për çfarëdo lidhje të proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës për pension dhe një qëllimi joekzistues që synohet të arrihet. Prandaj, Gjykata gjithashtu konkludon se mosekzistimi i ndonjë qëllimi që synohet të arrihet nënkupton mosekzistencën e çfarëdo marrëdhënieje të proporcionalitetit.

100. Prandaj, Gjykata gjen se neni 3 (2) i ligjit të kontestuar, duke shtuar paragrafët 5 dhe 6 të nenit 16 të ligjit bazik, nuk është në përputhje me të drejtën e barazisë në bazë të nenit 24 të Kushtetutës.

101. Për më tepër, Gjykata, duke pasur parasysh se e drejta për përfitimin e pensionit duhet të konsiderohet si gjenerim i një interesi pronësor, konstaton se neni 3 (2) i ligjit të kontestuar gjithashtu nuk është në përputhje me të drejtën e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

102. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se neni 3 (2) i Ligjit të kontestuar, duke shtuar paragrafët 5 dhe 6 të nenit 16 të ligjit bazik, nuk është në pajtim me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës.

103. Pasi ka arritur në këtë përfundim, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që të shqyrtojë shkeljet e pretenduara të nenit 51 të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 22 të DUDNJ-së dhe të nenit 14 të KEDNJ-së.

2. Kushtetutshmëria e nenit 4 të ligjit të kontestuar

104. Gjykata rikujton se neni 4 i ligjit të kontestuar ia shton ligjit bazik një nen të ri 16A (përkatësisht paragrafin 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, dhe 1.3), i cili thotë:

Pas nenit 16 të ligjit bazik, duhet të shtohet një nen i ri 16A me tekstin në vijim:

Neni 16A

1. Kategorizimi i veteranit luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe i beneficioneve të tjera, përcaktohet në përputhje me kohën e mobilizimit dhe të shërbimit në UÇK, si në vijim:

1.1 Kategoria e parë, veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
1.2 Kategoria e dytë, veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës;
1.3 Kategoria e tretë, veterani luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe që ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 marsit 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.
[...]"

105. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 3 [Përkufizimet] të ligjit bazik, i cili përcakton:

1.3 "Veteran i UÇK-së – pjesëmarrës në luftën për çlirimin në Kosovë, si:
[...]
1.3.2. Veteran luftëtar i UÇK-së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj, i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës;
[...]
1.3.4. Pjesëtar i UÇK-së – është çdo person, i cili me vendim apo akt tjetër, është caktuar të kryejë detyra konkrete në mbështetje politike, logjistike, financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njësive, shtabeve dhe zonave të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, gjatë periudhës 1997-1999".

106. Fillimisht, parashtruesit pretendojnë se *"kategorizimi i përkufizuar me dispozitën e nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-261 me të cilin formulohet neni 16a, paraqet rregullim diskriminues në raport me përkufizimin ligjor të sanksionuar me nenin 3 të ligjit bazik [nënparagrafi 1.3]"*.

107. Parashtruesit konkludojnë se "*një rregullim i tillë, i cili veçon subjektet e së drejtës mbi bazën e rrethanave subjektive, përbën shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës - [Barazia para Ligjit], të nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – [Ndalimi i Diskriminimit]"*.

108. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesit pohojnë që neni 4 i ligjit të kontestuar, duke shtuar nenin e ri 16A (1) në ligjin bazik, i kategorizon veteranët e UÇK-së, duke krijuar diskriminim në lidhje me nenin 3 (1.3) të ligjit bazik, i cili nuk parasheh kategorizimin e veteranëve të UÇK-së dhe, në këtë mënyrë, nuk është në përputhje me nenin 24 të Kushtetutës, me nenin 14 të KEDNJ-së dhe me nenin 7 të DUDNJ-së.

109. Gjykata rikujton se e drejta për barazi, sipas nenit 24 të Kushtetutës, aplikohet për të gjitha të drejtat që bien nën fushëveprimin e përgjithshëm të çdo të drejte të dhënë me ligj, duke përfshirë të drejtën në pronë, për të cilat ligjvënësi ka vendosur për t'i ofruar vullnetarisht.

110. Gjykata po ashtu rikujton se e drejta në pronë, sipas nenit 46 të Kushtetutës, nuk përfshin të drejtën për të marrë një pagesë të sigurisë sociale të çfarëdo lloji; megjithatë, nëse ligjvënësi vendos për të krijuar një skemë të përfitimeve, duhet ta bëjë këtë në një mënyrë të barabartë për të gjithë ata që janë në situata analoge ose situata relevante të ngjashme.

111. Gjykata vëren se neni 4 i ligjit të kontestuar (duke shtuar nenin 16A (1) në ligjin bazik) parasheh tri nivele të ndryshme për veteranët e UÇK-së, në përputhje me tri kategoritë. Veteranët e UÇK-së, që i përkasin Kategorisë së Dytë, do të marrin një pension më të ulët sesa veteranët e UÇK-së që i përkasin Kategorisë së Parë; dhe veteranët e UÇK-së, që i përkasin Kategorisë së Tretë, do të marrin një pension më të vogël sesa veteranët e UÇK-së që i përkasin Kategorisë së Dytë. Kështu, Gjykata vlerëson se nivelet e ndryshme të pensioneve për veteranët UÇK-së, të ngritura nga parashtruesit, hyjnë në fushëveprimin e së drejtës për pronën dhe është e mjaftueshme për të vlerësuar pretendimin për sa i përket shkeljes së të drejtës për barazi para ligjit.

112. Parashtruesit argumentojnë se përkufizimi i veteranëve të UÇK-së, siç parashihet në nenin 3 (1.3) të ligjit bazik, nuk bën ndonjë dallim ndërmjet veteranëve të UÇK-së. Prandaj, kushdo që i takon kategorisë së veteranëve të UÇK-së duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe jo të ndahet në kategori të ndryshme.

113. Gjykata rithekson se veteranët e UÇK-së duhet të përmbushin të gjitha kriteret ligjore për të përfituar nga statusi i veteranëve të UÇK-së, në përputhje me nenin 3 të ligjit bazik, siç janë: duke qenë "*qytetar i Kosovës apo shtetas i huaj i cili është bërë anëtar i UÇK-së*"; duke qenë i "*regjistruar si ushtar i armatosur dhe me uniformë nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së*"; dhe duke qenë "*aktiv deri në fund të luftës*".

114. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se të gjithë veteranët e UÇK-së, që i nënshtrohen ligjit, janë gjithashtu në një situatë relativisht të ngjashme, duke pasur parasysh kontributin e tyre si veteranë të UÇK-së, pavarësisht nga koha e tyre e mobilizimit dhe e shërbimit në UÇK.

115. Pra, pyetja tjetër që do të konsiderohet është prapë nëse trajtimi ndryshe mund të justifikohet ose jo në baza objektive dhe të arsyeshme, siç kërkohet nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe nga neni 55 i Kushtetutës, përkatësisht nëse:

(i). kufizimi është paraparë me ligj;

(ii). ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me kufizimin; dhe

(iii). ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.

116. Përkitazi me kriterin (i), Gjykata vëren se kufizimi i pretenduar i të drejtës për pension është paraparë me nenin 4 të ligjit të kontestuar (duke shtuar nenin 16A të ri (1) në ligjin bazik). Prandaj, Gjykata konsideron se kufizimi është në përputhje me kërkesat e përfshira në rastin e GJEDNJ-së dhe në përputhje me nenin 55 (1) të Kushtetutës. Prandaj, kufizimi është paraparë me ligj.

117. Përkitazi me kriterin (ii), Gjykata rikujton që Memorandumi shpjegues thotë se "*çështja kryesore e trajtuar në këtë draft është kategorizimi i veteranit luftëtar të UÇK-së, [...] i cili do të përcaktohet në përputhje me kohën e mobilizimit dhe të shërbimit në UÇK*".

118. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që Memorandumi shpjegues thotë se "*qëllimi kryesor i miratimit të [të Ligjit të kontestuar] është orientuar që të krijohet stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare për Buxhetin e Kosovës dhe përmbushjen e realizimit të të drejtave dhe përfitimeve të këtyre kategorive të dala nga lufta*".

119. Për më tepër, Gjykata vëren se qëllimi i kategorizimit, i paraparë në nenin 4 të ligjit të kontestuar (duke shtuar nenin e ri 16A (1) në ligjin bazik), ka për qëllim të sigurojë që

veteranët e UÇK-së të marrin një shumë të pensionit në proporcion me kohën e tyre të mobilizimit dhe të shërbimit në UÇK. Një qëllim tjetër është sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të buxhetit të Kosovës. Prandaj, Gjykata konsideron se koha e mobilizimit dhe e shërbimit në UÇK, si dhe qëndrueshmëria financiare e buxhetit, janë synimet legjitime për krijimin e kufizimit, i shërbejnë interesit publik dhe janë qartazi me themel të arsyeshëm. Prandaj, Gjykata konkludon se ekziston një qëllim legjitim që duhet të arrihet me atë kufizim.

120. Përkitazi me kriterin (iii), Gjykata vëren se kriteret që duhet të përmbushen nga çdo kategori janë përcaktuar në ligjin e kontestuar, përkatësisht duke marrë parasysh kohën e mobilizimit dhe të shërbimit të kontributit si luftëtarë të UÇK-së. Kështu, datat specifike të mobilizimit dhe të shërbimit janë marrë si momentet vendimtare në kontributin në aktivitetet e UÇK-së.

121. Në fakt, Gjykata vëren se kategoritë e ndryshme të veteranëve të UÇK-së janë përcaktuar sipas kohës së mobilizimit dhe të shërbimit në UÇK: nga viti 1991 deri më 5 mars 1998, aktivë deri në ditën e përfundimit të luftës (Kategoria e Parë); pas datës 5 mars 1998, aktivë deri në ditën e përfundimit të luftës (Kategoria e Dytë); pas datës 31 mars 1999, aktivë deri në ditën e përfundimit të luftës; dhe pas datës 31 mars 1999, aktivë deri në përfundimin e luftës, si dhe i angazhuar në luftë nga viti 1991, respektivisht pas 5 marsit 1998, por që nuk kanë qenë aktivë deri në ditën e përfundimit të luftës (Kategoria e Tretë).

122. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 4 i ligjit të kontestuar (ku shtohet një nen i ri 16A (4) në ligjin bazik) ka paraparë shumën e pensionit për secilën kategori, që është proporcionale me kohën e mobilizimit dhe të shërbimit në aktivitetet e UÇK-së.

123. Për më tepër, Gjykata rikujton se ligjvënësi gëzon diskrecion të caktuar për të vendosur lidhur me masat për arritjen e objektivave specifike dhe, sigurisht, nuk i takon Gjykatës të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga autoritetet relevante me vlerësim të vetin, lidhur me atë se cila mund të jetë politika më e mirë në këtë fushë.

124. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se raporti ndërmjet kufizimit të së drejtës në pension dhe qëllimit që synohet të arrihet me të është proporcional dhe i arsyeshëm. Prandaj, Gjykata konkludon se ekziston një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.

125. Si përmbledhje, Gjykata gjen se trajtimi ndryshe është i justifikuar në baza objektive dhe të arsyeshme dhe kësisoj neni 4 i ligjit të kontestuar (ku shtohet neni 16A (1) dhe (4) në ligjin bazik) është në pajtueshmëri me të drejtën e barazisë nga neni 24 i Kushtetutës dhe nga neni 14 i KEDNJ-së në lidhje të drejtën e pronës nga neni 46 i Kushtetutës dhe nga neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

126. Së dyti, Gjykata rikujton se, lidhur me nenin 4 të ligjit të kontestuar (ku shtohet neni 16A (1) dhe (4) në ligjin bazik), parashtruesi po ashtu pretendon se duke parashikuar kategorizimin e ri të veteranëve të luftës pa i ndryshuar, pa i plotësuar dhe pa i shfuqizuar në mënyrë eksplicite dispozitat e ligjit bazik, ligji i kontestuar është në kundërshtim me nenin 10 (2) të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, që përcakton se *"Ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi i një neni ose nënndarjeve të tij duhet të bëhet përmes një paragrafi të veçantë për çdo nen"*.

127. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Kushtetuta nuk rregullon standardet për hartimin e akteve normative. Sipas nenit 4 të Ligjit për nismat legjislative, të miratuar nga Kuvendi

i Kosovës, *"Të gjitha nismat legjislative duhet t'i përmbahen standardeve për hartimin e legjislacionit të përcaktuara nga Qeveria, nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj"*.

128. Kësisoj, Gjykata konsideron se zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative të nxjerra nga Qeveria nuk hyn në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës në kuptim të nenit 113 (5) të Kushtetutës.

129. Rrjedhimisht, ky pretendim refuzohet si i papajtueshëm *ratione materiae* me Kushtetutën.

130. Së treti, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës po ashtu kontestuan kushtetutshmërinë e nenit 4 të një teksti të ligjit të kontestuar që ishte bashkëngjitur fillimisht, e që supozohej se shtonte një paragraf të ri, paragrafin 6, në nenin 16A të ligjit bazik.

131. Në fakt, parashtruesit i bashkëngjitën kërkesës së tyre një version të ligjit të kontestuar, ku paragrafi 6, i nenit 16A, të ligjit bazik thotë:

> *"Në rast se buxheti prej 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e kosotos së përgjithshme vjetore të veteranit luftëtar, vetëm lartësia e pensionit prej 120, e paraparë në kategorinë e tretë, do t'i nënshtrohet vlerësimit në përputhje me buxhetin e paraparë në pikën 2"*.

132. Në lidhje me atë version fillestar, parashtruesit e kërkesës pohuan se *"është vetëm kategoria e tretë e veteranëve luftëtarë të UÇK-së të cilët do të përsojnë nga pamjaftueshmëria e mbulimit të shpenzimeve buxhetore për realizimin e të drejtës në pension. Një rregullim i tillë nuk i trajton në mënyrë dhe në kushte të barabarta të tri kategoritë e përfituesve të të drejtave që garantohen me ligjin bazik dhe me ligjin e kontestuar"*.

133. Megjithatë, me nenin 4 të versionit përfundimtar të ligjit të kontestuar, u shtua një paragraf i ri, paragrafi 6, në nenin 16A në ligjin bazik, ku tani thuhet:

> *Në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor Vjetor, atëherë reduktimi i pensionit ndodh në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj.*

134. Gjykata vëren se parashtruesit e kanë bazuar pretendimin e tyre në një tekst që është ndryshuar gjatë procesit të marrjes së versionit përfundimtar. Versioni përfundimtar parashikon që reduktimi i pensionit ndodh në mënyrë proporcionale për të gjithë veteranët e UÇK-së, në rast se buxheti i përgjithshëm i ndarë për përfituesit tejkalon 0.7% të BPV-së.

135. Gjykata i informoi parashtruesit e kërkesës për versionin përfundimtar të ligjit të kontestuar, siç është pranuar nga Sekretariati, dhe i ftoi ata që të dorëzonin komente lidhur me të. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë parashtresë nga parashtruesit brenda afatit të caktuar.

136. Duke marrë parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vëren se ky pretendim i ngritur nga parashtruesit është bazuar në tekstin që më pastaj ka ndryshuar në ligjin e kontestuar, siç është miratuar përfundimisht. Kësisoj, Gjykata konsideron se ky pretendim ka mbetur pa bazë dhe ndryshe nuk paraqet rast. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon këtë pretendim si të pabazuar.

137. Si përfundim, duke marrë parasysh pretendimin në tërësi, Gjykata gjen se neni 4 i Ligjit të kontestuar është në pajtueshmëri me të drejtën për barazi sipas nenit 24 të

Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, marrë në lidhje me të drejtën e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

3. Kushtetutshmëria e nenit 5 të kontestuar të ligjit të kontestuar

138. Gjykata rikujton se, me nenin 5 të ligjit të kontestuar, fshihet neni 18 i ligjit bazik, ku thuhet:

"Neni 18 i ligjit bazik, fshihet".

139. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit pohojnë se fshirja e nenit 18 të ligjit bazik "*është në kundërshtim me nenet 46 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

140. Në fakt, parashtruesit pretendojnë se "*shkelja e tillë rezulton në faktin se me nenin 18 të ligjit bazik [...] veteranëve luftëtarë të UÇK-së, si kategori e veçantë shoqërore, pa përjashtim, i është garantuar e drejta në pension, jo më pak se paga minimale në nivel të Republikës së Kosovës".*

141. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se neni 18 i ligjit bazik "*si i tillë, ishte në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të Konventës (Ndalimi i diskriminimit), sepse situata financiare do të ndryshonte si në dobi dhe në kufizim për të gjithë veteranët pa përjashtim dhe pa segregim grupor dhe individual".*

142. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se *"pensioni i garantuar me nenin 18 të ligjit bazik [...], sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, paraqet pritje legjitime (legitimate expectation) dhe shkelje të së drejtës së pronës*".

143. Në fakt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, pensioni i garantuar me nenin 18 të ligjit bazik, *"sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, paraqet pritje legjitime (legitimate expectation) dhe shkelje të së drejtës së pronës për faktin se kjo e drejtë legjitime po i mohohet kategorisë shoqërore që kishin pritje të tilla legjitime bazuar në dispozita ligjore dhe se, me ndryshimet e kontestuara, krijohet pasoja juridike direkte e cila i cenon pritjet e tilla".*

144. Parashtruesit e kërkesës konkludojnë që "*kjo e drejtë legjitime po i mohohet kategorisë shoqërore që kishin pritje të tilla legjitime bazuar ne dispozita ligjore, dhe se me [Ligjin] e kontestuar, krijohet pasoja juridike direkte e cila i cenon pritjet e tilla"* .

145. Gjykata ka parasysh nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës; nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] i KEDNJ-së dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1 të KEDNJ-së që u cituan më lart.

3.1 Zbatueshmëria e nenit 1 të Protokollit 1

(a) Parimet e përgjithshme përkitazi me fushëveprimin e dispozitës

146. Gjykata rithekson se neni 1 i Protokollit 1 përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshtron atë kushteve të caktuara; dhe, rregulli i tretë, ua njeh të drejtën shteteve, ndër të tjera, të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të

nevojshme për atë qëllim. Shih rastet e GJEDNJ-së, konkretisht *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbaijan*, kërkesa nr. 40167/06, 16 qershor 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 53080/13, i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 72.

(b) Fushëveprimi i nenit 1 të Protokollit 1 në lidhje me beneficionet e pensionit

147. Shteti mund t'ua njohë individëve të drejtën e beneficioneve të sigurimit social dhe të mirëqenies dhe mund të parashikojë që beneficionet të paguhen me kushtin e plotësimit të kritereve të kualifikueshmërisë. Parimet që aplikohen në përgjithësi në rastet nga neni 1 i Protokollit 1 janë në mënyrë të barabartë relevante kur bëhet fjalë për beneficionet sociale dhe të mirëqenies. Shih, rasti i GJEDNJ-së, *Belane Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 80.

148. Sidoqoftë, kushtet relevante ligjore janë objekt i ndryshimit. Në këtë drejtim, mund të ritheksohet që GJEDNJ-ja ka gjetur se e drejta e beneficionit social është, për aq sa parashihet në legjislacionin e aplikueshëm, e drejtë monetare për qëllime të nenit 1 të Protokollit 1. Pensioni, në rrethana të caktuara dhe sipas ligjit vendës, krijon një të drejtë të pronës. Shih, *Gaygusuz kundër Austrisë,* kërkesa nr. 17371/90, 16 shtator 1996, paragrafi 41.

149. Gjykata prapë rikujton se GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar që legjislacioni në fuqi që parasheh pagesën si një e drejtë për beneficion të mirëqenies, duhet të konsiderohet se gjeneron një interes pronësor që hyn në sferën e nenit 1 të Protokollit 1 për personat që plotësojnë kërkesat e tij. Shih *Belane Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 82.

150. Një ndërhyrje në të drejtat nga neni 1 i Protokollit 1 mund të rezultojë nëse pezullimi ose zvogëlimi i një pensioni nuk është si pasojë e ndonjë ndryshimi në vetë rrethanat e parashtruesit por është si pasojë e ndryshimeve në ligj ose në zbatimin e tij. Shih rastet e GJEDNJ-së: *Grudić kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 77; *Belane Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 85.

151. Fakti që një person ka hyrë dhe bën pjesë në një sistem të sigurimit social shtetëror nuk do të thotë domosdoshmërisht që sistemi nuk mund të ndryshojë, si për nga kushtet e kualifikueshmërisë së pagesës apo për nga shuma e beneficionit ose pensionit. Shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafët 85-89; *Belane Nagy kundër Hungarisë*, cituar më lart, paragrafi 88.

152. Në të vërtetë, GJEDNJ-ja ka pranuar mundësinë e ndryshimeve në legjislacionin e sigurimit social që mund të miratohen si përgjigje ndaj ndryshimeve shoqërore dhe pikëpamjeve evoluese për kategoritë e personave që kanë nevojë për asistencë sociale, si dhe ndaj evoluimit të situatave individuale. Shih, *Wieczorek kundër Polonisë*, kërkesa nr. 18176/05, 8 dhjetor 2009, paragrafi 67.

3.2 Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

153. Gjykata rikujton se fushëveprimi i nenit 1 të Protokollit 1 përfshin tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura.

a. Gëzimi paqësor i pronës

154. Gjykata vëren se çështja që duhet të shqyrtohet është nëse pensioni për veteranë të UÇK-së përbën pasuri në kuptim të së drejtës për gëzim paqësor të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1.

155. Gjithashtu, Gjykata vëren se neni 18 i ligjit bazik garantonte pension jo më të ulët se paga minimale. Megjithatë, me nenin 5 të ligjit të kontestuar është fshirë neni 18 i ligjit bazik. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se kjo fshirje është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1. Prandaj, Gjykata gjithashtu do të shqyrtojë nëse fshirja është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në, siç është interpretuar nga GJEDNJ-ja.

156. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit të fshirë 18 [Lartësia e shumës së pensioneve] të ligjit bazik, që përcaktonte:

> *"Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë".*

157. Gjykata rikujton se neni 5 i ligjit të kontestuar parasheh:

> *Neni 18 i ligjit bazik, fshihet.*

158. Gjykata vëren se me nenin 4 të ligjit të kontestuar shtohet neni 16A në ligjin bazik, që parasheh:

> *4. Pensioni mujor i veteranit luftëtar, sipas kategorive, është:*
> *4.1. Kategoria e parë, dyqind e pesëdhjetë (250) euro;*
> *4.2. Kategoria e dytë, njëqind e shtatëdhjetë (170) euro;*
> *4.3. Kategoria e tretë, njëqind e njëzet (120) euro.*

159. Gjykata po ashtu i referohet nenit 57 [Paga minimale] të Ligjit nr. 03/L – 212 të Punës, që parasheh:

> *"1. Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshilli Ekonomiko-Social".*

160. Gjykata vëren që, më 17 gusht 2011, Qeveria (Vendimi nr. 04/33) e përcaktoi pagën minimale në Kosovë, si në vijim:
> - 130.00 euro për të punësuarit nën moshën 35-vjeçare, dhe
> - 170.00 euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare deri në moshën 65-vjeçare.

161. Gjykata vëren se pensioni mujor i veteranit të UÇK-së nën Kategorinë e Dytë dhe të Tretë, siç është përcaktuar me veprim të nenit 4 të ligjit të kontestuar, mund të jetë më i ulët se paga minimale e përcaktuar. Kësisoj, çështja është nëse pensioni mujor më i ulët se paga minimale duhet t'u japë të drejtë përfituesve në posedim të pagës minimale, siç është paraparë me nenin e fshirë 18 të ligjit bazik.

162. Përkitazi me këtë, Gjykata konkludon që e drejta e veteranëve të UÇK-së në pension, siç garantohet me ligjin bazik dhe me ligjin e kontestuar, përbën pasuri në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1.

b. Kushtet e privimit nga pasuria

163. Siç u përmend më lart, rregulli i dytë i nenit 1 të Protokollit 1 trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshtron atë privim kushteve të caktuara.

164. Në këtë drejtim, Gjykata do të shqyrtojë nëse ka ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës së të drejtës së pensionit të veteranëve të UÇK-së. Nëse ka, atëherë a i shërben kjo ndërhyrje interesit publik dhe, pastaj, a është proporcionale për arritjen e atij qëllimi.

165. Gjykata rikujton se ajo konkludoi që e drejta e veteranëve të UÇK-së në pension është e drejtë e pronës. Mirëpo, një çështje tjetër që duhet pasur parasysh në vlerësimin sipas nenit 1 të Protokollit 1 është nëse përfituesit e pensionit të veteranëve të UÇK-së kanë të drejtë në pension të një shume minimale.

166. Gjykata rikujton se neni 1 i Protokollit 1, si i tillë, nuk garanton ndonjë të drejtë në pension në shumë të caktuar, edhe pse në rastet kur shuma e beneficionit reduktohet ose ndërpritet, kjo mund të paraqet ndërhyrje në pasuri që duhet të justifikohet.

167. Gjykata gjithashtu rikujton se GJEDNJ-ja, në vendime relevante, ka pasur parasysh tri konsiderata themelore me rastin e vlerësimit të kërkesave lidhur me beneficionet sociale ose me pensionet, konkretisht nëse veprimi ka qenë i ligjshëm, jodiskriminues dhe proporcional me interesin e përgjithshëm ose publik të synuar.

168. Gjykata vëren se neni 18 [Lartësia e shumës së pensioneve] i ligjit bazik (i fshirë me nenin 5 të ligjit të kontestuar) kishte përcaktuar lartësinë e pensionit për veteranët luftëtarë të UÇK-së *"Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, [...], cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë"*.

169. Gjykata rithekson se Memorandumi shpjegues thekson që *"qëllimi kryesor i miratimit të* [ligjit të kontestuar] *është orientuar që të krijohet stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare për Buxhetin e Kosovës"*.

170. Gjykata më tej vëren se neni 16A (2) i ligjit bazik (shtuar me nenin 4 të ligjit të kontestuar) thotë:

> *Buxheti i përgjithshëm për realizimin e pagesës së pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit.*

171. Përveç kësaj, Gjykata vëren se neni 16A (3) i ligjit bazik (shtuar me nenin 4 të ligjit të kontestuar) parasheh:

> *"Skema e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, zbatohet pas kategorizimit përfundimtar. Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik"*.

172. Për më tepër, Gjykata vëren se neni 16A (4) i ligjit bazik (shtuar me nenin 4 të ligjit të kontestuar) kishte përcaktuar shumën e pensionit mujor në pajtim me tri kategoritë e definuara si më lart.

173. Gjykata vëren se neni 16A i ligjit bazik (shtuar me nenin 4 të ligjit të kontestuar) dhe neni 16 [Pensioni personal i veteranit luftëtar] i ligjit bazik parashohin situatën e pensioneve kumulative.

174. Gjykata i referohet nenit 16A (6) të ligjit bazik (i shtuar me nenin 4 të Ligjit të kontestuar), i cili parasheh:

> *Në rast të tejkalimit të 0.7% te Bruto Prodhimit Vendor Vjetor, atëherë reduktimi i pensionit ndodh në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj.*

175. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 16 të ligjit bazik që parasheh:

> *"[...]*
> *2. Veterani luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.*
> *3. Veterani luftëtar i UÇK-së, i cili merr pension të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, sipas Ligjit nr. 03/L-100 për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 41/01, nëntor 2008), duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.*
> *[...]"*

176. Gjykata vëren se skema e pensionit do të vazhdojë të implementohet siç është paraparë në ligjin bazik deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve të UÇK-së dhe ata që janë të punësuar në sektorin publik ose privat nuk kanë të drejtë në pension.

177. Gjykata rikujton se neni i fshirë 18 i ligjit bazik kishte përcaktuar lartësinë e pensionit për veteranët e UÇK-së, ashtu që ajo "*nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë*".

178. Gjykata vëren se, përveç vlerësimeve të mësipërme, ligji i kontestuar po ashtu parasheh nëpërmjet nenit 16A (4) në ligjin bazik (shtuar me nenin 4 të ligjit të kontestuar) një kategorizim më preciz të veteranëve të UÇK-së, me sa duket duke i lejuar një grupi më të madh që të përfitojë nga Ligji, në pajtim me kohën përkatëse të mobilizimit dhe të shërbimit në kontributin e UÇK-së. Për më tepër, ligji i kontestuar përcakton një shumë të përgjithshme fikse që përbën buxhetin e përgjithshëm për realizimin e pagesës së pensionit të veteranit të UÇK-së, që "*nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit*".

179. Gjykata konsideron se, në këtë mënyrë, ligji i kontestuar ka përcaktuar një shumë totale fikse sa i përket BPV-së në vit, që ndahet për qëllimin ekskluziv të pagesës së pensioneve të veteranit të UÇK-së dhe shuma të ndryshme të pensionit paguhen në pajtim me kategoritë e përcaktuara. Në fakt, ligji i kontestuar merr parasysh jo vetëm interesin e gjerë publik, por edhe kohën e ndryshme të mobilizimit dhe të shërbimit të veteranëve të UÇK-së.

180. Prandaj, Gjykata konkludon se kjo masë përbën ndërhyrje të justifikuar në pasuri, pra një mjet të lejuar të shtetit për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës.

c. Kontrolli i shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm

181. Gjykata rikujton se ligjvënësi gëzon një margjinë më specifike të vlerësimit të lirë kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme të strategjisë ekonomike dhe sociale.

182. Gjykata, duke vërejtur faktet e përshkruara më lart, konsideron se institucionet shtetërore në procesin e propozimit dhe të miratimit të nenit 5 të ligjit të kontestuar vepruan në kuadër të margjinës së tyre të vlerësimit të lirë.

183. Në fakt, Gjykata tashmë ka konkluduar që pensioni për veteranë të UÇK-së përbën pasuri në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 dhe se ka ndërhyrje të justifikuar në gëzimin e lirë të së drejtës së pronës mbi bazën e shërbimit të interesit publik dhe duke pasur vëmendjen e duhur për parimin e proporcionalitetit. Në fakt, reduktimi i shumës është brenda kornizës së arsyeshme dhe aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjitha kategoritë e veteranëve të UÇK-së.

184. Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludon që, në dritën e rrethanave mbizotëruese të rastit dhe të vlerësimeve të përshkruara më lart, veprimi i ligjvënësit nëpërmjet miratimit të nenit 5 të kontestuar ka qenë i ligjshëm, joarbitrar dhe jodiskriminues mbi asnjë bazë të caktuar; ka qenë proporcional me interesat publike të synuara.

185. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë që pensioni i veteranëve të UÇK-së, i garantuar me nenin e fshirë 18 të ligjit bazik, *"sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, paraqet pritje legjitime (...)"*.

186. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 (1) të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se ky pretendim përkon me pretendimet që ata kanë ngritur sipas nenit 1 të Protokollit 1. Në këtë drejtim, Gjykata nuk ka gjetur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

187. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të ekzaminojë ndaras atë pohim sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të KEDNJ-së, pasi që i njëjti nuk përmban ndonjë pretendim që mund të çojë në një të gjetur tjetër.

188. Si përmbledhje, Gjykata gjen se neni 5 i ligjit të kontestuar, me të cilin u fshi neni 18 i ligjit bazik, është në pajtueshmëri me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1.

Konkluzion

189. Pasi vlerësoi, shqyrtoi dhe arriti në përfundim si më lart, Gjykata gjen se:

1. Neni 3 (2) i ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës;

2. Neni 4 i ligjit të kontestuar është në pajtueshmëri me nenin 24 të Kushtetutës dhe me nenin 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe

3. Neni 5 i ligjit të kontestuar është në pajtueshmëri me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (5) të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 42 të Ligjit dhe me rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, më 28 mars, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË SHPALLË që paragrafi dy (2) i nenit 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilin u shtuan paragrafët 5 dhe 6 në nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën;

III. TË SHPALLË që neni 4 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilin u shtuan neni 16A, paragrafët 1, nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 në Ligjin nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është në pajtueshmëri me Kushtetutën;

IV. TË SHPALLË që neni 5 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilin u fshi neni 18 i Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është në pajtueshmëri me Kushtetutën;

V. TË SHPALLË që, në bazë të nenit 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, Ligji i miratuar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-241 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje me përjashtim të paragrafit 2 (dy) të nenit 3;

VI. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

VII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

VIII. TË SHPALLË që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Arta Rama-Hajrizi

KO12/17, Parashtruesi i kërkesës: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

KO12/17, Aktgjykim i 9 majit 2017, i publikuar më 30 maj 2017

Fjalët kyçe*: kërkesë institucionale, Avokati i Popullit, kundërvajtjet, e drejta për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur, kërkesë e pranueshme.*

Në këtë rast, Avokati i Popullit në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63 , 64, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje nuk janë në pajtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Dispozitat e mësipërme të Ligjit për Kundërvajtje delegojnë kompetenca të caktuara gjyqësore lidhur me kundërvajtjet tek organet administrative sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Kundërvajtje.

Pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parashikuara më tej me Ligj dhe të parapara me rregullat e procedurës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës, Gjykata arriti në përfundim se kundërvajtjet bien në kuadër të fushës së veprës penale "akuza penale" brenda kuptimit të Kushtetutës. Megjithatë, mundësia e ankesës në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë përmbush kërkesën për qasje në një seancë të drejtë dhe të paanshme për një akuzë penale. Prandaj, Gjykata ka gjetur se dispozitat e kontestuara të ligjit të kontestuar janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASAVE TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO12/17

Parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Ligji i kontestuar), i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2017, përkatësisht nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar të referuara më lart, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon nga Gjykata që të vendosë masa të përkohshme, duke suspenduar zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit të kontestuar deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 2, nën-paragrafin 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55, 56, 62, dhe 64 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë pas miratimit të masave së përkohshme

6. Më 15 shkurt 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës miratimin e masave të përkohshme në rastin nr. KO12/17. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masat e përkohshme deri më 30 prill 2017.

7. Më 16 shkurt 2017, Sekretariati i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumente relevante për rastin, duke përfshirë Memorandumin shpjegues të Ligjit të kontestuar; Certifikatën e përputhshmërisë me "*Acquis të BE-së"* të nxjerrë nga Ministria e Integrimit Evropian; Certifikatën mbi Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të lëshuar nga Ministria e Financave; dhe Certifikatën e Pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

8. Më 28 shkurt 2017, Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Legjislacion) dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën.

9. Më 3 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Avokatin e Popullit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me komentet e pranuara nga Komisioni për Legjislacion dhe dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit, si dhe u dorëzoi kopjet e të gjitha parashtresave. Gjykata gjithashtu i njoftoi se ata mund të paraqesin komentet e tyre shtesë, nëse kanë, deri më 13 mars 2017.

10. Më 13 mars 2017, Avokati i Popullit dorëzoi përgjigjen lidhur me komentet e dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion, si dhe lidhur me dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit.

11. Më 14 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Sekretariatin e Kuvendit në lidhje me përgjigjen e pranuar nga Avokati i Popullit dhe u dorëzoi nga një kopje duke u dhënë mundësinë të ofrojnë komente shtesë, nëse kanë, deri më 21 mars 2017. Gjykata nuk pranoi asnjë koment.

12. Më 5 prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese që i rekomandonte Gjykatës vazhdimin e masave të përkohshme, të miratuara më 15 shkurt 2017. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi të vazhdojë masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017.

Përkitazi me vazhdimin e masave së përkohshme

13. Gjykata i referohet Vendimit të saj për masat e përkohshme të 15 shkurtit 2017 në këtë rast.

14. Gjykata vëren se palë të interesuara për pranueshmërinë dhe meritat e kësaj kërkese kanë dorëzuar vëllim të konsiderueshëm të dokumenteve dhe të komenteve. Gjykata konsideron se duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha argumenteve të paraqitura.

15. Rrjedhimisht, pa paragjykim të çfarëdo vendimi të mëtejmë që do të nxirret nga Gjykata në të ardhmen përkitazi me pranueshmërinë ose me meritat e kësaj kërkese, Gjykata vendos të vazhdojë masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, me nenin 27 të Ligjit dhe me rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës, më 5 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA VAZHDOJË masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017;

II. TA VAZHDOJË PEZULLIMIN e zbatimit të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje, gjatë kohëzgjatjes së njëjtë;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr. 50/2017, të 6 marsit 2017

KI34/17, Vendim për vazhdim të masës së përkohshme i 2 majit 2017, publikuar më 4 maj 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, vendimi për vazhdimin e masës së përkohshme, e drejta për zgjedhje, pozita e Kryetarit të Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

Në këtë rast parashtruesja e kërkesës u ankua se e drejta e saj për zgjedhje ishte cenuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ngase nuk ishte emëruar në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kërkoi caktimin e masës së përkohshme.

Gjykata, pa paragjykuar ndonjë vendim të mëtejshëm që do të merret për pranueshmërinë apo meritat e kërkesës në të ardhmen, vendos që miratimi i masës së përkohshme të vazhdojë deri më 16 qershor 2017.

VENDIM PËR VAZHDIM TË MASËS SË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KI34/17

Parashtrues

Valdete Daka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Valdete Daka (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini".

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartcekur të KGJK-së. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me këtë vendim janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me neni 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë dekretimin e z. Enver Peci në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme në pritje të vendimit të Gjykatës lidhur me kërkesën.

5. Parashtruesja gjithashtu kërkon nga Gjykata që të caktojë një seancë dëgjimore në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 16 mars 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 17 mars 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

10. Gjykata ftoi KGJK-në të paraqesë komentet e saj, nëse ka, deri më 23 mars 2017.

11. Më 23 mars 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj në Gjykatë.

12. Më 23 mars 2017, komentet e KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua që të paraqesë komente shtesë deri më 5 prill 2017.

13. Më 27 mars 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Kolegjit shqyrtues miratimin e masës së përkohshme.

14. Në të njëjtën datë, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme.

15. Në të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri ta miratojë masën e përkohshme deri më 16 maj 2017.

16. Më 31 mars 2017, parashtruesja e plotësoi kërkesën e saj me argumente shtesë dhe shkeljet e pretenduara të të drejtave të saj kushtetuese.

17. Më 3 prill 2017, Gjykata dërgoi parashtresën e parashtrueses në KGJK dhe i ftoi ata të paraqesin komente, nëse kanë, deri më 7 prill 2017.

18. Më 7 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj lidhur me plotësimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, KGJK-ja paraqiti komente shtesë.

19. Më 12 prill 2017, komentet shtesë të KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua të paraqesë ndonjë koment deri më 18 prill 2017.

20. Në të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga KGJK-ja që të parashtrojë, jo më vonë se më 18 prill 2017: (I) procesverbalin e mbledhjes së KGJK-së kur u votuan kandidatët për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; (II) dokumente tjera relevante që ata i konsiderojnë të nevojshme për tërë procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; dhe (III) sqarimi i kritereve për vlerësimin e meritave të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

21. Më 18 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj në Gjykatë.

22. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese që i rekomandonte Gjykatës vazhdimin e masës së përkohshme, të miratuar tashmë më 27 mars 2017, deri më 16 qershor 2017.

Lidhur me vazhdimin e masës së përkohshme

23. Gjykata i referohet Vendimit të saj për masë të përkohshme të 27 marsit 2017 në rastin KI 34/17.

24. Gjykata vëren se palët në këtë kërkesë kanë parashtruar argumente, dokumente dhe komente shtesë. Gjykata konsideron se duhet t'i kushtohet vëmendje të gjitha argumenteve të parashtruara.

25. Prandaj, Gjykata, pa paragjykuar ndonjë vendim të mëtejshëm që do të merret nga Gjykata për pranueshmërinë apo meritat e kërkesës në të ardhmen, vendos që miratimi i masës së përkohshme të vazhdojë deri më 16 qershor 2017.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit dhe rregullave 54 dhe 55 të Rregullores së punës, më 2 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA VAZHDOJË masën e përkohshme të miratuar më 27 mars 2017, përkatësisht të pezullojë procedurën e emërimit të kandidatit për Kryetar të Gjykatës Supreme nga Presidenti i Republikës së Kosovës për të njëjtën kohëzgjatje;

II. Që vazhdimi i kësaj mase të përkohshme do të zgjasë deri më 16 qershor 2017;

III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim Palëve dhe Presidentit të Republikës së Kosovës;

IV. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI105/16, Parashtrues: Fetih Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009

KI105/16, Vendim për refuzim të kërkesës, i 4 prillit 2017, publikuar më 10 maj 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, përsëritje e procedurës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, refuzim me procedurë të shkurtër, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut te shkaktuara nga Gjykata Supreme. Parashtruesi të nijetin pretendim në Gjykate e kishte ngritur edhe në rastet KI74/09 dhe KI64/11, ku rasti i tij ishte deklaruar i papranueshëm për shkak të humbjes së afatit ligjor.

Gjykata, në këtë rast ritheksoi se ankimi individual sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritshme nga Gjykata rihapjen e vendimeve të saj dhe gjykimin e serishëm për të njëjtën çështje. Si përfundim, Gjykata gjeti se kërkesa e parashtruesit, në fakt, ishte kërkesë për përsëritjen e procedurave të mëhershme, tashmë të vendosura nga Gjykata.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI105/16

Parashtrues

Feti Gashi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Feti Gashi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Mramor, komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson Skënder Musa, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar).

3. Lidhur me të njëjtën çështje parashtruesi i kërkesës më parë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), kishte dorëzuar kërkesat KI74/09 dhe KI64/11.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës së tanishme është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet shkelja e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 gusht 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 19 gusht 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 13 dhjetor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 4 prill 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtë.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 dhjetor 2009, parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën KI74/09. Me këtë kërkesë parashtruesi kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009, me të cilin pretendonte se i ishte shkelur e drejta në punë.

11. Më 15 dhjetor 2010, Gjykata, në bazë të propozimit të gjyqtarit raportues dhe të rekomandimeve të Kolegjit shqyrtues, kërkesën KI74/09 e deklaroi të paafatshme dhe, rrjedhimisht të papranueshme.

12. Më 12 maj 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI64/11, me pretendimin se kërkesën KI74/09 e kishte dorëzuar brenda afatit kohor për faktin se më 16 mars 2009 ia kishte dorëzuar një shkresë kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, dhe ishte në pritje të përgjigjes së asaj shkrese. Sipas parashtruesit të kërkesës, shkresa në fjalë përbënte fakt për nxjerrjen e një vendimi të ri nga Gjykata, për arsye se, sipas tij, procedura ende nuk kishte përfunduar në lidhje me çështjen e tij juridike.

13. Më 14 shkurt 2012, Gjykata, bazuar në rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës të Gjykatës, kërkesën KI64/11 e deklaroi të papranueshme, për shkak se e njëjta nuk paraqiste bazë ose fakt të ri dhe të rëndësishëm për nxjerrjen e një vendimi të ri.

14. Më 11 gusht 2016, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën KI105/16, ku objekti i çështjes është i njëjti me kërkesat KI74/09 dhe KI64/11, përkatësisht vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi në kërkesën e tanishme, pretendon se Gjykata Supreme shkeli të drejtën për mbrojte gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, dhe të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.

16. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: *"... që ta shqyrtoj kërkesën në mënyrë meritore dhe t'i vërtetojë shkeljet ligjore, dhe parashtruesit të kërkesës t'i jepet mundësia që të kthehet në punë, pasi që ta anuloni aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.184/2008 ..."*.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në bazë të shkresave të lëndës dhe të dokumenteve të prezantuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se objekti i çështjes së kërkesës së tanishme KI105/16 është i

njëjtë me rastet KI74/09 dhe KI64/11, në të cilat parashtruesi kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 184/2008, të 27 janarit 2009.

18. Gjykata vëren se kërkesa e tanishme KI105/16 e parashtruesit të kërkesës nuk paraqet ndonjë fakt të rëndësishëm për nxjerrjen e një vendimi të ri, por është thjesht përpjekje e sërishme e parashtruesit të kërkesës, për të kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 184/2008.

19. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze."*

20. Duke u mbështetur në rregullin e sipërshënuar, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme është thjesht përsëritje e kërkesave të mëparshme, përkatësisht kërkesave KI74/09 dhe KI64/11, të cilat Gjykata i kishte deklaruar të papranueshme për shkak të parashtrimit të tyre jashtë afatit katër mujor.

21. Gjykata rikujton se ankimi individual sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritshme nga Gjykata rihapjen e vendimeve të saj dhe gjykimin e sërishëm për të njëjtën çështje.

22. Për më tepër, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shih, ndër të tjera, vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI26/14, parashtrues *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafi 26 dhe 27).

23. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit, në fakt, është kërkesë për përsëritjen e procedurave të mëhershme, tashmë të vendosura nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, kërkesa refuzohet me procedurë të shkurtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu Arta Rama-Hajrizi

KI103/16 Parashtrues i kërkesës: Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. nr. 174/16, të 11 korrikut 2016

KI103/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 prillit 2017, i publikuar më 10 maj 2017

Fjalët kyçe: kërkesë individuale/person juridik, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe të punësuarit të tij u zhvillua procedura e brendshme në lidhje me mos vazhdimin e kontratës. Kjo procedurë gjithashtu kaloi nëpër faza të ndryshme në procedurën e rregullt gjyqësore deri në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit në detaje i shpjegoi parashtruesit të kërkesës se kishte detyrim ligjor ta paraqes padinë brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh. Kjo është arsyeja pse padia e tij ishte hedhur poshtë si e paafatshme.

Gjykata vëren se interpretimi i dispozitave që kanë të bëjnë me afatet ligjore është kompetencë e gjykatave të rregullta dhe si rrjedhojë është çështje e ligjshmërisë. Prandaj, ai kërkon nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe aktgjykimin ligjor.

Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike ose të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, në procesin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

Rrjedhimisht, Gjykata konsideron, në baza kushtetuese, se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI103/16

Parashtrues

Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 174/16, të 11 korrikut 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Shefqet Hasimi, zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e Avokaturës Shtetërore.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AA. nr. 174/16, të 11 korrikut 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend, konkretisht, nenet e Kushtetutës të cilat janë shkelur, por ai vetëm thekson se vendimi i kontestuar, si dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK) janë në kundërshtim me parimin *res judicata*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 gusht 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 tetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 2 dhjetor 2016, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

9. Më 30 mars 2017, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 2011, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe të punësuarit N. Sh. u zhvillua procedura e brendshme në lidhje me mosvazhdimin e kontratës.

11. Më 1 shkurt 2011, përfundoi procedura e brendshme [Vendimi nr. 05-5971/7] dhe ankesa e N. Sh. kundër mosvazhdimit të marrëdhënies së punës u refuzua.

12. Kundër Vendimit [nr. 05-5971/7] të parashtruesit të kërkesës, N. Sh. paraqiti ankesë në KPMK.
13. Më 22 prill 2011, KPMK [Vendimi nr. 02 (47)2011] e aprovoi ankesën e N. Sh., i anuloi të gjitha veprimet e mëparshme procedurale dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që N. Sh. ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës.

14. Më 9 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës [Vendimi nr. 64(VI)2011] e ktheu N. Sh. në vendin e mëparshëm të punës dhe më 13 qershor 2011, e informoi KPMK-në në lidhje me përmbarimin e vendimit të tij [nr. 02 (47) 2011].

15. Më pas, N. Sh. paraqiti propozim për përmbarim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilin kërkoi kompensim monetar për pagat për periudhën nga 1 shkurti 2011 deri më 9 qershor 2011, përkatësisht për periudhën në të cilën nuk ishte në marrëdhënie të punës.

16. Më 16 dhjetor 2011, Gjykata Themelore në Prishtinë [Aktvendimi E. nr. 807/2011] refuzoi propozimin e N. Sh. për përmbarim, duke konsideruar se me Vendimin [nr. 64 (VI)2011], parashtruesi i kërkesës e ka përmbaruar Vendimin [nr. 02 (47) 2011] e KPMK-së.

17. N. Sh. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 14 maj 2013, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ac. nr. 3021/2012] e refuzoi ankesën e N. Sh. si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar: *"Sa i përket kompensimit të pagave edhe kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar përmbarimin sepse në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nuk parashihet detyrimi që këtu debitori, këtu kreditori t'ia kompensoj pagat, andaj në kuptim të nenit 23 dhe 24*

të LPP mungon baza juridike për caktimin e përmbarimit, përkatësisht mungon titulli ekzekutiv. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar sepse të drejtën e tij që ti paguhen pagat mund ta realizoj në procedurë të posaçme kontestimore."

19. Më 22 prill 2013, N. Sh. përsëri paraqiti ankesë në KPMK, me propozim që parashtruesi i kërkesës të detyrohet që t'ia kompensojë pagat për periudhën gjatë së cilës ishte larguar nga puna, nga 1 janari 2011 deri me 9 qershor 2011.

20. Më 28 qershor 2013, KPMK [Vendimi A 02/184/2013] e aprovoi ankesën e N. Sh. dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që t'ia kompensojë pagat për periudhën gjatë së cilës ishte larguar nga puna, nga 1 janari 2011. deri më 9 qershor 2011. Në këshillën juridike të këtij vendimi thuhet se pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest administrativ në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh.

21. Më 19 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës kundër Vendimit [A 02/184/2013] të KPMK-së paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

22. Më 12 prill 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë [Aktvendimi A. nr. 1102/13] hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme.
23. Parashtruesi i kërkesës kundër këtij aktvendimi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.

24. Më 11 korrik 2016, Gjykata e Apelit [Aktvendimi AA. nr. 174/2016] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në arsyetimin, Gjykata e Apelit *inter alia*, theksoi:

> *"... Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka hedhë poshtë padinë e paditëses në këtë çështje juridiko-administrative si të paafatshme, ngase paditësja nuk ju ka përmbajtur afatit ligjor, se ka paraqitur padi në gjykatë, pas 34 ditëve nga data kur ka filluar të rrjedh afati për parashtrimin e padisë, duke lëshuar afatin ligjorë për paraqitjen e të njëjtës, sipas dispozitës së nenit 27 të LKA-së. Prandaj thëniet e ankesës së sipas detyrës zyrtare është dashtë të merret aktvendim për çështjen e gjykuar sipas nenit 391 pika d) të LPK-së, ky kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë."*

25. Parashtruesi i kërkesës i propozoi Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit inicimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

26. Më 29 korrik 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit [Njoftimi KLMC. nr. 16/06] njoftoi parashtruesin e kërkesës se në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës e ka bazuar kërkesën e tij në faktin se KPMK-ja dhe gjykatat e rregullta nuk e kanë aplikuar drejt parimin *res judicata* me rastin e zgjidhjes së kontestit të tij.

28. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson: *"[...] Gjykata Themelore në Prishtinë sipas shenjës A. nr. 1102/13 refuzon si e pasafatshme, ndërsa sipas detyrës zyrtare nuk kujdeset së a është çështja e gjykuar (res judicata). [...]"*

29. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon: *"Me anë të kësaj shkrese drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me kërkesë për ta vlerësua kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimeve kontestuese me shkelje të ligjeve. Vendimi i KPMK-së A 02/184/2013 i datës 28.06.2013 si çështje Res judicata të vendimit nr. 02/47/2011 i datës 22.04.2011, [...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

32. Në vazhdim, Gjykata i referohet edhe nenit 21.4 të Kushtetutës i cili përcakton:

> *"[...]*
> *4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

33. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

34. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (2) (d)) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*
> *[...]*
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

35. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet procedurale të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të vërtetuar pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit si dhe kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

36. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës është *"vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë"* të vendimeve të kontestuara.

37. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tij. Ai vetëm kërkon vlerësimin e

kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pa specifikuar nene të veçanta të Kushtetutës që janë shkelur.

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në detaje i shpjegon parashtruesit të kërkesës se kishte detyrim ligjor ta paraqes padinë brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh. Kjo është arsyeja pse padia e tij ishte hedhur poshtë si e paafatshme. Pak më shumë lidhur me këtë pikë, Gjykata vëren se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk mund të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pikërisht sepse padia e tij në Gjykatën Themelore ishte e paafatshme.

39. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Mosshfrytëzimi i kësaj mundësie do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar.

40. Gjykata rikujton, që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte përmbushur kushtin ligjor për ta paraqitur ankesën brenda afatit ligjor tek gjykatat e rregullta dhe kështu nuk u kishte dhënë mundësinë gjykatave të rregullta që ta shqyrtojnë këtë çështje. *(Shih, Aktvendimi në rastin KI24/16, Avdi Haziri,* Vlerësim i Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pev. nr. 191/2015, i 1 shtatorit 2015, paragrafi 39; Aktvendimi në rastin KI139/12, *Besnik Asllani,* Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012, i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; Aktvendimi në rastin nr. KI07/09, *Demë KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ,* Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18; Aktvendim në rastin nr. KI89/15, *Fatmir Koci,* Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr.473/2014, i 21 nëntorit 2014, paragrafi 35; dhe shih *mutatis mutandis*, *Selmouni kundër Francës, [DHM] § 74; Kudla kundër Polonisë [DHM] § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë* [aktvendim]).

41. Gjykata vëren se interpretimi i dispozitave që kanë të bëjnë me afatet ligjore është kompetencë e gjykatave të rregullta dhe si rrjedhojë është çështje e ligjshmërisë.

42. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se parashtruesi vetëm kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë, pa mbështetur se si ka ndodhur shkelja kushtetuese, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

43. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike ose të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, në procesin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

44. Në fakt, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

45. Gjykata rikujton se nuk është gjykatë për gjetjen e fakteve, dhe në këtë mënyrë, vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe nuk mund, pra, të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, shih, gjithashtu: *mutatis mutandis* rastin KI47-48/15, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II-14-0057 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 12 marsit 2015, parashtruesi i kërkesës: *Beqir Kosokoviku dhe Mustafë Lutolli*).

46. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të shërbejë si e drejtë për të iniciuar pretendim të argumentueshëm për shkelje të Kushtetutës (shih, për shembull, rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci,* Aktvendimi për papranueshmërinë, të 28 majit 2012, paragrafi 28).

47. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron, në baza kushtetuese, se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme siç parashikohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, përcaktohet në nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej në rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI44/16 Parashtruesja e kërkesës: Biljana Topko nga Beogradi, Republika e Serbisë, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A225/13, të 4 shtatorit 2015

KI44/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2017, i publikuar më 10 maj 2017

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, qartazi e pabazuar

Parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Parashtruesja paraqiti kërkesë në Komisionin e Kërkesave Pronësore të Agjencisë Kosovare të Pronës, duke kërkuar mbrojtjen e të drejtës pronësore mbi pronën, të cilën e mori nga Komuna e Suharekës në shfrytëzim të përkohshëm. Procedura gjyqësore në fjalë kaloi nëpër shkallë të ndryshme deri në Gjykatën Supreme.

Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtrueses si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës më të ulët.

Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Agjencisë Kosovare të Pronës shkelin të drejtat e saj për mjetin efektiv juridik, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtjen e pronës dhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave.

Prandaj, ajo kërkon nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe aktgjykimin ligjor.

Gjykata vëren se Kolegji i Apelit e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar sepse ajo nuk është bartëse e të drejtës në pronë; përkundrazi, ajo është përpjekur të fitojë pronën, që do të thotë se parashtruesja e kërkesës ka pasur vetëm shpresën e njohjes së të drejtave të pronësisë.

Për më tepër, Gjykata çmon se Kolegji i Apelit kishte dhënë arsyetim të qartë dhe konkludime të sakta në bazë të gjendjes faktike e cila është vërtetuar në procedurën gjyqësore. Nga ana tjetër, parashtruesja e kërkesës nuk shpjegoi se si dhe pse u shkelën të drejtat e saj me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së, i cili konkludoi se kërkesa e saj është e pabazuar.

Parashtruesja e kërkesës nuk ofroi dëshmi se procedurat para gjykatave të rregullta ishin të padrejta apo arbitrare, apo se janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, si e tillë, duhet të deklarohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI44/16

Parashtrues

Biljana Topko

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-225/13, të 4 shtatorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Biljana Topko nga Beogradi, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), GSK-KPA-së-A-225/13, të 4 shtatorit 2015.

3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 6 nëntor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në

rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 mars 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 26 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.

9. Më 13 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues kryesues të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016, dha dorëheqje si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 31 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 23 janar 1997, parashtruesja e kërkesës me Aktvendimin (Oz. nr. 351-106) e Komunës së Suharekës mori ngastër për përdorim të përkohshëm, si dhe leje për ndërtimin e objektit të përkohshëm montues (garazh) në të njëjtën ngastër.

12. Pas kësaj, parashtruesja e kërkesës në pronën e lartpërmendur lëndore ndërtoi një objekt montues dhe e shfrytëzoi pa pengesë deri në vitin 1999.

13. Më 5 dhjetor 2006, parashtruesja paraqiti kërkesë në Komisionin e Kërkesave Pronësore të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: KKPK) duke kërkuar mbrojtjen e të drejtës pronësore të pronës lëndore, të cilën ia kanë dhënë përkohësisht me aktvendimin e lartpërmendur.

14. Më 14 dhjetor 2012, KKPK-ja (me Vendimin KPCC/D/C184/2012) e refuzoi kërkesën e parashtrueses për shkak të mungesës së juridiksionit, duke konsideruar se prona e kontestuar nuk bie në kategorinë e pasurive të patundshme. KKPK-ja në arsyetimin e aktgjykimit të vet, thekson, *inter alia*, që:

> *"[...] Në bazë të aktvendimit, Komuna e Suharekës parashtruesja e kërkesës ka pasur të drejtë të shfrytëzojë pronën lëndore vetëm përkohësisht dhe ka marrë lejen për ndërtim vetëm të objektit montues në atë pronë. Për atë arsye kërkesa ka të bëjë me pronën e luajtshme, e jo me pasuri të paluajtshme private për çka KKPK nuk është kompetent [...] Kërkesat u refuzuan për shkak se nuk janë nën juridiksionin e komisionit, ose për arsye procedurale, dhe jo për shkak se janë pa merita, mund të zgjidhen në gjykatat vendore në përputhje me ligjet në fuqi [...]."*

15. Më 25 korrik 2013, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër vendimit të KKPK-së.

16. Më 4 shtator 2015, Kolegji i Apelit (me Aktgjykimin GSK-KPA-A-225/13) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e KKPK-së. Kolegji i Apelit në arsyetimin e vet, thekson, *inter alia*, se:

> *"[...] aktvendimi mbi dhënien dhe leja e ndërtimit përmbajnë vetëm lejen e ndërtimit të objektit të tipit montazh. Prandaj, garazha nuk mund të shikohet si pasuri e paluajtshme, sepse nëse dikush e merr lejen e ndërtimit të ndërtojë vetëm objektin montues të karakterit të përkohshëm, nuk mund të ketë lejen të ndërtojë objekt të përhershëm prej materialit të fortë [...]."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në procedurat para gjykatave të rregullta ka pasur shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik, në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në mbrojtjen e pronës dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, të cilat janë të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

18. Parashtruesja e kërkesës më tej thekson se ka pasur shkelje për shkak se organet kompetente në lidhje me kërkesën e saj nuk kanë vepruar në mënyrë të duhur dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj.

19. Parashtruesja kërkon nga Gjykata *"të prish aktgjykimin e Kolegjit të Apelit për konteste të AKP të Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A 225/13 të dt. 04.09.2015 dhe të AKP në lëndën KPA 14816 (KPCC/D/C/184/2012 të dt. 14.12.2012 dhe ti urdhërohet AKP dhe Gjykatës që në procesin e përsëritur të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme juridike dhe faktike në përputhje me ligjin, gjegjësisht të pranojnë kërkesën e parashtrueses dhe ti mundësojnë kthimin e pronës."*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

22. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

23. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

24. Gjykata vëren se pretendimet e parashtrueses së kërkesës mund të përmblidhen në:

(iv) shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenet e tjerë të Kushtetutës;
(v) shkeljet e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe të ndërlidhura me nenet e tjera

25. Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

26. Gjykata i referohet nenit 6.1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht [...] nga një gjykatë."

27. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 13 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se "*shkelja ka ndodhur për shkak se organet kompetente në rastin e kërkesës së saj nuk kanë vepruar në mënyrë të drejtë dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj*", në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

29. Gjykata vëren se çështja kryesore që u ngrit në gjykatat e rregullta ishte çështje e "*vërtetimit të së drejtës në pronë*". KKPK-ja (me Vendimin KPCC/D/C184/2012) arsyetoi se në këtë rast, kërkesa u refuzua për shkak se prona në fjalë nuk bie në kategorinë e pasurisë së paluajtshme, dhe se zgjidhja e kontesteve të tilla është nën juridiksionin e gjykatave vendore.

30. Një përfundim i tillë i KKPK-së është mbështetur nga Kolegji i Apelit (me Aktgjykimin GSK-KPA-A 225/13). Kolegji i Apelit në arsyetimin e aktgjykimit të vet, *inter alia*, thekson se: "*aktvendimi mbi dhënien dhe leja e ndërtimit përmbajnë vetëm lejen e*

ndërtimit të objektit të tipit montazh. Prandaj, garazha nuk mund të shikohet si pasuri e paluajtshme, sepse nëse dikush e merr lejen e ndërtimit të ndërtojë vetëm objektin montues të karakterit të përkohshëm, nuk mund të ketë lejen të ndërtojë objekt të përhershëm prej materialit të fortë."

31. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është përpjekur ta ndërtojë rastin e saj në baza ligjore, përkatësisht në interpretimin e gabuar të ligjeve përkatëse nga gjykatat e rregullta, si dhe në vlerësimin e gabuar të provave.

32. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave apo aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argument të arsyetuar dhe pretendim bindës kur pretendon se një autoritet publik ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të mbrojtura me Kushtetutë.

33. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu përsërit se roli i Gjykatës Kushtetuese është për të siguruar respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96. GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmërinë, të 16 dhjetorit 2011).

34. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtrueses së kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ata e kontestojnë janë prezantuar në detaje dhe, se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta.

35. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

36. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës është referuar edhe në shkeljet e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

37. Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme për t'i shqyrtuar këto pretendime për shkak se parashtruesja e kërkesës nuk kishte provuar se si këto nene kanë të bëjnë me të drejtat e saj themelore.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

38. Gjykata i referohet nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
> *[...]*

39. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton:

> *"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij.*
> *[...]."*

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e pronës

40. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të cilat janë të aplikueshme edhe me nenin 46 të Kushtetutës dhe e arsyetojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës në pronë (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 35 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004, *MALTZAN (FREIHERR VON) dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, paragrafi 74, Vendimi i KEDNJ-së për pranueshmëri i 2 marsit 2005).

41. Këto parime të përgjithshme janë si në vijim:

a) Privimi i pronësisë apo të një të drejte tjetër *in rem* në parim është akt i menjëhershëm dhe nuk prodhon gjendje të përhershme të *"privimit të së drejtës"* (Shih, *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimit i GJEDNJ-së, të 12 korrikut 2001).

b) Neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së të 9 tetorit 2003).

c) Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me *"pronën"* e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite "*pronë"* mund të jetë *"pasuri ekzistuese*", duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të cilave parashtruesi mund të pretendojë "*pritshmëri legjitime*" që do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës së njëjtë. Në të kundërtën, shpresa në njohje të të drejtave të pronësisë që ishte e pamundur për të realizuar në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet si *"pronë"* brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1, as një kërkesë kushtimore që pushon të jetë e vlefshme si rezultat i mospërmbushjes së kritereve (Shih, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, paragrafët 82 - 83, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 12 korrikut 2001, dhe *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, paragrafi 69, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë, të 10 korrikut 2002).

d) Nuk mund të thuhet se lind ndonjë "*pritje legjitime*" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtresat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50, i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).

B. Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk është bartëse e të drejtës në pronë; përkundrazi, ajo është përpjekur ta fitojë një pronë, do të thotë se parashtruesja ka pasur vetëm shpresën e njohjes së të drejtave të pronësisë, prandaj, një gjendje e tillë e drejtë *"nuk mund të konsiderohet "pronë" në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1."*

43. Të gjitha "*pritjet legjitime*" të parashtrueses së kërkesës se ajo do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës ishin të bazuara në Aktvendimin Oz. nr. 351-106 të Komunës së Suharekës me të cilin ka marrë ngastrën në shfrytëzim të përkohshëm si dhe në lejen për ndërtimin e objektit të përkohshëm montues.

44. Gjykata vëren se KKPK-ja (me Vendimin KKCC/D/C184/2012) e refuzoi kërkesën e parashtrueses për shkak të mungesës së juridiksionit.

45. Më tej, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit me Aktgjykimin (GSK-KPA-A-225/13) ka konstatuar se "*prona e kontestuar është pronë shoqërore e regjistruar në regjistrin kadastral në emër të komunës së Suharekës.*"

46. Më tej, Gjykata rikujton se neni 1 i Protokollit nr. 1 "*nuk garanton të drejtën për të fituar pronën".* Në Aktvendimin Oz. nr. 351-106 të Komunës së Suharekës shihet qartë se parashtrueses së kërkesës, për ngastrën në pronësi të Komunës së Suharekës, i është dhënë leja e përkohshme për ndërtimin e objektit të montuar të natyrës së përkohshme. Duke pasur parasysh si më sipër, është e qartë se prona e paluajtshme e kontestuar kurrë nuk ka qenë në pronësi të parashtrueses. Pretendimet e parashtrueses se ka pasur shkelje të së "*drejtës së saj për gëzim të qetë të pronës"* janë të pabazuara.

47. Gjykata rikujton se "*pritshmëria legjitime*" e të drejtës në pronë nuk mund të ndodhë *"në qoftë se ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit të brendshëm".* Përveç kësaj, neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk garantojnë të drejtën në fitim të pronës.

48. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se me vendimet e KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit nuk është shkelur neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Konkludim

49. Si përmbledhje, parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, të 30 qershorit 2009). Në fakt, parashtruesja e kërkesës nuk ka mbështetur dhe nuk ka treguar se me vendimet e kontestuara janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

50. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

51. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, si e tillë, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (b) dhe d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI02/17, Parashtrues i kërkesës: Fadil Aziri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-015/2014, të 20 prillit 2016

KI02/17, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2017, i publikuar më 10 maj 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, pronë, juridiksion*

Parashtruesi i kërkesës si blerës lidhi një kontratë për shitblerjen e pronës së paluajtshme (ngastrës kadastrale nr. 193 dhe 194/6, dhe ngastrës kadastrale nr. 194/1,2,3) pranë avokatit.

Të dyja këto kontrata nuk janë vërtetuar në Gjykatën Themelore, dhe vetë ngastrat kadastrale kishin pasur një numër më të madh të bashkëpronarëve, të anëtarëve të familjes Stamenković.

Parashtruesi i kërkesës e inicioi kontestin i cili përfundoi më 20 prill 2016, kur Kolegji i Apelit i AKP-së (me Aktgjykimin GSK-KPA-A-015/2014) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar *"...Kontratat për transferimin e të drejtave të pronës së paluajtshme në mes të bartësve të së drejtës pronësore do të bëhet me shkrim; nënshkrimet e palëve kontraktuese do të vërtetohen nga gjykata", rrjedh se kontratat e dorëzuara nga pala ankuese nuk e përmbushin kriterin ligjor të paraparë me këtë ligj, prandaj ato nuk prodhojnë ndonjë efekt për palët."*

Në thelb, parashtruesi i kërkesës theksoi të njëjtat pretendime që i theksoi edhe në procedurën e ankimit në Kolegjin e Apelit të AKP-së, duke deklaruar se KKPK-ja nuk kishte kompetencë për të vendosur në këtë kontest, sepse kompetenca e saj është e kufizuar në periudhën nga 27 shkurti 1998 deri në 20 qershor 1999; se Dragana Stamenković nuk e ka humbur të drejtën pronësore në këtë periudhë; se për shkak të arsyeve të lartpërmendura as Kolegji i Apelit të AKP-së nuk kishte kompetencë për të vendosur mbi kontestin; se e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës në vitin 2000, përkatësisht në vitin 2005; se parashtruesi i kërkesës nga ajo kohë është në posedim dhe përdorim të ngastrës së kontestuar; se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk mund të quhet uzurpator, por i njëjti për këtë pronë ka paguar shumën prej 33,000 euro.

Gjykata konstatoi se me Vendimin (KPCC/D/R/205/2013) e KAPK-së dhe me Aktgjykimin (GSK-KPA-A-015/2014) e Kolegjit të Apelit të AKP-së është shpjeguar në detaje gjendja faktike; ky vendim arsyeton pse kontratat të cilat parashtruesi i kërkesës i ka lidhur me disa bashkëpronarë janë joformale; pretendon se ligji kërkonte që ato të jenë në formë të shkruar dhe të vërtetuara nga gjykata për të prodhuar efekt juridik.

Gjykata konstatoi se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë argumentet dhe dëshmitë, që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara me lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI02/17

Parashtrues

Fadil Aziri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës (GSK-KPA-A-015/2014, të 20 prillit 2016)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fadil Aziri nga fshati Nëntë Jugoviq, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës së Gjykatës Supreme të Kosovës (GSK-KPA-A-015/2014, të 20 prillit 2016) (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit të AKP-së), të cilin e ka pranuar më 22 shtator 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit i cili pretendohet të jetë i *"paligjështëm"* dhe në kundërshtim me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50. Parashtruesi i kërkesës më tej nuk arsyeton se cilat dispozita dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 janar 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 27 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 06 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit të AKP-së.

8. Më 5. prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 gusht 2000, parashtruesi i kërkesës si blerës lidhi një kontratë për shitblerjen e pronës së paluajtshme (ngastrës kadastrale nr. 193 dhe 194/6) me Dragoljub Stamenković si shitës pranë avokatit Januz Murati.

10. Më 11 dhjetor 2005, parashtruesi i kërkesës si blerës lidhi një kontratë për shitblerjen e pronës së paluajtshme (ngastrës kadastrale nr. 194/1, 2, 3) me Spasoje Stamenković si shitës pranë avokatit Januz Murati.

11. Të dyja këto kontrata nuk janë vërtetuar në Gjykatën Themelore, dhe vetë ngastrat kadastrale kishin pasur një numër më të madh të bashkëpronarëve të anëtarëve të familjes Stamenković.

12. Më 14 mars 2007, Dragana Stamenković (njëra nga bashkëpronarët e ngastrave të lartpërmendura kadastrale) paraqiti kërkesë (nr. 21215) për vërtetimin e të drejtave pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës, me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e ¼ të pjesës ideale të ngastrës 194/1 në sipërfaqe prej 96 m² me objekte ndihmëse, oborr në sipërfaqe prej 5.00 ari dhe pemishte klasa e dytë me sipërfaqe prej 5.54 ari, e cila gjendet në Nëntë Jugoviq në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: prona e kontestuar).

13. Si dëshmi se është bashkëpronare e pronës kontestuese, Dragana Stamenković në ankesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në teksti e mëtejmë: AKP) paraqiti dokumentet në vijim:

    - Fletën poseduese nr. 109, të 23 marsit 2006, të lëshuar nga Zyra e Gjeodezisë - Qendra për Pronën e Paluajtshme në Komunën e Prishtinës, në të cilën gjyshja e Dragana Stamenković figuron si pronare e ¼ të pjesës ideale të pronës së kontestuar;

    - Vendimin mbi trashëgiminë O. nr. 196/96, të 17 prillit 2002, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, në të cilin theksohet se Dragana Stamenković ka trashëguar 1/7 e pjesës ideale të trashëgimisë së plotë;

    - Certifikatën mbi të drejtat e pronësisë nr. 011-095-43684 të 4 dhjetorit 2012, të lëshuar nga Zyra kadastrale e Prishtinës, në të cilën Dragana Stamenković figuron si bashkëpronare e 1/7 të pjesës ideale të pronës së kontestuar.

14. Parashtruesi i kërkesës në këtë kontest para AKP-së u paraqit si palë e kundërt duke theksuar se nuk e ka uzurpuar pronën kontestuese, por se të njëjtën e ka fituar në baze të kontratës së lartpërmendur nga 2000 dhe 2005.

15. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës bashkëngjiti edhe padinë e dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë të 26 janarit 2011, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë ndaj ngastrave 193, 194/1, 2, 3, 6.

16. Më 11 qershor 2013, Komisioni i Agjencisë Kosovare të Pronës me (Vendimin KPCC/D/R/205/2013) vendosi të aprovojë kërkesën e Dragana Stamenković me arsyetimin se ajo është pronare e 1/7 të pjesës ideale të pronës së kontestuar në bazë të dëshmive të paraqitura dhe në mungesë të dëshmive të vlefshme nga pala e kundërt (parashtruesi i kërkesës).

17. Më 23 tetor 2013, Vendimi KPCC/D/R/205/2013 i Komisionit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: KKPK) i është dërguar parashtruesit të kërkesës.

18. Më 19 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Vendimit KPCC/D/R/205/2013, duke kontestuar kompetencën e AKP-së, dhe theksoi së "*vendimet e AKP-së i referohet ekskluzivisht periudhës së caktuar kohore prej 27.02.1998 deri me 20.06.1999.*"

19. Parashtruesi i kërkesës në ankesë theksoi se humbja e pronës nuk është rezultat i konfliktit të armatosur në periudhën 1998-99. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Dragana Stamenković e ka humbur pronësinë ndaj pronës së kërkuar për shkak të transaksionit të bërë me shitblerjen në vitin 2005, të iniciuar nga Spasoje Stamenković.

20. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendoi se e dinte se Spasoje Stamenković nuk është i vetmi pronar i pronës së kërkuar, por e ka konsideruar si të tillë. Ai nuk e ka kontestuar pjesën ideale të Dragana Stamenković. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu deklaroi se e ka paraqitur padinë në gjykatat e rregullta, me të cilën kërkoi vërtetimin e pronësisë mbi pronën e kërkuar.

21. Më 14 qershor 2014, Dragana Stamenković paraqiti përgjigje në ankesë, ku theksoj se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në ankesë *" se ai e kishte blerë pronën e kërkuar nuk janë të vërteta, sepse ai nuk mund ta dëshmojë se ai e ka blerë atë nga bashkëpronarët sepse Spasoje dhe Dragoljub Stamenković ouk kanë qenë bashkëpronaret e vetëm të pronës."*

22. Më 20 prill 2016, Kolegji i Apelit të AKP-së me (Aktgjykimin GSK-KPA-A-015/2014) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Vendimin KPPC/D/R/205/2013, të 11 qershorit 2013, duke u arsyetuar:

> *"...Kontratat për transferimin e te drejtave të pronës së paluajtshme në mes të bartësit të së drejtës pronësore do të bëhet me shkrim; nënshkrimet e palëve kontraktueses do të vërtetohen nga gjykata", rrjedh se kontrata e dorëzuara nga pala ankuese nuk e përmbushin kriterin ligjor të paraparë me këtë ligj, prandaj ato nuk prodhojnë ndonjë efekt për palët. Sidoqoftë, nga provat e vërtetuara rezulton se në kontratën e vitit 2005 e cila ka të bëjë me pronën e kërkuar shitësi nuk ka qenë pronar i tërë pronës, por vetëm i në pjese të saj. Prandaj, në bazë të Ligjit mbi marrëdhëniet pronësore themelore (Gazeta zyrtare nr. 6/80) neni 14, paragrafi 2 i cili parasheh që shitja e pronës së paluajtshme në pronësi të disa bashkëpronareve është e vlefshme vetëm nësë ekziston pëlqimi i bashkëpronareve. Me tutje, pala ankuese ka pasur njohuri se shitësi Spasoje Stamenković në kontratën e lidhur më 2005 nuk ka qenë pronari i vetëm kur në ndërkohë qëllimi i kontratës në fjalë ka qenë tjetërsimi i tërë ngastrës. Rrjedhimisht, kontrata nuk është e vlefshme dhe nuk e prek të drejtën e palës përgjegjës në ankese mbi pronën e kërku*ar."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës së pari përshkruan gjerësisht gjendjen faktike dhe rendit një sërë shkeljesh të ligjit dhe të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, por të njëjtat nuk i lidh me dispozitat kushtetuese dhe nuk arsyeton së cilat të drejta kushtetuese janë shkelur.

24. Në thelb, parashtruesi i kërkesës thekson të njëjtat pretendime që i theksoi edhe në procedurën e ankimit në Kolegjin e Apelit të AKP-së, duke deklaruar se: KKPK-ja nuk kishte kompetencë për të vendosur në këtë kontest, sepse kompetenca e saj është i kufizuar në periudhën nga 27 shkurti 1998 deri në 20 qershor 1999; se Dragana Stamenković nuk e ka humbur të drejtën pronësore në këtë periudhë; se për shkak të arsyeve të lartpërmendura as Kolegji i Apelit të AKP-së nuk kishte kompetencë për të vendosur mbi kontestin; se e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës në vitin 2000, përkatësisht në 2005, respektivisht; së parashtruesi i kërkesës nga ajo kohe është në posedim dhe përdorim të ngastrës së kontestuar; se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk mund të quhet uzurpator, por i njëjti për këtë pronë ka paguar shumën prej 33.000 euro.

25. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës pretendon më tej se Dragana Stamenković vet ka deklaruar *"e ka humbur posedimin e pronës për shkake të konfliktit të armatosur në vitin 1998/99, duke cekur datën 28 qershor 1999 si date të humbjes se pronës"*. Parashtruesi i kërkesës më tej përfundon se nëse është saktë "*se prona është humbur me 28 qershor 1999,atëherë delë së është pas 20 qershorit ,kurse kompetenca e AKP-së për të vendos është pikrisht vetëm për periodën prej 27 shkurtit 1998 deri me 20.gershor 1999."*

26. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"jenë bërë shkelje ligjore dhe kushtetuese nga Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) konkretisht nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës me rastin e vendimit KPCC/D/R/205/20013 i dt. 11 qershor 2013 dhe të jep përgjigje se është apo nuk është kompetente që të vendos për kërkesa pronësore të humbura para apo pas periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri me 20 qershor 1999."*

27. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që *"Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës GSP-KPA-A-015 /2014 i dt. 20 prill 2016 të abrogohet-shfuqizohet e po ashtu edhe vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/20S/2013 i dt. 11 qershor 2013 dhe të shpallën inkompetente ,kurse lënda të dërgohet Gjykatës Themelore si kompetente në pikëpamje reale dhe teritoriale, pasi që veç është ngrite padia me shenjen C.nr.278/11 dhe kjo ti bashkohet kësaj lëndë në vendosje meritore."*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113. [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie.*

32. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të vërtetuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

33. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjore, përkatësisht në interpretimin e gabuar të ligjeve përkatëse dhe të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 nga KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së.

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në përgjithësi i përsërit pretendimet e ngritura në procedurën e ankimit në Kolegjin e Apelit të AKP-së në lidhje me gjendjen faktike dhe kompetencën e KAPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së.

35. Gjykata më tej vëren se me (Vendimin KKCC/D/R/205/2013) e KAPK-së dhe me (Aktgjykimin GSK-KPA-A-015/2014) e Kolegjit të Apelit të AKP-së është shpjeguar në detaje gjendja faktike; ky vendim arsyeton pse kontratat të cilat parashtruesi i kërkesës i ka lidhur me disa bashkëpronarë janë joformale; pretendon se ligji kërkonte që ato janë në formë të shkruar dhe të vërtetuara nga gjykata për të prodhuar efekt juridik.

36. Në fund, me këto vendime shpjegohet edhe ajo se në cilën shkallë kontratat janë të vlefshme, përkatësisht që vlejnë vetëm për ata bashkëpronarë që këto kontrata i kanë nënshkruar dhe nuk mund të prodhojnë efekt juridik ndaj personave ose bashkëpronarëve që këto kontrata nuk i kanë nënshkruar, e që në këtë rast është pronari i pronës kontestuese.

37. Për shkak të asaj që u tha më sipër, Gjykata nuk do t'i shqyrtojë më tej pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me gjendjen faktike, sepse nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar nëse llojet e veçanta të provave janë të pranueshme, cilat prova duhet të merren, e as të specifikoj se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të përcaktojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat (shih, rastin *Dukmedjian kundër Francës*, parashtresa nr. 60495/00, paragrafi 71, GJEDNJ, Aktgjykimi i 31 janarit 2006).

38. Gjykata më tej ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kompetencën e KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së për vendosje meritor në lidhje

me pronën e kontestuar dhe Gjykata këtu i referohet nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 i cili në lidhje me kompetencën përcakton si në vijim:

> *"3.1 Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:*
>
> > *(a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe*
> > *(b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore."*

39. Në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se periudha "*prej* 27 *shkurtit* 1998 *deri më 20 qershor 1999"* të cilën parashtruesi e interpreton gabimisht si periudhë të kompetencës, nuk paraqet periudhën e cila përcakton kompetencën e KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së për të vendosur në mënyrë meritore, por përcakton kohën e cila u konsiderua si periudha e konflikteve të armatosura.

40. Ndërsa, kompetenca ekskluzive e KKPK-së dhe e Kolegjit të Apelit të AKP-së është përcaktuar për të gjitha kërkesat të cekura në paragrafët (a) dhe (b) që janë pasojë e "*rrethanave të lidhura drejtpërdrejt me apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999".* Kompetencën e tyre, KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit i AKP-së e përcaktojnë sipas rrethanave të lartpërmendura për çdo rast individual.

41. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimin e ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës kur pretendon se autoriteti publik i ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të mbrojtura me Kushtetutë.

42. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu rithekson se roli i Gjykatës Kushtetues është për të siguruar respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, dhe jo të merret me interpretimin dhe zbatimin e të drejtës së brendshme; ky është roli i gjykatave të rregullta (shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtruesi i kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

43. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi për t'i prezantuar para gjykatave të rregullta arsyet materiale dhe ligjore për zgjidhjen e kontestit; argumentet e tij ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyre të duhur nga KKPK dhe Kolegji i Apelit të AKP-ës; procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe vendimet e marra ishin arsyetuar në detaje.

44. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe

të paanshëm (shih, *mutatis mutandis* rasti *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

45. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur pretendimin e precizuar dhe konkret për shkeljen e të drejtave të tij dhe nuk ka shpjeguar si dhe pse Kolegji i Apelit i AKP-ës mund t'i ketë shkelur të drejtat e tij kushtetuese; ai vetëm ka theksuar se ka pasur shkelje të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka ofruar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte për shkeljet e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *Trofimchuk kundër Ukrainë,* GJEDNJ, paragrafi 50-55. Aktgjykimi nr. 4241/03) i 28 tetorit 2010).

46. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis: Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

47. Prandaj, Gjykata konsideron se kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, më tej të precizuara me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës nuk janë plotësuar.

48. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tij është e papranueshme, si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI119/16, Parashtrues i kërkesës: Xhemail Lani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 7 qershorit 2016

KI119/16, Vendim për refuzim të kërkesës i 4 prillit 2017, i publikuar më 12 maj 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kërkesë e paplotë, pronë, lëndimet trupore, të refuzohet me procedurë të shkurtër*

Parashtruesi i kërkesës me rastin e mirëmbajtjes së fabrikës, duke ecur mbi vagonë, ka rënë dhe ka pësuar lëndime trupore.

Më 2 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në DHPGJS, e cila është regjistruar me numrin e rastit SCL-11-0055.

Më 29 shkurt 2016. godine, Komisioni për likuidimin e NSH "Përparimi" i ka dorëzuar DHPGJS-së përgjigjen në ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"...iu cenua e drejta në mbrojtjen e shëndetit gjatë punës, sepse pala e paditur nuk siguroi mjete për mbrojtje në punë, si: helmet koke, rrobe pune dhe ndriçim të mjaftueshëm"*.

Gjykata në rastin konkret, në pajtim me nenin 22 të Ligjit, dy herë ka kërkuar nga parashtruesi dhe përfaqësuesi i tij ligjor që të dorëzojnë në Gjykatë "*Vendimin e kontestuar SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 07 qershorit 2016"*.

Parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i tij ligjor kanë paraqitur vazhdimisht në Gjykatë një përgjigje kundër padisë (me numër SCL-11-0055), të paraqitur në Dhomën e Posaçme nga ana e Komisionit për likuidimin e NSH "Përparimi", të 7 qershorit 2016.

Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës për dorëzimin e vendimit të kontestuar, por në vend të tij ka dorëzuar përgjigjen në padi të Komisionit për likuidim, të cilën ai e ka pranuar përmes DHPGJS-së.

Prandaj, Gjykata konstatoi se parashtruesi përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, i) nuk ka dorëzuar vendimin e autoritetit publik të cilin e konteston; ii) nuk ka provuar se ndonjë prej të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë është shkelur nga ndonjë autoritet publik; iii) nuk ka paraqitur asnjë arsyetim procedural apo substancial për kërkesën e tij, dhe iv) nuk ka dorëzuar dokumentet mbështetëse të kërkuara nga Gjykata.

Gjykata konkludoi se kërkesa nuk i plotëson kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm sipas rregullit 29 të Rregullores së punës. Pasi që parashtruesi nuk ka bërë plotësimin dhe qartësimin e nevojshëm të kërkesës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI119/16

Parashtrues

Xhemail Lani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së "*Vendimit SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 7 qershorit 2016*"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Xhemail Lani nga fshati Llaushë, komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Rexhep S. Kaçaniku, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës pretendohet të kontestojë "*Vendimin SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 7 qershorit 2016*" (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit). Parashtruesi nuk i ka dorëzuar Gjykatës kërkesën e kontestuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë *"cenuar të drejtat e paditësit (parashtruesit e kërkesës) nga marrëdhënia e punës"*. Parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton më tej se cilat dispozita kushtetuese dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 tetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 13 dhjetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzoj në Gjykatë vendimet e kontestuara dhe autorizimin me të cilin e autorizon avokatin për ta përfaqësuar në Gjykatë.

8. Më 27 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin me të cilin e autorizon avokatin për ta përfaqësuar në Gjykatë dhe dokumente të tjera shtesë, por nuk e ka dorëzuar vendimin e kontestuar.

9. Më 24 janar 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu kërkoi nga Kolegji i Apelit ta dorëzoj në Gjykatë fletëkthesën për të vërtetuar se kur e ka pranuar parashtruesi vendimin e kontestuar.

10. Më 27 shkurt 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe nga përfaqësuesi i tij ta paraqesin në Gjykatë vendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit.

11. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje nga parashtruesi (dhe as nga përfaqësuesi i tij) në kërkesën për të paraqitur vendimin e kontestuar.

12. Më 4 prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i propozoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve të përgjithshme

13. Më 30 prill 2004, parashtruesi i kërkesës ka krijuar marrëdhënie pune, në bazë të kontratës së punës nr. 367, me Ndërmarrjen Shoqërore "Përparimi" (në tekstin e mëtejmë: NSH "Përparimi").

14. Më 3 dhjetor 2004, blerësi i përkohshëm i NSH "Përparimi" në procedurën e privatizimit i është drejtuar me shkresë Agjencisë Kosovare për Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me të cilën kërkoi *"t'u lejohet qasja e plotë në fabrikë në mënyrë që të mirëmbahet fabrika, të ruhet objekti dhe të fillohet remontimi i fabrikës"*.

15. Më 20 dhjetor 2004, parashtruesi i kërkesës me rastin e mirëmbajtjes së fabrikës, duke ecur mbi vagonë, ka rënë dhe ka pësuar lëndime trupore.

16. Më 13 janar 2006, parashtruesi paraqiti kërkesë në Komisionin për likuidimin të NSH "Përparimi", me të cilën kërkoi kompensim për lëndime në punë në vlerë prej 99.500.00 eurosh.

17. Më 24 maj 2011, Komisioni për likuidimin e NSH "Përparimi" (Vendimi nr. MITO18-0018) e refuzoi kërkesën e parashtruesit.

18. Më 22 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për shqyrtimin e likuidimit (në tekstin e mëtejmë: KSHL) dhe ankesa është regjistruar në regjistrin e ORL-së me numrin LRC/11/0063/MI.

19. Më 4 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës pranoi njoftimin nga AKP-ja përmes të cilit është informuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 03/L-067, të gjitha komisionet shqyrtuese të themeluara në pajtim me ligjet e mëparshme do të shpërbëhen.

20. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës u informua se ka në dispozicion afatin prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit të lartpërmendur për të paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) kundër vendimit të Komisionit për likuidimin e NSH "Përparimi".

21. Më 2 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në DHPGJS, e cila është regjistruar me numrin e rastit SCL-11-0055.

22. Më 9 shkurt 2016, DHPGJS-ja padinë e parashtruesit të kërkesës ia dorëzoi Komisionit për likuidimin e NSH "Përparimi" si palë e kundërt në kontest.

23. Më 29 shkurt 2016, Komisioni për likuidimin e NSH "Përparimi" i ka dorëzuar DHPGJS-së përgjigjen në ankesën e parashtruesit të kërkesës.

24. Më 7 qershor 2016, DHPGJS-ja (fletëngarkesa nr. SCL-11-0055) i dërgoi parashtruesit përgjigje në padi të Komisionit për likuidimin e NSH "Përparimi", të cilën ai e ka pranuar më 10 qershor 2016.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*... iu cenua e drejta në mbrojtjen e shëndetit gjatë punës, sepse pala e paditur nuk siguroi mjete për mbrojtje në punë, si: helmet koke, rrobe pune dhe ndriçim të mjaftueshëm.*"

26. Parashtruesi i kërkesës, më tej, konsideron se është shkelur Ligji për marrëdhënjet e detyrimeve dhe pretendon se "*sipas dispozitave të 154 të LMD, gjerë tek lëndimi erdhi me lëshimet e palës së paditur, kjo u vërtetua kur policia e Kosovës ia dërgoi shkresat e lëndës Prokurorisë së shtetit në Mitrovicë por ajo për shkak të numrit voluminoz të lëndëve nuk inicioi procedurën penale dh lënda ende nuk është arkivuar.*"

27. Në fund, mbi bazën e mësipërme, parashtruesi i kërkesës konkludon "*... se të gjitha vendimet paraprake në mënyrë të vrazhdë kanë cenuar të drejta e paditësit nga mardhënia e punës, sepse ai nuk e lëndoi vetveten me qëllim, si po i interpretohen dispozitat e nenit 154 të LMD dhe obligimet e punëdhënësit për mbrojtjen e punëkryesit në punë ...*".

28. Parashtruesi i kërkesës, më tej, i propozon Gjykatës:

> *"... që kërkesa e paditësit të konsiderohet e ligjshme, të shpallet shkelja e këtyre të drejtave si cenim i të drejtave kushtetuese dhe ti këthehen shkresat e lëndës gjykatës kompetente në shqyrtim dhe vendosje të serishme."*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, edhe të specifikuara më tej me Ligji dhe me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

31. Gjykata i referohet edhe neneve 22.4 dhe 48 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 22 [Procedimi i kërkesës]

> *"4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës".*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

> "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

32. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe*
> *[. ..]*
> *(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;*
> *(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe*
> *(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës ..."*

33. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"[...] (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtë në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën [...]."*

34. Gjykata së pari rikujton që në këtë rast, në pajtim me nenin 22 të Ligjit, dy herë ka kërkuar nga parashtruesi dhe përfaqësuesi i tij ligjor që ta dorëzojnë në Gjykatë "*Vendimin e kontestuar SCL-11-0055 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 07 qershorit 2016".*

35. Parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesi i tij ligjor kanë paraqitur vazhdimisht në Gjykatë një përgjigje kundër padisë (me numër SCL-11-0055), të paraqitur në Dhomën e Posaçme nga ana e Komisionit për likuidimin e NSH "Përparimi", të 7 qershorit 2016.

36. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës për dorëzimin e vendimit të kontestuar, por në vend të tij ka dorëzuar përgjigjen në padi të Komisionit për likuidim, të cilën ai e ka pranuar përmes DHPGJS-së.

37. Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe barra e të provuarit bie mbi parashtruesin, i cili nuk i ka plotësuar kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës (shih, p.sh. rastin nr. KI03/15, parashtruesi i kërkesës: *Hasan Beqiri*, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 5 qershorit 2015).

38. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, i) nuk ka dorëzuar vendimin e autoritetit publik të cilin e konteston; ii) nuk ka provuar se ndonjë prej të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë është shkelur nga ndonjë autoritet publik; iii) nuk ka paraqitur asnjë arsyetim procedural apo substancial për kërkesën e tij, dhe iv) nuk ka dorëzuar dokumentet mbështetëse të kërkuara nga Gjykata.

39. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa lëndore nuk është e plotë, për shkak se parashtruesi nuk e ka dorëzuar vendimin e kontestuar të autoritetit publik.

40. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm sipas rregullit 29 të Rregullores së punës. Pasi që parashtruesi nuk ka bërë plotësimin dhe qartësimin e nevojshëm të kërkesës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI23/16, Parashtrues i kërkesës Qazim Bytyqi dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KI23/16 Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2016, i publikuar më 12 maj 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë e parashtruar nga 20 parashtrues, qartazi e pabazuar*

Parashtruesit e kërkesës kontestojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare te Privatizimit.

Parashtruesi pretendojnë shkelje të së drejtës të garantuar me nenin 31.2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që pretendohet të jetë shkelur si pasojë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore.

Gjykata gjeti se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave pranë Kolegjit të specializuar dhe pranë Kolegjit te Apelit të Dhomës së Posaçme, prej 6 (gjashte) vjetësh dhe 9 (nëntë) muajsh, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme, duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve dhe çfarë ishte në rrezik për parashtruesit e kërkesës.

Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit nuk i plotësoi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe siç përcaktohen më tej me Rregulloren e punës dhe e kanë shpallur atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI23/16

Parashtrues

Qazim Bytyqi dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Qazim Bytyqi, Musa Muharremi, Lutfi Hyseni, Hysen Ahmeti, Ejup Behluli, Ramadan Goliqi, Selatin Dudaki, Fadil Amiqi, Avdulla Hasani, Brahim Kerak, Sali Xhema, Ymer Kodrolli, Hajriz Haziri, Gani Haziri, Idriz Kopili, Sahit Sahiti, Eshref Curolli, Mefail Kryeziu, Kemajl Shabani dhe Mustafë Mustafa, të gjithë nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson zyra e avokatëve Interlex Associates LLC nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vërtetimi i bazueshmërisë së kërkesës së parashtruesve që pretendojnë se gjykatat e rregullta ua kishin shkelur të drejtat nga neni 31.2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) si pasojë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shkurt 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Në kohën e dorëzimit të kërkesës, rasti i parashtruesve ishte ende në procedurë e sipër pranë Kolegjit të Apelit.

6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 7 prill 2016, Gjykata i informoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Gjykata u kërkoi parashtruesve të përgjigjen deri më 25 prill 2016 në këto pyetje konkrete:

   A) Cila ka qenë sjellja e parashtruesve të kërkesës gjatë katër (4) viteve e pesë (5) muajve, periudhë kjo gjatë së cilës ju pretendoni se keni pritur që DhPGjS të merr vendim? A i kanë parashtruar parashtruesit e kërkesës urgjencat e tyre në DhPGjS, para se kjo e fundit të sjellë Aktgjykimin e saj (SCEL-06-0016, të 23 shtatorit 2009) apo më pas?
   B) A është përgjigjur DhPGjS-ja në urgjencat e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës? Nëse po, luteni që t'i dorëzoni kopjet e përgjigjeve të tilla. Nëse jo, luteni që të dorëzoni komentet tuaja në lidhje me atë.
   C) Sa i përket mjetit juridik për kontestimin e kohëzgjatjes së tillë të procedurave, a mendoni se sistemi ligjor në Republikën e Kosovës ofron një mjet të tillë? Ju lutemi, elaboroni qëndrimin tuaj lidhur me këtë.
   D) Cili është mendimi juaj lidhur me atë se pse procedurat supozohet se ishin të stërzgjatura? Kush, si dhe çfarë mendoni se ka kontribuar në këtë?

8. Në të njëjtën datë, kërkesa iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme të përgjigjet deri më 25 prill 2016 në këto pyetje konkrete:

   A) A i kanë plotësuar të gjithë parashtruesit e kërkesës kriteret e pranueshmërisë për të parashtruar kërkesë në Gjykatë? Më saktësisht, a i kanë shteruar parashtruesit e kërkesës të gjitha mjetet juridike në dispozicion përkitazi me pretendimet e tyre?
   B) A mendoni se procedurat përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës e kanë tejkaluar "afatin e arsyeshëm" për DhPGjS-në që të merr vendim? Nëse përgjigja është jo, ju lutemi shpjegojeni se pse mendoni se kjo e drejtë e garantuar kushtetuese është respektuar?
   C) A mendoni se është shkelur e drejta e parashtruesve të kërkesës për vendim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së? Nëse përgjigja është jo, ju lutemi shpjegoni qëndrimin tuaj.
   D) A kanë pasur parashtruesit e kërkesës ndonjë mjet juridik të cilin kanë mundur ta shfrytëzojnë për adresimin e pretendimeve të tyre lidhur me "stërzgjatjen e procedurave" pranë DhPGjS-së? Nëse po, cili mjet ka qenë ai dhe a e kanë shfrytëzuar?

E) A kanë parashtruar parashtruesit e kërkesës urgjenca në DhPGjS, duke kërkuar që të përshpejtohen procedurat në rastin e tyre? Nëse po, cila ka qenë përgjigja e DhPGjS-së ndaj atyre kërkesave?
F) Cila ka qenë sjellja e parashtruesve të kërkesës gjatë procedurave dhe a kanë kontribuar ata në ndonjë mënyrë në stërzgjatjen e pretenduar?

9. Në të njëjtën datë, kërkesa iu dërgua Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Gjykata kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të përgjigjet deri më 25 prill 2016 në këto pyetje konkrete:

A) A i kanë plotësuar të gjithë parashtruesit e kërkesës kriteret e pranueshmërisë për të parashtruar kërkesë në Gjykatë? Më saktësisht, a i kanë shteruar parashtruesit e kërkesës të gjitha mjetet juridike në dispozicion përkitazi me pretendimet e tyre?
B) A kanë pasur parashtruesit e kërkesës ndonjë mjet juridik të cilin kanë mundur ta shfrytëzojnë për adresimin e pretendimeve të tyre lidhur me "stërzgjatjen e procedurave" pranë DhPGjS-së? Nëse po, cili mjet juridik ka qenë ai?
C) A konsideroni që parashtrimi i urgjencave, siç pretendojnë të kenë bërë parashtruesit e ankesës, do të duhej ose a paraqet mjet juridik efektiv për kontestimin e stërzgjatjes së procedurave? Ju lutemi, elaboroni qëndrimin tuaj lidhur me këtë.
D) A mendoni se sistemi ligjor i Kosovës parasheh mjet juridik përkitazi me stërzgjatjen e procedurave? A ekziston ndonjë mjet të cilin parashtruesit e kërkesës mund ta shfrytëzojnë kur konsiderojnë se u është mohuar e drejta e tyre për vendim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së?

10. Më 19 prill 2016, parashtruesit e kërkesës dorëzuan përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga Gjykata, si dhe bashkëngjitën kopjet e 5 (pesë) urgjencave që i kishin parashtruar në Dhomën e Posaçme.

11. Më 25 prill 2016, Gjykata pranoi përgjigje dhe komente nga Dhoma e Posaçme.

12. Më 11 maj 2016, Gjykata ua dërgoi parashtruesve të kërkesës përgjigjen dhe komentet e pranuara nga Dhoma e Posaçme dhe i ftoi parashtruesit e kërkesës që nëse kishin komente shtesë t'i dorëzonin brenda afatit prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh.

13. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi Dhomës së Posaçme komentet e pranuara nga parashtruesit e kërkesës më 19 prill 2016 dhe e ftoi Dhomën e Posaçme që nëse kishte komente shtesë t'i dorëzonte brenda afatit prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh.

14. Më 16 maj 2016, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan komentet shtesë lidhur me parashtresat e Dhomës së Posaçme.

15. Më 22 maj 2016, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e dorëzoi përgjigjen në Gjykatë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës theksoi se nuk i komenton vendimet gjyqësore *"ngase gjykatat janë të pavarura në kryerjen e funksionit gjyqësor"*.

16. Më 24 maj 2016, Dhoma e Posaçme i dorëzoi komentet shtesë lidhur me parashtresat e parashtruesve të dorëzuara në Gjykatë më 19 prill 2016.

17. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese në zëvendësim të gjyqtarit Robert Carolan i cili kishte dhënë dorëheqje më 9 shtator 2016. Përbërja e Kolegjit shqyrtues ka mbetur e pandryshuar.

18. Më 30 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesave.

Përmbledhja e fakteve

19. Nga shkresat e lëndës del se parashtruesit e kërkesës janë që të gjithë ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore NSH "Mustafa Goga" në Ferizaj.

20. Gjatë vitit 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) publikoi listën e punëtoreve të cilët, në bazë të ligjit në fuqi, kishin të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e 20% të të ardhurave nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjes NSH "Mustafa Goga". Parashtruesit e kërkesës nuk ishin përfshirë në këtë listë.

21. Në muajt qershor dhe korrik të vitit 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesa në Dhomën e Posaçme, ku kontestuan listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në 20% të të ardhurave.

22. Më 23 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin SCEL- 09-0016, me të cilin vendosi që të gjithë [parashtruesit e kërkesës] të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në 20% të të ardhurave.

23. AKP-ja paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, të 23 shtatorit 2013. AKP-ja ofroi material të ri me dokumente në mbështetje të ankesës së saj.

24. Më 16 mars 2016, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin AC-I-13-0191, me të cilin e refuzoi ankesën e AKP-së dhe e vërtetoi Aktgjykimin SCEL-09-0016 të Kolegjit të specializuar përkitazi me parashtruesit e kërkesës. Me këtë Aktgjykim, kërkesat e parashtruesve u vendosën në instancë të fundit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se gjykatat e rregullta ua kanë shkelur të drejtën e tyre në gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

26. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se "*Gjykata duhet pasur parasysh se kjo kërkesë nuk bëhet specifikisht për të kundërshtuar aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar SCEL – 09 - 0016 dhe Kolegjit të Apelit AC-I.-13-0191 në substancës e tij, por kërkohet nga gjykata që të vërtetoj se procesi i stërzgjatur në tërësinë e tij nuk është në përputhje me garancionet kushtetuese …".*

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"meqenëse privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore ka lënë të papunë një numër shumë të konsiderueshëm të punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës është paraparë me legjislacionin e aplikueshëm se kërkesat e kësaj natyre duhet të zgjidhen me procedura të përshpejtuara ngase shumë nga punëtorët janë në gjendje jashtëzakonisht të vështirë ekonomike. Në rastin konkret se çfarë periudhe kohore konsiderohet si e arsyeshme është caktuar nga legjislacioni specifik i privatizimit."*

Përgjigja nga Dhoma e Posaçme

28. Në parashtresat e 25 prillit 2016, Dhoma e Posaçme theksoi se rasti ishte shumë i ndërlikuar, pasi që i njëjti rast përfshinte 98 ankues me gjithsej 48 ankesa ndaj listës

përfundimtare të publikuar nga AKP-ja të përfituesve të pjesës së 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH "Mustafa Goga". Dhoma e Posaçme theksoi se "*Këto ankesa u desh të vlerësohen individualisht, ndaras dhe në mënyrë shumë të kujdesshme për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme*".

29. Gjithashtu, Dhoma e Posaçme pohoi se "*[...] Duke marrë parasysh pretendimet ankimore të Agjencisë së Privatizimit, Kolegjit të ankesave i është dashur më shumë kohë të nxjerrë vendim duke marrë parasysh të gjithë parashtruesit veç e veç për shkak të ndjeshmërisë së rastit. Madje, Dhoma e Posaçme është tejet e mbingarkuar në përgjithësi-mbi 21974 lëndë në pritje të të gjitha llojeve që i përfshin juridiksioni i saj, por gjykata merr të gjitha veprimet e nevojshme për zgjidhjen e rasteve duke marrë parasysh urgjencën dhe prioritetet.*"

30. Për më tepër, Dhoma e Posaçme bëri me dije se "*Numri tepër i madh i dokumenteve lidhur me procedurat i kontribuon në masë të madhe kohëzgjatjes së procedurës, veçanërisht pasi që obligimi për të siguruar përkthimet i është bartur Dhomës së Posaçme me ligj (neni 25.8 i Shtojcës së LDHP-së, të ndryshuar). Në lëndët SCEL ankesat dhe të gjitha parashtresat e ankuesve si në lëndën në fjalë janë përkthyer gjithmonë nga Dhoma e Posaçme*".

31. Gjithashtu, Dhoma e Posaçme bëri me dije se *"Dhoma e Posaçme është tejet e mbingarkuar në përgjithësi-mbi 21974 lëndë në pritje të të gjitha llojeve që i përfshin juridiksioni i saj. Veprimtaria e saj është penguar nga mungesa dhe lëvizjet e mëdha të stafit, kryesisht gjyqtarët, përderisa numri i lëndëve SCEL si dhe i të gjitha padive dhe ankesave po rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe të konsiderueshme për shkak të juridiksionit ekskluziv të Dhomës së Posaçme në çështjet e privatizimit (neni 4 i LDHP-së). Edhe pse Dhoma e Posaçme ka mbyllur 13389 në periudhën prej 01/01/2009 deri me 31/03/2016, aktualisht janë në pritje 21974 lëndë. Për shkak të fluksit të lartë vazhdueshëm të lëndëve të reja numri i lëndëve në pritje po rritet."*

32. Dhoma e Posaçme potencoi se parashtruesit e kërkesës kishin në dispozicion një mjet juridik kundër vonesave të paarsyeshme në procedurë. Neni 10.12 i Ligjit për Dhomën e Posaçme nr. 04/L-033 përcakton që,

> *"Nëse Gjykata, Kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm dështon të nxjerrë aktvendim apo aktgjykim brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj, ose në rastet kur afatet e tilla kohore nuk janë përcaktuar me ligj, dështon ta nxjerrë brenda një kohe të arsyeshme, Kolegji i Apelit, në bazë të parashtresës së palës, urdhëron Gjykatën, Kolegjin e specializuar, nën-kolegjin apo gjyqtarin e vetëm që të nxjerrë aktgjykimin apo aktvendimin në fjalë brenda dhjetë (10) ditësh pune."*

33. Për më tepër, Dhoma e Posaçme pretendoi se parashtruesit e kërkesës kanë mundur të parashtrojnë "urgjenca" joformale duke kërkuar që procedura të përshpejtohet. Për aq sa Dhoma e Posaçme e pranoi se parashtruesit e kërkesës në fakt kishin parashtruar të paktën një "urgjencë" të tillë, Dhoma e Posaçme bëri me dije se nuk ishte përgjigjur në lidhje me të. Dhoma e Posaçme e pranoi se vonesat në procedurë pranë Kolegjit të specializuar ose pranë Kolegjit të Apelit nuk ishin shkaktuar nga veprimet e parashtruesve.

Përgjigjja nga parashtruesit e kërkesës

34. Në përgjigje të parashtresave të Dhomës së Posaçme, parashtruesit e kërkesës theksojnë se mjeti juridik i përcaktuar në nenin 10.12 të Ligjit për Dhomën e Posaçme aplikohet vetëm në ato situata kur një gjyqtar ose një Kolegj i Dhomës së Posaçme ka marrë vendim, por ka dështuar të nxjerrë Aktgjykimin me shkrim brenda afatit ligjor. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kjo nuk aplikohet në rastin e tyre, ku ende nuk kishte ndonjë vendim.

35. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës e mohojnë deklaratën se ata nuk kishin dorëzuar ndonjë "urgjencë" me kërkesën që të përshpejtohet procedura. Parashtruesit pohojnë se ata e kishin vizituar Dhomën e Posaçme disa herë për të kërkuar gojarisht përshpejtimin e procedurës, po ashtu kishin dorëzuar edhe dy "urgjenca" në Kolegjin e specializuar si dhe tri "urgjenca" në Kolegjin e Apelit që po merreshin me rastin. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata nuk morën asnjëherë përgjigje në "urgjencat" e tyre.

36. Parashtruesit e kërkesës po ashtu hedhin poshtë argumentet e Dhomës së Posaçme lidhur me ndërlikueshmërinë e rastit dhe ngarkesën me lëndë të Dhomës së Posaçme. Parashtruesit e kërkesës citojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) për të theksuar se është detyrë e shtetit të organizojë sistemin juridik dhe gjyqësor në atë mënyrë që i garanton të drejtën çdo personi për të pasur vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, dhe se argumenti për mbingarkesë me lëndë nuk mund të merret si arsyetim (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së: *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [DHM], § 183, *Sürmeli kundër Gjermanisë* [DHM], § 129; *Vocatur*o kundër *Italisë,* § 17; dhe *Cappello kundër Italisë,* § 17).

37. Në fund, sa i përket rëndësisë së rastit, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Dhoma e Posaçme ishte plotësisht në dijeni se të gjithë parashtruesit e kërkesës janë kryesisht në moshë dhe se duhet kushtuar kujdes i veçantë në trajtimin e këtij rasti. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se dy nga parashtruesit kanë ndërruar jetë që nga fillimi i kësaj procedure, dhe nuk mund të përfitojnë më personalisht nga kërkesat e tyre.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar..*
> *[...]*
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

40. Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme pohon se parashtruesit e kërkesës e kishin në dispozicion një mjet juridik për të përshpejtuar procedurat, të cilin ata nuk e shfrytëzuan. Dhoma e Posaçme citon nenin 10.12 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme.

41. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë këtë mjet duke theksuar se i njëjti aplikohet vetëm pasi të jetë marrë vendimi nga gjykata, ashtu që ajo gjykatë të detyrohet të nxjerrë vendimin e saj me shkrim. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se

pretendimi i tyre ka të bëjë me përshpejtimin e procedurave në kohën kur ende nuk është marrë vendimi. Kësisoj, ata pretendojnë se mjeti juridik i propozuar nga Dhoma e Posaçme nuk ka vlejtur në rastin e tyre, sepse në kohën e dorëzimit të kërkesës, ata ende po prisnin vendimin e Kolegjit të Apelit lidhur me paditë e tyre.

42. Gjykata vëren se neni 10.12 i Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme qartazi tregon se ka të bëjë me ato situata kur Gjykata, Kolegji i specializuar, nën-kolegji ose gjyqtari i vetëm, *"dështon të nxjerrë aktvendim apo aktgjykim"*. Përveç kësaj, ky nen i jep autorizim Kolegjit të Apelit të urdhërojë Gjykatën, Kolegjin ose gjyqtarin "*që të nxjerrë aktgjykimin apo aktvendimin në fjalë brenda dhjetë (10) ditësh pune.*"

43. Si i tillë, Gjykata konsideron se ky nen i referohet në mënyrë specifike çështjes së "*nxjerrjes"* së vendimit që tashmë është marrë, dhe nuk i referohet marrjes së vendimit nga gjykata, kolegji ose gjyqtari.

44. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën para se të merrej vendimi përfundimtar lidhur me rastin e tyre nga Kolegji i Apelit. Më pastaj, Kolegji i Apelit solli aktgjykimin përfundimtar në rastin e parashtruesve të kërkesës.

45. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se ky mjet i paraparë me nenin 10.12 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme nuk ka vlejtur në situatën e parashtruesve, dhe nuk do të ishte mjet juridik adekuat dhe efektiv për të përshpejtuar vendimmarrjen në rastin e tyre.

46. Dhoma e Posaçme po ashtu pohon se parashtruesit kanë mundur të dorëzojnë të ashtuquajturat "urgjenca" në Kolegjin e Specializuar dhe në Kolegjin e Apelit për të kërkuar që rasti i tyre të trajtohej me urgjencë. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata u janë drejtuar të dy kolegjeve dhe u kanë paraqitur të paktën 5 (pesë) urgjenca, por pa asnjë rezultat.

47. Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme u referohet "urgjencave" si mjet joformal. Dhoma e Posaçme nuk tregon se cilat dispozita ligjore rregullojnë shfrytëzimin e "urgjencave". Gjykata gjithashtu vëren se Dhoma e Posaçme e pranoi se parashtruesit e kërkesës kishin dorëzuar të paktën një urgjencë, por se ajo nuk mori asnjë përgjigje.

48. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e të drejtave të tyre kushtetuese, "*vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

49. Gjykata konsideron se "urgjenca" nuk kualifikohet si "mjet juridik i përcaktuar me ligj", sepse ajo është vetëm një praktikë joformale që nuk është e paraparë me asnjë ligj, dhe nuk është as adekuate, as efektive, për zgjidhjen e ankesave të parashtruesve.

50. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës i kanë shterur të gjithat mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

51. Gjykata më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës e kanë precizuar kërkesën e tyre në mënyrë adekuate, siç përcaktohet me nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parashikon:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

52. Përveç kësaj, Gjykata i merr parasysh paragrafët (1) (d) dhe (2) (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."*

53. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës tregojnë se për shkak të kohëzgjatjes së procedurës në fjalë ka pasur shkelje të të drejtave të tyre për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31.2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës dhe nenit 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ-së.

Neni 31.2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës

> *"[...]*
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm ...".*

Neni 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) i KEDNJ-së

> *"1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...".*

54. Për të verifikuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata do të merret me: i) përcaktimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi në institucionet kompetente ii) parimet relevante dhe iii) duke analizuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës.

i) Periudha që do të merret parasysh

55. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në muajt qershor dhe korrik 2009 parashtruesit e kërkesës i kanë paraqitur ankesat në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve të përpiluar nga AKP-ja, në të cilën nuk ishin përfshirë si punëtorë që kanë të drejtë në pjesën e 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Mustafa Goga".

56. Gjykata, me rastin e përcaktimit të periudhës kohore që duhet të merret parasysh, do ta marrë si fillim të procedurës, muajin qershor 2009. Si datë të përfundimit të procedurës, Gjykata do ta marrë 16 marsin 2016, që është data kur Kolegji i Apelit ka nxjerrë Aktgjykimin përfundimtar, me të cilin e ka zgjidhur objektin e kontestit të parashtruesve të kërkesës.

57. Prandaj, Gjykata vëren se periudha që duhet ta marrë parasysh në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së është 6 (gjashtë) vjet e nëntë (9) muaj.

ii) Parimet relevante

58. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, dhe në veçanti: (a) ndërlikueshmërinë e rastit, (b) sjelljen e palëve në procedurë (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike, si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 38).

iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

59. Gjykata vëren se ky rast ka të bëjë me një procedurë, në të cilën parashtruesit kontestuan mospërfshirjen e tyre në listën e përfituesve të pjesës së 20 % nga të ardhurat e privatizimit të NSH "Mustafa Goga", për të cilën ata konsiderojnë se kishin të drejtë të përfitonin.

60. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme deklaron se rasti kishte të bënte me 98 ankues dhe përfshinte 48 ankesa të ndryshme. Dhoma e Posaçme pohoi se secila ankesë kërkonte një vlerësim individual, të veçantë dhe të kujdesshëm për shkak të natyrës së ndjeshme të ankesave. Gjithashtu, Dhoma e Posaçme pohoi se bëhej fjalë për një numër të madh të dokumenteve ku të gjitha duhej përkthyer gjë që kërkonte kohë shtesë.

61. Gjykata vëren se parashtruesit kontestuan pohimin se rasti ishte veçanërisht i ndërlikuar, sepse shumica e ankesave ishin në substancë të njëjta.

62. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se rasti ishte, në mënyrë të arsyeshme, i ndërlikuar.

63. Sa i përket sjelljes së palëve të rastit, Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme e pranon se parashtruesit e kërkesës nuk kishin bërë asgjë që do të vononte procedurën. Për më tepër, parashtruesit bënë me dije se ata e kishin vizituar Dhomën e Posaçme disa herë, dhe se kishin dorëzuar të paktën pesë "urgjenca" në kolegjet e Dhomës së Posaçme që po merreshin me rastin.

64. Në këtë rrethana, Gjykata konsideron se çfarëdo vonese në procedurë nuk mund t'u atribuohet parashtruesve të kërkesës.

65. Sa i përket sjelljes së gjykatës përkatëse dhe autoriteteve tjera publike, Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme pretendon se është e mbingarkuar me punë dhe se duhet të ndërmarrë shumë veprime administrative, sikurse përkthimi i dokumenteve, si dhe verifikimi dhe krahasimi i dokumenteve në secilën fazë të procedurës, në mënyrë që të procedojë me rastet.

66. Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë vlefshmërinë e ngarkesës me punë si argument për të justifikuar vonesën e paarsyeshme në procedurë gjyqësore.

67. Gjykata rikujton se, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vonesat që ndonjëherë shkaktohen nga mbingarkesa me punën e gjykatave, mund të jenë të pranueshme përderisa nuk janë shumë të gjata dhe nëse autoritetet ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të përcaktuar rendin e prioriteteve në bazë të urgjencës dhe rëndësisë së

tyre (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 13 korrikut 1983, *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvircës*, kërkesa nr. 8737/79, paragrafët 27-32).

68. Në kontekstin e ndërlikueshmërisë së rastit, si dhe të obligimit për të përmbushur të gjitha kërkesat procedurale, Gjykata vëren se Kolegji i specializuar e përmbylli procedurën me Aktgjykim meritor pas një periudhe prej 4 (katër) vjetësh e 3 (tre) muajsh.

69. Gjykata më tej vëren se AKP-ja ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë të Kolegjit të specializuar. Kjo ankesë u parashtrua brenda afatit ligjor dhe me të u paraqitën fakte dhe prova të reja të cilat Kolegji i Apelit është dashur t'i krahasojë dhe verifikojë me institucionet relevante.

70. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit e nxori Aktgjykimin sipas ankesës më 16 mars 2016, dhe me atë rast e zgjodhi kontestin e parashtruesve me aktgjykim të formës së prerë. Procedura në Kolegj të Apelit zgjati 2 (dy) vjet dhe 5 (pesë) muaj.

71. Gjykata vëren se brenda një periudhe prej gjithsej 6 (gjashtë) vjetësh dhe 9 (nëntë) muajsh Dhoma e Posaçme nxori dy aktgjykime për meritat e rastit që përfshinte 98 ankues dhe trajtonte 48 ankesa. Numri i hapave proceduralë përfshinte përkthimin dhe verifikimin e një numri të madh të dokumenteve, dhe se rasti kishte nevojë të individualizohet dhe të trajtohet veç e veç në raport me secilin nga 98 ankuesit.

72. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se dy nivelet e juridiksionit të Dhomës së Posaçme i zhvilluan procedurat e tyre me kujdes të arsyeshëm.

73. Lidhur me atë se çfarë ishte në rrezik për parashtruesit në kontest, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesve ka të bëjë me një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes ku kanë punuar ata, dhe që, në sistemin e pronësisë shoqërore, ishte pjesërisht në pronësi të tyre.

74. Kësisoj, Gjykata konsideron se pritja për marrjen e një shume të parave ishte e një rëndësie të konsiderueshme për jetën e tyre, por nuk ishte e një natyre aq detyruese sa të kërkonte urgjencë të veçantë nga ana e gjykatave.

75. Si përfundim, Gjykata gjen se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave pranë Kolegjit të specializuar dhe pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, prej 6 (gjashtë) vjetësh dhe 9 (nëntë) muajsh, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme, duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve dhe çfarë ishte në rrezik për parashtruesit e kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 27 qershorit 2000, *Frydlender kundër Francës*, Nr. 30979/96, paragrafët 43-46; dhe Aktgjykim i GJENDJ-së, i 8 qershorit 2006, *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, paragrafët 128-134).

76. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë dëshmuar pretendimin se u është shkelur e drejta për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 (2) të Kushtetutës dhe me nenin 6(1) të GJEDNJ-së.

77. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI114/16, Parashtrues: Feriz Gashi dhe Hysni Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Api-Kzi-6/2011, të 25 shtatori 2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz.nr.283/2009, të 19 prillit 2011

KI114/16, Aktvendim për papranueshmëri i 4 prillit 2017, publikuar më 16 maj 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës, ka nxjerrë Aktgjykimin, Api-Kzi-6/2011, të 25 shtatori 2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-kz.nr.283/2009, të 19 prillit 2011 me të cilat kishte refuzuar ankesat e parashtrueseve kundër aktgjykimeve me të cilat parashtruesi Feriz Gashi ishte dënuar për veprën penale vrasje e rëndë dhe veprën penale mbajtje, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar i armeve, ndërsa parashtruesi Hysni Gashi për veprën penale shtytje për te kryer veprën penale, vrasje e rëndë.

Parashtruesit në kërkesën e tyre nuk kanë saktësuar se cila dispozitë kushtetuese mund të jetë shkelur. Gjykata konstatoi se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse është dorëzuar jashtë afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI114/16

Parashtrues

Feriz Gashi dhe Hysni Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Api-Kzi-6/2011], të 25 shtatorit 2012, dhe i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Ap-Kz. nr. 283/2009], të 19 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLLKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga*:*

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Feriz Gashi dhe Hysni Gashi nga komuna e Shtimes (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi Feriz Gashi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Api-Kzi-6/2011], të 25 shtatorit 2012, të cilin e ka pranuar më 3 mars 2013.

3. Parashtruesi Hysni Gashi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Ap-Kz. nr. 283/2009] të 19 prillit 2011, të cilin e ka pranuar më 14 korrik 2011.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit nuk kanë specifikuar të drejtat kushtetuese që pretendojnë që u janë shkelur, por kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara, përmes së cilave pretendojnë që *"gjykatat e Republikës së Kosovës vepruan padrejtësisht në rastin e tyre"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në nenin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 shtator 2016, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 1 nëntor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtën kohë ju dërgoi formularin e kërkesës të Gjykatës dhe, kërkoi nga parashtruesit të plotësojnë këtë formular.

9. Më 1 nëntor 2016, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Gjykata e Apelit që të paraqesin dëshmi se kur aktgjykimet e kontestuara i janë dorëzuar parashtrueseve të kërkesës.

10. Më 21 nëntor 2016, Gjykata pranoi formularin e plotësuar të kërkesës nga parashtruesit.

11. Më 24 nëntor 2016, Gjykata pranoi konfirmimin për kohën e pranimit të aktgjykimeve të kontestuara nga parashtruesit.

12. Më 4 prill 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 22 prill 2006, parashtruesit e kërkesës ishin arrestuar si të dyshuar për vrasjen e V. Z. dhe A. Xh. në Shtime.

14. Më 25 prill 2006, Prokurori publik lëshoi vendimin (PP. nr. 239-1/06) për fillimin e hetimeve kundër të dyshuarve, Feriz Gashi dhe Hysni Gashi.

15. Më 10 janar 2007, Prokurori Publik dorëzoi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut), aktakuzën kundër parashtruesit Feriz Gashi për veprën penale vrasje e rëndë dhe veprën penale mbajtje, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe kundër parashtruesit Hysni Gashi për veprën penale shtytje për të kryer veprën penale, vrasje e rëndë.

16. Më 6 mars 2007, Gjykata e Qarkut konfirmoi aktakuzën e paraqitur nga Prokurori publik, kundër parashtruesve të kërkesës.

17. Më 27 mars 2009, Gjykata e Qarkut, nxori Aktgjykimin [P. nr. 10/2007] me të cilin e shpalli të akuzuarin Feriz Gashi fajtor dhe e dënoi me dënimin me burgim prej 25 (njëzetepesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, dhe të akuzuarin Hysni Gashi e shpalli fajtor dhe e dënoi me burgim prej 20 (njëzetë) vjetësh.

18. Në afatin ligjor, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesën në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut [P. nr. 10/2007], duke theksuar shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Penale, shkelje të Ligjit Penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

19. Po ashtu, brenda afatit ligjor ankesa të ndara paraqitën edhe palët e dëmtuara E.F. dhe G.B. përmes përfaqësuesve të tyre ligjor, në veçanti, duke kundërshtuar vendimin mbi

masën e dënimit dhe duke propozuar ndryshimin e Aktgjykimit dhe shqiptimin e burgimit afatgjatë ndaj dy të akuzuarve.

20. Më 30 prill 2010, Prokurori Publik, propozoi që ankesat të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut [P. nr. 10/2007].

21. Më 19 prill 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Ap-Kz. nr. 283/2009], me të cilin ndryshoi vendimin e Gjykatë së Qarkut mbi dënimin për parashtruesin Feriz Gashi, duke dhënë dënim prej 30 (tridhjetë) vjetësh, ndërsa vërtetoi aktgjykimin sa i përket parashtruesit Hysni Gashi

22. Më 13 korrik 2011, parashtruesi Feriz Gashi ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Ap-Kz. nr. 283/2009], pasi ishte dënuar me dënim afatgjatë dhe i lejohej ankesa në shkallë të tretë, duke theksuar se Aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë kanë *"vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht gjendjen faktike, se është shkelur kodi penal dhe se sanksioni penal është shqiptuar gabimisht"*.

23. Më 25 shtator 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Api-Kzi-6/2011] me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit Feriz Gashi si të pabazuar, ndërsa sipas detyrës zyrtare ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Ap-Kz nr. 283/2009] sa i përket dënimit, duke ulur dënimin me burgim në 29 (njëzetenëntë) vjet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Gjykatat e Republikës së Kosovës vepruan padrejtësisht*" dhe kërkojnë nga Gjykata që të *"sjell drejtësi ndaj tyre, si për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës kur janë të pafajshëm"*.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga parashtruesit, në pajtim me kriteret e nenit 113, paragrafi 1 dhe 7 të Kushtetutës, që nënkupton se parashtruesit kanë përmbushur kriterin që të njihen si palë e autorizuar si dhe kanë shterur mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

28. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor..."*.

29. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"1) Gjykata *mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(...)

(c) kërkesa *parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi."*

30. Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata ka konstatuar se parashtruesi Hysni Gashi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Ap-Kz. nr. 283/2009] të 19 prillit 2011, i cili i është dorëzuar më 14 korrik 2011.

31. Ndërsa, parashtruesi Feriz Gashi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Api-Kzi-6/2011], të 25 shtatorit 2012, i cili i është dorëzuar më 6 mars 2013.

32. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesit paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatë, më 16 shtator 2016.

33. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.

34. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, shih, edhe: rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi,* Aktvendim për papranueshmërinë, të 17 marsit 2014, paragrafi 24).

35. Nga kjo rrjedh se, kërkesa e parashtruesve është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KO12/17, Parashtruesi i kërkesës: Avokati i Popullit, Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën te neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

KO12/17, Aktgjykim i 9 majit 2017, i publikuar më 30 maj 2017

Fjalët kyçe*: kërkesë institucionale, Avokati i Popullit, kundërvajtjet, e drejta për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur, kërkesë e pranueshme.*

Në këtë rast, Avokati i Popullit në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63 , 64, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje nuk janë në pajtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Dispozitat e mësipërme të Ligjit për Kundërvajtje delegojnë kompetenca të caktuara gjyqësore lidhur me kundërvajtjet tek organet administrative sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Kundërvajtje.

Pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parashikuara më tej me Ligj dhe të parapara me rregullat e procedurës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës, Gjykata arriti në përfundim se kundërvajtjet bien në kuadër të fushës së veprës penale "akuza penale" brenda kuptimit të Kushtetutës. Megjithatë, mundësia e ankesës në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë përmbush kërkesën për qasje në një seancë të drejtë dhe të paanshme për një akuzë penale. Prandaj, Gjykata ka gjetur se dispozitat e kontestuara të ligjit të kontestuar janë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO12/17

Parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston përputhshmërinë me Kushtetutë të neneve të caktuara të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Ligji i kontestuar), i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2017, përkatësisht, neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i përputhshmërisë me Kushtetutën të neneve të cekura më lart të Ligjit të kontestuar, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, për të suspenduar zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit të kontestuar deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 2, nënparagrafi 1, dhe në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55, 56, 62, dhe 64 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 10 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

8. Më 14 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

9. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me udhëzimin që t'ua shpërndajë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Sekretariatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga i cili u kërkua që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për rastin; Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës ndonjë koment dhe dokumentet relevante lidhur me kërkesën.

10. Nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nga deputetët e Kuvendit, nga Kryeministri, nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe nga Ministria e Drejtësisë, u kërkua që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 3 mars 2017.

11. Më 15 shkurt 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi të miratojë masën e përkohshme deri më 30 prill 2017.

12. Më 16 shkurt 2017, Sekretariati i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumente relevante për rastin, duke përfshirë Memorandumin shpjegues të Ligjit të kontestuar, Certifikatën e përputhshmërisë me "*Acquis* të BE-së" të nxjerrë nga Ministria për Integrim Evropian, Certifikatën mbi vlerësimin e ndikimit buxhetor të lëshuar nga Ministria e Financave, dhe Certifikatën e pajtueshmërisë me Rregulloren e punës së Qeverisë.

13. Më 28 shkurt 2017, Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Legjislacion) dorëzoi komentet e tyre lidhur me kërkesën.

14. Më 3 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Avokatin e Popullit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me komentet e pranuara nga Komisioni për Legjislacion dhe dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit, si dhe u dorëzoi kopjet e të gjitha parashtresave. Gjykata gjithashtu i njoftoi se ata mund të paraqesin komentet e tyre shtesë, nëse kanë, deri më 13 mars 2017.

15. Më 13 mars 2017, Avokati i Popullit dorëzoi përgjigjen e tij ndaj komenteve të dorëzuara nga Komisioni për Legjislacion si dhe të dokumenteve të pranuara nga Sekretariati i Kuvendit.

16. Më 14 mars 2017, Gjykata e njoftoi Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë dhe Sekretariatin e Kuvendit në lidhje me komentet e pranuara nga Avokati i Popullit, dhe u dorëzoi nga një kopje. Gjykata gjithashtu njoftoi secilën prej këtyre palëve, se ata mund të paraqesin komentet e tyre shtesë, nëse kanë, deri më 21 mars 2017. Gjykata nuk pranoi asnjë koment.

17. Më 5 prill 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Gjykatës që të miratojë vazhdimin e masës së përkohshme të miratuar nga Gjykata më 15 shkurt 2017. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi njëzëri të miratojë vazhdimin e masës së përkohshme deri më 15 qershor 2017.

18. Më 9 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe t'i vlerësojë meritat e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 5 gusht 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e kontestuar, me 71 (shtatëdhjetë e një) vota për, 0 (zero) vota kundër dhe 0 (zero) abstenime.

20. Më 23 gusht 2016, Ligji i kontestuar u shpall nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

21. Më 8 shtator 2016, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

22. Neni 171 i Ligjit të kontestuar përcakton se "Ligji hyn në fuqi në janar të vitit 2017".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhje me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse ato *"delegojnë kompetencat gjykuese tek organet ekzekutive*".

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*personat e akuzuar për kundërvajtje kanë të drejtë për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*", dhe se në rastet e gjykuara nga "Organet e Kundërvajtjes" (në tekstin e mëtejmë: OK), "*Ligji për kundërvajtje nuk u siguron personave të akuzuar qasje në një gjykatë të pavarur*", duke argumentuar gjithashtu se "*Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës nuk ka juridiksion të plotë në kontrollimin e vendimeve të "organeve të kundërvajtjes"*.

25. Parashtruesi i kërkesës përmbledh pretendimet e tij, duke parashtruar pyetjen e mëposhtme në Gjykatë: "*Ky delegim i kompetencave gjykuese tek organet administrative dhe ekzekutive, a paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?"*.

26. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë të veçantë pretendon se: (I) "*personat e akuzuar për kundërvajtje kanë të drejtë për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur*" dhe (II) "*në rastet e gjykuara nga Organet e Kundërvajtjes, Ligji për kundërvajtje nuk u siguron personave të akuzuar qasje në një tribunal të pavarur*". Parashtruesi i kërkesës pohon se kjo e fundit është rezultat i dy tipareve të veçanta të Ligjit të kontestuar: (a) "*Organet e kundërvajtjeve nuk përmbushin kriteret e një tribunali të pavarur*" dhe (b) "*Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës nuk ka juridiksion të plotë në kontrollimin e vendimeve të "organeve të kundërvajtjes".*

I. Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë para një tribunali të pavarur për personat e akuzuar për kundërvajtje

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Ligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje delegon tek organet administrative dhe ekzekutive [organeve të kundërvajtjes] kompetencën për të gjykuar dhe për të vendosur sanksione, në një varg të gjerë të rasteve kundërvajtëse. Vendimet e këtyre organeve i nënshtrohen vetëm një forme të kufizuar të kontrollit gjyqësor."*

28. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se *"ky delegim i kompetencave gjykuese tek [organet e kundërvajtjes] paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"* .

29. Më tej, parashtruesi i kërkesës argumenton se *"një linjë e gjatë e vendimeve gjyqësore të GjEDNj-së tregon se, edhe kur kundërvajtjet nuk klasifikohen si "vepra penale" brenda sistemit ligjor kombëtar, ato mund të quhen "vepra penale" në kontekstin e Konventës, nëse penalizimi i kundërvajtjeve u shërben qëllimeve parandaluese dhe ndëshkuese. Ky parim u dëshmua qartë në rastin Öztürk kundër Gjermanisë, Aplikimi nr. 8544/79, GjEDNj (1984)."*

30. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës specifikon se *"Duke marrë parasysh këto qëllime shprehimisht parandaluese dhe ndëshkuese, vepra të tilla duhet të konsiderohen "penale" brenda kuptimit të nenit 6, në përputhje me arsyetimin e GjEDNj-së në Ozturk. Prandaj, personat e akuzuar për kundërvajtje në Republikën e Kosovës, duhet të gëzojnë mbrojtjet e nenit 6, duke përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur."*

II. Sa i përket asaj nëse Ligji i kontestuar ofron të drejtën për gjykim të drejtë para një tribunali të pavarur për personat e akuzuar për kundërvajtje

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Në mënyrë që të quhet "tribunal i pavarur", një organ duhet të përmbushë disa kritere. Dy kriteret më relevante për vlerësimin e Ligjit për kundërvajtje janë: (a) që organi të jetë i pavarur prej ekzekutivit dhe (b) që ai të ketë juridiksionin e plotë. [...] Vetëm një institucion që ka juridiksion të plotë dhe që përmbushë një varg kërkesash, si p.sh. pavarësia nga ekzekutivi..., meriton etiketimin 'tribunal' brenda kuptimit të nenit 6, par. 1".*

a) Përkitazi me pavarësinë e organeve të kundërvajtjes nga dega ekzekutive

32. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se "*organet kundërvajtëse, siç përshkruhen në Ligjin për kundërvajtje, gjithashtu nuk arrijnë të jenë të pavarura prej ekzekutivit, sipas ndonjërit nga kriteret e listuara të GJEDNJ-së [...] organet e kundërvajtjes janë "organe të administratës shtetërore" apo organe që*

"mbikëqyrin zbatimin e ligjeve, organi i kundërvajtjes përkufizohet si "organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike ... të mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje" [...] Prandaj, sipas përkufizimit të vetë Ligjit, organet e kundërvajtjes jo vetëm që nuk janë të pavarura nga ekzekutivi, por janë vetë pjesë e ekzekutivit".

33. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se përbërja e OK-ve, siç përcaktohet me Ligjin e kontestuar, nuk siguron masat e nevojshme për pavarësinë dhe paanësinë e anëtarëve të tyre.

34. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës, duke u bazuar në Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 2 shtatorit 1998, *Lauko kundër Sllovakisë*, Aplikimi nr. 26138/95, pohon se OK-të *"nuk mund të konsiderohen 'të pavarura' prej ekzekutivit brenda kuptimit të nenit 6, par. 1 të Konventës".*

b) Lidhur me Shqyrtimin Gjyqësor nga Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *"Sipas precedentëve të GjEDNj-së, mungesa e pavarësisë së një organi administrativ mund të tolerohet, nëse vendimet e atij organi "i nënshtrohen kontrollit të mëtejshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë"*.

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *"koncepti i "juridiksionit të plotë", siç përdoret nga GjEDNj, është i rreptë dhe përfshin, në veçanti, "kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështje ligjore dhe faktike, vendimin e [organit administrativ]"*, dhe *"është e nevojshme që 'tribunali' në fjalë të ketë juridiksionin për të shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin përpara tij".*

37. Parashtruesi i kërkesës, më tej, specifikon se *"Kompetenca e Departamentit për Çështje Administrative për të kontrolluar vendimet e organeve kundërvajtëse është e kufizuar, sidomos në lidhje me çështje faktike. Ligji për Konfliktet Administrative përcakton shprehimisht se, në kontrollimin e vendimit të një organi administrativ, Departamenti 'vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative'-me fjalë të tjera, në bazë të fakteve të vërtetuara nga vetë organi i kundërvajtjes".*

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon më tej që "*Ligji për Konfliktet Administrative i jep Departamentit [për Çështje Administrative] mundësinë për të anuluar vendimet e organeve administrative mbi dy baza faktike të kufizuara: nëse (a) "nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike" ose (b) faktet "në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht"* (po aty, *neni 43, par. 2). Në këtë mënyrë, Departamenti për Çështje Administrative mund t'i hedhë poshtë konkluzionet që organi kundërvajtës i nxori prej këtyre fakteve të vërtetuara, apo të konstatojë që këto fakte nuk janë vërtetuar plotësisht. Mirëpo, ajo që Departamenti nuk mund të bëjë është të shqyrtojë të tjera pretendime faktike apo prova që nuk ishin shqyrtuar më parë gjatë procedurave administrative të vetë organit kundërvajtës. Mbi këtë pikë, shih Ligjin për Kundërvajtje, neni 66, par. 1, nënparagrafi 3 (në ankesat kundër vendimeve të organeve kundërvajtëse 'nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja'). Prandaj, Departamenti për Çështje Administrative nuk ka mundësinë 'për të shqyrtuar të gjitha çështjet faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin përpara saj".*

Përgjigjja e Komisionit për Legjislacion të Kuvendit

39. Në përgjigjen e tij ndaj kërkesës, Komisioni për Legjislacion rikujton se *"më 31 mars 2016, Komisioni për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve relevantë në procesin e shqyrtimit [të Projektligjit për Kundërvajtje] ka mbajtur një seancë dëgjimore publike për të parë qëllimet e propozuesit [Ministria e Drejtësisë], dhe reformat që trajtohen me këtë ligj. Ministria e Drejtësisë deklaroi në këtë dëgjim publik se qëllimi kryesor lidhet me reformimin e të gjithë fushëveprimit të veprave dhe për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin në shqiptimin e gjobave dhe në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me veprat. Gjithashtu është theksuar se përmes këtij projektligji do të bëhet një reformë themelore dhe thelbësore e fushëveprimit të veprave, ku parashikohet heqja e dënimit me burg, dhe për një numër të caktuar të veprave shqiptohet gjoba nga autoritetet kompetente"*.

40. Më tej, Komisioni për Legjislacion shton se *"është thënë se ky ligj në fazat e shqyrtimit në nivel ministror ka kaluar konsultime të gjera nga Ministria e Drejtësisë, duke përfshirë në këtë proces aktorët profesionistë me institucione të pavarura, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Gjykatën Supreme, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, duke nënvizuar se është në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian"*.

41. Komisioni për Legjislacion shpjegon se *"Grupi punues, duke ruajtur frymën e ligjit, ka vazhduar të punojë me aktorët e përfshirë në këtë proces dhe ka propozuar 32 amendamente në Komision për miratim, të cilat nuk kanë ndryshuar përmbajtjen e ligjit në nenet e kontestuara"*.

Përgjigjja e parashtruesit të kërkesës

42. Në përgjigje të komenteve të parashtruara nga Komisioni për Legjislacion dhe dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit, parashtruesi i kërkesës paraqiti komentet e veta duke pretenduar se *"asnjë nga këto materiale, duke përfshirë Komentet e Komisionit për Legjislacion, nuk e kundërshtojnë konkluzionin e Avokatit të Popullit, domethënë që nenet e kontestuara janë vërtetë të papajtueshme me Kushtetutën. Me fjalë të tjera, Komentet e Komisionit për Legjislacion nuk bëjnë përpjekje për të mbrojtur kushtetutshmërinë e këtyre neneve"*.

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *"Dokumentet e dërguara nga Sekretariati i Kuvendit dëshmojnë se në asnjë seancë plenare dhe në asnjë mbledhje të komisionit, nuk është analizuar, as nuk është përmendur, kjo çështje kyçe"*. Parashtruesi i kërkesës, më tej, shton se "*dështimi i Kuvendit në këtë drejtim paraqet shkelje të nenit 55, par. 4 të Kushtetutës, i cili përcakton se: "Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut ... , të gjitha institucionet e pushtetit publik ... e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël", duke marrë parasysh edhe nenin 53 të Kushtetutës, i cili udhëzon se: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"."*

44. Parashtruesi i kërkesës përfundimisht thekson se *"Edhe kjo Gjykatë [Kushtetuese] ka theksuar detyrën e institucioneve shtetërore për të analizuar me kujdes implikimet kushtetuese të akteve që i nxjerrin, si dhe ka theksuar rëndësinë e marrjes parasysh të komenteve të institucioneve tjera, në rastin KO73/16"*. Të njëjtën mënyrë, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ka dëshmi që mund të sugjerojë se Komisioni për

Legjislacion *"ka analizuar në mënyrë të duhur implikimet [e neneve të kontestuara të Ligjit për Kundërvajtje] sipas dispozitave të Kushtetutës"*.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

46. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

47. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> > *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;"*

48. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute."*

49. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë, në bazë të neneve 113 (2) dhe 135 (5) të Kushtetutës.

50. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 29 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.*
>
> *2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.*
>
> *3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar."*

51. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar dispozitat e Ligjit të kontestuar që konsiderohen të mos jenë në përputhshmëri me Kushtetutën, ka specifikuar se me cilat nene të Kushtetutës pretendohet se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri, dhe ka paraqitur prova që mbështesin pretendimet e tij.

52. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 30 [Afatet] e Ligjit, i cili përcakton: *"Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar."*

53. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 10 shkurt 2017.

54. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka identifikuar dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, ka specifikuar dhe arsyetuar pretendimet e tij kushtetuese, ka paraqitur dëshmi mbështetëse dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar.

55. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa gjithashtu nuk është e papranueshme në asnjë nga bazat e tjera të përfshira në rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

56. Rrjedhimisht, Gjykata deklaron që kërkesa është e pranueshme.

Meritat/Substanca e kërkesës

57. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e konteston përputhshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të caktuara të Ligjit të kontestuar, përkatësisht neneve 55 (paragrafët: 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68, duke pretenduar se ato nuk janë në përputhje me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

58. Gjykata rikujton dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së:

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. […]"

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[…]."

59. Gjykata përsëritë se sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut] të Kushtetutës, *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

60. Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"delegimi i kompetencave gjyqësore në degën ekzekutive"* nuk është në përputhje me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë pyetje: "*Ky delegim i kompetencave gjykuese tek organet administrative dhe ekzekutive, a paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?*."

61. Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit të GJEDNJ-së *Özturk kundër Gjermanisë*, në të cilën GJEDNJ, ndër të tjera, pohoi se *"Konventa nuk është kundër lëvizjeve drejt "dekriminalizimit" që po ndodhin - në forma skajshmërisht të ndryshme - në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës"* (Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 21 shkurtit 1984 *Özturk kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 854/79, paragrafi 49). I njëjti Aktgjykim më tej sqaron se *"duke hequr disa forma të sjelljes nga kategoria e veprave penale sipas ligjit kombëtar, ligjvënësi mund të jetë në gjendje t'i shërbejë interesave të individit, si dhe nevojave të administrimit të duhur të drejtësisë, në veçanti për aq sa autoritetet gjyqësore në këtë mënyrë lirohen nga detyra e ndjekjes dhe ndëshkimit të kundërvajtjeve - të cilat janë të shumta, por me rëndësi të vogël - të rregullave të trafikut rrugor"*. (Shih *Özturk kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 49).

62. Megjithatë, Gjykata rikujton se në të njëjtin dhe në aktgjykime të tjera të aplikueshme, GJEDNJ gjithashtu përcakton kufizime rreth këtij qëndrimi të përgjithshëm të referuar më lart. Në *Özturk kundër Gjermanisë*, GJEDNJ pohoi që "*megjithatë, nëse Shtetet Kontraktuese kishin mundësi sipas zgjedhjes së tyre, duke klasifikuar një vepër si "rregullative" në vend të penale, për të përjashtuar funksionimin e klauzolave themelore të nenit 6 dhe 7 (neni 6, neni 7), zbatimi i këtyre dispozitave do t'i nënshtrohej vullnetit të tyre sovran. Një gjerësi që shtrihet aq larg mund të çojë në rezultate të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës*". (Shih *Özturk kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 49).

63. Gjykata më tej thekson se në aktgjykimet tjera, GJEDNJ-ja përcaktoi kriteret të cilat do të siguronin që delegimi i këtyre kompetencave të mos jetë në papajtueshmëri me KEDNJ-në. Këto kritere përcaktojnë që personat në fjalë, duhet të kenë mundësinë të kontestojnë çdo vendim të autoriteteve të tilla administrative në një gjykatë që plotëson garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, që i nënshtrohet një "juridiksioni të plotë", duke përfshirë edhe kompetencën për të anuluar vendimet e tilla në të gjitha aspektet – edhe sa i përket çështjeve të faktit po ashtu edhe të ligjit. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 10 shkurtit 1983, *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, kërkesat nr. 7299/75, 7496/76, paragrafi 29, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 tetorit 1995, *Gradinger kundër Austrisë*, kërkesa nr. 15963/90, paragrafi 42).

64. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se GJEDNJ më tutje konstatoi se *"kalimi i ndjekjes dhe ndëshkimit të kundërvajtjeve tek autoritetet administrative nuk është në kundërshtim me Konventën, me kusht që personi në fjalë të mund të sfidojë çdo vendim të tillë kundër tij para një gjykate që ofron garancitë e nenit 6 (neni 6)"*. (Shih *Özturk kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 56).

65. Gjykata gjithashtu i referohet në mënyrë specifike praktikës tjetër gjyqësore të GJEDNJ-së, në të cilat theksohet:

> *"Gjykata rithekson që vendimet e nxjerra nga autoritetet administrative të cilat vetë nuk i përmbushin kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 (neni 6-1) i Konventës - siç është rasti në këtë instancë me autoritetin e policisë federale dhe qeverinë rajonale*

*(shih paragrafin 6 dhe paragrafin 7 më lart) - duhet t'i nënshtrohet kontrollit pasues nga një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë". (*Vendimi i GJEDNJ-së i 23 tetorit 1995*, Schmautzer kundër Austrisë,* kërkesa nr. 15523/89, paragrafi 3*; Gradinger kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 42 dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 17 dhjetorit 1996*, Terra Woningen B.V. kundër Holandës,* kërkesa nr. 2064/92, paragrafi 52*).*

"Kompetencat e Gjykatës Administrative duhet të vlerësohen në dritën e faktit se gjykata në këtë rast kishte të bënte me procedurat që ishin me karakter penal për qëllimet e Konventës. Rrjedhimisht, kur pajtueshmëria e këtyre kompetencave vlerësohet në kuadër të nenit 6 para. 1 (art, 6-1), duhet të merren parasysh ankesat e ngritura në atë gjykatë nga parashtruesi si dhe karakteristikat përcaktuese të një "organi gjyqësor që ka juridiksion të plotë". Këto përfshijnë kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështje ligjore dhe faktike, vendimet e organit më poshtë. (Shih Schmautzer kundër Austrisë, cituar më lart, paragrafi 36*; Gradinger kundër Austrisë,* cituar më lart, paragrafi 44*;* dhe *Terra Woningen B.V. kundër Holandës,* cekur më lart, paragrafi 52*).*

66. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se heqja e formave të caktuara të sjelljes nga kategoria e veprave penale sipas ligjit kombëtar dhe delegimi i gjykimit të të njëjtave te një autoritet administrativ, nuk është në vetvete në kundërshtim me KEDNJ-në dhe mund të shërbejnë për një qëllim më të gjerë të administrimit të duhur të drejtësisë, ndër të tjera. Megjithatë, ky qëndrim zbatohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, për sa kohë që vendimet e autoriteteve të tilla administrative i nënshtrohen kontrollit të mëvonshëm nga një *"organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë"*.

67. Gjykata më tej do t'i adresojë dy pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës. E para që lidhet me çështjen nëse *"personat e akuzuar për kundërvajtje kanë të drejtë për një gjykim të drejtë para një tribunali të pavarur",* me fjalë të tjera, çështjen e zbatueshmërisë së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për personat e akuzuar për kryerjen e kundërvajtjeve. Ndërsa e dyta, çështjen që lidhet me pyetjen *"nëse Ligji [i kontestuar], u garanton personave të akuzuar për kundërvajtje të drejtën për tribunal të pavarur",* rrjedhimisht, çështjen e përputhshmërisë me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ.

Çështja e zbatueshmërisë

Lidhur me atë nëse e drejta për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur vlen edhe për personat e akuzuar për kundërvajtje

68. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës argumenton se *"[...] edhe kur kundërvajtjet nuk klasifikohen si "vepra penale" brenda sistemit ligjor kombëtar, ato mund të quhen "vepra penale" në kontekstin e Konventës [...]"*.

69. Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me kriteret për të përcaktuar nëse një vepër kualifikohet si "penale" për qëllimet e nenit 6 të KEDNJ-së. Çështjet që duhet të konstatohen në këtë drejtim janë: (a) nëse teksti i cili përcakton veprën penale sipas ligjit kombëtar i përket ligjit penal; (b) natyrën e veprës penale; dhe, në fund, (c) natyrën dhe shkallën e ashpërsisë së dënimit që do të zbatohet. (Shih, *mutatis mutandis, Özturk kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 50; *Schmautzer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 27; dhe *Lauko kundër Sllovakisë*, cekur më lart, paragrafi 56).

70. Kriteret e mësipërme janë alternative dhe jo kumulative. Që neni 6 i KEDNJ-së të zbatohet për "akuza penale", mjafton që vepra në fjalë, sipas natyrës së saj, të jetë "penale" nga pikë vështrimi i KEDNJ-së, ose duhet ta ketë bërë personin në fjalë përgjegjës për një sanksion i cili, sipas natyrës dhe shkallës së ashpërsisë, i përket në përgjithësi sferës "penale". (Shih, *mutatis mutandis, Özturk kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 53; *Lauko kundër Sllovakisë*, cekur më lart, paragrafi 57).

71. Gjykata vëren se neni 2 i Ligjit të kontestuar përcakton se kundërvajtjet janë ato vepra që kanë të bëjnë me sjelljen e cila cenon apo rrezikon rendin dhe qetësinë publike, si dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutë, mbrojtja e të cilave është e pamundur pa përfshirjen e kundërvajtjeve. Po ashtu, thuhet se sanksioni për kundërvajtje mund të përcaktohet vetëm me ligj.

72. Prandaj, kundërvajtjet siç janë definuar në Ligjin e kontestuar i drejtohen të gjithë qytetarëve dhe jo një grupi të caktuar që ka një status të posaçëm. Përveç kësaj, ato kanë një karakter ndëshkues, i cili është një veçori e zakonshme dalluese e dënimeve penale.

73. Si përmbledhje, karakteri i përgjithshëm i veprave penale të rregulluara me Ligjin e kontestuar, së bashku me qëllimin parandalues dhe ndëshkues të dënimeve të shqiptuara për kundërvajtje, mjaftojnë për të treguar se veprat në fjalë, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, janë penale për nga natyra. (shih, *mutatis mutandis, Lauko kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 58).

74. Prandaj, Gjykata konkludon se kundërvajtjet janë "penale" për nga natyra dhe kualifikohen si "akuza penale" për qëllimet e nenit 6 të KEDNJ-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës.

Çështja e përputhshmërisë

Lidhur me atë nëse Ligji i kontestuar u ofron të drejtën për gjykim të drejtë para një gjykate të pavarur personave të akuzuar për kundërvajtje

75. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës argumenton se "*Në mënyrë që të quhet "tribunal i pavarur", një organ duhet të përmbushë disa kritere. Dy kriteret më relevante për vlerësimin e Ligjit për Kundërvajtje janë: (a) që organi të jetë i pavarur prej ekzekutivit dhe (b) që ai të ketë juridiksionin e plotë [...].*"

76. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit pretendon se qoftë OK , qoftë organi gjyqësor që merret me kundërvajtje duhet të jetë në përputhje me kriteret për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, siç përcaktohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi, duke rikujtuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, pohon se *"mungesa e pavarësisë së një organi administrativ mund të tolerohet, nëse vendimet e atij organi "i nënshtrohen kontrollit të mëtejshëm nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë"*.

77. Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës theksohet se vendimet e marra nga autoritetet administrative të cilat nuk i përmbushin vetë kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së, duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues nga një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë", duke përfshirë edhe kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështjet e faktit dhe ligjit, vendimet e autoriteteve administrative. (Shih, ndër të tjera dhe *mutatis mutandis*, vendimet e mëposhtme të GJEDNJ-së: *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës* i 10 shkurtit 1983, cituar më sipër, paragrafi 29; *Schmautzer kundër Austrisë*, i cekur më lart, paragrafi 3, paragrafi 52; dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 26 prillit 1995, *Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 16922/90, paragrafi 28).

78. Rrjedhimisht, çështja nëse OK-të përmbushin kriteret për një gjykatë të pavarur sipas nenit 6 të KEDNJ-së bëhet dytësore, në rast se Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Departamenti për Çështje Administrative) përmbush plotësisht kriteret për një proces të rregullt gjyqësor para një gjykate të pavarur dhe të paanshme lidhur me një akuzë penale.

79. Për këtë arsye, Gjykata së pari do të vlerësojë nëse shqyrtimi gjyqësor nga Departamenti për Çështje Administrative siç parashihet me Ligjin e kontestuar ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar rastet e kundërvajtjeve dhe nëse kjo është në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

A ka juridiksion të plotë Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës për të shqyrtuar vendimet e OK-ve

80. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka cekur që Departamenti për Çështje Administrative nuk ka mundësi që të shqyrtojë të gjitha çështjet e fakteve dhe të ligjit që janë relevante për kontestin para tij. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Departamenti për Çështje Administrative nuk ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar rastet e kundërvajtjes, dhe prandaj, nuk i plotëson kriteret e një gjykate të pavarur siç parashihet në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

81. Gjykata gjithashtu rikujton që GJEDNJ ka deklaruar se në mënyrë që një "tribunal" të përmbushë kërkesat e nenit 6, paragrafit 1, të KEDNJ-së, kërkohet që "tribunali" në fjalë të ketë juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e fakteve dhe të ligjit përkatës për kontestin para tij. (shih, *mutatis mutandis, Schmautzer kundër Austrisë*, cekur më lart, paragrafi 35 dhe *Terra Woningen B.V. kundër Holandës*, cekur më lart, paragrafi 52).

82. Gjykata në fjalë duhet të ketë kompetencën për të anuluar në të gjitha aspektet - lidhur me çështjet e faktit dhe të ligjit, vendimin e organit të shkallës më të ulët. (*Schmautzer kundër Austrisë*, cekur më lart, paragrafi 36).

83. Më tej, Gjykata do të shqyrtojë nëse Departamenti për Çështje Administrative i plotëson këto kritere.

84. Gjykata së pari vëren se, Kapitulli X (Kompetenca dhe përjashtimi), neni 55 (Kompetenca lëndore dhe përbërja e Gjykatës), paragrafi 5 dhe neni 58 (Vendimi); Kapitulli XII (Mbrojtja Gjyqësore), neni 64 (E drejta në zhvillimin e konfliktit administrativ); dhe neni 66 (Arsyet për paraqitjen e padisë), të Ligjit të kontestuar, rregullojnë të drejtat e mbrojtjes gjyqësore të personave të akuzuar për kundërvajtje.

85. Gjykata i referohet nenit 55 (Kompetenca lëndore dhe përbërja e Gjykatës) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton:
"[...]

> *4. Për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike [...] të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje.*
>
> *5. Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje të nxjerrë nga organet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni garantohet mbrojtje gjyqësore".*

86. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 66 (Arsyet për paraqitjen e padisë) të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton:

> *"1. Vendimi i organit kundërvajtës mund të kontestohet me padi:*
>
> *1.1. nëse me vendim ka qenë shkelur dispozita materiale e ligjit, me të cilën është paraparë kundërvajtja;*
>
> *1.2. nëse janë shkelur dispozitat e procedurës, sepse nuk ka vendosur organi kompetent ose nëse vendimi nuk i ka të gjitha elementet përbërëse të parapara;*
>
> *1.3. për shkak të përcaktimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me ç'rast në padi nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja, nëse paditësi gjen se me siguri pa fajin e tij nuk ka qenë e mundshme që t'i propozojë në procedurë, dhe;*
>
> *1.4. për shkak të sanksioneve të shqiptuara, konfiskimit të sendeve dhe shpenzimeve të procedurës".*

87. Rrjedhimisht, vendimi i Organeve të Kundërvajtes mund të kontestohet në Departamentin për Çështje Administrative me anë të një ankese: (*i*) për shkelje të dispozitave materiale; (*ii*) për shkelje të dispozitave procedurale; (*iii*) për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në të cilën nuk pranohen fakte të reja, përveç nëse paditësi, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i propozojë ato në procedurën administrative; dhe (*iv*) për shkak të sanksioneve të vendosura, aseteve të konfiskuara dhe shpenzimeve të procedurës.

88. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 64 (E drejta në zhvillimin e konfliktit administrativ), paragrafët 1 dhe 4, të Ligjit të kontestuar, i cili përcakton:

> *"1. Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje, të cilën e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes, mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ.*
>
> [...]
>
> *"4. Gjykata kompetente që të vendosë për konfliktet administrative procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative."*

89. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 46, paragrafët 2, 3 dhe 4, të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcakton se:

> "*[...]*
>
> *2. Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar.*
>
> *3. Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar.*
>
> *4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.*
>
> *[...]."*

90. Gjykata rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ankesat e ngritura kundër vendimeve të Organeve të Kundërvajtjes nuk mund të deklarojnë fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja te Departamenti për Çështje Administrative, duke parandaluar këtë të fundit të shqyrtojë të gjitha çështjet e fakteve dhe ligjit që lidhen me kontestin para tij.

91. Megjithatë, Gjykata thekson përsëri se neni 66, paragrafi 1.3, i Ligjit të kontestuar u mundëson palëve që të kontestojnë vendimet e OK-ve, *inter alia*, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

92. Sa i përket mundësisë për të paraqitur fakte të reja, Gjykata rikujton që neni 66, paragrafi 1.3, i Ligjit të kontestuar mundëson që faktet e reja të paraqiten para Departamentit për Çështje Administrative, edhe pse, pala duhet të arsyetojë që faktet e reja nuk kanë mundur t'i paraqes para OK-ve, pa fajin e tij/saj.

93. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu vë në dukje se neni 38 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton që Gjykata vërteton gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal. Paragrafi 5, i nenit 38 specifikon se gjykata mund të vendosë çështjen pa shqyrtim verbal, vetëm kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar dhe nëse gjykata posedon fakte të mjaftueshme.

94. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata konstaton se Ligji i kontestuar, konkretisht nenet 64 dhe 66 të Ligjit të kontestuar, në lidhje me nenet 38 dhe 46 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, i lejon Departamentit për Çështje Administrative të shqyrtojë vendimet e Organeve të Kundërvajtjes për shkelje të ligjit, shkelje të procedurës si dhe çështje të faktit, duke përfshirë edhe faktet e reja, me kusht që pala që i ka paraqitur ato nuk ka mundur që t'i paraqesë ato fillimisht para Organeve të Kundërvajtes.

95. Si rezultat, Departamenti për Çështje Administrative ka autoritet të bëjë shqyrtimin e plotë gjyqësor të vendimeve të OK-ve në çdo aspekt, dhe kjo përfshin çështjet e shkeljes së dispozitave materiale; dispozitave procedurale; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve; dhe vendosjes së sanksioneve, aseteve të konfiskuara dhe shpenzimeve të procedurës.

96. Përfundimisht, në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Departamenti për Çështje Administrative mund ta anulojë aktin e kontestuar, ta miratojë atë, ose mund ta zëvendësojë aktin e kontestuar me vendimin e vet.

97. Prandaj, Gjykata konkludon se Departamenti për Çështje Administrative ka juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që lidhen me kontestin para tij dhe të anulojë vendimin e Organeve të Kundërvajtes në të gjitha aspektet, në çështjet e faktit dhe ligjit. Prandaj, Departamenti për Çështje Administrative, kualifikohet si një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë", që i përmbushë kërkesat për t'u konsideruar si "gjykatë e pavarur dhe e paanshme" në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.

Nëse Organet e Kundërvajtes i përmbushin kriteret e një 'gjykate të pavarur'

98. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se OK-të nuk përmbushin kriteret e një gjykate të pavarur duke argumentuar se *"organet e kundërvajtjes jo vetëm që nuk janë të pavarura nga ekzekutivi, por janë vetë pjesë e ekzekutivit"*.

99. Gjykata vëren se e drejta për një gjykim të drejtë, në kuadër të së cilës e drejta e shqyrtimit nga një gjykatë të pavarur është komponentë thelbësore, mban vend

vendimtarë në një shoqëri demokratike. (Shih *Lauko kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 63).

100. Për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet i "pavarur" nga ekzekutivi, është e nevojshme të merret parasysh mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, kohëzgjatja e mandatit të tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme si dhe çështja nëse organi në dukje paraqitet si i pavarur . (shih *Lauko kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 janarit 2012, *Pohoska kundër Polonisë*, Aplikimi nr. 33530/06, paragrafi 34).

101. Megjithatë, Gjykata gjithashtu rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, ku theksohet se vendimet e marra nga autoritetet administrative të cilat vetë nuk i përmbushin kërkesat e nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues nga një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë. (Shih *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe *Gradinger kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 42).

102. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e pranon këtë fakt, siç dëshmohet nga deklarata në kërkesën e tij, *"Sipas precedentëve të GjEDNj-së, mungesa e pavarësisë së një organi administrativ mund të tolerohet, nëse vendimet e atij organi "i nënshtrohen kontrollit të mëtejshëm nga një organ gjyqësor që ka jurisdiksion të plotë"*.

103. Gjykata tashmë ka konkluduar se Departamenti për Çështje Administrative kualifikohet si një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë", duke përmbushur kërkesat për t'u konsideruar si "gjykatë e pavarur dhe e paanshme" brenda kuptimit të nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës.

104. Prandaj, duke marrë parasysh se vendimet e Organeve të Kundërvajtjes i nënshtrohen shqyrtimit të plotë gjyqësorë të Departamentit për Çështje Administrative, dhe konstatimit të Gjykatës se Departamenti për Çështje Administrative plotëson kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata nuk e sheh të nevojshme që të vlerësojë nëse vet Organeve të Kundërvajtjes i përmbushin kriteret e një tribunali të pavarur për qëllimet e nenit 6 (1) të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.

Përfundim

105. Duke marrë parasysh dhe duke iu referuar arsyeve të cekura më lart, Gjykata konkludon se:

1. Kundërvajtjet janë "penale" për nga natyra dhe cilësohen si "akuza penale" në kuptimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Prandaj, çdo person i akuzuar për kundërvajtje ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

2. Departamenti për Çështje Administrative cilësohet si një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë" dhe përmbush kërkesat për t'u konsideruar si "një gjykatë e pavarur dhe e paanshme" në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

3. Në bazë të pikës 2 të cekur më lart, Gjykata ka konstatuar se dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar janë në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe se, për këtë arsye, nuk e konsideron të

nevojshme të përcaktojë nëse vetë Organet e Kundërvatjes i plotësojnë kërkesat e një gjykate të pavarur dhe të paanshme për qëllime të të njëjtave nene.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (2) të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe me rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, më 9 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, dhe 68 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, janë në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

III. TË KONSTATOJË se Vendimi i Gjykatës për vazhdimin e masës së përkohshme të 5 prillit 2017, Ref. VMP 1054/17, me të cilin u vazhdua pezullimi i zbatimit të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje, deri më 15 qershor 2017, përfundon me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesit të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministrit të Kosovës, Ministrit të Drejtësisë dhe Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

V. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani Arta Rama-Hajrizi

KO126/16, Gjykata referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën

KO126/17, Aktvendim për papranueshmëri i 27 marsit 2017, i publikuar më 1 qershor 2017.

Fjalët kyçe: *kërkesë institucionale, procedurë e kontrollit konkret-incidental të ligjit, gjykata referuese, Ligji për Trepçën, vlerësim i kushtetutshmërisë së ligjit, e drejta krahasuese, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, kërkesa ishte dorëzuar nga gjyqtari individual i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Gjykata Kushtetuese ia njohu atij gjyqtari legjitimitetin për të dorëzuar kërkesë të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën, duke iu referuar si "gjykatë referuese".

Gjykata referuese, në thelb, pretendonte se Ligji për Trepçën e kishte shndërruar Kombinatin Metalurgjik Trepça në shoqëri aksionare që cenonte të drejtat e kreditorëve që kishin pretendime pronësore. Gjykata Kushtetuese duke iu referuar dispozitave gjegjëse kushtetuese, dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në raste të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të drejtës ndërkombëtare krahasuese erdhi në përfundim se gjykata referuese ishte palë e autorizuar për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese, po ashtu erdhi në përfundim, se Ligji për Trepçën nuk rregullon vetë zgjidhjen e mos marrëveshjeve në lidhje me pretendimet e kreditoreve ndaj Trepçës. Përveç kësaj, Ligji për Trepçën përcakton shprehimisht, në nenin 15, se janë dy ligje të tjera që zbatohen drejtpërdrejt ndaj të gjitha pretendimeve kreditore, përkatësisht Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike. Rrjedhimisht, kërkesa e gjykatës referuese u shpall e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO126/16

Gjykata referuese

Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Gjykata referuese

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: gjykata referuese). Është nënshkruar nga z. Werner K. Kannenberg, gjyqtar në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Trepçën), i cili është miratuar më 8 tetor 2016, është shpallur më 31 tetor 2016 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 36 të 31 tetorit 2016.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 75 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 1 nëntor 2016, gjykata referuese parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

5. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

6. Më 4 nëntor 2016, Gjykata njoftoi Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria) dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

7. Më 10 nëntor 2016, V. H., avokat nga Prishtina, parashtroi në Gjykatë parashtresën *amicus curiae* të paraqitur pa ftesë nga ana e Gjykatës. Parashtresa në fjalë nuk është marrë parasysh sepse nuk ishte kërkuar nga Gjykata.

8. Më 10 nëntor 2016, Gjykata njoftoi gjykatën referuese se procedurat që kanë të bëjnë me rastin KO126/16, që janë duke u kryer në gjykatën referuese, janë pezulluar deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim për këtë rast.

9. Më 17 nëntor 2016, Qeveria i dërgoi komentet e saj në Gjykatë.

10. Më 21 nëntor 2016, AKP-ja i dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.

11. Më 1 dhjetor 2016, Gjykata i dërgoi gjykatës referuese komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe nga AKP-ja. Njëkohësisht, Gjykata kërkoi nga gjykata referuese që ta njoftojë Gjykatën nëse është nxjerrë dhe si është nxjerrë vendimi për të referuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën.

12. Më 6 dhjetor 2016, gjykata referuese, nëpërmjet një memorandumi paraqiti përgjigje në pyetjen e Gjykatës dhe komentet e Qeverisë dhe të AKP-së.

13. Më 27 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 23 janar 2014, minatori B. B. paraqiti në Gjykatën Themelore në Mitrovicë padi kundër Ndërmarrjes Shoqërore Trepça (në tekstin e mëtejmë: NSH Trepça) për kompensim të dëmit për lëndim të pësuar në punë.

15. Më 25 shtator 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë e shpalli veten jokompetente për të gjykuar këtë rast dhe, më 26 shtator 2014, ia dërgoi çështjen Dhomës së Posaçme në kompetencë lëndore dhe territoriale.

16. Më 23 shkurt 2016, Kolegji i Specializuar ia delegoi rastin C-II-14-0114 gjyqtarit Werner K. Kannenberg për të vendosur si gjyqtar i vetëm në këtë rast.

17. Gjyqtari Werner K. Kannenberg nënshkroi kërkesën e dorëzuar në Gjykatë si një gjyqtar i vetëm në rast.

Pretendimet e gjykatës referuese

18. Thelbi i argumentit të gjykatës referuese për jokushtetutshmërinë e Ligjit për Trepçën ka të bëjë me efektet negative të Ligjit për të drejtat e kreditorëve, të cilët kishin padi kundër NSH Trepça para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë edhe paditësin në rastin konkret.

19. Gjykata referuese thekson se Ligji për Trepçën "*ka krijuar një shoqëri aksionare nga një pjesë e mëparshme e NSH (Trepça). Kjo nuk e ndikon juridikisht statusin e NSH-së*".

20. Gjykata referuese më tej argumenton se "*derisa asetet jothelbësore dhe jofitimprurëse duhet të mbesin nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (neni 14 paragrafi 1), ligji i bart asetet e vlefshme thelbësore të NSH-së tek shoqëria aksionare (neni 6, paragrafi 3, i cituar në lidhje me nenin 2, paragrafi 2). Mbi të gjitha, ndërmarrja Trepça i humbë të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operacionale, sepse të gjitha këto janë bartur të shoqëria e sapo krijuar*".

21. Gjykata referuese deklaron se padia në rastin në fjalë, që është në shqyrtim para Kolegjit të specializuar, *"ndërlidhet me njësinë biznesore të minierës Kishnicë dhe Artanë (të cekura në nenin 2 paragrafi 2, nënparagrafi 2), e që për këtë arsye vlefshmëria e Ligjit është relevante për rezultatin e lëndës si për trashëgiminë/identitetin ligjor të së padituresë ashtu edhe* për *pyetjen nëse paditësi sipas ligjit është objekt i eksproprijimit jokushtetues pa kompensim"*.

22. Në lidhje me atë rast, gjykata referuese deklaron se "*duke u bazuar në rezultatet e deritashme në shqyrtimin e rastit, sipas vlerësimeve paraprake të Gjykatës, ka shumë të ngjarë që padia do rezultoi të paktën pjesërisht e suksesshme"*.

23. Gjykata referuese më tej argumenton se "*nëse realizohet ndarja e aseteve që shkojnë te shoqëria aksionare ndërsa detyrimet t'i mbesin NSH Trepça, kjo do të ketë edhe implikime të rënda ligjore. Për shkak se është e qartë se transferimi i pronës i kryer sipas ligjit ndikon rëndë në vlerën e çfarëdo padie ndaj NSH-së, faktikisht duke e ulur atë në vlerën zero për kërkesëpaditë e pasiguruara siç është një e tillë e paditësit...prandaj, për shkak të ndikimit mbi të gjithë kreditorët, në kuptim të asaj se i ndanë asetet nga detyrimet, ligji duket të jetë jokushtetues, shkelë garancitë kushtetuese për mbrojtjen e pronës kundër eksproprijimit pa kompensim (neni 46 i Kushtetutës)*".

24. Për më tepër, sipas gjykatës referuese "*duke qenë se 20% e aseteve të marra nga NSH Trepça është kthyer në pronë private, kjo duhet të justifikohet përmes qëllimeve ose interesave publike. Në mungesë të justifikimit të tillë, gjykata konsideron se edhe mbi këtë bazë Ligji është jokushtetues"*.

25. Gjykata referuese nënvizon se "*Gjykata Kushtetuese veçse ka marrë vendim lidhur me Ligjin për Trepçën... si rrjedhojë e kërkesës së disa anëtarëve të Kuvendit [...] Ky vendim mbi papranueshmërinë i Gjykatës Kushtetuese nuk e parasheh të njëjtën çështje që është thelb i kërkesës në fjalë*".

26. Në fund, gjykata referuese thekson: *"Pasi që është prerogativë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese që zyrtarisht të anulojë legjislacionin e miratuar nga Kuvendi, Gjykata në pajtim me nenin 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, paraqet çështjen e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën përmes kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese"*.

Përgjigjja e Qeverisë

27. Qeveria e konsideron kërkesën e gjykatës referuese si të papranueshme, për shkak se e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese.

28. Pasi deklaron se rasti konkret është i njëjtë me rastin KO59/14, ku një gjyqtar parashtron kërkesë individualisht, Qeveria thekon se *"në bazë të dokumenteve në dispozicion shihet qartë se gjyqtari në fjalë nuk ka vendim nga kolegji apo kryetari i Gjykatës Supreme, pjesë e të cilit është Dhoma e Posaçme, për dërgimin ë një kërkese të tillë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo procedurë qartë përcaktohet nga neni 113.8 i*

Kushtetutës, ashtu siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese në rastet e vendosura si më sipër".

29. Më tej, Qeveria i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI25/10, ku *"Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk mund të gjykojë ose veprojë kundër misionit primar të Gjykatës Supreme, pjesë e së cilës është vetë Dhoma e Posaçme".* Qeveria thekson se *"[...] konstatimi i gjyqtarit referues se nëse paditë kreditore ndaj NSH Trepça do të pranoheshin si të bazuara në meritë, ndërmarrja e tillë nuk do të ishte likuide për t'i përmbushur ato [...] shkon përtej juridiksionit të tij material sepse ai thjeshtë nuk mund ta supozojë madhësinë e kompensimit që mund të rezultojë nga paditë të cilat akoma nuk i janë nënshtruar shqyrtimit meritor dhe të cilat, për aq kohë sa nuk shqyrtohen në meritë, kanë thjeshtë statusin e pretendimeve kreditore".*

30. Më tej, Qeveria argumenton se *"gjyqtari referues nuk provon në asnjë mënyrë nevojën e zgjidhjes së një kontesti kushtetues si parakusht që ai të procedojë me zgjidhjen e rastit të tij individual [...] Baza juridiksionale materiale për zgjidhjen e rastit të tillë është Ligji për AKP-në dhe Ligji për Trepçën nuk e cenon në asnjë rrethanë të drejtën e pretenduesve kreditorë për të realizuar të drejtat e tyre në relacion me NSH Trepça dhe AKP-në".*

31. Për më tepër, Qeveria deklaron se *"[...] pretendentët kreditorë të NSH Trepça janë të mbrojtur edhe me parimin e përgjegjësisë jokontraktore të shtetit, që është parim themelor i së drejtës [...]. Megjithatë, një kompensim i tillë do të realizohej vetëm pasi që kreditorët e mundshëm të fitojnë të drejtën e kompensimit përmes një vendimi përfundimtar të Gjykatës, aplikimi i të cilave nuk mund të bëhet për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve të NSH Trepça dhe AKP-së".*

32. Qeveria në vazhdim thekson se *"që t'i lejosh gjyqësorit që në mënyrë hipotetike [...] të konsiderojë një ligj kundërkushtetues përbën shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve, ndërhyrje të gjyqësorit në autoritetin e pushtetit legjislativ për të nxjerrë ligje me karakter të përgjithshëm".*

33. Qeveria kërkon nga Gjykata që *"[...] të konstatohet se parashtruesi, gjyqtari individual z. Werner K. Kannenberg, nuk është palë e autorizuar por nuk është as brenda juridiksionit të tij ratione materiae për të parashtruar një kërkesë të tillë ashtu që kjo kërkesë duhet të hidhet poshtë si e papranueshme".*

34. Në fund, Qeveria deklaron se *"në rast se Gjykata Kushtetuese gjen që kërkesa e lartpërmendur* është *e pranueshme, atëherë propozimi i Qeverisë është që kërkesa të refuzohet mbi dy baza: **e para**, si një kërkesë për një çështje res judicata (rasti KO118/16); dhe, **e dyta**, se kërkesa ka ngritur një çështje hipotetike duke prejudikuar sjelljen e shtetit të Kosovës në të ardhmen lidhur me të drejtën për pronë në të gjitha rastet e tjera kontestuese që lidhen me zbatimin e Ligjit për Trepçën, edhe pse akoma nuk ka vendim të organeve gjyqësore kosovare që bazohen në zbatimin e Ligjit për Trepçën dhe interpretimin e tij gjyqësor në rastet konkrete".*

Përgjigjja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

35. AKP-ja njoftoi Gjykatën se "*e paditura në tërësi e kishte kompensuar paditësin sipas marrëveshjes/ujdisë jashtë gjyqësore e cila ishte arritur në mes të palëve më 25 prill 2014, respektivisht 19 shkurt 2015".*

36. AKP-ja më tutje sqaron se *"paditësi B. B. nuk e kishte tërhequr padinë përkundër faktit se ai kishte nënshkruar marrëveshjen dhe kishte pranuar kompensimin për lëndimin në punë, dëmin material dhe atë jomaterial".*

37. Në vazhdim, AKP-ja deklaron se "*Neni 15 i Ligjit për Trepçën ka përcaktuar se pretendimet kreditore* ndaj *Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Ligjit nr. 04/L-035, për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit [...]. Paragrafi 3 i këtij ligji thekson se 'prej hyrjes në fuqi të këtij ligjit të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça do të trajtohen në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike".*

38. AKP-ja më tutje thekson se *"paditësi B. B. nuk ka paraqitur kërkesë kreditore në AKP. Paditësi ka pretendime të caktuara monetare të cilat janë objekt i një procesi gjyqësor të papërfunduar me vendim meritor. Këto pretendime janë të adresuara kundër një entiteti (Miniera dhe Flotacioni Kishnicë dhe Artanë) i cili nuk është shuar as likuiduar por ka shënuar transformim juridik".*

39. AKP-ja konsideron se *"transformimi i këtyre njësive është transformim i ligjshëm dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Transformimi në SH.A. i disa njësive është në interes të ndërmarrjes dhe punëtorëve".*

Përgjigjet dhe komentet shtesë të gjykatës referuese

40. Në pyetjen e Gjykatës nëse është nxjerrë dhe si është nxjerrë vendimi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për të referuar kërkesën, gjykata referuese u përgjigj se *"kërkesa në fjalë është nënshkruar nga gjyqtari i vetëm i poshtëshënuar, në përbërjen e duhur për të shqyrtuar lëndën C-II-14-0114, pra, 'Gjykata' në këtë rast".*

41. Gjykata referuese argumenton se çdo përbërje e gjykatës (së rregullt), që ka kompetencë për të vendosur për rastin, mund të paraqesë kërkesë për kontroll incidental në Gjykatën Kushtetuese. Në ndërlidhje me këtë, ajo thekson se "*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është pjesë e Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, përbërjet e Dhomës së Posaçme janë përbërje të Gjykatës Supreme. Siç është rasti në çdo vend tjetër, çdo vendim i marrë nga përbërja e paraparë me ligj është vendim i "Gjykatës" dhe për këtë arsye ka dispozita ligjore lidhur me përbërjen e Gjykatës".*

42. Më tutje, gjykata referuese konsideron se *"[...] parashtrimi i kërkesave në Gjykatën Kushtetuese dhe shkëmbimet pasuese të memorandumeve nuk janë veprime administrative. Një gjë e tillë është pjesë e funksionit gjyqësor të gjykatës e cila e bën kërkesën. Prandaj vlejnë të gjitha dispozitat dhe garancitë në procedurën gjyqësore: vetëm gjykata kompetente mund të vendosë, nuk mund të lejohen ndërhyrjet e brendshme apo të jashtme nga personat të cilët nuk janë gjyqtari(ët) përgjegjës për lëndën".*

43. Gjykata referuese deklaron se "*nëse Gjykata Kushtetuese do të jetë e prirur që ta konsiderojë të papranueshëm referimin e tërë ligjit [...] Gjykata kërkon anulimin e dispozitave që marrin asetet e NSH Trepça...*". Në mënyrë të veçantë, ajo kërkon anulimin e dispozitave në vijim: nenin 2 (2) dhe nenin 6 (3); nenin 5 (2) (3) (4) (5).

44. Gjykata referuese thekson se *"kur një person është pronar i një padie, por me anë të ndërhyrjeve ligjore, vlera e padisë së tij bëhet ekuivalente me zero, ai kthehet në pronar të një "nudum ius", e drejta e cila ekziston formalisht dhe pa asnjë vlerë. Pasi që vlera e një padie monetare është ajo që lejon gëzimin e një të drejte, kjo është e mbrojtur me anë të KEDNJ-së sipas Nenit 1 protokollit 1 dhe nenit 14 të KEDNJ-së".*

45. Në fund, gjykata referuese *"[...] fton Gjykatën Kushtetuese që, në interes të paditësit në këtë lëndë, por edhe më në përgjithësi në interes të shoqërisë si tërësi, që t'ia demonstrojë publikut se drejtësia në Kosovë vepron në mënyrë të pavarur dhe mbizotëron mbi autoritetin* [politik], *që ta adresojë padrejtësinë, me qëndrim të*

vendosur për sa i përket vlerës së kushtetutës ndaj legjislativit dhe politikës në Kosovë. Prandaj kjo Gjykatë sugjeron që kërkesa të konsiderohet se është e pranueshme dhe të urdhërojë kompensimin e përshtatshëm".

Dispozitat përkatëse ligjore dhe kushtetuese

Dispozitat përkatëse kushtetuese:

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.

2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 9 [Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm]

1. Çdo kolegj i specializuar i Dhomës së Posaçme mund të lëshojë urdhër për t'ia deleguar njërit prej anëtarëve të tij, apo një nën-kolegji që përbëhet nga dy anëtarë të tij, përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast që është juridiksion i fushës së tij. Aktgjykimet dhe aktvendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm apo nën-kolegji të tillë do të konsiderohet të jetë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë.

Dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën

Neni 2 [Fushëveprimi]

1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë transformimin e njësive biznesore të listuara në paragrafin 2. të këtij neni në Shoqërinë Aksionare Trepça Sh.A.

2. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A. janë:

2.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89);

2.2. Minierat me FlotacionKishnicë dhe Artanë (Fi 349/88);
2.3. Minierat me FlotacionKopaonik - Leposaviç (Fi 804/89).

Neni 5 [Resurset Minerale, bartja e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore]

2. Trepça Sh.A. hulumton dhe shfrytëzon resurset minerale në bazë të licencës për hulumtim dhe shfrytëzim të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

3. Të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operuese të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça kalojnë në Trepça Sh.A.

4. Të gjithë punëtorët të cilët kanë kontratë të rregullt pune në njësinë biznesore të definuar me këtë ligj, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë marrëdhënien e punës në njësinë përkatëse biznesore.

5. Trepça Sh.A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit.

Neni 6 [Statuti]

3. Asetet e Trepça Sh.A. përbëhen nga asetet e njësive biznesore të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit dhe me metodat standarde të vlerësimit.

Neni 14

1. Asetet e tjera të ndërmarrjes shoqërore "Trepça", të cilat nuk transformohen me këtë ligj në Trepça Sh.A., do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Asetet jothelbësore dhe joprofitabile do të mbeten në menaxhim të AKP-së për t'iu nënshtruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me ligjin.

KAPITULLI VIII PRETENDIMET E KREDITORËVE

Neni 15

1. Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/-L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

3. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça SH.A. do të trajtohen në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike.

E drejta krahasuese

46. Gjykata vëren se një numër i madh i shteteve evropiane parasheh të ashtuquajturën "procedurë paraprake të vendosjes", nëpërmjet të cilës një gjykatë e rregullt e ngrit çështjen e kushtetutshmërisë së aktit të legjislacionit në Gjykatën Kushtetuese, kur ka

dyshime nëse dispozitat specifike të një akti legjislativ që duhet zbatuar në një rast konkret gjyqësor janë apo jo në përputhje me Kushtetutën. Kjo procedurë emërtohet në mënyra të ndryshme, ndërsa në terminologjinë e drejtësisë kushtetuese në Kosovë njihet si "kontroll kushtetues incidental".

47. Nga analiza krahasimtare mund të shihet se gjykatat e rregullta të shumicës së shteteve evropiane janë të autorizuara të parashtrojnë kërkesë në gjykata kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave specifike ligjore (në disa vende edhe të akteve të tjera), të cilat duhet të zbatohen drejtpërdrejt në një rast gjyqësor konkret. Një autorizim i tillë ekziston në Shqipëri, në Armeni, në Belgjikë, në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kroaci, në Republikën Çeke, në Hungari, në Itali, në Maqedoni, në Rumani, në Slloveni, në Spanjë, në Turqi. Në disa shtete, si: në Bullgari, në Greqi dhe në Letoni, vetëm gjykatat më të larta janë të autorizuara për inicimin e kontrollit incidental në gjykatat kushtetuese.

48. Analiza krahasuese vë në pah këto elemente të përbashkëta të kontrollit kushtetues incidental: Së pari, duhet të ekzistojë një rast konkret në shqyrtim pranë gjykatave të rregullta; së dyti, duhet të ekzistojë një dyshim i arsyetuar se dispozita përkatëse ligjore që duhet zbatuar drejtpërdrejt për zgjidhjen e rastit nga gjykata e rregullt mund të jenë në shpërputhje me Kushtetutën; dhe së treti, gjykatat e rregullta duhet të ndjekin një procedurë të caktuar për referimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

49. Gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë nëse janë plotësuar kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të parashikuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet fillimisht nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar,

(...)
8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".

51. Përveç kësaj, Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 51 [Saktësimi i kërkesës]

1. Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Neni 52 [Procedura para gjykatës]

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53 [Vendimi]

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

52. Gjykata i referohet edhe rregullave 75 dhe 76 të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

Rregulli 75 [Parashtrimi i kërkesës]

1. Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.

2. Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

3. Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

Rregulli 76 [Njoftimi]

Gjykata, pas parashtrimit të kërkesës, e urdhëron gjykatën që të pezullojë ndonjë procedurë që është duke u zhvilluar përkitazi me rastin në fjalë, derisa Gjykata të ketë lëshuar një vendim.

53. Gjykata vëren se, ndryshe nga shumë vende të tjera, në Republikën e Kosovës praktika e kërkesave për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së normave ligjore nga gjykatat e rregullta kufizohet në dy raste (përkatësisht, rasti KO04/11 dhe KO5/14).

54. Në rastin konkret, në mënyrë që t'i shqyrtojë kriteret e pranueshmërisë, Gjykata duhet që fillimisht të vlerësojë nëse gjykata referuese është e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.

55. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KO59/14, ajo ka përcaktuar se e drejta e gjykatave të rregullta për të referuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së normave juridike buron nga neni 113, paragrafi 8, i Kushtetutës. Megjithatë, në përputhje me këtë nen, "gjykata" është palë e autorizuar dhe jo *"gjyqtarët"* (shih rastin Gjykata Kushtetuese, KO59/14, Aktvendim i 14 korrikut 2014). Këtë qëndrim, Gjykata e arsyetoi duke u referuar në dallimin që e bën Kushtetuta dhe Ligji për gjykatat, ndërmjet "gjykatave" dhe "gjyqtarëve".

56. Megjithatë, Gjykata konsideron se rrethanat e rastit konkret dallojnë në thelb nga ato të rastit KO59/14. Kështu, në rastin KO59/14, kërkesa ishte referuar nga Kryetari i trupit gjykues (të Departamentit për Krime të Rënda), në një rast në të cilin gjykata duhej të gjykonte në trup gjykues. Për më tepër, në këtë rast, Kryetari i Gjykatës Themelore përkatëse, të cilës i përkiste gjyqtari, informoi Gjykatën Kushtetuese se brenda Gjykatës Themelore nuk ishte marrë asnjë vendim për të referuar rastin për kontroll incidental të kushtetutshmërisë.

57. Në rastin konkret, gjykata referuese e gjykon çështjen nëpërmjet një gjyqtari të vetëm, në pajtim me nenin 9 [Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm] të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton:

> *"1. Çdo kolegj i specializuar i Dhomës së Posaçme mund të lëshojë urdhër për t'ia deleguar njërit prej anëtarëve të tij, apo një nënkolegji që përbëhet nga dy anëtarë të tij, përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast që është juridiksion i fushës së tij. Aktgjykimet dhe aktvendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm apo nënkolegj i tillë do të konsiderohet të jetë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë".*

58. Gjykata rikujton se Kolegji i Specializuar ia ka deleguar rastin gjyqtarit Werner K. Kanenberg për ta vendosur si një gjyqtar i vetëm në atë rast. Prandaj, *"(...) vendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm (...) do të konsiderohen të jenë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë",* përkatësisht për qëllimet e nenit 113, paragrafi 8, të Kushtetutës i cili i autorizon "gjykatat" të referojnë çështjet e përputhshmërisë kushtetuese të një ligji në Gjykatën Kushtetuese.

59. Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, "gjykatë" është çdo gjyqtar ose kolegj gjyqtarësh që ka kompetencë të plotë për të gjykuar meritat e një rasti në pritje përpara saj.

60. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se kërkesa është dorëzuar nga "gjykata" në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës.

61. Më tutje, Gjykata rikujton nenin 51 të Ligjit, i cili parasheh:

> "*1. Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.*
>
> *2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën."*

62. Nga sa u tha më lart, rezulton se me qëllim që kërkesa e parashtruar sipas nenit 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, të jetë e pranueshme, ajo duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

> a) gjykata referuese duhet të ketë lëndën në shqyrtim e sipër;
> b) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër;
> c) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin mbi çështjen në pritje; dhe
> d) gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën.

63. Gjykata thekson se si kusht themelor, i përcaktuar shprehimisht edhe në Ligj dhe në Rregullore, për pranueshmëri të një kërkese për kontroll incidental të kushtetutshmërisë, është ekzistenca e të ashtuquajturit "element i lidhshmërisë" së drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave të ligjit të kontestuar dhe objektit të çështjes që është në gjykim para gjykatave të rregullta.

64. Gjykata konsideron se *"zbatimi i drejtpërdrejtë"* i normës konkrete nënkupton se nga zbatimi apo moszbatimi i drejtpërdrejtë i normës varet rezultati i vendimit nga ana e gjykatës referuese.

65. Gjykata vëren se ky interpretim mbështetet nga praktika gjyqësore e vendeve të tjera. Kështu, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë thekson elementin lidhës ndërmjet normës së kontestuar dhe rastit konkret duke arsyetuar se *"[...] nëse Gjykata do të shpallte jokushtetuese dispozitat e kontestuara do të refuzohej padia, ndërsa nëse shpallja e atyre dispozitave si kushtetuese do të rezultonte me aprovimin e padisë" (shih Vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë 2 BvL 12, 13 , 14, 15/56 i 6 nëntorit 1957).*

66. Në të njëjtën linjë, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë argumenton se *"parashtruesi i kërkesës duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërtën, nëse parashtruesi i kërkesës vlerëson se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes edhe pse sipas tij, është antikushtetues, duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes... (Shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë-Vendimi V-30/10 i 17 qershorit 2010 dhe Vendimi nr. 13, i 4 majit 2009)".*

67. Gjykata vëren se, në rastin në fjalë, procedura para gjykatës së rregullt (Kolegji i Specializuar) kishte filluar sipas *"padisë për kompensim dëmi"* për dëmet e shkaktuara në vendin e punës. Në anën tjetër, gjykata referuese thekson se *"padia në fjalë ndërlidhet me njësinë biznesore të minierës Kishnicë dhe Artanë (të cekura në nenin 2 paragrafi 2, nënparagrafi 2), e që për këtë arsye vlefshmëria e Ligjit është relevante për rezultatin e lëndës si për trashëgiminë/identitetin ligjore të së paditurës ashtu edhe për pyetjen nëse paditësi sipas ligjit është objekt i eksproprijimit jokushtetues pa kompensim".*

68. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit dhe shkresave të lëndës, Gjykata vëren se asnjë nga dispozitat e Ligjit për Trepçën nuk duhet të zbatohen drejtpërsëdrejti në procedurën e vendosjes së meritave të rastit para gjykatës referuese. Ligji për Trepçën nuk rregullon vetë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me pretendimet e kreditorëve ndaj Trepçës. Përveç kësaj, Ligji për Trepçën përcakton shprehimisht, në nenin 15, se janë dy ligje të tjera që zbatohen drejtpërdrejt ndaj të gjitha pretendimeve kreditore, përkatësisht Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike.

69. Gjykata vëren se i thelbi i kërkesës përfshihet në argumentin se Ligji për Trepçën e bën të pazbatueshëm pretendimin e kreditorit dhe, rrjedhimisht, hipotetik. Ky argument presupozon se hyrja në fuqi e Ligjit për Trepçën e bën joefektiv çfarëdo mjeti juridik, të cilin paditësi, në cilësinë kreditorit potencial, do të mund ta ndiqte, duke e bërë të paefektshme çdo mundësi për të pasur një trajtim adekuat gjyqësor të kërkesës së tij.

70. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykata referuese parashikon *a priori* rezultatin e procedurës gjyqësore, duke u shprehur: "*Duke u bazuar në rezultatet e deritashme në shqyrtimin e rastit, sipas vlerësimeve paraprake të gjykatës, ka shumë të ngjarë që padia do rezultojë të paktën pjesërisht e suksesshme".*

71. Gjykata thekson se nuk është brenda fushëveprimit të juridiksionit të saj të bëjë interpretim kushtetues të dispozitave përkatëse ligjore, duke u nisur nga parashikime hipotetike lidhur me mënyrën se si gjykatat e rregullta mund të bëjnë zbatimin e tyre në të ardhmen.

72. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, në thelb, gjykata referuese argumenton jokushtetutshmërinë e tërë Ligjit për Trepçën – jo vetëm të dispozitave përkatëse të tij

dhe e bën argumentin duke pretenduar se ky ligj cenon të drejtat e të gjithë kreditorëve potencialë ndaj NSH Trepça.

73. Rrjedhimisht, gjykata referuese nuk elaboron se cilat dispozita të Ligjit për Trepçën i konsideron në kundërshtim me Kushtetutën. Vetëm i përmend disa nga nenet e Ligjit për Trepçën, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre si zgjidhje alternative, përkatësisht vetëm "*nëse Gjykata do të jetë e prirur që ta konsideroj të papranueshëm referimin e tërë ligjit*".

74. Gjykata konsideron se vetëm referimi në disa nene të ligjit të kontestuar nuk nënkupton specifikimin e tyre, siç kërkohet me nenin 51 (2) të Ligjit. Rrjedhimisht, kjo nuk është në përputhje me kërkesën për arsyetim të pasigurisë përkitazi me pajtueshmërinë kushtetuese të neneve specifike të Ligjit.

75. Gjykata rikujton se, në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës, kontrolli incidental i kushtetutshmërisë është procedurë e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normave konkrete/dispozitave të specifikuara të ligjit dhe nuk është procedurë e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk ua njeh gjykatave të rregullta autorizimin për të referuar kërkesën e kontrollit abstrakt të akteve të legjislativit.

76. Përveç kësaj, Gjykata rikujton Aktvendimin e saj për papranueshmëri në rastin KO118/16, të 31 tetorit 2016, në të cilin Gjykata ka bërë vlerësimin *in abstracto* të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën.

77. Përfundimisht, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mbështet argumentimin se dispozitat e ligjit të kontestuar zbatohen drejtpërdrejt në procedurën që po zhvillohet para gjykatës referuese dhe nuk specifikon në mënyrë të mjaftueshme se cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën dhe përse janë në kundërshtim.

78. Prandaj, Gjykata konstaton se gjykata referuese nuk i ka mbështetur pretendimet e veta, prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 75 të Rregullores së punës, më 27 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues — **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bekim Sejdiu — Arta Rama-Hajrizi

KI137/16, Parashtruesi i kërkesës Agdi Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016, të 23 qershorit 2016

KI 137/16, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2017, i publikuar më 1 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa individuale, akuza penale, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor nga Gjykata Themelore në Gjilan (PKR 171/2014) për veprën penale të vrasjes siç parashihet me nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua nga Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 580/15). Përveç kësaj, kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë u refuzua nga Gjykata Supreme (Vendimi PPr. Kr. nr. 174/2016) si e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, në Gjykatën Kushtetuese, *inter alia,* se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk e kishte mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij. Prandaj, kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç përcaktohet më tej me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI137/16

Parashtrues

Agdi Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016, të 23 qershorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLLKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agdi Krasniqi nga Gjilani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ymer Huruglica, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Pml. nr. 118/2016), të 23 qershorit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan (PKR. nr. 171/2014), të 9 tetorit 2015 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (PAKR. nr. 580/2015), të 5 janarit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 118/2016 i është dorëzuar parashtruesit më 25 korrik 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi pretendon që i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 nëntor 2016, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të dorëzuar në postë, më 24 nëntor 2016.

7. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues, (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi dorëzimin në Gjykatë të autorizimit për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 6 janar 2017, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, duke përfshirë edhe autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës .

10. Më 25 janar 2017, përfaqësuesi parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 580/2016) të plotësuar me disa faqe që mungonin në kopjen e aktgjykimit të njëjtë të dorëzuar së bashku me kërkesë.

11. Më 5 prill 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 16 korrik 2012, në lagjen "Çamëria", rruga "Musli Ymeri" në Kamenicë, pas një kacafytje ndërmjet parashtruesit dhe G. D., mbetet i vdekur ky i fundit nga lëndimet e marra gjatë përleshjes.

13. Më 25 shtator 2012, Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, me Aktakuzën PP. nr. 167/2012, ka akuzuar parashtruesin për kryerjen e veprës penale nga neni 146 [Vrasje] të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

14. Më 7 shkurt 2014, Gjykata Themelore (P. nr. 187/2012) shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për *"veprën penale vrasje në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, nga neni 146 lidhur me nenin 8 paragrafi 3 të KPK"*.

15. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës parashtroi ankesë, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 187/2012) *"për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal"*.

16. Ankesa parashtruan edhe Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Prokurori i Prokurorisë Themelore) *"për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal",* si dhe

përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar *"për shkak të vendimit mbi sanksionin penal"*.

17. Më 1 korrik 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 262/2014) aprovoi ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore dhe mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, dhe sipas detyrës zyrtare vendosi që çështja të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore. Më 9 tetor 2015, Gjykata Themelore, pas rishqyrtimit të rastit, përmes Aktgjykimit (PKR. nr. 171/2014) shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës *"për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK"*.

18. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës parashtroi ankesë, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 171/2014), për shkak të *"shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal"*.

19. Ankesa parashtruan edhe Prokurori i Prokurorisë Themelore dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar. Më 5 janar 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 580/15) refuzoi ankesat e Prokurorisë Themelore, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe të përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (PKR. nr. 171/2014).
20. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të *"shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal"*.

21. Më 23 qershor 2016, Gjykata Supreme (Aktvendimi PPr. Kr. nr. 174/2016) refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 171/2014) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 580/2015) duke arsyetuar, ndër të tjera, se*:*

> *"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme nuk mund të aprovohen. Arsyet e cekura nga [Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit] janë valide. Pa marrë parasysh se tani i ndjeri [G.D] i pari e ka sulmuar të dënuarin, këto veprime [parashtruesit] nuk mund të kualifikohen' si mbrojtje e nevojshme. Në kërkesë citohet një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës në të cilin është thënë se "nëse tani i ndjeri e ka iniciuar konfliktin dhe e ka goditur [parashtruesit], atëherë duhet vlerësuar se a ishte i kundërligjshëm reagimi i tij ... se ai ka pas të drejtë t'i kundërvihet sulmit dhe nuk ka qenë i detyruar të rri pasiv dhe të pres deri sa i dëmtuari të bëjë punën e vet". Këto thënie janë reale, sepse i dënuari vërtetë ka të drejtë të mbrohet nga sulmi i personit tjetër, mirëpo, mbrojtja e tij duhet t'i plotësojë kriteret e kërkuara me dispozitën e nenit 12. të KPK. Në rastin konkret ato nuk janë plotësuar sepse me goditje me grusht i dënuari ka reaguar me goditje me thikë, veprim ky i cili nuk ka qenë i domosdoshëm për zmbrapsjen e sulmit të këtillë. Në shkresat e lëndës e as në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka të dhëna për atë se tani i ndjeri eventualisht ka qenë me fuqi fizike ekstreme e i dënuari fizikisht shumë i dobët, që ka pas dallim në moshë apo diç të ngjashme e që kishte për të ndikuar në vlerësimin më të detajuar të mos mundësisë eventuale që mbrojtja me thikë (e jo me grushta) të jetë medoemos e nevojshme për zmbrapsjen e sulmit e tani të ndjerit"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E

Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

23. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore (PKR. nr. 171/2014) ka kundërthënie që bëjnë që diapozitivi i Aktgjykimit të jetë në kundërshtim me vetveten.

24. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pretendon se Aktgjykimi Gjykatës Themelore (PKR. nr. 171/2014) dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 580/15) *"janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale [...] të cilat, nuk janë eliminuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme [...]"*.

25. Parashtruesi, më tej, thekson se përfundimet e Gjykatës Supreme: *"janë në kundërshtim me një aktgjykim të asaj gjykate Pkl. nr. 90/2012 të datës 22 qershor 2012, sipas të cilit aktgjykim konstatohet se [...] nëse i dëmtuari i pari e ka iniciuar konfliktin dhe e ka goditur të akuzuarin [...] atëherë duhet vlerësuar se a ishte i kundërligjshëm reagimi i [Parashtruesit] pas goditjes që kishte pësuar nga i dëmtuari, dhe ai ka të drejtë të mbrohej, ka të drejtë t'i kundërvihet sulmit, nuk është i detyruar të rri pasiv dhe të pres deri sa i dëmtuari të bëj punën e tij"*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

28. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*.

29. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi ka parashtruar kërkesën si individ dhe si palë e autorizuar; ka specifikuar shkeljet e mundshme kushtetuese; dhe se kërkesa është parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

30. Përveç kësaj, Gjykata rikujton paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

> *(3) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(4) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e ligjshmërisë, duke cekur shkeljet e pretenduara në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërinë e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta.

32. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).

33. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë,* nr. 21893/93, para. 65, shih po ashtu, *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit (PKR. nr. 171/2014) arsyetoi vendimin e saj për shpalljen fajtor të parashtruesit, duke theksuar se *"Gjykata [...] erdhi në përfundim se në veprimet e [parashtruesit] janë realizuar të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së dhe se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe fajtor për këtë vepër penale dhe se në momentin kritik, veproi me dashje dhe siç rezulton nga provat e administruara i akuzuari ka vendosur të veprojë si reaksion ndaj veprimit të [G. D] duke goditur 10 herë me brisk-thike të ndjerin [G. D], të cilave nuk ka mundur t'u mbijetojë dhe rrugës për në spitalin e Gjilanit, ndërron jetë".*

35. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 560/15) vërtetoi gjendjen faktike dhe arsyet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke theksuar se "*Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërthënie me vetveten, e as me arsyetimin e tij. Kështu, në rastin konkret në këtë çështje penale-juridike, dispozitivi është përpiluar konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-se, ku në dispozitiv janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të [parashtruesit] të cilat edhe përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor".*

36. Ndërsa, Gjykata Supreme, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit si të drejtë dhe gjithashtu ju përgjigj pretendimeve të parashtruesit se ai ka vepruar në mbrojtje të nevojshme për të zmbrapsur sulmin nga [G.D] dhe se, sipas parashtruesit, në një rast tjetër (Aktgjykimin Pkl. nr. 90/2012) Gjykata Supreme kishte vendosur ndryshe edhe pse rasti ishte i ngjashëm me atë të parashtruesit të kërkesës.
37. Në këtë mënyrë, parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij.

38. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që parashtruesi e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se procedura pranë gjykatave të rregullta,

shikuar në tërësi, ishte e drejtë. (Shih, *mutatis mutanids*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 29 dhe 30).

39. Gjykata në fund vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ai, në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

40. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

41. Për këto arsye, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij dhe për këtë arsye kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, më 5 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues,

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI101/16, Parashtrues i kërkesës: Ukë Balaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 94/16, të 11 majit 2016

KI101/16, Aktvendim për papranueshmëri i 4 prillit, i publikuar më 1 qershor 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, mbrojtja e pronës*

Më 20 janar 1990, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e blerësit lidhi kontratë për shitblerjen e patundshmërisë, ngastrës kadastrale nr. 506, me sipërfaqe prej 0.44,66ha dhe ngastrës kadastrale nr. 505, me sipërfaqe prej 0.88,56 ha, të dyja në komunën e Gllogocit, me Hajriz Tahirin në cilësinë e shitësit. Kjo kontratë është lidhur para avokatit dhe nuk ishte vërtetuar në gjykatën kompetente.

Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi për vërtetimin e pronësisë mbi patundshmëritë e kontestuara në Gjykatën Komunale në Gllogoc, e cila (me Aktgjykimin C. nr. 43/2011) në pjesën e parë të dispozitivit e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit që të vërtetohet se është pronar i patundshmërive të kontestuara në bazë të kontratës mbi shitblerjen dhe mbajtjen, dhe të detyrohet i padituri që paditësit t'ia njeh këtë të drejtë dhe t'ia lejojë regjistrimin në librat përkatëse kadastrale. Me të njëjtin aktgjykim, në pjesën e dytë të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kundër kërkesëpadia e të padituri Hajriz Tahirit dhe është vërtetuar se ai është pronar i paluajtshmërisë së përshkruar më sipër në bazë të aktvendimit të Komisionit për komasacion nr. 461-228, të 2 korrikut 1985. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës është detyruar që këtë të drejtë t'ia njoh të padituri.

Aktgjykimi (C. nr. 43/2011) i Gjykatës Komunale në Gllogoc është vërtetuar me Aktgjykimin (CA. nr. 1336/2013) e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimin (Rev. nr. 94/2016) e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, e cila e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit, me arsyetim të detajuar.

Parashtruesi konsideroi se aktgjykimet e kontestuara e kanë shkelur të drejtën e tij nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi: *"Se është lidhur kontrata për shitblerjen në mes të paditësit dhe të padituri, të cilit janë nip dhe dajë, por kontrata ka qenë gojore dhe është përmbushur nga të dy palët, është paguar çmimi, ka hyrë në posedim, është ndërtuar shtëpia në sipërfaqe prej 15 ari, kurrë nuk ka ushtruar padi i padituri për pengim posedimi, etj."*.

Gjykata vërtetoi se parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime që i theksoi edhe në procedurat para gjykatave të rregullta, ku Gjykata Komunale në Gllogoc (me Aktgjykimin C. nr. 43/2011) dha një përgjigje të detajuar për të gjitha pretendimet e parashtruesit, duke arsyetuar, ndër të tjera: *„... Kontrata e përpiluar me shkrim me datën 20.01.1990 në mes të ndërgjyqësve mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e cila i është paraqitur gjykatës nga paditësi si provë e njëjta është jovalide, pasi siç parashihet me dispozitat e nenit 4 par. 2 dhe par. 3 të Ligjit të Qarkullimit të paluajtshmërive, sipas të cilës kontrata për kalimin e së drejtës së paluajtshmërisë në mes të titullarëve të drejtës së pronësisë lidhet në formë me shkrim, ndërsa nënshkrimet e kontraktuesve vërtetohen nga ana e gjykatës, ku kjo dispozitë sipas nenit 1. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 është dispozitë e zbatueshme..."*.

Gjykata konstatoi se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë argumentet dhe dëshmitë, që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare.

Gjykata konstatoi se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të

drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se, në bazë të të gjithave të përshkruara me lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI101/16

Parashtrues

Ukë Balaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 94/16, të 11 majit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ukë Balaj nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Xhevat Bici.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 94/16, të 11 majit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet shkelja e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 korrik 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 gusht 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 2 shtator 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën kohë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 4 prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të përgjithshme

9. Më 20 janar 1990, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e blerësit lidhi kontratë për shitblerjen e patundshmërisë, ngastrës kadastrale nr. 506, me sipërfaqe prej 0.44,66 ha dhe ngastrës kadastrale nr. 505, me sipërfaqe prej 0.88, 56 ha, të dyja në komunën e Gllogocit (në tekstin e mëtejmë: patundshmëritë e kontestuara) me Hajriz Tahirin në cilësinë e shitësit. Kjo kontratë është lidhur para avokatit dhe nuk ishte vërtetuar në gjykatën kompetente.

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi për vërtetimin e pronësinë mbi patundshmëritë e kontestuara në Gjykatën Komunale në Gllogoc, ndërsa pala tjetër u përgjigj me kundërpadi.

11. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Gllogoc (Aktgjykimi C. nr. 43/2011) në pjesën e parë të dispozitivit e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit që të vërtetohet së është pronar i patundshmërive të kontestuara në bazë të kontratës mbi shitblerjen dhe mbajtjen, dhe të detyrohet i padituri që paditësit t'ia njeh këtë të drejtë dhe t'ia lejojë regjistrimin në librat përkatëse kadastrale.

12. Me të njëjtin aktgjykim, në pjesën e dytë të dispozitivit aprovohet si e bazuar kundër kërkesëpadia e të paditurit Hajriz Tahirit dhe vërtetohet se ai është pronar i paluajtshmërisë së përshkruar më sipër në bazë të aktvendimit të Komisionit për komasacion nr. 461-228, të 2 korrikut 1985; gjithashtu parashtruesi i kërkesës detyrohet që këtë të drejtë t'ia njoh të paditurit.

13. Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur me kohë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit (C. nr. 43/2011), të Gjykatës Komunale në Gllogoc.

14. Më 1 janar 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi CA. nr. 1336/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e konfirmoi aktvendimin e përmendur më lart të gjykatës së shkallës së parë.

15. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur me kohë kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e lartpërmendura të ndryshohen, ashtu që kërkesa e paditësit të pranohet si e bazuar.

16. Më 5 maj 2016, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 94/2016) e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit, me arsyetim të detajuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Se është lidhur kontrata për shitblerjen në mes të paditësit dhe të padituri, të cilit janë nip dhe dajë, por kontrata ka qenë gojore dhe është përmbushur nga të dy palët, është paguar çmimi, ka hyrë në posedim, është ndërtuar shtëpia në sipërfaqe prej 15 ari, kurrë nuk ka ushtruar padi i padituri për pengim posedimi, etj.*"

18. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"gjykatat kanë marrë për bazë thëniet e të padituri se ka të bëjë me kontakt të pengut çka nuk është e vërtetë, s'ka kontratë me shkrim e as dëshmitarë të cilët kanë qenë prezent. I padituri e pranon se ka pranuar të hollat e shitjes, të njëjtat nuk i ka kthyer kurrë, pra tek pas vitit 2004 ka hyrë me dhunë në këtë pasuri."*

19. Parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese i arsyeton si në vijim: *"Është shkelur e drejta e pronës nga neni 46 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, sepse paditësi Ukë Balaj e ka blerë nga i padituri ngastrën nr. 506 nga tabela 27 dhe ngastrën nr. 505 nga tabela nr. 28 ZK Çikatovë e Re, dhe atë kontratë mbi shitblerje të vitit 1984 nuk e kanë vërtetuar në gjykatë, paditësi e ka pas në posedim dhe shfrytëzim me dekada."*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113. [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *1."Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

23. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d)* kërkesa arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e bazuar.
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) kërkesa nuk arsyetohet prima facie.*

24. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike. Andaj, i ka plotësuar kriteret procedurale të nenit 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, për të vërtetuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

25. Në fakt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet shkeljes së nenit 46 të Kushtetutës. Megjithatë, ai nuk shpjegon se pse konsideron se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur dispozitat që i garantojnë të drejtat dhe liritë.

26. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjore, përkatësisht në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike në lidhje me vlefshmërinë e kontratës kontestuese, si dhe në vlerësimin e gabuar të provave nga gjykatat e rregullta.

27. Së pari, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime që i theksoi edhe në procedurat para gjykatave të rregullta, ku Gjykata Komunale në Gllogoc (Aktgjykimi C. nr. 43/2011) dha një përgjigje të detajuar për të gjitha pretendimet e parashtruesit, duke arsyetuar, ndër të tjera:

> *"... Kontrata e përpiluar me shkrim me datën 20.01.1990 më mes të ndërgjyqësve mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e cila i është paraqitur gjykatës nga paditësi si provë e njëjta është jovalide, pasi siç parashihet me dispozitat e nenit 4 par.2. dhe pr.3. të Ligjit të Qarkullimit të paluajtshmërive, sipas të cilës kontrata për kalimin e së drejtës së paluajtëshmërisë në mes të titullarëve të drejtës së pronësisë lidhet në formë me shkrim, ndërsa nënshkrimet e kontraktuesve vërtetohen nga ana e gjykatës, ku kjo dispozitë sipas nenit 1. të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 është dispozitë e zbatueshme."*

28. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit (Aktgjykimi CA. nr. 1336/2013) shpjegoi edhe më hollësisht gjendjen faktike, të drejtën e mbajtjes dhe vlefshmërinë e kontratës, duke shpjeguar se:

> *"Nga vërtetimi i gjendjes faktike rezulton se nuk janë përmbushur elementet e kontratës mbi shitjen, ... sepse kontrata është fiktive, me të cilin mbulohet kontrata mbi pengun. Sipas deklaratës së avokatit kontrata lëndore në të vërtetë është peng me të cilin paditësi-kundërpaditurit i ka siguruar kërkesat e veta në të holla në rast të mospagimit të borxhit, ashtu që të bëhet pronarë në paluajtëshmerinë lëndore. Këso kontrate nuk lejohet në kuptim të nenit 103 LMD dhe nuk e ka mbrojtjen ligjore. Si pasojë e kësaj paditësi-kunderipadituri nuk mund ta realizoj te drejtën e pronësisë me anë të mbajtjes në kuptim të nenit 28.4 të Ligjit mbi bazat pronësore juridike. Mirëbesim nuk ka me qenë se paditësi-kunderipadituri ka hy në posedim të paluajtshmerisë lëndore në bazë të kontratës fiktive mbi shitblerjen e cila ka qenë punë stimuluese sepse e ka mbuluar kontratën e pengut. Mbajtësi i çështjes në mënyrë jo ligjore dhe mirëbesim të posedimit nuk mund ta fitoj të drejtën e pronësisë."*

29. Së fundi, mendimi i tillë ligjor është pranuar edhe nga Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 94/2016), i cili në detaje ka arsyetuar se parashtruesi i kërkesës kurrë nuk u bë pronar i pronës kontestuese:

> *"Edhe Gjykata Supreme ndan mendimin se është e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet se është pronar i ngastrave lëndore në bazë të kontratës kontestuese të lartpërmendur e cila në fakt mbulon kontratën e pengut si garancion për borxhin e të padituri të cilin e ka marrë përsipër paditësi , dhe fakti*

se këto ngastra i ka shfrytëzuar deri në vitin 2003, nuk rezulton se janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në favor të tij as në bazë të mbajtjes, pasi që pengu është vetëm si garancion respektivisht mjet për sigurimin e kërkesës së caktuar kryesisht në të holla, dhe nuk mund të sjell asnjëherë gjer të fitimi i pronësisë, kështu që bazuar në këtë fakt, si dhe në faktin se kontrata kontestuese juridikisht është e pavlefshme për arsyet e dhëna më lart, rezulton se në asnjërën nga bazat juridike të lartpërmendura paditësi nuk ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrat lëndore, kështu që të dy gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Në anën tjetër i padituri pa dyshim ka dëshmuar të drejtën e tij të pronësisë në ngastrat kontestuese, me faktet se në bazë të procesverbalit të komisionit për komasacion , atij i janë ndarë këto ngastra, të cilat edhe i ka regjistruar si pronësi të tij në librat përkatës kadastral."

30. Gjykata përsërit se nuk ka detyrë që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës kur pretendon se autoritetet publike ia kanë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të mbrojtura me Kushtetutë.

31. Gjykata rikujton se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vërtetojë nëse disa lloje të provave janë të lejuara, cilat prova duhet të merren dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të përcaktojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në tërësi ishin të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së dëshmive (Shih rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* aplikacioni nr. 35394/97, paragrafët 34-35, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 12 majit 2000).

32. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu përsërit se roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente tjera ligjore dhe nuk mund, pra, të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmërinë, të 16 dhjetorit 2011).

33. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi për të paraqitur në gjykatat e rregullta arsye materiale dhe ligjore për zgjidhjen e kontestit; argumentet e tij janë dëgjuar dhe trajtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta; procedurat, marrë në tërësi, ishin të drejta dhe vendimet e marra ishin hollësisht të arsyetuara.

34. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave të gjykatave të rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih, *mutatis mutandis* rastin *Mezõtúr - Tiszazug Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

35. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë një pretendim të saktë dhe konkret për shkeljen e të drejtave të tij dhe nuk e shpjegon si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme mund të këtë shkelur të drejtat e tij kushtetuese; ai vetëm theksoi se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie,* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, KEDNJ, Vendimi nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

36. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *mutatis mutandis*: *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

37. Prandaj, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmerisë, të përcaktuara me Kushtetutë, më tej të precizuara me Ligj dhe të përshkruara me Rregulloren e punës nuk janë përmbushur.

38. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e tij është e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (a) dhe 56 të Rregullores së punës, më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI26/16 Parashtrues Januz Fazliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [AC-I-14-0311-A0001-A0023]

KI26/16 Aktvendim për papranueshmëri i 2 majit 2017 i publikuar më 1 qershor 2017

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar

Objekti i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës sipas nenit 21 (Parimet e Përgjithshme), nenit 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenit 24 (Barazia para Ligjit) në lidhje me nenin 3 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 53 (Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut) dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve te paraqitura se parashtruesi i kërkesës nuk i mbështeti pretendimet e tij dhe nuk dëshmoi shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI26/16

Parashtrues

Januz Fazliu

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga*:*

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Januz Fazliu nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit), të 15 korrikut 2015. Aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit më 17 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat e parashtruesit nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 3 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 15 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore "Voçar" (në tekstin e mëtejmë: NSH "Voçar") në periudhën nga 1 tetori 1984 deri më 1 janar 1994.

10. Më 1 janar 1994, menaxhmenti i NSH "Voçar" me Aktvendimin [nr. 31/94] e dërgoi parashtruesin në pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 24 muaj.

11. Gjatë vitit 2007, parashtruesi paraqiti padi kundër NSH "Voçar" në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit të të padituri [nr. 31/94], të 1 janarit 1994 dhe pagesën e kompensimit për fitimin e humbur.

12. Më 2 maj 2007, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) filloi procesin e privatizimit të NSH "Voçar".

13. Më 22 mars 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin [Cl. nr. 464/07], e ndërpreu procedurën lidhur me këtë çështje, në bazë të kërkesës së AKP-së dhe nenit 277 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sepse i padituri është NSH "Voçar" në falimentim kundër të cilit ka filluar procedura e likuidimit.

14. Më 12 prill 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale për ndërprerjen e procedurës.

15. Më 4 korrik 2011, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Ac. nr. 2880/2012] me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, me arsyetim se: "*Gjykata e Apelit një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon, për faktin se AKP-ja ka bërë një njoftim publik, si dhe me shkresën e saj të fundit të datës 10.02.2011 gjithashtu ka njoftuar se ndërmarrja e paditur është në procesin e likuidimit, duke kërkuar ndërprerjen e të gjitha procedurave gjyqësore kundër kësaj ndërmarrje*".

16. Më 21 korrik 2011, AKP publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin fituar të drejtën për marrjen e një pjese nga 20% të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH "Voçar", në të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ishte i përfshirë.

17. Më 11 gusht 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) pas skadimit të afatit ligjor, duke pretenduar se ai ka të drejtë në 20% të të ardhurave nga privatizimi.

18. Më 20 shtator 2011, AKP ka dërguar komentet e saj ndaj ankesës së parashtruesit në të cilat theksoi se ankuesi (parashtruesi) nuk i plotëson kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, për t'u kualifikuar për realizimin e të drejtës për shpërndarje të 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Voçar", sepse nuk ka ofruar prova të vlefshme për të justifikuar kërkesën e tij.

19. Më 29 shtator 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0045], me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit me arsyetim:

> "*Gjykata në bazë të shkresave të lëndës ka vërtetuar se ankuesi, nuk ka ofruar asnjë provë materiale për vërtetimin e të cekurave në ankesë. Ankuesi nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (e plotësuar dhe e ndryshuar). Për këto arsye ankesa refuzohet si e papranueshme*".

20. Më 27 tetor 2014, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar duke pretenduar "*se ai e humbi punën për shkak të masave të përkohshme të sistemit politik gjatë viteve të 90-dhjeta*".

21. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023], me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

> *"Parashtruesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale për të dëshmuar marrëdhënien e tij të punës në këtë NSH. Kolegji i Specializuar ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë materiale për t'i provuar pretendimet ankimore, andaj ishte refuzuar ankesa si e pabazuar. Kolegji i Apelit konstaton se vendimi i Kolegjit të Specializuar lidhur me këtë ankues është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale as në procedurën e ankesës, për t'i mbështetur pretendimet e tij. Për këto arsye, ankesa refuzohet si e pabazuar".*

Ligji relevant

> Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13: *"Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se 3 (tri) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi në kërkesë theksoi se "*aktgjykimin e Kolegjit të Apelit e konsideron të pabazuar për shkak se e përjashton nga lista përfundimtare për përfitimin e 20% nga privatizimi i NSH "Voçar"*.

23. Parashtruesi, më tej, thekson *"se me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-14-0311-A0001-A0023, të dt. 15.07.2015, në pjesën që ka të bëjë me parashtruesin, janë bërë shkeljet e dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe atë të: nenit 21, 22 lidhur me nenin 53 dhe nenin 54; nenit 24 lidhur me nenin 3, dhe nenit 31, për çka në atë pjesë i njëjti shfuqizohet"*.

24. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë: *"që Gjykata të detyrojë AKP-në ta përfshijë atë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta të përfitimit të së drejtës së pjesëmarrjes në 20% nga të hyrat nga procesi i privatizimit"*.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

27. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

28. Lidhur me atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzoi kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar dhe se ka treguar për shkeljet e mundshme kushtetuese, kërkesa është parashtruar në pajtim me afatet e përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Prandaj, Gjykata konkludon se janë përmbushur të gjitha kriteret formale të pranueshmërisë për shqyrtimin e kërkesës.

29. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *" (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar"*.
>
> *(2) "Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

30. Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, vërejti se parashtruesi ka ndërtuar kërkesën e tij mbi pretendimet se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara në nenet 3, 21, 22, 24, si dhe 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës.

31. Gjykata para së gjithash deklaron se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

32. Lidhur me këtë, duke vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, që kanë të bëjnë me diskriminimin, e që është në pajtim me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, Gjykata i gjeti këto pretendime të pabazuara dhe atë për arsye se parashtruesi në kërkesën e parashtruar në Gjykatë theksoi se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me punëtorët e tjerë të NSH "Voćar", pa e treguar më atë rast bazën e kësaj pabarazie.

33. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se diskriminimi ekziston nëse rezulton me një trajtim të ndryshëm të individëve në pozitat dhe situatat e ngjashme dhe nëse ky trajtim nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Për të qenë i justifikuar, trajtimi duhet të ndjek një qëllim legjitim, dhe duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit i cili duhet të realizohet (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës,* i 13 qershorit 1979, Aplikacioni nr. 6833/74).

34. Për këtë arsye është e nevojshme që në çdo rast të përcaktohet nëse parashtruesi është trajtuar ndryshe nga të tjerët në situatat e njëjta apo të ngjashme. Çdo trajtim i ndryshëm do të konsiderohet diskriminues në qoftë se nuk ka justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, gjegjësisht nëse nuk ndjek qëllimin legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi, përveç pretendimeve të tij për shkeljen e të drejtave të cekura, nuk ka ofruar ndonjë argument i cili do të tregonte se ai ka qenë në ndonjë mënyrë i diskriminuar nga ana e gjykatave në procedurën në fjalë.

36. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, e që është në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, Gjykata gjithashtu i gjen këto pretendime të pabazuara, dhe atë për arsye se baza e ankesës së parashtruesit për shkeljet e pretenduara bazohet vetëm në faktin se ai nuk ka mundur para gjykatave të rregullta të realizojë të drejtën e tij për kompensim për të cilin ai mendon se ka të drejtë.

37. Gjykata vëren se gjykatat gjatë procedurës së rregullt i kanë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e të dyja palëve në procedurë, edhe të parashtruesit si paditësit edhe të AKP-së si të padituës me rastin e vërtetimit të bazueshmërisë së padisë, duke i vënë në pozitë të barabartë, duke iu mundësuar të paraqesin argumentet, dokumentacionin dhe provat e tyre, gjë që mund të shihet edhe në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta.

38. Gjykata, më tej, vëren se aktgjykimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit janë të bazuara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/ 13, në bazë të të cilit edhe kanë konkluduar se a) parashtruesi në kohën e privatizimit - likuidimit nuk ka

qenë punëtor i NSH "Voçar", b) nuk ka qenë në listën e pagave të NSH "Voçar" për jo më pak se 3 (tri) vite para privatizimit, dhe c) nuk ka arritur të ndërtojë rastin se diskualifikimi i tij është pasojë e diskriminimit.

39. Rrjedhimisht, Gjykata nga arsyetimi i dhënë nuk e sheh arbitraritetin; për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i kanë marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet të cilat parashtruesi i ka theksuar gjatë procedurës së rregullt, dhe se me atë rast kanë dhënë konkluzione të qarta përse këto pretendime janë të pabazuara.

40. Gjykata thekson se parashtruesi, gjithashtu, pretendon se atij i është shkelur e drejta për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

41. Gjykata rikujton se nga neni 54 i Kushtetutës rrjedh se kushti për realizimin e së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave është shkelja apo mohimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Nëse ka një shkelje të tillë, bartësi i së drejtës së shkelur ose të mohuar ka të drejtë pasuese në mjete efektive ligjore.

42. Gjykata, në fakt ka konkluduar se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i pabazuar. Prandaj, nuk ka shkelje të të drejtave që çojnë në mbrojtjen gjyqësore. Rrjedhimisht, nuk ekziston objekti për shqyrtim kushtetues.

43. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka bazë për të shqyrtuar pranueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e të drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave në bazë të nenit 54 të Kushtetutës.

44. Si përmbledhje, Gjykata vlerëson se në procedurën e zbatuar nuk ka fakte apo rrethana të cilat në ndonjë mënyrë do të tregonin se parashtruesit në procedurën në Kolegjin e Apelit i janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

45. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

46. Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret sipas të cilave ankesa e parashtruesit të kërkesës do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

47. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, më 2 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI41/16, Parashtrues Bedrije Rama, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.5/2015, të 17 dhjetorit 2015

KI41/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 majit 2017, publikuar më 2 qershor 2017

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta e punës, qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktvendimin CML.nr.5/2015, të 17 dhjetorit 2015, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore- Dega në Podujevë, CP.nr.450/13, të17 tetorit 2014 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4600/14, të 19 prillit 2015.

Parashtruesja ndër të tjera pretendoi, se Gjykatës Supreme e Kosovës ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtën e punës, si rezultat i moszbatimit të vendimeve të nxjerra në procedurë gjyqësore dhe administrative, për të cilat ajo pretendon se kanë qenë në dobi të saj.

Gjykata konstatoi se parashtruesja e kërkesës nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI41/16

Parashtrues

Bedrije Rama

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 5/2015, të 17 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bedrije Rama, me banim në Podujevë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Rrahman Rama nga Podujeva (bashkëshorti i parashtrueses).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 5/2015, i 17 dhjetorit 2015, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 2 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur, me të cilin parashtruesja pretendon se i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 shkurt 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.

8. Më 7 nëntor 2016, Gjykata e informoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.

9. Më 23 dhjetor 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të dorëzoi në Gjykatë, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. 4714/12, të 6 gushtit 2012 .

10. Më 26 dhjetor 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

11. Më 23 shkurt 2017, Gjykata e informoi Komunën e Podujevës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

12. Më 6 mars 2017, Komuna e Podujevës dërgoi në Gjykatë komentet e saj lidhur me rastin.

13. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën administrative

14. Më 8 korrik 2004, parashtruesja e kërkesës kishte lidhur kontratë me Komunën e Podujevës për dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore në pronësi shoqërore në rrugën "Skënderbeu".

15. Më 6 tetor 2005, Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Podujevës mori vendim (Vendimi nr. 02-1/240-02) duke urdhëruar: "*të hiqen të gjitha objektet e përkohshme në të dy anët e rrugës në rrugën "28 Nëntori" në Podujevë [...]*".

16. Më 9 janar 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë në Komunën e Podujevës, duke kërkuar ndërrimin e lokacionit të kioskës nga rruga "Skënderbeu" në rrugën "28 Nëntori", me arsyetimin se në rrugën "Skënderbeu" nuk është e mundur të zhvillohet veprimtaria për shkak të ankesave të disa fqinjëve.

17. Më 31 mars 2006, Komuna e Podujevës (Konkluzioni nr. 09-32) refuzon kërkesën e parashtrueses, për shkak të pengesave urbanistike, përkatësisht me arsyetimin se "*lokacioni ku pala kërkon vendosjen e objektit montazhë është në shfrytëzim të gjykatave komunale dhe asaj për kundërvajtje ku së shpejti pritet të bëhet ndërtimi i objektit për gjykata*".

18. Më 4 prill 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë te kryeshefi ekzekutiv në Komunën e Podujevës, ndaj Konkluzionit nr. 09-32, të 31 marsit 2006, të Komunës së Podujevës.

19. Më 11 maj 2006, kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës (Vendimi nr. 02/09-03-353) refuzon si të pabazuar ankesën, me arsyetimin se "*kërkesa e të përmendurës nuk ka mbështetje ligjore*".

20. Më 29 maj 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kundër vendimit në fjalë të kryeshefit ekzekutitv të Komunës së Podujevës, duke pretenduar ekzistimin e "*shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative*".

21. Më 14 gusht 2006, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Vendimi nr. 66/06) e anuloi vendimin e kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Podujevës dhe e ktheu lëndën në rishqyrtim (tek kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës). Në këtë vendim theksohet se *"nuk ka mbështetje ligjore në bazë të të cilit është vendosur për këtë çështje administrative. Në shkresat e lëndës si dhe në arsyetimin e vendimit nga ana e organit komunal të Podujevës, nuk është vërtetuar se ekziston vendim për planin gjeneral urbanistik për këtë lagje të qytetit, të miratuar nga Kuvendi Komunal në Podujevë. Në procesin administrativ të shkallës së parë, gjatë vlerësimit të provave në vendimmarrje, organi përkatës nuk sjellë prova me bazë ligjore*".

22. Pas këtij vendimi të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, parashtruesja e kërkesës e vendosi kioskën në rrugën "28 Nëntori".

23. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë te kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës për zbatim të Vendimit nr. 66/06, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

24. Më 4 tetor 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti Padi në Gjykatën Supreme për zbatimin e Vendimit nr. 66/06, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

25. Më 12 nëntor 2007, Komuna e Podujevës-Drejtoria për Inspekcion (Aktvendimi nr. 165/05) urdhëron parashtruesen e kërkesës që të largojë kioskën e vendosur në rrugën "28 Nëntori" në Podujevë, duke e udhëzuar që fillimisht duhet të pajiset me leje nga organi kompetent.

26. Më 13 nëntor 2007, kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës (Vendimi nr. 02.09-52-466-1), duke vendosur në riprocedurë, refuzon si të pabazuar ankesën e parashtrueses e cila kishte paraqitur kërkesë për zbatim të Vendimit nr. 66/06, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë vendim theksohej se "*kontrata e cekur* [e lidhur në vitin 2004] *de jure është ende në fuqi meqë e njëjta nuk është shkëputur nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, por de facto është shkëputur në mënyrë të njëanshme nga znj. Bedrije Rama, e cila në mënyrë arbitrare kioskën e ka zhvendosur në paluejshtmërinë [...] e cila gjendet në rrugën "28 Nëntori", paluejshtmëri në pronësi të Komunës së Podujevës njëherit në shfytëzim të Gjykatës Komunale [...] Nga kjo, ky organ konstaton se Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, e KK Podujevë, me të drejtë e ka refuzuar kërkesën e të përmendurës për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të lokacionit të evidentuar [...]*".

27. Më 14 nëntor 2007, Komuna e Podujevës-Drejtoria për Inspekcion ia rrënoi kioskën parashtrueses së kërkesës të vendosur në rrugën "28 Nëntori".

28. Më 4 janar 2008, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kundër Vendimit nr. 02.09-52-466-1, të 13 nëntorit 2007, të kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Podujevës, duke i kërkuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit *"që të anulojë vendimin e kryeshefit ekzekutiv të KK Podujevës si të pabazuar dhe të lejoj vendosjen e përkohshme të kioskut*".

29. Më 4 shkurt 2008, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi A. nr. 2431/2006) hedh poshtë padinë e parashtrueses së kërkesës (të paraqitur më 4 tetor 2006), si të palejuar. Në aktvendim, theksohet se "*Gjykata Supreme vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e procedurës së konfliktit gjyqësorë administrativ nga baza e heshtjes së administratës për faktin se kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës ka vepruar sipas detyrimit nga aktvendimi i lartcekur [...] ashtu që ka marrë veprimin e sipërcekur i cili në pajtim me dispozitën e sipërcekur ligjore nuk është akt përfundimtar administrativ [...]*".

30. Më 30 prill 2008, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Vendimi nr. A-03/08) aprovon ankesën e parashtrueses (të paraqitur më 4 janar 2008), duke anuluar vendimin e kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Podujevës, 02.09-52-466-1, të 13 nëntorit 2007, dhe e kthen lëndën në rishqyrtim tek kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës. Në vendim, ndër të tjera, arsyetohet se "*vendimi i nxjerrë nga kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës, nuk ka mbështetje ligjore në bazë të së cilit është vendosur për këtë çështje administrative [...] nuk ekziston as vendim për revokimin e lejeve të përkohshme i nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Podujevës*".

31. Më 30 qershor 2008, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë në Komunën e Podujevës, ku kërkoi nga Komuna e Podujevës që të shqyrtojnë vendimin e tyre të mëparshëm, në përputhje me Vendimin nr. A-03/08, e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

32. Më 18 gusht 2008, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme kundër kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Podujevës, për shkak të mosmarrjes së vendimit nga ana e organit të shkallës së parë.

33. Më 31 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën lidhur me konfliktin administrativ (Aktgjykimi A. nr. 1041/2008) aprovon padinë e parashtrueses së kërkesës, duke e urdhëruar kryeshefin ekzekutiv të Komunës së Podujevës, që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh të vendosë lidhur me kërkesën e parashtrueses për zbatimin e Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr. A-03/08, të 30 prillit 2008. Në Aktgjykim, ndër të tjera, arsyetohej se "*janë plotësuar kushtet ligjore të parashikuara nga neni 26 par. 1 të Ligjit të Konflikteve Administrative për paraqitje të padisë për shkak të mosmarrjes së aktvendimit nga ana e organit administrativ sipas vendimit detyrues të organit të shkallës së dytë, prandaj organi i paditur është i obliguar që brenda afatit të lënë të veprojë sipas Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr. A-03/08 datë 30.04.2008, duke i mbajtur parasysh vërejtjet e paraqitura në këtë aktgjykim*".

Përmbledhja e fakteve në procedurë përmbarimore

34. Më 9 dhjetor 2011, parashtruesja e kërkesës iu drejtua Gjykatës Komunale në Podujevë me propozim për lejim të përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr.1041/2008, të 31 tetorit 2011.

35. Më 17 tetor 2012, Gjykata Komunale në Podujevë (Aktvendimi E. nr. 1233/11), aprovoi propozimin e parashtrueses së kërkesës që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, Komuna e Podujevës të vendosë lidhur me kërkesën për zbatim të Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Vendimi nr. A-03/08) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr.1041/2008.

36. Më 30 tetor 2012, Komuna e Podujevës paraqiti kundërshtimin në Gjykatën Komunale në Podujevë kundër këtij Aktvendimi.

37. Më 9 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Podujevë (Aktvendimi E. 1233) refuzon si të pabazuar kundërshtimin, me arsyetimin se "*nuk janë plotësuar asnjë nga shkaqet për të ushtruar prapësimin, e të cilat shkaqe do ta pengonin përmbarimin e lejuar nga Gjykata konform nenit 55 të LPP-së*".

38. Më 22 nëntor 2012, Komuna e Podujevës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Podujevë, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

39. Më 6 gusht 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. nr. 4714/12) miratoi ankesën e Komunës së Podujevës, kurse Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Podujevë e prishi dhe lëndën e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë.

40. Në aktvendim theksohet se "*sipas gjetjes së kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë ka lejuar përmbarimin në kundërshtim me nenin 24 (b) të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP) [...]. Me qenë se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendimin për përmbarimin dhe me këtë rast nuk e ka vlerësuar përshtatshmërinë e propozimit të paraqitur në mënyrë të bazuar tregohet me ankesë se aktvendimi i atakuar është nxjerrë me shkelje të Ligjit të Procedurës Përmbarimore*".

41. Më 17 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë nxori Aktvendimin CP. nr. 450/13 duke përfunduar procedurën përmbarimore ndaj kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Podujevës. Në këtë aktvendim argumentohet se "*Gjykata, duke marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit në Prishtinë sipas detyrës zyrtare konform nenit 66 të LPP-së që ka hyrë në fuqi me dt. 01.01.2012, vendosi që të përfundoj procedurën përmbarimore të propozuesve lidhur me nenin 71 të LPP-së. Marrë parasysh nenin 24 (b) të LPP-së së vjetër, nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka të bëjë me detyrim në të holla por vetëm urdhër që kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës në afat prej 30 ditësh të vendosë lidhur me kërkesën e propozuesve të kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin A.nr.1041/2008, dt. 31.10.2011, atëherë bazuar në nenin 71 par 1.1 të LPP-së si dhe dokumenti në bazë të cilit është marrë vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përmbarueshërisë, i njëjti nuk është dokument ekzekutiv dhe procedura duhet përfunduar konform nenit 66.1 dhe 3 të LPP-së sipas detyrës zyrtare*".

42. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë.

43. Më 29 prill 2015, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4600/14) refuzoi si të pabazuar ankesën, duke e mbështetur në tërësi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë.

44. Më 27 maj 2015, parashtruesja paraqiti propozim te Prokurori i Shtetit për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, CP. nr. 450/13, të 17 tetorit 2014 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4600/14, të 19 prillit 2015.

45. Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës aprovoi kërkesën e parashtrueses dhe ngriti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

46. Më 17 dhjetor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi CML. nr. 5/2015) refuzon si të pathemeltë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Në Aktvendimin e Gjykatës Supreme, ndër të tjera, theksohet: "*gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se dokumenti përmbarimor në bazë të së cilit është lejuar përmbarimi nuk ka titull ekzekutiv në kuptim të nenit 24 (b) të LPP, dhe*

se procedura duhet të përfundoj në kuptim të nenit 66.1 dhe 3 të LPP, sipas detyrës zyrtare". Më tutje, në këtë Aktvendim, Gjykata Supreme arsyetoi se "*propozimi i propozueses-kreditores për lejimin e përmbarimit në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme të Kosovës, që është marrë me procedurë administrative nuk paraqet titull ekzekutiv në kuptim të nenit 24 pika (b) të LPP, që ka qenë në aplikim në kohën kur është parashtruar propozimi për përmbarim*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Parashtruesja pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 5/2015, të 17 dhjetorit, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49, të Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

48. Më konkretisht, parashtruesja pretendon se: "*[...] mu kan shkel të drejtat e punës pasi që mu ka mbyll vendi i punës dhe tani nuk kam ku të punoj dhe komuna nuk i zbaton vendimet e Ministrisë dhe aktgjykimin e Gjyqit Suprem që mu ka pranuar Padia [...] edhe pse gjykatat kanë marrë vendime pozitive për mua ato në fund kanë bërë ndërprerjen e procedurës, kurse komuna kurr nuk i ka zbatuar vendimet e gjykatave dhe të ministrisë".*

49. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

> *"Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që të bjen një vendim pozitiv në favor timin që të shtynë Komunën që të zbaton vendimin e Ministrisë dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme që është pranuar padia, që të vendosi kioskën, që të fillojë të punojë pasi që jam në gjendje të vështirë ekonomike [...] kërkojmë që të zbatohen aktgjykimet dhe aktvendimet e Ministrisë dhe të vendoset kioska në rrugën " 28 Nëntori".*

Komentet e dorëzuara nga Komuna e Podujevës

50. Në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës, Komuna e Podujevës thekson se e mbështet plotësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 5/2015, të 17 dhjetorit, duke argumentuar si në vijim: " *konsiderojmë se Gjykata Supreme e Kosovës me të drejtë e ka refuzuar si të pathemeltë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit Shtetëror të Kosovës paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë CP.nr.450/2013 të dt 17.10.2014 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4600/2014 datë 29.04.2015".*

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

52. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

53. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh se:

> "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj*".

54. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *(...)*
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *(...)*
> *(d) nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

55. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor.

56. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

57. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës.

58. Lidhur me këtë pretendim të parashtrueses, Gjykata i referohet nenit 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], i cili përcakton :

> *"1. E drejta e punës garantohet.*
> *2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".*

59. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se deri tek shkelja e të drejtës së garantuar me nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, ka ardhur si rezultat i moszbatimit të vendimeve të nxjerra në procedurë gjyqësore dhe administrative, për të cilat ajo pretendon se kanë qenë në dobi të saj.

60. Në këtë drejtim, parashtruesja e pretendon se "*Edhe pse gjykatat kanë marrë vendime pozitive për mua ato në fund kanë bërë ndërprerjen e procedurës, kurse Komuna kurrë nuk i zbatuar vendimet e gjykatave dhe të Ministrisë*".

61. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata sjell në vëmendje se në rastin konkret ka disa vendime të ndryshme, të sjella në procedurë administrative dhe instanca të ndryshme gjyqësore.

62. Gjykata vëren se vendimi i fundit, të cilin parashtruesja e konteston shprehimisht, është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, CML. nr. 5/2015, i 17 dhjetorit 2015, në procedurë përmbarimore.

63. Gjykata vëren se Aktvendimi në fjalë i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi lidhur me pretendimet e parashtrueses, të cilat tashmë ishin ngritur në instanca më të ulëta dhe të cilat kishin të bënin me kryerjen e procedurës përmbarimore.

64. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit të Gjykatës Supreme CML. nr. 5/2015, të 17 dhjetorit 2015 e cila i vërtetoi se gjykatat e instancës më të ulët, në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës përmbarimore dhe të drejtën materiale.

65. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë përgjigje dhe arsyetime të hollësishme në vendimet e tyre, se pse është mbyllur procedura e përmbarimit dhe se në rastin konkret mungonte titulli ekzekutiv i urdhrit përmbarimor.

66. Për më tepër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykatat e rregullta kanë bërë kualifikimet dhe interpretimet përkatëse të fakteve dhe ligjeve të zbatueshme në rastin konkret.

67. Gjykata thekson se konstatimet dhe kualifikimet e fakteve si dhe interpretimet ligjore janë në prerogativën e gjykatave të rregullta.

68. Gjykata vë në dukje, se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në këtë drejtim, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", në raport me vendimet e gjykatave të rregullta (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë,* GJEDNJ, kërkesa nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu, *mutatis mutandis,* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

69. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk dëshmon se është viktimë e një veprimi të padrejtë ose arbitrar të një autoriteti publik, që ka rezultuar në cenimin e të drejtës së saj të mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, apo ndonjë të drejtë tjetër kushtetuese.

70. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e saj për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ajo në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar asaj të drejtën e garantuar me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesja.

71. Prandaj, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, më 2 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI132/16, Parashtrues: Musa Torbani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 97/2016, të 14 qershorit 2016

KI132/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2017, publikuar më 2 qershor 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, çështje civile-pronësore, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi i kërkesës, pretendonte se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta ishin në kundërshtim me Kushtetutën. Më tej ai pretendonte se iu shkel e drejta e pronës, për arsye se gjykatat e rregullta ua njohën paditësve të drejtën e pronësisë pa u bazuar në fakte dhe prova, dhe se ato paluajtshmëri në mënyrë të kundërligjshme ishin regjistruar në emrin e paditësve.

Gjykata, në këtë rast, konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, sepse faktet dhe argumentet e prezantuara nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia mohuan atij të drejtat kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, u deklarua qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI132/16

Parashtrues

Musa Torbani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 97/2016, të 14 qershorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Musa Torbani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 97/2016, të 14 qershorit 2016 (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar), të cilin e ka pranuar më 25 korrik 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 14 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të paspecifikuar, paditësit I. F. dhe B. A. nga Prizreni ushtruan kërkesëpadi për njohjen e të drejtës së pronësisë përkitazi me paluajtshmëritë p. k. nr. 5200/3, në sipërfaqe prej 8434 m2 dhe p. k. nr. 5201/4 në sipërfaqe prej 600 m2.

10. Më 28 janar 2014, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 642/11) aprovoi kërkesëpadinë e paditësve dhe vërtetoi se të njëjtit në bazë të mbajtjes në mirëbesim janë bashkëpronarë të paluajtshmërive në fjalë. Me këtë vendim, parashtruesi dhe dy të paditurit tjerë obligohen që paditësve t'ua njohin bashkëpronësinë mbi paluajtshmëritë dhe t'ua lejojnë atyre regjistrimin e paluajtshmërive në fjalë në librat kadastrale.

11. Parashtruesi i kërkesës dhe të paditurit apeluan vendimin e 28 janarit 2014 në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

12. Më 18 maj 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 2285/2014) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe të paditurve dhe e konfirmoj, si të drejtë, vendimin e 28 janarit 2014.

13. Parashtruesi dhe të paditurit, ndaj aktgjykimit të 18 majit 2015, parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

14. Më 14 qershor 2016, Gjykata Supreme (Rev. nr. 97/2016) refuzoi si të pabazuar kërkesën e tyre për revizion dhe e konfirmoj aktgjykimin e 18 majit 2015. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

> *[...]*
> *"Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë konstatuar se paditësit si bashkëpronar në bazë të nenit 20 të LFMPJ (ligj i zbatueshëm në Kosovë, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24), si dhe me nenin 40 par. 1 të Ligjit nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, kanë fituar pronësinë në bazë të punës së vlefshme juridike - mbajtjes me mirëbesim.*
>
> *Pretendimin e cekur në revizion, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 204 dhe neni 182 par. 1 dhe 2 pika (n) të LPK, sepse nuk ka dhënë arsyetim lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara, ngase, në*

aktgjykimin e kundërshtuar janë dhënë arsye për të gjitha faktet relevante për një aktgjykim të drejtë e të bazuar në ligj dhe janë arsyetuar pretendimet ankimore të cilat janë vlerësuar se të njëjtat nuk kanë vënë në dyshim ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar".
[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me Kushtetutën. Më tej ai pretendon se i është shkelur e drejta e pronës, për arsye se gjykatat e rregullta ua njohën paditësve të drejtën e pronësisë pa u bazuar në fakte dhe prova, dhe se ato paluajtshmëri në mënyrë të kundërligjshme janë regjistruar në emrin e paditësve.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton:

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e Pranueshmërisë], paragrafin (1), shkronjën (d) dhe paragrafin (2), shkronjën (b) dhe (d) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(...)
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
(...)
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;".

20. Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me shkeljen e barazisë para ligjit, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të drejtën e pronës.

21. Sa i përket pretendimit për gjykim të drejtë dhe të barazisë para ligjit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në fakt vetëm i përmend këto nene të Kushtetutës, mirëpo ai më tej nuk argumenton, si dhe pse erdhi deri te shkelja e këtyre neneve konkrete të Kushtetutës nga gjykatat e rregullta.

22. Ndërsa, sa i parket pretendimit për shkeljen e të drejtës së pronës, ai argumenton se shkelja e kësaj të drejte erdhi, sepse gjykatat e rregullta, në mënyrë të kundërligjshme

dhe pa u mbështetur në fakte dhe prova ua njohën paditësve të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërité, për të cilat ai pretendonte se i takonin atij.

23. Gjykata rithekson se vërtetimi i të drejtës së pronësisë është juridiksion i gjykatave të rregullta. Fakti i vetëm se e drejta e pronësisë u takon paditësve, nuk duhet të kuptohet me automatizëm si shkelje e të drejtës së pronës e cila garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.

24. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i saj është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese në këtë rast konkret nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

25. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

26. Gjykata, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të argumentojë dhe provojë se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë gjatë gjykimit të çështjes së tij. Prandaj, fakti i vetëm se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

27. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

28. Nga sa më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, sepse faktet dhe argumentet e prezantuara nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat kushtetuese.

29. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 49 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI111/16, Parashtrues: Asllan Zenuni, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. S/16, të 2 shkurtit 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4370/15, të 18 dhjetorit 2015

KI111/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2017, publikuar më 2 qershor 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, çështje civile-pronësore, kërkesë e paafatshme, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese të shkaktuara nga gjykatat e rregullta dhe prokuroria e shtetit për arsye se autoritetet në fjalë nuk kishin respektuar dispozitat ligjore përkatëse për dhënien e vendimeve të drejta. Pas vlerësimi të rastit, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e paafatshme. Prandaj në pajtim me nenin 49 të Ligjit u deklarua e papranueshme për shqyrtim.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI111/16

Parashtrues

Asllan Zenuni

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. S/16, të 2 shkurtit 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4370/15, të 18 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Asllan Zenuni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. S/16, të 2 shkurtit 2016 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4370/15, të 18 dhjetorit 2015 (në tekstin e mëtejmë: vendimet e kontestuara).

3. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit më 29 dhjetor 2015. Ndërsa, njoftimi i Prokurorit të Shtetit, për refuzimin e kërkesës për mbrojte të ligjshmërisë iu dorëzua më 2 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Ai nuk ka specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës, përkitazi me shkeljen e të drejtave të tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafin (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të

Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 18 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 13 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e kërkesës me dokumentacion relevant.

9. Më 23 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë dorëzoi kërkesën e plotësuar së bashku me dokumentacionin relevant.

10. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si të paafatshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore të Ferizajt, për shkak të pengim-posedimit dhe të shfrytëzimit të pronës së tij nga fqinjët.

12. Më 5 tetor 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj (C. nr. 318/2011), refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.

13. Parashtruesi i kërkesës e apeloi Aktvendimin e 5 tetorit 2015, të gjykatës së instancës së parë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave të ligjit material.

14. Më 18 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, AC. nr. 4370/15), e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e lënë në fuqi kështu Aktvendimin e 5 tetorit 2015, të gjykatës së instancës së parë.

15. Më 14 janar 2016, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar me propozim Prokurorisë së Shtetit për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

16. Më 2 shkurt 2016, Prokurori i Shtetit (Njoftimi, KMLC. nr. S/16), hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojte të ligjshmërisë, për shkak të mospërmbushjes së kushteve ligjore për inicim të saj në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

17. Më 16 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës dorëzoi kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë.

18. Më 18 mars 2016, administrata e Gjykatës Supreme informon parashtruesin e kërkesës se lënda e tij nuk ndodhej në Gjykatën Supreme dhe se për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë parashtruesi mund t'i drejtohej Prokurorisë së Shtetit, sipas nenit 245 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës argumenton dhe pretendon si më poshtë:

a. "Aktgjykimi i shkallës së parë është sjellë me injorimin e propozimit të paditësit për caktimin e masës së përkohshme; mospërfilljen e ekspertizës të dt.07.09.2015; lejimin e kohës dhe hapësirës që e paditura të veproi e lirë në pronën publike dhe të uzurpoi të njëjtën të vendos pengesa (murin dhe rrethojën në pronën publike ....

b. Gjykata e shkallës së dytë ka shkelur dispozitat e nenit 204 të LPK-së, citoj: "... gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj", e po ashtu me rastin e vlerësimit të provave Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e nenit 8 të LPK-së, pasi nuk i ka vlerësuar drejtë thëniet e paditësit në seancat gjyqësore, e as provat që i ka ofruar ai, pra nuk i ka vlerësuar me kujdes dhe ndërgjegje e kjo do të thotë se edhe njëra e edhe Gjykatat tjetër kanë sjellë vendime në kundërshtim me provat, meqë, sipas bindjes sime, kjo ka ndodhë për shkak të anueshmërisë apo ndonjë faktori tjetër degradues (...).

c. Prokuroria e shtetit sipas bindjes sime nuk e ka trajtuar drejtë Propozimin tim për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë dhe më është përgjigjur me një Njoftim të thjeshtë se nuk ka shkelje ligjore, përmes të cilit nuk më ka dhënë kurrfarë këshille juridike, se ku mund të drejtohem me kërkesë/ankesë për të realizuar të drejtën time."

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht (...)".

22. Gjykata gjithashtu merr parasysh 36 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafin (1) shkronjën (c), që përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi;"
[...]

23. Gjykata vë në pah se dispozitat e sipërcekura kërkojnë që kërkesa në Gjykatë të dorëzohet brenda 4 (katër) muajve nga dita e pranimit të vendimit përfundimtar (mjetit të fundit efektiv juridik).

24. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vendimin e Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 29 dhjetor 2015 dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit (KMLC. nr. S/16), më 2 shkurt 2016, gjersa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 5 shtator 2016, që do të thotë se njëjta është e paafatshme.

25. Sa i përket shkresës së Gjykatës Supreme, të 18 marsit 2016, Gjykata konsideron se kjo shkresë nuk mund të merret për bazë për qëllime të llogaritjes se afatit 4 (katër) mujor, sepse nuk i plotëson kriteret për t'u quajtur vendim përfundimtar (mjeti i fundit efektiv juridik).

26. Për më tepër, Gjykata rikujton se afati ligjor i përcaktuar me nenin 49 të Ligjit është i natyrës prekluzive dhe është vendosur për të promovuar sigurinë juridike, duke siguruar që rastet të cilat ngrehin çështje nga Kushtetuta të shqyrtohen brenda afatit të arsyeshëm (Shih *mutatis mutandis* rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

27. Nga sa u tha më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i plotëson kriteret procedurale të pranueshmërisë, ashtu siç kërkohet me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores, prandaj si e tillë e njëjta duhet të deklarohet e paafatshme dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 49 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI 75/16, Parashtrues i kërkesës Teatri Kombëtar i Kosovës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 56/2016, te 17 marsit 2016

KI 75/16, Aktvendim për papranueshmëri i 16 janarit 2017, i publikuar më 2 qershor 2017.

Fjalët kyçe: *kërkesë institucionale, Teatri Kombëtar i Kosovës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kompensimi monetar, i papranueshëm, qartazi i pabazuar*

Më 27 janar 2004, Q. B. parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke u ankuar se parashtruesi ia kishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme kompensimin mujor monetar që e gëzonte në përputhje me Vendimin nr. 139, të 5 tetorit 2000, të lëshuar nga parashtruesi. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 1034/2013) e miratoi ankesën e parashtruesit dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në Gjykatën Komunale. Q. B. paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Më 17 mars 2016, Gjykata Supreme pranoi, si të themeltë, revizionin e Q. B., duke e lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 144/09·

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme "është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës". Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar, dhe as nuk ka pretenduar se procedurat gjyqësore, të shikuara në tërësi, ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë çdo shkelje kushtetuese dhe nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt për interpretimin dhe zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastet e GJEDNJ Garcia Ruiz kundër Spanjës 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Shih po ashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI 70/11 Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

Prandaj Gjykata konstaton se, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si e pabazuar në baza kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI75/16

Parashtrues

Teatri Kombëtar i Kosovës
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 56/2016, të 17 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Teatri Kombëtar i Kosovës - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i përfaqësuar nga Shefqet Hasimi, zyrtar i lartë juridik në Zyrën e Avokaturës Shtetërore.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 56/2016, të 17 marsit 2016, që refuzoi si të papranueshme ankesën e tij dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 16 tetorit 2012.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit më 14 prill 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet se "*është në kundërshtim me Kushtetutën*".

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 maj 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

7. Më 14 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 16 nëntor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe po të njëjtën ditë Gjykatës Supreme iu dërgua një kopje e kërkesës.

9. Më 16 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 27 janar 2004, Q. B. parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke u ankuar se parashtruesi ia kishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme kompensimin mujor monetar që e gëzonte në përputhje me Vendimin nr. 139, të 5 tetorit 2000, të lëshuar nga parashtruesi.

11. Më 16 tetor 2012, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 144/09) miratoi kërkesëpadinë si të bazuar dhe detyroi parashtruesin që atij t'ia paguajë kompensimin material të cekur në Aktgjykim.

12. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit "*për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*".
13. Më 11 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 1034/2013) e miratoi ankesën e parashtruesit dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në Gjykatën Komunale.

14. Q. B. paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të "*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*".

15. Më 17 mars 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 56/2016) pranoi, si të themeltë, revizionin e Q. B. dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Njëkohësisht, Gjykata Supreme e la në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 144/09.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës vetëm pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme "*është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës*".

17. Parashtruesi nuk ka shpjeguar cili (at) nen (e) është shkelur me Aktgjykimin e kontestuar dhe, në veçanti, cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë janë shkelur.

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë ndonjë deklaratë për zgjidhjen e kërkuar nga Gjykata.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij ta qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

22. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, ku përcaktohet:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *(...)*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *(...)*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

23. Gjykata rikujton se parashtruesi nuk ka shpjeguar cilat të drejta dhe liri pretendon të jenë shkelur. Më tej, ai nuk tregon as cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.

24. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, kur përshkruan faktet e kërkesës së tij, i referohet vetëm aktgjykimeve të gjykatave të ndryshme. Përveç kësaj, kur e ka justifikuar kërkesën e tij dhe duke përmendur shkeljet e pretenduara të Kushtetutës, ai vetëm përmend aktgjykimet e gjykatave, pa ndonjë analizë apo shqyrtim.

25. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur para Gjykatës të njëjtat baza që ka paraqitur para gjykatave të rregullta. Ato baza kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë. Asnjë bazë mbi kushtetutshmërinë nuk është paraqitur nga parashtruesi para Gjykatës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se të gjitha bazat e ngritura nga parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta kanë marrë përgjigje dhe janë arsyetuar nga ana e këtyre gjykatave. Domethënë, Gjykata Supreme ka trajtuar gjerësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse me kompensimin material mujor dhe ka vlerësuar ligjshmërinë e ndërprerjes së saj.

27. Në fakt, Gjykata Supreme konsideron se që nga "*themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin mbi Pensionin Invalidor i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeveri dhe Kuvend të Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ende qëndron detyrimi i së padituris që ndaj paditësit t'ia përmbush obligimin sipas Vendimit të saj n3.139 të datës 3.10.2000 dhe atë deri sa të themelohet dhe funksionalizohet Fondi i sipërpërmendur, përkatësisht, deri sa paditësi të arrijë moshën e pensionit të pleqërisë moshën 65 vjeçare*".

28. Më tej, Gjykata Supreme ka gjetur se "*Gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, prandaj, e ndryshoi aktgjykimin e saj dhe vendosi ta lë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë*".

29. Gjykata rithekson se vërtetimi i gjendjes faktike dhe ligjit të zbatueshëm është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë), dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm për të siguruar pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore (çështje e kushtetutshmërisë). Prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" duke vlerësuar çështjen e ligjshmërisë. (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

30. Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka treguar, ose pretenduar, se procedurat gjyqësore, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të konsiderojë shkelje kushtetuese.

31. Gjykata rithekson se nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt dhe të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta në interpretimin dhe zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,* rasti *Fc Metrebi kundër Georgias* par. 31, Aktgjykim i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007; shih, gjithashtu, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI70/11, *Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

32. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka deklaruar faktet e kërkesës së tij dhe nuk ka ndërtuar asnjë pretendim kushtetues. Për më tepër, ai nuk ka arritur të provojë se procedurat para gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ishin të padrejta apo arbitrare apo se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur.

33. Kështu, Gjykata konkludon se nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Prandaj, Gjykata konstaton se në përputhje me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b), kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, të nenit 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe (2) (b), si dhe 56 të Rregullores së punës, më 16 janar 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI68/16, Parashtrues i kërkesës: Fadil Rashiti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 249/2015, të 3 dhjetorit 2015

KI 68/16, Aktvendim për papranueshmëri i 31 marsit 2017, i publikuar më 5 qershor 2017

Fjalët kyç*: Kërkesë individuale, akuzë penale, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Gjilan (Aktgjykimi P. Nr. 286/2014) për kryerjen e veprës penale sipas nenit 186 [Ngacmimi] i Kodit Penal të Kosovës. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, PAL nr. 570/2015) sipas ankesave e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua nga Gjykata Supreme.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi në Gjykatën Kushtetuese, *inter alia* se Gjykata Supreme duke refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për vendimin e Gjykatës së Apelit, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata vlerësoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetuan shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të thirrura nga ai dhe se ky i fundit nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij. Prandaj, Gjykata deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme si qartazi të pabazuar siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç përcaktohet më tej nga rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI68/16

Parashtrues

Fadil Rashiti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 249/2015, të 3 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fadil Rashiti, nga fshati Velekincë, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Shemsedin Pira, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin (PML nr. 249/2015, të 3 dhjetorit 2015) të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin (P. nr. 286/2014, të 10 shkurtit 2015) të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë (PA1 nr. 570/2015, të 8 korrikut 2015) (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 dhjetor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën

Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 prill 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 28 prill 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 11 maj 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 19 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Supreme të paraqesin dëshmi për datën e dorëzimit të Aktgjykimit (PML. nr. 249/2015) të Gjykatës Supreme.

10. Më 28 korrik 2016, Gjykata pranoi konfirmimin lidhur me datën kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar aktgjykimi i mësipërm.

11. Më 13 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës më 9 shtator 2016.

12. Më 13 janar 2017, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi autorizimin që dëshmon se ai është i autorizuar që ta përfaqësojë parashtruesin e kërkesës në Gjykatë.

13. Më 31 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 28 shkurt 2014, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: Prokurori) parashtroi aktakuzë [PP. II. nr. 159/2014] kundër parashtruesit të kërkesës në bazë të dyshimit se kishte kryer veprat penale sipas nenit 186 [Ngacmimi] dhe 185 [Kanosja] të Kodit Penal të Kosovës (KPK), ndaj palës së dëmtuar H. D.

15. Më 10 shkurt 2015, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 286/2014) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale sipas nenit 186 [Ngacmimi] të KPK-së dhe i shqiptoi dënimin me kusht prej 180 ditësh burgim i cili nuk do të ekzekutohej nëse parashtruesi i kërkesës gjatë kohës së verifikimit prej 1 (një) viti e 6 muajsh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Parashtruesi i kërkesës u lirua nga akuza në lidhje me veprën penale sipas nenit 185 [Kanosja] të KPK-së.

16. Në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore arsyetohej, ndër të tjera, si në vijim:

> *"Në rastin konkret në bazë të provave të administruara është vërtetuar se i akuzuari gjatë vitit 2013 por edhe 2014 [...] edhe atëherë kur nuk ka qenë në detyrë zyrtare me rroba civile ka shkuar në vendin e punës në terren ku ka qenë e dëmtuara [H. M] në detyrë zyrtare, pastaj edhe në zyrë në Stacion Policor duke e ngacmuar me veprimet e tij - duke e prekur me gishtat e dorës në fytyrë, pastaj duke ia zënë rrugën [H. M] për të hyrë në derën e hyrjes në Stacion Policor në*

Gjilan duke bërë sjellje të pakontrolluara dhe të padëshiruara për [H. M] - duke ia zënë rrugën me trup të tij pastaj duke ju ofruar me gojë në vesh te [H. M] duke i pështpëritë siç edhe me të drejtë ka dëshmuar edhe e dëmtuara duke i thënë "ta kici veshin" [...] pastaj duke i bërë thirrje telefonike në mënyrë të përsëritshme të cilat kanë qenë të padëshiruara për [H. M], pastaj duke i dërguar mesazhe - SMS-ve dhe duke e quajtur me emrin përkëdhelës 'BIBUSH', e këto veprime i akuzuari i ka bërë me qëllim të ngacmimit, frikësimit si dhe duke mbajtur nën shqetësim të madh emocional pasi që e njëjta është e martuar dhe ka fëmijë dhe sjelljet e tilla me të drejtë mund t'i shkaktojnë [H. M], probleme të mëdha familjare e sidomos bashkëshortore, pastaj pasiguri për një jetë të saj private të lirë dhe të qetë. Sjelljet e tilla inkriminuese të [parashtruesit të kërkesës] ndaj [H. M] kohë pas kohe në mënyrë të përsëritshme kanë shkaktuar ankth dhe pasiguri [...]

Nga ajo që u theksua më lart është vërtetuar se në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale të ngacmimit nga neni 186 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 4 të KPRK-së për të cilën gjykata e shpalli fajtor dhe dënoi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi."

17. Avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, për shkak të *"shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin"* duke propozuar që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore *"të ndryshohet dhe [parashtruesi i kërkesës] të lirohet nga akuza penale e [Ngacmimit]/."*

18. Prokurori gjithashtu parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të *"vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike"*, duke propozuar që aktgjykimi i kontestuar, për sa i përket veprës penale sipas nenit 185 [Kanosja] të KPK-së, ku parashtruesi u lirua nga fajësia, të anulohet dhe çështja penale t'i kthehet Gjykatës Themelore për rigjykim dhe rivendosje. Në lidhje me veprën penale nga neni 186 [Ngacmimi] i KPK-së, Prokurori kërkoi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të ndryshohet dhe parashtruesit të kërkesës t'i shpallet një dënim më i rëndë.

19. Pala e dëmtuar - H. M., gjithashtu parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit në lidhje me dënimin e shqiptuar përkitazi me veprën penale nga neni 185 [Kanosja] të KPK-së, duke propozuar që për parashtruesin e kërkesës të vendoset një dënim më i rëndë.

20. Më 8 korrik 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PA1. nr. 570/2015) i refuzoi të gjitha ankesat si të pabazuara dhe konstatoi si në vijim:

"[...]sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 394, par. 1, pika 1.1, të KPPK [Kodi i Procedurës Penale i Kosovës], [Gjykata e Apelit] ka ardhur në përfundim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkeljet për të cilat pretendohet në ankesën e mbrojtësit të [parashtruesit të kërkesës], se dispozitivi i [Aktgjykimit të Gjykatës Themelore] është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale, të ngacmimit.
[...]
gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë ka proceduar të gjitha provat e nevojshme, dhe ka vërtetuar faktet që karakterizojnë veprën penale të ngacmimit nga neni 186, par 4, lidhur me par 1 të KPK, e cila rezulton nga deklarata e të dëmtuarës –[H. M.], si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve [I. R.], [L. B.], [E. R.], [S. R.], si dhe nga vlerësimi i SMS-

ve, nga të cilët rezulton se [parashtruesi i kërkesës] ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, sepse e kanë ngacmuar vazhdimisht [H. M.] me fjalët e ndryshme, nga të cilat rezulton se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht."

21. Avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht të nenit 384 të KPPK-së pasi që *"Gjykata [e Apelit] as nuk i ka informuar e as në procesverbalin e seancës nuk ka theksuar se palët dhe mbrojtësi i [parashtruesit të kërkesës] janë të informuar apo jo për seancë."*

22. Prokurori me anë të parashtresës (KMLP. II. nr. 186/15, të 11 nëntorit 2015), propozoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

23. Më 3 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 249/2015) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi si në vijim:

"[...] Në dispozitën e nenit 390. par.1 të KPPK thuhet se "kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të Apelit i dërgohet prokurorit kompetent të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij." Në rastin konkret, me aktgjykimin e [Gjykatës Themelore] nuk është shqiptuar dënimi me burgim por dënimi me kusht, për ç' arsye nuk ka ekzistuar obligimi i Gjykatës së Apelit që për seancën e [Gjykatës së Apelit] të informojë [parashtruesin e kërkesës], mbrojtësin e tij e as personat tjerë të përmendur më lart dhe me mos informimin e tyre nuk është bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"me asnjë provë të besueshme dhe të plotë qoftë të dëshmitarëve apo provave materiale, nuk është vërtetuar se në veprimet e [parashtruesit të kërkesës] të jenë formësuar tiparet e kësaj vepre penale [...]".*

26. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se *"[...] në përmbledhjen e prezantuar të dispozitivit të aktgjykimit [të Gjykatës Themelore] vetvetiu rezulton se i njëjti është i pakuptueshëm, i paqartë dhe kundërthënës me arsyetimin [...]."*

27. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se "*gjykatësi [A. SH.] në Gjykatën Themelore në Gjilan merr aktvendim dhe me shpall fajtor për "ngacmim seksual" duke modifikuar/ndryshuar deklaratat e dëshmitarëve si dhe të [palës së dëmtuar - H. M.], si dhe duke llogaritur si dëshmitarë edhe persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dëshmitarë",* duke pretenduar se gjyqtari i mësipërm ka lidhje familjare me H. M.

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata e Apelit duke vërtetuar aktgjykimin e [Gjykatës Themelore], si të drejtë e veçmas Gjykatës [Supreme] e cila ka vendosur sipas [...] Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, ka bërë shkelje flagrante të dispozitave të ligjit dhe të drejtave kushtetuese [të parashtruesit të kërkesës]."*

29. Parashtruesi i kërkesës në fund pretendon se avokati i tij mbrojtës në fjalën e tij përfundimtare në Gjykatën Themelore *"fare nuk përmend asnjë shkelje që ky gjykatës [i Gjykatës Themelore] i bënë në këtë lëndë kundër meje, njëherit edhe në ankesat dërguar Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme nuk paraqet asnjë provë mbrojtëse."*

30. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të:

- shpallet si e pranueshme kërkesa.
- shpallet si jokushtetues aktgjykimi goditur i Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe
- urdhërohet që vendimi final i Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 286/2014, të kthehet në gjykim të sërishëm.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

"*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta *dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

34. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

35. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës ankohet në Gjykatë se: *(i)* gjykatat e rregullta kanë marrë vendimin për dënimin e tij pa dëshmi të mjaftueshme dhe nuk kanë marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit kur kanë vendosur për dënim; *(ii)* përmbledhja e përfshirë në dispozitiv të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore është qartazi e pakuptueshme, e paqartë dhe kundërthënëse me arsyetimin; (*iii*) vendimi për dënimin e tij është bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, deklaratat e të cilëve janë ndryshuar nga gjyqtari i Gjykatës Themelore i cili gjithashtu kishte konflikt interesi në këtë rast; (*iv*) Gjykata e Apelit nuk e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës apo avokatin e tij mbrojtës në lidhje me seancën e mbajtur në Gjykatën e Apelit për rastin e tij; dhe (*v*) avokati i tij nuk i ka ngritur në gjykatat e rregullta disa nga pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në këtë Gjykatë.

36. Lidhur me pretendimin e parë dhe të dytë, Gjykata gjithashtu rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në përgjigje ndaj pretendimit të parashtruesit, ku, ndër të tjera, thuhet:

"aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkeljet për të cilat pretendohet në ankesën e mbrojtësit të [parashtruesit të kërkesës], se dispozitivi i [Aktgjykimit të Gjykatës Themelore] është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale, të ngacmimit.
[...]
gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë ka proceduar të gjitha provat e nevojshme, dhe ka vërtetuar faktet që karakterizojnë veprën penale të ngacmimit nga neni 186 par 4 lidhur me par 1 të KPK, e cila rezulton nga deklarata e të dëmtuarës –[H. M.], si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve [I. R.], [L. B.], [E. R.], [S. R.], si dhe nga vlerësimi i SMS- ve [...]."

37. Sa i përket pretendimit të tretë të parashtruesit të kërkesës, asgjë në kërkesë nuk sugjeron se kjo çështje është ngritur nga parashtruesi gjatë procedurës së rregullt. Kjo çështje është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë më parë e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt.

38. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljen e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Mosshfrytëzimi i kësaj mundësie do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (Shih, Aktvendimin në rastin KI139/12, *Besnik Asllani*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012, i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; dhe *shih Selmouni kundër Francës, [DHM] § 74; Kudla kundër Polonisë [DHM] § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [aktvendim]).*

39. Në lidhje me pretendimin e katërt, se Gjykata e Apelit nuk e ka njoftuar atë apo avokatin e tij mbrojtës në lidhje me seancën e mbajtur në Gjykatën e Apelit, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme ku thuhej që pasi nuk ishte shqiptuar dënim me burgim, Gjykata e Apelit nuk kishte asnjë obligim sipas nenit 390, paragrafi 1 i KPPK-së që ta njoftojë parashtruesin e kërkesës ose avokatin e tij mbrojtës për seancën e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit.

40. Përveç kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë se e drejta për *"seancë publike"* siç garantohet me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut [në tekstin e mëtejmë: Konventa], domosdo nënkupton të drejtën për *"seance gojore"*. (Shih, *mutatis mutandis Dory kundër Suedisë,* Aktgjykim i GJEDNJ-së i 12 nëntorit 2002, aplikacioni nr. 28394/95, paragrafi 37).

41. Parimi i mbajtjes së seancës gojore dhe publike në kontekst penal ka rëndësi të posaçme, me ç'rast, personit të akuzuar me kryerjen e veprës penale në përgjithësi, duhet t'i ofrohet mundësia që të jetë i pranishëm fizikisht në seancën e gjykatës së shkallës së parë që i plotëson të gjitha kriteret e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës. Në këtë seancë parashtruesi duhet të gëzojë të drejtën që rasti i tij të "dëgjohet", dhe, ndër të tjera, që të ofrojë dëshmi për mbrojtjen e tij, t'i dëgjojë dëshmitë kundër tij, t'i marrë në pyetje dhe në pyetje të tërthortë dëshmitarët (Shih rastin *Jussila*

kundër Finlandës, aplikacioni nr. 73053/01, [DHM], Aktgjykim i 23 nëntorit 2006, paragrafi 40).

42. Megjithatë, prania personale e të akuzuarit nuk ka rëndësi kritike në seancën e apelit sikurse në seancën e gjykimit. Mënyra se si neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës zbatohen në procedurë në gjykatat e apelit, varet nga tiparet e veçanta të procedurës në zhvillim dhe, se duhet të merren parasysh procedurat si tërësi, në rendin juridik dhe roli i Gjykatës së Apelit në atë rend juridik (Shih Aktgjykim i 18 tetorit 2006, *Hermi kundër Italisë,* aplikacioni nr. 18114/02, paragrafi 60).

43. Megjithatë, kur një Gjykatë e Apelit duhet të shqyrtojë një rast sa i përket fakteve dhe ligjit dhe të bëjë një vlerësim të plotë të çështjes së fajësisë apo pafajësisë, ajo nuk mund të përcaktojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i akuzuari me qëllim që të provojë se ai nuk ka kryer veprën e cila pretendohet të përbëjë vepër penale (shih Aktgjykimin GJEDNJ-së i 9 qershorit 2009, *Sobolewski (nr. 2) kundër Polonisë*, Aplikimi nr. 19847/07, para. 35, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 6 korrikut 2004, *Dondarini kundër San Marino*, Aplikimi nr. 50545/99, para. 27).

44. Gjykata vëren se, në procedurë në Gjykatën Themelore, parashtruesi u dëgjua gojarisht lidhur me veprën penale për të cilën ai është i akuzuar. Më pas, gjykata ka kryer procedurën e provave në të cilën i ka dëgjuar dëshmitarët dhe janë paraqitur provat tjera. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përfitoi nga ndihma juridike e avokatit dhe ishte në gjendje të paraqesë dëshmitë dhe argumentet e tij për të kundërshtuar dhe për të kontestuar provat e paraqitura kundër tij dhe akuzat penale.

45. Gjykata vëren se në procedurën e apelit, Gjykata e Apelit vetëm konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në bazë të fakteve të përcaktuara nga Gjykata Themelore.

46. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ishte privuar nga të drejtat dhe garancitë e parapara me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, si në lidhje me një "seancë dëgjimore". Ai kishte mundësi që ta mbrojë veten e tij personalisht, ai kishte ndihmë juridike dhe ishte në gjendje që të marrë pjesë në procedurën në fazën ku Gjykata Themelore e shpalli atë fajtor.

47. Sa i përket pretendimit të pestë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës fajëson avokatin e tij për mos ngritje të disa nga pretendimeve të ngritura në gjykatat e rregullta të cilat parashtruesi i kërkesës i ngre në këtë Gjykatë, që në fakt, nuk është një argument i vlefshëm për t'u marrë parasysh në Gjykatën Kushtetuese.

48. Gjykata thekson, se sjellja në gjykatë e avokatit apo e përfaqësuesit të autorizuar nga vetë parashtruesi është përgjegjësi e parashtruesit. Çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet në parim parashtruesit të kërkesës (Shih *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, nr. 14102/02 GJEDNJ, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis*, *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë*, Nr. 58511/13 GJEDNJ, Aktvendim i 27 janarit 2014).

49. Prandaj, Gjykata vëren se pas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, kanë hedhur poshtë pretendimet e tij për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së duke mbështetur plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore respektivisht të Gjykatës së Apelit. Të dy instancat i janë përgjigjur të gjitha pretendimeve për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

50. Gjykata rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion

për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës.

51. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

52. Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues:*Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

53. Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit të tij nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë.

54. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

55. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi në gjykatat e rregullta duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstatoi se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

56. Prandaj, në rastin konkret, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat ai thirret dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

57. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI58/16, Parashtrues Kadri Emini, Skender Emini, Flamur Emini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml.nr.8/2016, të 26 janarit 2016

KI58/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2017, publikuar më 5 qershor 2017

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin, Pml.nr.8/2016, të 26 janarit 2016, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1.nr.175/2015, të 16 marsit 2015.

Parashtruesit e kërkesës nuk kanë saktësuar se cila dispozitë kushtetuese mund të jetë shkelur, duke pretenduar shkelje ligjore . Parshtruesit pretendojnë se si rezultat i një mosmarrëveshjeje që kanë pasur me persona të tjerë, ka ardhur deri te një konflikt fizik ndërmjet tyre, duke pretenduar që personat që kanë kryer vepër penale duhej të jenë dënuar me dënim më të lartë.

Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre në baza kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI58/16

Parashtrues

Kadri Emini
Skender Emini
Flamur Emini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 8/2016, të 26 janarit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kadri Emini, Skender Emini dhe Flamur Emini me banim në Komoran (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga Kadri Emini.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 8/2016, i 26 janarit 2016, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 10 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë saktësuar se cila dispozitë kushtetuese mund të jetë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 mars 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 13 qershor 2016, parashtruesit e dorëzuan në Gjykatë formularin e kërkesës.

8. Më 1 korrik 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga parashtruesit që të dorëzojnë në Gjykatë Aktgjykimin P. nr. 1833/2013, të 22 gushtit 2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe Aktgjykimin PA1. nr. 175/2015, të 16 marsit 2015, të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.

9. Më 11 korrik 2016, parashtruesit dorëzuan në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

10. Më 8 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

11. Më 16 gusht 2011, parashtruesit e kërkesës në njërën anë dhe në anën tjetër L. V. dhe R. V., si rezultat i një mosmarrëveshjeje që kanë pasur ndërmjet dy familjeve, ka ardhur deri te një konflikt fizik ndërmjet tyre.

12. Më 30 prill 2013, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur propozim aktakuzë ndaj parashtruesve të kërkesës dhe personave të tjerë, të përfshirë në konflikt.

13. Më 22 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 1833/2013), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës Skender Eminin, si dhe L. V. dhe R. V. për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje, nga neni 188 [Lëndim i Lehtë Trupor] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i shqiptuar dënim me gjobë. Parashtruesit e kërkesës Kadri Emini dhe Flamur Emini janë liruar nga akuza sepse nuk është provuar se kanë kryer vepër penale.

14. Në një datë të paspecifikuar R. V. dhe L. V. në njërën anë, si dhe parashtruesi i kërkesës Skender Emini në anën tjetër, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatim të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, duke kërkuar që të njëjtit të lirohen nga akuza. Parashtruesit e kërkesës Kadri Emini dhe Flamur Emini parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke kërkuar që R. V. dhe L. V., t'u shqiptohet dënim më i rëndë.

15. Më 16 mars 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi PA1. nr. 175/2015) refuzon ankesat e parashtruesve të kërkesës si dhe të R. V. dhe L. V., si të pabazuara si dhe vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 1833/2013, të 22 gushtit 2014. Më tutje, në arsyetim theksohet "*pretendimet ankimore të [...] përkitazi me shkeljet esenciale nuk qëndrojnë ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale [...] Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij [...]*".

16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 175/2015, të 16 marsit 2015.

17. Më 26 janar 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 8/2016) refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Më tutje, në Aktgjykim, shtohet "*kjo Gjykatë mbështet në tërësi qëndrimin juridik të dy gjykatave se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale [...]. Në rastin konkret kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur të dëmtuarit, pra personat të cilët sipas dispozitës së lartcekur nuk e gëzojnë këtë të drejtë*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit pretendojnë se me vendimin e kontestuar atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, duke mos e saktësuar se cila dispozitë kushtetuese mund të jetë shkelur.

19. Parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë "*Ne mendojmë se këtu ka shkelje ligjore se personat që e kanë kryer veprën penale janë dënuar me dënim për lëndime të lehta trupore*". Sipas parashtruesve, personat që kanë kryer vepër penale duhej të jenë dënuar me dënim më të lartë.

20. Parashtruesit gjithashtu pretendojnë se si rezultat i një mosmarrëveshjes me familjen me të cilën janë në konflikt, e njëjta ia kufizon lirinë e lëvizjes parashtruesve të kërkesës duke ua pamundësuar punimin e tokës. Këto pretendime parashtruesit nuk i ndërlidhin me vendimin e kontestuar.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1 dhe 7, [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

24. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

(...)

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e *pabazuar.*

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
(...)
(a) Kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose.
(...)".

25. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

26. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës nuk tregojnë se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë shkelur. Përveç kësaj, ata nuk tregojnë as cili nen (nenet) i Kushtetutës është shkelur.

27. Gjykata vëren se parashtruesit në kërkesën e tyre, në thelb të kërkesës së tyre nuk janë të kënaqur me vërtetimin e gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta, duke pretenduar "*Ne mendojmë se këtu ka shkelje ligjore se personat që e kanë kryer veprën penale janë dënuar me dënim për lëndime të lehta trupore* [...]" .

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se të gjitha bazat e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës para gjykatave të rregullta, gjykatat e rregullta u përgjigjën dhe i arsyetuan pretendimet e palëve. Në të vërtetë, Gjykata e Apelit kishte trajtuar në mënyrë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse pretendimet e parashtruesve.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila konkludoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, theksohet *"... me vërtetimin e drejtë të gjendejs faktike të akuzuarit L. V., R. V. dhe Skender Emini i ka shpallur fajtor për këtë vepër dhe iu ka shqiptuar dënimin me gjobë [...]. Dënimi që i është shqiptuar të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në përpjestim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe në shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor [...]".*

30. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur me prova e as nuk e kanë arsyetuar pretendimin e tyre në baza kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura nga ta nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

31. Ndërsa sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesve të kërkesës, Gjykata nuk lëshohet në arsyetim të këtyre pretendimeve sepse konsideron se parashtruesi nuk i ndërlidh këto pretendime me vendimet e kontestuara dhe, për më tepër, këto janë relacione në mes të palëve të treta, prandaj parashtruesit me faktet e paraqitura në kërkesë nuk kanë arritur të ndërtojnë asnjë pretendim kushtetues.

32. Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë arritur të dëshmojnë, se procedurat gjyqësore, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë ndonjë shkelje kushtetuese.

33. Gjykata rikujton, që fakti se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

34. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës, nuk janë plotësuar.

35. Prandaj, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, më 8 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI141/15, Parashtrues: Hajdar Podrimja, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP nr. 29/2015, të 29 tetorit 2015

KI141/15, Aktvendim për papranueshmëri i miratuar më 2 maj 2017 dhe publikuar më 7 qershor 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar*

Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve të gjykatave të rregullta.

Parashtruesi e kishte paraqitur kërkesën e tij pranë Gjykatës Supreme si palë e interesuar në procedurë dhe konsideronte se refuzimi i kërkesës së tij i kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të papranueshme sepse parashtruesi nuk kishte mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij e as nuk kishte dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregonte shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij. Gjykata po ashtu, shikuar në përgjithësi procedurat, nuk vërejti se ka fakte apo rrethana që tregojnë se Gjykata Supreme apo gjykatat e rregullta i kishin marrë vendimet e tyre me arbitraritet apo në ndonjë mënyrë tjetër i kishin shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën e parashtruesit si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI141/15

Parashtrues

Hajdar Podrimja

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP nr. 29/2015, të 29 tetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hajdar Podrimja nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP nr. 29/2015, të 29 tetorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 29 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 18 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova kryesuese të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje më 9 shtator 2016.

9. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata mund të vërejë se gjatë vitit 1969 është bërë nacionalizimi i ngastrës nr. 197 të paraardhësit juridik të parashtruesit në sipërfaqe prej 1.59,76 ha.

11. Gjatë vitit 1969, paraardhësi juridik i parashtruesit të kërkesës për shkak të nacionalizimit të ngastrës kontestuese inicioi procedurën gjyqësore e cila ka përfunduar më 25 tetor 1970 me Aktgjykimin Ac. nr. 647/69, të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

12. Me këtë aktgjykim është refuzuar prapësimi i paraardhësit juridik të parashtruesit dhe i është dhënë mundësia palës së tretë Z. TH., që si palë e cila ka marrë pjesë në procedurën e nacionalizimit të regjistrojë pronën në fjalë në kadastër në emrin e tij.

13. Më 1 shtator 1986, Komisioni për Nacionalizim të Komunës së Rahovecit, nxori Aktvendimin nr. 461-41, në të cilin si pronar i ngastrës kontestuese është regjistruar Z. TH.

14. Gjatë vitit 2010, parashtruesi paraqiti kërkesën në Komisionin për Rregullimin e Tokave në Komunën e Rahovecit, në të cilën kërkoi regjistrimin e pronës në fjalë në emrin e tij, duke pretenduar se regjistrimi i kësaj prone në personin Z. TH. është kontestues, sepse ka ndodhur si rezultat i fshehjes së fakteve që ekziston edhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Cml-nr. 21/71, të 28 tetorit 1971, me të cilin është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 647/69.

15. Më 26 korrik 2010, Komisioni për Rregullimin e Tokave të Kuvendit Komunal të Rahovecit nxori Aktvendimin nr. 461-16/2010, me të cilin e aprovoi kërkesën e parashtruesit dhe e shpalli pjesërisht të pavlefshëm Aktvendimin e Komisionit për Nacionalizimin e Tokave të Komunës së Rahovecit, nr. 461–41, të 1 shtatorit 1986, që ka të bëjë me pjesën e ngastrës kadastrale 197.

16. Më 25 gusht 2010, pala e tretë Z. TH., paraqiti ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejmë: MBPZHR) kundër Aktvendimit të Komisionit për Rregullimin e Tokave të Kuvendit Komunal të Rahovecit, të 26 korrikut 2016.

17. Më 8 tetor 2010, MBPZHR i dërgoi ankuesit Z. TH., përgjigjen SP-2227/210, në të cilën theksoi se MBPZHR *"nuk ka kompetencë lëndore të procedojë sipas ankesës së parashtruar nga ai"*.

18. Më 8 nëntor 2010, Z. TH. me padinë e paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), inicioi kontestin administrativ për anulimin e aktit/përgjigjes së MBPZHR-së në lidhje me ankesën me nr. SP-2227/210, të 8 tetorit 2010.

19. Më 22 janar 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin A. nr. 1076/2010, me të cilin e aprovoi padinë e Z. TH., dhe anuloi përgjigjen e MBPZHR-së në ankesë, gjithashtu, e urdhëroi MBPZHR-në që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të merr aktvendimin sipas ankesës së paditësit të 25 gushtit 2010, të ushtruar kundër vendimit të Komisionit për Rregullimin e Tokave të Kuvendit Komunal të Rahovecit, nr. 461-16/2010.

20. Parashtruesi i kërkesës, si palë e interesuar në procedurë, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, A. nr. 1076/2010, në të cilën ka kërkuar që padia e Z. TH. (paditësit) të hidhet poshtë si e palejuar.

21. Më 11 qershor 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin AA. nr. 120/2015, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit, ndër të tjera, thuhet: *"Organi i paditur (MBPZHR) është dashur që gjatë procedimit të vendos sipas bazave ligjore të cekura si më lartë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankesës siç parashihet në nenin 131. 1 të LPA, me aktvendim përmbajtjesor, ashtu siç parashihet në nenet 84, 85 dhe 86 të LPA-së, i cili aktvendim do të duhet t'i kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, mënyrën e vendosjes, bazën ligjore në të cilat bazohet akti dhe në arsyetim të jepen arsye të plota dhe të qarta dhe këshillën për apelim"*.

22. Parashtruesi paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit për shkak të shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa, të ndryshohen aktgjykimet dhe që padia e paditësit të hidhet poshtë si e palejuar.

23. Më 29 tetor 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 29/2015, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e palës së interesuar (parashtruesit) për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit. Në arsyetimin e aktgjykimit, ndër të tjera, thuhet:

> *"Organi i paditur (MBPZHR) ka pas për obligim për të vendosur sipas ankesës së paditësit, në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (nenet 74 – 85) nr. 03/L-040, ku përcaktohen kompetencat e ministrive për ushtrimin e kontrollit dhe ligjshmërisë së akteve të nivelit lokal, andaj mosmarrja e vendimit për kërkesën e paditësit përbën shmangie të detyrimeve ligjore nga ana e MBPZHR"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi në kërkesë theksoi se Gjykata Supreme me veprimet e kundërligjshme dhe kundërkushtetuese refuzoi kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, duke i shkelur kështu të drejtat dhe liritë e tij themelore të parapara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë: *"Që Gjykata të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, ARJ-UZVP. nr. 29/2015, të datës 29.10.2015, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 120/2015, të datës 11.06.2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 1076/2010, të 22 janarit 2015"*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

27. Në këtë kuptim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

28. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

29. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

30. Gjykata gjatë analizës së pretendimeve të parashtruesit nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, vërejti se parashtruesi e ndërtoi kërkesën e tij mbi pohimet se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur për shkak se "*Gjykata Supreme nuk e aprovoi kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimeve gjyqësore, të cilën e kishte ushtruar si palë e interesuar në procedurë"*.

31. Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave kushtetuese në të cilat thirret, kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave në procedurën në të cilën është vendosur për lejueshmërinë procedurale të padisë së paraqitur nga pala e tretë Z. TH., kundër MBPZHR-së.

32. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta gjatë procedurës së rregullt i kanë marrë parasysh të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës gjatë përcaktimit të bazueshmërisë së kërkesës së tij, gjë që mund të shihet edhe në bazë të vendimeve të tyre.

33. Gjykata më tej vëren se në procedurën lëndore para gjykatave të rregullta është përcaktuar vetëm lejueshmëria procedurale e padisë lëndore kundër MBPZHR-së, dhe se në këtë procedurë nuk ishte vendosur në asnjë mënyrë për "të drejtat civile" të parashtruesit, por as për "detyrimet" e tij.

34. Prandaj, rezultati i procedurës në të cilën janë marrë vendimet e kontestuara nuk ishin vendimtare për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të parashtruesit e kërkesës.

35. Rrjedhimisht, Gjykata në bazë të arsyetimit të dhënë nga gjykatat e rregullta nuk sheh arbitraritet; për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i shqyrtuan pretendimet të cilat i ka paraqitur parashtruesi në kërkesat e tij, me ç'rast dhanë përfundimet të qarta sepse këto pretendime janë të pabazuara.

36. Si përmbledhje, Gjykata vlerëson se në procedurën e mbajtur nuk ka fakte apo rrethana që në ndonjë mënyrë do të tregojnë se në procedurat në Gjykatën Supreme parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat ose liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë apo me KEDNJ.

37. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih: rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013.

38. Gjykata konsideron se kriteret sipas së cilave ankesa e parashtruesit të kërkesës do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ nuk janë plotësuar.

39. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20, paragrafi 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Arta Rama-Hajrizi

KI 22/16, Parashtrues i kërkesës Naser Husaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015

KI 22/16, Aktgjykimi i 2 majit 2017, i publikuar më 9 qershor 2017

Fjalët kyçe*: kërkesë individuale, shkelje, aktgjykim, pronësia mbi pronë, e drejta për gjykim të drejtë, vlerësim i kushtetutshmërisë*

Më 19 qershor 2013, Gjykata Themelore në Pejë (Aktgjykimi C. nr. 21/10) e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Më 27 korrik 2013, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, ku kjo gjykatë vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë. Më 20 nëntor 2015, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 335/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit t[e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 dhe 31 të Kushtetutës, sepse ka qenë i njëanshëm në baza personale kundër tij.

Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor. Po ashtu, e bazuar në praktiken gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (shih rastet KI72/12, KI135/14), Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme me të cilin është refuzuar revizioni, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-se [E drejta për një proces të rregullt.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 56 (1) dhe 74 (1) te Rregullores së punës, deklaron të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015 dhe e kthen Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim ne pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI22/16

Parashtrues

Naser Husaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Husaj, avokat nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AC. nr. 2740, të 30 tetorit 2015, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C. nr. 21/10, të 19 qershorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 21 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore - Parimet e Përgjithshme] dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

7. Më 8 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 janar 2010, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë ndaj M. J., duke kërkuar që t'i vërtetohet pronësia mbi parcelat e tokës në sipërfaqe të tërësishme prej 5.40.91 ha. Ai pretendoi se pronësia mbi këto parcela toke i takon mbi bazën e kontratës mbi shitblerje që kishte me të ndjerin S. J. (trashëgimlënësi i të padituruës M. J.), si dhe mbi bazën e mbajtjes. Parashtruesi më vonë e kishte precizuar padinë dhe kishte shtuar në të edhe të paditur të tjerë (të përfshirë në mënyra të ndryshme transaksione me të njëjtat parcela të tokës).

10. Parashtruesi e kishte parashtruar padinë pasi që, sipas tij, nuk po i bartej ligjërisht e drejta e pronësisë, edhe pse qysh në vitin 2000 ai kishte lidhur një marrëveshje për shitblerje me S. J.

11. Sipas parashtruesit, i biri i tij U. H. ishte fillimisht blerësi, ndërsa më vonë, me ndryshimin e kontratës, si blerës paraqitet vetë parashtruesi. Ai pohon se kishte paguar rreth 90% të shumës së kontraktuar dhe se gjithashtu pronën e paluajtshme kontestuese e mban në shfrytëzim mbi 13 vjet.

12. Më 19 qershor 2013, Gjykata Themelore në Pejë (Aktgjykimi C. nr. 21/10) e refuzoi padinë si të pabazuar.

13. Më 27 korrik 2013, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

14. Më 30 tetor 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi AC. nr. 2740/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë.

15. Më 20 nëntor 2015, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Në "arsyet e revizionit", parashtruesi theksoi se me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit i është bërë "*shkelje e rëndë e dispozitave të procedurës kontestimore dhe atë, në Kolegjin e Gjykatës së Apelit ka marrë pjesë gjyqtari Q. A., i cili është nën hetime sipas kallëzimit tim penal, datë 26/11/2004, të dërguar me postë në Prokurorinë e Shtetit, për vepër penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autorizimeve, për dy vepra*

penale, dhe lënda kundër tij ekziston në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, sipas informatave të Prokurorit të Shtetit ... (J. M.), datë 4/12/2014 PPN. Nr. 404/14. I njëjti s'ka pasur të drejtë të marrë pjesë në Kolegj dhe të vendosë sipas ankesës sepse këtu kemi të bëjmë me konflikt interesi dhe këtë e parasheh KPK. Me nenin 424/1-3-4, pra vendos në mënyrë që të më hakmerret mua".

17. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 335/2015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

18. Në pjesën relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme arsyetohej se *"[...] Aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 dhe 31 të Kushtetutës, sepse ka qenë i njëanshëm në baza personale kundër tij.

20. Parashtruesi ngrit si pretendim kryesor çështjen e pjesëmarrjes së gjyqtarit Q. A. në Kolegjin shqyrtues të Gjykatës së Apelit, ani pse ai ka pasur konflikt interesi, për shkak të padisë penale që parashtruesi kishte ushtruar ndaj gjyqtarit Q. A.

21. Në lidhje më këtë, parashtruesi shprehet se "*Gjyqtari Q. A. s'ka guxuar të marrë pjesë në Kolegj se aty ka konflikt interesi dhe kjo paraqet vepër penale".*

22. Më tej, parashtruesi thekson se "*Për çudi, Gjykata Supreme [...] e refuzon Revizionin pa u bërë një muaj prej se e kam dorëzuar dhe nuk thirret në rrethanën se gjyqtari Q. A. nuk ka guxuar të marrë pjesë në Kolegj në Gjykatën e Apelit".*

23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që vendimin e kontestuar "*ta shpall kundërkushtetues sepse m'i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtën në gjykim të drejtë dhe vendim të drejtë gjyqësor".*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

25. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Më tej, Gjykata merr në konsideratë nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

27. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores, ku përcaktohet:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi* e *pabazuar".*

28. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar mjetet juridike dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor. Po ashtu, Gjykata konsideron se kërkesa ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie*, ndërkohë që ajo nuk është qartazi e pabazuar.

29. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë meritat e rastit, duke shqyrtuar pretendimet ashtu sikur janë paraqitur në kërkesë.

Vlerësimi i meritave të rastit

30. Fillimisht, Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës obligon Gjykatën Kushtetuese që "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

31. Gjykata vëren se parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 335/2015, por edhe aktgjykimet e instancave më të ulëta, duke pretenduar se ato i kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 21 dhe 31 të Kushtetutës.

32. Por, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi nuk ka sqaruar pretendimin për shkelje të nenit 21 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore - Parimet e Përgjithshme], por vetëm sa e ka përmend në kërkesë dhe si të tillë Gjykata nuk do ta trajtojë. Ndërkohë, thelbi i kërkesës ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], i cili ka përmbajtjen si në vijim:

> *Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm]*
>
> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
>
> [...]

33. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 16 dhjetor 1992, f 34, seria A nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës,* 22 prill 1992. f. 33, Seria A nr. 235).

34. Gjykata vëren se Gjykata Themelore (Aktgjykimi C. nr. 21/10) mbi bazën e gjendjes së vërtetuar faktike, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit (paditësit) për vërtetim të së drejtës së pronësisë. Gjykata Themelore arsyetoi se parashtruesi (paditësi) nuk kishte vërtetuar se kishte fituar të drejtën e pronësisë me ndonjë bazë ligjore apo titull juridik të vlefshëm.

35. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 2740/2013) konstatoi se Gjykata Themelore kishte vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe se kishte aplikuar drejt ligjin në rastin konkret. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtruesit duke lënë në fuqi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

36. Nga përmbajta e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se ky Aktgjykim ishte marrë në "*seancë të Kolegjit"* me ç 'rast "*Kolegji i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK, gjeti se ... ".* Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës dhe praktika e përgjithshme rezulton se parashtruesi nuk kishte mundësi ta kundërshtonte përbërjen e Kolegjit gjyqësor në procedurën e ankimimit në Gjykatën e Apelit.

37. Gjykata vëren se parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion, ku bazë kryesore ankimore e parashtruesit ishte pjesëmarrja e një gjyqtari në përbërjen e Gjykatës së Apelit, i cili, sipas parashtruesit, kishte konflikt interesi në lëndën e tij dhe kundër të cilit parashtruesi kishte paraqitur kallëzim penal.

38. Gjykata sjell në vëmendje se Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën për revizion, duke arsyetuar se "*Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as shkelje të tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin [...]".*

39. Megjithatë, Gjykata vëren se në arsyetimin e vet Gjykata Supreme nuk mori parasysh pretendimet e parashtruesit për pjesëmarrjen e gjyqtarit Q. A. në përbërjen e Gjykatës së Apelit edhe pse në kërkesën për revizion parashtruesi kishte ngritur pretendimin lidhur me pjesëmarrjen e këtij gjyqtari në kolegjin e Gjykatës së Apelit.

40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni tjetër i një vendimi të arsyetuar është t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u ofrojë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI72/12 të 17 dhjetorit 2012).

41. Në dritën e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi dhe arsyetimit të dhënë nga gjykatat e rregullta, Gjykata vlerëson se në parim nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (Shih rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28). Në këtë drejtim, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit.

42. Gjykata e rithekson se gjykatat e rregullta nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ato duhet të adresojnë pretendimet që janë relevante për çështjen në shqyrtim, për më tepër nëse ato ngrihen në fazat të ndryshme të procedurës, siç ka ndodhur me kërkesën e tanishme (shih Gjykata Kushtetuese, Rasti KI135/14, Aktgjykim i 8 shkurtit 2016).

43. Gjykata rithekson se e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre, si në aspektin procedural po ashtu edhe në aspektin material (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI135/14).

44. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata nga rasti në rast, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Masa deri në të cilën aplikohet detyra për ta arsyetuar vendimin mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (*Hirvisaari kundër Finlandës,* Akgjykimi i GJEDNJ, i 27 shtatorit 2001, par. 30).

45. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ka adresuar fare një nga pretendimet kryesore të tij në kërkesën për revizion, e që kishte të bënte me pjesëmarrjen e një gjyqtari në gjykim në instancën e shkallës së dytë, lidhur me paanësinë e të cilit parashtruesi kishte ngritur dyshime serioze. Për pasojë, parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar bie ndesh me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

46. Gjykata konsideron se kjo çështje është e karakterit thelbësor për rastin sepse qartësimi i saj do të evitonte frikën e parashtruesit lidhur me paanësinë e trupit gjykues në gjykimin e rastit të tij dhe do të forconte bindjen se pretendimet e parashtruesit janë dëgjuar në mënyrë të duhur.

47. Sikur Gjykata Supreme të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesit lidhur me paanshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Apelit- pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë gjithsesi se do të përmbushej kushti i "palës së dëgjuar" dhe i administrimit të duhur të drejtësisë. Nuk është në detyrën e Gjykatës të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve substanciale të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur – posaçërisht nëse kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme sikurse paanshmëria e gjykatave.

48. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se paanësia nënkupton mungesën e paragjykimeve apo të animeve dhe ajo mund të testohet në mënyra të ndryshme (W*ettstein kundër Zvicrës*, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII dhe *Micallef kundër Maltës,* GJEDNJ nr.17056/06, §§ 93/ 2009).

49. Gjykata më tej vë në pah se paraqitja e paanësisë është e rëndësishme, në dritën e postulatit juridik se "drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por ajo duhet edhe të shihet që po bëhet". Ky është element qenësor i besimit që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ngjallin te publiku (shih, *Volkov kundër Ukrainës,* par. 106, aktgjykim i GJEDNJ-së 2013 dhe *De Cubber kundër Belgjikës*, 26 tetor 1984, § 26, Seria A nr. 86).

50. Pas vlerësimit të procedurave në tërësi, dhe posaçërisht nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Gjykata konstaton se mosadresimi, përkatësisht mungesa e paraqitjes së argumenteve juridike të qarta mbi pretendimet e parashtruesit përkitazi me çështjet thelbësore të procesit, përbëjnë një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimit.

51. Nga sa u argumentua më sipër si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (shih rastet KI72/12, KI135/14), Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës

Supreme me të cilin është refuzuar revizioni, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt].

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 maj 2017

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TA DEKLAROJË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015;

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË KËRKOJË nga Gjykata Supreme, në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së punës, të dorëzojë informacione në Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi të Gjykatës;

VI. TË MBETET e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Aktgjykimi;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IX. TË DEKLAROJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

Mendim mospajtues

i

gjyqtares Snezhana Botusharova

Rasti nr. KI 22/16

Parashtrues

Naser Husaj

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015

1. E respektoj vendimin e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: 'Shumica'). Megjithatë, nuk mund të pajtohem me konkluzionin përfundimtar dhe arsyetimin për shkak të disa lëshimeve.

2. Së pari, konsideroj se teksti i aktgjykimit nuk ka ndjekur kërkesat kushtetuese për pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës kishte shteruar mjetet juridike.

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në përbërje të Gjykatës së Apelit ishte një gjyqtar i cili duhej të ishte përjashtuar.

4. Ligji i zbatueshëm për çështjen e përjashtimit të gjyqtarëve është Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), Kapitulli III [Përjashtimi i Gjyqtarit nga Gjykimi]. Çështja është nëse parashtruesi mund të ketë kërkuar përjashtimin e një gjyqtari të Gjykatës së Apelit që kishte vendosur për ankesën e tij kundër vendimit të Gjykatës Themelore.

5. Kjo pyetje - nëse një kërkesë e tillë mund të ishte ngritur - nuk ishte adresuar nga Shumica, e cila shkoi drejtpërdrejt në gjetjen e një shkeljeje në baza të caktuara.

6. Konsideroj se çështja nëse parashtruesi i kërkesës mund ta kishte ditur përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së Apelit ka rëndësi të madhe për funksionimin e duhur, transparent dhe të parashikueshëm të gjyqësorit.

7. Nuk do të marr qëndrim në këtë, por dua të theksoj se Shumica duhej të kishte shtjelluar nëse ka ekzistuar një mënyrë që parashtruesi të kërkonte përjashtimin e një gjyqtari në kolegjin e Gjykatës së Apelit.

8. Nëse nuk kishte asnjë mënyrë për ta njoftuar kryesuesin e kolegjit (në lidhje me kërkesën për përjashtim), kjo do të thotë që Shumica duhej të kishte treguar se cili është mjeti tjetër që duhej të përdorej. Pa këtë analizë për të identifikuar nëse parashtruesi e ka plotësuar këtë kërkesë, nuk duhej të ishte bërë shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes.

9. Së dyti, shumica konstatoi shkelje sepse Gjykata Supreme nuk e kishte adresuar në mënyrë specifike ankesën e parashtruesit të kërkesës se në përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së Apelit ishte një gjyqtar me një konflikt të pretenduar interesi vis-à-vis atij vetë.

10. Vlen të theksohet se, në parim, edhe nëse mund të ketë një konflikt "potencial" të interesit me një nga gjyqtarët, Kolegji i Gjykatës së Apelit përbëhej nga tre gjyqtarë, secili prej tyre i pavarur, dhe aty mbeti një shumicë legjitime prej dy gjyqtarëve për të marrë vendimin në rastin e parashtruesit.

11. Pretendimi se gjyqtari për të cilin parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që të lirohej ka ndikuar në dy kolegët e tij në kolegj nuk është i argumentuar dhe është edhe ofendues.

12. Mendoj se Gjykata Supreme kishte arsyetuar me të drejtë në vendimin e saj që,

> "*Dispozitivi i aktgjykimit është i kjartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhëne arsye te plota dhe te mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.*"

13. Duke mos shtjelluar shterimin e mjeteve juridike dhe duke mos adresuar siç duhet se çfarë duhej të kishte arsyetuar Gjykata Supreme, konsideroj se qëndrimi i Shumicës është njësoj sikur të veprosh si gjykatë e shkallës së katërt.

Dorëzoi me respekt,

_____
Snezhana Botusharova
Gjyqtare

KI109/16, Parashtrues, Lumni Limaj, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së një vendimi ose akti të pacaktuar të një autoriteti publik.

KI109/16 Vendim për Refuzim të Kërkesës së 01 qershorit 2017, publikuar më 09 qershor 2017.

Fjalët kyçe*: Kërkesë individuale, kërkesë e paplotë.*

Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është babai biologjik i një fëmije dhe ai tregon se ai iu drejtua autoriteteve të ndryshme publike për të fituar qasje në këtë fëmijë, por pa sukses.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar në kërkesën e tij se cili akt konkret i një autoriteti publik pretendon se i ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Parashtruesi gjithashtu nuk ka specifikuar se cilat të drejta të tij kushtetuese pretendohet se janë shkelur. Gjykata kërkoi ng parashtruesin ta qartësojë kërkesën e tij, por parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kësaj kërkese.

Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar saktësisht, dhe nuk mund të merret në shqyrtim meqë nuk plotëson asnjë nga kushtet procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedure të shkurtër në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI109/16

Parashtrues

Lumni Limaj

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së një vendimi ose akti të pacaktuar të një autoriteti publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lumni Limaj, me banim në Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston ndonjë vendim apo akt të veçantë të një autoriteti publik, megjithëse ai i referohet në përgjithësi akteve të Qendrës për Punë Sociale në Prizren, Prokurorisë Publike në Prizren dhe Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilat pretendohet se atij nuk i është lejuar qasja në vajzën e tij biologjike.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike të lartpërmendura. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon asnjë të drejtë apo liri të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) që konsideron se është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 gusht 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI109/16, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI109/16 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 11 tetor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën kohë, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të qartësojë vendimin ose aktin e saktë të autoritetit publik të cilin ai e konteston, të sigurojë një kopje të vendimit ose aktit të kontestuar, të saktësojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij dhe të dorëzojë të gjitha informatat dhe dokumentet e tjera relevante që mbështesin kërkesën. Përveç kësaj, parashtruesit të kërkesës i është kërkuar që të paraqesë autorizimin për personin e përmendur në kërkesë si përfaqësues i tij. Parashtruesit të kërkesës iu kërkua të sigurojë këtë informatë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i letrës së Gjykatës.

8. Gjykata nuk mori asnjë përgjigje nga parashtruesi i kërkesës.

9. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për refuzimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është babai biologjik i një fëmije të lindur në vitin 2005. Emri i tij nuk paraqitet në certifikatën e lindjes.

11. Parashtruesi i kërkesës deklaron se ai është duke u përpjekur të fitojë qasje dhe/ose kujdestarinë për këtë fëmijë.

12. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai i është drejtuar Qendrës për Punë Sociale në Fushë Kosovë me kërkesën e tij për qasje dhe/ose kujdestarinë e fëmijës.

13. Me sa duket, parashtruesi i kërkesës filloi procedurat kontestimore në Gjykatën Themelore të Prizrenit, të regjistruar me numrin C. nr. 50/16-02.

14. Më 3 mars 2016, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Prizren vendosi t'i japë ndihmë juridike falas parashtruesit të kërkesës për përfaqësim ligjor në rastin C. nr. 50/16-02.

15. Më 3 mars 2016, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Prizren kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Çështje të Përgjithshme, që të heqë dorë nga kërkesa për të paguar taksat gjyqësore në rastin e parashtruesit të kërkesës C. nr. 50/16-02, sepse ai ishte përfitues i ndihmës juridike falas.

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se më 12 maj 2016, Prokuroria e Prizrenit mori vendim lidhur me parashtruesin e kërkesës dhe/ose pretendimet e tij.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i fundit në rastin e tij është marrë nga Qendra për Punë Sociale në Prizren.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se që nga fillimi i përpjekjeve të tij për të fituar qasje dhe/ose kujdestarinë e fëmijës së tij biologjik të pretenduar, të gjitha autoritetet publike të përfshira kanë shmangur ose penguar kërkesën e tij.

19. Parashtruesi kërkon zgjidhjen e kërkesës së tij për qasje dhe/ose kujdestarinë e fëmijës së tij biologjik.

Pranueshmëria kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

22. Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili saktëson se:

> "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj*."

23. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili, *inter alia,* parasheh se:

> *"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*
> *[...]*
> *(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor;*
> *[...]*
> *(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;*
> *(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe*
> *(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës."*

24. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka përmbushur asnjë nga kriteret e kërkuara me dispozitat e mësipërme të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës.

25. Gjykata veçanërisht vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë ndonjë informatë në lidhje me vendimin ose aktin konkret të një autoriteti publik me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e tij. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu nuk ka treguar se cila nga të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë pretendohet të jetë shkelur nga një autoritet publik.

26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka: (a) ofruar një autorizim të vlefshëm për përfaqësuesin e tij; (b) paraqitur ndonjë fakt apo të dhënë në lidhje me rastin e tij; (c) paraqitur ndonjë justifikim procedural ose substancial të kërkesës së tij; (d) dorëzuar

ndonjë informatë apo dokument mbështetës; dhe (e) shteruar ndonjë mjet juridik të paraparë me ligj.

27. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

> *"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtë në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".*

28. Gjykata rikujton se më 11 tetor 2016, parashtruesit i është kërkuar të japë informata të sakta në lidhje me pretendimet e tij dhe vendimet ose aktet e autoriteteve publike me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e tij. Përveç kësaj, parashtruesit të kërkesës i është kërkuar që të ofrojë autorizim për përfaqësuesin e tij, si dhe të dorëzojë dokumente në mbështetje të kërkesës së tij.

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kësaj kërkese.

30. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa në fjalë është e paplotë dhe nuk është e qartësuar saktësisht, përkundër kërkesës së Gjykatës drejtuar parashtruesit të kërkesës për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa nuk mund të merret në shqyrtim meqë nuk plotëson asnjë nga kushtet procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 116 të Kushtetutës dhe të rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI148/16, Parashtrues, Mitat Qovanaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014

KI148/16, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2017, publikuar më 9 qershor 2017.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, kërkesë e papranueshme*

Në vitin 1985, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori aktgjykimin me anë të të cilit konfirmoi pronësinë mbi parcelat e shpronësuara të parashtruesit dhe obligoi Komunën e Prizrenit që t'ia paguajë një shumë të hollave si kompensim.

Në vitin 2013, në Gjykatën Themelore në Prizren, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të vitit 1985. Gjykata Themelore në Prizren, refuzoi kërkesën për përmbarim me arsyetimin se ka kaluar afati i paraparë me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Pas ankesës së parashtruesit, Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin CP. nr. 1976/13, kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës sepse ai nuk kishte paguar taksën e kërkuar gjyqësore.

Parashtruesi pranë Gjykatës Kushtetuese kishte pretenduar se iu kishte shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse nuk ishte përmbaruar Aktgjykimi i vitit 1985.

Gjykata konstatoi se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme dhe e paafatshme, sepse ishte dorëzuar jashtë afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI148/16

Parashtrues

Mitat Qovanaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Mitat Qovanaj, me banim në Prizren (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Egzon Qovanaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 54 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

7. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

8. Më 6 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai informata nëse ka parashtruar ankesë kundër Aktvendimit CP. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014. Një kopje e kërkesës i është dërguar edhe Gjykatës Themelore në Prizren.

9. Më 16 mars 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument, duke deklaruar se nuk ka parashtruar ankesë kundër Aktvendimit CP. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014.

10. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës, i autorizuar nga babai i tij, parashtroi padi në Gjykatën e Qarkut në Prizren, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe kompensimin si rezultat i eksproprijimit të pronës në rajonin e Vërmicës.

12. Më 10 qershor 1985, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Cp. nr. 292/83) konfirmoi pronësinë mbi parcelat e shpronësuara dhe e obligoi Sekretariatin Federal për Hidro-ekonomi "Drini i Bardhë" (në tekstin e mëtejmë: i padituri) që t'i paguajë parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar të të hollave si kompensim. Kundër këtij vendimi, i padituri parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme.

13. Më 24 dhjetor 1985, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi ankesën e të padituri si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut, të 10 qershorit 1985.

14. Më 19 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C. nr. 292/83, të 10 qershorit 1985, në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

15. Më 24 mars 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi C. nr. 1976/13) e aprovoi kërkesën e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren të 10 qershorit 1985.

16. Më 8 prill 2014, Komuna e Prizrenit parashtroi prapësim kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Përveç kësaj, Komuna e Prizrenit arsyetoi kundërshtimin e saj, duke deklaruar se kërkesa për përmbarim ishte dorëzuar pas afatit të përcaktuar me ligj. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi përgjigje ndaj kundërshtimit të Komunës së Prizrenit.

17. Më 22 maj 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi Cp. nr. 1976/13): I. Aprovoi kundërshtimin e Komunës së Prizrenit si të bazuar; II. Refuzoi kërkesën e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të 10 qershorit 1985 si të pabazuar; dhe III. Shfuqizoi Aktvendimin Cp. nr. 1976/13, të 24 marsit 2014 dhe anuloi të gjitha veprimet lidhur me procedurën e përmbarimit.

18. Gjykata Themelore e bazoi vendimin e saj, duke iu referuar dispozitave të ligjeve në fuqi për procedurën e përmbarimit dhe marrëdhënieve të detyrimeve.

19. Gjykata Themelore konstatoi se: *"[...] po ashtu përkitazi me parashkrimin e kërkesave në procedurën e përmbarimit si në rastin konkret edhe në nenin 361 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) që i referohet kërkesave të vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente, thuhet: "Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim".*

20. Prandaj, Gjykata Themelore konkludoi se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi propozimin e tij për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të 10 qershorit 1985 pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 361, paragrafi 1 i LMD-së.

21. Më 3 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, të 22 majit 2014.

22. Më 29 gusht 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi Cp. nr. 1976/13) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, për shkak se ai nuk e kishte paguar taksën e kërkuar gjyqësore.

23. Me aktvendimin e sipërpërmendur të Gjykatës Themelore, të 29 gushtit 2014, ai ishte këshilluar në mënyrë të qartë: *"Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate".*

24. Bazuar në deklaratën e parashtruesit të kërkesës të dorëzuar në Gjykatë, më 16 mars 2017, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Cp. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 54 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me zgjatjen dhe mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 10 qershorit 1985, është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë.

26. Sa i përket Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Cp. nr. 1976/13, të 22 majit 2014, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Sipas praktikës së GJEDNJ-së, çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme, sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar, por duhet të realizohet edhe në praktikë (shih: Aktgjykimi KI129/11 i Gjykatës Kushtetuese, pjesë të cituara nga Gjykata e Strasburgut)".*

27. Parashtruesi më tej kërkon *"[...] që ta vërtetoj të drejtën time kushtetuese [Neni 46: Mbrojtja e Pronës], dhe të urdhëroj Kuvendin Komunal në Prizren - Drejtorinë për Punë Pronësore Juridike, përmbarimin e Aktgjykimit Cp. nr. 292/83 të datës 10.06.1985, respektivisht kompensimin e eksproprijimit të tokës, në vlerë prej 84.999.10 Euro, me kamatë ligjore 7, 5%, që do të llogaritet prej ditës së depozitimit me datën 11.11.1980, deri në pagimin përfundimtar"*.

28. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon: *"Përfundimisht, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese shqyrtimin e kërkesës sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, edhe pse kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit prej 4 muajsh [...]."*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe të parapara në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

31. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh që:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."*

32. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, me të cilin theksohet që:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose [...]"*.

33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014. Vendimi i fundit lidhur me çështjen e parashtruesit të kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Themelore, CP. nr. 1976/13, i 29 gushtit 2014, me të cilin ishte hedhur poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës, sepse ai nuk e kishte paguar taksën e kërkuar gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë, më 19 dhjetor 2016.

34. Sa i përket çështjes së afatit kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Sipas praktikës së GJEDNJ-së, çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme, sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar, por duhet të realizohet edhe në praktikë"*.
35. Lidhur me pretendimin e sipërpërmendur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet arsyetimit të Gjykatës Themelore, e cila në aktvendimin e saj konkludoi se

kërkesa e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, të 10 qershorit 1985 ishte parashkruar.

36. Për më tepër, Gjykata vëren se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore, të 22 majit 2014, parashtruesi i kërkesës ishte këshilluar në mënyrë të qartë të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit. Nga vendimi pasues i Gjykatës Themelore i 29 gushtit 2014 rezulton, se parashtruesi i kërkesës nuk ka paguar taksën e kërkuar gjyqësore për ankesën e tij.

37. Më pas, më 29 gusht 2014, Gjykata Themelore theksoi se kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës kishte pasur të drejtë të parashtrojë ankesë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të ushtrojë ankesë kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, të 29 gushtit 2014, por ai nuk e bëri këtë. Prandaj, dështimi i parashtruesit të kërkesës për të parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedurë të mëtejshme, e cila do të mund të adresonte thelbin e pretendimeve të tij.

38. Si përfundim, duke iu referuar faktit se vendimi i kontestuar ishte marrë më 22 maj 2014, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 19 dhjetor 2016, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

39. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar, që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).

40. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 maj 2017, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI34/17, Parashtrues: Valdete Daka, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr. 50/2017, të 6 marsit 2017

KI34/17, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, publikuar më 12 qershor 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pozita e Kryetarit të Gjykatës Supreme, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes*

Në këtë rast parashtruesja e kërkesës u ankua se e drejta e saj për zgjedhje ishte cenuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ngase nuk ishte emëruar në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme.

Gjykata konstatoi se mekanizmi i votimit i zbatuar nga KGJK-ja për kandidatët për emërimin e një kandidati ne pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, nuk ka parashikuar masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e mjaftueshëm të parimeve të barazisë, transparencës dhe hapjes gjatë procesit të votimit. Si rezultat i këtij procesi të votimit të gabuar dhe jo koherent, të gjithë kandidatet për Kryetar të Gjykatës Supreme, duke përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës, ishin vendosur në një pozitë të pasigurisë juridike, pabarazisë dhe përzgjedhjes se pameritуar. Gjykata konstatoi shkelje të neneve 24.1, 31.1 dhe 108.1 dhe 4 të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI34/17

Parashtrues

Valdete Daka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Valdete Daka (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson avokati Artan Qerkini nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" me qendër në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), KGJK nr. 50/2017 të 6 marsit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartcekur të KGJK-së, me të cilin, sipas parashtrueses së kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesja kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë dekretimin e z. Enver Peci në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme në pritje të vendimit të Gjykatës lidhur me kërkesën.

5. Parashtruesja gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të caktojë seancë dëgjimore në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 29, 54, 55 dhe 56 (1) (3) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 16 mars 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi.

9. Më 17 mars 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

10. Gjykata ftoi KGJK-në të paraqesë komentet e saj, nëse ka, deri më 23 mars 2017.

11. Më 23 mars 2017, KGJK-ja dorëzoi komentet e saj në Gjykatë**.**

12. Më 23 mars 2017, komentet e KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua që të paraqesë vërejtje shtesë deri më 5 prill 2017.

13. Më 27 mars 2017, gjyqtarja raportuese i rekomandoi Kolegjit shqyrtues vendosjen e masës së përkohshme, që ishte aprovuar nga Kolegji shqyrtues.

14. Të njëjtën datë, Gjykata vendosi njëzëri ta miratojë masën e përkohshme deri më 16 maj 2017.

15. Më 31 mars 2017, parashtruesja e plotësoi kërkesën e saj me ankesa shtesë.

16. Më 3 prill 2017, Gjykata e përcolli parashtresën e parashtrueses në KGJK dhe i ftoi ata të paraqesin komentet e tyre, nëse kanë, deri më 7 prill 2017.

17. Më 7 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj lidhur me plotësimin e kërkesës, si dhe disa komente shtesë.

18. Më 12 prill 2017, komentet shtesë të KGJK-së iu komunikuan parashtrueses së kërkesës dhe ajo u ftua të paraqesë ndonjë koment deri më 18 prill 2017.

19. Të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga KGJK-ja që të dorëzojë, jo më vonë se më 18 prill 2017 si në vijim: (i). Procesverbalin e mbledhjes së KGJK-së kur u votuan kandidatët për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; (ii). Dokumente tjera relevante të cilat KGJK-ja i konsideroi të kenë lidhje me tërë procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; dhe (iii). Sqarimi i kritereve për vlerësimin e meritave të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

20. Më 18 prill 2017, KGJK-ja paraqiti komentet e saj përfundimtare dhe dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

21. Më 2 maj 2017, Gjykata vendosi njëzëri të vazhdojë masën e përkohshme deri më 16 qershor 2017**.**

22. Më 1 qershor 2017, Gjykata aprovoi pranueshmërinë e kërkesës me shumicë dhe votoi me shumicë gjetjen e shkeljes.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 08 dhjetor 2016, KGJK-ja mori Vendimin KGJK nr. 152/2016 për shpalljen e pozitës së lirë të punës për Kryetar të Gjykatës Supreme.

24. Më 23 dhjetor 2016, ishte shpallur konkursi për këtë pozitë. Parashtruesja e kërkesës aplikoi në këtë konkurs dhe u regjistrua në rrethin e vlerësimit të kandidatëve.

25. Më 13 janar 2017, KGJK-ja caktoi Komisionin për Vlerësim dhe Intervistim për të shqyrtuar kandidatët.

26. Më 13 shkurt 2017, janë mbajtur intervistat dhe Komisioni vlerësoi kandidatët si në vijim:

5.	Valdete Daka	90 pikë
6.	Nesrin Lushta	87.3 pikë
7.	Enver Peci	85 pikë
8.	Erdogan Haxhibeqiri	83 pikë

27. Më 6 mars 2017, KGJK-ja, pas votimit të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, përfundoi si më poshtë:

- Në raundin e parë, znj. Valdete Daka u rendit e para në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte 5 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 4 ABSTENIME;

- Në raundin e dytë, znj. Nesrin Lushta renditet e dyta në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte 2 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 4 ABSTENIME; dhe

- Në raundin e tretë z. Enver Peci, i renditur i treti në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikave të Komisionit të Vlerësimit, kishte 6 vota PËR dhe 4 ABSTENIME.

28. Më 6 mars 2017, KGJK-ja pas tri raundeve të votimit, me Vendimin e saj KGJK nr. 50/2017, zgjodhi z. Enver Peci që të emërohet Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe dërguan nominimin e tyre te Presidenti i Republikës së Kosovës për emërimin e tij me dekret.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 108.4 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], nenit 24.2 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"Në procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ka pasur parregullsi të cilat reflektojnë në cenimin e të drejtave të parashrueses të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe atë, inter alia, të drejtën e përcaktuar në nenin 45, sipas të cilit secili qytetarë i Republikës së Kosovës ka të drejtën aktive (të drejtën të zgjedhë) dhe të drejtën pasive të votës (të drejtën për t'u zgjedhur)."*

31. Parashtruesja kërkon nga Gjykata që të vlerësojë *"a i është cenuar e drejta kushtetuese e garantuar me nenin 45, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si rezultat i zbatimit të gabuar të Rregullores së KGJK-së për përzgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës"*.

32. Parashtruesja e kërkesës deklaron se *"[...] nuk kërkon nga Gjykata Kushtetuese të deklarohet në lidhje me mënyrën e interpretimit të nenit 4 të Rregullores në fjalë..."*, por ajo, *"... kërkon të konstatojë se zbatimi i gabuar i saj, ka cenuar të drejtat kushtetuese të parashtrueses së kërkesës [...]"*.

33. Sipas parashtrueses së kërkesës bazuar në Rregulloren e përmendur më lart, KGJK-ja së pari votoi për kandidatin i cili ka pasur rezultatin më të mirë të vlerësimit, në rastin konkret, KGJK-ja ka votuar për të. Në atë votim, 5 (pesë) anëtarë votuan "PËR" zgjedhjen e saj, 4 (katër) anëtarë "ABSTENUAN", ndërsa 1 (një) anëtar kishte votuar "KUNDËR".

34. Në vijim ajo deklaron se, "*sipas vlerësimit të KGJK-së kandidatja e parë nuk ka marrë shumicën e thjeshtë të votave, prandaj është vazhduar me procedurën e votimit për dy kandidatët e mbetur. Kandidati i renditur si i treti, z. Enver Peci, pas votimit të anëtarëve të KGJK-së ka marrë 6 vota "PËR" dhe 4 vota "KUNDËR"*.

35. Parashtruesja e kërkesës vlerëson se "*Përfundimisht sipas vlerësimit të KGJK-së z. Enver Peci është propozuar për përzgjedhje në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas mënyrës së përshkruar më lartë. Vlen të potencohet se lista për përzgjedhjen e kandidatëve ka karakter shterues, çka do të thotë se në rastin kur kandidati i parë merr shumicën e thjeshtë të votave, votimi përfundon dhe për kandidatët e tjerë nuk votohet fare"*.

36. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"procedura e përzgjedhjes është përfshirë në shkelje të paragrafit 2 të nenit 8 të Rregullores Nr. 9/2016, të riformuluar me nenin 4 të Rregullores Nr. 14/2016 të KGJK-së"*.

37. Parashtruesja e kërkesës thekson se *"në asnjë rast abstenimi nuk mund të* konsiderohet *si votë negative apo kundër sepse atë efekt e ka vota KUNDËR dhe nuk mund të barazohet vota abstenim dhe kundër. Abstenimi nënkupton vullnetin e anëtarëve për ta krijuar kuorumin dhe mundësimin e zhvillimit te procedurës, për mos-pjesëmarrje në votim dhe pajtim me vendimin e anëtarëve tjerë."*

38. Ajo më tutje vlerëson se "*fokusi duhet përqendruar te interpretimi juridik dhe logjik i shprehjes së vullnetit të KGJK-së si organ kolegjial i vendimmarrjes. Në rastin konkret, gjatë votimit 5 (pesë) anëtarë kanë shprehur vullnetin PËR përzgjedhjes së kandidates ndërsa vetëm 1 (një) votë ka qenë KUNDËR, andaj duhet të shtrohet pyetja se mbi çfarë logjike është ardhur deri te konstatimi se KGJK ka shprehur vullnetin kundër kandidaturës së kandidates Valdete Daka"*.

39. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, "*Në Vendimin e datës 6 mars 2017, KGJK nuk u pajtua me standardet kushtetuese për propozimin e gjyqtarëve në pozitën udhëheqëse në sistemin gjyqësor të Kosovës. Norma kushtetuese kërkon që emërimi, gjegjësisht propozimi i KGJK-së duhet të bëhet në bazë të meritës së kandidatëve, derisa Vendimi 50/2017 i KGJK-së nuk përmban asnjë arsyetim pse z. Enver Peci ka meritat e mjaftueshme për t'u propozuar për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës edhe pa marrë parasysh faktin se në vendim thuhet se* ***ai ishte renditur i treti (3) në listën e kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme****. Nëse do të respektoheshin standardet kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve në pozita*

udhëheqëse, KGJK-ja duhet të ketë dhënë arsye të hollësishme mbi meritat e z. Enver Peci, i cili do të justifikonte propozimin e KGJK-së për dekretimin e tij në pozitën e lartpërmendur".

40. Parashtruesja e kërkesës më tej deklaron se *"me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk kanë zbatuar standardet e parapara në nenin 108.4 të Kushtetutës. Mund të vërehet qartë që Rregullorja 14/2016 e KGJK-së për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave nuk i aplikon kërkesat sipas Kushtetutës. Në një situatë të tillë, duhet të marrim parasysh hierarkinë e akteve gjyqësore, ku Kushtetuta mbizotëron çdo akt tjetër ligjor që është në kundërshtim me të".*

41. Parashtruesja e kërkesës konsideron se *"me rastin e propozimeve për dekretim të gjyqtarëve për rolet udhëheqëse, në bazë të dispozitave kushtetuese, KGJK-ja duhet të marrë parasysh se ky autoritet shtetëror do të ndihmojë dukshëm Presidentin e Republikës, para se të dekretojë kandidatin për Kryetar të Gjykatës Supreme, për të pasur një pasqyrë të qartë, një vlerësim të vërtetë dhe të ftohtë të meritave, kritere objektive dhe subjektive dhe në fund, që të sigurojë kandidaturën më të plotë, me një mbështetje të gjerë".*

42. Lidhur me çështjen e shterjes së mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës deklaroi se "*Për të mbështetur qëndrimet juridike të shprehura më lartë parashtruesja e kërkesës i referohet Praktikës së Gjykatës Kushtetuese të krijuar nëpërmjet Aktgjykimit Nr. KI99/14 dhe KI100/4, Parashtrues Shyqri Syla dhe Laura Pula, në të cilin Gjykata Kushtetuese në mes tjerash shprehet: "Megjithatë, Gjykata vëren se edhe në qoftë se ka mjete juridike. në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marr parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur. Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim".*

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Parashtruesja kërkon vendosjen e masës së përkohshme në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit dhe rregullit 54 të Rregullores së punës.

44. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"zbatimi i vendimit të KGJK-së, që përmban në vete një mori shkeljesh të të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë, do të ishte në vetvete edhe një cenim i mëtutjeshëm i të drejtave të garantuara. Vet zbatimi i këtij vendimi antikushtetues do të privonte ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e funksionimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të gjitha vendimet e marra nën drejtimin e z. Enver Peci do të mund të shpalleshin si të kundërligjshme, fakt ky i cili cenon parimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës. Nëse një aktgjykim në dobinë time nga Gjykata Kushtetuese do të qonte në zgjedhjen time për Kryetare të Gjykatës Supreme të Kosovës, vendimet unifikuese të Gjykatës Supreme të marra nën drejtimin e z. Peci, e të cilat merren me qëllim të zbatimit unik të ligjeve, do të konsideroheshin si të pavlefshme".*

Komentet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

45. KGJK-ja *"thekson se kërkesa e parashtruar është e papranueshme për shkak të faktit se parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar për ngritjen e kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese.*
[...]
Vendimi i KGJK-së është një akt administrativ dhe si i tillë, një konflikt administrativ mund të ngrihet kundër tij në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për

Çështje Administrative. Parashtruesja e kërkesës mund ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar ato".

46. Në mbledhjen e 6 marsit 2017, pas votimit lidhur me këtë çështje, Këshilli Gjyqësor i Kosovës arriti në përfundimin si më poshtë: "...

- *Në raundin e parë,* ***znj. Valdete Daka*** *e renditur e para sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte* ***5 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 4 ABSTENIME;***

- *Në raundin e dytë,* ***znj. Nesrin Lushta*** *e renditur e dyta në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikëve të Komisionit Vlerësues, kishte* ***2 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 4 ABSTENIME****; dhe*

- *Në raundin e tretë* ***z. Enver Peci****, i renditur i treti në listë sipas pikëve të fituara në bazë të mesatares së pikave të Komisionit të Vlerësimit, kishte* ***6 vota PËR dhe 4 ABSTENIME".***

47. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 4 të Rregullores nr. 14/2016 për ndryshimin e nenit 8 të Rregullores 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Monitorues, KGJK-ja thekson që: ***"VOTA E ABSTENIMIT*** *është një institut procedural që është përdorur nga pothuajse të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kur votojnë për raste të caktuara. Pretendimi se ky institut nuk rregullohet me ligj apo rregullore nuk do të konsiderohet si çështje kontestuese sepse nuk mund të gjejmë një rregullore të tillë për votimin* ***PËR*** *dhe* ***KUNDËR****. Si rregull, kjo çështje nuk është e rregulluar me vendosmëri nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por gjatë nxjerrjes së vendimeve ky institucion përdor vota PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM dhe asnjë vendim nuk është kontestuar asnjëherë si rezultat i këtij votimi".*

48. Në përgjigje ndaj shkeljes së pretenduar të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, KGJK-ja konsideron se: *"[...] kjo dispozitë ligjore është e detyrueshme për t'u zbatuar për të gjithë kandidatët, ku në këtë rast KGJK-ja në mënyrë të pavarur dhe të paanshme e ka zbatuar atë".*

49. KGJK-ja më tutje kërkon nga Gjykata të hedh poshtë kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme dhe për dëgjim publik.

50. KGJK-ja gjithashtu konsideron se "*...në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk është i zbatueshëm standardi kushtetues nga neni 108, paragrafi 4 i Kushtetutës së Kosovës, me vetë zhvillimin e procedurës paraprake pranë Komisionit Vlerësues, i cili ka bërë vlerësimin edhe në bazë të meritave personale, konsiderojmë që në këtë proces është zbatuar edhe parimi i meritokracisë në këtë procedurë konkrete. Duhet pasur parasysh se KGJK-ja në cilësinë e organit kolegjial i cili sipas Kushtetutës përbëhet prej 13 anëtarëve, vendimmarrja në këtë organ kolektiv konsiston në diskrecionin e anëtarëve të këtij organi të cilin e shprehin përmes procesit të votimit duke u bazuar në procedurat të rregulluara sipas aktit të brendshëm të organit gjegjës por edhe sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës".*

51. Përveç kësaj, KGJK-ja deklaron se "*[...] Neni 24.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se Askush nuk mund të diskriminohet në baza të gjinisë ....", megjithatë kjo dispozitë nuk ka përcaktuar asnjë të drejt të asnjë personi që duke u*

thirur në një të drejt të tillë të krijoj rezultat pozitiv për veten e tij. Për më tepër nisur nga parimi i nenit 3, Barazia para ligjit konsiston në të drejtën e qytetarëve që të mos diskriminohen në kuptimin e gëzimit të të drejtave dhe lirive ku secili duhet të gëzoj mbrojtje të njëjtë me kushte të njëjta pa marr parasysh dallimet ndërmjet njerëzve".

52. Në fund, KGJK-ja konsideron që "ë*shtë evidente që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kryer ndonjë lëshim formal dhe procedural që do ta bënte procesin e propozimit të kandidatit më të përshtatshëm për pozitën e Gjykatës Supreme të Kosovës, të joadekuat, të pavlefshëm ose ligjërisht të papërshtatshëm".*

Komentet shtesë të parashtrueses së kërkesës

53. Parashtruesja e kërkesës ka komentuar se: *"Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton së paku dy komponentë të cilët do të shërbejnë si udhëzues për KGJK-në në lidhje me propozimet e këtij institucioni që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve në pozitat udhëheqëse në gjyqësorin e Kosovës . Këta komponentë janë: **meritat e kandidatit** dhe barazia gjinore dhe etnike në mes të kandidatëve".*

54. Sa i përket arsyetimit të Vendimit të KGJK-së lidhur me meritat e kandidatëve, parashtruesja e kërkesës komentoi se: "*në Vendimin e datës 6 mars 2017, KGJK nuk veproi në pajtim me standardet kushtetuese për propozimin e gjyqtarëve në pozita udhëheqëse në sistemin gjyqësor të Kosovës. Norma kushtetuese kërkon që emërimi, gjegjësisht propozimi i KGJK-së duhet të bëhet në bazë të meritës së kandidatëve, derisa Vendimi 50/2017 i KGJK-së nuk përmban asnjë arsyetim pse z. Enver Peci ka meritat e mjaftueshme për t'u propozuar për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës edhe pa marrë parasysh faktin se në vendim vërehet se **ai ishte renditur i treti (3) në listën e kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme**. Nëse do të respektoheshin standardet kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve në pozita udhëheqëse, KGJK duhet të ketë dhënë arsye të hollësishme mbi meritat e z. Enver Peci, i cili do të justifikonte propozimin e KGJK-së për dekretimin e tij në pozitën e lartpërmendur".*

55. Sa i përket respektimit të Kushtetutës nga KGJK-ja gjatë zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme, parashtruesja e kërkesës komentoi se: "*me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, [KGJK] nuk ka zbatuar standardet e parapara në nenin 108.4 të Kushtetutës. Mund të vërehet qartë që Rregullorja 14/2016 e KGJK-së për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave nuk i aplikon kërkesat sipas Kushtetutës. Në një situatë të tillë, duhet të marrim parasysh hierarkinë e akteve ligjore, ku Kushtetuta mbizotëron çdo akt tjetër ligjor që është në kundërshtim me të".*

56. Sa i përket zbatimit të nenit 31 të Kushtetutës për rastin e saj, parashtruesja e kërkesës komentoi që: *"Dështimi për të aplikuar normat kushtetuese në emërimin e kandidatit për kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, bën që i gjithë procesi i zgjedhjes të jetë i pavlefshëm dhe i parregullt, neni 31 i Kushtetutës së Kosovës, garanton [...] mbrojtje të barabartë të të drejtave, para gjykatave dhe autoriteteve tjera shtetërore, siç është në të vërtetë KGJK-ja. Prandaj, nuk ka dilemë që efektet e nenit 31 të Kushtetutës janë përtej procedurës gjyqësore".*

57. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës i referohet Opinionit Nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) ku theksohet se procedurat për emërimin e kryetarëve të gjykatave duhet të ndjekin të njëjtën rrugë si ato të përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve duke marrë parasysh meritat dhe përvojën gjyqësore të kandidatëve.

Përgjigja e KGJK-së ndaj komenteve shtesë të dorëzuara nga parashtruesja e kërkesës

58. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës sipas nenit 108 (4) të Kushtetutës, KGJK komentoi se: *"Teksti kushtetues i sipërpërmendur krijon disa premisa të përgjithshme dhe standarde kushtetuese, mbi të cilat duhet të bazohen propozimet për emërimin e gjyqtarëve. Këto parime dhe standarde duhet të shërbejnë si parime udhëzuese gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve që do të emërohen në pozitat e larta gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vazhdimisht ka ofruar mbështetje dhe ka afirmuar këto standarde kushtetuese dhe janë këto standarde që kanë udhëhequr çdo proces të rekrutimit për pozita gjyqësore. Megjithatë, dispozita e lartpërmendur nuk i referohet fare procesit të propozimit ose emërimit të kandidatëve për pozitën e kryetarëve të gjykatave, dhe as për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës në veçanti"*.

59. KGJK-ja pohon që neni 103 (4) [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 22 [Emërimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës] të Ligjit (Nr. 03/L-223) për KGJK-në është respektuar plotësisht në procesin zgjedhor të Kryetarit të Gjykatës Supreme. Në lidhje me këtë, KGJK-ja komentoi se: *"Në dritën e këtyre dy dispozitave ligjore përkatëse, ne konsiderojmë se duhet të ndërtohet një proces i tërë i propozimit dhe emërimit të kandidatëve për Kryetarin e Gjykatës Supreme. Sa i përket dispozitës së parë ligjore, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i referohet Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht nenit 103 (4) të saj, i cili përcakton që kandidati për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të jetë nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Përveç kësaj, paragrafi 2 i këtij neni përcakton si në vijim: "Kryetarët e Gjykatave emërohen nga Këshilli në konsultim me gjyqtarët e gjykatave përkatëse. Në emërimin e Kryetarëve të Gjykatave, Këshilli do të marrë në konsiderim trajnimin e specializuar menaxherial apo përvojën". Nga dispozita ligjore në fjalë mund të shihet qartë se procesi i emërimit të gjyqtarëve të kryetarëve të gjykatave nuk është një proces i izoluar plotësisht i varur nga procesi i intervistimit ose testimit. Dispozita e lartpërmendur instalon një proces të konsultimit, nëpërmjet marrjes së mendimeve të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse kur propozon ose emëron këta kryetarë të gjykatave"*.

60. Sa i përket vlerësimit të meritave të kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, KGJK-ja, komentoi se: *"[...] Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kryer me sukses obligimin e tij ligjor me dhënien e propozimeve për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Përveç kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas dhënies së propozimeve për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjithashtu ka marrë parasysh kërkesën e dytë ligjore, përkatësisht trajnimin e posaçëm menaxherial ose përvojën e punës. Për këtë qëllim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konsideroi se kandidati i propozuar ka specializimin e kërkuar dhe përvojën adekuate menaxheriale në mënyrë që të mbajë pozitën më të lartë gjyqësore në Kosovë"*.

61. Sa i përket referencës së parashtrueses së kërkesës në Opinionin nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, KGJK-ja komentoi se: *"Duke iu referuar referencës [...] në Opinionin nr. 19 (2016) të Këshilli Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë që shërben si organ i Këshillit të Evropës, organizatë anëtare e të cilit nuk është Republika e Kosovës, ne konsiderojmë si të pranueshëm dhe të qartë ekzistencën e këtyre standardeve të njohura ndërkombëtare në këtë fushë, por ato në asnjë mënyrë të drejtpërdrejtë nuk janë të zbatueshme në kontekstin specifik të Kosovës dhe për këtë arsye, përderisa dokumentet e tilla nuk përbëjnë një instrument të detyrueshëm sipas ligjeve pozitive, ne e konsiderojmë si të parëndësishme referencën e bërë ndaj këtyre standardeve"*.

62. Përfundimisht, KGJK-ja parashtroi se, në bazë të nenit 20 paragrafi 2 i Ligjit për KGJK-në (nr. 03 / L-223), gjyqtarët e Gjykatës Supreme janë konsultuar në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhanë mendime për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Znj. Valdete Daka 1 (një) mendim pozitiv;

2. Znj. Nesrin Lushta 4 (katër) mendime pozitive;

3. Z. Enver Peci 4 (katër) mendime pozitive;

4. Z. Erdogan Haxhibeqiri 3 (tri) mendime pozitive.

Dispozitat relevante kushtetuese, ligjore dhe dispozita tjera

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

[...]

4. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve te Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.

Ligji Nr. 03 / L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Neni 22
Emërimi i Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës

1. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës do të emërohet siç ceket në nenin 103 (4) të Kushtetutës.

Rregullorja nr. 14/2016 e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Neni 4

"Këshilli Gjyqësor voton në mënyrë të fshehtë dhe kandidati që merr shumicën e thjeshtë të votave konsiderohet si i përzgjedhur për pozitën e kryetarit të gjykatës".

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale???

Neni 48
Votimi

"48.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit".

Pikat 37 dhe 38 të Opinionit nr. 19 (2016) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE)

"*37. Mënyra e përzgjedhjes, emërimit ose zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave në shtetet anëtare varet nga përgjigjet e pyetësorit. Këto procedura ndikohen nga sistemi ekzistues i administratës gjyqësore dhe roli i kryetarëve të gjykatave. Në*

disa sisteme, kryetarët emërohen ose promovohen nga gjyqtarët, ndërsa të tjerët lejojnë që emërimet ose zgjedhjet të bëhen nga jashtë. Në rastin e parë, merren parasysh meritat e kandidatit, si dhe përvoja e tij/saj gjyqësore".

"38. KKGJE konsideron se procedurat për emërimin e kryetarëve të gjykatave duhet të ndjekin të njëjtën rrugë si ato për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve. Kjo do të përfshijë një proces vlerësimi të kandidatëve dhe një organi që ka autoritetin për të zgjedhur dhe/ose emëruar gjyqtarët në pajtim me standardet e vendosura në Rekomandimin CM/Rec (2010) 12 dhe Opinionet e mëparshme të KKGJE17".

Vlerësimi i pranueshmërisë

63. Gjykata së pari do të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

65. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës.

66. Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin që:

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
Afatet

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht."

67. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose
c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar."

68. Sa i përket kërkesave të përcaktuara në nenin 113 (7) të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë të detyruar të shterojnë vetëm mjetet juridike që janë të qasshme, për të siguruar kompensim në lidhje me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. Prandaj, baza e mjetit juridik në të drejtën vendore duhet të jetë e qartë (Shih ndër të tjera Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 28 korrikut 1997, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, paragrafi 74)

69. Gjykata vëren se dispozitat e Ligjit në fuqi, Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk parashohin mjete juridike kundër vendimit të kontestuar nga parashtruesja e kërkesës.

70. Gjykata vëren se KGJK-ja ka parashtruar se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka mundur të iniciojë konflikt administrativ dhe të përdorë mjetet juridike në dispozicion të saj sipas Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Sidoqoftë, KGJK-ja nuk e mbështeti atë pohim me praktikën gjyqësore përkatëse, në raste të krahasueshme, ku shihet se parashtruesja e kërkesës do të kishte perspektivë të arsyeshme për sukses në rast se ajo do të kishte zgjedhur të inicionte një konflikt administrativ.

71. Sa i përket çështjes së shterjes së mjeteve juridike, në raste të krahasueshme, Gjykata përsërit gjetjet e saj në Aktgjykimin në rastet KI99/14 dhe KI100/14: "*Megjithatë. Gjykata vëren se. edhe ne qofte se ka mjete juridike në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marr parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shtjerrim"* (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI99/14 dhe KI100/14, Parashtrues të kërkesës Shyqyri Syla dhe Laura Pula, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes se Kryeprokurorit te Shtetit,* Aktgjykim i 8 korrikut 2014, në paragrafin 50*)*.

72. Për më tepër, në rastet në të cilat mjeti juridik i sugjeruar në të vërtetë nuk ofronte gjasa të arsyeshme për sukses, p.sh. nga pikëpamja e praktikës së vendosur gjyqësore vendore, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar atë nuk është pengesë për pranueshmëri (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI56/09, *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit të Komunës së Prizrenit*, Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010, në paragrafin 45 me referenca të mëtejshme).

73. Duke marrë parasysh specifikën e procedurës së zgjedhjeve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit se nuk ka mjet juridik që adreson në mënyrë efektive pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës.

74. Sa i përket afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, Gjykata konsideron se, kur është e qartë që në fillim se parashtruesi i kërkesës nuk ka mjet juridik efektiv, periudha katër mujore fillon nga data e aktit për të cilin është bërë ankesa ose data në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte prekur drejtpërdrejt ose u bë i vetëdijshëm për një akt të tillë ose kishte njohuri për efektet e tij të padëshiruara (*Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], § 157).

75. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses është dorëzuar në pajtim me afatin ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

76. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka specifikuar me saktësi se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, janë shkelur në dëmin e saj, me

jokushtetutshmërinë e pretenduar të procedurave të votimit për nominimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme.

77. Pas ekzaminimit të ankesave dhe vëzhgimeve të parashtrueses së kërkesës, si dhe komenteve të KGJK-së, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet te varet nga shqyrtimi i meritave. Prandaj, kërkesa nuk mundet të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (Shih, për shembull, Rasti *A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55 dhe gjithashtu shih *mutatis mutandis* Rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit,* Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

Meritat e kërkesës

78. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], dhe 108. 4 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës.

79. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
>
> *2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
>
> *3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".*

80. Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> "1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".*

81. Gjykata i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.*
>
> *2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë".*
>
> *3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike"*

82. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 108 [Këshillit Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, i cili ndër të tjera përcakton se:

> *"1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.*
>
> *2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
>
> *[...]*
>
> *4. Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të jurisdiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.*

83. Gjykata vëren se i takon vetë asaj të karakterizojë faktet e rastit *vis-a-vis* normave kushtetuese dhe se atë nuk e obligon karakterizimi i bërë nga parashtruesja e kërkesës apo nga KGJK-ja (Shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO73/16, parashtruesi i kërkesës Avokati i Popullit, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative Nr. 1/2016 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës më 21 janar 2016*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 78 me referenca të mëtejshme).

84. Në lidhje me nenin 24 (1) të Kushtetutës, Gjykata rikujton që "*të gjithë janë të barabartë para ligjit*". Gjykata konsideron se kjo nënkupton që parimet e përgjithshme të barazisë së trajtimit zbatohen për të gjitha veprimet e autoriteteve publike në marrëdhëniet e tyre me individët.

85. Ky parim është përcaktuar më saktësisht në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, i cili kërkon që të gjitha autoritetet publike në procedurat e tyre duhet të garantojnë mbrojtjen e barabartë të të drejtave të individëve.

86. Për më tepër, Gjykata rikujton që neni 108 (1) i Kushtetutës e detyron KGJK-në të garantojë funksionimin e pavarur dhe të paanshëm të sistemit gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se cilësia e procedurave të vendimmarrjes brenda KGJK-së gjithashtu duhet të bazohet në parimet e pavarësisë dhe të paanësisë, si parakusht për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë si tërësi.

87. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që neni 108 (4) i Kushtetutës kërkon që propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bazohen, *inter alia*, në meritë të kandidatëve.

88. Gjykata vëren se parimi i meritokracisë është i lidhur ngushtë me parimin e barazisë para ligjit, mbrojtjen e barabartë të të drejtave, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e hapjes.

89. Në procesin e përzgjedhjes siç është zbatuar nga KGJK-ja, secili nga kandidatët për emërim si Kryetar i Gjykatës Supreme është vlerësuar sipas kritereve të bazuara në meritë për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për këtë pozitë. Bazuar në informatat e dhëna në Gjykatë duket se katër kandidatët janë vlerësuar të kenë merita të

mjaftueshme për këtë pozitë, duke qenë se secili nga kandidatët ka arritur një rezultat prej së paku 80 pikëve. Megjithëse as parashtruesja e kërkesës, dhe as KGJK-ja nuk kanë treguar domethënien e saktë të këtyre rezultateve, duke pasur parasysh se, në parim, të katër kandidatët u pranuan në procesin e votimit, Gjykata vëren se KGJK-ja konsideroi se secili prej kandidatëve ka merita të mjaftueshme për t'u kualifikuar për këtë pozitë.

90. Si e tillë, çështja themelore në lidhje me meritat e secilit kandidat për t'u kualifikuar për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk është një çështje që ka pasur qëllim të adresohej me votim, pasi kjo tashmë ishte adresuar në procesin e vlerësimit paraprak. Procesi i votimit kishte për qëllim të zgjidhte një kandidat nga katër kandidatët e kualifikuar mjaftueshëm.

91. Gjykata rikujton se në procesin e votimit, aspekt themelor i parimit të "*barazisë*" është që çdo kandidat do të përfitojë nga "*barazia e mundësive*". Kjo do të thotë që të gjithë kandidatët do të kenë mundësinë të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

92. Përveç kësaj, sipas "*parimit të përgjithshëm të barazisë*", Gjykata duhet të vlerësojë në bazë të testit të proporcionalitetit nëse parashtruesja e kërkesës/ kandidatët janë vënë në pozitë të barabartë gjatë procesit të votimit për zgjedhjen e kandidatit për nominim si Kryetar të Gjykatës Supreme.

93. Gjykata është në dijeni të lirisë së vlerësimit të KGJK-së në votimin e kandidatit që ata e konsiderojnë më të përshtatshëm për të marrë pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Megjithatë, kjo liri nuk është absolute dhe nuk mund të konsiderohet të jetë aq e gjerë sa të shpërfillë parimet e drejtësisë dhe barazisë në procesin e votimit.

94. Gjykata shqyrton "procedurat në tërësi", që do të thotë se i tërë procesi i votimit shqyrtohet për nga respektimi i parimeve të barazisë dhe drejtësisë. Në këtë mënyrë, Gjykata rishikon cilësinë themelore të procesit të votimit në tërësinë e tij për sa i përket të gjithë kandidatëve, dhe jo vetëm sa i përket parashtrueses së kërkesës në mënyrë të veçantë. Gjykata konsideron se votimi nënkupton "zgjedhjen midis alternativave", dhe abstenimi nënkupton "mos pjesëmarrje në procesin e votimit".

95. Gjykata vëren se në procesin e votimit të zbatuar nga KGJK-ja, në fakt, nuk kishte zgjedhje midis alternativave, sepse secili kandidat u votua veçmas. Vetëm pas refuzimit të një kandidati, kandidati i ardhshëm merrej në konsiderim dhe votohej. Duke pasur parasysh se u përzgjodh kandidati i tretë që u votua, kandidati i katërt nuk u votua fare.

96. Përveç kësaj, në çdo raund të votimit, secili prej votuesve kishte pasur prapë mundësinë të votonte për ose kundër kandidatit që votohej. Në fakt, secili anëtar që voton i KGJK-së ka mundur të mos bëjë asnjë zgjedhje, sepse kur shikohet procedura e përgjithshme, bëhet e qartë se secili anëtarë që voton i KGJK-së ka mundur të votojë për të gjithë kandidatët, ose ka mundur të votojë kundër të gjithë kandidatëve.

97. Sa i përket abstenimit, Gjykata vëren se procesi mundësoi që anëtarët që votojnë të KGJK-së jo vetëm që kanë mundur ta bëjnë, por edhe abstenuan në mënyrë selektive; me fjalë të tjera, në vend që të abstenojnë nga pjesëmarrja në procesin e votimit në tërësi, anëtarët që votojnë të KGJK-së zgjodhën të marrin pjesë në votimin e një kandidati dhe të mos marrin pjesë në votimin e një kandidati tjetër, me sa duket në mënyrë arbitrare.

98. Përveç kësaj, Gjykata konsideron që edhe në rastet kur zbatohet vota e abstenimit, autoriteti publik ka për detyrë që në mënyrë të qartë të rregullojë kuptimin dhe vlerën e votës abstenuese. Dështimi në parashikimin e votës abstenuese dhe dështimi për të

parashikuar efektin e saj në procesin e votimit krijon pasiguri juridike sepse pengon parimet e hapjes dhe parashikueshmërisë.

99. Në këto rrethana, Gjykata vëren se forma aktuale e rregullimit të procesit të votimit nuk u ofron "mundësi të barabarta" kandidatëve, sepse procesi nuk parasheh mekanizma mbrojtës procedural në lidhje me garantimin e trajtimit të barabartë.

100. Pabarazia nuk bazohet në ndonjë cilësi të veçantë të kandidatëve, por në procedurë substancialisht të padrejtë të votimit që u mundëson anëtarëve që votojnë të KGJK-së të votojnë shumë herë dhe të abstenojnë në mënyrë selektive për kandidat.

101. Pozita e lirë e Kryetarit të Gjykatës Supreme është vetëm një konkurs. Vetëm një nga kandidatët mund të emërohet në këtë pozitë. Secili votues duhet të jetë në gjendje të japë votën e vet për një kandidat, jo për dy, tre ose më shumë kandidatë. Procesi i votimit është një proces i vetëm, dhe secilit anëtar që voton i KGJK-së duhet t'i mundësohet ose të marrë pjesë ose të abstenojë - gjithçka ose asgjë.

102. Gjykata konsideron se procesi i votimit i kryer nga KGJK-ja përbën padrejtësi në procedurën e votimit sepse është e pamundur të dihet se kush është duke marrë pjesë në votim dhe kush jo. Në të njëjtën kohë është e pamundur të dihet se kush ka në fakt mbështetjen e shumicës së anëtarëve që votojnë të KGJK-së dhe kush nuk e ka.

103. Prandaj, Gjykata konsideron se pabarazia në procesin e votimit nuk siguron që të gjithë kandidatët të përfitojnë nga barazia para ligjit, siç garantohet me nenin 24 (1) të Kushtetutës, dhe nga mbrojtja e barabartë e të drejtave e garantuar me nenin 31 (1) të Kushtetutës. Si pasojë e këtyre pabarazive, Gjykata konsideron se KGJK-ja nuk ka vepruar në pajtueshmëri me detyrimet e saj kushtetuese për të siguruar pavarësi dhe paanshmëri të sistemit gjyqësor, dhe për të miratuar propozime për emërime në sistemin gjyqësor në bazë të meritave, siç kërkohet me nenin 108, paragrafët 1 dhe 4 të Kushtetutës.

104. Në bazë të shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata konstaton se procesi i votimit për nominimin e kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme është i papajtueshëm me nenin 24 (1) [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës. Gjykata konsideron se procesi i votimit nuk ofron garanci të mjaftueshme procedurale për të mbrojtur barazinë e kandidatëve gjatë tij, dhe si i tillë, dëmton perceptimin publik për pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit të drejtësisë të cilën KGJK-ja kërkohet ta sigurojë.

105. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se edhe forma e emërimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të konsiderohet të jetë në pajtim me parimet e hapjes, meritokracisë dhe parashikueshmërisë. Ajo ka ndikim në pavarësinë dhe paanshmërinë në tërë administratën e drejtësisë në Kosovë dhe ndikon në besimin që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 tetorit 2009, *Micallef kundër Maltës*, [DHM], kërkesa nr. 17056/06, paragrafi 99 dhe referencat e përmendura aty).

106. Prandaj, Gjykata konkludon se KGJK-ja duhet të mbajë proces të ri të votimit që nga kandidatët të zgjedhë kandidatin për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Ky votim i ri duhet të jetë në përputhje me konstatimet e kësaj Gjykate dhe në harmoni me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

107. Pasi konstatoi se procesi i votimit i kryer nga KGJK-ja në përzgjedhjen e kandidatit për Kryetar të Gjykatës Supreme nuk ishte në pajtim me nenet 24 (1) [Barazia para Ligjit]

dhe 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, Gjykata e konsideron te panevojshme që ta shqyrtojë pretendimin e rastin e parashtruesit në lidhje me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Kërkesa e parashtrueses për të mbajtur shqyrtim verbal

108. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për të mbajtur seancë verbale, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit, i cili, ndër të tjera, parasheh që:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal*
>
> *2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".*

109. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në këtë rast sipas formulimit të nenit 20 paragrafi 2 i Ligjit.

110. Prandaj, kërkesa e parashtrueses për të mbajtur seancë gojore refuzohet.

Përfundim

111. Në përfundim, Gjykata konstaton se mekanizmi i votimit i zbatuar nga KGJK-ja për kandidatët për emërimin e një kandidati në pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, nuk ka parashikuar masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e mjaftueshëm të parimeve të barazisë, transparencës dhe hapjes dhe gjatë procesit të votimit. Si rezultat i këtij procesi të votimit të gabuar dhe jokoherent, të gjithë kandidatët për Kryetar të Gjykatës Supreme, duke përfshirë edhe parashtruesen e kërkesës, ishin vendosur në një pozitë të pasigurisë juridike, pabarazisë dhe përzgjedhjes së pameritуar.

112. Gjykata vëren se nuk është detyrë e saj të spekulojë se cili kandidat është më i përshtatshëm për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Gjykata dëshiron të sigurohet se votimi dhe procesi i votimit janë në pajtim me Kushtetutën. Pajtueshmëria me standardet kushtetuese, *inter alia*, përfshin: (i) një proces të votimit i cili u garanton kandidatëve barazi, transparencë dhe hapje; (ii) koherencë logjike dhe lidhje në mes të procesit të votimit dhe përzgjedhjes së kandidatit të zgjedhur bazuar në zgjedhjen e shprehur në mënyrë demokratike të anëtarëve që votojnë të KGJK-së.

113. Gjykata rithekson se është në dijeni të lirisë së vlerësimit të KGJK-së në zgjedhjen e kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme. Megjithatë, kjo liri nuk është absolute dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë, që të jetë në kundërshtim me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenet 27, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1) dhe 63 (1) dhe (5) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2017

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, me shumicë votash, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të neneve 24 (1) [Barazia para Ligjit], 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës;

III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës;

IV. TË SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e KGJK Nr. 50/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 6 marsit 2017;

V. TA URDHËROJË Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të mbajë proces të ri të votimit për përzgjedhje të kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme në pajtim me gjetjet në këtë Aktgjykim;

VI. TA URDHËROJË Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, që të dorëzojë informata në Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi;

VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;

VIII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'i kumtohet Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Palëve;

IX. TË PUBLIKOHET në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit në Gazetën Zyrtare.

X. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

Rasti Nr. KI34/17

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJK nr. 50/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të 06 marsit 2017

MENDIM MOSPAJTUES
i gjyqtares Gresa Caka-Nimani

Me respekt, shpreh mospajtimin tim me votën e shumicës në Rastin Nr. KI34/17 (Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJK nr. 50/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të 06 marsit 2017). Shumica ka vendosur të deklarojë këtë kërkesë të pranueshme dhe të konstatojë se Vendimi i kontestuar (KGJK nr. 50/2017) i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), është nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 (1) [Barazia para Ligjit], 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Me respekt, kërkesa do të duhej të ishte deklaruar e papranueshme në pajtim me nenin 113 (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës; nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe pikën (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Sic do të shtjellohet në vijim, neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe Rregulli 36 i Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e "shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj", me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj. Kërkesa në fjalë, nuk e plotëson këtë kusht. Rrjedhimisht, në vijim, ky Mendim Mospajtues, në mënyrë specifike do të kontestojë "Vlerësimin e Pranueshmërisë" së Aktgjykimit në rastin nr. KI34/17, paragrafët 68, 69, 70, 71, 72 dhe 73, respektivisht.

Ky Mendim Mospajtues bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

1. Kërkesa është dorëzuar në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës. Ky nen qartë përcakton që individët janë të autorizuar të ngrenë pretendimet për shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, me kusht që, të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Neni 47 [Kërkesa Individuale] i Ligjit, gjithashtu përmban të njëjtat kritere, që individët kanë të drejtë të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike kur konsiderojnë se të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik, megjithatë, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.[1] Njejtë, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese lejon që Gjykata të shqyrtojë meritat e kërkesës vetëm nëse plotësohen katër kriteret e përcaktuara në paragrafin e parë të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë].[2] Rrjedhimisht, kriteri për "shterimin e të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj" është përcaktuar qartë në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës Kushtetuese.

[1] Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Kapitulli III mbi Procedurat e Veçanta, Pjesa 10 "Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës", Neni 47 mbi Kerkesat Individuale.
[2] Sipas Rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] së Rregullores së punës, Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar; b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar; c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; dhe d) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e pabazuar. Shkaqe shtesë për papranueshmëri përcaktohen në paragrafin 3 të rregullit 36.

2. Koncepti i shterimit dhe/ose detyrimit për shterimin e mjeteve juridike rrjedh dhe bazohet në rregullat "përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare".[3] Rrjedhimisht, ekziston një praktikë e vendosur ndërkombëtare rreth detyrimit të shterimit të mjeteve juridike. [4] E njëjta vlen edhe për Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e cila sipas nenit 35 (Kushtet e pranueshmërisë) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), mund *"të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuara të të drejtës ndërkombëtare ..."*.[5] Praktika e GJEDNJ-së për vlerësimin nëse është përmbushur detyrimi i shterjes së mjeteve juridike, është e vendosur mirë në vendimet gjyqësore të saj. Këto të fundit, janë të detyrueshme për Gjykatën Kushtetuese në kuptimin e interpretimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.[6]

3. Qëllimi i detyrimit për shterjen e mjeteve juridike është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar apo korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës.[7] Në kontekstin e GJEDNJ-së, ky detyrim bazohet në supozimin se rendi i brendshëm juridik siguron mjet efektiv për shkeljet e të drejtave të mbrojtura nga Konventa. Ky është një aspekt i rëndësishëm i natyrës subsidiare të Konventës.[8] Gjykata Kushtetuese i ka qëndruar besnike këtij parimi. Ajo vazhdimisht ka pohuar se parimi i subsidiaritetit kërkon që të gjithë parashtruesit e kërkesave të i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, me qëllim të parandalimit të shkeljes së Kushtetutës ose, nëse ka, me qëllim të korrigjimit të një shkelje të tillë të ndonjë të drejte themelore. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vazhdimisht ka pohuar se parashtruesit e kërkesave janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata Kushtetuese, kur ata dështojnë që të shfrytëzojnë procedurat e rregullta ose dështojnë të raportojnë shkeljet e Kushtetutës në procedurat e rregullta.[9] Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese ka zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të rreptë rregullin e shterimit të mjeteve juridike dhe vazhdimisht i është përmbajtur parimit të subsidiaritetit. Kjo, me përjashtim të vetëm katër rasteve paraprake, përveç këtij Aktgjykimi, në të cilat Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se

---

[3] Të cilave u referohet në mënyrë specifike neni 35 i Konventës. Shih paragrafin 1 të nenit 35 të Konventës: "Gjykata mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuara të të drejtës ndërkombëtare dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë."

[4] Ndër të tjera, një vendim historik mbi çështjen: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, rasti Interhandel (*Zvicra kundër Shteteve të Bashkuara*), Aktgjykim i 21 marsit 1959.

[5] Paragrafi 1 i nenit 35 (Kushtet e pranueshmërisë) të Konventës.

[6] Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, sipas të cilit: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[7] Në kontekst të GJEDNJ-së, kjo vlen për autoritetet kombëtare dhe Konventën, respektivisht.

[8] Ndër të tjera: Selmouni kundër Francës, paragrafi 74 dhe referencat në të; Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 42, dhe referenca të tjera në të; Kudła kundër Polonisë, paragrafi 152; Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafët 69 dhe 97.

[9] Ndër të tjera: Aktvendim në rastin KI139/12, Besnik Asllani, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012 të 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; Aktvendim, në rastin nr. Kl07/09, Demë KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18; Vendim në rastin nr. KI89/15, Fatmir Koci, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 473/2014, të 21 nëntorit 2014, paragrafi 35; dhe Aktvendimi ne Rastin Nr. KI24/16, Parashtruesi Avdi Haziri, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 191/2015, të 1 shtatorit 2015.

është përmbushur ose ka "liruar"[10] parashtruesit e kërkesave nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike.[11]

4. Kushtet mbi bazën e të cilave mund të hiqet dhe/ose konsiderohet i përmbushur ky detyrim, janë të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo e fundit duhet të jetë referenca udhëzuese për Gjykatën Kushtetuese kur bën vlerësimin nëse është përmbushur detyrimi për shterimin e mjeteve juridike për kërkesat e parashtruara sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

5. Në parim, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, detyrimi për të shteruar mjetet juridike është i kufizuar në shfrytëzimin e atyre mjeteve juridike ekzistenca e të cilave është mjaftueshëm e sigurt, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; që janë të disponueshme, të qasshme, e efektive; dhe që janë në gjendje/përmbajnë mundësinë që të korrigjojnë shkeljet e pretenduara të Konventës.[12] Për më tepër, një parashtrues nuk mund të konsiderohet se ka dështuar të shterojë mjetet juridike nëse ai/ajo mund të dëshmojë, duke iu referuar praktikës gjyqësore përkatëse ose duke ofruar ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion të cilin ai/ajo nuk e ka shfrytëzuar, do të ishte i destinuar të dështojë.[13]

6. Më saktësisht, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton: a) përjashtimet e vendosura ndaj detyrimit të shterimit të mjetit juridik;[14] dhe b) parimet e vendosura,

---

[10] Në terminologjinë e përdorur nga GJEDNJ: "*Waive the requirement*".

[11] Aktgjykimi në Rastin Nr. KI56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit; Aktgjykimi në rastin nr. KI06/10 VALON BISLIMI kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë; Aktgjykimi në Rastin Nr. KI41/12 Parashtrues të kërkesës Gezim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale ne Prishtine dhe Këshillit Gjyqësor te Kosovës; dhe Aktgjykimin ne Rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14 Parashtruesi Shyqyri Syla dhe Laura Pula, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve te Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën zgjedhore te Kryeprokurorit te Shtetit.

[12] Për më shumë kontekst që ka të bëjë me praktikën e GJEDNJ-së për shterjen e mjeteve juridike, ndër të tjera i referoheni: Selmouni kundër Francës, paragrafët 71 deri 81; Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, Seksioni B. Shterimi i mjeteve juridike të brendshme, paragrafët 55 deri 77; Demopolous dhe të tjerët kundër Turqisë, Seksionet: A. Parashtresat para Gjykatës për shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe B. Shterjen e mjeteve juridike vendore, respektivisht, paragrafët 50 deri 129; Ocalan kundër Turqisë, paragrafët 63 deri 72; dhe Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës, paragrafët 155 deri 162.

[13] Ndër të tjera: rasti Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës, paragrafët 156 dhe referencat në të; dhe Selmouni kundër Francës, paragrafët 74-77.

[14] Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në parim, dhe ndër të tjera, ka konstatuar se, <u>nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon</u>, kërkesa për shterje do të konsiderohet e përmbushur: a) kur gjykata e apelit shqyrton meritat e kërkesës edhe pse e konsideron kërkesën të papranueshme (shembull: konteksti i rastit Voggenreiter kundër Gjermanisë); b) në rastet që kanë të bëjnë me parashtruesit e kërkesës të cilët nuk kanë respektuar format e përcaktuara me legjislacionin e brendshëm, nëse autoriteti kompetent megjithatë ka shqyrtuar thelbin e kërkesës (shembull: Vladimir Romanov kundër Rusisë, paragrafi 52 dhe referencat në të); c) nëse ekziston më shumë se një mjet juridik potencialisht efektiv, parashtruesi obligohet të ketë shfrytëzuar vetëm njërin prej tyre (shembujt: Karakó kundër Hungarisë, paragrafi 14 dhe referencat në të; Kozacıoğlu kundër Turqisë, paragrafët 40 dhe referencat në të; Micallef kundër Maltës, paragrafi 58, dhe Jasinskis kundër Letonisë, paragrafët 50, 53, 54); d) ankesa duhet të jetë ngritur "të paktën në substancë" (shembuj: Castells kundër Spanjës, paragrafi 32, dhe Fressoz dhe Roire kundër Francës, paragrafi 37 dhe referencat në të); e) Mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme nuk duhet të shfrytëzohen (shembuj: konteksti i rasteve Çınar kundër Turqisë dhe Prystavka kundër Ukrainës); f) një mjet juridik që nuk është i qasshëm drejtpërdrejtë për parashtruesin e kërkesës, por që varet nga ushtrimi i lirisë së diskrecionit nga një ndërmjetës, nuk ka nevojë të shfrytëzohet (shembuj: Tănase kundër Moldavisë, paragrafi 122); g) një mjet juridik i brendshëm i cili nuk i nënshtrohet ndonjë afati të saktë dhe rrjedhimisht krijon pasiguri, nuk mund të konsiderohet efektiv (shembull: konteksti i rastit Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar); dhe h) në rastet ku shfrytëzohet një mjet juridik të ofruar nga Gjykatat Kushtetuese, vlerësimi i shterimit do të bëhet në

mbi bazën e të cilave, në çdo rast, bëhet vlerësimi për përmbushjen ose jo, të detyrimit të shterimit të mjetit juridik. Për sa i takon kategorisë së dytë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në parim, përcakton se zbatimi i këtij rregulli, duhet të bëhet në mënyrë fleksibile, ndërsa, mjetet juridike, në parim, duhet të karakterizohen nga ekzistenca, disponueshmëria, qasja dhe efektiviteti. Sa i përket, zbatimit fleksibil, vlerësimi i detyrimit të shterimit duhet të bëhet me "*fleksibilitet dhe pa formalizëm të tepruar*".[15] Sa i përket karakteristikave të tjera, në parim, a) ekzistenca e mjetit juridik duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë; b) mjeti juridik duhet të ketë disponueshmërinë, qasjen dhe efektivitetin e nevojshëm; c) mjeti juridik duhet gjithashtu të jetë në gjendje të mundësoj korrigjimin përkatës në lidhje me pretendimet; dhe d) duhet të ofrojë mundësi të arsyeshme për sukses.[16] Për më tepër, vlerësimi fleksibil i karakteristikave të nevojshme të mjetit juridik, duhet të bëhet duke marrë parasysh rrethanat e secilit rast individual. Në këtë drejtim, GJEDNJ gjithashtu ka përvetësuar konceptin e "*rrethanave të veçanta*", përmes të cilit e bën vlerësimin, nëse ka ndonjë bazë të veçantë që e liron parashtruesin e kërkesës nga përmbushja e detyrimit të shterjes së mjetit juridik.[17]

7. Vlerësimi nëse një rast specifik i plotëson kriteret[18], mbi bazën e të cilave do të mund të konstatohej se është përmbushur detyrimi për shterjen e mjeteve juridike, duhet të bëhet në bazë të shpërndarjes së barrës së të provuarit, proces ky i përcaktuar qartë në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Sipas kësaj të fundit, shpërndarja e barrës së të provuarit ndahet midis parashtruesit të kërkesës dhe qeverisë që pretendon mos-shterimin.[19] Në kontekstin e rastit konkret, shpërndarja e barrës së të provuarit, bie ndërmjet Parashtrueses së kërkesës dhe KGJK-së. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është detyrë e qeverisë, në kontestin e rastit konkret KGJK-së, që pretendon mos-shterimin, të ofroj prova që mjeti juridik i propozuar: a) ekziston në teori dhe në praktikë; b) është i qasshëm dhe efektiv; c) në gjendje të mundësoj adresimin e pretendimeve/ankesave të Parashtrueses; dhe d) ofron mundësi të arsyeshme për sukses. Këto argumente kanë më shumë peshë, nëse do të mbështeten me shembuj nga praktika gjyqësore. [20] Megjithatë, pasi kjo barrë e të provuarit të jetë përmbushur, barra i bie parashtruesit të kërkesës për të vërtetuar se mjeti i referuar

varësi të juridiksionit të Gjykatës përkatëse (shembull: konteksti i Grišankovës dhe Grišankovs kundër Letonisë, Liepājnieks kundër Letonisë dhe Szott-Medyńska kundër Polonisë).

[15] Selmouni kundër Francës, paragrafi 77 dhe referencat në të; Cardot kundër Francës, paragrafi 34 dhe referencat në të; Ringeisen kundër Austrisë, paragrafi 89 dhe referencat në të; dhe Kozacıoğlu kundër Turqisë, paragrafi 40 dhe referencat në të.

[16] Të gjitha këto koncepte dhe rrethanat në të cilat ato zbatohen, përcaktohen qartë në praktikën gjyqësore të vendosur të GJEDNJ-së. Në këtë drejtim, shihni ndër të tjera, Norbert Sikorski kundër Polonisë, paragrafi 117; mbi efektivitetin, ndër të tjera: Vernillo kundër Francës, paragrafi 27; Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafi 66 dhe referencat në të; Johnston dhe të tjerët kundër Irlandës, paragrafi 45 dhe referencat në të; dhe Paksas kundër Lituanisë, paragrafi 74, 75 dhe referencat në të; mbi ofrimin e mundësisë së arsyeshme të suksesit: ndër të tjera, Paksas kundër Lituanisë, paragrafi 74, 75 dhe referencat në të.

[17] Për konceptin e "rrethanave të veçanta", ndër të tjera: Van Oosterwijck kundër Belgjikës, paragrafët 36 deri 40, dhe referencat përkatëse; Selmouni kundër Francës, konteksti i paragrafëve 71 deri 81, dhe referencat përkatëse; Ocalan kundër Turqisë, paragrafi 67; Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafët 67 dhe 68 dhe referencat në të. Më tej, lidhur me shqyrtimin e kontekstit të përgjithshëm ligjor dhe politik, ndër të tjera, Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafët 68-69 dhe referencat në të; Selmouni kundër Francës, paragrafi 77.

[18] Në të dy rastet, në rastet e përjashtimeve të përcaktuara nga detyrimi i shterimit; dhe parimet e vendosura që duhet të merren parasysh në çdo rast kur duhet të bëhet një vlerësim për rregullin e shterimit, siç referohet në paragrafin 6 të këtij Mendimi Mospajtues.

[19] Për një diskutim më të detajuar mbi shpërndarjen e barrës së provës, ndër të tjera, referohuni: Selmouni kundër Francës, paragrafi 76 dhe referencat në të; dhe Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafi 68 dhe referencat në të.

[20] Ndër të tjera, konteksti i Paulino Tomás kundër Portugalisë dhe Mikolajová kundër Sllovakisë, paragrafi 34.

nga qeveria, në kontestin e rastit konkret KGJK, në fakt është shteruar, dhe nëse ky nuk është rasti, të argumentojë të kundërtën e pretendimeve të KGJK-së, përkatësisht që: a) për ndonjë arsye, mjeti i propozuar është joadekuat dhe joefektiv në rrethanat e veçanta të rastit; ose b) që ekzistojnë rrethana të veçanta, të cilat e lirojnë Parashtruesën e kërkesës nga përmbushja e detyrimit të shterimit të mjetit juridik.[21] Në fund, dhe sic është cekur me lartë, GJEDNJ gjithashtu ka konstatuar se një parashtrues nuk mund të konsiderohet se ka dështuar të shterojë mjetet juridike nëse ai/ajo mund të vërtetojë, duke u mbështetur ne praktikë gjyqësore relevante ose në ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion të cilin ai/ajo nuk e ka shfrytëzuar, ishte i destinuar të dështonte.[22]

8. Duke thënë këtë, gjithashtu duhet të theksohet, se lirimi nga detyrimi i shterimit të mjetit juridik, bëhet vetëm përjashtimisht. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se *"ai/ajo ka bërë çdo gjë që në mënyrë të arsyeshme mund të pritej nga ai /ajo për të shteruar mjetet juridike"*.[23] Në të vërtetë, edhe më tutje, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i referohet "*dyshimeve të thjeshta*"[24], si një arsye e pamjaftueshme për të liruar një parashtrues nga detyrimi i shterimi të mjeteve juridike. "*Dyshimet e thjeshta*" nga ana e parashtruesit të kërkesës, sa i përket karakteristikave të nevojshme të një mjeti juridik, nuk do e lirojnë atë nga detyrimi për ta provuar mjetin përkatës.[25] Përkundrazi, është në interesin e parashtruesit të kërkesës që të i drejtohet gjykatës së duhur për t'i dhënë asaj mundësinë që të zhvillojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së interpretimit.[26]

9. Tani, siç u tha më lart, Gjykata Kushtetuese duhet të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.[27] Parimet e vendosura nga kjo e fundit, duke përfshirë, edhe përdorimin e koncepteve si *fleksibil*, *në dispozicion*, *të qasshme*, e *efektiv,* ndër të tjera, nuk mund të bëhet jashtë kontekstit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

10. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur ose mund të lirohet nga detyrimi për shterjen e mjeteve juridike, në secilin rast konkret veçmas dhe duke u bazuar vetëm në parashtresat përkatëse të palëve, në rastin konkret, KGJK-së dhe Parashtrueses së kërkesës, siç kërkohet me parimin e shpërndarjes së barrës së të provuarit, të përcaktuar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

11. Në rastin konkret, duke iu referuar *Selmouni kundër Francës* dhe dy Aktgjykimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese,[28] Parashtruesja e kërkesës pohon se nuk ekzistojnë mjete juridike që mund të adresojnë shkeljet e pretenduara të shkaktuara

---

[21] Ndër të tjera, Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, paragrafi 68 dhe referencat në të; dhe Selmouni kundër Francës, paragrafi 76 dhe referencat në të.

[22] Ndër të tjera, Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës, paragrafi 156; dhe Augusto kundër Francës, paragrafët 37 dhe 42.

[23] Shih D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, paragrafi 116 dhe referencat në të.

[24] Në terminologjinë e përdorur nga GJEDNJ: *" mere doubts"*.

[25] Ndër të tjera, Epomagdem kundër Turqisë, paragrafi i parë i fq. 6 dhe referencat në të; Milošević kundër Holandës, paragrafi e fundit të fq. 6; dhe MPP Golub kundër Ukrainës, paragrafi i fundit i Seksionit C mbi Vlerësimin e Gjykatës.

[26] Ndër të tjera, Ciupercescu kundër Rumanisë, paragrafi 169.

[27] Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës ku thuhet se: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.".

[28] Aktgjykimi në rastin nr. KI06/10 VALON BISLIMI kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë; dhe Aktgjykimi në rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14 Parashtrues Shyqyri Syla dhe Laura Pula, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën zgjedhore të Kryeprokurorit të Shtetit.

nga Vendimi (KGJK nr. 50/2017) i kontestuar. Ky pretendim nuk është dëshmuar në kërkesën e Parashtrueses. Ndaj këtij qëndrimi të mbajtur nga Parashtruesja e kërkesës, KGJK-ja është përgjigjur duke u thirrur në mos-shterjen e mjeteve juridike, dhe duke iu referuar mjeteve juridike në dispozicion, të parapara me Ligjin Nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ dhe juridiksionin përkatës të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Argumentet e KGJK-së sigurisht që do të kishin pasur më shumë peshë, nëse do të mbështeteshin me shembuj nga praktika gjyqësore relevante. Megjithatë, Parashtruesja e kërkesës nuk është përgjegjur ndaj pretendimeve dhe argumenteve të KGJK-së për mos-shterje, duke dështuar kështu të bartë barrën e saj të provës. Parashtruesja e kërkesës nuk ka argumentuar, siç kërkohet me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përse mjeti i referuar nga KGJK është joadekuat apo joefektiv dhe nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që e lirojnë Parashtruesën e kërkesës nga detyrimi i shterimit të këtij mjetit juridik. Në fakt, në bazë të parashtresave të palëve, rezulton se nuk ka pasur asnjë përpjekje nga ana e Parashtruesës së kërkesës për të shteruar ndonjë mjet juridik. Në rrethana të tilla, Parashtruesja e kërkesës do të duhej jo vetëm të përmend, por edhe të dëshmojë se mjeti juridik nuk ekziston ose se mjeti juridik në dispozicion i cili nuk është përdorur, është joadekuat, joefektiv dhe/ose i destinuar të dështojë. Lidhur me këtë të fundit, sikur në rastin e KGJK-së, argumentet e Parashtrueses së kërkesës do të kishin peshë më të madhe nëse do të ishin mbështetur nga praktika relevante gjyqësore, siç kërkohet nga praktikën gjyqësore e GJEDNJ-së. Kjo nuk është bërë. Prandaj, Parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar se është bërë *"gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ajo që të shterojë mjetet juridike"*. Duhet të përsëritet, siç është diskutuar në paragrafin 8 të këtij Mendimi Mospajtues, se "*dyshimet e thjeshta*" nga ana e Parashtruesit të kërkesës lidhur me efektivitetin ose jo, të një mjeti të caktuar juridik, nuk do ta lirojnë nga detyrimi për ta provuar atë.

12. Në këtë drejtim, dhe me respekt, vlerësimi i pranueshmërisë në Aktgjykimin e Rastit nr. KI34/17, për sa i përket detyrimit të shterimit të mjeteve juridike, i elaboruar në paragrafët 68 deri 73, përkatësisht, nuk pasqyron një vlerësim të bazuar mbi barrën e të provuarit. Konkretisht, përderisa paragrafët 68 dhe 72 të Aktgjykimit janë teknikisht të saktë, ata janë nxjerrë jashtë kontekstit dhe nuk janë bazuar në argumentet e ofruara nga Parashtruesja e kërkesës dhe nga KGJK-ja. Ngjashëm, argumentet e pasqyruara në paragrafin 69 të Aktgjykimit, nuk janë ngritur nga Parashtruesja e kërkesës. Më tej, në paragrafin 70 të Aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese e vë barrën e provës vetëm mbi KGJK-në. Është e saktë që KGJK-ja nuk ka mbështetur pretendimet e saj për mos-shterimin dhe/ose mjetin e saj të propozuar nuk e ka mbështetur me ndonjë praktikë gjyqësore relevante, në raste të krahasueshme, që në këmbim do të kishin treguar se parashtruesja e kërkesës do të kishte mundësi të arsyeshme për sukses. Megjithatë, siç u diskutua në mënyrë më të detajuar në paragrafin 7 të këtij Mendimi Mospajtues, barra e të provuarit nuk bie vetëm mbi KGJK-në, siç reflektohet në këtë Aktgjykim. Kjo varet po aq edhe nga Parashtruesja e kërkesës. Siç është shtjelluar më lart, kjo e fundit nuk ka shpjeguar: a) pse nuk është bërë asnjë përpjekje për të shteruar ndonjë mjet juridik; b) nuk i ka dëshmuar pretendimet për mosekzistimin e mjetit; dhe c) nuk i është përgjigjur pretendimeve të KGJK-së për mos-shterim.

13. Në fund, është e qartë se zbatimi fleksibil i rregullit të shterimit të mjetit juridik duhet t'i përshtatet secilit rast specifik, bazuar në shpërndarjen e barrës së të provuarit. *Rëndësia* ose *specifika* që mund të ndërlidhen me një vendim të kontestuar, në rastin konkret, me Vendimin KGJK nr. 50/2017, siç është arsyetuar në paragrafët 71 dhe 73 të Aktgjykimit, nuk mund të justifikojë <u>në vetvete</u> lirimin nga përmbushja e detyrimit për shterim të mjeteve juridike. Këto janë kritere shtesë, zbatimi i të cilave jashtë kontekstit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, do të mund të rezultonte në trajtimin e pabarabartë të parashtruesve të kërkesave mbi bazën e nenit 113.7 të Kushtetutës.

14. Në pajtim me këtë, dhe siç është shtjelluar më lart, kërkesa do të duhej të ishte deklaruar e papranueshme, për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës; nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit dhe pikën (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

15. Duke marrë parasysh qëndrimin e arsyetuar më lartë, dhe të përmbledhur në paragrafin 14 të këtij Mendimi Mospajtues, do të përmbahem nga dhënia e një mendimi të detajuar për vlerësimin e meritave e kërkesës siç është shtjelluar në Aktgjykim. Një qëndrim i tillë do të e preventonte edhe shumicën për të shqyrtuar meritat e kërkesës. Por, duhet të shtoj, se pajtohem me konstatimin e Gjyqtareve Altay Suroy dhe Bekim Sejdiu, respektivisht, në Mendimin e tyre Mospajtues se, përtej qështjes së shterimit të mjeteve juridike, ekzistojnë edhe baza tjera, mbi të cilat kërkesa do të duhej të shpallej e papranueshme, posaqërisht si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, sepse Parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj për shkeljen e neneve 24 (1) [Barazia para Ligjit], 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 108 (1) dhe (4) [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, trajtimi i këtyre pretendimeve, sic janë parashtruar, nuk rezulton në nivelin e shkeljeve kushtetuese.

Dorëzoi me respekt,

Gresa Caka-Nimani

Gjyqtare

MENDIMI MOSPAJTUES I GJYQTARËVE ALTAY SUROY DHE BEKIM SEJDIU NDAJ AKTGJYKIMIT NË RASTIN Nr. KI34/17

I. Me respektin më të madh shprehim mospajtimin tonë me vendimin e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në rastin me numër KI34/17. Konsiderojmë se kërkesa do duhej të shpallej e papranueshme, sepse për këtë ekzistojnë disa baza. Për më tepër, edhe nëse kërkesa do ta kalonte testin e pranueshmërisë, e konsiderojmë të gabueshëm konkludimin nga shumica e gjyqtarëve se Vendimi i KGJK-së nr. 50/2017 është i përfshirë me shkelje të të drejtave të parashtrueses, të garantuara me nenet 24 (1), 31 (1) dhe 108 (1 dhe 4) të Kushtetutës.

II. I bashkohemi Mendimit Mospajtues të gjyqtares Gresa Caka-Nimani, për sa i përket mënyrës së arsyetimit të kushtit të shterimit të mjeteve juridike. Pa paragjykuar se a ka pasur parashtruesja apo jo në dispozicion mjete juridike efektive, konsiderojmë se arsyetimi i Gjykatës lidhur me shterimin e mjeteve juridike është i pamjaftueshëm. Si i tillë, vendimi i shumicës në këtë rast e liron parashtruesen nga detyrimi për të dëshmuar se: nuk ekzistojnë mjete juridike që ajo do të mund t'i shteronte; për ndonjë arsye ato janë joadekuate apo të paefektshme në këtë rast; apo ekziston ndonjë rrethanë e caktuar që në rastin konkret e liron parashtruesen nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, para se të paraqiste kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Ne pajtohemi, gjithashtu, me vlerësimin e gjyqtares Gresa Caka-Nimani se kjo mangësi e vendimit të shumicës lidhur me çështjen e (mos)shterimit të mjeteve juridike bëhet më e dukshme për faktin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka pretenduar se parashtruesja kishte në dispozicion mjete juridike të qasshme dhe efektive, të cilat duhet të shteroheshin para se të paraqitej kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Ky pretendim qenësor i KGJK-së mbeti pa përgjigje nga parashtruesja e kërkesës.

III. Përveç mospajtimit me shumicën lidhur me mënyrën e trajtimit të kriterit të (mos)shterimit të mjeteve juridike, konsiderojmë se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin në fjalë është i përfshirë me të metat thelbësore, si në vijim:

a. Aktgjykimi i votuar nga shumica e gjyqtarëve nuk e identifikon dhe trajton qartë dhe në mënyrë të saktë thelbin e kërkesës së parashtrueses. Si rregull i përgjithshëm, individët parashtrojnë kërkesa kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, në formë të kërkesës për kontroll konkret dhe të ashtuquajtur "represiv" – në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Përtej kësaj, neni 113.8 i Kushtetutës mundëson që individët të ngrenë pretendime gjatë shqyrtimeve gjyqësore pranë gjykatave të rregullta, lidhur me jokushtetutshmërinë e normave specifike ligjore, ndërsa gjykatat e rregullta mund të referojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mbi këtë bazë (i ashtuquajturi kontrollit kushtetues "incidental").

   Brenda këtij sfondi të gjyqësisë kushtetuese, individët mund të ngrenë pretendime në Gjykatë Kushtetuese, me argumentin e të qenit viktimë të një shkeljeje kushtetuese (*locus standi*) për shkak të veprimeve arbitrare apo të padrejta të autoriteteve publike. Por, në asnjë rast, individët nuk mund të ngrenë drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese pretendime se normat përkatëse ligjore janë në shpërputhje me Kushtetutën.

Në rastin konkret, kërkesa e parashtrueses përmban elemente edhe të një kërkese individuale, në frymën e nenit 113.7 të Kushtetutës e edhe të një kërkese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së normave përkatëse që rregullojnë funksionimin e KGJK-së.

Jemi të mendimit se në vendimin e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk është bërë dallim ndërmjet këtyre dy elementeve të kërkesës së parashtrueses dhe, për pasojë, atyre nuk u është bërë trajtim i duhur.

Së pari, parashtruesja e kërkesës pretendon se, në procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe me nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]. Parashtruesja paraqet dy argument kryesore për të mbështetur pretendimet e saj: Argumenti i parë ka të bëjë me mënyrën e votimit dhe përllogaritjen e votave gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatit për t'u propozuar për Kryetar/e të Gjykatës Supreme. Ndërsa, argumenti i dytë ka të bëjë me vlerësimin e "meritave të kandidatëve" që KGJK-ja propozon për Kryetar të Gjykatës Supreme (parashtruesja i referohet nenin 108.4., të Kushtetutës, që përcakton se KGJK-ja duhet që, me rastin e propozimeve <u>për emërimet e gjyqtarëve</u> të marrë parasysh, ndër të tjera, edhe meritat e kandidatëve dhe parimin e barazisë gjinore).

Fillimisht, duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese ka qenë vazhdimisht konsistente në qëndrimin se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me mënyrën se si organet e tjera publike bëjnë konstatimin e fakteve dhe interpretimin e dipozitave përkatëse ligjore, sepse kjo është, kryesisht, çështje e ligjshmërisë (jo e kushtetutshmërisë). Gjykata Kushtetuese përfshihet në çështje të interpretimeve ligjore nga organet e tjera publike vetëm nëse një gjë e tillë ndërlidhet me shkelje të të drejtave dhe të standardeve kushtetuese.

Konsiderojmë se Aktgjykimi i votuar nga shumica nuk ka arritur të argumentojë se KGJK-ja, me veprime arbitrare apo të padrejta, i ka cenuar parashtrueses të drejtat përkatëse kushtetuese. Aktgjykimi në fjalë nuk adreson, qartazi, argumentin e parashtrueses lidhur me mënyrën e votimit dhe të përllogaritjes së votës (përkatësisht të interpretimit të efektit të votës abstenuese). Ndërsa, për sa i përket pretendimit tjetër themelor të parashtrueses se ajo është diskriminuar sepse rezultati i votimit në KGJK nuk ka pasqyruar rezultatin e intervistës së kandidatëve të cilët kanë qenë në garë për t'u emëruar si Kryetar të Gjykatës Supreme, Aktgjykimi në fjalë nuk përmban arsyetim bindës se pse rezultati i intervistimit të kandidatëve duhej të ishte përcaktues për mënyrën e votimit në KGJK-së.

Në ndërlidhje me këtë, sjellim në vëmendje se në përgjigjen e KGJK-së argumentohet gjerësisht se vlerësimi i meritave të kandidatëve bëhet duke pasur parasysh disa kritere të përcaktuara nga Ligji për Këshillin Gjyqësor (duke përfshirë konsultimin me gjyqtarët e gjykatave përkatëse; trajnimet për menaxhim; përvoja menaxhuese).

Së dyti**,** parashtruesja ngreh pretendime, edhe pse shkarazi, lidhur me mospërputhjen e Rregullores 14/16 të KGJK-së me Kushtetutën. Ajo pretendon se, citojmë: *"[...] Rregullorja 14/2016 e KGJK-së për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave*

nuk i aplikon kërkesat sipas Kushtetutës" (shih paragrafët 40 dhe 55 të Aktgjykimit).

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese shkon përtej pretendimit të parashtrueses lidhur me cenimin e të drejtave të saj individuale, duke bërë një vlerësim të përgjithësuar të procesit të votimit në KGJK. Kështu, në paragrafin 98 të këtij Aktgjykimi thuhet se, citojmë: "[...] *Dështimi në parashikimin e votës abstenuese dhe dështimi për të parashikuar efektin e saj në procesin e votimit krijon pasiguri juridike sepse pengon parimet e hapjes së parashikueshmërisë*". Ndërsa paragrafi 99 thekson, citoj: "[...] *Gjykata vëren se forma aktuale e rregullimit të procesit të votimit nuk ofron 'mundësi të barabarta' kandidatëve, sepse procesi nuk parasheh mekanizma mbrojtës procedural në lidhje me garantimin e trajtimit të barabartë*".

Këto konstatime të shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese aludojnë, qartazi dhe drejtpërdrejtë, në defekte strukturore të procesit të votimit në KGJK. Ky proces është i rregulluar, kryesisht, nga Ligji dhe Rregullorja e KGJK-së. Në këndvështrimin tonë, detyrë e Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret ishte vlerësimi se a i janë cenuar parashtrueses të drejtat përkatëse kushtetuese, si pasojë e veprimeve arbitrare apo të padrejta të KGJK-së e jo si pasojë e efektit të neneve përkatëse të Ligjit dhe të Rregullores së KGJK-së, që rregullojnë procesin e votimit për përzgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Supreme.

Jemi të mendimit se në rastin konkret nuk ishte detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të bënte vlerësim të përgjithësuar kushtetues për mënyrën se si KGJK-ja, si institucion kushtetues, zbaton procedurat lidhur me propozimet për emërimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Për më tepër, një veprim i tillë mund të ketë efekt negativ në pavarësinë vendimmarrëse të KGJK-së.

b. Shumica e gjyqtarëve gjeti se KGJK ka shkelur nenin 31 (1) të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (paragrafi II i dispozitivit të Aktgjykimit).

Në vlerësimin tonë, parakusht për zbatim në rastet jopenale, të garancive përkatëse që ngërthen e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm – e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është ekzistimi i një kontesti lidhur me të drejtat specifike kushtetuese. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut qartëson se termit "kontest", në kuptim të nenit 6 të Konventës, duhet t'i jepet kuptim përmbajtjesor dhe jo teknik apo formal (shih vendimet në rastet: *Le Compte, Van Leuven and De Meyere v. Belgium*, 23 June 1981; *Gorou v. Greece*, 20 March 2009). Për më tepër, kontesti duhet të jetë i vërtetë dhe i natyrës serioze. Ky kusht për zbatimin e nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, konfirmohet katërçipërisht edhe nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 6 i Konventës nuk zbatohet në çështje jokontestuese dhe procedura të njëanshme, të cilat nuk përfshijnë palë kundërshtare dhe të cilat zbatohen kur nuk ka kontest lidhur me të drejta (shih vendimin në rastin *Alaverdyan v Armenia,* 24 August 2010).

Në rastin konkret, vendimi i arritur nga shumica nuk bën ndërlidhjen e domosdoshme ndërmjet ekzistimit të një kontesti (para se kërkesa të referohej në Gjykatën Kushtetuese) dhe zbatimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të

paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. Si përfundim dhe në ndërlidhje me të metat e shtjelluara më lart, konsiderojmë se vendimi i shumicës, i mishëruar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI34/17, mund të prodhojë dy efekte negative. Së pari, KGJK-ja vihet në situatën e një pasigurie juridike. Kjo për faktin se në përsëritjen e procesit të votimit për propozimin e kandidatit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, KGJK-ja mund të vihet në situatë kur duhet të përcaktohet në mes të zbatimit të pavarur të normave përkatëse të Ligjit dhe Rregullores së KGJK-së dhe konstatimeve të bëra nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin në fjalë. Së dyti, ky Aktgjykim mund të krijojë një precedent të ndërlikuar, për sa i përket procedurave që ndiqen në situata të ngjashme për emërime në pozita të larta publike në Republikën e Kosovës.

Paraqitur me respekt:

_____	_____
Altay Suroy	Bekim Sejdiu
Gjyqtar	Gjyqtar

KI147/16 Parashtrues i kërkesës Asllan Fazliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 250/2016, të 13 tetorit 2016

KI147/16 Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2017 i publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar*

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura se parashtruesi nuk i mbështeti pretendimet e tij dhe nuk dëshmoi shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI147/16

Parashtrues

Asllan Fazliu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 250/2016, të 13 tetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Asllan Fazliu nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 250/2016], të 13 tetorit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet t'i janë shkelur parashtruesit të kërkesës të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 nëntor 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (gjyqtare) dhe Gresa Caka-Nimani (gjyqtare).

7. Më 6 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 5 prill 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punonjës i Entit për llogaritje dhe pagesa - Filiali në Ferizaj (të njohur si: "Shërbimi i Kontabilitetit Shoqëror", në tekstin e mëtejmë: SHKSH) deri në vitin 1991.

10. Më 9 prill 1991, SHKSH nxori Vendimin [nr. 7/3-2] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës "*për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës.*"

11. Në një datë të pacaktuar në vitin 1992, parashtruesi ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, duke kërkuar anulimin e Vendimit [nr. 7/3-2] të SHKSH-së, kthimin në vendin e punës, si dhe pagesën e pagave të papaguara.

12. Më 26 qershor 1998, Gjykata Komunale në Ferizaj nxori Aktgjykimin [1080-1092], me të cilin e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe e detyroi të paditurin (SHKSH) që parashtruesin ta kthej në vendin e punës si dhe t'ia paguaj pagat e papaguara.

13. SHKSH-ja paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 26 qershorit 1998.

14. Më 14 shtator 1998, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin [597/98], me të cilin e refuzoi ankesën e SHKSH-së si të pabazuar, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj e vërtetoi në tërësi.

15. Më 24 prill 2000, parashtruesi paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Ferizaj kundër Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Prishtinë (ABPK) për kompensim të dëmit, duke konsideruar se e paditura ka legjitimitet pasiv dhe se ajo ende ka në dispozicion mjetet e luajtshme dhe të paluajtshme të ish-SHKSH.

16. Më 7 prill 2003, Gjykata Komunale në Ferizaj nxori Aktgjykimin [C. nr. 10/2000], me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

> *"Sipas këtij aktgjykimi i cili është sjellë konform rregullores së UNMIK- ut nr. 1999/20 që ka të bëj ekskluzivisht me autoritetin bankar të pagesave të Kosovës tani si e paditur është paraparë që një autoritet i tillë - e paditura nuk ka marr obligimet financiare të ish SHKSH-së , e me këtë siç është rasti tani me paditësin për pagesën e kompensimit të dëmit respektivisht kompensimit të të ardhurave personale prej momentit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës e tutje."*

17. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C. nr. 10/2000] për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, nenit 353, paragrafi 1, pika 1.2. dhe 3 të LKS-së, me propozim që aktgjykimi të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

18. Më 24 maj 2005, Gjykata e Qarkut nxori Aktvendimin [Ac. nr. 446/2003], me të cilin e aprovoi ankesën e parashtruesit dhe e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C. nr. 10/2000]. Në arsyetimin e aktvendimit theksohet:

> *"Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta bëjë eliminimin e shkeljeve ..., duke bërë rregullsinë e padisë për sa i përket emërtimit të drejtë të të paditurës ...".*

19. Më 1 dhjetor 2006, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin [C. nr. 312/2005] me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

> *"... kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar, duke u bazuar në gjendjen e re të krijuar pas ndryshimeve të pësuara te e paditura ish SHKSH - tani AQBK, me Rregulloren e UNMIK - ut, të cituar me parë,. Një gjendje e tillë është vërtetuar edhe me dokumentet relevante të lartshënuara dhe nga kundërshtimi kategorik dhe i bazuar i së paditurës për marrjen përsipër të obligimeve sipas padisë së paditësit të cilat obligime eventualisht do t'i kishte ish SHKSH, e të cilat nuk i ka marrë e paditura- tani sipas Rregullores nr. 47/2006 me emërtimin AQBK, andaj kjo gjykatë sipas kësaj gjendje juridike dhe faktike nuk mundi të vendosi ndryshe."*

20. Më 4 dhjetor 2006, parashtruesi ka bërë kërkesëpadi të re me po të njëjtat kërkesa në të cilën tani si palë të paditur e deklaroi Bankën Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), si pasardhëse të ABPK-së.

21. Më 22 tetor 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj nxori Aktgjykimin [C. nr. 324/08] me të cilin refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

> *"Gjykata ka analizuar pretendimet e palëve në procedurë veçanërisht ka analizuar pretendimin e palës së paditur, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në Prishtinë, se e paditura nuk ka legjitimitetin e palës në procedurë, për faktin se për periudhën për të cilën kërkohen të ardhurat personale, gjatë viteve 1990-1991, Banka Qendrore nuk ka ekzistuar dhe nuk është pasardhëse e ish Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror apo të ish Bankës Populllore të Jugosllavisë."*

22. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [C. nr. 324/08].

23. Më 16 shtator 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [CA. nr. 41/2013] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

> *"... në mënyrë të padyshimtë rezulton se e paditura Banka Qendrore e Kosovës është trashëgimtar juridik i Drejtorisë qendrore për bankat në Kosovë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/47, dhe Drejtorisë për banka dhe pagesave në Kosovë e cila është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/20. Po e paditura nuk është trashëgimtar juridik i Bankës Populllore të Jugosllavisë - Entit për llogaritje dhe pagesa-Filialës në Ferizaj, e cila ka ekzistuar deri në vitin 1999, me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit janë ndërpre.*
> *[...]*

Për shkak të përmendurave më lart Gjykata e Apelit gjeti se konkludimi i drejtë i gjykatës së shkallës së parë se banka qendrore e Kosovës, e paditura nuk e ka legjitimitetin pasiv në këtë çështje juridike a kështu që me të drejtë kërkesëpadinë e refuzoi si të pa bazuar."

24. Parashtruesi paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [CA. nr. 41/2013], për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale.

25. Më 13 tetor 2016, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 50/2016], me të cilin e refuzoi kërkesën për revizion, duke arsyetuar:

"... me nenin 1 të Rregullores nr. 2006/47 datë 24.08.2006, mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës është përcaktuar që Autoriteti Bankar i Kosovës (AQBK), është pasardhëse e autoritetit bankar dhe të pagesave të Kosovës, si subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si person juridik sipas Ligjit në fuqi në Kosovë, kurse as me këtë rregullore nuk është paraparë se AQBK, është pasardhës-trashëgimtar juridik i Bankës Populllore të Jugosllavisë-Entit për Llogaritje dhe Pagesa-Filiala në Ferizaj, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës me të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore kur kanë gjetur se e paditura nuk e ka legjitimitetin pasiv në këtë çështje juridike dhe kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

E paditura me asnjë rregullore apo ligj nuk ka marrë ndonjë detyrim nga marrëdhënia e punës për punëtorët e Bankës Populllore të Jugosllavisë-Entit për Llogaritje dhe Pagesa-Filiala në Ferizaj, e cila është obliguar që paditësin ta kthejë në punë dhe t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës ..."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës konsideron "*që gjykatat e të tri instancave kanë marrë vendime të njëanshme dhe jo të drejta. Meqë paditësit nuk i është garantuar një gjykim fer, korrekt dhe të paanshëm dhe që kjo është e garantuar edhe me dispozitat e nenit 31.1 të Kushtetutës së Rep. së Kosovës. Po ashtu, paditësit nuk i garantohet dhe e drejta respektivisht mbrojtja siç parashihet edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut."*

27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata "*që të ANULOJË Aktgjykimin Rev. nr. 250/2016, të 13.10.2016, dhe çështjen sipas padisë së paditësit t'ia kthej Gjykatës kompetente për vendosje të sërishme."*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

30. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

31. Lidhur me sa u tha më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i ka theksuar shkeljet e mundshme kushtetuese, si dhe kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.

32. Megjithatë, Gjykata, gjithashtu, duhet t'u referohet rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."

33. Gjykata vëren se thelbi i kërkesës ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë interpretuar dispozitat relevante ligjore të cilat kanë të bëjnë me legjitimitetin pasiv të palëve të paditura (gjegjësisht: SHKSH, AQBK, BQK), gjë e cila pretendohet se ka rezultuar me shkelje të të drejtave dhe lirive të parashtruesit të garantuara me nenin 31.1 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

34. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata rikujton se drejtësia e një procesi vlerësohet duke shikuar procedurën në tërësi (shih rastin: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68) dhe si rrjedhojë, në përcaktimin e bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesit, Gjykata do t'iu përmbahet këtyre parimeve.

35. Gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata vërejti se parashtruesi përgjatë tërë procedurës kishte mundësi të ndërmarrë veprime ligjore për të mbrojtur të drejtat e tij në procedurë gjyqësore, se kishte të drejtë për qasje në gjykata me juridiksion të plotë gjatë tërë procedurës, dhe se në asnjë fazë të procedurës nuk i është mohuar barazia substanciale në paraqitjen e argumenteve, provave dhe fakteve; parashtruesit i është dhënë mundësia e shqyrtimit publik para gjykatave si "element thelbësor" i të drejtës për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31.1 të Kushtetutës.

36. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë zbatuar dispozitat relevante ligjore mbi të cilat i bazuan vendimet e veta lidhur me çështjen e legjitimitetit pasiv të të paditurave dhe ato ofruan arsye të mjaftueshme për zbatimin e tyre, që është saktësisht çështje e ligjshmërisë që hyn në juridiksionin e gjykatave të rregullta.

37. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit të kryera nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave apo aplikimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe deri në atë masë sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

38. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) është përcaktuar që "*roli i gjykatave të*

rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).”

39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se një kërkesë është qartazi e pabazuar nëse i mungojnë provat *prima facie* që do të tregonin qartazi për shkelje të mundshme të të drejtave dhe lirive të njeriut (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 31 majit 2005, *Vanek kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 53363/99), dhe nëse faktet në lidhje me të cilat parashtrohet kërkesa, në mënyrë të qartë, nuk përbëjnë shkelje të të drejtave siç pretendon parashtruesi i kërkesës, përkatësisht nëse parashtruesi nuk ka “kërkesë të arsyetuar” (shih Aktgjykimin e GJEDNJ të 26 korrikut 2005, *Mezõtúr-Tiszazug Vizagalkodasi Társulat kundër Hungarisë,* kërkesa nr. 5503/02).

40. Si përfundim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese.

41. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 2 (b) të Rregullores së punës, më 5 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI145/16, Parashtrues të kërkesës Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani, Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016

KI 145/16, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2017, i publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesa individuale, trashëgimia, të drejtat pronësore, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesit parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore në lidhje me disa prona të mbetura nga i ndjeri E. B. Gjykata Themelore ne Prishtine (Aktgjykimi C. nr. 1477/2008) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës. Parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit si e pabazuar. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 263/2016) e refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Kushtetuese, se Gjykata Supreme duke e refuzuar si të pabazuar revizionin e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat para gjykatave të rregullta ishin në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtjen e pronës dhe për barazi para ligjit. Prandaj, Gjykata e deklaroi të papranueshme kërkesën e parashtruesve si qartazi të pabazuar siç parashihet me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI145/16

Parashtrues

Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kujtim Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Alije Shabani nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 263/2016, të 9 nëntorit 2016, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit (Ac. nr. 1219/2015) të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), të 28 qershorit 2016. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesve të kërkesës më 18 nëntor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe të rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 27 janar 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 8 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 4 korrik 2000, Ejup Bajrami kishte vdekur, duke lënë pas pronën e paluajtshme të përbërë nga 3 (tri) parcela kadastrale që gjenden në Prishtinë. Z. Bajrami la pas një testament, të regjistruar me nr. 207/97 të 11 dhjetorit 1997, të depozituar në Gjykatën Komunale (në tekstin e mëtejmë: Testamenti). Në testamentin e tij, ai emërtoi Myrvete Bajramin, Fatmire Bajramin, Kadrije Bajramin, Vildane Bajramin, Fakete Bajramin dhe Veton Bajramin si trashëgimtarë të pasurisë së tij të paluajtshme.

10. Në nenin 7 të testamentit saktësohej se Isak Shabani, i biri i Ejup Bajramit, nuk kishte marrë asgjë nga testamenti sepse Ejup Bajrami i kishte siguruar Isak Shabanit mjete për ndërtimin e dy shtëpive dhe një lokali afarist në Prishtinë.

Procedura jokontestimore

11. Më 19 mars 2002, Gjykata Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) konfirmoi (Vendimi për Trashëgimi T. nr. 113/00) emrat e trashëgimtarëve bazuar në testament. Gjykata Komunale gjithashtu e njohu Feride Bajramin, bashkëshorten e të ndjerit, si trashëgimtare në bazë të Ligjit.

12. Më 16 mars 2008, Isak Shabani vdiq duke lënë pas pronën e paluajtshme që gjendet në Zonën Kadastrale të Prishtinës, të regjistruar me numrin UL-71914059-05809.

13. Më 16 nëntor 2009, Gjykata Komunale me Aktvendimin (T. nr. 176/09) i pranoi parashtruesit si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit Isak Shabani. Parashtruesja Alije Shabani, gruaja e të ndjerit Isak Shabani, trashëgoi të gjithë pasurinë, sepse pjesa tjetër e parashtruesve deklaruan se nuk e pranojnë trashëgiminë.

Procedura kontestimore

14. Më 30 korrik 2008, disa nga parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale kundër Mirvete Ejupi-Sopjanit, Fatmire Bajramit, Kadrie Bajrami-Mujevcit,

Vildane Bajrami-Blakqorit, Fakete Bajrami-Mexhuanit, Feride Bajramit dhe Veton Bajramit (në tekstin e mëtejmë: të padituri) duke kërkuar konfirmimin e pronësisë lidhur me pronën e trashëguar nga të padituri nga i ndjeri Ejup Bajrami.

15. Më 7 tetor 2011, padia u ndryshua për të përfshirë të gjithë parashtruesit e kërkesës.

16. Më 22 nëntor 2013, parashtruesit e kërkesës e plotësuan padinë për të përfshirë anulimin e testamentit.

17. Më 10 tetor 2014, parashtruesit e kërkesës e ndryshuan padinë për të kërkuar vetëm anulim të pjesshëm të testamentit dhe për të konfirmuar se parashtruesit e kërkesës, si trashëgimtarë të të ndjerit Isak Shabani, janë bashkëpronarë të pronës së trashëguar nga të padituri nga i ndjeri Ejup Bajrami.

18. Më 31 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1477/2008) refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës.

19. Parashtruesit u ankuan kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të *"Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale."*

20. Të padituri parashtruan përgjigje ndaj ankesës, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) *"[...] të refuzojë ankesën e [parashtruesve të kërkesës] si të pabazuar, dhe të vërtetojë aktgjykimin e kontestuar"*.

21. Më 28 qershor 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 1219/2015) e refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

22. Parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit për shkak të *"shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale."*

23. Të padituri parashtruan përgjigje ndaj revizionit, me propozim që Gjykata Supreme ta refuzojë *"revizionin e [parashtruesve të kërkesës] si të pabazuar dhe t'i refuzojë aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit"*.

24. Më 4 gusht 2008, parashtruesit e kërkesës parashtruan në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit propozimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

25. Më 11 gusht 2016, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC. nr. 59/2016) i njoftoi parashtruesit se, meqë parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar revizion në Gjykatën Supreme *"Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, konsideron se në rastin konkret, është i mjaftueshëm revizioni si mjet i jashtëzakonshëm juridik dhe se nuk është e nevojshme që në të njëjtën gjykatë, për të njëjtat arsye, të paraqitet edhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë."*

26. Më 9 nëntor 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 263/2016) e refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje të pronës dhe për barazi para ligjit.

28. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se Gjykata Supreme nuk mori parasysh se të paditurit, si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit Ejup Bajrami *"pa dijeninë e paraardhësit të [parashtruesve të kërkesës] [...] Isak Shabani, pranë kësaj gjykate [Komunale] e kanë zhvilluar procedurën e trashëgimisë, duke mos e paraqitur si trashëgimtar Isak Shabanin i cili është djali i tani të ndjerit Ejup Bajrami dhe ka qenë në jetë në kohën e shqyrtimit të trashëgimisë. Të paditurit, duke mos e përfshi paraardhësin e paditësve si trashëgimtar ligjor në aktvdekje e kanë bërë vepër penale, duke shkelur ligjin për trashëgimin në dëm të [parashtruesve të kërkesës]"*.

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta janë marrë vetëm pjesërisht me pretendimin e tyre, pasi që *"kanë vendosur vetëm sa i përket kërkesës për anulimin e testamentit të cilën e kanë refuzuar, për shkak të parashkrimit të kërkesës, mirëpo ky qëndrim nuk qëndron ngase (me dispoz. e nenit 54 part. 3 i LMT i KSA të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko- trashëgimor) afati i anulimit i testamentit për personin në keqbesim është 20 vite pas shpalljes së testamentit, ndërsa mirëfilli dihet se të paditurit kanë vepruar në keqbesim"*.

30. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se gjykatat e rregullta nuk kanë adresuar padinë e tyre dhe nuk kanë dhënë arsyetim për vendimet e tyre lidhur me të drejtën e parashtruesve për të trashëguar pronën e të ndjerit Ejup Bajrami, si trashëgimtar ligjor të Isak Shabanit, kështu që "*dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota në lidhje me [...] të drejtën e parashtruesve të kërkesës në trashëgimi si trashëgimtar ligjor e cila u është mohuar pa bazë ligjore, paraqet shkelje të drejtës për t'u dëgjuar dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar si pjesë përbërëse të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ-në."*

31. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë më tej se Gjykata Supreme e Kosovës, duke refuzuar revizionin e tyre, ka shkelur të drejtën e tyre në pronë *"kjo për faktin se tani paraardhësi i tyre si trashëgimtar legjitim në mënyrë kundërligjore e drejta në trashëgimi"* i është mohuar, përderisa e drejta në pronë është e garantuar me Kushtetutë dhe gëzimi i pronës rregullohet me ligj, prandaj *"askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona."*

32. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, pretendojnë që Gjykata Themelore nuk i ka plotësuar detyrimet e saj ligjore nga nenet 76 dhe 78 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me legjitimitetin aktiv kur i lejoi Alije Shabanit (bashkëshortes së të ndjerit Isak Shabani) që të përfshihet si palë në procedurë edhe pse sipas ligjit për trashëgiminë asaj *"i mungon legjitimimi real aktiv për të qenë palë paditëse në këtë kontest, ngase [...] nuk mund të trashëgoj pasurinë e babait të bashkëshortit të saj"*.

33. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë se të drejtat e tyre janë shkelur dhe t'i shpallin të pavlefshme aktgjykimet e gjykatave të rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të parashikuara në Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

36. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, se i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe kanë dorëzuar kërkesën në kohën e duhur.

37. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

38. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] së Rregullores së punës, të cilët parashohin:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

39. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtave të tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje të pronës dhe për barazi para ligjit.

40. Gjykata vëren se, lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në bazë të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit pretendojnë se:

(i) gjykatat e rregullta vendosën në mënyrë të paligjshme që kërkesa e tyre për anulimin e pjesshëm të testamentit ishte parashkruar;
(ii) gjykatat e rregullta dështuan të adresojnë dhe të japin përgjigje të qarta dhe të plota lidhur me të drejtën e parashtruesve të kërkesës për trashëgimi si pasardhës të Isak Shabanit; dhe,
(iii) gjykatat e rregullta shkelën legjislacionin kur ato lejuan që Alije Shabani të përfshihej si palë në procedurë, edhe pse asaj i mungon legjitimiteti real aktiv për t'u konsideruar si palë në këtë kontest, sepse ajo nuk mund të trashëgojë pasurinë e babait të bashkëshortit të saj.

41. Lidhur me pretendimin *(i),* Gjykata vëren se Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 263/2016) vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

42. Në të vërtetë, Gjykata Themelore konsideroi se *"[...] me dispozitën e nenit 54 të Ligjit për Trashëgiminë (1974), veç tjerash, parashihet se anulimin e testamentit [...] mund t'a kërkojë vetëm personi që ka interes juridik [...] brenda afatit prej një viti nga dita kur ka marrë dijeni se ekzistojnë shkaqet e pavlefshmërisë [...]."*

43. Përveç kësaj, Gjykata Supreme më tej specifikoi se parashtruesit e kërkesës *"anulimin e [Testamentit] e kanë kërkuar me parashtresën e dt.22.11.2013, respektivisht, me*

parashtresën e dt.10.10.2014 kur kërkojnë anulimin e pjesërishëm të testamentit [...].Nga kjo rrjedh se, nëse jo më herët, atëherë së paku me dt.7.10.2011 [parashtruesit e kërkesës] kanë ditur për testamentin [...], por që veprimet përkatëse të lartcekura janë marrë nga [parashtruesit e kërkesës] në datat e sipërpërmendura, [...] d.m.th. pas afateve të parapara ligjore."

44. Lidhur me pretendimin (ii), Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Themelore (Aktgjykimi C. nr. 1477/08) theksoi se *"paraardhësi i [parashtruesve të kërkesës], Ejup Shabani, ka bërë ndarjen faktike të pasurisë- Isak [Shabani] ka marrë pjesën e vetë të trashëgimisë duke shfrytëzuar mjete financiare dhe ngastrat e lartcekura për të ndërtuar dy shtëpi dhe lokal afarist, po ashtu ka përvetësuar në emër të pjesës së tij trashëgimore edhe ngastrën kadastrale 7161 në sip. prej 23 ari".*

45. Gjykata Themelore theksoi më tej që *"duke u mbështetur në nenin 40 të Ligjit mbi Trashëgiminë, gazeta zyrtare e KSAK-së nr. 43174, [...] çdo trashëgimtari ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi në çfarëdo mënyre".*

46. Për më tepër, Gjykata Themelore konkludoi që *"trashëgimlënësi Ejup paraardhësit të [parashtruesve të kërkesës] të ndjerit Isak Shabani, ashtu siç e ka thënë edhe në testament i ka nda pjesën e vet të trashëgimisë".*

47. Vlerësimet e Gjykatës Themelore u konfirmuan nga Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin AC. nr. 1219/2015) dhe Gjykata Supreme (me Aktgjykimin Rev. nr. 263/2016), siç vijon.

48. Në të vërtetë, Gjykata e Apelit "në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të [Gjykatës Themelore] duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e [parashtruesve të kërkesës] është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e [Gjykatës Themelore]".

49. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konsideroi se *"aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të [Ligjit për Procedurën Kontestimore], të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike".*

50. Përkitazi me pretendimin *(iii),* Gjykata Themelore (me Aktgjykimin C. nr. 1 477/08) theksoi se " *[parashtruesit e kërkesës, duke përfshirë Alije Shabani] pasardhës të të ndjerit Isak Shabani dhe duke qenë pasardhës kanë legjitimitet real aktiv në këtë çështje".* Ky konkludim u konstatua si i ligjshëm nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

51. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë vlerësuar faktet dhe kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale në lidhje me kërkesën e tyre. Konkluzionet e tyre u arritën pas ekzaminimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesit dhe të padituri.

52. Gjykata më tej vëren se parashtruesit e kërkesës përsërisin para Gjykatës të njëjtat argumente që kishin parashtruar në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në veçanti, lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta.

53. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28.

54. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt". Shih: GJEDNJ*,* rasti *Akdivar kundër Turqisë,* nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih edhe: *mutatis mutandis* Gjykata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012.

55. Me fjalë të tjera, vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i drejtë i ligjit është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë).

56. Fakti i thjeshtë që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentueshme për shkeljen e të drejtave të tyre të mbrojtura me Kushtetutë.

57. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesit e kësaj kërkese të kenë pasur gjykim të drejtë. Shih: *inter alia,* rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991.

58. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta kur i referohet pretendimeve të parashtruesve për shkelje të ligjit procedural dhe material është i justifikuar dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare. Shih: GJEDNJ, rasti *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009.

59. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të parashtruesve të kërkesës të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton që e drejta në pronë zbatohet vetëm për pasuritë ekzistuese të një personi dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës. Shih: *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës*, nr. 6633/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1879, paragrafi 50.

60. Në rrethana të caktuara "*pritja legjitime*" për përvetësimin e pasurisë mund të gëzojë gjithashtu mbrojtje nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Shih: *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, para. 74.

61. Megjithatë, Gjykata rikujton se nuk mund të thuhet se "pritshmëria legjitime" paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit vendor kurse, kërkesat e parashtruesve i hedhin poshtë gjykatat vendore më vonë. Shih: *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, Ibidem, para.75.

62. Gjykata konsideron se rrethanat e rastit nuk u kanë dhënë parashtruesve të drejtë në një interes material të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

63. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se gjykata e rregullt ua kishte shkelur të drejtën e tyre për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.

64. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

65. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Shih rastin e GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33.

66. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk e kanë mbështetur pretendimin që tregon se ata ishin të diskriminuar në procedurat në gjykatat e rregullta.

67. Si përmbledhje, Gjykata më tej konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur fakte që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese e të drejtave të tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtje të pronës dhe barazi para ligjit.

68. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, është e papranueshme në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (d), 36 (2) (d) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI138/16 Parashtrues i kërkesës Gani Gërbeshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Kzz. 136/16, të 14 korrikut 2016

KI138/16 Aktvendimi për papranueshmëri i 3 majit 2017 i publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyçe*: Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar*

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me paragrafin 5 të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me paragrafin 1.2 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Gjykata konkludoi në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura se parashtruesi nuk i mbështeti pretendimet e tij dhe nuk dëshmoi shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbushi kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës dhe e deklaroi atë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI138/16

Parashtrues

Gani Gërbeshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Kzz. 136/16, të 14 korrikut 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gani Gërbeshi, nga fshati Ropicë, komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Mahmut Halimi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin Pml. kzz. 136/16 të Gjykatës Supreme, të 14 korrikut 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. 132/14, të 30 korrikut 2015 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 474/15, të 14 janarit 2016.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 gusht 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 5 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me paragrafin 1.2 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje Gjykatës Supreme.

9. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 17 dhjetor 2014, Prokurori në Mitrovicë parashtroi në Gjykatën Themelore aktakuzën PP. nr. 179/14, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë.

11. Më 30 korrik 2015, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 132/14) shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale vrasje e rëndë dhe e dënoi atë me burgim.

12. Më 27 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: *"Shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale*; V*ërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike; Shkeljes së ligjit penal; dhe Vendimit për dënimin"*.

13. Më 14 janar 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 474/15], aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pjesën e saj të dënimit dhe duke refuzuar si të pabazuar pjesën e mbetur të ankesës, duke vërtetur aktgjykimin e kundërshtuar.

14. Më 10 maj 2016, parashtruesi parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, dispozitiv të pakuptueshëm dhe kontradiktor, shkelje të nenit 394 (1) të KPP, shkelje të parimeve *in dubio pro reo* dhe të pavarësisë së gjykatave, si dhe kualifikim të gabuar të veprës penale.

15. Më 14 korrik 2016, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të 14 janarit 2016. Në dispozitiv të aktgjykimit theksohet:

> *"... Kolegji i Gjykatës Supreme gjen që gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë përcaktuar drejt elementet e krimit dhe konsideron se mbrojtja nuk arriti të provojë shkeljen e ligjit penal. Kolegji vëren se Gjykata e Apelit ka analizuar me kujdes jurisprudencën e paraqitur nga mbrojtja. Vepra*

penale është cilësuar në mënyrë korrekte si vrasje e rëndë sipas nenit 179 (1) (5) të KPK-së."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe parimet e prezumimit të pafajësisë dhe *in dubio pro reo* janë shkelur në procedurat e kryera në gjykatat e rregullta.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*të tri gjykatat në mënyrën më të rëndë kanë shkelur parimin "in dubio pro reo" në dëm të dënuarit Gani, sepse mbrojtja është fakt se ka paraqitur interpretim të kundërt të asaj që shihet në video-incizim, gjë që nuk do të thotë se është shtrembëruar përshkrimi real i asaj që shihet dhe kështu i është dhënë interpretim tjetër shpjegimit të provës".*

18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata "*(...) të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të garantuara me nenin 31. par. 5 të Kushtetutes së Republikës së Kosovës, nenit 6. par. 1 dhe 2 të KEDNJ dhe nenit 3. par.1 dhe 2 të KPPRK; (...) të shpallë të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Themelore ne Mitrovicë, të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës të sfiduara me këtë kërkesë; dhe të urdhërojë që kjo çështje të kthehet në rigjykim dhe rivendosje (...)".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të parashikuara në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet], i cili përcakton se *"kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

22. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatin e paraparë dhe se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

23. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

24. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."

25. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar saktë se si dhe pse pretendohet se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
26. Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës "*të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

27. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) është përcaktuar se "*roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e të drejtës procedurale dhe materiale". Shih: mutatis mutandis,* rasti i GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, i 21 janar 1999, paragrafi 28.

28. Gjykata gjithashtu përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës se katërt". Shih: rasti i GJEDNJ-së *Akdivar kundër Turqisë,* nr. 21893/93, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65. shih edhe: *mutatis mutandis* Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit shqyrtoi tërësisht provat dhe analizat e bëra nga Gjykata Themelore.

30. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit nuk ka mundur të shohë "*asnjë kundërthënie apo mospërputhje të dukshme në mes të gjetjeve të trupit gjykues dhe provave të prezantuara në gjykim siç është video-xhirimi apo fotografitë dhe regjistrimet e bëra në vendin e krimit"*. Gjykata e Apelit konsideroi se *"mbrojtja nuk ka arritur të mbështesë me prova apo ta identifikojë asnjë kundërthënie në këtë aspekt"*. Ajo konkludoi se *"Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesë në emër të Gani Gërbeshit nuk i zbehin gjetjet në fjalë"*.

31. Gjykata më tej vëren se Gjykata Supreme ka shqyrtuar tërësisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, dispozitivit të pakuptueshëm dhe kontradiktor, shkeljes së nenit 394 (1) të KPP, shkelje të parimeve *in dubio pro reo* dhe pavarësisë së gjykatave, cilësimit të veprës si vrasje e rëndë në pajtim me nenin 179 (1) (5) të KPK-së, si dhe bashkëkryerje dhe qëllimin e mundshëm. Pastaj, Gjykata Supreme konstatoi se *"gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë përcaktuar drejt elementet e krimit dhe konsideron se mbrojtja nuk arriti të provojë shkeljen e ligjit penal"*.

32. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në mënyrë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse kanë marrë parasysh dhe kanë analizuar të gjitha pretendimet e bëra nga parashtruesi në

ankesat e tij. Përveç kësaj, gjykatat e rregullta i përshkruan plotësisht dhe i vlerësuan provat veçanërisht dhe në lidhje të ndërsjellë.

33. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme vlerësoi se *"një pjesë e madhe e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundërshton vlerësimin e provave të bëra nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit"*.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon në Gjykatë shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të *"interpretimit të ndryshëm të shpjegimit të provave"*. I njëjti pretendim është parashtruar në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme dhe ishte shqyrtuar plotësisht dhe ishte përgjigjur në mënyrë të arsyeshme nga to.

35. Gjykata vëren se parashtruesi përsërit para saj të njëjtat argumente që ai kishte parashtruar në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në veçanti, në lidhje me vlerësimin e provave dhe vërtetimin pasues të gjendjes faktike.

36. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

37. Gjykata përsërit se është përtej kompetencës së saj të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ky vlerësim është qartazi arbitrar. Gjykata tanimë ka vlerësuar se gjykatat e rregullta kanë kryer një procedurë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të provave në të cilën janë administruar provat e paraqitura nga mbrojtja dhe prokuroria.

38. Përveç kësaj, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (çështje e kushtetutshmërisë). Shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, para. 68.

39. Për më tepër, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur ose se parashtruesi ishte i privuar nga ndonjë garanci procedurale, e cila mund të çojë në shkelje të asaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1, të nenit 6 të KEDNJ-së.

40. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i dëshmojë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, 5 dhjetor 2013).

41. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin e tij dhe as nuk ka paraqitur dëshmi *prima facie* që tregojnë se ka pasur shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

42. Gjykata më tej konsideron se ajo nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt".

43. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (d) , (2) (b) dhe 56 të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Arta Rama-Hajrizi

KI133/16, Parashtrues i kërkesës: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "3CIS JSC", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 232/2015, të 9 marsit 2016

KI133/16, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2017, i publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontratë, pronë, tatim mbi vlerën e shtuar, administrata tatimore, shërbimet, prima facie*

Më 7 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës e pranoi Njoftimin për rivlerësimin e tatimit të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ATK).

Me këtë njoftim, pas kontrollit të bazuar në librat e regjistrimit të parashtruesit të kërkesës, ATK-ja ka përcaktuar se parashtruesi është i detyruar t'i paguaj detyrimet e tatimit mbi vlerën e shtuar (në tekstin e mëtejmë: TVSH) në vlerë prej 424,321.98 €, për periudhat tatimore fiskale 2008, 2009 dhe 2010.

Parashtruesi i kërkesës udhëhoqi kontestin i cili përfundoi me Aktgjykimin (A.A. nr. 232/2015) e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e cila e vërtetoi Vendimin nr. 243/2013, të datës 19.09.2013 të Departamentit për Ankesa të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës konsideroi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk e ka përcaktuar vendin e furnizimit të shërbimeve; nuk e ka arsyetuar obligimin për pagimin e TVSH-së nga ana e parashtruesit; se Gjykata e Apelit mori parasysh vetëm pretendimet e ATK-së dhe se Gjykata e Apelit nuk e ka respektuar parimin e barazisë së armëve; se Gjykata e Apelit është dashur të angazhojë një ekspert për interpretimin e normave ligjore; se aktgjykimi është bazuar vetëm në zbatimin e nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores 2002/17 për TVSH-në dhe të plotësuar me Ligjin nr. 2004/48; se Gjykata e Apelit nuk ka mundur të përcaktojë në mënyrë të qartë synimin e ligjvënësit në lidhje me përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimeve elektronike dhe për këtë arsye në këtë rast Gjykata e Apelit duhet të kishte zbatuar Direktivën e Bashkimit Evropian 2006/112/EC, të 28 nëntorit 2006.

Gjykata konstatoi se parashtruesi i përsëritë të njëjtat pretendime të cilat janë theksuar edhe në procedurat para gjykatave të rregullta, ku Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin A. A. nr. 232/2015) dha përgjigje të detajuar për të gjitha këto pretendime të parashtruesit, duke arsyetuar se: *"... Sipas nenit 9 par. 2 të Rreg. nr. 2001/11, të ndryshuar me Rreg. nr. 2002/17, dhe e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-114 për TVSH, përcaktohet se, citim: „Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportit bëhet në vendin e punës së furnizuesit. Ndërsa kur kjo nuk mund të përcaktohet, atëherë bëhet në vendin ku ofrohen shërbimet". Duke bërë interpretimin e këtij neni Kolegji vlerëson se gjithçka është e qartë dhe nuk ka paqartësi se për periudhën nga viti 2008 e gjer më 30.06.2010, sa ishte në fuqi ky ligj obligimi për kryerjen e shërbimeve të transportit dhe furnizime të tilla si në rastin konkret të paditësit për shërbimet e kryera jashtë Kosovës duhet ngarkuar me TVSH si vendi i furnizimit dhe selisë së paditësit".*

Gjykata konstatoi se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë argumentet dhe dëshmitë, që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI133/16

Parashtrues

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "3CIS JSC"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A. A. nr. 232/2015, të 9 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "3CIS JSC" (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Petrit Prekazi, në bazë të autorizimit të lëshuar nga drejtori gjeneral i parashtruesit të kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin (A. A. nr. 232/2015, të 9 marsit 2016) e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, të cilin ai e ka pranuar më 25 korrik 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 12 janar 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë.

8. Më 8 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës e pranoi Njoftimin për rivlerësimin e tatimit të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ATK).

10. Me këtë njoftim, pas kontrollit të bazuar në librat e regjistrimit të parashtruesit të kërkesës, ATK-ja ka përcaktuar se parashtruesi është i detyruar t'i paguaj detyrimet e tatimit mbi vlerën e shtuar (në tekstin e mëtejmë: TVSH) në vlerë prej 424,321.98 €, për periudhat tatimore fiskale 2008, 2009 dhe 2010.

11. Më 12 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë (nr. 243/2013) në ATK, Departamenti për ankesa, në të cilën theksoi se zbatimi i legjislacionit nga ana e AKP-së, ka qenë i padrejtë, për shkak se AKP nuk i ka analizuar transaksionet specifike të cilat janë kryer jashtë vendit.

12. Më 19 shtator 2013, ATK-ja Departamenti për ankesa (Vendimi nr. 243/2103) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

13. Më 17 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër të padituresë ATK në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

14. Parashtruesi i kërkesës në padi ka pretenduar se ATK-ja, në rastin kur e ka ngarkuar parashtruesin e kërkesës si tatimpagues me TVSH, në mënyrë të gabuar ka interpretuar dhe zbatuar dispozitat e Ligjit për TVSH-në.

15. Më 24 qershor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (me Aktgjykimin A. nr. 1350/13) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, si të bazuar, dhe e anuloi Vendimin (nr. 243/2013) e ATK-së – Departamenti për ankesa në Prishtinë, dhe Njoftimin e rivlerësimit të taksave të AKP-së.

16. ATK ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 9 mars 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë (me Aktgjykimin A. A. nr. 232/2015) e aprovoi ankesën e ATK-së dhe urdhëroi si në vijim:

> *"I. Aprovohet ankesa e të padituresë, Administrata Tatimore e Kosovës, në Prishtinë.*

II. Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, divizioni fiskal, A. nr. 135011 3, i datës,26.06.2015
III. Refuzohet padia e paditësit, "3 Cis", (JSC), sh.p.k., me seli në Prishtinë.
IV. Vërtetohet Vendimi nr. 243/2013, i datës 19.09.2013, i Departamentit për Ankesa i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë."

18. Më 5 tetor 2016, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit duke kërkuar që të iniciojë procedurën në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit (A. A. nr. 232/2015), të Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

19. Më 7 tetor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me Njoftimin KMLA. nr. 7/2016 e informoi parashtruesin e kërkesës si në vijim:

"Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ju njoftojmë se propozimi i juaj nuk është aprovuar, sepse sipas vlerësimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, nuk ekzistojnë arsyet e mjaftueshme ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parapara me nenin 247 paragrafi 1 pika a) dhe b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës së pari konsideron se çështja kryesore në lidhje me tatimet detyruese është nëse ai fare mund të jetë tatimpagues i TVSH-së në Kosovë, duke marrë parasysh se kjo kompani ofron shërbime profesionale nga një distancë për klientët nga jashtë në fushën e rrjeteve të telekomunikacionit, konfigurimin dhe projektimin, testimin dhe ekspertizën e pajisjeve, si dhe integrimin dhe menaxhimin e rrjeteve të telekomunikacionit me teknologji të avancuar.

21. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se përcaktimi i vendit të ofrimit të shërbimeve elektronike paraqet bazën për përcaktimin e taksave.Ai me tej pretendon se ka paqartësi në lidhje me legjislacionin dhe rregulloret përcjellëse në lidhje me TVSH-në, për një lloj të tillë specifik të punës së kryer nga parashtruesi dhe se për këtë arsye është dashur të zbatohet Direktiva e Bashkimit Evropian 2006/112/EC, e 28 nëntorit 2006, ashtu siç ka vepruar Gjykata Themelore në Prishtinë.

22. Parashtruesi i kërkesës konsideron se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk e ka përcaktuar vendin e furnizimit të shërbimeve; nuk e ka arsyetuar obligimin për pagimin e TVSH-së nga ana e parashtruesit; se Gjykata e Apelit mori parasysh vetëm pretendimet e ATK-së dhe se Gjykata e Apelit nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve; se Gjykata e Apelit është dashur të angazhojë një ekspert për interpretimin e normave ligjore; se aktgjykimi është bazuar vetëm në zbatimin e nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores 2002/17 për TVSH-në dhe të plotësuar me Ligjin nr. 30/L-114 për TVSH; që këto dispozita nuk zbatohen në rastin e parashtruesit; se këto dispozita janë në kundërshtim të plotë me qëllimin dhe frymën e Ligjit nr.2004/48; se Gjykata e Apelit nuk ka mundur të përcaktojë në mënyrë të qartë synimin e ligjvënësit në lidhje me përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimeve elektronike dhe për këtë arsye në këtë rast Gjykata e Apelit duhet të kishte zbatuar Direktivën e Bashkimit Evropian 2006/112/EC, të 28 nëntorit 2006.

23. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk ka "*ka dhënë përgjigje të qartë dhe të plotë në lidhje me pyetjen kryesore përkitazi me përcaktimin e detyrimit të pagesës së TVSH-së për shërbimet e ofruara klientëve të huaj jashtë Kosovës, dhe kjo paraqet shkelje të së drejtës se parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.*"

24. Duke u nisur nga pretendimet e lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës konkludon se keqinterpretimi i nenit 9, paragrafi 2, të Rregullores 2002/17 në fillim nga ATK-ja, i cili më vonë është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, çoi në shkeljen e të drejtave të parashikuara me nenet 3, 24 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata ta shpallë kërkesën të pranueshme dhe ta deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113. [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

28. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> "*4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme*."

29. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

30. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(c) kërkesa nuk arsyetohet prima facie".*

31. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, i ka shteruar mjetet efektive juridike, pra që i ka plotësuar kriteret procedurale të përcaktuara me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër muajsh, siç kërkohet me nenin 49 të Ligjit.

32. Megjithatë, për të përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 36 të Rregullores së punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjore duke pretenduar kryesisht se aktgjykimi në rastin e tij është nxjerrë në bazë të interpretimit të gabuar dhe jo të plotë të ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave të rregullta.

34. Në fakt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet neneve 3, 22, 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, në esencë të gjitha pohimet e parashtruesit janë të ndërlidhura me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

35. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsëritë të njëjtat pretendime të cilat i ka theksuar edhe në procedurat para gjykatave të rregullta, ku Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin A.A. nr. 232/2015) dha përgjigje të detajuar për të gjitha këto pretendime të parashtruesit, duke arsyetuar se:

> *"... Sipas nenit 9 par. 2 të Rreg. nr. 2001/1 "i ndryshuar me Rreg. nr. 2002/17 dhe e ndryshuar me dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-114 për TVSH, përcaktohet se, citim: "Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë edhe shërbimin e transportit bëhet në vendin e punës së furnizuesit. Ndërsa kur kjo nuk mund të përcaktohet, atëherë bëhet në vendin ku ofrohen shërbimet". Duke bërë interpretimin e këtij neni Kolegji vlerëson se gjithçka është e qartë dhe nuk ka paqartësi se për periudhën nga viti 2008 e gjer më 30.06.2010, sa ishte në fuqi ky ligj obligimi për kryerjen e shërbimeve të transportit dhe furnizime të tilla si në rastin konkret të paditësit për shërbimet e kryera jashtë Kosovës duhet ngarkuar me TVSH si vendi i furnizimit dhe selisë së paditësit."*

36. Më tej, Gjykata e Apelit (me Aktgjykimin A. A. nr. 232/2015) dha përgjigje të detajuar pse Gjykata Themelore në Prishtinë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe procedurale, duke arsyetuar:

> *"Kolegji nuk mund ta pranoj si të drejtë interpretimin e dispozitave ligjore nga gjykata e shkallës së parë e cila nenin 9.2 të cekur si më lart e vlerëson si jo të plotë dhe jo të qartë duke bërë përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimeve veçanërisht kur bëhet fjalë për shërbime elektronike, sepse kjo dispozitë përcakton qartë së vendi prej nga ofrohen shërbimet bëhet në vendin e punës së furnitorit e nëse nuk mund të përcaktohet, atëherë bëhet në vendimin ku ofrohen shërbimet. Andaj Kolegji nuk i pranon si të drejtë që mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë bazohet në dispozitat e Ligjit 03/L-146 për TVSH, për periudhën 2008-30.06.2010,i cili nuk ishte në fuqi për periudhën për të cilën paditësi është ngarkuar me TVSH, në bazat ligjore të cekura si më lart".*

37. Gjykata përsëritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç apo për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës kur pretendon se autoriteti publik ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të mbrojtura me Kushtetutë.

38. Gjykata rikujton se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara materiale apo të metat juridike të gjykatave të rregullta, nëse me këto

gabime nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë, dhe vetëm në atë masë në të cilën kanë ndodhur shkelje të tilla.

39. Për më tepër, detyra e Gjykatës Kushtetuese është të përcaktojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat (Shih rastin *Dukmedjian kundër Francës*, kërkesa nr. 60495/00, paragrafi 71, GJEDNJ, Aktgjykimi i 31 janarit 2006).

40. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu rithekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe jo të merret me interpretimin dhe zbatimin e ligjit të brendshëm, ngase kjo është detyrë e gjykatave të rregullta (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi t'i paraqesë para gjykatave të rregullta argumentet dhe arsyetimet e tij, materiale dhe ligjore, për zgjidhjen e kontestit; argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe gjykatat e rregullta; procedurat ishin, shikuar në tërësi, të drejta dhe vendimet e marra ishin plotësisht të arsyetuara.

42. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë pretendim të argumentuar për shkeljen e të drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih: *mutatis mutandis* rasti *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 1, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur pretendim të mbështetur dhe konkret në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij dhe nuk ka shpjeguar se si apo pse Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit mund të këtë shkelur të drejtat e tij kushtetuese; ai vetëm theksoi se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie,* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih: *Trofimchuk kundër Ukrainës,* GJEDNJ, paragrafi 50-55, Aktgjykimi nr. 4241/03, i 28 tetorit 2010).

44. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis: Shub kundër Lituanis*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

45. Prandaj, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë, të parashikuara me Ligj dhe të përcaktuara në Rregulloren e punës, nuk janë plotësuar.

46. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama

KI117/16, Parashtrues Rexhep Lushtaku, Tahir Meha, Shefqet Bytyqi, Bedri Gashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.nr.18/16, të 23 prillit 2016

KI117/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 prillit 2017, publikuar më 13 qershor 2017

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, parimet e përgjithshme, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, e drejta e punës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin ARJ.nr.18/16, të 23 prillit 2016 , me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.45/2016, të 2 marsit 2016.

Parashtruesit ndër të tjera pretenduan, se Gjykatës Supreme e Kosovës ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, respektivisht parimet e përgjithshme, barazinë para ligjit, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe të drejtën për mbrojtja gjyqësore e të drejtave, duke ua refuzuar kërkesën për kompensim të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e kujdestarisë për mbajtjen e punës gjatë natës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjshmërisë.

Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur dhe dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/16

Parashtrues

Rexhep Lushtaku
Tafil Meha
Shefqet Bytyqi
Bedri Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ nr. 18/16,
të 23 majit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rexhep Lushtaku, Tafil Meha, Shefqet Bytyqi dhe Bedri Gashi, që të gjithë me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ nr. 18/16, të 23 majit 2016, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar rishqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit gjyqësor i parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 45/2016, të 2 marsit 2016.

3. Vendimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 2 qershor 2016.

4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civilë të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPM) A/02/126/2014, të 2 majit 2014 dhe Vendimit të Komisionit për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nr. 123/14 (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Ankesa i KSK-së), të 19 majit 2014.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e garantuara me

nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) si dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 26 shtator 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 28 shtator 2016, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë një dokument shtesë.

9. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

10. Më 9 nëntor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

11. Më 4 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës themeluan marrëdhënie pune me Këshillin e Sigurisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KSK), si zyrtarë për grumbullimin dhe përpunimin e informatave.

13. Më 9 shkurt, 10 mars, 4 qershor, 6 korrik, 8 tetor 2010, dhe më 11 janar 2011 parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në KSK, duke kërkuar kompensimin material për punën e kryer jashtë orarit të punës.

14. Më 25 nëntor 2011, KSK-ja (Vendimi 271/2011) refuzoi kërkesën e parashtruesve, me arsyetimin se ata nuk kanë punuar jashtë orarit, por kanë punuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e parapara me kontratën e punës, ku ndër të tjera parashihet se ata duhet të jenë të gatshëm të punojnë me rotacion, që nënkupton edhe punë në orarin e natës.

15. Më 29 nëntor 2011, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Sekretariatin e Komisionit për Ankesa të KSK-së, për shkak të moskompensimit të pagesës për punën jashtë orarit, vërtetimit të gabuar të fakteve dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 5 dhjetor 2011, Sekretariati i KSK-së lëshoi Vendimin e përgjithshëm 237/2011, dhe vendosi që të gjithë zyrtarët e Sekretariatit të KSK-së dhe Qendrës së Situatave do të marrin pagesë retroaktive për shkak të punëve dhe detyrave shtesë nga muaji prill deri në nëntor 2011.

17. Më 12 janar 2012, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në KPM, për shkak se Komisioni për Ankesa i KSK-së nuk kishte nxjerrë asnjë vendim (kishte heshtur) lidhur me ankesën e parashtruesve të 29 nëntorit 2011. Parashtruesit kërkuan që të bëhet kompensimi i plotë i orëve të papaguara të punës jashtë orarit (kujdestarive), pasi që një pjesë e tyre nuk ishte paguar në bazë të Vendimit 237/2011 të Komisionit për Ankesa të KSK-së, të 5 dhjetorit 2011.

18. Më 16 janar 2012, Komisioni për Ankesa i KSK-së (Vendimi nr. 08/12) refuzoi ankesën e parashtruesve. Në vendim arsyetohej se "*1) Aktet nënligjore, të cilat do të duhej të rregullonin pjesën e kujdestarive për Shërbyesit Civilë, janë akoma në procesin e draftimit. 2) Pas llogaritjes së orëve të kaluara në punë, duke marrë për bazë orarin e punës, zyrtarët në fjalë nuk kanë më shumë se 40 orë punë në javë, prandaj nuk bëjnë punë jashtë orarit. 3) Mungojnë mjetet financiare [...].*"

19. Më 21 shkurt 2012, Drejtori i Qendrës së Situatave të KSK-së i dërgoi një shkresë Ministrisë së Financave, ku kërkoi ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë.

20. Më 29 shkurt 2012, Ministria e Financave i dërgoi një shkresë shtesë Drejtorit të Qendrës së Situatave të KSK-së, ku e informoi se nuk ka mundësi që të bëhet ndarja buxhetore e mjeteve shtesë pa aprovimin paraprak të Kuvendit. Për më tepër, në vendim thuhet: "*Në pamundësi për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë, ju rekomandoj që të shikoni mundësinë e plotësimit të kërkesës së juaj përmes transferimit të mjeteve nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve nga programet tjera të ZKM-ës, konform me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 04/L-079, si dhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.*"

21. Më 3 prill 2012, KPM-ja (Vendimi nr. 02/05/2012), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe e la në fuqi Vendimin nr. 08 /12, të Komisionit për Ankesa të KSK-së të 16 janarit, duke arsyetuar se Komisioni për Ankesa i KSK-së për shkak të mungesës së mjeteve financiare ka vepruar në pajtim me Ligjin për Buxhetin nr. 04/L-079.

22. Më 25 prill 2012, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Supreme, për anulimin e Vendimit nr. 02/05/2012 të KPM-së, për shkak të shkeljes së rregullave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjshmërisë.

23. Më 3 maj 2012, KPM-ja paraqiti në Gjykatën Supreme të Kosovës, përgjigje në padi.

24. Padia e parashtruesve e parashtruar në Gjykatën Supreme i është referuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore). Në të vërtetë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për gjykatat më 1 janar 2013, Gjykata Themelore u bë organ kompetent për të adresuar pretendimet e parashtruesve në procedurën administrative.

25. Më 30 dhjetor 2013, parashtruesit e kërkesës zgjeruan padinë në Gjykatën Themelore me kompensim shtesë të pagave (mbajtjen e kujdestarive) gjatë vitit 2013.

26. Më 10 mars 2014, Gjykata Themelore (Aktgjykimi A. nr. 546/12), aprovoi padinë e parashtruesve të kërkesës dhe e anuloi Vendimin nr. 02/05/2012, të 3 prillit 2012, të KPM-së. Në aktgjykim arsyetohet se "*organi i paditur KPMSHCK nuk është dashur që gjatë vendimmarrjes të lëshohet në vendimin nr. 08/12 të datës 16.1.2012 të nxjerrë nga Komisioni për konteste dhe ankesa pranë KSK-së, pasi që ky vendim është lëshuar*

jashtë afatit ligjor, dhe është nxjerrë pasi që paditësit kanë parashtruar ankesë tek organi i paditur". Përveç kësaj, në aktgjykim theksohet se KPM-ja nuk i ka adresuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e parashtruesve të kërkesës.

27. Më 2 maj 2014, KPM-ja (Vendimi A/02/126/2014) e anuloi Vendimin e Komisionit për Ankesa të KSK-së 08/12, të 16 janarit 2012, e obligoi Sekretariatin e KSK-së që sërish ta shqyrtojë ankesën e parashtruesve të 29 nëntorit 2011, dhe e obligoi KSK-në që ta zbatojë këtë vendim në afat prej 15 ditëve.

28. Më 19 maj 2014, KSK-ja (Vendimi nr. 123/2014) refuzoi ankesën e parashtruesve të 29 nëntorit 2011. Në vendim theksohej se kompensimi për mbajtjen e kujdestarive parashtruesve ju kompensohet me ditë pushimi, ndërsa ata nuk kryejnë punë jashtë orarit. Më tutje, në aktvendim theksohet: *"Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës ka kërkuar nga Ministria e Financave mjete shtesë [..] për kompenzimin e kujdestarive për stafin e Qendrës së Situatave , ku kompenzimi të bëhet me pagesë e jo me ditë pushimi pasi kjo shkakton vështirsi në mbarëvajtjen e punëve, por kjo kërkesë është refuzuar*."

29. Më 6 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në Gjykatën Themelore kundër Vendimit të KPM-së A/02/126/2014, të 2 majit 2014, për shkak të shkeljes së të drejtës procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes të ligjshmërisë.

30. Më 31 gusht 2015, KPM-ja paraqiti në Gjykatën Themelore përgjigje në padi, duke kërkuar që padia e parashtruesve të hidhet poshtë si e palejuar sepse është parashtruar jashtë afatit.

31. Më 7 dhjetor 2015, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në KPM, ku kërkuan shpalljen e Vendimit 123/14, të KSK-së, të 19 majit 2014, akt absolutisht të pavlefshëm.

32. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Themelore (Aktgjykimi A. nr. 853/2014) refuzoi padinë si të pabazuar "*sepse kjo gjykatë vlerësoi se me rastin e rivendosjes organi i paditur, KPMSHCK ka marrë për bazë të gjitha vërejtjet si në aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, se nga faktet e vërtetuara drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje të konstatuar dhe në procedurën e administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor del se nuk është shkelur edhe drejta materiale në dëm të paditësve*."

33. Më 17 dhjetor 2015, KPM-ja njoftoi parashtruesit e kërkesës se kërkesa e tyre është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

34. Më 18 janar 2016, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, të 14 dhjetorit 2015.

35. Më 2 mars 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AA. nr. 45/2016), refuzoi ankesën si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 14 dhjetorit 2015. Në aktgjykim konsiderohej se gjendja faktike ishte vërtetuar drejtë dhe se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm.

36. Më 20 prill 2016, parashtruesit e kërkesës parashtruan te Kryeprokurori i Shtetit propozim për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, A. nr. 853/2014, të 14 dhjetorit 2015, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA. nr. 45/2016, të 2 marsit 2016.

37. Më 20 prill 2016, parashtruesit e kërkesës, parashtruan kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 45/2016, të 2 marsit 2016.
38. Më 27 prill 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (Njoftimi KMLA. nr. 2/16), njoftoi parashtruesit e kërkesës se nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

39. Më 23 maj 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi ARJ. nr. 18/2016), refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe arsyetoi se "*në rastin konkret nuk kemi akt administrativ të nxjerrë në procedurë administrative në shkallë të dytë andaj kjo gjykatë nuk u lëshua në shkeljet eventuale të së drejtës materiale [...] Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm.*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ.

41. Parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se *"e drejta jonë është shkelur në atë menyrë që me vendimet e lartpërmenduara jemi dëmtuar, sepse na mohuan të drejtën e kompenzimit të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e kujdestarisë, punës gjatë natës, punës gjatë festave zyrtare si dhe realizimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte specifike të punës.*"

42. Parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se *"dështimi i Gjykatës për të dhënë përgjigje rreth kompenzimit të dëmit, paraqet shkelje të të drejtës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e të drejtës pë gjykim të drejtë dhe të paanshëm.*"

43. Parashtruesit e kërkesës, më tej, pretendojnë se Vendimi A/02/126/2014 i KPM-së, i 2 majit 2014, është arbitrar sepse nuk është i bazuar në fakte dhe prova të paraqitura në ankesë dhe se është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se "*Vendimi i KPMSHCK A/02/126/2014 i dt.2. 05.2014, është arbitrar, sepse nuk bazohet në ligj dhe diskriminues, është në kundërshtim me mënyrën se si KPMSHCK i ka shqyrtuar lëndët në raste të njëjta.*"

44. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Qeveria e Kosovës e refuzoi kërkesën e parashtruesve për shtesën mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës, ndërsa një institucioni tjetër (Departamenti i Mjekësisë Ligjore) të cilët kishin parashtruar kërkesë të njëjtë, e njëjta është aprovuar. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se si rezultat i mosaprovimit të kërkesës, Qeveria e Kosovës ka bërë shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

45. Parashtruesit e kërkesës, përfundojnë duke kërkuar nga Gjykata: *"[...] të realizojnë të drejtën e kompensimit të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e punës gjatë kujdestarisë, punës gjatë natës, punës gjatë vikendeve [...]."*

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

48. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

49. Në këtë drejtim, Gjykata më tej i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*

50. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

51. Gjykata rikujton, se përveç kërkesës së parashtruesve për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ. nr. 18/2016, të 23 majit 2016, parashtruesit gjithashtu kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të KPM-së A/02/126/2014, të 2 majit 2014 dhe Vendimit të Komisionit për Ankesa të KSK-së, nr. 123/14, të 19 majit 2014.

52. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me këto vendime ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, duke ua refuzuar kërkesën për kompensim të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e kujdestarisë për mbajtjen e punës gjatë natës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjshmërisë.

53. Parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Supreme shkelje të së drejtës materiale, procedurale, dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjykata konsideron

se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi për bazat e ankesës së lartpërmendur, të cilat tashmë ishin ngritur në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Për këto arsye, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është tani vendim përfundimtar për këtë çështje kontestuese.

54. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjet efektiv juridik dhe për mbrojtje gjyqësore.

55. Gjykata fillon duke analizuar pretendimet e parashtruesve për shkeljen e të drejtave për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjet efektiv juridik dhe për mbrojtje gjyqësore.

(1) Shkelja e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mjet efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave

56. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

57. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 6.1 të KEDNJ-së, me të cilin përcaktohet:

> *" Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë."*

58. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë në Gjykatën Kushtetuese se me vendimet e gjykatave të rregullta *"E drejta jonë është shkelur në atë mënyrë që me vendimet e lartpërmendura jemi dëmtuar, sepse na mohuan të drejtën e kompenzimit të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e kujdestarisë, punës gjatë natës, punës gjatë festave zyrtare si dhe realizimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte specifike të punës."*

59. Gjykata vëren se parashtruesit parashtruan kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm "*për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe shkeljes të dispozitave procedurale."*

60. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin ishte konkluduar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore.

61. Në të vërtetë, Gjykata Supreme vlerësoi se "*qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, pë arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konflit Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare [...] Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit mbi refuzimin e ankesës së paditësve nga e paditura , iu ka referuar dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative 02/L-28 dhe atë të nenit 93, i cili përcakton pasojat e aktit apsolutisht të pavlefshëm."*

62. Për më tepër, Gjykata Supreme ka shqyrtuar pretendimin për shkelje të dispozitave procedurale. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme ka konsideruar si të pabazuar shkeljen e pretenduar "*meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së padituerës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.*"

63. Gjykata Supreme më tej konsideroi se "*gjykata e shkallë së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësve ka nxjerrë prova të mjaftueshmë të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësve në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike.*"

64. Gjykata rikujton se, ndër të tjera, parashtruesit pretendojnë se "*dështimi i Gjykatës për të dhënë përgjigje rreth kompenzimit të dëmit, paraqet shkelje të të drejtës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e të drejtës pë gjykim të drejtë dhe të paanshëm.*"

65. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, jo vetëm që vërtetoi arsyet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimeve të shkallëve më të ulëta, por edhe adresoi çështjet thelbësore që lidhen me pretendimin për "*shkelje të të së drejtës materiale dhe procedurale.*"

66. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme i ka vlerësuar provat në tërësi duke i analizuar faktet dhe duke konsideruar se "*gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave konstaton se vendimi kontestues i të padituerës në rivendosje është nxjerrë në pajtim me vrejtjet e dhëna sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, A. nr. 546/12 të datës 10.03,.2014 dhe se organi i të paditur drejt ka vërtetuar gjendjen faktike me rastin e shpalljes së vendimit të komisionit pë zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të këshillit të sigurisë, akt apsolutisht i pavlefshëm ngase i njëjti nga organi administrativ në shkallë të dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së ankuesve është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 92 pika do të Ligjit për Procedurën Administrative.*"

67. Gjykata përsërit se në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për një vendim të arsyetuar përfshin një kompleks të detyrimeve të vendimeve të Gjykatës, përkatësisht, që të ofrojnë arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, t'ua demonstrojnë palëve që ato janë dëgjuar, t'ua sigurojnë mundësinë për t'u ankuar kundër vendimit dhe të sigurojnë qartësi të mjaftueshme të shkaqeve mbi të cilat është nxjerrë vendimi.

68. Edhe pse gjykata e rregullt ka liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve dhe pranimin e provave, neni 6 (1) nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës Shih, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801, GEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, para. 36, *Van de Hurk kundër Holandës*, Nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës* (déc.); *Perez kundër Francës* [DHM] Nr. 47287/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 prillit 2004, para 81; *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Nr. 18390/91, GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18064/91. GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 27.

69. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i KPM-së, A/02/126/2014, i 2 majit 2014 është arbitrar, sepse nuk e kanë vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe kanë shkelur dispozitat ligjore. Gjykata vëren se Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj A. nr. 853/2014, të 14 dhjetorit 2015 i ishte përgjigjur kësaj padie dhe për më tepër e miratoi Vendimin A/02/126/2014 të KPM-së, të 2 majit 2014. Gjykata Themelore vlerësoi se "*kërkesëpadia e paditësve nuk u aprovua si e bazuar sepse kjo gjykatë vlerësoi se me rastin e rivendosjes organi i*

paditur, KPMSHCK ka marrë për bazë të gjitha vërejtjet si në aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, se nga faktet e vërtetuara drejt është vërtetuar gjendja faktike dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje të konstatuar edhe në procedurën e administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor del se nuk është shkelur edhe e drejta materiale në dëm të paditësve". Arsyetimi i tillë është vërtetuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të kontestuar.

70. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme adresoi të gjitha shkaqet e ankesës të ngritura në kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës pas të gjitha procedurave përmes Komisionit të Ankesave të KSK-së, të KPM-së, Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kanë pasur qasje të mjaftueshme në gjykatat e rregullta dhe mundësi të mjaftueshme për të paraqitur prova dhe argumente në lidhje me çështjen e tyre të kontestuar. Provat janë analizuar dhe argumentet janë vlerësuar si më lart.

71. Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Shih rasti i GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* kërkesa nr. 30544/96, 21 janar 199, para. 28.

72. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës paraqitën në Gjykatën Kushtetuese në thelb të njëjtat baza të ankesës që ata i kanë paraqitur në shkallën e fundit. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit kërkojnë nga Gjykata *"të realizojnë të drejtën e kompensimit të dëmit, dhe realizimin e të drejtës në pagesën e punës gjatë kujdestarisë, punës gjatë natës, punës gjatë vikendeve."*

73. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe për këtë arsye nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt". Shih: rastet e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë,* Kërkesa nr. 21893/93, 16 shtator 1996, paragrafi 65. Rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmërinë, i 5 prillit 2012*).*

74. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me konkluzionin e vendimeve të gjykatave të rregullta. Megjithatë, fakti i thjeshtë se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e procedurave të kryera në gjykatat e rregullta, nuk mund të ngrejë vetvetiu një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të garantuar me Kushtetutë (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

75. Për më tepër, parashtruesit nuk kanë arritur të tregojnë dhe të dëshmojnë në baza kushtetuese se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur. Faktet e rastit nuk tregojnë se gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.

76. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konstaton se në përgjithësi është respektuar e drejta e parashtruesve të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm gjatë procedurës dhe, në mënyrë më specifike, ata kishin qasje të lirë në gjykata, u ishin dhënë aktgjykime të arsyetuara në shkallë të ndryshme të procedurës. Gjykata më tej konstaton se, në pajtim me këtë, të drejtat e tyre në mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësore ishin të garantuara.

77. Prandaj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësore janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

(2) Shkelja e së drejtës në punë dhe barazia para ligjit

78. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur e drejta në punë dhe se ata janë diskriminuar.

79. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, i cili përcakton :

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

80. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit], i cili parasheh:

"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."

81. Gjykata vëren nga faktet dhe vlerësimet e mësipërme se procedurat e kryera dhe vendimet e nxjerra nuk ishin në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, janë gjithashtu qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

82. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së që përcakton se diskriminimi *"është trajtimi i ndryshëm, pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme*". Shih: rastet e GJEDNJ-së *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 25379/02, 20 maj 2008, paragrafi 48, *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, kërkesa nr. 15250/02, 13 dhjetor 2005, paragrafi 63, dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 57325/00, 13 nëntor 2007, paragrafi 44.

83. Gjykata më tej vëren se parashtruesit e kërkesës nuk tregojnë se ishin viktimë e një veprimi të një autoritetit kompetent në lidhje me humbjen ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe se as nuk iu është ndaluar me vendim të një organi për të punuar dhe për të kryer profesion për të cilin mendojnë se kanë të drejtë. Për këtë arsye, Gjykata i konsideron si të pabazuara pretendimet e parashtruesve për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

84. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar dhe mbështetur shkeljen e neneve të Kapitujve II dhe III të Kushtetutës. Këto nene nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për *"gëzimin e të drejtave dhe lirive"*. Prandaj, Gjykata konkludon se pa këto shkelje, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme] nuk merren parasysh.
85. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

86. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe 56 dhe të Rregullores së punës, më 4 prill 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI112/16, Parashtrues, N.T.SH. "LOKI", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 110/16, të 7 qershorit 2016

KI112/16, Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2017, publikuar më 13 qershor 2017.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, person juridik, kërkesë e papranueshme*

Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. nr. 110/16, me anë të të cilit aprovoi si të bazuar revizionin e Komunës së Prizrenit dhe e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit që si rezultat i shkëputjes së kontratës së koncesionit, në emër të kompensimit të dëmit për investime në shfrytëzimin e tregut në Prizren, t'i paguhet një shumë e caktuar e të hollave.

Parashtruesi në kërkesën e tij ka pretenduar se i është shkelur e drejta e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Një ndër pretendimet kryesore të parashtruesit ishte se ai nuk ishte njoftuar për revizionin e parashtruar nga Komuna e Prizrenit dhe për këtë arsye ai nuk kishte pasur mundësi t'iu përgjigjet pretendimeve të palës tjetër.

Gjykata konstatoi se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, dhe faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk kishin arsyetuar pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe paanshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI112/16

Parashtrues

N.T.SH. "LOKI"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 110/16, të 7 qershorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.T.SH. "LOKI" nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Shoqata e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 110/16, të 7 qershorit 2016.

3. Parashtruesi pohon që aktgjykimin e lartcekur e ka pranuar më 21 korrik 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 18 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (gjyqtarë).

8. Më 12 janar 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme dhe Komunës së Prizrenit.

9. Më 12 janar 2017, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Prizren informatën (apo dëshminë përkatëse), nëse parashtruesi i kërkesës është njoftuar lidhur me kërkesën për revizion të parashtruar nga Komuna e Prizrenit.

10. Më 3 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prizren njoftoi Gjykatën që janë në pamundësi të dërgimit të informatës së kërkuar nga Gjykata, pasi që të gjitha shkresat e lëndës gjenden në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

11. Më 28 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prizren i dorëzoi Gjykatës dëshminë, përkatësisht fletëkthesën, e cila dëshmon se njoftimi për kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme i ishte dorëzuar përfaqësuesit të autorizuar (avokatit) të parashtruesit të kërkesës më 8 prill 2016.

12. Më 8 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 1 gusht 2001, parashtruesi i kërkesës nënshkroi një kontratë të koncesionit me Komunën e Prizrenit për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare, në bazë të cilës kishte marrë në shfrytëzim Tregun e Bylmetit në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Tregu i Bylmetit).

14. Më 12 shkurt 2003, Komuna e Prizrenit anuloi kontratën e lartcekur mbi koncesionin, dhe si rrjedhojë mbylli objektin e Tregut të Bylmetit. Sipas shkresave të lëndës, Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Prizrenit vendimin e tij për ndërprerje të kontratës e kishte arsyetuar se parashtruesi nuk iu kishte përmbajtur kontratës mbi koncesionin.

15. Më 17 qershor 2003, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren. Në padinë e tij, parashtruesi kërkoi kompenzim të dëmit material si shkak i shkëputjes së njëanshme të kontratës mbi koncesionin në emër të mjeteve të investuara në Tregun e Bylmetit.

16. Më 5 prill 2004, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 384/03) aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës, duke obliguar Komunën e Prizrenit që parashtruesit, në emër të mjeteve të investuara, t'ia paguajë një shumë të caktuar. Gjykata Komunale në aktgjykimin e saj kishte konstatuar se si rrjedhojë e shkëputjes së njëanshme të kontratës mbi koncesionin, parashtruesi i kërkesës kishte pësuar dëm material duke qenë i penguar që t'i shfrytëzojë tregjet deri në skadimin e afatit të kontratës.

17. Më 2 dhjetor 2004, Komuna e Prizrenit parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 5 prillit 2004.

18. Më 18 mars 2005, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 431 /2004) aprovoi ankesën e Komunës së Prizrenit me ç'rast ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje. Gjykata e Qarkut konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren përmbante shkelje të dispozitave të së drejtës procedurale dhe se *"kjo shkelje konsiston në faktin se aktgjykimi i sulmuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare dhe se egziston kundërthënja në mes arsyeve të dhëna në aktgjykimin dhe vetë përmbajtjes."*

19. Më 7 qershor 2005, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 229/05) aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit si të bazuar.

20. Më 13 dhjetor 2005, Komuna e Prizrenit parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 7 qershorit 2005.

21. Më 7 prill 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 540/2005) aprovoi ankesën e Komunës së Prizrenit, duke prishur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren dhe lëndën e ktheu në rigjykim dhe rivendosje.

22. Më 13 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi P. nr. 398/06) aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar.

23. Më 25 maj 2007, Komuna e Prizrenit parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren.

24. Më 9 qershor 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 260/07) aprovoi ankesën e Komunës së Prizrenit, duke prishur lëndën në tërësi dhe rastin e ktheu në rivendosje.

25. Më 11 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 406/08) aprovoi në tërësi padinë parashtruesit të kërkesës si të bazuar.

26. Më 22 korrik 2010, Komuna e Prizrenit parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren.

27. Më 11 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 368/2010) aprovoi ankesën e Komunës së Prizrenit, duke prishur në tërësi aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ktheu në rivendosje.

28. Më 14 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prizren parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për caktimin e kompetencës lëndore. Në kërkesën e saj, Gjykata Komunale në Prizren pohoi që Gjykata e Qarkut në Prizren është kompetente për vendosjen e kërkesës së palëve, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë është prishur më tepër se dy herë.

29. Më 6 gusht 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi Cn. nr. 9/2012) vendosi që për këtë çështje kontestimore me kompetencë lëndore është Gjykata Komunale në Prizren.

30. Më 22 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 498/12) aprovoi si të bazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, duke vendosur si në vijim: I. Obligoi Komunën e Prizrenit që parashtruesit t'ia paguaj një shumë të caktuar të hollash si kompensimin për mjetet e investuara; II. Refuzoi si të pabazuar kundërpadinë e Komunës së Prizrenit për kompensim për shkak të mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e parashtruesit, si dhe III. Obligoi Komunën e Prizrenit që parashtruesit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës.

31. Gjykata Komunale në Prizren vlerësoi se *"Nga dëshmitë e paraqitura, del që në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestues fakti që ata kanë [shkëputur] kontratën për koncesion, kontestuese është që nëse ndërprerja e njëanshme e kontratës paditësit i ka shkaktuar dëm, pasi që ai kishte investime në rregullimin e hapësirës së tregut dhe pajisjen e së njëjtës".*

32. Në vijim, Gjykata Komunale përfundoi se *"Sipas nenit 132 të LMD* [Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore], *me prishjen e kontratës, të dy palët janë të liruara nga obligimet e tyre, përveç obligimit të kompensimit të dëmit. Me ndërprerjen e kontratës, secila palë i detyrohet palës tjetër kompensimin për shfrytëzimin që ndërkohë e ka pasur nga ajo që është e detyruar të kthejë, respektivisht, kompensojë, derisa me ndërprerjen e kontratës, pala e cila iu është përmbajtur kontratës, plotësisht apo pjesërisht, ka të drejtë që t'i kthehet ajo çfarë ka dhënë. Në rastin konkret, paditësi ka investuar mjetet e veta e që e paditura nuk mund t'i mohojë, e për këtë arsye ka të drejtë në kthimin e të njëjtave".*

33. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren të 22 nëntorit 2012, Komuna e Prizrenit parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

34. Më 11 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 1288/13) refuzoi si të pabazuar ankesën e Komunës së Prizrenit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, të 22 nëntorit 2012.

35. Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e saj, konstatoi se Gjykata Komunale në Prizren, në aktgjykimin e saj, ka bërë vlerësimin e drejtë të fakteve dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

36. Më 9 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm, C. nr. 498/12, të Gjykatës Themelore të Prizrenit, përmes përmbaruesit privat kërkoi që me urdhër përmbarimor të bllokohen llogaritë e debitorit deri në pagesën definitive të vlerës totale të borxhit.

37. Më 10 shkurt 2016, Komuna e Prizrenit parashtroi revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Në kërkesën e saj për revizion, Komuna e Prizrenit pretendoi vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët.

38. Në kërkesën e saj për revizion, Komuna e Prizrenit, ndër të tjera, theksoi se gjykatat e shkallës më të ulët kanë bërë vlerësimin e gabuar të provave, duke mos marrë për bazë edhe prova të cilat Komuna e Prizrenit i ka ofruar këtyre gjykatave. Më tej, Komuna e Prizrenit po ashtu pretendoi se dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore (në tekstin e mëtejmë: LMD) do *"duhej të aplikoheshin në favor të Komunës e jo paditësit, i cili ka qenë fajtor dhe moszbatues i obligimeve kontraktuale."*

39. Më 7 qershor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 110/16) aprovoi si të bazuar revizionin e Komunës së Prizrenit dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, që Komuna e Prizrenit të detyrohet *"që për shkak të shkëputjes së kontratës mbi koncesionin, në emër të kompensimit të dëmit për mjetet e investuara në shfrytëzimin e tregut në Prizren"* parashtruesit t'ia paguaj një shumë të caktuar të hollash.

40. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj theksoi se *"Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të dy gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e tyre përfshihen me zbatim të gabuar të së drejtës materiale."*

41. Gjykata Supreme, më tej, arsyetoi se *"[...] nga procesverbalet e lartpërmendura të inspekcionit të paduriës, aktvendimit të inspektoratit të tregut për ndalimin e menjëhershëm të shfrytëzimit të tregut të marrë me koncesion nga ana e paditësit, nga konkluzioni i bordit të drejtorëve të paduriës, dhe nga aktvendimi për shkëputjen e kësaj marrëveshje për koncesion, faji për prishje të kësaj marrëveshjeje ekskluzivisht qëndron në anën e paditësit, kështu që e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për dëmet eventuale që paditësi i ka pësuar me rastin e shkëputjes së kësaj marrëveshjeje për koncesion, dhe si rrjedhojë e kësaj e paditura nuk është e detyruar që këtë dëm paditësit t'ia kompensojë[...]"*.

42. Gjykata Supreme përfundoi se *"[...] me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët gabimisht është zbatuar e drejta materiale, përkatësisht neni 124 dhe 132 i LMD, andaj u deshtë që aktgjykimet e tyre të ndryshohen dhe lidhur me kërkesëpadinë e paditësit të vendoset në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

43. Parashtruesi i kërkesës pohon se aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

44. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka kompetencën të rivlerësoj provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykata e shkallës së parë dhe e Apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Gjykata Supreme nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të atakuara"*.

45. Sipas parashtruesit *"Kontrolli i saj* [Gjykatës Supreme] *duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë së vendimeve të atakuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata Supreme nuk mund të anashkalojë apo të lërë provat që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykata e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në shkallë të parë dhe të dytë."*

46. Si rrjedhojë, parashtruesi përfundon se Gjykata Supreme ka tejkaluar kompetencat e saj, duke shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë *"nga një gjykatë e themeluar sipas ligjit, e po ashtu në mënyrën e rivlerësimit të provave, parashtruesit i është cenuar e drejta e gjykimit nga një gjykatë e paanshme."*

47. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është njoftuar për revizionin e parashtruar nga Komuna e Prizrenit, në cilësinë e të paduriës, dhe si rrjedhojë atij nuk i është mundësuar që në afatin ligjor nga pranimi i njoftimit për revizion t'i përgjigjet pretendimeve të paraqitura nga e paditura, respektivisht Komuna e Prizrenit.

48. Në këtë drejtim, parashtruesi përfundon që *"mosdhënia e mundësisë për t'u deklaruar në lidhje me pretendimet e palës kundërshtare të shprehura në revizionin e saj ndaj Aktgjykimit të formës së prerë, parashtruesin e kërkesës e ka vendosur në mënyrë të pabarabartë në raport me palën tjetër, me çka është shkelur rëndë parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit [...]"*.

49. Në fund, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera kërkon që aktgjykimin e kontestuar ta deklarojë të pavlefshëm dhe rastin ta kthejë në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

52. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

> *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashkruara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

53. Më tej, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

54. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar në pajtim me Kushtetutën, konteston një akt të autoritetit publik, në këtë rast Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ka shteruar të gjitha mjete e nevojshme juridike dhe ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit katër (4) mujor pas pranimit të aktgjykimit.

55. Sidoqoftë, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

56. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi kontestuar i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për

Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

57. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme ka tejkaluar kompetencat e saja duke bërë vlerësim të provave, edhe pse në procedurën e revizionit Gjykata Supreme ka të drejtë vetë që të *"[...] shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të atakuara"* dhe jo të vërtetojë gjendjen faktike.

58. Gjykata vëren se, në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme ka konstatuar se gjykatat e shkallës më të ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale (përkatësisht nenet 124 dhe 132 të LMD). Gjykata Supreme i është referuar gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, ku është vlerësuar se faji për prishjen e njëanshme të kontratës mbi koncesionin rëndonte mbi parashtruesin. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme ka ardhur në përfundim se në bazë të dispozitave gjegjëse të LMD-së, Komuna e Prizrenit, në cilësinë e të padituërës, nuk ishte e obliguar që t'ia kompensonte parashtruesit dëmin e kërkuar material.

59. Prandaj, Gjykata e konsideron si të pabazuar pretendimin e parashtruesit se ai është viktimë i një shkeljeje kushtetuese, të shkaktuar nga tejkalimi i kompetencave të Gjykatës Supreme.

60. Për më tepër, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

61. Gjykata rikujton se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës, n*r. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

62. Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës se ai nuk është njoftuar lidhur me kërkesën për revizionin, të parashtruar nga Komuna e Prizrenit, në cilësinë e të padituërës, Gjykata vëren se më 28 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prizren i dorëzoi Gjykatës dëshminë, përkatësisht fletëkthesën, e cila dëshmon që përfaqësuesi ligjor i autorizuar nga parashtruesi i kërkesës, njoftimin për kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme e kishte pranuar më 8 prill 2016.

63. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte autorizuar një avokat që ta përfaqësojë atë gjatë procedurave pranë gjykatave të shkallës më të ulët. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimi për shkelje të barazisë së armëve nuk qëndron për arsye se përfaqësuesi ligjor i autorizuar nga vetë parashtruesi ishte njoftuar dhe kishte pranuar kërkesën për revizion nga Gjykata Themelore në Prizren para se Gjykata Supreme të merrte vendimin e saj lidhur me revizionin.

64. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se çfarëdo veprimi ose mosveprimi procedural nga përfaqësuesi i atribuohet në parim parashtruesit të kërkesës (Shih *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, nr. 14102/02 GJEDNJ, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; dhe shih, *mutatis mutandis*, *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 58511/13 GJEDNJ, Aktvendim i 27 janarit 2014). Në këtë rast veprimet e tilla përfshijnë edhe pranimin e vendimeve gjyqësore (Shih rastet KI46/13, KI47/13, KI48/13 dhe KI68/13, Parashtrues

Naim Morina, Bukurije Drançolli, Avdi Imeri dhe Genc Shala, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 5 korrikut 2013).

65. Në fund, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005)·

66. Për arsyet e mësipërme, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.

67. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) kërkesa është qartazi e pabazuar mbi baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, si dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI30/16, Parashtrues: KONZORCIUMI"ALFA.i" Sh.p.k. & "INFRATEK", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. rev. nr. 44/2015, të 18 nëntorit 2015

KI30/16, Aktvendim për papranueshmëri i 31 marsit 2017, publikuar më 13 qershor 2017.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia e armëve, kërkesë për masë të përkohshme, sencë publike, kërkesë qartazi e pabazuar*

Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës u ankua se Gjykata Supreme ka vepruar njëanshëm gjate shqyrtimit te revizionit sepse ai nuk ishte ftuar apo nuk i ishte dhënë mundësia qe ta prezantoje rastin e tij në seancë gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ishte shkelur parimi i barazisë së armëve, e drejta për seancë publike dhe po ashtu kërkoi caktimin e masave të përkohshme.

Gjykata vërejti se, në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për cenim të parimit të barazisë së armëve sepse parashtruesit i ishte dhënë mundësia për t'iu përgjigjur revizionit të palës kundërshtare, gjë që nga përmbajtja e kërkesës rezultoi se nuk e ka bërë dhe, se seanca gjyqësore publike është mbajtur në instancën e parë të gjyqësorit dhe se bazuar në shtjellimin e deritanishëm të jurisprudencës se Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mos mbajtja e seancës publike gjyqësore në instancën e dytë dhe të tretë të gjyqësorit, në vetvete, nuk përbën cenim të parimit të barazisë së armëve. Kërkesa u shpall e papranueshme qartazi e pabazuar dhe po ashtu kërkesa për masë të përkohshme u refuzua për shkak se nuk ishte arsyetuar *prima facie*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI30/16

Parashtrues

KONZORCIUMI "ALFA.i" Sh.p.k. & "INFRATEK"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. rev. nr. 44/2015, të 18 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Konzorciumi "ALFA.i" Sh.p.k. & "INFRATEK" me seli në Rakosh të Istogut (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Muhamet Shala, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 44/2015, të 18 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, E. rev. nr. 44/2015, të 18 nëntorit 2015, për të cilin parashtruesi pretendon se shkel nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 7 [Vlerat], nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon vënien e masës së përkohshme dhe ndalimin e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 27, 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullat 29 dhe 55 (4) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

8. Më 25 prill 2016, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e kompanisë parashtruese për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës u është dërguar Komunës së Prishtinës dhe Gjykatës Supreme.

9. Më 13 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës më 9 shtator 2016. Kolegji shqyrtues u caktua në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

10. Më 17 janar 2017, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë dokumente shtesë përkitazi me kërkesën e kompanisë parashtruese. Gjykata Supreme u njoftua për kërkesën e Gjykatës për dokumente shtesë që i ishte adresuar Gjykatës Themelore në Prishtinë.

11. Më 24 janar 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentet shtesë.

12. Më 31 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 23 janar 2009, parashtruesi i kërkesës dhe Komuna e Prishtinës kishin lidhur marrëveshje për hartimin e projektit rrugor të ashtuquajtur "Unaza e brendshme – Pjesa Lindore".

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Komunës së Prishtinës, për shkak të mosmarrëveshjeve për kompensim të punimeve shtesë.

15. Më 18 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në praninë e palëve ndërgjyqëse me Aktgjykimin C. nr. 271/2013, vendosi si në vijim:

> *"I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Konsorciumi Alfa-i sh.p.k dhe Infratek me seli në Istog .*
>
> *II. Detyrohet pala e paditur Komuna e Prishtinës që t'i paguaj paditësve shumën e përgjithshme prej 89.760,00 (tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro në emër të hartimit të projektit Unaza e brendshme-Pjesa Lindore-tenderi nr. 61608336211, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin paritiv prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim".*

16. Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi se kishte marrë vendim për aprovim të kërkesëpadisë së kompanisë parashtruese, duke u bazuar kryesisht në dispozitat e marrëveshjes së 23 janarit 2009 të lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe dispozitat e vendimit për inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore të miratuar nga Komuna e Prishtinës, më 29 mars 2012.

17. Komuna e Prishtinës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 8 maj 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ae. nr. 107/2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurës Komuna e Prishtinës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

19. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, u shpreh se aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i arsyetuar, gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se nuk kishte shkelje të së drejtës procedurale dhe materiale. Gjykata e Apelit po ashtu shtoi se personat kompetentë të Komunës së Prishtinës kishin miratuar ndryshimin e projektit dhe shpenzimet shtesë të kompanisë parashtruese për përfundimin e projektit konform dispozitave të marrëveshjes së tyre.

20. Komuna e Prishtinës paraqiti kërkesë për revizion të vendimeve të Gjykatës Themelore dhe të Apelit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim, që vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e kompanisë parashtruese të refuzohet.

21. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk ishte përgjigjur ndaj revizionit të Komunës së Prishtinës, edhe pse për këtë gjë ishte njoftuar në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit procedural.

22. Më 18 nëntor 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin E. Rev. nr. 44/2015 e pranoi si të bazuar revizionin e Komunës së Prishtinës, ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe refuzoi kërkesëpadinë e kompanisë parashtruese.

23. Gjykata Supreme arsyetoi se gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur kanë konstatuar se kërkesëpadia e kompanisë parashtruese është e bazuar, sepse në rastin konkret, pëlqimi për ndryshimin e projektit nuk ishte dhënë nga personi kompetent i Komunës së Prishtinës.

24. Në këtë drejtim, pjesa relevante e aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton:

> *"Në nenin 24.1 të Ligjit në fjalë është përcaktuar se Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidhë ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Kontrata publike e nënshkruar nga kushdo përveç Zyrtarit Prokurues të autoritetit kontraktues është e pavlefshme dhe e pazbatueshme. Në rastin konkret pëlqimin për ndryshimin në projekt nuk ka dhënë Zyra e Prokurimit Publik të paditurës dhe se kërkesën e paditësve për pagesën e punëve shtesë, departamenti i prokurimit të paditurës me shkresën e datës 10.4.2013 nuk e ka pranuar. Sipas nenit 22.2 të kontratës së lidhur në mes të ndërgjyqësve është përcaktuar se çdo ndryshim të kontratës ka të drejtë ta bëj Autoriteti Kontraktues, dhe se pëlqimin për punët shtesë nuk ia ka dhënë Autoritetit kontraktues të paditurës gjegjësisht Zyra e Prokurimit. Prandaj thëniet e revizionit të paditurës në këtë drejtim janë të*

bazuara dhe nga arsyet e dhëna më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 224.1 të LPK".

Pretendimet e kompanisë parashtruese

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme i përmendur më lart është nxjerrë duke shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë me aktgjykimin e saj E. Rev. nr. 44/2015 të datës 18. 11. 2015, nuk e ka vlerësuar punën e pjesëve shtesë në lartësi deri në 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës me nr. identifikues 616 08 336 211 të datës 23. 01. 2009 me emërtim: "Hartimi i Projektit Unaza e Brendshme -Pjesa Lindore", të cilin fakt e ka konstatuar vet ajo gjykatë me aktgjykimin e cituar më sipër. Ndonëse e ka theksuar shprehimisht dispozitën ligjore të nenit 34 pika (iii) të Ligjit për Prokurorin Publik, me të cilin është paraparë se, ekzekutimi i punimeve shtesë dhe të punimeve të ngjashme të cilat janë të mbuluara me një kontratë, mund të kryhen nga i njëjti kontraktor, nëse punët shtesë nuk e tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës bazë. Ndërkaq, nuk është kontestues fakti se, punët shtesë në kuptim të kontratës së përmendur më sipër, janë porositur shprehimisht nga ana e Autoritetit Kontraktues -Komunës së Prishtinës, kurse ato porosi si të tilla, janë miratuar nga organi kompetent i autorizuar në bazë të ligjit - Asambleja Komunale dhe janë ekzekutuar nga ana e kontraktuesit -Konzorciumi "ALFA.i" Sh.p.k. &" INFRATEK" me seli në Rakosh –Istog".*

27. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se "*Me dispozitën e nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë se: Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet edhe në parimin e sundimit të ligjit. Prandaj, në rastin konkret, ky parim është shkelur nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë me aktgjykimin e saj E. REV. nr. 44/2015 të datës 18. 11. 2015, me të cilin ajo gjykatë nuk e ka vlerësuar punën e pjesëve shtesë, në lartësi deri në 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës ... po ashtu, me këtë dispozitë kushtetutare të nenit 7 të përmendur më sipër, është paraparë edhe parimi i të drejtës në pronë".*

28. Për sa i përket respektimit të parimit të barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë me rastin e shqyrtimit të Revizionit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ae. nr. 107/2014 të datës 08.05.2015, me mosdhënien e mundësisë parashtruesit të kërkesës që duke e ftuar të prezantoj në seancë gjyqësore, është bazuar njëanshëm në formimin e një bindje jo të drejtë lidhur me nevojën e domosdoshme për kryerjen e punimeve shtesë në interesin publik të Komunës së Prishtinës".*

29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga gjykata që të vendosë masë të përkohshme si dhe ta shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

33. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 36
Kriteret e pranueshmërisë

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
...
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesën, ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës si dhe kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.

35. Gjykata, po ashtu, duhet të vërtetojë nëse parashtruesi i kërkesës ka arritur që kërkesën e saj ta saktësoj dhe të mbështes pretendimet e ngritura në pajtim me nenin 48 të Ligjit.

36. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngre dy pretendime: (i) Gjykata Supreme ka kryer shkelje kushtetuese kur ka pranuar revizionin e palës kundërshtare dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e kompanisë parashtruese për kompensim për punët shtesë dhe (ii) Gjykata Supreme ka vepruar njëanshëm gjatë shqyrtimit të revizionit sepse parashtruesi i kërkesës nuk ishte ftuar apo nuk i ishte dhënë mundësia që ta prezantojë rastin e saj në seancë gjyqësore.

37. Për sa i përket pretendimit të parë të kompanisë parashtruese që ka të bëjë me pranimin e revizionit nga ana e Gjykatës Supreme dhe refuzimin e kërkesëpadisë së kompanisë parashtruese, Gjykata konsideron se kjo ka të bëjë me konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjeve nga gjykatat e rregullta gjatë procedurave gjyqësore që zhvillohen para tyre.

38. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç nëse kjo mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

39. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM],* nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

40. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë proceseve gjyqësore në gjykatat e rregullta, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë,* nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012 dhe rastin nr. KI86/16, parashtrues i kërkesës, *"BENI" Ndërmarrje Tregtare*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2016).

41. Gjykata thekson se detyrë e saj është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

42. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit për cenim të parimit të barazisë së armëve, Gjykata vëren se nga dokumentet e përfshira në kërkesë rezulton se gjykatat e rregullta ia kishin dorëzuar parashtruesit një kopje të revizionit të paraqitur nga pala kundërshtare, siç kërkohet me dispozitat përkatëse të ligjit procedural; mirëpo, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje ndaj revizionit të paraqitur nga pala kundërshtare.

43. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë se në parim, palët ndërgjyqëse gëzojnë të drejtën për pjesëmarrje në seancë publike në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës. Seanca publike i mbron palët ndërgjyqësore ndaj administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehtë larg vëmendjes së publikut (*Diennet kundër Francës,* paragrafi 33; *Martinie kundër Francës,* [DHM], paragrafi 39).

44. Megjithatë, Gjykata vë në pah se mosmbajtja e seancës gjyqësore publike në instancën e dytë ose të tretë të gjyqësorit mund të justifikohet bazuar në veçoritë e procedurës në fjalë me kusht që seanca publike gjyqësore është mbajtur në instancën e parë gjyqësore (shih, *Helmers kundër Suedisë*, paragrafi 36). Kështu që ankesa që trajton vetëm çështje ligjore, dhe jo edhe çështje të faktit, mund të jetë në pajtim me kriteret e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës edhe pse parashtruesit mund të mos i jetë dhënë mundësia që të dëgjohet personalisht nga Gjykata e Apelit dhe Supreme (shih, *Miller kundër Suedisë*, paragrafi 30).

45. Prandaj, përveç nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që arsyetojnë mosmbajtjen e seancës publike gjyqësore, e drejta për seancë publike gjyqësore sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të Konventës nënkuptojnë të drejtën për seancë publike gjyqësore të paktën në instancën e parë gjyqësore (*Fischer v. Austria,* paragrafi 44; *Salmonsson kundër Suedisë,* paragrafi 36).

46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se nuk bëhet fjalë për cenim të parimit të barazisë së armëve sepse parashtruesit i është dhënë mundësia për t'iu përgjigjur revizionit të palës kundërshtare, gjë që nga përmbajtja e kërkesës rezulton se nuk e ka bërë dhe, se seanca gjyqësore publike është mbajtur në instancën e parë të gjyqësorit dhe se bazuar në shtjellimin e deritanishëm të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mosmbajtja e seancës publike gjyqësore në instancën e dytë dhe të tretë të gjyqësorit, në vetvete, nuk përbën cenim të parimit të barazisë së armëve (Shih, për shembull, rastin nr. KI74/16*,* Parashtrues *X,* Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 nëntorit 2016 dhe referencat tjera të përmendura në atë vendim).

47. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ajo kishte mundësi që gjatë fazave të ndryshme të procedurës, të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ajo i konsideroi relevante për rastin e saj; se asaj i është dhënë mundësia që të kontestoj në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të saj janë dëgjuar e shqyrtuar nga gjykatat e rregullta; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht. Rrjedhimisht, rezulton se procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

48. Sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij për shkelje Kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar mbi baza kushtetuese.

Kërkesa për masë të përkohshme

49. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vënien e masave të përkohshme ndaj vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme pa elaboruar se në çfarë mënyre do të pësonte dëm të pariparueshëm, në rast të zbatimit të vendimit të kontestuar apo se si ai vendim e cenon interesin publik (Shih, për shembull, rastin nr. KI86/16, parashtrues i kërkesës *"BENI" Ndërmarrje Tregtare*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2016).

50. Për sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit, i cili parasheh*:*

Masat e përkohshme

"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".

51. Më tej, Gjykata i referohet edhe rregullit 55 (4) të Rregullores, që specifikon:
"[...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

52. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 31 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI144/16, Parashtrues: Salih Gerqina, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta 2009

KI144/16, Vendim për refuzim të kërkesës, i 3 majit 2017, publikuar më 14 qershor 2017

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejte, refuzim me procedurë të shkurtër, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 22, 29, 30, 31 dhe 53 të Kushtetutës, nga gjykatat e rregullta për shkak se te njëjtat kishin kualifikuar në mënyrë të gabuar veprat penale të ngarkuara.

Gjykata, në këtë rast nuk i mori për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa ishte jo e plotë, sepse asaj nuk i ishin bashkëngjitur vendimet gjyqësore të kontestuara. Prandaj, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 29 (2) (h) dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, Gjykata përfundoi se kërkesa e parashtruesit duhet refuzuar me procedurë të shkurtër.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI144/16

Parashtrues

Sali Gerqina

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sali Gerqina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e gjykatave të rregullta (të tri instancave gjyqësore), por këto vendime nuk ia ka bashkëngjitur kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet shkelja e të drejtave të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 8 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti plotësimin e kërkesës me dokumentacion mbështetës.

8. Më 13 shkurt 2017, Posta e Kosovës e informon Gjykatën se adresa e parashtruesit (Rr. "Aleksandër Mojsiu", nr. 20) të kërkesës është e panjohur.

9. Më 23 mars 2017, Gjykata tentoi që shkresa e 8 shkurtit 2017 t'i dërgohet sërish parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, tentimi ishte i pasuksesshëm pasi që Posta e Kosovës, më 27 mars 2017, informoi Gjykatën se adresa e parashtruesit të kërkesës ishte e panjohur.

10. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e shkurtër e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend tekstualisht disa vendime të gjykatave të rregullta, me të cilat ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, megjithatë ato vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, sepse gabimisht kualifikuan natyrën e veprës penale, për faktin se sipas nenit 374.1, në lidhje me nenin 22 paragrafi (1), pika (75) të KPPRK-së, vepra penale konsiderohet krim i rëndë dhe e njëjta është dashur të trajtohej nga Prokurori i Krimeve të Rënda dhe nga gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit të Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore të Gjakovës, dhe jo nga Prokurori i Përgjithshëm dhe gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit të Përgjithshëm i asaj gjykate. Kjo shkelje sipas parashtruesit nuk është vërejtur dhe as nuk është vlerësuar nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, pas ushtrimit të mjeteve juridike.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

14. Kësisoj, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 22 të Ligjit: *"Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë*

dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...)".

15. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 29 pikën (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullin 32 pikën (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që përcakton:

29 (2) "Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
[...]

32 (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë (...)".

16. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 22, 29, 30, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës, për shkak të kualifikimit të gabuar të veprës penale.

17. Në zbatim të dispozitave të lartpërmendura, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa është jo e plotë, sepse asaj nuk i janë bashkëngjitur vendimet gjyqësore të kontestuara (shih Vendimin për hedhje poshtë të kërkesës të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI03/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21, si dhe rastin KI07/16, parashtrues *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).

18. Gjykata, nëpërmjet postës së rregullt, tentoi dy herë që të komunikonte me parashtruesin e kërkesës, për qëllim të plotësimit të kërkesës me dokumentacion mbështetës, megjithatë komunikimi ishte i pamundur pasi që adresa e parashtruesit, siç është dhënë në shkresat e lëndës, ishte e panjohur.

19. Gjykata vë në dukje se, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë adresë tjetër ose numër kontaktues, si alternativë për t'u kontaktuar. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se barra e përgjegjësisë për dështimin e kompletimit të kërkesës me dokumentacion mbështetës bie mbi parashtruesin e kërkesës.

20. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret formale për shqyrtim të mëtejmë, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës.

21. Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 29 (2) (h) dhe me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 22.4 dhe të rregullave 29 (2) (h) e 32 (5) të Rregullores së punës, më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI141/16, Parashtrues i kërkesës: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar „Agrounion“, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016 dhe Njoftimit të Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016

KI141/16, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2017, i publikuar më 14 qershor 2017

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, ushqim, veterinaria, procedurë e kundërvajtjes, prima facie*

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë paraqiti kërkesë për inicimin e procedurës së kundërvajtjes kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Divizioni për Kundërvajtje. Në kërkesën e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë theksohej se parashtruesi i kërkesës: *“ka vendosur në treg në territorin e Republikës së Kosovës, Preparate për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), që nuk janë të autorizuara ose që nuk kanë pasur certifikatë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e natyrisht që nuk kanë qenë të përfshira në Regjistrin - listën e PMB-ve të lejuara për qarkullim dhe përdorim në Kosovë”*.

Parashtruesi i kërkesës udhëhoqi kontestin i cili përfundoi me Aktvendimin KA. nr. 339/2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, e cila e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin Reg. nr. 26553/14 e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës i është drejtuar edhe Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, dhe ai me Njoftimin KMLK. nr. 7/16 e njoftoi parashtruesin e kërkesës që: “*nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”*.

Parashtruesi i kërkesës pohoi se ka pasur shkelje të pretenduar të ligjit, të cilat kanë të bëjnë me njoftimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve, parashkrimin absolut të kundërvajtjeve, tejkalimin e akuzave lidhur me kundërvajtjen, si dhe shkelje të parimit *reformatio in peius*.

Gjykata vëren se parashtruesi përsërit të njëjtat pretendime të cilat i ka theksuar edhe në procedurat në gjykatat e rregullta, ku Gjykata e Apelit (Aktendimi KA. nr. 339/2016) dha përgjigje të detajuar në këto pretendime të parashtruesit.

Gjykata konstatoi se parashtruesit të kërkesës i është ofruar mundësia që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesë argumentet dhe dëshmitë, që ai i konsideronte relevante për rastin e tij. Njëkohësisht, ai kishte mundësi të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese. Kërkesa është deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI141/16

Parashtrues

Agrounion sh.p.k

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016, dhe Njoftimit të Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Agrounion" përmes drejtorit gjeneral të saj, Refik Shabani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me seli në Sllatinë të Madhe, komuna e Fushë-Kosovës, e përfaqësuar nga avokati Bahtir Troshupa.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016, së bashku me Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016.

3. Njoftimi i Kryeprokurorit të Shtetit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 1 gusht 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës së bashku me Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

5. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 1 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.

9. Më 13 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

10. Më 14 mars 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.

11. Më 21 mars 2017, Gjykata i kërkoi parashtruesit të japë sqarime shtesë lidhur me kërkesën dhe të dorëzojë dokumente shtesë lidhur me autorizimin.

12. Më 30 mars 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi dokumentin shtesë dhe iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.

13. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 10, 15, dhe 17 prill 2014, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë kreu një inspektim treditor të punës së parashtruesit të kërkesës dhe përpiloi gjashtë dokumente për gjendjen e gjetur (Procesverbalet nr. 003615, 003616, 003619, 003620, 003625 dhe 003626 të 10, 15, dhe 17 prillit 2014).

15. Më 28 prill 2014, në bazë të procesverbaleve të lartpërmendura, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë paraqiti kërkesë për inicimin e procedurës së kundërvajtjes kundër parashtruesit në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Divizioni për kundërvajtje. Në kërkesën e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë theksohej se parashtruesi i kërkesës

> *"ka vendosur në treg në territorin e Republikës së Kosovës, Preparate për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), që nuk janë të autorizuara ose që nuk kanë pasur certifikatë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e natyrisht që nuk kanë qenë të përfshira në Regjistrin - listën e PMB-ve të lejuara për qarkullim dhe përdorim në Kosovë."*

16. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Reg. nr. 26553/14 e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kundërvajtjet dhe e dënoi me gjobë prej 6.000 €.

17. Më 8 janar 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar se gjykata nuk

i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës të gjitha dokumentet dhe procesverbalet nga seancat.

18. Më 15 janar 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ka. nr. 28/2016 e anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe e ktheu rastin në rigjykim.

19. Më 31 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Reg. nr. 26553/14, në rigjykim, e shpalli parashtruesin fajtor dhe dënoi me gjobë prej 6.000 €.

20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar se aktvendimi ishte nxjerrë me "*abuzim me funksionin gjyqësor nga gjyqtarja*" dhe se kishte ndodhur *"parashkrimi absolut të kundërvajtjes së dyshuar"*.

21. Më 15 prill 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin KA. nr. 339/2016 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin Reg. nr. 26553/14 e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

22. Më 22 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës i drejtua Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës duke kërkuar inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

23. Më 29 korrik 2016, Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës me Njoftimin KMLK. nr. 7/16 e njoftoi parashtruesin e kërkesës që:

> *"Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe propozimit tuaj, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ju njofton se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës përshkruan gjerësisht gjendjen faktike dhe pretendon një numër të shkeljeve të Ligjit për procedurën kundërvajtëse në lidhje me të drejtat e tij. Këto pretendime kanë të bëjnë me njoftimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve; parashkrimin absolut të kundërvajtjeve, tejkalimin e akuzave lidhur me kundërvajtjen. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës këto shkelje të pretenduara nuk i ndërlidh me ndonjë shkelje kushtetuese konkrete.

25. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se është shkelur parimi *reformatio in peius*. Parashtruesi i kërkesës e arsyeton këtë pretendim me faktin se është dënuar për kundërvajtje të kryera në tre ditët kur u bë inspektimi dhe se *"... nuk ka pasur kërkesë për fillimin e procedurës për dyshime të kundërvajtjes të kryer me datë 15 prill 2014 dhe 17 prill2014"*.

26. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata e Apelit e dënoi atë për kundërvajtjet e kryera në ditë të tjera dhe jo për kundërvajtjet për të cilat parashtruesi ishte dënuar fillimisht, ashtu që akuzat u ndryshuan në dëm të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo nuk ishte brenda fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës së Apelit, pasi që vetë ankesa ishte paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe jo nga prokurori.

27. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se *"... pavarësisht që në Kushtetutë dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut shprehimisht nuk flitet për parimin reformatio in peius, në esencë, parimet kushtetuese dhe parimet e KEDNJ-së e përmbajnë në vetvete këtë parim. Andaj konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij*

të përcaktuara me parimin reformatio in peius e rrjedhimisht të garantuara me Kushtetutë neni 21 -Parimet e Përgjithshme, dhe nga neni 31/E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm/të Kushtetutës si dhe është shkelur dhe neni 6 i KEDNJ e drejta për proces të rregullt/Gjykim të Drejtë".

28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që:

> *"Të SHPALLË, të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës se Apelit KA. nr. 339/2016 të datës 15.04.2016 dhe ta KTHEJË [...] në Rigjykim në Gjykatën e Apelit lëndën ...".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

30. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

31. Më tej, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

32. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

33. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie".*

34. Gjykata së pari konsideron se, në bazë të nenit 21.4 të Kushtetutës që parasheh se "*të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme,"* parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejnë për individët dhe që janë të zbatueshme edhe për personat juridikë siç është parashtruesi i kërkesës.

35. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe të parapara me rregullin 36 të Rregullores së punës.

36. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të ligjit, përkatësisht me informimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve; me parashkrimin absolut të kundërvajtjeve; me tejkalimin e akuzës lidhur me kundërvajtjen dhe parimin *reformatio in peius*.

37. Gjykata vëren se parashtruesi, në esencë, përsërit të njëjtat shkelje të pretenduara të cilat i ka ngritur gjatë procedurave në gjykatat e rregullta. Në procedurat e përsëritura, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit i morën parasysh ato, i korrigjuan shkeljet e pretenduara dhe i arsyetuan detajisht vendimet e tyre.

38. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për "*informimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve* (Aktvendimi KA. nr. 339/2016) Gjykata e Apelit dha përgjigje të detajuar, duke arsyetuar si vijon:

> *"... pas këtij refuzimi të nesërmen paraqitet në gjykatë e pranon ftesën dhe me dt.25.03.2016 paraqet kërkesë për shtyrje të seancës me të njëjtin arsyetim. Gjyqtarja duke pasur parasysh tendencën e avokatit në zvarritje të procedurës, gojarisht e ka njoftuar avokatin se nuk do të ketë shtyrje të seancës, mirëpo i njëjti përkundër kësaj nuk është paraqitur në gjykatë me dt.30.03.2016, ndërsa dëshmitarët e propozuar për dëgjim nga ana e tij kanë prezantuar".*

39. Më tej, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për "*parashkrimin e kundërvajtjeve dhe tejkalimit të akuzës lidhur me kallëzime penale*", si dhe në lidhje me pretendimin e tij se "*Gjykata e ka të njohur faktin se nuk ka kërkesë për fillimin e procedurës për dyshime të kundërvajtjes të kryer me datë 15 prill 2014 dhe 17 prill 2014."* Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dha përgjigje të detajuar në lidhje me këto pretendime, duke arsyetuar:

> *"... Pretendimet nga ankesa, se kundërvajtja e supozuar është kryer me dt.10.04.2014 dhe rrjedhimisht ka arritur parashkrimi i të drejtës për zhvillimin e procedurës-nuk qëndron sepse më dt. 15.04.2014 e gjithashtu edhe më dt. 17.04.2014 në vazhdimësi është kryer kontrollimi inspektues dhe me procesverbale është konstatuar kundërvajtja e kryer nga e pandehura. Gjithashtu, kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje e dt.29-30.04.2016 e ngarkon të pandehurën për kryerje të kundërvajtjes, pos për dt.10.04.20 16, edhe për dt. 15.04.2016 procesverbalet e inspektimit nr.003619 dhe 003620. dhe për dt.17.04.2016 procesverbalet e inspektimit nr.003625 dhe 003626. kështu që nuk qëndron as pretendimi nga ankesa, se Gjykata e shkallës së parë, për sa i përket datës së kryerjes së kundërvajtjes, ka vepruar në kundërshtim me kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje ...".*

40. Në fund, Gjykata vëren se edhe pretendimet për shkelje të parimit *reformatio in peius*, për shkak të shqiptimit të dënimit më të lartë edhe pse ankesa ishte ushtruar nga vetë parashtruesi i kërkesës, morën përgjigje nga Gjykata e Apelit si në vijim:

> *"... Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtje nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht nuk ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale në*

dëm të pandehurës, kurse sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar konsiderohet se në vështrim të nenit 9 të LK, i është shqiptuar nën minimumin e paraparë ligjor, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktvendimit dhe pezullimin e procedurës kundërvajtje për shkak të parashkrimit, siç propozohet në ankesën e ushtruar".

41. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit, që pretendohet të janë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç nëse ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendime të dëshmuara dhe argumente bindëse me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.

42. Gjykata rikujton se nuk është roli i saj të vërtetojë se cilat lloje të provave janë të lejuara dhe cilat prova duhet të merren parasysh dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të konstatojë nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 majit 2000, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 35394/97, paragrafët 34-35).

43. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe rrjedhimisht nuk mund të veprojë si "*gjykatë e shkallës së tretë ose të katërt*" (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, të 16 dhjetorit 2011, nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*).

44. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi të paraqesë para gjykatave të rregullta arsyet materiale dhe juridike për zgjidhjen e kontestit. Gjykata po ashtu konsideron se argumentet e parashtruesit të kërkesës janë dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta dhe vendimet e marra ishin plotësisht të arsyetuara.

45. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me përfundimin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, thjesht mospajtimi me rezultatin e procedurave të zhvilluara nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

46. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka prezantuar pretendim preciz dhe konkret se cilat të drejta pretendohet të jenë cenuar dhe nuk ka shpjeguar si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës së Apelit mund të ketë shkelur këto të drejta kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës vetëm ka theksuar se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka ofruar ndonjë provë *prima facie* e cila do të tregonte shkelje të të drejtave kushtetuese (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 31 majit 2005, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, nr. 53363/99).

47. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimet e kontestuara parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06).

48. Për këto arsye, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

49. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI31/17, Parashtrues: Shefqet Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM. Nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016

KI31/17, Aktgjykimi i 30 majit 2017, publikuar më 2017.

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtje gjyqësore e të drejtave, pension invalidor, kërkesë për masë të përkohshme*

Në këtë rast parashtruesi i kërkesës kontestoi dy vendime të gjykatave të rregullta që kishin refuzuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në njërën anë, dhe caktimin e masës së sigurisë ndaj pronës së tij në anën tjetër. Parashtruesi u ankua për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe cenim të pasurisë së tij për shkak të masës së sigurisë që ishte caktuar ndaj asaj pasurie.

Gjykata konstatoi se duke mos i kushtuar vëmendje të duhur provave të propozuara nga parashtruesi, vendimeve të paarsyetuara si dhe refuzimit për të dëgjuar dëshmitarin e vetëm të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, gjykatat në të gjitha instancat kanë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 te Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 te Konventës. Gjykata më tutje shtoi se, si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës ka mundur të privohet nga e drejta e tij për gëzimin paqësor të pronës dhe të drejtës për jetën private për shkak se prona e tij private iu nënshtrua masave te sigurisë dhe bllokimit të pensionit të tij invalidor.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI31/17

Parashtrues

Shefqet Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CLM nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shefqet Berisha nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme CML nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016.

3. Vendimi i lartpërmendur kontestohet në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP. nr. 1216/15 të 21 nëntorit 2016; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1347/16, të 24 prillit 2016; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2929/2015, të 15 shkurtit 2016; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 401/2014, të 26 tetorit 2015; dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 162/09, të 29 tetorit 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

5. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 162/09, të

29 tetorit 2013, dhe të pezullohet çdo procedurë gjyqësore, procedurë përmbarimi, veprim apo vendim i autoriteteve publike që rrjedhin nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Qëllimi i aktgjykimit të lartpërmendur dhe procedurat e përmbarimit pasuese janë konfiskimi i pronës private të parashtruesit të kërkesës dhe pensionit të tij invalidor i cili është i nevojshëm për trajtimin e tij mjekësor.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 116 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 29, 54 dhe 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 10 mars 2017 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

9. Më 22 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).
10. Më 22 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 27 mars 2017, Gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës ta miratojë masën e përkohshme. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi me shumicë votash që ta miratojë masën e përkohshme deri më 20 qershor 2017.

12. Më 28 mars 2017, Gjykata publikoi Vendimin e lartpërmendur për masë të përkohshme, përkatësisht kundër Aktgjykimit C. nr. 162/09, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 tetorit 2013 dhe urdhëroi ndalimin kundër çdo procedure gjyqësore, procedure përmbarimi, veprimeve apo vendimeve të autoriteteve publike që dalin nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Masa e përkohshme është miratuar deri më 20 qershor 2017.

13. Më 30 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës, shkelje të dispozitave kushtetuese dhe vazhdimin e masës së përkohshme derisa gjykatat e rregullta të rishqyrtojnë çështjen sipas dispozitivit dhe arsyetimit të Aktgjykimit të kësaj Gjykate.

Përmbledhje e fakteve

14. Më 2 shkurt 2009, paditësi K. Sh. parashtroi padi në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të detyrohet t'ia paguajë shumën prej € 20. 337,40 duke përfshirë normën e interesit duke filluar nga dita kur është dorëzuar padia.

15. Më 23 qershor 2010, K. Sh. dorëzoi një padi tjetër në Gjykatën Themelore, duke zëvendësuar atë të mëparshme, duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të detyrohet t'i paguajë atij shumën prej € 17.500 duke përfshirë kamatën.

16. Më 1 janar 2013 hyri në fuqi Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat. Në pajtim me nenin 2 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2. i atij Ligji: *"Gjykata Themelore - gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike të themeluara me këtë ligj"*.

17. Më 6 shkurt 2013, Gjykata Themelore nxori vendim me të cilin e detyroi parashtruesin e kërkesës të përgjigjet në padinë e K. Sh. brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

18. Më 15 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës në përgjigjen e tij i kontestoi pretendimet e K. Sh. dhe kërkoi nga Gjykata Themelore që ta refuzojë kërkesëpadinë e K. Sh. në tërësi si të pabazuar ose ta hedh poshtë atë si të papranueshme.

19. Më 19 prill 2013 dhe 7 qershor 2013 u mbajtën dy seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar dëshmitarët. Parashtruesi i kërkesës kundërshtoi mënyrën se si janë marrë dhe vlerësuar provat, sepse në njërën anë, provat dhe dëshmitarët e propozuar nga parashtruesi i kërkesës ishin refuzuar; ndërsa në anën tjetër, provat dhe dëshmitarët e propozuara nga K.Sh. u pranuan nga gjykata.

20. Më 29 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C. nr. 162/09 aprovoi kërkesëpadinë e paditësit K. Sh. dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që t'ia paguajë paditësit 'huanë e papaguar'. Të njëjtën ditë, parashtruesi paraqiti prova të reja, duke pretenduar se: (i) ligjshmëria dhe identiteti i K.Sh. nuk ishte përcaktuar saktë dhe se identiteti i tij nuk është i njohur; dhe, (ii) propozoi që të dëgjohet një dëshmitar. Provat dhe dëshmitari i propozuar ishin refuzuar nga gjykata.

21. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim.

22. Më 26 tetor 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin CA. nr. 401/2014 e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

23. Më 23 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Parashtruesi theksoi prapë se ai kishte ngritur përmes instancave më të ulëta argumentin për shkelje të pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për mos pranimin e dëgjimit të dëshmitarit të tij dhe marrjen parasysh të provave të tij.

24. Më 30 nëntor 2015, me kërkesë të paditësit K. Sh., Zyra e Përmbaruesit Privat lëshoi një urdhër (P. nr. 784/15) të përmbarimit. Parashtruesi i kërkesës e kundërshtoi këtë urdhër.

25. Më 4 prill 2016, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 50/2016 refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, vërtetoi detyrimin e tij ndaj paditësit dhe i ndryshoi vendimet e gjykatës së instancës më të ulët vetëm në aspektin e normës së interesit. Gjykata Supreme arsyetoi se: (i) vendimet e gjykatave të rregullta ishin mjaft të qarta dhe të arsyetuara; (ii) ekzistenca e marrëdhënieve ligjore midis palëve ndërgjyqëse është konfirmuar nga dëshmia e dëshmitarëve; (iii) dëshmitari i propozuar nga parashtruesi i kërkesës për t'u dëgjuar ishte i parëndësishëm për rastin në fjalë; dhe, (iv) pretendimi me të cilin vihet në dyshim identiteti dhe legjitimiteti i K. Sh. ishte i pabazuar dhe se parashtruesi nuk e ka ngritur këtë pretendim para gjykatave të instancës më të ulët, *inter alia*, në kundërshtim me faktet dhe procesverbalin e paraqitur në dosjet e gjykatave.

26. Në ndërkohë, paditësi K.Sh. parashtroi propozim për vendosjen e masës së sigurisë ndaj pronës së patundshme të parashtruesit të kërkesës.

27. Më 15 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Vendimin C. nr. 2929/2015 aprovoi si të bazuar propozimin e paditësit K. Sh. për vendosje të masës së sigurisë. Parashtruesi i kërkesës ishte urdhëruar që të mos ndërtojë asgjë, që të mos shesë, dhe të mos lidh kontratë dhe të vërtetojë kontratën mbi shitblerjen e parashtruesit të kërkesës me noterin kompetent në Prishtinë në njësinë kadastrale të caktuar në Prishtinë deri sa të nxirret një vendim tjetër i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

28. Parashtruesi ushtroi ankesë në kohën e duhur ndaj Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimit me të cilin ishte vendosur masa e sigurisë.

29. Më 24 prill 2016, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 1347/16 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

30. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke pretenduar, *inter alia*, se paditësi K. Sh., gjatë gjithë kohës u paraqit me një identitet të rremë dhe se kjo nuk ishte verifikuar nga gjykata, pavarësisht ankesave të shumta të parashtruesit të kërkesës.

31. Përkitazi me çështjen e identitetit dhe legjitimitetit të K.Sh., parashtruesi ka bashkangjitur si provë një njoftim nga autoritetet gjermane të prokurorisë ku në pjesën përkatëse thuhet: "*...autoritet kosovare janë njoftuar përmes Interpolit ... se i akuzuari Schwarz (i cili dikur quhej K. Sh., në vitin 1995 përmes natyralizimit ka fituar shtetësinë gjermane dhe ka ndërruar emrin e tij në A. C. R. Sch.)...se deri në çfarë mase paraqet përdorimi i të dhënave personale të mëhershme vepër penale...mbetet përgjegjësi e autoriteteve kosovare*".

32. Më 31 maj 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës se e ka pranuar iniciativën e tij dhe ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Prokurori i Shtetit pretendoi në Gjykatën Supreme se vendimet e gjykatave duhej të shfuqizoheshin për shkak të shkeljeve esenciale të së drejtës procedurale.

33. Më 4 gusht 2016, parashtruesi parashtroi kërkesën KI102/16 në Gjykatë. Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme për shkak se ishte e parakohshme pasi që procedurat ishin në pritje në Gjykatën Supreme. Gjykata gjithashtu vërejti se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese sa i përket legjitimitetit procedural të palëve dhe dëgjimit të dëshmitarëve (shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI102/16, *parashtrues i kërkesës Shefqet Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 marsit 2017, paragrafi 41).

34. Më 24 gusht 2016, Gjykata Supreme me Aktvendimin CLM. nr. 10/2016 e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit të parashtruar kundër vendimeve të gjykatave të faktit dhe të apelit në procedurë. Gjykata Supreme arsyetoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm për shkelje që kanë të bëjnë me kompetencë territoriale, detyrimi për të mbajtur dëgjim publik ose në një situatë kur publiku ishte mbajtur jashtë një seance publike. Gjykata Supreme konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkelje të legjitimitetit procedural të palëve.

35. Më 21 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP. nr. 1216/15 e hodhi poshtë kundërshtimin e parashtruesit ndaj urdhrit për përmbarim (P. nr.

784/15 të 30 nëntorit 2015) të lëshuar nga Zyra e Përmbaruesit Privat. Gjykata Themelore konstatoi se urdhri për përmbarim ishte bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 162/09 të 29 tetorit 2013.

36. Objekt i procedurës së përmbarimit të lartpërmendur ishte sekuestrimi i pronës private të parashtruesit dhe bllokimi i pensionit të tij invalidor i cili ishte i nevojshëm për trajtimin e tij mjekësor.

37. Parashtruesi e kontestoi vendimin e sipërpërmendur (PPP. nr. 1216/15) të Gjykatës Themelore pranë Gjykatës së Apelit.

38. Gjykata vëren se procedurat përmbarimore janë ende duke u zhvilluar në Gjykatën e Apelit, ato nuk mund të pengojnë përmbarimin e vendimit të Gjykatës Themelore për sekuestrimin e pronës së parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në të gjitha instancat nuk kanë marrë parasysh provat e propozuara nga ai, dhe as nuk kanë arsyetuar pse i kanë hedhur poshtë ato prova. Kjo përfshinte, *inter alia,* refuzimin që të përcaktojnë me saktësi identitetin e K.Sh. dhe ta dëgjojnë dëshmitarin e propozuar nga parashtruesit të kërkesës. Ky dëshmitar, sipas parashtruesit të kërkesës, - ishte dëshmitar i rëndësishëm për vendosjen e drejtë të rastit të tij, gjegj. nëse ai i kishte borxh parashtruesit të kërkesës apo jo, nëse paditësi me të vërtetë i ka dhënë atij "kredi" apo jo.

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij , për shkak të refuzimit për të dorëzuar prova dhe dëgjimit të dëshmitarit të propozuar nga ai, si dhe mungesës së arsyetimit për këtë, janë shkelur parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për një vendim të arsyetuar, si pjesë thelbësore e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai asnjëherë nuk pranoi se ai kishte marrë ose i detyrohej të holla paditësit në kundërshtim me atë që deklaroi gjykata themelore.

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: "*Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur nenin 6 të Konventës, për shkak se nuk është marrë fare me kërkesën për pjesëmarrje në seancën e revizionit të parashtruar për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut -neni 6 i Konventës. Përmes kësaj kërkesë i kërkoj gjykatës që të mbajë seancën në të cilën ajo do të dëgjonte pretendimet e mia për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut -neni 6 i Konventës. Argumentet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe lirive nga ana e gjykatave të mëparshme (shkeljet që kanë penguar gjykim të drejtë dhe të paanshëm) janë të bashkangjitur në këtë letër dhe justifikohen duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ.*"

43. Parashtruesi i kërkesës deklaron se: "*Prokuroria e Shtetit ka kërkuar anulimin e vendimeve gjyqësore të cilat janë nxjerrë në procedurë të vendosjes së masës siguruese - duke e konsideruar se ekzistojnë elementet të veprës penale (identiteti i falsifikuar i paditësit), sepse ai nuk është Komjet Shala (shtetas i Kosovës), por është Andreas Carsten Robert Shwarz, shtetas gjerman me vendbanim dhe vendqëndrim të përhershëm në Republikën Federale të Gjermanisë. Duke marrë parasysh se RFGJ e ndalon dyshtetësinë, nuk ka asnjë mundësi që të shmanget ekzistimi i këtyre veprave penale. Edhe sikur të lejohej dyshtetësia, në asnjë mënyrë nuk lejohet që të përdoren*

identitete të ndryshme në shtete të ndryshme, sepse identiteti përcaktohet nga emri personal dhe në këtë kuptim përcaktohet edhe personaliteti dhe legjitimiteti i një pale. Nuk mund të bëhet fjal e për të njëjtin person - por për personalitete të ndryshme .. Si mund të konsiderohet një procedurë e rregullt, përderisa nuk është i sigurt as identiteti i palëve në procedurë?"

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë nxjerrë vendime të paarsyetuara: "*Gjykata e Apelit përpos që nuk i ka arsyetuar vendimet/konkluzionet e saj, madje as nuk i ka përsëritur arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë - dhe nuk e arsyeton se pse pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë... Gjykata Supreme e Kosovës ka përsëritur heshtazi të gjitha shkeljet e instancave paraprake, duke i kthyer ato në shkelje të vazhdueshme të lirive dhe të drejtave themelore nga pushteti gjyqësor i shtetit. Gjykata ndër të tjera nuk i arsyeton fare vendimet e saj se nuk ka pasur shkelje të së drejtës formale dhe se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale".*

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij procedurat në tërësi ishin jokushtetuese dhe për këtë arsye, duhet të deklarohen jokushtetuese *ab initio*. Në këtë drejtim, ai pohon se: *"Në pajtim me këtë standard të G}EDNJ, e njoftoj Gjykatën Kushtetuese se kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor (trial) - dhe se kjo kërkesë nuk kufizohet në vlerësim të kushtetutshmërisë së vetëm vendimit të fundit. Sepse disa nga shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore, në fakt janë kryer nga Gjykata e Shkallës së Parë, qe ne fillim të procesit gjyqësor".*

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme (Aktvendimi CLM nr. 10/2016 i 24 gushtit 2016) edhe një herë dështoi që të adresojë çështjet kyçe të ngritura nga ai dhe nga Prokurori i Shtetit, përkatësisht: (i) çështjen e identitetit dhe legjitimitetit procedural të K .Sh; (ii) mënyra se si janë marrë provat; dhe, (iii) pse i vetmi dëshmitar i propozuar prej tij ishte refuzuar nga gjykatat. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij është shkelur parimi i barazisë së armëve në të gjitha instancat gjyqësore.

47. Parashtruesi kërkon vendosjen e masës së përkohshme, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullin54 të Rregullores së punës. "Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson: "*...parashtroj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës kërkesën për masë të përkohshme kundër të gjitha aktgjykimeve dhe vendimeve të nxjerra nga gjykatat sepse ato janë nxjerrë në shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe gëzim paqësor të pronës."*

48. Parashtruesi i kërkesës specifikon arsyet e mëposhtme: (i) prona e patundshme e cila është objekt i masave të sigurisë ishte gjithashtu objekt i hipotekës në favor të personit të tretë; (ii) vendosja e masave të sigurisë në pronën e cila ishte objekt i hipotekës përbën vepër penale; (iii) llogaria e parashtruesit (pensioni invalidor) përmes të cilit ai siguron trajtimin e tij mjekësor është e bllokuar, dhe (iv) parashtruesi që nga viti 1992 ka qenë i diagnostikuar me 100% shkallë të invaliditetit, dhe se për këtë arsye, bllokimi i pensionit të tij invalidor do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm.

49. Parashtruesi i kërkesës pohoi se për shkak të vendimeve të njëanshme të gjykatave në rastin e tij është krijuar një situatë e "shkeljes së vazhdueshme". Vendosja e masës së sigurisë kundër provës së tij dhe bllokimi i pensionit të tij invalidor shkel të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

50. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës deklaron se: "*Mendoj se përmbarimi i një vendimi kundër një pensioni invalidor, që është ndihmë për trajtim mjekësor dhe për të shpëtuar jetën time, rezulton edhe në shkelje të nenit 8 të Konventës".*

51. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që ta shpallë kërkesën të pranueshme, (ii) që të konstatojë se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, (iii) t'i deklarojë të pavlefshme procedurat gjyqësore në tërësi dhe t'i anulojë vendimet e kontestuara; (iv) që të vendosë masë të përkohshme; dhe (v) ta kthejë rastin në Gjykatën Themelore për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Vlerësimi i pranueshmërisë

52. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

53. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton: "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, të parashikuara me ligj, dhe për shkak të mungesës së ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, ai e ka adresuar kërkesën e tij në Gjykatë.

55. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh: "*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...*".

56. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në Vendimin e saj për masë të përkohshme të 28 marsit 2017, konstatoi si më poshtë: *"Që nga Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI102/16 me të cilin kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte deklaruar e papranueshme për shkak se ishte e parakohshme, Gjykata vëren se gjendja e parashtruesit nuk ishte rregulluar por në të vërtetë ajo ishte rënduar akoma, dhe si e tillë, ajo paraqet një situatë të vazhdueshme"*

57. Gjykata vëren se kriteri për parashtrimin e kërkesës brenda afatit prej katër (4) muajve nuk zbatohet në rastet e shkeljes së pretenduar të vazhdueshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih, ndër autoritetet e tjera, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI50/12 parashtrues i kërkesës, *Agush Lolluni*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).

58. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

59. Lidhur me përmbushjen e kësaj kërkese, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar saktësisht se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, janë shkelur në dëm të tij nga jokushtetutshmëria e pretenduar e procedurave gjyqësore.

60. Pas ekzaminimit të ankesave dhe vëzhgimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të një kompleksitetit të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet te varet nga shqyrtimi i meritave. Prandaj, kërkesa nuk mundet të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit te

rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (Shih, për shembull, *Rasti i A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55 dhe shih gjithashtu *mutatis mutandis* Rasti nr. KI132/15, *Manastiri Visoki Deçani*, Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

Meritat e kërkesës

61. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje te neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

62. Në rastin e tanishëm, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës, në pajtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

63. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

64. Përveç kësaj, neni 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së parasheh:

> "*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij".*

65. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i parashtruesit është se procedurat gjyqësore në tërësi ishin jokushtetuese, sepse gjykatat që nga fillimi kanë shkelur të drejtën e tij për të dëgjuar dëshmitarin e tij dhe provat e pranuara dhe çështjen e identitetit dhe legjitimitetit të palës kundërshtare.

66. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e "drejtësisë" siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës mbulon procedurat në tërësi, dhe pyetja nëse një person ka pasur një gjykim "të drejtë" shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht i një incident i veçantë ose mangësi procedurale, si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih, për shembull, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§55-70).

67. Gjykata vëren se parashtruesi gjithashtu pretendon se ai duhet të mbështetet në pensionin e tij invalidor për trajtimin e tij mjekësor dhe në pikëpamje të vendimeve të gjykatave që ai nuk mundet ta bëjë këtë. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se vendosja e masave të sigurisë në pronën e tij private do të dëmtojë gjithashtu të drejtat e personave të tretë dhe si e tillë është e paligjshme dhe është një vepër penale.

68. Përveç kësaj, Gjykata vëren se kërkesa ngre dyshime serioze rreth kushtetutshmërisë së procedurave gjyqësore, lidhur me: (i) arbitraritetin e pretenduar në vlerësimin e

fakteve; (ii) çështjen e identitetit dhe legjitimitetit procedural të K. Sh; (iii) pretendimit për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dëshmitari i tij dhe pranimin e provave; (iv) pasojat e mundshme të pafavorshme për parashtruesin dhe palët e treta në rast të zbatimit të masave të sigurisë ndaj pronës së tij, si dhe bllokimin e pensionit të tij invalidor.

69. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] to Kushtetutës, i cili përcakton se: "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

70. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se dyshimet e ngritura në kërkesën në shqyrtim do të vlerësohen kryesisht në dritën e kërkesave të parimit të barazisë së armëve. Gjykata po ashtu do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës është dëmtuar në lidhje me të drejtat e tjera, përkatësisht gëzimin paqësor të pronës dhe jetës private; shkelja e të cilave mund të jetë rezultat i shkeljes së parimit të barazisë së armëve.

71. Parimi i "barazisë së armëve" është i natyrshëm në kuptimin e një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë. Kërkesa e "barazisë së armëve", në kuptimin e një "ekuilibri të drejtë" midis palëve, vlen në parim për raste civile si dhe për raste penale (Shih rastin e *Feldbrugge kundër Holandës*, KEDNJ, kërkesa nr. 8562/79, Aktgjykimi i 29 majit 1986 paragrafi 44).

72. "Barazia e armëve" nënkupton që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj - duke përfshirë provat e saj - në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-a-vis* palës tjetër (Shih, *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).

73. Sa i përket çështjes së administrimit të provave, Gjykata vëren se Kushtetuta dhe Konventa nuk vendosin rregulla për prova të tilla (shih rastin *Mantovanelli kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 21497/93, Aktgjykimi i 18 marsit 1997, në paragrafin 34). Pranueshmëria e provave dhe mënyra se si duhet të vlerësohen janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen me ligjin kombëtar dhe gjykatat kombëtare (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28). E njëjta vlen edhe për vlerën provuese të provave dhe barrën e të provuarit (*Tiemann kundër Francës dhe Gjermanisë* (vend.). Gjithashtu, gjykatat e rregullta duhet të vlerësojnë rëndësinë e provave të propozuara (shih rastin e *Qendra Evropiane 7 S.r.l dhe Di Stefano* kundër Italisë [DHM], kërkesa ne. 38433/09, Aktgjykimi i 7 qershorit 2012, paragrafi 198).

74. Megjithatë, detyra e Gjykatës sipas Kushtetutës dhe Konventës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi janë të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave (shih Rastin e *Elsholz kundër Gjermanisë* [DHM], kërkesa nr. 25735/94, Aktgjykimi i 13 korrikut 2000 në paragrafin 66). Prandaj, duhet të përcaktojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë ashtu që të garantojnë një gjykim të drejtë (shih rastin e *Blücher kundër Republikës Çeke*, GJEDNJ, kërkesa nr. 58580/00, Aktgjykimi i 11 janarit 2005, paragrafi 65).

75. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të kryejnë një shqyrtim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët (shih rastin e *Vand de Hurk kundër Holandës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafin 59).

76. Në çështjen e provave të dëshmitarëve, Gjykata vëren se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 § 1 nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën e thirrjes së dëshmitarëve

dhe pranueshmëria e dëshmive të dëshmitarëve është në parim çështje e ligjshmërisë. Megjithatë, procedurat në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën në të cilën ishin lejuar provat, duhet të jetë "e drejtë" në kuptim të nenit 31 lidhur me nenin 6 § 1 (*Dombo dhe Beheer B. V. kundër Holandës*, paragrafi 31).

77. Kur gjykatat refuzojnë kërkesat për të thirrur dëshmitarët, ata duhet të japin arsye të mjaftueshme dhe refuzimi nuk duhet të jetë arbitrar; nuk duhet të përbëjë një kufizim joproporcional të aftësisë së palës ndërgjyqëse për të paraqitur argumente në mbështetje të çështjes së tij (shih rastin *Wierzbicki kundër Polonisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 24541/94, Aktgjykimi i 18 qershorit 2002 paragrafi 45).

78. Dallimi i trajtimit në lidhje me dëgjimin e dëshmitarëve të palëve mund të jetë i tillë që të cenojë parimin e "barazisë së armëve" (*Dombo dhe Beheer B.V. kundër Holandës*, paragrafi 35, ku vetëm një nga dy pjesëmarrësit në ngjarjet në fjalë u lejuan të japin dëshmi (shkelje).

79. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se nëse vërtetohet se një palë në procedurë i kërkesës ishte vendosur në një disavantazh të qartë *vis-à-vis* kundërshtarit të tij gjatë rrjedhës së procedurave të rregullta; atëherë, kjo është një tregues se është shkelur parimi i barazisë së armëve.

80. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka ngritur shqetësime për gjykim të drejtë në të gjitha instancat e gjykatës, gjegjësisht mospranimi i provave lidhur me legjitimitetin e K. Sh. dhe të dëgjimit të dëshmitarit të tij, por gjykatat nuk kanë marrë qëndrim lidhur me këto shqetësime dhe rrjedhimisht kanë shkelur "ekuilibrin e drejtë", e cila është kusht për barazi të armëve ndërmjet palëve ndërgjyqëse në procedurat civile.

81. Sa i përket rastit konkret, Gjykata do të hetojë pretendimet e parashtruara nga parashtruesi në çdo hap të procedurës para gjykatave dhe më pas, t'i ballafaqojë këto pretendime me gjetjet e gjykatave që të përcaktojë drejtësinë e procedurës si tërësi.

82. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në parashtresën e tij (C. nr. 162/2009 të 15 shkurtit 2013) drejtuar Gjykatës Themelore ne Prishtinë, kundërshtoi pretendimin se ai i detyrohet të holla paditësit K.Sh., duke deklaruar se padia e këtij të fundit është tërësisht e pabazuar dhe "fiktive". Për më tepër, parashtruesi i kërkesës shtoi se edhe nëse ai i detyrohet para paditësit, një borxh i tillë "hipotetik" do t'i nënshtrohej parashkrimit.

83. Në procesverbalin gjyqësor (C. nr. 162/09 të përpiluar më 7 qershor 2013) të seancës kryesore në Gjykatën Themelore në Prishtinë thuhet, ndër të tjera, se parashtruesi i kërkesës e ka kundërshtuar padinë e paditësit lidhur me të hollat e pretenduara që i detyrohet këtij të fundit. Ky procesverbal gjyqësor gjithashtu tregon se kërkesa e parashtruesit për dëgjimin e dëshmitarit I. S., ishte refuzuar pa asnjë shpjegim. Procesverbali gjyqësor gjithashtu tregon se parashtruesi i kërkesës njoftoi gjykatën se parashtresa e tij përfundimtare do të jetë me shkrim dhe në mënyrë më të detajuar.

84. Në parashtresën e tij përfundimtare (C. nr. 162/2009, të 29 tetorit 2013) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, përsëriti se ai e kundërshton padinë e paditësit si të pabazuar sa i përket të hollave të detyruara, theksoi mospërputhjen e paditësit në lidhje me shumën e borxhit, kërkoi që dëshmitari I.S. të dëgjohet, e informoi gjykatën se ai ka paraqitur kallëzim penal në Policinë e Kosovës për shkak të kërcënimeve dhe frikësimeve të kryera ndaj tij dhe familjes së tij nga ana e paditësit. Parashtruesi gjithashtu ngriti dyshime lidhur me identitetin dhe legjitimitetin e paditësit K. Sh.

85. Sa i përket dëgjimit të dëshmitarit të tij, parashtruesi i kërkesës deklaroi se është e pakuptueshme pse gjykata do ta refuzonte një dëshmitar të tillë, i cili do të ndihmonte gjykatën për të konstatuar të vërtetën veçanërisht në dritën e kundërshtive të dëshmive të dëshmitarëve të propozuar nga paditësi.

86. Lidhur me identitetin dhe legjitimitetin e paditësit K. Sh., parashtruesi i sugjeroi gjykatës që të pezullojë menjëherë procedurën dhe të verifikojë identitetin e paditësit. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës shtoi se në Gjermani, kundër paditësit ishte ngritur procedurë penale pikërisht për shkak të identiteteve të tij të ndryshme.

87. Në ankesën e tij (C. nr. 162/2009) pranë Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës përsëriti pretendimin e tij për pavlefshmërinë e çështjes juridike në mes të tij dhe paditësit, identitetin e paditësit dhe të drejtën e tij për dëgjimin e dëshmitarit I. S. Parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit për anshmërinë e gjykatës themelore në procedurë. Parashtruesi theksoi veçanërisht se dëgjimi i dëshmitarit I. S., është shumë i rëndësishëm, sepse ai do të shpjegonte nëse ai i detyrohet të holla paditësit apo jo.

88. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit konstatoi se nuk është e nevojshme të përgjigjet ndaj pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

89. Në kërkesën e tij për revizion (CA. nr. 411/2014, të 23 nëntorit 2015) pranë Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që të aprovojë revizionin si të bazuar dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim. Parashtruesi i kërkesës përsëriti se dëshmitë e tij lidhur me legjitimitetin e paditësit dhe kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit të tij I.S., u refuzuan nga gjykatat e shkallës më të ulët dhe u konsideruan të parëndësishme pa ndonjë shpjegim.

90. Në lidhje me këtë, Gjykata nxjerr në pah përgjigjen e Gjykatës Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 50/2016, i 4 prillit 2016) lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i Gjykatës Supreme mund të përmblidhet si më poshtë. Gjykata Supreme konstatoi se (i) çështja ligjore, d.m.th., borxh që parashtruesi i detyrohet paditësit ishte konstatuar nga dëshmitë e dëshmitarëve; (ii) pretendimet e parashtruesit për refuzimin e dëshmitarit të tij janë të pabazuara, sepse gjykata e faktit vendosi se dëshmitari I.S., është i parëndësishëm; dhe, (iii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për identitetin e paditësit është i paqëndrueshëm sepse gjykata e faktit ka identifikuar pasaportën e tij, dhe se parashtruesi nuk e ka ngritur këtë çështje para gjykatave të shkallës më të ulët.

91. Sa i përket çështjes së pretenduar juridike të përcaktuar ndërmjet parashtruesit dhe paditësit, Gjykata Supreme deklaroi si në vijim: "*Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është konstatuar se i padituri ka borxh paditësit shumën prej 35.000 DM, e cila është konvertuar në 17.500 €. Borxhi rrjedh nga raporti juridik i kontratës mbi huan, ku paditësi në emër të huas ia ka dhënë të paditurit shumën prej 35.000 DM/ Në bazë të marrëveshjes mbi huan në vitin 1999, i padituri ka qenë i detyruar që shumën e huas t'ia kthejë paditësit gjer më 31.12.2002, e që ky afat është zgjatur gjer me 31.12.2008, dhe se pas këtij afati i padituri nuk ia ka kthyer borxhin paditësit. Ekzistimi i raportit juridik të kontratës mbi huan në mes të ndërgjyqësve është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitareve të dëgjuar I.J., A.B. dhe S.B.*"

92. Në pyetjen e dëshmitarit të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme arsyetoi si më poshtë: "*Thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar ta dëgjojë dëshmitarin I.S., imamin e xhamisë "Sofalia" në Prishtinë, janë të pabazuara, nga arsyeja se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozimi për dëgjimin e dëshmitarit në fjalë është irrelevante për vendosje në këtë çështje juridike. Thëniet e revizionit se dëshmitarët e dëgjuar nuk janë deklaruar për faktet relevante për vendosje në këtë çështje juridike, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkalles së parë*

ka dëgjuar dëshmitarët në rrethana që kanë të bëjnë se a ka ekzistuar raporti juridik nga kontrata mbi huan në mes të palëve ndërgjyqës, i cili fakt ka qenë relevant për vendosje të drejtë ne këtë çështje juridike, nga arsyeja se palët ndërgjyqës kanë lidhur kontratë verbale mbi huan".

93. Në çështjen e identitetit të paditësit, Gjykata Supreme ka mbajtur si në vijim: "*I padituri në revizion konteston faktin e legjitimitetit dhe identitetit të palës së paditur, duke theksuar se paditësi përveç identitetit K.Sh., ka identitet si ACSh, si shtetas gjerman, Mirëpo, në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë me 19.4.2013, gjykata ka bërë identifikimin e paditësit në bazë të pasaportës nr. K000432720 dhe se në këtë shqyrtim ka qenë prezent personalisht i padituri dhe i autorizuari i tij H.R., të cilët nuk kanë pasur vërejtje në identitetin e paditësit si dhe në shqyrtimet e mëvonshme, prandaj, nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se nuk është bere identifikimi i palës paditëse".*

94. Gjykata vëren se, në ndërkohë, kanë ndodhur disa ngjarje në lidhje me rastin e parashtruesit, gjegjësisht, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës në Rastin Nr. KI102/16, parashtruesi *Shefqet Berisha* i cili ishte deklaruar i papranueshëm për arsye se ishte e parakohshme. Në këtë rast, Gjykata vlerësoi se kjo kërkesë ngre çështje të rëndësishme kushtetuese dhe se, asgjë, nuk e përjashton parashtruesin e kërkesës për të paraqitur një kërkesë të re në të ardhmen.

95. Në këtë dritë, kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë u pranua nga Prokurori i Shtetit, i cili e paraqiti atë kërkesë në Gjykatën Supreme. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi te Prokurori i Shtetit një njoftim zyrtar nga autoritetet ndjekëse gjermane lidhur me identitetin e paditësit.

96. Prokurori i Shtetit deklaroi në Gjykatën Supreme se gjykatat e shkallës së ulët nuk i janë përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për identitetin dhe legjitimitetin e paditësit K. Sh.

97. Gjykata Supreme (Aktvendimi CLM Nr. 10/2016, i 24 gushtit 2016) e refuzoi kërkesën për mbrojtje duke arsyetuar se një kërkesë e tillë mund të paraqitet vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me kompetencën territoriale, detyrimin për mbajtjen e dëgjimit publik ose në situatë kur publiku ishte mbajtur jashtë një seance publike. Gjykata Supreme konkludoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të parashtrohej për shkelje të legjitimitetit procedural të palëve.

98. Kanë pasuar edhe ngjarje të tjera në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht vendosja e masave të sigurisë nga Gjykata Themelore kundër pronës së parashtruesit dhe bllokimi i pensionit të tij invalidor. Parashtruesi i kërkesës ka përsëritur pretendimet e tij edhe gjatë procedurës së përmbarimit (masat e sigurisë) dhe bllokimin e procedurave të pensionit të tij invalidor.

99. Parashtruesi parashtroi kërkesë të re në Gjykatë duke kërkuar vendosjen e masës së përkohshme në favor të tij duke pretenduar shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen e pronës dhe jetën private.

100. Gjykata miratoi masë të përkohshme në rastin nr. KI31/17 parashtruesi *Shefqet Berisha*, duke vlerësuar, inter alia, se "*që nga Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI102/16 me të cilin kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte deklaruar e papranueshme për shkak se ishte e parakohshme, Gjykata vëren se gjendja e parashtruesit nuk ishte rregulluar por në të vërtetë ajo ishte rënduar akoma, dhe si e tillë, ajo paraqet një situatë të vazhdueshme".*

101. Me fuqinë e të lartpërmendurve, Gjykata së pari vëren se gjetjet e fakteve të gjykatave nuk pasqyrojnë përmbajtjen e rastit sepse parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk pranoi se kishte lidhur një çështje ligjore me paditësin ndërsa gjykatat, pa pranuar provat e propozuara deklaruan se ai bëri atë (Shih Parashtresën Nr. 162/2009 të 15 shkurtit 2009 dhe gjithashtu shihni Shënimet Gjyqësore C. nr. 162/2009 të 7 qershorit 2013).

102. Së dyti, gjykatat e refuzuan propozimin e parashtruesit për ta dëgjuar dëshmitarin e tij të vetëm pa shpjegime të mjaftueshme nga njëra anë, dhe pranimin e dëshmitarëve të propozuar nga paditësi, nga ana tjetër, duke shkelur kështu "ekuilibrin e drejtë" midis palëve në konteste civile (shih Parashtresën nr. 162/2009 dhe gjithashtu shih Shënimin Gjyqësor C. nr. 162/2009 të cituar më lart).

103. Së treti, gjykatat konstatuan se parashtruesi asnjëherë nuk e ngriti çështjen e identitetit të paditësit, ndërsa është mjaft e qartë se ai e ngriti atë çështje nga e instanca e parë deri në atë të fundit (shih Parashtresën nr. C. nr. 162/2009 i 29 tetorit 2013).

104. Së katërti, gjykatat, nga njëra anë, kanë vlerësuar pasaportën e Kosovës të paditësit, ndërsa nga ana tjetër kanë hedhur poshtë dëshminë e parashtruesit të kërkesës për identitetin e paditësit, përkatësisht, njoftimin zyrtar të autoriteteve ndjekëse gjermane për të njëjtën çështje, prandaj, përsëri, duke shkelur "ekuilibrin e drejtë" midis palëve ndërgjyqëse në procedurat civile (shih kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë).

105. Në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme (CLM nr. 10/2016 të 24 gushtit 2016), me të cilin refuzohet kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata vëren se si Gjykata Supreme nuk i ka kushtuar fare vëmendje provave të paraqitura nga Prokurori i Shtetit; sidomos, njoftimi zyrtar i autoriteteve ndjekëse gjermane në lidhje me procedurat e ngritura kundër paditësit K.Sh.

106. Gjykata konsideron se gjyqtarët në procedurë të rregullt duhet t'i kushtojnë vëmendje dispozitave mbizotëruese kushtetuese, respektivisht neneve 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës. Interpretimi i dispozitave ligjore duhet të bëhet në frymën e Kushtetutës dhe të Konventës. Duke parë në këtë dritë, Gjykata konsideron se duke mos marrë parasysh provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme nuk e ka interpretuar dhe zbatuar ligjin në frymën e Kushtetutës dhe të Konventës.

107. Prandaj, Gjykata konsideron se dështimi i gjykatave në të gjitha instancat e procedurave për t'i marrë në konsideratë dëshmitë dhe dëshmitarët e propozuar nga parashtruesi i kërkesës, është në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si elementë thelbësorë të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

108. Prandaj, Gjykata gjen se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.

Masa e përkohshme

109. Siç u tha më sipër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 162/09, të 29 tetorit 2013, dhe të ndalojë çdo procedurë gjyqësore, procedurë përmbarimore, veprime ose vendime të autoritetet publike që rrjedhin nga ai aktgjykim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

110. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa për masë të përkohshme është e bazuar dhe e justifikuar në një çështje që ka të bëjë me pronën e paluajtshme dhe pensionin invalidor të parashtruesit të kërkesës. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se një kompensim i mundshëm material nuk mund të korrigjojë dëmin e pariparueshëm që do t'i bëhej parashtruesit të kërkesës nëse pasuria e tij i nënshtrohet masave të sigurisë dhe pensionit invalidor të bllokuar, sepse prona e paluajtshme është unike dhe pensioni invalidor ka pasoja të drejtpërdrejta në jetesën e parashtruesit, e cila është vlera supreme në hierarkinë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rasti nr. KI72/12, *parashtruesit e kërkesës Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr.1053 / 2008, i 31 majit 2012, Aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2012, Paragrafët 65-69)*

111. Gjykata konsideron se si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi gjithashtu u gjend në një pozitë të pasigurt në lidhje me të drejtën e tij për gëzimin paqësor të posedimit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të drejtës për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të Konventës.

112. Gjykata përsërit se Gjykata e shkallës së parë ka shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; megjithatë, Gjykata e Apelit si dhe Gjykata Supreme nuk e kanë korrigjuar atë shkelje.

113. Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 55 (9) të Rregullores së punës pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të çështjes së kontestuar, vendos ta vazhdojë masën e përkohshme, deri në rishqyrtimin përfundimtar nga gjykatat.

Përfundim

114. Në përfundim, Gjykata konstaton se duke mos i kushtuar vëmendje të duhur provave të propozuara nga parashtruesi dhe Prokurori i Shtetit, vendimeve të paarsyetuara si dhe refuzimit për të dëgjuar dëshmitarin e vetëm të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, gjykatat në të gjitha instancat kanë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës ka mundur të privohet nga e drejta e tij për gëzimin paqësor të pronës dhe të drejtës për jetën private për shkak se prona e tij private iu nënshtrua masave të sigurisë dhe bllokimit të pensionit të tij të invalidor.

115. Gjykata më tej përsërit se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë në domenin e gjykatave të rregullta dhe autoriteteve të tjera publike në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe për aq sa këto çështje rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë jokushtetuese (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI135/14, *parashtruesi IKK Classic,* Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, me referenca të mëtejshme). Prandaj, Gjykata ka obligim kushtetues që të sigurojë që procedurat që zhvillohen para autoriteteve publike dhe sidomos gjykatave, duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

116. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktvendimi i Gjykatës Supreme (CLM. nr. 10/2016, i 24 gushtit 2016) shpallet i pavlefshëm dhe rasti, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, i kthehet Gjykatës Supreme të Kosovës për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) dhe 116 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 55 (4), (5) dhe (9) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 30 maj 2017,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës;

IV. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (C. nr. 162/09, të 29 tetorit 2013) dhe vendimet që pasojnë në ankesë, masat e sigurisë dhe procedurat e përmbarimit, veprimet ose vendimet e autoriteteve publike që rrjedhin nga ai aktgjykim;

V. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin (CLM nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016) dhe Aktgjykimin (Rev. nr. 50/2016, të 4 prillit 2016) të Gjykatës Supreme të Kosovës;

VI. TA KTHEJË Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (CLM nr. 10/2016, të 24 gushtit 2016) për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

VII. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, lidhur me masat e ndërmarra për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VIII. TA MIRATOJË kërkesën për masë të përkohshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës ta rishqyrtojë çështjen sipas arsyetimit dhe dispozitivit të Aktgjykimit të kësaj Gjykate;

IX. TË MBETET fuqimisht e angazhuar ne këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;

X. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet Palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

XI. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI127/15, Parashtrues: Mile Vasović, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në zhvillim në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07)

KI127/15, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 qershorit 2016, publikuar më 15 qershor 2016

Fjalët kyçe: *Kërkesë individuale, çështje civile, e drejta për gjykim të drejtë, zvarritje e procedurave, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme*

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës, pretendonte se zvarritja e panevojshme e procedurave nga gjykatat e rregullta dhe mos nxjerrja e vendimit përfundimtar në kohë të arsyeshme shkelte të drejtat e tij për gjykim të drejtë, e vendoste atë në pozitë të pabarabartë para ligjit, si rezultat i këtyre zvarritjeve ai pretendonte se i ishin mohuar edhe të drejtat pronësore.

Gjykata, në dritën e rrethanave komplekse të këtij rasti, mori parasysh bazën ligjore komplekse, sjelljen e palëve procedurale, interesat legjitime të tyre dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe detyrimet e veçanta procedurale që gjykatat e rregullta ishin të detyruara t'i zbatonin përkitazi me këtë rast, dhe arriti në konkluzion se gjykatat respektive që nga momenti i vënies në lëvizje të tyre nuk kishin qëndruar pasive, siç pretendonte parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit, në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores se punës, u deklarua qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI127/15

Parashtrues

Mile Vasović

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë
së procedurave në zhvillim në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës,
përkitazi me lëndën C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07)**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mile Vasović, me vendbanim në Beograd (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike. Ai konteston tejzgjatjen e procedurave përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07) nga gjyqësori i rregullt i Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurave nga gjykatat e rregullta, përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07), si rezultat i të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6, paragrafi 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt], nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] dhe me nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së

Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI127/15, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin nr. KSH. KI127/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 30 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 2 shtator 2016, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Prishtinë informata shtesë përkitazi me rastin.

9. Më 7 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë e informon Gjykatën se lënda civile C. nr. 850/07 (P.nr.850/07), me të gjitha shkresat përcjellëse më 14 gusht 2014, i është dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

10. Më 16 janar 2017, Gjykata i është drejtuar me një shkresë Dhomës së Posaçme, nga e cila kërkoi informata përkitazi me statusin e lëndës C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07).

11. Më 13 mars 2017, Dhoma e Posaçme informon Gjykatën se lënda e Gjykatës Themelore, C. nr. 850/07 (P.br.850/07), është regjistruar pranë saj si rast C-III-14-0211 dhe pritet të vendoset nga shkalla e parë e Dhomës së Posaçme, sipas radhës dhe prioriteteve.

12. Më 5 prill 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga kërkesa e parashtruesit rezulton se më 26 qershor 1992, Ndërmarrja Shoqërore "Fabrika e Amortizatorëve" (Vendimi nr. 2856/1) i kishte dhënë në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës banesën e cila ndodhet në lagjen Dardania në Prishtinë. Më 1 korrik 1992, parashtruesi kishte lidhur kontratë (nr. 5117/93) me ndërmarrjen banesore për shitblerjen e banesës, të cilën kontratë e kishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 5 korrik 1993. Parashtruesi pohon të ketë jetuar në banesë deri në vitin 1999, kur dhe është larguar nga Kosova.

Procedura pranë Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore

14. Në një datë të paspecifikuar (pas vitit 1999), pala e tretë SH.V., parashtroi kërkesën DS606377 pranë Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejmë: DPB), me pretendimin se ai e kishte humbur të drejtën e pronësisë mbi banesën në fjalë si pasojë e një vendimi diskriminues mbi baza etnike të lëshuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes Shoqërore "Fabrika e Amortizatorëve".

15. Në një datë të paspecifikuar edhe parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën DS000743, pranë DPB-së, për të vërtetuar të drejtën e pronësisë mbi banesën.

16. Më 22 tetor 2005, Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejmë: KÇPB), me Vendimin HPCC/D/221/2005/A&C, e refuzoi kërkesën e palës së tretë (parashtruesi i kategorisë A) dhe aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës (parashtruesi i kategorisë C), duke ia njohur atij të drejtën e posedimit mbi banesën, por jo edhe të drejtën e transferimit të pronës tek personat e tjerë, derisa gjykata kompetente të vendoste për titullin e pronësisë mbi atë banesë, nëse pala e tretë përkitazi me të drejtat e tij pronësore mbi banesën në fjalë, do t'i drejtohej gjykatës kompetente.

17. Në nëntor të vitit 2005, pala e tretë, pranë KÇPB-së, kërkoi rishqyrtimin e vendimit të mëhershëm HPCC/D/221/2005/A&C të 22 tetorit 2005.

18. Më 11 dhjetor 2006, KPB-ja-me Vendimin HPCC/REC/81/2006 konfirmoj vendimin e 22 tetorit 2005, me arsyetimin se pala e tretë nuk kishte paraqitur dëshmi të reja dhe për faktin se vendimi nuk ishte përfshirë me gabime thelbësore gjatë zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Faktet në procedurë gjyqësore (kontestimore)

19. Më 16 prill 2007, pala e tretë parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë ndaj parashtruesit të kërkesës dhe Ndërmarrjes Shoqërore "Fabrika e Amortizatorëve". Objekti i kërkesëpadisë ishte anulimi kontratës së shitblerjes së banesës dhe rikthimi i të drejtës pronësore mbi banesën.

20. Më 17 prill 2007, pala e tretë kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë të vendoste masë të përkohshme në mënyrë që parashtruesit të kërkesës t'i ndalohej shitja, vënia në hipotekë dhe transferimi i banesës.

21. Më 30 tetor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi I. nr. 503/07), caktoi masë të përkohshme me të cilën parashtruesit të kërkesës iu ndalua shitja, vënia në hipotekë dhe vërtetimi i kontratës së shitblerjes së banesës. Në vijim arsyetimi i vendimit: *"Pasi që kreditori në propozimin për caktimin e masës së përkohshme të datës 17.04.2007 e bëri të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe rrezikun se debitori (parashtruesi i kërkesës) do të pamundësonte apo vështirësonte realizimin e kërkesës, gjykata në bazë të nenit 267 të LPP-së, vërtetoi se ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së përkohshme, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi (në bazë të nenit 268 pika 2 të LPP-së)."*

22. Më 11 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi kundërshtim në shkallë të dytë të Gjykatës Komunale në Prishtinë ndaj aktvendimit të shkallës së parë të 30 tetorit 2007, duke argumentuar se me Vendimin HPCC/REC/81/2006 të KPB-së është refuzuar kërkesa e palës së tretë, për sa i përket të drejtave pronësore mbi banesën.

23. Më 1 dhjetor 2011, shkalla e dytë e Gjykatës Komunale në Prishtinë (Aktvendimi I. nr. 503/07), refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës, duke e lënë në fuqi masën e përkohshme, deri në përfundimin e procedurës kontestimore, përkitazi me lëndën C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07), të iniciuar nga pala e tretë.

24. Më 9 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ndaj Aktvendimit të shkallës së dytë të 1 dhjetorit 2011, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljes së ligjit material.

25. Më 31 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Gz. 1459/2011), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Aktvendimin e shkallës së dytë të 1 dhjetorit 2011.

26. Më 27 shtator 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07), përkitazi me objektin e kërkesëpadisë, të iniciuar nga pala e tretë, e shpallë veten jokompetente dhe vendosi që lënda C. nr. 850/07 (P. nr. 850/0) t'i dërgohet Dhomës së Posaçme pasi vendimi të bëhej i plotfuqishëm.

27. Më 4 prill 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë ndaj Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë të 27 shtatorit 2012, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

28. Në ndërkohë, më 8 mars, 3 prill dhe 27 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar me ankesa Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Kosovës, me pretendimin se gjykata e shkallës së parë është duke e zvarritur dërgimin e lëndës për vendosje në gjykatën e shkallës së dytë.

29. Më 7 qershor 2013, Zyra e Prokurorit Disiplinor, përmes shkresës KDT/13/541), parashtruesit të kërkesës iu përgjigj: *"ZPD ka vërtetuar se vonesa në dërgimin e lëndës sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë nga ana e personit përgjegjës dhe administratës në Gjykatën Komunale në Prishtinë është katër muaj. Vonesa prej katër muajsh, në rastin konkret nuk i plotëson kriteret për hapjen e hetimit disiplinor për sjellje joprofesionale".*

30. Më 31 janar 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi AC. nr. 853/13), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë të 27 shtatorit 2012, duke arsyetuar si më poshtë:

> *[...]*
> *"Gjykata e shkallës së dytë, në këtë situatë të krijuar, nuk mund të lëshohet në një vërtetim tjetër të gjendjes faktike, sepse bëhet fjalë për një ndërmarrje shoqërore, siç është "Fabrika e Amortizatorëve" në Prishtinë, e cila e ka cilësinë e të paditurit, prandaj, në situata të tilla, kompetente për vendosje për këtë çështje juridike të paditësit është ekskluzivisht Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjë e cila në mënyrë decidive është përcaktuar edhe me dispozitat relevante të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit..."*
> *[...]*

31. Në dhjetor të vitit 2014, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Dhomës së Posaçme me një kërkesë për përshpejtimin e lëndës C. nr. 850/07 (P.nr. 850/07). Kërkesa e tij ishte refuzuar, si e parregullt, për shkak se nuk i përmbushte kriteret e ligjore për t'u quajtur ankesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se tejzgjatja e panevojshme e procedurave nga gjykatat e rregullta dhe mosnxjerrja e vendimit përfundimtar për çështjen e tij rezulton me shkeljen e të drejtave të tij, si më poshtë:

> 1) Shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, nga shkaku se: *"Për më shumë se tetë vite është duke u zhvilluar procedura gjyqësore në lidhje me të drejtën për banesën time, dhe deri më tani nuk ka filluar shqyrtimi i bazueshmërisë së kërkesëpadisë, e cila është paraqitur kundër meje. Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të gjitha vendimet e marra kishin të bënin ose me vendimin për masën e përkohshme të ndalimit të disponimit me banesën ose me*

kompetencën e gjykatës. Për këtë arsye, për më shumë se tetë vite më është pamundësuar disponimi me pronën time, dhe kur e marrim parasysh vitin 1999, kur unë u detyrova të largohem nga banesa, kjo është më shumë se 16 vjet."

2) Shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, për shkak të mosgëzimit paqësor të pronës, e cila vjen si rezultat i tejzgjatjes së procedurave nga gjykatat e rregullta;

3) Shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të Konventës, me pretendimin se *"... për 8 vite nuk fillon shqyrtimi i çështjes kryesore dhe i objektit të kërkesëpadisë, prandaj, parashtroj pyetjen a jam unë i barabartë para ligjit si qytetarët e tjerë të Kosovës".*

33. Përveç konstatimit të shkeljeve të pretenduara, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që "*në bazë të shkeljeve të vërtetuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të gjykojë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial"* dhe që *"... gjykatat e Kosovës të urdhërohen që brenda një afati sa më të shkurtër të marrin vendimin në lëndën për të cilën parashtroj këtë ankesë".*

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Së pari, Gjykata merr parasysh dispozitat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, që përcaktojnë:

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

37. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës, parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

38. Për më tepër, rregulli 36 (2) (b) i Rregullores së punës, specifikon:

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
[...]
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;".

39. Gjykata vëren se thelbi i kërkesës ka të bëjë me pretendimin për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, përkatësisht shkeljen e të drejtës për një gjykim përfundimtar, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

40. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 31, paragrafit (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin (1) të Konventës, që përcaktojnë:

> Neni 31 (2) i Kushtetutës
> *2) "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*
> *[...]*
>
> Neni 6 (1) i Konventës
> *1) "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij".*
> *[...]*

41. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se neni 6 (1) i Konventës kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të dëgjuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme, dhe nëse është e nevojshme, t'i bashkojë procedurat, t'i pezullojnë ato apo edhe të hedhin poshtë vendimet për procedura të reja (Për më tepër, shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, të 1 prillit 2014, ankimet nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, paragrafi 91).

42. Sa i përket shtrirjes në kohë të procedurave, Gjykata merr parasysh kriteret e përcaktuara në Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në rastin *Tomažič kundër Sllovenisë*, të 2 qershorit 2008), ankimi nr. 38350/02, paragrafi 54, ku përcaktohet si në vijim: *"Sa i përket arsyeshmërisë së zgjatjes së procedurave, [GJEDNJ] thekson se kjo duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: kompleksitetin e rastit, sjelljen e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje"*.

43. Sipas kuptimit të nenit 6, paragrafit (1) të Konventës, llogaritja e procesit, shtrirjes në kohë të procedurave, fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastin, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë* GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 64, shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë* GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (Shih rastin *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë* GJEDNJ, të 15 korrikut 1982, paragrafi 74).

44. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kemi të bëjmë me dy lloje të procedurave. Procedura e ndjekur pranë DPB-së, si organi i pavarur, dhe procedurat e ndjekura pranë gjykatave të rregullta.

45. Sa i përket procedurave të ndjekura pranë DPB-së, Gjykata vëren se procesi pranë DPB-së u iniciua, fillimisht me kërkesë të palës së tretë (kërkesa DS606377) dhe, më pastaj

edhe të parashtruesit të kërkesës (kërkesa DS000734). Mirëpo, data e inicimit të procedurës nuk është specifikuar nga parashtruesi i kërkesës dhe nuk është e qartë nga shkresat e lëndës. Për Gjykatën, është e qartë se procedura pranë këtij autoriteti kaloi dy instanca shqyrtuese. Ajo në instancën e parë përfundoi më 22 tetor 2005 dhe u konfirmua më 11 dhjetor 2006, pas ushtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga pala e tretë.

46. Gjykata vë në pah se KÇPB-ja, banesën ia dha në posedim parashtruesit të kërkesës, por ia ndaloi atij transferimin e pronës tek personat e tjerë, nëse pala e tretë në afatin e përcaktuar, do t'i drejtohej gjykatës kompetente lidhur me të drejtat e tij pronësore mbi atë banesë. Ky urdhër mbeti në fuqi, pasi pala e tretë ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke u bazuar në këshillën e dhënë në vendimin HPCC/D/221/2005/A&C të komisionit në fjalë, në pikën 1.(a). Sipas vendimit në fjalë parashtruesi i kërkesës e gëzon të drejtën e posedimit të banesës, por jo edhe të shitjes ose dhënies në hipotekë, deri në një vendim përfundimtar me të cilin do të vendoset e drejta e pronësisë.

47. Sa i përket procedurave të ndjekura në gjykatat e rregullta, Gjykata vëren se pas vendosjes së çështjes nga DPB-ja, pala e tretë, krahas ushtrimit të kërkesëpadisë pranë gjykatës së shkallës së parë kishte kërkuar edhe masë të përkohshme. Procedura përkitazi me caktimin e masës së përkohshme kaloi tri instanca gjyqësore (dy në shkallë të parë dhe një në shkallë të dytë). Ajo u iniciua në gjykatën e shkallës së parë më 17 prill 2007 dhe përfundoi në gjykatën e shkallës së dytë më 31 janar 2012. Ky proces zgjati 4 (katër) vjet e gjashtë muaj.

48. Ndërsa, sa i përket kërkesëpadisë, Gjykata vëren se kontesti u iniciua nga pala e tretë, pranë gjykatës së shkallës së parë më 16 prill 2007, e cila më 27 shtator 2012 shpalli veten jokompetente për të vendosur për meritat e kërkesëpadisë. Ky vendim u konfirmua nga gjykata e shkallës se dytë, më 31 janar 2014 (pas ushtrimit të ankesës së parashtruesit). Procesi në këto dy instanca gjyqësore zgjati 6 (gjashtë) vjet e dhjetë muaj.

49. Gjykata, gjithashtu, vë në dukje se lënda C. nr. 850/07 (P. nr. 850/07) i është dërguar Dhomës se Posaçme, më 14 gusht 2014, për të vendosur si gjykatë kompetente. Lidhur me statusin e kësaj lënde Dhoma e Posaçme ka informuar Gjykatën se e njëjta pritet të vendoset sipas radhës dhe prioriteteve. Shikuar në tërësi, nga vendimi i parë i organit administrativ, deri në dorëzimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, procedurat kanë zgjatur 8 (tetë) vjet e gjashtë muaj.

50. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në procedurë pranë gjykatave të rregullta paraqiten tri palë, gjegjësisht, parashtruesi i kërkesës, pala e tretë (SH.V.,) dhe Ndërmarrja shoqërore "Fabrika e Amortizatorëve". Duke qenë se kjo e fundit ishte ndërmarrje shoqërore, si palë pranë Dhomës së Posaçme është paraqitur edhe AKP-ja. Palët, përkatësisht parashtruesi i kërkesës dhe pala e tretë, kanë ndërmarrë gjithsej shtatë veprime procedurale (dy pranë organit administrativ dhe pesë në gjykatat e rregullta).

51. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se parashtruesit kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë parashtruesit duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në shtyrjen në kohë (Shih rastin, *McFarlane kundër Irlandës* GJEDNj, të 10 shtatorit 2010, aplikimi nr. 31333/06, paragrafin 148).

52. Për më tepër, Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm që kërkojnë dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës (Shih rastin *Eckle kundër Gjermanisë,*

GJEDNj, aplikimi nr. 8130/78, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82). Palët në procedurë janë plotësisht të barabarta në përdorimin e mjeteve ligjore të vëna në dispozicion nga ligji, nëse qëllimi i tyre është rivendosja e një të drejte të pretenduar.

53. Gjykata, në dritën e rrethanave komplekse të këtij rasti, duke marrë parasysh bazën ligjore komplekse, sjelljen e palëve procedurale, interesat legjitime të tyre dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe detyrimet e veçanta procedurale që gjykatat e rregullta kanë qenë të detyruara t'i zbatojnë përkitazi me këtë rast konkret, arrin në konkluzion se gjykatat respektive që nga momenti i vënies në lëvizje të tyre nuk ishin pasive.

54. Sa i përket pretendimeve tjera të parashtruesit të kërkesës, Gjykata nuk e konsideron si të nevojshme trajtimin e tyre veç e veç, përderisa thelbi i ankesës ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 31 (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës, respektivisht me të drejtën për një vendim përfundimtar, në kohë të arsyeshme.

55. Nga sa më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, respektivisht të drejtën për gjykim të drejtë, brenda një afati kohor të arsyeshëm, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij këtë të drejtë kushtetuese.

56. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit, në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores se punës, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 qershor 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI07/17, Parashtrues, Pashk Mirashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, të 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR nr. 231/2015, të 6 gushtit 2015

KI07/17, Aktvendim për papranueshmëri i 29 majit 2017, publikuar më 15 qershor 2017.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, vepër penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta në mjete juridike, masë e përkohshme, ratione materiae*

Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (PML. nr. 228/16), përmes të cilit kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, lidhur me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale. Parashtruesi i kërkesës po ashtu konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (PAKR nr. 231/2015), të nxjerrë në procedurë penale, përmes të cilit ankesa e parashtruesit ishte e refuzuar si e pabazuar. Në ankesën e tij, pranë Gjykatës së Apelit, parashtruesi kishte pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit penal dhe procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe apelimin e vendimit përkitazi me dënimin.

Parashtruesi në kërkesën e tij kishte pretenduar shkeljen e të drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në mjete juridike. Ai gjithashtu, kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të urdhërojë lirimin nga burgu deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata konstatoi se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse sa i përket pretendimeve lidhur me procedurën penale, Gjykata konstatoi se ishte e paafatshme, ndërsa sa i përket pretendimeve lidhur me procedurën e rishikimit konstatoi se nuk është *ratione materie* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, edhe kërkesa për masë të përkohshme u refuzua.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI07/17

Parashtrues

Pashk Mirashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, të 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR nr. 231/2015, të 6 gushtit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Pashk Mirashi, me banim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Alexander Borg Olivier, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Vendimet e kontestuara janë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, i 20 tetorit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Aktvendimi PN. nr. 523/2016, i 20 korrikut 2016) dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë (Aktvendimi KP. nr. 603/2015, i 16 dhjetorit 2016) dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR nr. 231/2015, i 6 gushtit 2015.

3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 27 tetor 2016, ndërsa Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, të 6 gushtit 2015, iu dorëzua parashtruesit në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Përveç kësaj, pas parashtrimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), parashtruesi paraqiti kërkesë për masë të përkohshme duke kërkuar nga Gjykata që të urdhërojë lirimin e parashtruesit nga vuajtja e dënimit me burg.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 1 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 8 mars 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

9. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gresa Caka- Nimani.

10. Më 29 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

11. Më 4 prill 2017, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit e njoftoi Gjykatën se parashtruesi "*sapo është marrë në paraburgim policor si pasojë e një urdhri të lëshuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore të Prishtinës*". Në të njëjtën kohë, ai paraqiti kërkesë për masë të përkohshme duke kërkuar lirimin e parashtruesit të kërkesës.

12. Më 18 prill 2017, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi ED. 1624/15, i 11 prillit 2017) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim derisa Gjykata të nxjerrë një vendim përfundimtar. Parashtruesi i kërkesës në letrën e tij, kërkon nga Gjykata që të shqiptojë masë të përkohshme dhe ta lirojë parashtruesin nga burgu.

13. Më 29 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 27 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës, u caktua si likuidues i Bankës Kreditore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: BKP). Më parë, ai ishte u.d. drejtor për degën e BKP-së në Gjakovë.

15. Më 29 prill 2010, parashtruesi u shkarkua nga pozicioni i tij si likuidues sepse kishte nënshkruar marrëveshje për likuidimin e kredive pa konsultime paraprake me BKP-në.

16. Më 16 gusht 2010, u.d. i likuiduesit të BKP-së parashtroi kallëzim penal kundër parashtruesit të kërkesës në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë.

17. Më pas, kërkesa e lartpërmendur për kallëzim penal u transferua në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PSRK).

18. Më 24 shkurt 2011, PSRK-ja (Vendimi PPS nr. 87/2010) filloi procedurë hetimore kundër parashtruesit të kërkesës. Hetimet lidhur me rastin e parashtruesit u drejtuan nga prokurori special N. M.

19. Më 10 gusht 2011, PSRK-ja ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprave penale si në vijim: keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit; mashtrimi; dhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare ose autorizimit siç parashihet me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

20. Më 5 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (KA. 556/11) e konfirmoi aktakuzën e ngritur kundër parashtruesit të kërkesës.

Aktakuza dhe gjykimi i prokurorit special

21. Më 31 korrik 2012, prokurori i EULEX-it ngriti aktakuzë kundër N.M., prokurorit special, i cili përfaqësonte PSRK-në gjatë fazës së hetimit dhe ngritjen e aktakuzës kundër parashtruesit të kërkesës. N.M., pas kallëzimit penal të parashtruar kundër parashtruesit të kërkesës, ishte akuzuar për ndërmarrjen e një sërë veprimesh të korrupsionit gjatë procedurës së hetimit dhe aktakuzës kundër parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës, u shpall dëshmitar bashkëpunues në procedurën kundër N.M..

22. Më 6 qershor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. 413/2013) e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë (Aktgjykimi 346/12 i 23 majit 2013) dhe e shpalli prokurorin special fajtor për shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit dhe e dënoi atë me burgim.

Aktakuza e ndryshuar dhe procedura gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës

23. Më 17 nëntor 2014, PSRK-ja ndryshoi aktakuzën e ngritur kundër parashtruesit të kërkesës duke aplikuar dispozitat e KPK të ri, të cilat ishin më të favorshme për parashtruesin e kërkesës.

24. Më 18 nëntor 2014, PSRK-ja ngriti aktakuzën e ndryshuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

25. Më 16 qershor 2014, filluan procedurat gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës.

26. Gjatë procedurës gjyqësore, PSRK-ja u përfaqësua nga një prokuror special i zëvendësuar.

27. Më 21 janar 2015, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 516/2012) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për tri vepra penale: mashtrimi, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe falsifikimit të dokumenteve zyrtare dhe autorizimit, dhe e dënoi atë me burgim.

28. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të ligjit penal dhe procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe apeloi vendimin përkitazi me dënimin.

29. Më 6 gusht 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 231/2015) e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

30. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se: "*Në këtë çështje penale nuk është kontestuese se aktakuzën PPS. nr.87/10 me dt. 10.08.2011, e ka ngritur ish prokurori special N.M.. Gjatë shqyrtimit gjyqësor aktakuzën e Prokurorisë Speciale e ka përfaqësuar prokurori special-R. M, i cili edhe ka bërë ndryshimin e aktakuzës. Në vetë ankesën e të akuzuarit Mirashi dhe mbrojtëses së tij theksohet se me vendim të kryeprokurores së Prokurorisë Speciale është refuzuar kërkesa për përjashtimin e prokurorit R. M., prandaj, që në atë fazë i akuzuari dhe mbrojtësja kanë shfrytëzuar të drejtat e tyre ligjore dhe përfaqësuesi i akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pasur një vendim meritor. Përfaqësuesi i akuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vepruar në tërësi në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.*"

31. Gjykata e Apelit më tej konstatoi se: *"Sa i përket pretendimit të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij se i akuzuari, me urdhëresën e Gjykatës së Qarkut në Pejë, PP. nr. 43/12, të dt. 01.06.2012 i akuzuari, është shpallur dëshmitari bashkëpunues, prandaj, ndaj tij nuk mund të zhvillohet kurrfarë procedure penale janë pretendime të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e saja, të cilat i aprovoi edhe kjo gjykatë se Pashk Mirashi, është shpallur dëshmitar bashkëpunues për veprat penale që ndërlidhen me të akuzuarit N. M., dhe [...] dhe atë për veprat penale dhënia e ryshfetit nga neni 344 par. 1 i KPK-së, ushtrimi i ndikimit nga neni 345, par. 2 KPK-së nxitja në kundërshtim me nenin 24 i KPK-së, për të kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare apo i autoritetit nga neni 399 të KPK-së. Pra, i akuzuari është shpallur dëshmitar bashkëpunues vetëm sa i përket veprave dhe personave & cituara më lart dhe veprimet e tij që ndërlidhen me këta të akuzuar, por jo edhe me punën e tij që ka bërë gjatë kohës sa ka qenë drejtor e më vonë likuidator i bankës kreditore - Dega në Gjakovë prandaj, urdhri për Pashk Mirashin për t'u shpallur dëshmitar bashkëpunues nuk ka të bëjë me veprimtarinë e Pashk Mirashit njëherë si Drejtor e pastaj si likuidator i Bankës Kreditore-Dega në Gjakovë, dhe* se *procedura penale e zhvilluar ndaj Pashk Mirashit është tërësisht e bazuar në ligj"*.

Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

32. Më 7 shtator 2015, parashtruesi parashtroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

33. Në kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale, parashtruesi pohoi se hetimet ishin kryer nga një ish-prokuror special, i cili për të njëjtin rast ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim me një aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të 23 majit 2013 dhe gjithashtu kërkoi dëgjimin e dy dëshmitarëve të tjerë. Parashtruesi i kërkesës përfundoi se në cilësinë e tij si dëshmitar bashkëpunues gjatë hetimit dhe gjykimit të ish-prokurorit special nuk mund të shpallet fajtor për veprat penale për të cilat ai ishte akuzuar.

34. Më 16 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi KP. nr. 603/2015) e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale.

35. Gjykata Themelore arsyetoi se *"Pretendimet për rishikimin e procedurës penale bazohen në dispozitat e nenit 423 të KPCRK, një dispozitë që parashikon që procedurat e përfunduara me një vendim të formës së prerë mund të rishikohen kur vërtetohet se vendimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore, ndërsa në këtë çështje penale veprimet hetimore janë bërë nga ish-prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës [N.M.], i cili u shpall fajtor për të njëjtin rast dhe u dënua me vendim të formës së prerë. Ky pohim i mbrojtjes së të dënuarit Pashk Mirashi, nuk qëndron sepse aktakuza e ngritur nga [N.M.], ish-prokuror, është ndryshuar dhe përfaqësuar nga prokurori special, [R.M.]"*.

36. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

37. Më 20 korrik 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendimi PN. nr. 523/2016) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

38. Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj konstatoi se: *"[...]Kështu edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk plotësohen kushtet ligjore për lejimin e rishikimit të procedurës penale konform dispozitave të nenit 423 par. 1 pika 1.3 të KPP, ngase, nga shkresat e lëndës del se nuk janë ofruar fakte dhe prova të reja, të cilat e arsyetojnë lejimin e rishikimit të procedurës penale, ndaj të dënuarit Pashk Mirashi"*.

39. Në një datë të pacaktuar, kundër aktvendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 16 dhjetorit 2015 dhe Gjykatës së Apelit, të 20 korrikut 2016, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

40. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi pretendoi shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit penal dhe procedurës penale. Në të njëjtën kohë, ai i propozoi Gjykatës Supreme ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe të shtyjë ekzekutimin e dënimit.

41. Më 20 tetor 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML. nr. 228/16) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

42. Gjykata Supreme konkludoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura në mjetin juridik janë vetëm përsëritje e atyre të paraqitura në ankesë *"[...] kundër aktgjykimit të shkallës së parë [Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, të 21 janarit 2015] dhe në ankesën e fundit kundër Aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë [Aktvendimi i Gjykatës Themelore, të 16 dhjetorit 2015], e cila ka hedhur kërkesën për rishikimin e procedurës penale [...]"*.

Ekzekutimi i dënimit me burgim

43. Më 4 prill 2017, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën që në bazë të një urdhri të gjykatës ai u arrestua dhe u dërgua në një institucion korrektues për të vuajtur dënimin e tij me burgim.

44. Më 11 prill 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi ED. nr. 1624/15) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim si të pabazuar. Sipas Gjykatës Themelore, fakti që parashtruesi ka parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë *"së procedurës penale kundër [parashtruesit të kërkesës] dhe kërkesës për masë të përkohshme [...] në Gjykatë konsiderohen si arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit të tij me burg."*

45. Parashtruesi e njoftoi Gjykatën se kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 11 prillit 2017, ai parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Deri në këtë datë, Gjykata nuk është njoftuar për ndonjë vendim të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

47. Parashtruesi gjithashtu konsideron se: "*Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës e kanë shkelur të drejtën e [parashtruesit të kërkesës] për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm."* Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Nga rrethanat e rastit është e qartë se përmes PSRK-së, prokurori special N. M. kishte iniciuar procesin hetimor penal kundër [parashtruesit të kërkesës]. I njëjti prokuror special kishte keqpërdorur pozitën zyrtare, ishte shpallur fajtor dhe dënuar me aktgjykim të prerë për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës së tij zyrtare gjatë hetimeve."*

48. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se "*Në faqen 7 të Aktgjykimit të Gjykatës e Apelit [6 gusht 2015] pranohet se prokurori special i Kosovës R. M. ka bërë ndryshime në aktakuzë. [...] Për çfarëdo arsye, Gjykata Themelore e Prishtinës po ashtu Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë dështuar të kërkojnë konfirmimin e aktakuzës së ndryshuar dhe kështu ia kanë mohuar parashtruesit të këtij referimi mjetet e garantuara ligjore që parashihen me nenin 249 dhe 250 të Kodit të Procedurës Penale".*

49. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata, që:

> *i) "E shpallë këtë referim të pranueshëm dhe të bazuar; si dhe*
> *ii) E shpallë të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr. PML. 228/2016, i datës 20 tetor 2016, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës nr. P. 516/12 (PPS nr. 87/10), i datës 21 janar 2015; dhe Aktgjykimin e Gjykatës e Apelit të Kosovës nr. PAKR. 231/2015 i datës 8 qershor 2015, që e shkelin nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 dhe 13, të KEDNJ-së .*

50. Pas parashtrimit të kërkesës së tij në Gjykatë, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit e njoftoi Gjykatën se parashtruesi i kërkesës, në bazë të urdhrit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ishte ndaluar dhe ishte vendosur në një institucion korrektues për të vuajtur dënimin me burg.

51. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, më 4 prill dhe 18 prill 2017, ka parashtruar kërkesa në Gjykatë për të vendosur masë të përkohshme dhe për të urdhëruar lirimin e parashtruesit nga burgu derisa Gjykata të nxjerrë një vendim përfundimtar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

52. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të përcaktuara në Kushtetutë dhe më tej të parapara në Ligj dhe specifikuara në Rregullore të punës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

54. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]".*

55. Gjykata më tej i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;*
>
> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
> *[...]*
> *(e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën*
> *[...]".*

56. Gjykata rikujton që parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se gjykatat e rregullta gjatë procedurës penale dhe rishikimit të procedurës penale kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

57. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kërkon nga Gjykata që të deklarojë se të gjitha procedurat penale, duke përfshirë procedurën e aktakuzës, procedura penale në të cilën ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim, si dhe rishikimi i procedurës penale që "*[...] të shpallet i pavlefshëm e që është në shkelje të të drejtës Kushtetuese të parashtruesit për një gjykim të drejtë me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNj-së".*"

Sa i përket procedurës penale

58. Sa i përket procedurës penale, Gjykata vëren se vendimi i fundit dhe përfundimtar në procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 231/2015, i 6 gushtit 2015), me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh: *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ".*

59. Megjithëse parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar datën kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, është e qartë se periudha ndërmjet datës së këtij vendimi, d.m.th. 6 gushtit 2015 dhe datës së dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatë, pra 1 shkurtit 2017, ka kaluar afatin ligjor të përcaktuar në nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe në rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

60. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së gjatë procedurës penale, është e papranueshme për shkak se është e paafatshme.

Sa i përket procedurës së rishikimit

61. Sa i përket rishikimit të procedurës penale, Gjykata vëren se vendimi i fundit lidhur me rishikimin e procedurës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. nr. 228/2016, i 20 tetorit 2016, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Vendimit të Gjykatës së Apelit (Aktvendimi PN. nr. 523/2016, i 20 korrikut 2016) dhe Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë (Aktvendimi KP. nr. 603/2015 i 16 dhjetorit 2016).

62. Gjykata vëren se në këtë procedurë, gjykatat e rregullta vendosën vetëm lidhur me përmbushjen e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës penale dhe jo për meritat e rastit.

63. Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, *"të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

64. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsëritë se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës. (Shih, në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, paragrafi 37; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31, shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 Janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

65. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila konstaton se neni 6 nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti sepse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij nuk është "akuzuar për vepër penale" brenda kuptimit të atij neni (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë* nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003)

66. Gjykata konsideron se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. *"E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtueshmëri ratione materiae me Kushtetutën."* (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31).

67. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të rishikuar procedurën penale nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

68. Në përfundim, Gjykata, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) dhe (3) (e) konstaton se kërkesa:

a) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën penale duhet të deklarohet e papranueshme për shkak se është e paafatshme; dhe
b) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me rishikimin e procedurës penale duhet të deklarohet e papranueshme, sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

69. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, duke kërkuar nga Gjykata që ta urdhërojë lirimin e parashtruesit të kërkesës nga burgu derisa Gjykata të nxjerrë një vendim përfundimtar.

70. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se "ekzekutimi i paligjshëm" i dënimit me burgim shkel të drejtat e tij të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

71. Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës i cili parasheh:

"[...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

(d) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(e) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(f) masa e përkohshme është me interes publik."

72. Siç u konkludua më sipër, kërkesa është e papranueshme dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 49 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (c) dhe (3) (e), si dhe 55 dhe 56 të Rregullores së punës, më 29 maj 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQEVE
A	
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit	58, 183
Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP)	41, 42, 43, 44, 58, 59, 60, 63, 109, 110, 182, 183, 185, 207, 208, 321, 322, 329, 330, 333, 335, 361, 362, 363, 364, 365, 389, 390, 391, 392, 591
Aktgjykim	445, 466, 569
Aktvendim për Papranueshmëri	12, 13, 18, 19, 24, 26, 27, 32, 33, 37, 39, 40, 45, 48, 49, 53, 57, 65, 66, 74, 76, 83, 93, 94, 100, 101, 113, 114, 116, 120, 125, 128, 130, 131, 141, 142, 148, 149, 154, 155, 158, 167, 168, 170, 173, 182, 187, 188, 197, 199, 200, 203, 206, 211, 212, 219, 221, 222, 228, 229, 232, 245, 250, 251, 295, 296, 302, 303, 311, 312, 325, 326, 337, 338, 341, 359, 360, 372, 373, 377, 379, 381, 387, 388, 395, 396, 403, 405, 406, 411, 412, 416, 417, 420, 422, 423, 430, 432, 433, 438, 439, 459, 460, 494, 495, 501, 502, 508, 511, 517, 518, 523, 525, 526, 534, 537, 538, 544, 545, 546, 547, 552, 553, 560, 561, 572, 584, 585, 593, 594, 601, 602
Aksident	12, 14, 50
Amendament	102, 104, 105, 115, 261, 262, 348
Ankesë kushtetuese	30, 93, 96, 564, 602
Avokat	13, 19, 24, 27, 33, 35, 37, 40, 49, 66, 76, 131, 132, 133, 134, 137, 155, 202, 203, 206, 212, 222, 236, 287, 291, 296, 311, 313, 320, 321, 326, 361, 373, 379, 381, 382, 384, 423, 425, 426, 427, 428, 429, 445, 466, 511, 538, 539, 544, 547, 561, 565, 594
Avokati i Popullit	102, 160, 159, 259, 260, 282, 283, 284, 342, 343, 345, 349
B	

Barazia para Ligjit 32, 33, 49, 55, 57, 125, 130, 131, 141, 187, 188, 192, 206, 208, 209, 211, 212, 217, 228, 229, 230, 251, 253, 257, 258, 262, 265, 271, 287, 387, 388, 392, 405, 406, 465, 466, 468, 472, 477, 480, 482, 483, 489, 491, 501, 502, 518, 525, 527, 530, 535, 547, 550, 584, 585

Baza Juridike 13, 19, 28, 33, 41, 50, 55, 57, 58, 59, 66, 76, 94, 102, 125, 132, 142, 149, 155, 161, 168, 173, 182, 188, 200, 206, 213, 222, 229, 237, 243, 251, 259, 284, 288, 291, 296, 298, 303, 312, 320, 327, 338, 344, 360, 374, 381, 388, 396, 406, 412, 417, 423, 433, 439, 445, 455, 460, 467, 495, 503, 512, 518, 527, 538, 547, 556, 561, 570, 585, 595

D

Deputetët 11, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 108, 111, 112, 114, 161, 257, 258, 259, 260, 261, 263, 264, 344, 349

Dëshmitar 35, 36, 37, 174, 175, 176, 177, 179, 187, 190, 191, 192, 195, 196, 197, 244, 245, 246, 247, 249, 383, 425, 426, 427, 428, 429, 565, 568, 571, 572, 573, 574, 576, 577, 578, 579, 580, 581, 582, 596, 597

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) 49, 51, 52, 257, 259, 262, 265, 266, 270, 271

DH

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme 11, 39, 40, 41, 60, 182, 183, 184, 186, 206, 207, 208, 225, 300, 319, 320, 322, 323, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 334, 335, 360, 361, 363, 364, 365, 369, 387, 388, 390, 391, 586, 588, 591

E

E Drejta

e pronës 88, 109, 154, 157, 224, 225, 226, 257, 266, 307, 365, 383, 405, 408

për pension 22, 257, 263, 265, 268, 270, 273, 274, 275, 278, 279

për kompensim 530, 534

për gjykim të drejtë dhe të paanshëm 12, 13, 15, 26, 29, 30, 33, 39, 40, 43, 48, 49, 55, 57, 60, 66, 73, 76, 84, 85, 93, 94, 96, 97, 130, 131, 141, 142, 159, 160, 161, 173, 177, 188, 196, 199, 200, 202, 206, 208, 209, 211, 212, 217, 221, 222, 228, 229, 230, 241, 242, 246, 247, 251, 253, 258, 262, 282, 283, 287, 303, 306, 325, 326, 333, 342, 343, 345, 350, 351, 372, 373, 375, 376, 387, 388, 392, 406, 423, 426, 438, 439, 441, 444, 445, 448, 451, 459, 460, 462, 465, 466, 468, 477, 480, 481, 482, 483, 489, 491, 492, 494, 495, 501, 502, 510, 511, 518, 525, 527, 530, 532, 534, 537, 538, 542, 543, 544, 546, 547, 550, 556, 561, 564, 568, 569, 573, 575, 576, 581, 582, 583, 585, 593, 594, 599

për proces të rregullt 130, 131, 160, 173, 177, 195, 206, 208,209, 222, 242, 246, 247, 251, 283, 290, 292, 303, 343, 345, 350, 351, 354, 392, 438, 439, 444, 451, 494, 495, 502, 510, 511, 518, 527, 530, 538, 542, 544, 550, 561, 564, 569, 573, 575, 576, 581, 582, 583, 585, 594, 599

për zgjidhje efektive 40, 41, 43, 76, 251, 303, 594, 599

e punës dhe ushtrimit të profesionit 100, 101, 108, 118, 119, 211, 212, 217, 396, 401, 402, 403, 527, 530, 535

zgjedhore dhe e pjesëmarrjes 287, 465, 466, 471, 477, 481, 482, 491

për mjete juridike 32, 33, 39, 40, 43, 44, 142, 212, 217, 251, 253, 303, 307, 525, 527, 530, 594, 599

Ex officio 368

F

Fond 28, 29, 121, 151, 215, 216, 217, 218, 363, 420, 490, 606

G

Gazeta Zyrtare e Kosovës 175, 215, 314, 507, 606

Gazeta Zyrtare e RSFJ-së

GJ

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)	30, 197, 300, 492, 499, 500, 508, 551, 606
Gjykata Komunale	
në Gjakovë	55, 59, 61, 62, 606
në Ferizaj	126, 496, 497, 606
në Prishtinë	389, 503, 587, 588, 606
në Prizren	213, 214, 216, 539, 540,541, 606
në Pejë	132, 134, 143, 146, 147, 444, 446, 606
në Vushtrri	21, 606
në Suharekë	221, 223, 606
Gjykata e Qarkut	
në Prishtinë	459, 587, 596, 606
në Pejë	133, 143, 606
në Prizren	214, 216, 459, 461, 540, 606
Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë	28, 606
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës	2, 13, 16, 19, 27, 33, 40, 41, 49, 57, 66, 76, 94, 101, 125, 131, 142, 149, 155, 160, 168, 173, 182, 188, 200, 206, 209, 212, 219, 221,222, 229, 236, 242, 245, 251, 258, 283, 287, 291, 296, 303, 312, 320, 326, 343, 360, 374, 381, 388, 393, 396, 406, 412, 417, 423, 433, 439, 443, 445, 455, 460, 466, 476, 478, 495, 502, 511, 518, 526, 538, 547, 556, 561, 569, 572, 575, 582, 585, 594, 606.
Gjykata Supreme e Kosovës	14, 18, 35, 53, 65, 67, 70, 97, 98, 127, 177, 221, 224, 246, 247, 250, 253, 337, 399, 400, 401, 407, 420, 449, 461, 505, 530, 537, 540, 541, 542, 550, 573, 574, 583, 599, 607
Gjyqtar raportues	14, 20, 28, 34, 41, 77, 102, 132, 143, 150, 156, 174, 189, 201, 207, 213, 223, 230, 252, 259, 292, 313, 321, 327, 361, 374, 382, 389, 397, 407, 413, 418, 434, 440, 446, 456, 496, 503, 512, 519, 527, 539, 548, 557, 586, 595, 607

I

Imunitet 103, 104, 189, 191, 194, 195, 215, 217, 218, 219, 261, 284, 344, 607

Inter alia 14, 21, 22, 24, 26, 30, 34, 35, 37, 48, 53, 61, 90, 116, 143, 144, 201, 202, 205, 238, 244, 245, 246, 298, 304, 305, 306, 349, 356, 372, 422, 457, 468, 478, 481, 508, 571, 572, 573, 580, 601, 607

J

Juridiksion 21, 45, 53, 65, 74, 79, 82, 87, 98, 138, 162, 163, 185, 203, 311, 345, 346, 347, 352, 353, 354, 356, 357, 365, 369, 409, 420,429, 499, 607

K

Kërkesë e paafatshme 337, 411, 607

Kërkesë e parakohshme 130, 607

Kërkesë e papranueshme 187, 290, 405, 411, 555, 584, 607

Kërkesë e pranueshme 159, 257, 282, 342, 607

Kërkesë individuale 12, 18, 26, 32, 39, 52, 55, 65, 69, 74, 130, 148, 154, 187, 199, 221, 228, 235, 241, 250, 286, 290, 295, 302, 311, 345, 346, 347, 352, 353, 354, 356, 357, 365, 369, 409, 420, 429, 499, 607

Kërkesë qartazi e pabazuar 12, 15, 18, 23, 24, 36, 39, 44, 48, 52, 54, 56, 61, 64, 65, 69, 73, 75, 84, 91, 93, 97, 99, 112, 122, 128, 129, 141, 145, 147, 185, 186, 187, 191, 198, 199, 202, 208, 210,211,218, 221,224, 227, 228, 231, 233, 250, 254, 255, 295, 301, 302, 309, 311, 316, 325, 333, 335, 372, 376, 378, 380, 386, 387, 391, 393, 395, 402, 403, 405, 408, 409, 419, 420, 422, 427, 430, 432, 436, 437, 438, 442, 443, 448, 475, 477,489, 494, 499, 500, 501, 506, 509, 510, 514, 516, 517, 521, 523, 525, 531, 536, 537, 543, 545, 546, 553, 560, 564, 567, 578, 584, 589, 592, 607

Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë 190, 245, 375, 435, 520, 572, 608

Kërkesë e bashkuar 29, 608

Kërkesë për rishqyrtim 80, 90, 530, 532, 608

Këshilli

i Pavarur Mbikëqyrës (KPMK) 20, 126, 296, 297, 526, 608

Gjyqësor i Kosovës (KGJK) 235, 286, 287, 328, 465, 466,468, 471, 472, 473, 474, 477, 478, 480, 481, 482, 483, 489, 490, 491, 608

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme 39, 42, 43, 44, 45, 55, 59, 62, 81, 82, 86, 90, 154, 156, 184, 207, 209, 302, 305, 306, 309, 311, 312, 314, 315, 316, 317, 318, 321, 329, 332, 333, 335, 390, 393, 608

Kolegji shqyrtues 14, 20, 28, 34, 41, 46, 50, 58, 67, 77, 95,103, 126, 132, 139, 143, 150, 156, 169, 174, 180, 183, 201, 207, 213, 223, 230, 237, 239, 252, 260, 284, 288, 289, 292, 297, 304, 313, 321, 329, 339, 345, 361, 374, 382, 389, 397, 407, 413, 418, 424, 434, 440, 446, 456, 461, 467, 496, 503, 512, 519, 527, 539, 548, 553, 557, 562, 570, 586, 595, 602, 608

Kontratë

e punës 22, 126, 217, 366, 608

për shitblerje 55, 58, 59, 62, 64, 78, 79, 82, 95, 131, 137, 139, 176, 244, 311, 313, 314, 379, 382, 383, 384, 446, 572, 586, 587, 608

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 230, 231, 425, 608

Kodi Penal i Kosovës (KPK) 340, 608

Komuna e

Prishtinës 291, 312, 548, 549, 609

Podujevës 49, 182, 397, 398, 399, 400, 401, 609

Suharekës 223, 302, 304, 609

Vushtrrisë 21, 22, 511, 609

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) 119, 609

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 18, 32, 33, 36, 37, 38, 41, 43, 44, 45, 49, 51, 52, 55, 57, 59, 61, 63, 64, 66, 68, 69, 70, 72, 76, 81, 84, 85, 86, 88, 89, 91, 94, 97, 98, 99, 117, 118, 129, 131, 136, 137, 160, 161, 165, 185, 186, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 206, 208, 209, 212, 217, 222, 226, 251, 253, 254, 255, 259, 262, 265, 266, 270, 271, 273, 275, 277, 280, 283, 291, 292, 303, 305, 306, 307, 308, 309, 318, 326, 327, 328, 329, 333, 343,

345, 350, 351, 352, 353, 354, 356, 357, 358, 364, 385, 386, 392, 393, 429, 439, 441, 442, 443, 444, 450, 451, 460, 462, 495, 499, 502, 505, 506, 508, 511, 513, 515, 518, 521, 522, 527, 530, 532, 538, 542, 544, 561, 563, 564, 566, 576, 577, 582, 594, 599, 600, 601, 602, 609

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) 236, 609

Kompensim 22, 109, 110, 118, 119, 120, 132, 137, 223, 297, 321, 361, 362, 363, 370, 392, 476, 496, 525, 528, 531, 540, 548, 551, 582, 609

Kryeministri i Republikës së Kosovës 260, 609

Kuvendi i Republikës së Kosovës 107, 123, 609

Kundërvajtje 6, 7, 34, 35, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 282, 283, 285, 342, 343, 345, 346, 347, 348, 349, 351, 352, 353, 355, 356, 357, 358, 397, 560, 562, 563, 566, 609

Kthim në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum) 96, 97, 98, 184, 609

L

Legjitimiteti pasiv 215, 610

Ligji

për Gjykatat 243, 368, 610

për Gjykatën Kushtetuese 13, 19, 28, 33, 50, 57, 66, 76, 94, 100, 102, 121, 123, 125, 132, 142, 149, 155, 161, 168, 174, 182, 188, 200, 206, 213, 222, 229, 237, 243, 247, 251, 259, 281, 284, 288, 291, 295, 302, 303, 312, 320, 327, 338, 344, 359, 360, 362, 374, 381, 388, 396, 406, 412, 417, 423, 424, 433, 439, 445, 455, 460, 463, 467, 495, 503, 512, 518, 527, 538, 547, 556, 562, 570, 585, 595, 610

për Konfliktet Administrative 163, 347, 355, 356, 610

për Marrëdhëniet e Detyrimeve 175, 250, 254, 459, 462, 610

për Procedurën Kontestimore 60, 63, 90, 185, 250, 254, 389, 413, 452, 505, 507, 610

për Procedurën Përmbarimore 29, 610

mbi Qarkullimin 78, 610

M

Marrje e ryshfetit 34, 35, 201

Masa e Përkohshme 46, 47, 139, 164, 165, 166, 176, 178, 180, 237, 239, 240, 243, 248, 249, 283, 284, 288, 289, 344, 467, 553, 570, 582, 587, 588, 602

Mbrojtja

Gjyqësore e të Drejtave 33, 39, 40, 43, 48, 49, 142, 173, 177, 211, 212, 217, 242, 246, 247, 291, 302, 303, 307, 372, 373, 376, 387, 388, 393, 525, 527, 530, 568, 569, 573, 575, 576, 583, 594, 599, 609

e Pronës 55, 57, 76, 88, 100, 101, 108, 117, 131, 141, 154, 155, 221, 222, 225, 226, 257, 258, 259, 262, 266, 275, 277, 303, 307, 365, 379, 381, 405, 406, 459, 460, 462, 463, 501, 584, 585

Mendim mospajtues 452, 483

Ministria (ministri)

e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 151

e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 560

e Drejtësisë 161, 344, 348

e Financave 78, 103, 260, 284, 344, 528, 529

e Integrimeve Evropiane 260, 284, 344

e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 417

e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 398, 399

e Tregtisë dhe Industrisë 28

Mos zbulim i identitetit 222, 227

Mutatis mutandis 18, 24, 32, 37, 45, 83, 96, 114, 116, 120, 138, 146, 157, 179, 197, 203, 219, 232, 233, 255, 267, 276, 300, 309, 318, 335, 352, 353, 354, 377, 385, 386, 403, 415, 420, 428, 429, 448, 477, 480, 500, 508, 514, 515, 523, 534, 544, 551, 552, 566, 576

N

Ndërmarrje Shoqërore 39, 41, 42, 110, 182, 183, 185, 321, 329, 361, 364, 366, 389, 586, 587, 588, 591

Ndalimi i diskriminimit 192, 257, 259, 262, 265, 266, 271, 275, 392, 585

Ndalimi i Torturës 188, 191, 193

P

Palët/Pala e Autorizuar/a 30, 43, 60, 68, 84, 96, 111, 148, 152, 161, 184, 191, 202, 218, 231, 253, 259, 264, 284, 305, 315, 323, 338, 340, 344, 349, 350, 359, 363, 367, 368, 376, 383, 384, 396, 401, 402, 419, 423, 435, 444, 448, 460, 470, 475, 483, 489, 499, 503, 505, 513, 521, 543, 551, 564, 565, 600

Palë e tretë 249, 440, 442, 577, 586, 587, 588, 591

Parashkrim 176, 462, 560, 563, 565, 566, 578

Parashtruesi i kërkesës 14, 15, 16, 19, 20, 22, 23, 27, 28, 29, 32, 33, 35, 36, 37, 38, 46, 49, 51, 52, 53, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 72, 73, 94, 96, 97, 98, 99, 101, 126, 128, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 138, 139, 142, 143, 145, 146, 149, 151, 152, 155, 160, 161, 162, 163, 164, 168, 169, 173, 174, 175, 176, 178, 185, 188, 189, 191, 192, 194, 196, 197, 198, 200, 201, 202, 203, 206, 207, 208, 209, 215, 222, 229, 230, 231, 232, 233, 236, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 251, 252, 253, 254, 255, 283, 291, 292, 293, 296, 298, 299, 300, 304, 305, 312, 313, 314, 315, 317, 320, 321, 322, 324, 338, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 350, 353, 354, 373, 347, 375, 381, 382, 383, 384, 388, 393, 406, 408, 409, 412, 413, 417, 418, 423, 424, 426, 430, 434, 435, 445, 447, 449, 452, 455, 456, 457, 458, 460, 473, 495, 497, 499, 505, 506, 511, 512, 514, 518, 519, 520, 538, 539, 547, 548, 549, 556, 558, 561, 569, 570, 572, 573, 574, 577, 578, 585, 586, 587, 594, 595, 597, 598, 601

Parimet e Përgjithshme 61, 76, 85, 88, 90, 100, 101, 108, 117, 118, 120, 125, 130, 131, 136, 211, 212, 217, 266, 267, 275, 308, 365, 387, 388, 439, 441, 445, 448, 478, 513, 521, 525, 527, 530, 535, 543, 561, 564

Parimi i subsidiaritetit 300, 428, 484

Pension 20, 21, 22, 23, 245, 248, 249, 263, 265, 268, 269, 270, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 570, 573, 574, 576, 577, 580, 582

Person Juridik 93, 96, 148, 152, 295, 498, 537

Pranueshmëria e kërkesës 15, 60, 83, 96, 151, 218, 263, 292, 349, 391, 435, 557

Pretendim 15, 16, 22, 23, 24, 29, 35, 36, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 51, 53, 54, 59, 60, 61, 62, 63, 65, 68, 70, 72, 73, 79, 82, 84, 86, 89, 93, 96, 97, 98, 99, 108, 109, 110, 112, 114, 116, 117, 118, 120, 121, 122, 127, 128, 135, 136, 143, 144, 145, 146, 147, 156, 162, 165, 169, 174, 175, 177, 183, 184, 185, 186, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 197, 201, 202, 203, 208, 209, 216, 217, 224, 226, 230, 231, 238, 244, 246, 249, 253, 254, 255, 263, 264, 274, 280, 292, 298, 301, 306, 308, 309, 311, 314, 315, 317, 322, 333, 345, 349, 350, 351, 352, 361, 364, 366, 370, 375, 377, 378, 379, 384, 385, 390, 391, 393, 402, 403, 407, 408, 426, 428, 430, 435, 436, 441, 442, 447, 449, 457, 464, 471, 476, 483, 486, 487, 520, 521, 522, 523, 528, 530, 533, 535, 542, 543, 544, 545, 551, 552, 557, 535, 563, 565, 566, 571, 577, 579, 586, 588, 590, 597, 598, 599, 600, 601, 602

Presidenti i Republikës së Kosovës 161, 237, 240, 289, 344, 345, 349, 468

Prima facie 15, 16, 23, 36, 44, 46, 52, 61, 69, 84, 97, 112, 128, 139, 145, 164, 165, 180, 185, 191, 202, 208, 209, 218, 224, 231, 240, 248, 250, 254, 255, 316, 318, 333, 376, 383, 385, 391, 393, 402, 408, 419, 427, 436, 438, 442, 443, 448, 475, 499, 500, 506, 509, 514, 515, 517, 521, 523, 531, 543, 546, 553, 560, 564, 566, 589, 602

Procesi i privatizimit 391

Procedurë penale 65, 68, 69, 72, 579, 593

Procedurë civile 241, 537, 568

Prokuror 35, 53, 71, 146, 189, 191, 194, 196, 230, 232, 322, 425, 426, 515, 597, 598, 599

Prokurori Publik 35, 339, 340

Prokurori i Shtetit 34, 53, 67, 179, 189, 201, 232, 245, 247, 395, 400, 413, 504, 529, 563, 572, 574, 580, 581, 582

Paluajtshmëri 133, 134, 135, 138, 221, 223, 226, 379, 382, 384, 405, 407, 408, 409

Q

Qeveria e Republikës së Kosovës 107, 108, 109, 260

Ratione materiae 26, 30, 31, 274, 363, 593, 600, 602

Res Judicata 74, 80, 81, 82, 85, 86, 87, 88, 91, 136, 296, 298, 299, 363, 462, 463

Revizion 18, 19, 22, 26, 29, 78, 79, 96, 97, 127, 141, 175, 176, 177, 214, 215, 216, 217, 221, 224, 226, 244, 246, 250, 252, 253, 379, 382, 407, 416, 418, 444, 447, 449, 450, 451, 453, 498, 501, 502, 504, 507, 539, 541, 542, 544, 549, 550, 551, 552, 571, 573, 579, 580

Rigjykim 15, 21, 29, 34, 50, 59, 85, 91, 143, 144, 146, 174, 178, 201, 375, 400, 425, 497, 513, 540, 563, 564

S

Seancë dëgjimore 41, 46, 139, 238, 287, 348, 466

Sundimi i Ligjit 82, 90, 550

U

UNMIK-u (Rregulloret) 20, 22, 28, 43, 44, 62, 79, 81, 82, 213, 215, 217, 218, 219, 312, 315, 316, 379, 386, 390, 392, 407, 496, 497, 587

V

Vepër penale 35, 70, 71, 72, 194, 195, 196, 197, 230, 377, 429, 432, 435, 446

Vlerësim i

Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit 18, 19, 32, 33, 39, 40, 48, 65, 66, 74, 76, 124, 125, 141, 142, 154, 155, 167, 168, 172, 173, 199, 200, 205, 205, 206, 221, 222, 225, 253, 290, 291, 292, 293, 300, 302, 303, 311, 312, 337, 338, 372, 373, 379, 381, 387, 388, 396, 416, 417, 422, 423, 428, 433, 437, 438, 439, 444, 445, 452, 494,

495, 510, 511, 517, 518, 525, 526, 546, 547, 593, 594

i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit 12, 13, 16, 55, 57, 93, 94, 130, 131, 181, 182, 219, 228, 229, 241, 242, 251, 295, 296, 395, 396, 405, 406, 443, 459, 460, 560, 561, 568, 569

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni Titulli/Emërtimi **Numri i faqes**

KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE

5 Gjuhët 103, 192, 195, 250, 252, 253, 265, 266, 535

7 Vlerat 76, 89, 164, 353, 547, 550

KAPITULLI II
TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

21 Parimet e përgjithshme 61, 76, 85, 88, 90, 100, 102, 108, 118, 120, 125, 130, 131, 136, 211, 212, 217, 265, 267, 275, 308, 365, 387, 388, 438, 439, 445, 448, 521, 525, 527, 530, 536, 543, 561, 56

22 Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare 48, 55, 100, 101, 108, 125, 177, 211, 212, 217, 242, 246, 247, 270, 273, 275, 287, 288, 438, 439, 441, 518, 556, 569, 575, 576, 581

24 Barazia para ligjit 32, 33, 49, 55, 57, 125, 130, 131, 141, 187, 188, 192, 206, 208, 209, 211, 212, 317, 228, 229, 230, 251, 253, 257, 258, 261, 262, 265, 271, 287, 288, 292, 405, 406, 465, 466, 468, 472, 478, 480, 483, 491, 502, 518, 525, 530, 547, 550, 584, 585

27 Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshterues 188, 192

29 E drejta e lirisë dhe sigurisë 49, 188, 193, 229, 230, 231, 556

30 Të drejtat e te akuzurit 195, 556, 187

31 E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm 12, 13, 15, 26, 29, 30, 34, 39, 40, 50, 55, 60, 66, 73, 76, 84, 85, 93, 94, 96, 131, 141, 142, 159, 160, 161, 173, 177, 188, 196, 199, 200, 206, 208, 209, 212, 217, 221, 222, 228, 230, 241, 242, 246, 247, 251, 253, 257, 262, 282, 283, 287, 303, 306, 325, 326, 333, 342, 343, 350, 351, 372, 374, 392, 406, 423, 426, 438, 439, 444, 448, 451, 459, 460, 462, 465, 466, 468, 477, 480, 481, 482, 483, 489, 491, 492, 494, 495, 502, 510, 511, 518, 525, 527, 530, 532, 533, 538, 542, 546, 547,

	550, 556, 561, 564, 568, 569, 573, 575, 576, 581, 582, 583, 585, 593, 594
32 E drejta për mjete juridike	32, 33, 39, 40, 43, 142, 211, 217, 251, 303, 525, 527
45 Te drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	287, 465, 471, 477, 481, 482, 491
46 Mbrojtja e pronës	55, 57, 76, 88, 100, 102, 108, 116, 117, 131, 142, 154, 155, 221, 222, 225, 231, 257, 259, 262, 266, 275, 277, 305, 307, 379, 380, 381, 405, 406, 459, 460, 462, 463, 501, 502, 584, 585
49 E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	18, 19, 100, 101, 108, 118, 119, 167, 212, 217, 395, 401, 402, 525, 527, 530, 535
53 Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	49, 226, 266, 295, 300, 350, 387, 388, 392, 514, 527, 530, 556, 577, 581, 594
54 Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	32, 33, 39, 40, 43, 49, 142, 173, 177, 212, 217, 242, 246, 247, 290, 291, 303, 307, 372, 373, 376, 388, 393, 525, 527, 530, 569, 573, 575, 576, 594, 599

KAPITULLI III
TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

58 Përgjegjësitë e shtetit	100, 101, 108, 117
60 Keshilli Konsultativ për Komunitete	100, 102, 108, 109, 117

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102 Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor	75, 90, 130, 132, 136, 365, 478, 480
108 Këshilli Gjyqësor i Kosovës	235, 286, 287, 328, 465, 466, 471, 472, 473, 477, 478, 480, 481, 482, 483, 489, 490, 491

SHKELJE TË NENIT 24, 31, 46 DHE 108 TË KUSHTETUTËS

24	Barazia para Ligjit	281, 482.
31	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	451, 482, 583.
46	Mbrojtja e Pronës	281.
108	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	482.